



محمد

DRITË E PASHUAR

PROFETI MUHAMED (s.a.s.)

M. FETHULLAH GYLEN

1

Hyrje.....	10
Profeti i Derguar si Mëshir për Botët,Agimi I pritur	29
Një Periudhe e Erret	36
Edhe Para Profetesise ai Pati Jetuar si Profet	45
Udhëtimet	52
Udhëtimi për në Damask dhe murgu Bahira.....	52
Udhëtimi i dytë për në Damask.....	54
Çdo njeri atë priste.....	54
Pse s'besuan?	58
Zili dhe xhelozit	60
Ndjenja e rivalitetit.....	65
Shkaqe të tjera.....	68
Profeti i Paralajmeruar dhe i Pritur.....	70
Lutja e Ibrahimit (as), sihariqi i Isait (as)	70
Paralajmërimet e Testamentit të Vjetër	72
Lajmet e gëzueshme të Ungjillit.....	80
Farakliti.....	80
Prijësi i Gjithësisë	82
Ai Eshte Njeriu i Dimensioneve te Veçanta	85
Qellimi i Dergimit te Profeteve	91
E veçanta e Profetit tonë.....	94
Kumtesa te i Dërguari i Allahut.....	97
3. SHEMBULL I BUKUR.....	105
4. SIGURIMI I DREJTPESHIMIT BOTE - AMSHIM	110

5. MBYLLJA E DERES PRETENDIMEVE	112
Veçoritë e Profeteve	117
SHENJTERI	117
2. VULLNETARIZEM.....	118
3. PRINCIPALITET	123
4. KESHILLE E MIRE.....	127
5. THIRRJE PER UNITET	133
Besnikeri dhe Drejtësi	135
Besnikët janë të denjë për lavdërim	137
Injoranca e pati njohur atë si të besueshëm	141
Ai pati këshilluar gjithmonë për drejtësi	144
Ai pati qenë burrë i fjalës	154
Fjalet e Vertetojne Ate	156
Mbi Çeshtjen e se Fshehtes	161
NJOFTIMET E FSHEHTA.....	165
Për kohën e vet	165
Për të ardhmen në një kohë të afërt	171
Intrigat.....	173
Epërsi dhe fitore.....	175
Paqja	178
"Do të jetojë një shekull"	179
E ardhmja e afërt.....	180
Sihariqi për siguri dhe pasuri.....	183
Dëshmia e Ammarit	185
Një fis i pafe në emër të fesë.....	187

Udhëtimi me anije dhe Ummi Haram.....	191
Benu Kantura	192
Triumfi i Stambollit.....	194
E ardhmja e largët.....	197
Intriga e komunizmit.....	201
Thesari në Eufrat.....	203
Pastrimi i jesuizmit.....	204
Përmirësimet në agrokulturë	205
Çekuilibret e ditëve të sotme.....	205
Përhapja e diturisë	209
Ikja nga Kur'ani.....	210
Koncepti i kohës	211
Përhapja e faizit.....	214
Koha kur besimtari do të fshihet	216
Naftë në Talekan	218
LIDHUR ME DEGE TE NDRYSHME TE	
SHKENCAVE.....	222
Shërim për çdo sëmundje	223
Lepra dhe karantina	234
Prekja e gojës së qenit.....	235
Larja e duarve para dhe pas ngrënies	239
Pastrimi i gojës e i dhëmbëve.....	241
Masë në ngrënie	244
Makiazhi'.....	246
Xhenxhefli (Nigella Sativa)	246

Miza	248
Hemorragjia e brendshme	250
Tek pijet alkoolike nuk ka shërim	250
Syneti	252
AMANETI DHE BESUESHMERIA 4.....	256
BESUESHMERIA TE PROFETI YNE.....	259
I besueshëm në detyrën e dërgesës profetike.....	260
I besueshëm ndaj të gjithë qenies.....	265
Ftesa bashkësisë për besueshmëri	272
Besueshmëria e tij në emigracion	280
Besueshmëria e tij në fushën e luftës	282
Nënshtrim marramendës.....	283
O gonxhe të shpresës!	294
KUMTIMI.....	296
TRE PARIME NE KUMTIM	299
METODA NE KUMTIM.....	304
Kumtimi tek ai, një veçori e lindur.....	312
Pasioni ne Kumtim	315
Ftesa Ebu Talibit	316
Ftesa Vahshiut	318
Ftesa Ikrimes	324
Dhimbjet e kumtimit e linin pa gjumë	328
Ashku i kumtimit te sahabet	332
THIRRJE UDHEHEQESVE TE SHTETEVE	337
Nexhashiu.....	338

Herakliti.....	342
Dhe të tjerët	345
HUDEJBIJE NGA KENDVESHTRIMI I KUMTIMIT	347
KUMTIMI NE PLANIN INDIVIDUAL.....	348
MERITIMI I KONSIDERATES HYJNORE	351
DISA SPECIFIKA TE RENDESISHME NE KUMTIM	355
Njohja e mirë e individëve.....	358
Përjetimi paraprak i specifikave që do të kumtohen	364
Veprimi pa pritur shpërblim	371
ZGIUARSIA PROFETIKE	379
ZGJUARSIA E PROFETIT TONE.....	383
DISA SHEMBUJ	388
Meremetimi i Qabes.....	388
Njohja e mirë e bashkëbiseduesit.....	390
Biseda sipas bashkëbiseduesit	393
Ligjërata para emigrantëve dhe medinasve në Hunejn	398
PROFETI YNE DHE FJALA.....	408
ANALIZA E NJË TUFE HADITHESH.....	424
1. Disa fjalë që përbëjnë kulm në tevhid (unitet) ,	425
2. Njeriu është një udhetar	427
3. Përfundimet e fjalës së drejtë e të fjalës së gënjeshtërt.....	429
4. Njeriu rri me atë që do	432
5. 'Takva ose morali i bukur'.....	434
6. Si të jeni, ashtu qeveriseni	436
7. Aktet janë sipas njetit (qëllimit)	442

Nijeti ose qëllimi i paracaktuar	444
Hixhreti	448
Hixhreti ose strehimi te Mëshira Hyjnore.....	451
8.Belaja e dorës dhe e gjuhës.....	454
Besimtari ideal.....	455
Privimi nga shikimi hyjnor.....	458
Privimi nga përfundimi i mirë	459
Fundi: Dënim i dhimbshëm.....	460
Mendjemadhësia dhe krenaria	461
Kopracia dhe mburrja në të dhënë.....	464
Ndëshkimi i llojit të aktit.....	465
13. Belaja e gjuhës dhe nderi.....	467
Të folurit është një dhuratë e bekuar	469
Edukata në të folur	471
Vendi midis shalëve	472
Lartësim vertikal.....	475
14. Aktet që fshijnë gabimet dhe lartësojnë nivelin	479
Synimi: Namaz	484
Përgatitjet për namaz.....	486
Pastrimi i gabimeve	490
Përgatitja dhe kujdes	492
15. Surpriza për robtë e mirë.....	499
16. Xheneti është rrethuar me shëmti, kurse xhehenemi, me epshe.....	505
17. Tri të drejta: e drejta e Zotit, e shtetit dhe e fesë	513

18. Të gënjejesh një herë apo dy herë	517
19. Njerëzit janë si mineralet.....	518
20. Padrejtësia nuk mbetet pa u ndëshkuar.....	521
21. Shtatë grupe njerëzish nën hijen e Zotit.....	523
22. Bota është një "hije për të kaluar vapën".....	529
23. Pesë gjëra që s'u janë dhënë të parëve.....	530
24. Besimtari është njeriu i përgjegjesisë.....	537
25. Disa ndalime* dhe veprime të papëlqyeshme**.....	541
Kundërshtimi i nënës	541
Groposja e vajzave për së gjalli.....	542
Tradhtia ndaj amanetit.....	543
Thashethemet	544
Të pyeturit shumë.....	546
26. Dhurimi**.....	547
SPEKTRI I LUTIEVE TE TIJ	550
PROFETI I MESHIRES	559
Ekstremizmi në mëshirë	562
Gënjeshtria e humanizmit	563
Në çdo gjë ai është në majë	566
Mëshirë universale	573
Fëmijët	583
Dhembshuri edhe për kafshët.....	588
Durimi i tij.....	593
BUTESIA E PROFETIT TONE	594
(Butësia e shprehive dhe e sjelljeve).....	594

Një shembull purifikimi dhe përsosjeje	614
MIREZIA, BUJARIA DHE THJESHTESIA E TIJ	625
Një fragment nga mirësia dhe bujaria e tij	627
Dhe thjeshtësia e Tij.....	647
Ishte mes njerëzish	650
Natyrshmëria	654
Thjeshtësia dhe dimensionet e tij prej robi.....	656
Dhe një pëmbledhje.....	662

Përshkrimi i personalitetit të lartë e të zgjedhur të Hz. Muhammedit (s.a.v.) dhe, më tepër se përshkrimi, prezantimi i tij si faktor për shpëtimin e njerëzimit dhe mundësia për ta bërë të njohur jetën e tij të lartë në formë të përshtatshme ndaj asaj Pozite Eprore, ashtu si edhe për shumicën, ka qenë për mua një nga subjektet më të rëndësishme që ma ka vënë nën ndikimin e vet botën time mendore e ndjesore duke u kthyer në një kërkesë dhe dëshirë të papërmbajtur...

Ai është krenaria e njerëzimit. Që prej katërmëdhjetë shekujsh, gjenitë më të mëdhenj dhe filozofët gjigantë me përmasa botërore si dhe shumë e shumë teoricienë e mendimtarë -yje të qiellit tonë të mendimit- kanë ndenjur të përulur nën hijen e tij duke i thënë: "Ti je njeriu për të cilin ne krenohemi se i përkasim"!!.

Madhësisë së tij i mjafton qoftë edhe kaq që ne, në kohën tonë, pas kaq e kaq lëngatash, dëgjojmë ende sot tek përhapet nga minaretë thirrja "Eshhedu enne Muhammede'r-Resulullah, Dëshmoj se

Muhammedi është i dërguari i Allahut", sodisim tek shpalos krahët Shpirti i Gjallë Muhammedian e merr fluturim dhe entuziazmohemi së bashku me shpirtrat e shenjtë pesë herë në ditë. Përsëri, në emër të personalitetit të tij të lartë mund të themi se, pavarësisht nga zelli dhe përpjekjet intriguese të shumë armiqve të brendshëm e të jashtëm, brezat e tij, shumë e shumë të rinj që ende s'u ka dirsur qimja, duke kuptuar siç duhet Të vërtetën Muhammediane gjithashtu pavarësisht se konceptet e saj janë shumë të vështira, këta të rinj, pra, vrapojnë pas Hz. Muhammedit (s.a.v.) ashtu si fluturat pas dritës, gjë që përbën një dukuri të pashembullt në botë. Koha nuk mundi ta zbehte tek ne, në ndjesitë tona, asnjërin nga të vërtetat që i përkasin atij. Po, ai vazhdon të jetë po aq i gjallë e i freskët! Ashtu siç edhe u kam thënë shpesh miqve, sa herë që të shkoj në Medinën e Ndritshme, fryma e tij më mbështjell në atë mënyrë, sa që më duket se një hap më tej do të takohem vetë me të dhe do të dëgjoj nga një zë i gjallë përshëndetjen: "Mirë se erdhët, qofshi shëndoshë e gëzuar"!(i) Ja, pra, kaq i freskët është ai në shpirtin tonë e, me kalimin e kohës, bëhet edhe më i freskët!

Po, koha plaket e thinjet, disa mendime vjetrohen e humbasin vlerë, kurse Hz. Muhammedi (s.a.v.) në zemrat e besimtarëve, si një gonxhe që çel nga pak e më shumë çdo ditë, ripërtërihet e bëhet çdo ditë edhe më i freskët...

Me ç'pandeh unë, po qe se do të mund të tregonim për të ashtu siç tregojmë për gjëra të tjera, gjë që s'kemi mundur ta bëjmë, po qe se do të jepej mundësia për të treguar për të ashtu siç është dhënë mundësia për të treguar për tjetërkënd dhe po qe se institucionet shoqërore-artistike do të mund të bashkëpunonin plotësisht për të treguar për të, në zemrat e brezave të sotëm vetëm ai do të ngrinte fron dhe në ndjesi vetëm ai do të gjendej. Megjithatë, pavarësisht nga çdo gjë, në lindje e në perëndim të njerëzimit, nga dita në ditë, çdo njeri, me shtambën në dorë vrapon kah ai burimi më i pastër i të pastërve e më i kulluar i të kulluarve e përpiqet të arrijë te çadra e Mbretit që kurorëzon diejt.

Po, sot, duke filluar me Amerikën, Anglinë, Francën dhe Gjermaninë, pothuajse e gjithë bota po vëren një ringjallje për llogari të tij, muslimanët e çdo vendi po qëndisin mendimet e tij të ndritshme dhe Islami pothuajse po jeton frymën e një "Epoke të

Lumtur" të re. Edhe në botën islame gjendja nuk është e ndryshme. Sot, në vend të njerëzve që nja dy shekuj më parë patën ndjerë interesim ndaj Islamit dhe ndaj muslimanëve të thjeshtë e naivë, ka njerëz të mësuar që zhvillojnë shkencën e çështjeve islame e që, nën rrezet ndriçuese të dijes, mendojnë e veprojnë në përputhje me Hz. Muhammedin. Ata që deri tani e kanë shfrytëzuar vazhdimisht pjesën e mësuar të popullsisë, që i kanë përdorur universitetet, institutet dhe shkollat e tjera për llogari të ca "izma"-ve dhe ata që janë përpjekur t'i vënë në punë institucionet kombëtare për llogari të mohimit dhe herezisë, po shpërbëhen, më në fund, një e nga një krejt si ajzbergët dhe po rrëshqasin me shpejtësi drejt tij. Po shohim se atyre që prej vitesh kanë ndërruar vend me mijëra herë, atyre që, duke ndërruar vend, kanë kërkuar një degë për t'u kapur, atyre që kanë vrapuar nga sistemi në sistem e nga kjo shkollëzë në shkollëzën tjetër, të gjitha këto bredhje u kanë përfunduar me fiasko; ata vrapojnë te shkolla e Hz. Muhammedit që s'ka pësuar kurrë gjer më sot fiasko. Ja, M. Bucaille, R. Garaudy e sa e sa të tjerë që u janë dëgjuar emrat...

Vetëm diçka: a mundëm ta njohim, vallë, në masën e duhur ne Mbretin e Zemrave që u ka mësuar atyre mbretërve mbretërimin? E pse t'ju përziej juve në këtë pyetje? Unë që po flas, a munda ta prezantoj atë plotësisht ose a munda t'ju komunikoj juve ashtu siç duhet ato që di? Dhe, duke e futur edhe veten mes atyre që janë në pozitën e mësuesit, i pyes edhe ata, edhe veten: a mundëm të tregojmë, vallë, në përmasat e vlerës së vet, për zotërinë e zotërinjve që u jep gjallëri zemrave gjer në entuziazëm?

Jo! Po që se njerëzimi do ta kishte njohur, do të bëhej mexhnun, i pasionuar për të dhe do të vihej udhëve për ta kërkuar; pastaj, kur t'ia mbështillte shpirtin kujtimi i bukurisë së tij, do t'i mbusheshin sytë me lot, do t'i mbusheshin dhe do të dridhej nga padurimi për të hyrë në mjedisin e tij të dëlirë, në botën e profetësisë, në klimën e tij të pastër, do t'i dilte përballë erës për t'i dhënë jetë hirit të zemrës së djegur me zjarrin e dashurisë për të dhe vazhdimisht ashtu do të shtyhej përpara...

Njeriu ka ardhur gjer në ditët e sotme gjithmonë duke dashur atë që di, me aq sa di, dhe si armik i asaj që nuk di. Është për këtë arsye që pika ku fokusohen

specifikat për të cilat janë përpjekur një jetë të tërë armiqtë tanë, është nxitja për të harruar famën e tij të shkëlqyer dhe përgatitja e brezave të rinj si armiq të Profetit të të dy botëve. Por ç'ngushëllim favorizues është fakti që megjithëse armiqtë tanë kanë dashur ta shkulin nga zemrat emrin e tij e ta hedhin tej, sot janë kapërcyer të gjitha pengesat dhe barrierat për të arritur tek ai dhe veçanërisht rinia e ka hedhur veten në prehrin e tij me gëzimin e njeriut që, pasi ka bredhur ditë të tëra në vapën përvëluese të shkretëtirës e është përleshur me vdekjen i urët e i etur, i del para një burim uji... Sigurisht, ajo zemër e mbushur plot dhembshuri do t'i marrë në gjoks ata që vrapojnë për tek ai me kaq dëshirë e s'do t'i lërë vetëm!

Nuk e di, a i keni vënë re me kujdes ata që mbushin cep më cep xhamitë ditën e premte? Po qe se po, keni parë që shumica dërrmuese e tyre janë të rinj. Cila është ajo forcë që, përkundër thithjes së të rinjve prej dhunës dhe perversitetit me anë të atij vakumit të tyre të frikshëm në tërë veprimtarinë e tyre sistematike, i bën këta të rinj që në borën e dimrit të marrin abdest duke u dridhur nga të ftohtët e të vrapojnë për në xhami? Po deshët, po jua them

unë: Eshhtë tërheqja e shenjtë e Hz. Muhammedit (s.a.v.)!

Na e rrokin apo s'na e rrokin mendjet, zemrat vërtiten si flutura rreth atij Qiriri, rreth atij Dielli... Në një të ardhme shumë të afërt, mendjet endacake e të hallakatura që s'kanë mundur gjer tani të vrapojnë për tek ai duke ngecur, kështu, në rrugë si miza dimri të vetmuara, do të pendohen për atë që kanë ngecur në rrugë dhe, duke rrahur pëllëmbët pas gjunjëve, do të thonë: "Pse s'u bëmë flutura e të vraponim për tek ai!" Por, ndoshta, për shumë prej tyre atë kohë çdo gjë do të ketë mbaruar.

Njerëzimi do të vrapojë pas tij, katedrat shkencore do të bëjnë kërkime rreth tij dhe zemrat e hapura ndaj klimës së mendimit do të bien pas tij; një pjesë e madhe e armiqve, të kthyer në miq, do të mblidhen rreth tij dhe po mblidhen. Më në fund, sot, Hz. Muhammedi po peshon rëndë edhe në të gjitha "peshoret" e frontit përballë dhe madhështia e tij po pohohet edhe nga bota armike. Në një hadith, porosi profetike, me gojën e Profetit thuhet: "U peshova me dhjetë vetë nga të ummetit, bashkësisë sime, dhe erdha më rëndë. Pastaj me njëqind, me një mijë vetë dhe prapë erdha më rëndë. Pastaj erdhën dy engjëj të

ngarkuar me detyrë e thanë: "Lëreni. Edhe sikur me të gjithë ummetin e tij të matet, prapë më rëndë do të peshojë!"(1) Më në fund, edhe kjo ishte realizuar! Profeti e tregon kështu një ëndërr tjetër që kish parë: "Më vunë mua në njërën anë të peshores dhe ummetin në anën tjetër dhe unë erdha më rëndë!"(2)

Po, sikur të vihen në njërën anë të peshores të gjithë sahabet, pasuesit e tij, bashkëkohësit e pasuesve dhe ndjekësit e tyre, të gjithë mistikët e sofitët që njohin shpirtat njerëzorë, të urtët e shenjtorët dhe të gjithë njerëzit e mëdhenj që kanë ardhur e do të vijnë gjer në kiamet, në katastrofën e kësaj bote, përsëri ai Sovrani i Zemrave dhe drita e syve tanë do të peshojë më rëndë. Sepse e gjithë qenia është krijuar për respekt ndaj virtyteve të tij. Ai përbën për gjithësinë "qëllim krijimi" dhe është karakterizuar kështu me pak fjalë që janë bërë të famshme si hadith: "Po të mos ishte ti, nuk do ta kisha krijuar gjithësinë!"(3) Sigurisht, shkrimi i një libri që nuk i merret vesh kuptimi, është një punë e kotë. Kurse Allahu është i pastër nga kotësitë. Për rrjedhojë, ai kërkon një ciceron zëkthjellët si Zotëria i Kohës e i Hapësirës që të tregojë për kuptimin e gjithësisë. Gjithashtu duhet të jetë një lajmëtar e një

interpretues si ai që të lajmërojë e të interpretojë se nga vjen, ku shkon e përse duhet njeriu nën urdhrin e të cilit janë vënë ky qiell i pacak, dielli, hëna e yjet në të dhe e gjithë qenia si dhe t'ua komunikojë shpirtëve se ç'ka "pas kuintave" të kësaj gjithësie që shohim me sy... E, nëse është kështu, po qe se s'do të ekzistonte ai, edhe njeriu, edhe gjithësia s'do të kishin kuptim.

Hz. Muhammedi (s.a.v.) është njeriu që u përfton vlerë gjërave. Për ne ai është më i dashuri i të dashurve. Këtu, bashkë me pohimin se e shoh veten si më mëkatari i besimtarëve, nuk do të mund të kaloj pa treguar për një ndjenjën time. Dhe, me këtë, kam për qëllim të them se, kur edhe unë, një mëkatari i tillë, arrij ta dua gjer në këtë shkallë të Dërguarin e Allahut, kush e di se në ç'masë flakëron ai në zemrat e larta e të afta për të ndjerël.. Ja, pra, edhe konstitucioni im shpirtëror(ii) nga ky kënd duhet vlerësuar. Ndryshe, më vjen turp të sjell këtu, para jush, një çështje që më përket mua. Kur Providenca Hyjnore ma pati mundësuar të përkëdhelja ato dhera të bekuara me këtë fytyrën time mëkatore, aq e përndritshme, aq e përndritshme më qe dukur toka e të Dërguarit të Allahut dhe një të tillë ngazëllim

shpirtëror pata ndjerë nga të ndodhurit atje, saqë, po të supozonim se atë kohë do të ftohesha nga të gjitha portat e xhennetit, parajsës, më besoni se te asnjëra s'do të drejtohesha, por do të parapëlqejta të mbetesha atje ku isha. Në të vërtetë, xhenneti është dëshira e ne të gjithëve e as që mund të mendohet ndonjë musliman që të mos dojë të hyjë atje. A nuk i drejtohem Zotit në lutjet tona çdo mëngjes e mbrëmje që të na ruajë nga xhehennemi, skëterra, e të na marrë në parajsën e Tij? Duke i pranuar të gjitha këto, prapëseprapë them që, po qe se do të thirresha, pra, atë çast, për t'u favorizuar me atë dhuratë të lartë, sipas të gjitha gjasave, do të kërkoja leje nga Imzot për të mbetur aty, pranë varrit të të Dërguarit të Tij!(iii) Kujdes, të mos pandehet se me këtë dua të them se jam i denjë për ato lloj konsideratash; desha të shpreh vetëm miqësinë dhe dashurinë që ndjej për të Dërguarin e Allahut. E kundërta, jam i tillë që një jetë të tërë po lutem për të pasur nderin të jem më i vogli ndër pasuesit e Profetit, skllav i tij me kularin në qafë... Dhe lutja e mëposhtme më është sa e sa herë refren i buzëve të mia: "Zoti mos na largoftë për asnjë çast nga

mendimi për të fërkuar fytyrën tonë në pluhurin e këmbëve të pasuesve të Profetit!"

Të njëjtat ndjenja pata përjetuar edhe në Shtëpinë e Allahut.(iv) Këto ndjenja janë, ndoshta, ndjenjat e përbashkëta të të gjithë neve. Atëherë mbetet të themi se nuk jam vetëm unë ose vetëm disa vetë që jetojnë të mbushur plot me ndjenja të tilla. Ka të tillë të pasionuar pas të Dërguarit të Allahut, të cilëve, ky konstitucion, kjo gjendje shpirtërore që përshkova, do t'u duket shumë vulgare e naive.

Meqë erdhi këtu fjala, po ju tregoj edhe për një kujtim tjetër.

Ato ditë patëm qenë bashkë me deputetin Arif Hikmet Beun në haxh. Para se të nisej, ai i kishte pasë dhënë fjalën vetes se, po të shkonte në Medinë, do të shtrihej drejt e në tokë e do të rrokullisej në ato dhera. Pastaj, sapo pati shkelur këmbën në Medinë, pati vepruar ashtu siç pati pasë premtuar. Sa herë dhe kudo që ta kujtoj atë tablo, më mbushen sytë me lot!

I Dërguari i Allahut është një profet. Por është një profet, ardhja e të cilit është lajmëruar si sihariq nga kulla e profetësisë së të gjithë profetëve të

ardhur para tij. Allahu na tregon kështu në Kur'an për fjalën që ka marrë nga të gjithë profetët se do t'i besojnë e do ta ndihmojnë këtë profetin e lajmëruar prej tyre: "Kujtoni kur Allahu mori zotimin e peygamberëve: "Meqë ju dhashë libër e urtësi, ju pa tjetër do ta besoni dhe ndihmoni peygamberin që vjen pas jush e që vërteton çka keni me vete. A e pranuat, a e morët përsipër këtë detyrë të madhe?" "Po, -thanë ata.- E pranuat!" Atëherë Allahu tha: "Dëshmoni, pra, edhe Unë po dëshmoj bashkë me ju!" (Kur'ani, Al-i Imran: 81).

Ja, pra, edhe profetët jetuan duke i ndenjtur besnikë fjalës së dhënë Zotit dhe, në të gjitha veprimet, u përpoqën të mbanin atë orientim. Dhe, kur Profeti u ngjit në Miraxh, ata u falën pas tij shpirtërisht.(4) Po, me Hz. Ibrahimin, Hz. Nuhun, Hz. Musanë e Hz. Isanë në krye, pothuaj të gjithë profetët deshën të bëheshin muezinët e tij. Hz. Mesihu, në ungjill, duke thënë "Unë po shkoj që të vijë i zoti i kohës" (Ungjilli i Shën Joanit: 16/8), e vinte atë profet të lartë në qendrën e vëmendjes së njerëzimit. Po, kur ai qe ngjitur në qiell, fundet e qiejve qenë mbushur me xhevahirë, yjet i qenë shtruar nën këmbë si gurë kalldrëmi dhe, kur i qe

afruar horizontit të diellit, ky pat rënë në sevda për t'iu bërë përkrenare atij. Të gjithë këta i rrinin përreth profetësisë së tij ashtu si fluturat rreth dritës...

Ai pati edhe veçori njerëzore të cilat i përfaqësoi në shkallën më të lartë dhe me të cilat na u bë udhëzues neve. Për shembull, ai qe një kryetar familjeje i shkëlqyer. Në një periudhë të caktuar të jetës ai qe ndodhur me nëntë gra të kurorëzuara, por nuk pati dhënë shkas e nuk pati lënë asnjë hapësirë për replika dhe grindje midis tyre. Në atë shtëpi ku pikonte eliksiri profetik pika-pika, po qe se secili prej fëmijëve që pati rritur, do t'i takonte një shekull të caktuar, do të bëhej një prijës shpirtëror e një novator që do ta ndriçonte atë shekull. S'e di, sa vetë kanë pasur mundësi ta njohin atë në këtë aspekt?

Prapë, ai pati qenë një udhëheqës ushtarak i shkëlqyer, një mjeshtër i luftës. Me një grusht njerëzish që i bënëin dritë përreth, ai pati rrafshuar përtokë fronet e mbretërve që i patën shpallur luftë botës dhe sa e sa sundimtarë i pati kthyer në skllëvër që s'pranojnë lirim të portës së tij. Ai pati qenë një komandant ushtarak megjithëse s'pati pasë mësuar prej askujt shkencën dhe teknikën luftarake në planin teorik.

Prapë, ai qe njeriu-kyç ku patën arritur dhe qenë mbështetur dituritë. Sikur t'i shihte në një ekran ngjarjet që do të ndodhnin gjer në kiamet, i lexonte ato nga një tabelë e fshehtë dhe i numëronte një e nga një.(5) Sot, pas shumë shekujsh nga dita kur u dha urdhri hyjnor që ai të ndërronte jetë, në pikën e arritur në përfundim të kërkimeve në sajë të mundësive të mrekullueshme të teknikës e teknologjisë, çdo njeri sheh flamurin e ngulur nga Profeti Muhammed (s.a.v.) katërmbëdhjetë shekuj më parë dhe personat të cilët Allahu dëshiroi t'i orientonte e t'i aftësonte për të parë drejt, duke shqiptuar Fjalën e Dëshmisë, kthehen e bëhen edhe një hallkë tjetër më shumë në zinxhirin e përndritshëm të trashëgimit Islam. Ja një prej mijëra evenimenteve të tilla, kanadezi Keith Moore, profesor i anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Torontos, një pediatër specialist, ky, në fushën e vet, të cilin e kam parë në një videokasetë.

Pasi dëgjon nëpërmjet ajeteve-argumente të Kur'anit periudhat e zhvillimit të fetusit në mitër, gjë që ka mundur të zbulohet vetëm me mundësitë e sotme teknike, shpreh bindjen dhe nënshtrimin e vet

ndaj Zotit duke thënë: "Eshhedu en la ilahe il'lallah ve eshedu enne Muhammeden Resulullah", "Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Tij!" Një rast tjetër, një shkencëtar fiziolog japonez, pasi njihet me ajetet-argumente të Kur'anit që kishin lidhje me fushën e vet, megjithëse duke e shqiptuar me vështirësi, thotë: "Eshhedu en la ilahe il'lallah" dhe nuk lëkundet aspak që të hyjë në Islam. Ja, pra, siç u pa, atje ku ngecin shkencat, Kur'ani hap shteg dhe pika e fundit ku kanë arritur shkencat, takohet me pikënisjen e të Dërguarit të Allahut. Mirë, po kush ia pati mësuar atij këto gjëra? Mësimet ai i pati marrë nga Allahu që është "Alim", "i Ditur" dhe "Habir", "i Informuar". Pas tij qëndronte "Mësuesi i Madh"! Është për këtë arsye që intuïta e tij me kalimin e kohës nuk u vjetërua, në të kundërt, me kalimin e ditëve, u rinua dhe ky rinim do të vazhdojë për sa kohë do të ekzistojë bota!

Gjithashtu, ai pat qenë njeriu që qe dashur nga shokët e tij në përmasa që nuk do t'i mundësohen e nuk do t'i takojnë asnjë njeriu. Për shembull, në mbarim të luftës "Ma-u Rexh", kur Hubejb b. Adiji qe vënë në tryezën e ekzekutimit prej heretikëve të

çmendur të ndezur me zjarrin e urrejtjes e të hakmarrjes, që vënë para një alternative të tillë: "A do të deshe që në këtë çast, në vendin tënd, të ekzekutohej Muhammedi?" Dhe përgjigjja e tij pati qenë e prerë, e qartë dhe e pakthyeshme: "Jo, vallahi, nuk do të pranoja që, në këmbim të shpëtimit tim, t'i ngulej atij qoftë edhe një gjemb në këmbë!" Pastaj, pasi pati treguar këtë shembull guximi në tryezën e ekzekutimit, Hubejbi pati ngritur duart drejt qiellit duke thënë: "Imzot, duke ardhur këtu, nuk munda t'i lija lamtumirën Mikut Tënd, pra, çoja, atje ku ndodhet, përshëndetjen time!" Pikërisht ato çaste kur Profeti që ulur e po bisedonte me pasuesit e tij, menjëherë drejton trupin dhe thotë: "Përshëndetje ty, o Hubejb!" Kur të pranishmit, të habitur, e pyesin, ai përgjigjet e thotë mes lotëve: "Hubejbin e ekzekutuan politeistët! Hubejbi ra dëshmor! Në çastin e fundit më dërgoi një përshëndetje!"(6)

Dhe ja një tablo tjetër kënaqësindjellëse për zemrën e çdo njeriu që ende beson, megjithëse nga ngjarja në fjalë kanë kaluar shekuj. Ishte lufta e Uhudit. Zonja Sumejra dëgjon se i Dërguari i Allahut ka rënë dëshmor, e ndalon vrapin në rrëzë të malit Uhud dhe, ndërsa nuk interesohet aspak tek i

tregojnë kufomat e të atit, burrit e djemve të rënë dëshmorë, vazhdon ta kërkojë në çdo vend Profetin duke mërmëritur "Ç'u bë i Dërguari i Allahut?" Pastaj, në një çast, kur i tregojnë se ku ndodhet, shkon, i bie para këmbëve dhe i thotë: "Pasi që ti je gjallë, të gjitha fatkeqësitë më lehtësohen, o i Dërguari i Allahut!"(7) Ja, të tillë vend pati zënë ai ndër zemra!

Dhe një shembull tjetër. Njeriu-horizont pati marrë ftesë prej përtej qiejsh dhe do të largohej, më në fund, prej miqve me të cilët pati ndarë të njëjtin fat për 23 vjet me radhë. Prandaj, në ditët e veta të fundit, pati dalë pranë pasuesve pak i mërzitur e i hidhëruar. Ajo gjendje duhet t'i kishte prekur shumë pasuesit që, kur i Dërguari i Allahut hynte në shtëpi, në çdo zemër fillonin të frynin erëra brengje. Muaz b. Xhebeli shkante e vinte nga Jemeni ku ishte ngarkuar me punë nga i Dërguari i Allahut. Kur shkante, çonte mesazhe e, kur kthehej, sillte çështje e probleme gati për zgjidhje. Para se të dilte për udhëtimin e fundit, pati shkuar pranë Profetit për t'i marrë bekimin. Profeti i dy botëve i thotë: "Shko, o Muaz! Kur të kthehesh, ka shumë mundësi të vizitosh vetëm faltoren dhe varrin tim!" Sikur ta

kishin goditur në kokë, Muazit i këputen krahët, i mbushen sytë me lot dhe mbetet ashtu, i shembur aty ku ndodhet. Jo për të shkuar në Jemen, por s'i mbetet më fuqi as për t'u ngritur në këmbë!(8)

Ai ishte një njeri që i zgjidhte të gjitha problemet e jetës shoqërore me lehtësinë e heqjes së një qimeje prej gjalp(v) Bernard Shou që ka jetuar 13 shekuj pas Profetit, me fjalët e mëposhtme është vetëm njëri prej qindra kundërshtarëve të tij që e pranojnë këtë të vërtetë: "Sa nevojë ka njerëzimi në shekullin tonë të grumbullimit të problemeve njëri përmbi tjetrin për Muhammedin që i zgjidhte të gjitha vështirësitë me lehtësinë e pirjes së një kafeje!"

Po, kur njerëzimi t'i kthehet atij, atëherë do t'ia arrijë prehjes, sigurisë dhe horizonteve të ndriçuara, do të shpëtojë së bredhuri pa drejtim e së qeni lodër në duart e kohës, do të shpëtojë nga mjerimi i ndëshkimit në të dy botët e do të ngjitet në qiellin e të qenit njeri. Në të vërtetë, me gjithë pengesat e forcave armiqësore, kjo ringjallje e dytë porsa ka filluar. Ja ç'thotë Kur'ani: "Me gjuhët e tyre ata kërkojnë të shuajnë dritën e Allahut, por Allahu po e plotëson dritën e Vet edhe pse s'u pëlqen mohuesve; Ai e dërgoi përfaqësuesin e Vet me orientim të drejtë

e me fenë e së vërtetës për ta bërë këtë mbizotëruese ndaj të gjitha feve, edhe pse idhujtarët nuk e presin mirë një gjë të tillë!" (Kur'ani, Saff: 8)

Sigurisht, Allahu do ta nxjerrë në dritë fenë e Vet, zemrat e dëshiruara do të vrapojnë për tek Ai, tek Ai do t'ia arrijnë prehjes e sigurisë dhe, duke qenë ende në këtë botë, do të bëhen sikur kanë hyrë në parajsë. Edhe po të mos duan heretikët dhe mizorët evropianë, hipokritët aziatikë që shfrytëzojnë popullsitë e Azisë dhe indiferentët që kemi midis nesh, Mbreti i Profetëve, i pranuar si i tillë nga profetët, i cili mban në dorë myhyrin dhe vë vulën, Mbreti i Mbretërve, namin e madhështisë së të cilit e lajmërojmë pesë herë në ditë, me siguri që një ditë do të hyjë në të gjitha zemrat dhe do të bëhet i zgjedhuri, i dashuri e i adhuruari i çdokujt!

Në të njëjtën kohë, ai qe edhe njeriu i paqes e i qetësisë. Ne e dimë dhe e besojmë kategorikisht se mesazhi që solli ai, gjithashtu qe një burim paqeje e qetësie dhe historia është dëshmitarja më e madhe e kësaj. Ja, pra, e vetmja zgjidhje për ta bërë njerëzimin që ta shijojë përsëpari këtë paqe e qetësi, është që t'ua bëjmë të njohur njerëzve Atë dhe dritën që solli Ai. Sepse, në raport me sa do të njihet ai, do të duhet

dhe, në sajë të asaj dashurie, do të ndërrojë fytyra e shoqërisë.(9)

Brenda kuadrit të një hyrjeje, duke u mbështetur në bujarinë dhe favorin e Providencës Hyjnore, u përpoqa të prezantoj shkurt disa gjëra për Profetin e të dy botëve, të cilin kam planifikuar ta përshkruaj në shumë aspekte të Personalitetit e të Veprës së tij.

Ç'është e vërteta, çdo fjalë që flet për të, është e bukur; diçka që s'është e bukur, duhet t'i lihet shprehjes dhe stilit. Në pastë të meta të shprehjes e të stilit, ato më përkasin tërësisht mua. Kurse ato që i përkasin Zotërisë së Gjithësisë, janë vetëm e vetëm të bukura!

AUTORI

Profeti i Derguar si Mëshir për Botët, Agimi I pritur

Një botë sterrë e zezë e mbarsur me dritë... Në horizont, jehona mbushur plot sihariqe për kohën e shkurtër të mbetur gjer në shfaqjen e Profetit... Aq i madh është ndikimi i tij nëpër ndërgjegje, sa shumë

mekas tregojnë vazhdimisht për Profetin e Fundit që do të vijë. Dhe porosi: "Sapo të shfaqet, vraponi për tek ai dhe bëhuni një me shpirtin e tij!"(10)

Një popull i tërë me shpirtin në të dalë dhe shpresa e çdokujt te shpëtimtari që do të vijë. Nënat dhe baballarët duan që ky shpëtimtar të jetë nga brezi i tyre dhe disa ua vënë emrin Muhammed fëmijëve të porsalindur...(11)

Por ai e kishte të përcaktuar rrugën e tij: do të kalonte nëpër brezin e artë që përçohet nga Hz. Ibrahim i Ismaili dhe, pastaj, nga Abdylmuttali bi Abdullahu dhe zemrat prisnin dritën që do të vinte përmes këtij drejtimi.

Ngjarjet që kishin ndodhur e ndodhnin, për ardhjen e tij lajmëronin, kurse dendësimi i errësirës fliste për afrimin e agimit që do ta griste errësirën.

Njerëzimi i asaj dite ishte i privuar nga ideali dhe qëllimi që i japin kuptim jetës. E gjithë vepra njerëzore ishte "si ndjekja e një iluzioni optik në shkretëtirë. I eturi e pandeh për ujë atë, por, kur arrin në vend, nuk gjen gjë..." (Kur'ani, Nur: 39)

Edhe ndjenjat, mendimet dhe sjelljet e njerëzve nuk ndryshonin shumë nga kjo. Ato ishin "si errësira e dendur në një det të gjerë ku njerëzimin e kishin

mbuluar dallgë mbi dallgë e sipër tyre re aq sa, po të nxirrte dorën jashtë, edhe atë nuk do ta shihte dot!" (Kur'ani, Nur: 40)

Emri i asaj periudhe është Injorancë. Por jo një injorancë si antonim i dijes; ajo ishte një injorancë - sinonim i mohimit, herezisë dhe blasfemisë që janë antonime dhe antagonistë të besimit.

Nuk dua që, duke ju ofruar shëmtitë e asaj periudhe në formën e një tabloje sterrë të zezë, të lëshoj, qoftë edhe përkohësisht, një perde të zezë mbi shpirtin tuaj!

Përshkrimet ekuivoqe e të pasakta i çorientojnë mendjet dhe, sipas meje, preteksti për këtë është një mëkat. Por e shoh të dobishme që, për të mundur ta përshkruajmë atë periudhë, duhen prekur, qoftë edhe pak, disa prej zakoneve dhe traditave të atyre ditëve dhe vetëm duke bërë shenjë për to gjersa të kuptohet më mirë se Profeti u dërgua si mëshirë për të gjithë botën dhe se ç'favor hyjnor qe dërgimi i kësaj mëshire!

Ardhja e tij është për çdo njeri favor i madh dhe mirësia më e gjerë e Zotit. Që kjo është kështu, na e thotë vetë Zoti ynë: "Allahu u ka bërë një favor të madh besimtarëve duke u dërguar nga mesi i tyre

një peygamber që t'u lexojë argumentet e Tij, t'i pastrojë (nga të këqijat, nga mëkatet) dhe t'ua mësojë Librin dhe urtësitë" (Kur'ani, Al-i Imran: 164).

Vini re bujarinë, ndihmën dhe favorin e Allahut që u dërgon njerëzve për profet njërin nga mesi i tyre, nga origjina e tyre, i cili ndan me ta të njëjtat ndjenja e mendime, i cili është udhëzues e prijës i tyre në rrugën që shkon te e Vërteta, i cili mund të dalë në krye të tyre nëse është nevoja për imam, i cili mund të hipë në minber nëse është nevoja për hatib, i cili mund të vejë vulën e të presë monedha nëse është nevoja për një drejtues shteti, i cili mund t'i komandojë ata në mënyrën më të përkryer sesa komandantët ushtarakë më të shkëlqyer nëse është nevoja për t'i komanduar.

Në kristianizëm ka një besim të gabuar. Kristianët bartin një besim të gabuar, sipas të cilit Zoti e sakrifikoi Hz.Isanë, birin e Vet (mos qoftë e thënë!), për të falur mëkatet e parë të njerëzimit. Hz. Isai u gozhdue në kryq dhe kështu u fal mëkati i parë i trashëguar nga njeriu i parë, Ademi, tek secili njeri tjetër që e ka sjellë me vete në mënyrë të bashkëlindur. Ky është i gabuar si besim dhe, sipas disa interpretimeve, në aspektet e dukshme të tij

është një deviacion. Megjithatë, ekziston një nënkuptim i drejtë në këtë konsideratë që është dëshira e Zotit për t'ua falur mëkatet njerëzve e për t'i futur në rrugë të drejtë. Dhe ja, për këtë, Zoti e ka dërguar robin e Tij më të dashur, Hz. Muhammedin (s.a.v.), si profet për t'ua falur mëkatet njerëzve, për të mos i lënë ata të vetëm e pa mbështetje që të hutohen e të humbasin, por që të ngjiten në nivelin e njeriut të vërtetë e të bëhen të përsosur, që ta thellojnë në shpirta besimin te Allahu e ta ndjejnë për çdo çast Atë dhe, siç thotë Ibrahim Hakiu, ta njohin Zotin e tyre duke e zbuluar në ndjesitë e tyre:

"Nuk më nxënë - tha Zoti - tokë e qiej";
Në minierën e ndjesive i fshehur u zbulua...

Ndjesitë janë një burim i tillë thesaresh ku Zoti, të cilin nuk e nxënë botët, në çdo çast bën të ndihet prania e Tij si margaritari më i vyer.

Librat, mendjet, mendimet, filozofitë, shprehjet, qielli, toka dhe tërë qenia nuk mund ta përfshijnë Allahun brenda kufijve të tyre dhe asnjërës prej këtyre nuk i mjafton fuqia për ta shprehur Atë. Janë vetëm ndjesitë, është vetëm zemra ajo që, qoftë edhe pjesërisht, mund të bëhet interpretues i Tij. Po, zemra është një gjuhë e tillë që veshët nuk kanë

dëgjuar gjer më sot një shprehje aq të shkëlqyer e të qartë sa shprehja e saj!

E nëse është kështu, njeriu duhet të përpiqet për të marrë udhë në zemrën e vet, për ta kërkuar pikërisht te ajo atë që kërkon dhe, duke arritur te Zoti, për të përfunduar tek Ai! Prandaj edhe e dërgoi Zoti mes nesh Hz. Muhammedin (s.a.v.)!

Po, pati ardhur ai mes njerëzve për t'u lexuar atyre ajetet e Allahut, për t'u shpalosur atyre pjesë-pjesë mrekullitë e Tij dhe për t'i mësuar njeriut vlerën e vet. Sigurisht, në sajë të tij njerëzimi, duke u pastruar nga fëlliqësitë e natyrës, do të purifikohet, duke shpëtuar nga vulgaritetet trupore, do të lartësohet në nivelin e formës së jetës së zemrës e të shpirtit dhe u lartësua... Sigurisht, ai do t'u mësonte dhe praktikonte njerëzve Librin dhe urtësitë, kurse njerëzit, duke gjetur veten në botën dritësore të Librit dhe urtësive, do të zgjoheshin në përjetësi dhe do të hynin në rrugën e përjetësimit, gjë që, në përfundim, ashtu ngjau...

Për ne ka ditë shumë të rëndësishme, prodhimore e të mbushura plot begati. Disa nga këto konsiderohen edhe festa të besimtarëve. Këtë gëzim feste të përjetuar çdo javë ditën e xhuma (të

premtë), e përjetojmë në një dimension më të madh në festat e bajrameve të Ramazanit e të Kurbanit. Bajrami i Kurbanit është dita kur Hz. Ibrahim bëri një sakrificë konkrete, ndërsa për muslimanët, dita kur, me plot sinqeritet, kërkojnë rrugë për faljen e mëkateve të tyre dhe, kushtuar këtij qëllimi, një pjesë shkojnë e vizitojnë Shtëpinë e Allahut, qëndrojnë në Arafat dhe luten e përgjërohen me shpirt Muhammedian. Kurse Ramazani është një festë e pasur, e gjatë dhe e begatshme, shprehje e afrimit të Zotit me anë të një muaji agjërimi, shprehje e ndarjes me të tjerët të gëzimit të jetës. Por është edhe një festë tjetër që konsiderohet festa e të gjithë njerëzimit, madje e të gjithë qenies, dita kur i Dërguari i Allahut na nderoi duke denjuar të vijë mes tonë, është Ditëlindja Muhammediane. Me fjalë të tjera, është dita kur Zoti, Dritën që e krijoi në cilësinë e një dielli, e zbriti si një kandil në qiellin e njerëzimit. Po, në saje të asaj Drite, të gjitha errësitat e injorancës u grisën dhe gjithësia u përfshi nga ndriçimi. Dhe kjo është ndihma më e madhe dhe favori më i madh i Zotit për xhindët e për njerëzit!

(10) Ibni Hisham, es-Siratu'n-Nebevije 1/204.

(11) Muhammed b. Sa'd, et-Tabakatu'l-Kubra 1/169

Një Periudhe e Erret

Çdo periudhë kohore gjatë së cilës është lëkundur apo lëkundet besimi monoteist, është koha kur sundon errësira. Nëse besimi te Zoti që është drita e qiejve dhe e tokës, nuk sundon në të gjitha zemrat, errësira i nxin e i bën sterrë të zeza ndërgjegjet dhe shpirtrat. Meqë cilësia e vështrimit të sendeve dhe dukurive nga ana e një zemre dhe ndërgjegjeje të tillë do të jetë miope dhe e turbullt, njeriu do të jetojë krejt si lakuriqët e natës në një natë krejt të errët.

Në një periudhë kur të gjitha parimet fetare qenë lëkundur nga themeli dhe kur fetë qiellore qenë korrigjuar nga vetë anëtarët e tyre, ndoshta disa monoteistë i besonin një Zoti që nuk e emërtonin

dot, që nuk e njihnin dot e, që, për rrjedhojë, nuk kryenin adhurime në rrugën e Tij; zërat e tyre ishin aq të dobët sa nuk tërhiqnin vëmendjen e askujt.

Idhujtaria në periudhën e injorancës

Të gjithë politeistët krenoheshin dhe gjenin prehje në adhurimin e idhujve me të cilët kishin mbushur Qaben. Kurse ata vetë mes tyre që kishin pak njohuri, thoshin se idhujt i pranonin vetëm si ndërmjetës që i afronin ata te Zoti. Në një ajet-argument të Kur'anit kjo specifikë pohohet kështu: "Ne i adhurojmë ata vetëm që të na afrojnë më shumë tek Allahu." (Kur'ani, Zumer: 3). Kështu, ndjenja e adhurimit e dedikuar si një amanet i rëndësishëm krijimit të njeriut, edhe një herë tjetër shpërdorohej, edhe një herë tjetër tradhëtohej! Njerëzit adhuronin drurin, gurin, tokën, diellin, hënën dhe yjet, madje, u kushtoheshin një copë herë idhujve që i kishin bërë me duart e veta prej gjërave të ngrënshme si prej hallve dhe djathi dhe pastaj, pasi i kapte uria, u hynin e i hanin.

Këtë mendim arkaik e këtë botëkuptim të tejkualuar Kur'ani e trajton në këtë mënyrë: "Ata lënë Allahun e jepen pas gjërave nga të cilat nuk kanë as dëm e as dobi dhe thonë:"Këta janë ndërmjetësit

tanë te Allahu." Thuaju: "Mos vallë ju i tregoni Allahut për ndonjë gjë që mund të mos e dijë Ai në tokë e në qiej? Hasha, mos qoftë e thënë! Ai është i lartë e s'ka të bëjë me gjërat me të cilat ata e barazojnë!" (Kur'ani, Junus: 18).

Si dhe: "Kujdes! Feja e vërtetë është vetëm feja e Allahut. Ata që e lënë Atë dhe zënë miq të tjerë, thonë: "Ne i adhurojmë ata për të na afruar më shumë te Allahu. S'ka dyshim se Allahu do të gjykojë për kontradiktën e tyre. Pa dyshim, Allahu nuk i orienton në udhë të drejtë mohuesit dhe gënjeshtarët!" (Kur'ani, Zumer: 3).

Përveç kësaj, ata kërkonin edhe justifikim për këtë gjë. Justifikimi më i madh i tyre qe se kështu kishin pasë vepruar edhe etërit e tyre: "Kur politeistëve u thuhet që ta pranojnë revelacionin e Allahut, ata përgjigjen: "Jo, ne shkojmë pas traditës së etërve tanë!" Mos vallë edhe nëse etërit e tyre s'kanë kuptuar asgjë e s'e kanë gjetur të vërtetën?" (Kur'ani, Bakara: 170).

Drama e vajzave të vogla

Një të keqe tjetër të periudhës së injorancës Kur'ani e tregon kështu: "Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet se i ka lindur vajzë, i nxihet fytyra e

mbushet plot mllef. Kërkon të fshihet për shkak të asaj të keqeje që e ka gjetur. Pastaj mendon nëse duhet ta mbajë fëmijën duke pranuar turpin, apo ta mbulojë të gjallë në dhe. Ç'gjykim i keq e i mbrapshtë!" (Kur'ani, Nahl: 58-59). Po, kur ndonjërit prej tyre i lindte vajzë, mbushej plot mllef dhe hante veten nga marazi për këtë ngjarje që, sipas tyre, ishte një ndëshkim dhe jo dhuratë prej Zotit. Prandaj edhe përpiquej të mos dilte në sy të njerëzve. Ndërkaq, përpiquej të vendoste: ose do ta mbante fëmijën duke pranuar turpin, ose do ta varroste të gjallë atë duke pastruar (!), kështu, nderin e vet.

Ja, pra, kështu poshtërohej femra në kohën e injorancës dhe ky nënvleftësim, kjo përbuzje e ky poshtërim nuk ishte diçka specifike vetëm për arabët e asaj periudhe. Gjendja ishte po ajo edhe në perandoritë romake dhe sasanite. Duke u nisur nga kjo, mund të thuhet se transformimi i jashtëzakonshëm që kreu Islami midis arabëve në lidhje me botën femërore, ishte një operacion i pashembullt në historinë e njerëzimit në emër të saj.

Po, është Kur'ani që i del për herë të parë përballë kësaj egërsie dhe e ndalon vrasjen e vajzave të vogla për çfarëdo shkakut dhe në çfarëdo kushtesh:

"Thuaj: "Ejani t'ju lexoj ato që me të vërtetë jua ndaloi Zoti juaj: ...të mos i mbytni fëmijët për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë edhe juve, edhe ata..." (Kur'ani, En'am: 151).

Sikur Zoti u thoshte: Pse i vrisni fëmijët? Pjesën tuaj të të mirave Unë jua siguroj. A nuk e shihni se toka e pasur si mijëra sofrat ju jepet nën urdhrin tuaj? Qielli ju vrapon në ndihmë. Kush mund të jetë përveç Meje ai që për ju sjell retë, lëshon shi e borë dhe bën që të mbijnë miliona bimë? Kur i shihni të gjitha këto, me ç'ndërgjegje dhe me ç'mendje ju kap frika e jetesës dhe i vrisni fëmijët? Por mos harroni: ata që veprojnë kështu, kurrë s'do të meritojnë të bisedojnë me Zotin e tyre, ndërsa ata fëmijët e pafajshëm një ditë do të pranohen para Zotit dhe do të pyeten se për çfarë zakoni i vranë dhe fëmijëvrasësit do të marrin pa tjetër ndëshkimin e krimit të tyre! Ajeti-argument i mëposhtëm na tregon neve moralin e asaj periudhe në tërë tmerrin e vet: "Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura gjallë se për çfarë mëkati janë vranë, ..." (Kur'ani, Tekvir: 8-9).

Një ditë, një prej sahabeve, pasuesve të Profetit, pati treguar në këtë mënyrë në praninë e tij për egërsinë e periudhës së injorancës: "O i Dërguari i

Allahut! Në kohën e injorancës ne i groposnim të gjalla vajzat. Edhe unë kam pasur një vajzë të vogël. Një ditë i thashë s'emës: "Vishe vajzën se do ta çoj te daja i saj." (Gruaja e dinte se ç'do të thoshte kjo: pas pak, fëmija i saj, pjesë e mishit dhe e gjakut të saj, do të hidhej në një gropë dhe do të përpëlitej nën dhe gjersa të jepte shpirt. Por ç'e do se gruaja në atë kohë s'kishte asnjë lloj të drejte dhe mundësie për t'i dalë përpara kësaj egërsie; ajo vetëm mund të derdhte lot!) Gruaja bëri siç i thashë. Fëmija kujtonte se me të vërtetë do të shkonte te daja dhe përgatitej e gëzuar. E mora për dore dhe e çova në buzë të gropës që e pata hapur që më parë. I thashë të shihte në gropë. Sapo zgjati kokën për të parë, i dhashë një shqelm dhe e shtyva brenda. Sidoqoftë, arriti të kapej në buzë të gropës. Edhe përpiquej të dilte, edhe më thoshte se më ishte bërë rroba me pluhur të cilin përpiquej ta shkundte. Megjithatë, i dhashë një shqelm tjetër dhe e mbulova të gjallë nën dhe!"

Ndërsa burri tregonte, i Dërguari i Allahut dhe të pranishmit qanin me ngashërim. Njëri prej tyre tha: "O njeri, e hidhërove të Dërguarin e Allahut!" Kurse Profeti i tha burrit: "Tregoje edhe një herë!" Burri e tregoi edhe një herë ngjarjen. Lotët e syve të Profetit

të të dy botëve i rridhnin nëpër mjekër e poshtë.(12)
Me këtë përsëritje, Profeti sikur donte të theksonte:
"Ja, pra, kështu ishit ju para Islamit! Kërkova të
përsëritej tregimi që të kujtonit edhe një herë tjetër
vetëdijen e të qenit njeri që ju përftoi Islami!"

Siç u pa nga kjo ngjarje e hidhur, atë ditë
njerëzimi kalonte një krizë të rëndë. Çdo natë, në
errësirën e shkretëtirës hapeshin gropa të thella dhe,
në atmosferën e një mijë e një klithjeve
zemërcjerrëse, vajza të vogla të pafajshme jepnin
shpirt të mbuluara nën dhe. Për nga egërsia,
njerëzimi i kishte lënë prapa edhe çakajtë. Ai që
s'kishte dhëmbë, nuk kishte të drejtë jete dhe ishte i
dënuar pa shpëtim të copëtohej mes dhëmbëve të
atij që kishte. Shoqëria jetonte në kllapi, ndërsa
s'kishte kush t'i thoshte "mjaft!" asaj kllapie!

Pikërisht në ato ditë, Ai që ishte shkak i krijimit
të qenies, ndahej nga njerëzit dhe tërhiqej në malin
Hira që do t'i thoshte "Mali i Dritës" dhe sytë i
prisnin agimet shpëtimtare në horizont. Gjithsesi, në
ato orë pritjeje, vinte ballin në sexhde, lutej pa
pushim dhe i kërkonte Zotit të vet një shpëtimtar
për njerëzimin! Në përshkrimet e Buhariut e të
Myslimit përdoren shprehje që tregojnë pikërisht për

adhurim. Disa herë i Dërguari i Allahut nuk kthehej në Mekë, por rrinte aty gjersa t'i mbarohej ushqimi. Pastaj kthehej, merrte ushqim dhe vinte përsëri në mal.(13)

Gjithsesi, Ai, nga njëra anë mendonte për qenien, për "paskuintën" e saj, për krijimin dhe qëllimin e krijimit dhe, nga ana tjetër, për njeriun që kish dalë nga drejtpeshimi, për hallin e tij që të shtinte drithmat dhe për vuajtjen e tij zemërpërvëluese...

Vlera që ndërrojnë

Po shoqëria ishte mbërthyer nga një gjendje e tillë që të gjitha vlerat njerëzore ishin kthyer përmbys, virtytet kishin filluar të konsideroheshin turpe, kurse turpet, virtyte. Egërsia duartrokitej, ndërsa ndjenja njerëzore për buzej. Ujqit, të bërë çobenj, bënin demonstrim force, kurse delet rënktonin në duart e atyre çobenjve të pamëshirshëm. Në mënyrë të tillë ishin përhapur prostitucioni, adulteri dhe imoraliteti, saqë shumica edhe të atin nuk e njihnin. Soji dhe fisnikëria kishin tharë e ishin zhdukur. Pijet dhe kumari nuk ishin apsak ndër gjërat e konsideruara turp. Matrapazllëku vlerësohej si një dukuri normale dhe thithja e gjakut të njerëzve

me lloj-lloj spekulimesh konsiderohej si mjeshtëri dhe mençuri.

Ja, pra, ndihej nevoja e një fjale me fuqi eliksiri që t'u thoshte "ndal!" këtyre dukurive. Kjo nevojë ishte aq e fuqishme, saqë shpërtheu menjëherë Mëshira dhe po aty u bë preteksti i dërgimit të detyrës profetike Profetit të profetëve dhe, me ardhjen e tij, çdo gjë ndërroi aty për aty. Siç ka thënë edhe poeti i madh Ahmed Shevkiu, "Lindi drejtësia/ Plot dritë u mbush gjithësia/Në buzët e kohës tani/ buzëqeshje ka dhe krenari."(14)

Koha dhe hapësira që ishin errësirë, me dritën e sjellë nga Hz. Muhammedi u shndërruan menjëherë në një tufë trëndafilash që buzëqeshin. Vite më pas, me rastin e hixhretit, populli i Medinës do ta priste Atë me thirrje që ishin shprehje pikërisht të një realiteti dhe ndjenjash të tilla.

(12) Darimi: Mukaddime, 1.

(13) Buhari, Bed'u'l-Vahj, 3; Myslim, Iman, 252.

(14) Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/241.

Njeriu i besueshmërisë

Periudhat e fëmijërisë, të rinisë e të pjekurisë së tij patën qenë në cilësinë e hyrjes, shkallareve dhe shkallëve drejt profetësisë në mënyrë të tillë që një shumicë njerëzish nga ata që e njihnin, i patën besuar dhe i qenë dorëzuar sapo pati shpallur se ishte ngarkuar me detyrën e profetësisë.

Ai nuk kishte gënjyer qoftë edhe një herë të vetme në jetën e tij. Kurse tani pikërisht ky njeri fliste për Allahun dhe thoshte se ishte peygamber. Si mund të ndodhte që një njeri që nuk kishte thënë diçka të kundërt me realitetin edhe në çështjet më të vogla, të mund të thoshte gënjeshtër në një çështje kaq të madhe e sublime? Një gjë e tillë s'mund të ndodhte kurrë! Ja, pra njeriu i asaj dite kështu mendonte; edhe nëse jo të gjithë, ata që e linin mënjanë inatin dhe zilinë, besonin menjëherë. Periudha që jetoi Profeti, që periudha e injorancës, mirëpo ky emërtim i është dhënë kësaj periudhe lidhur me jetesën e atyre që patën mbetur jashtë kohës që e posaçme vetëm për të. Ai kurrë nuk e

pati jetuar periudhën e injorancës ndonëse pati jetuar në atë periudhë. Ai pati qenë njeriu i sigurisë e i besueshmërisë. Dhe, gjithashtu, çdo njeri të tillë e pranonte atë. Bie fjala, dikush donte të bënte një udhëtim për ç'shkak i duhej ta linte familjen në një dorë të sigurt. Dhe për këtë, pa u lëkundur aspak, do t'i drejtohej Muhammedit (s.a.v.). Nëse dikush mendonte t'ia dorëzonte mallin në ruajtje dikujt, për këtë do t'i drejtohej Muhammed Eminit (të Besuarit) duke e ditur se nga malli nuk do t'i prekej as edhe një grimcë. Nëse dikush donte të dinte mendimin më të drejtë mbi një çështje, vraponte te ai etaloni i drejtësisë, e dëgjonte atë, konkludonte në bazë të thënieve të tij dhe të gjitha shpjegimet e tij i mbante për parime në çdo punë, sepse, siç thamë, ai s'kishte gënjyer qoftë edhe një herë në jetën e tij!

Mos doni argumente ? Ja, pra! Ai ka dalë në kodrën Ebu Kubejs dhe i pyet njerëzit që ka përreth: "A do të më besonit sikur t'u thosha se pas kësaj kodre po vjen një ushtri për të na sulmuar?" Të gjithë në një gojë i thonë: "Po, do të të besonim, sepse kurrë nuk dëgjuam që të kesh thënë gënjeshtër!" Midis atyre që përgjigjen kështu, gjenden edhe armiq të fesë si Ebu Leheb dhe Ebu Xhehl¹⁶.

Mirëpo të gjithë e vërtetojnë drejtësinë e tij dhe e pranojnë besueshmërinë e tij. Ai e pati humbur të atin duke qenë ende në bark të nënës, kurse nënën kur qe bërë pesë-gjashtë vjeç. Pastaj e pati marrë nën mbrojtje i gjyshi, Abdylmuttalibi. Por edhe këtë e pati humbur sa pati shkelur në të tetat. Dukej sikur kaderi, paracaktimi hyjnor, e ndante atë prej çdokujt dhe e përgatiste për t'iu dorëzuar tërësisht Allahut. Të gjithë mbrojtësit që mund t'i zgjasnin dorën, shkonin një e nga një dhe tërhiqej vëmendja mbi mbrojtjen e Providencës Hyjnore drejtpërsëdrejti e praktikisht. Ai duhet t'i ketë ndjerë që në krye të herës në ndërgjegje dhe duhet t'i ketë shqiptuar "Fjalën e Njesisë" dhe shprehjen "Hasbinallah", "Allahu më mjafton". Prandaj të gjithë faktorët aparentë duhej të shmangeshin tërësisht nga mesi dhe ashtu pati ndodhur...

"Abdullah" që do të thotë "Robi i Allahut" dhe "Amine" që do të thotë "Grua e drejtë dhe e besueshme", janë emrat e prindërve që e patën sjellë atë në jetë. Po, ai vinte në botë nga një grua që lindte besim, që ishte ruajtësja e amanetit të besimit e të sigurisë. Po ashtu, emri i të atit të këtij njeriu të nderuar, i cili qysh para profetësisë krenohej me të

qenët rob i Zotit, bartte kuptimin "Rob i Zotit". Këto nuk janë rastësi. Nuk janë, sepse është Allahu ai që i përcakton.

Ai u rrit jetim

Ai u rrit si jetim. Përpara ishte një ngarkesë e rëndë që do të merrej përsipër, një detyrë e madhe. Dhe duhej që ai të përgatitej që tani. Ai duhej që të përgatitej me një konstrukt që t'i përgjigjej shkallës më të lartë të nënshtrimit ndaj Zotit, që të mund t'u vinte gjoksin të gjitha vështirësive. Allahu e mbrojti atë nga kapriçioziteti i të pasurit si dhe nga përulesia e të varfërit. Dhe në çdo hap të jetës siguroi përgatitjen e tij si njeri të aftë për të ruajtur maturinë dhe orientimin larg nga ekstremiteti i djathtë apo i majtë.

Për një lider është shumë e rëndësishme që të kalojë nëpër ditë të tilla plot shqetësim. Ai duhet ta dijë mirë se ç'do të thotë bonjakëri në mënyrë që të mundet të sillet si një baba i dhembshur ndaj popullit të tij. Duhet ta ketë shijuar varfërinë që, duke e njohur gjendjen e atyre që ka nën administrim, të ndërhyjë ashtu siç duhet. Ja, pra, karakteri specifik i të Dërguarit të Allahut - zgjatja e dorës jetimit dhe të varfërit dhe kujdesi për ta - që ndodhej në gjendjen e

një fare brenda moralit të lartë të tij, ushqejej me ujin e kësaj jete që jetonte, me dheun dhe ajrin e saj. Edhe pastaj, atëherë kur ai u ngjit majave, duke mos ndryshuar asgjë nga gjendja e tij e kohëve të para, duke jetuar rrafsh e thjeshtë pa ndryshuar mënyrën e të jetuarit gjatë gjithë jetës, tregoi se mbetej një personalitet i pangjashëm. Sa që gjallë, kurrë nuk e përbuzi jetimin dhe nuk e ktheu duarbosh nevojtarin. Sepse këtë ia pati porositur dhe udhëzuar personalisht Providenca Hyjnore: "A nuk të gjeti Ai ty jetim e të bëri vend? Dhe të gjeti të paorientuar e të orientoi? Dhe të gjeti të varfër e të begatoi? Pra mos e përbuz jetimin! Dhe mos e përzë nevojtarin! Dhe me të mirat që të dha Zoti yt, udhëzo!" (Kur'ani, Duha: 6-11)

Sa herë që ta këndoj këtë kapitull, megjithëse im atë më ka vdekur vite më parë, përsëri ia ofroj atë si një ndërmjetës të Dërguarit të Allahut dhe i lutem atij shpirti të lartë që të mos më përzërë nga dera e tij: "Ja një jetim në derën tënde! Mos e përzë nga dera tënde këtë jetim!"

Pranë Abdylmuttalibit

Abdylmuttalibi e pat parandjerë shumë kohë më parë nurin e profetësisë tek ai. Ditët e jetuara me të

kalonin përherë të mbara e të begata. E ulte atë në kuvendet e të mëdhenjve, tregonte respekt dhe konsideratë për të. Tek ai shihte shpëtimin e njerëzimit. Në shikimin e të Dërguarit të Allahut kishte një thellësi të tillë që ishte e pamundur ta konstatoje tek të tjerët. Luej, për të cilin thuhej se ndoshta ishte profet nga etërit, kishte paralajmëruar se një profet i tillë do të vinte prej brezit të tij dhe Abdylmuttalibi, i mbështetur në këtë sihariq, kishte ndjerë se i nipi, Muhammedi, do të bëhej profet. Madje mund të thuhet se pikërisht si rrjedhojë e kësaj e donte të nipin me një dashuri skajore gjer në xhelozë. Kur do të vdiste, ky burrë vigan pati qarë me ngashërim dhe i qe përgjigjur kështu Ebu Talibit që i qe afruar pranë dhe e pati pyetur për shkakun: "Nuk do të mundem më ta marr në gjoks Muhammedin e ta përkëdhel, prandaj po qaj!" Mendoni tani që, ky burrë i cili nuk ishte lëkundur përballë ushtrisë së Ebrehesë e të cilit gjatë dhjetra vitesh lufte as nuk i ishte njomur syri, qante si fëmijë se do të ndahej nga nipi i tij i dashur! Kjo do të thoshte fund edhe i kujdestarisë së Abdylmuttalibit. Po, edhe ai i mbylli sytë duke dhënë këshillën e fundit. Pas tij, atë

"Margaritarin e Pashoq" do ta merrte në mbrojtje Ebu Talibi.

Kalimi te Ebu Talibi

Ebu Talibi e mbajti fjalën. E mbrojti të Dërguarin e Allahut për afro dyzet vjet me radhë, iu bë mburojë atij. Dhe kjo mirësi e Ebu Talibit nuk mund të mbetej pa përgjigje. Providenca Hyjnore i mundësoi atij të ketë një bir si Hz. Aliu. Brezi i çdo profeti ka vazhduar nga vetvetja. Kurse brezi i të Dërguarit të Allahut do të vazhdonte nëpërmjet Hz. Aliut. Madje thuhet se është edhe një rrëfim për këtë që i dedikohet Profetit.

Hz. Aliu përfaqësonte aspektin e prijësisë të Profeti i të Dy Botëve. Nisur nga kjo, ai konsiderohet kurora e të gjithë prijësve. Vlerësimi i lartë që i është bërë e do t'i bëhet gjer në Kiamet, është si një dhuratë e si një përgjigje për bujarinë e treguar prej tij ndaj Ebu Talibit dhe të Dërguarit të Allahut.

Edhe Ebu Talibi, ashtu si i ati, Abdylmuttalibi, ishte vetëm një pretekst në aparencë. Ishte Providenca Hyjnore Ai që e rriti dhe e mbrojti atë. Ndërsa nga njëra anë Allahu e lartësonte atë Personalitetin e Zgjedhur drejt nivelit të profetësisë,

nga ana tjetër shoqëria përgatitej në mënyrë që të mund ta pranonte atë në momentin e duhur. Çdo ditë që kalonte, merrnin trajtë edhe më të qartë shenjat e profetësisë së tij dhe Hz. Muhammedi (a.s.) ruante pozitën e tij të lartë në aktualitetin e përditshëm si një njeri për të cilin flisnin të gjithë dhe e njihnin nga afër të gjithë.

Udhëtimet

Udhëtimi për në Damask dhe murgu Bahira

Librat biografikë flasin për udhëtimin e parë të të Dërguarit të Allahut në shoqërim të të ungjit Ebu Talib kur pati qenë ende dymbëdhjetë vjeç. Ky udhëtim qe bërë për në Damask. Karvani bën konak diku në një han dhe Muhammedi caktohet si vëzhgues, ndërsa të tjerët ulen për të pushuar. Ndërsa karvani po i afrohej hanit, një murgu të quajtur Bahira, të njohur nga vendasit, i tërheq vëmendjen një dukuri. Mbi karvan qëndronte një re që e shoqëronte vazhdimisht. Kur karvani qëndronte, edhe reja qëndronte; kur karvani vihej në lëvizje, edhe reja lëvizte. Për këtë, murgu Bahira i

fton në ngrënie të gjithë pjesëmarrësit e karvanit. Kjo sjellje e murgut i cili gjer atëherë nuk pati treguar aspak interesim për karvanet, i çudit të gjithë. Të gjithë i përgjigjen ftesës përveç Muhammedit. Dhe murgu nuk sheh midis tyre atë që kërkon. Prandaj pyet nëse ka mbetur dikush në rojë të karvanit. Pasi merr përgjigjen, e thërret edhe atë. Sapo Muhammedi hyn në dhomë, murgu në vetvete arrin në konkluzion dhe e pyet Ebu Talibin se kush ishte ai. Ebu Talibi i thotë se ishte i biri, por murgu nuk e beson sepse ka konkluduar se djali është Ai dhe e di se i ati duhej ta kishte lënë jetim pa lindur ende. Më vonë, murgu e heq mënjanë Ebu Talibin dhe e këshillon të heqë dorë nga ky udhëtim, sepse, sipas tij, çifutët ishin njerëz ziliqarë dhe, duke e njohur këtë djalë nga pamja, mund të mendonin ndonjë të keqe për të meqë s'ishte nga radhët e tyre. Këto gjëra murgu vetëm sa i mendon, kurse Ebu Talibit i thotë vetëm kaq: "Hiq dorë nga ky udhëtim!.." Ebu Talibi ia dëgjon këshillën, gjen një justifikim, ndahet prej karvanit dhe kthehet pas për në Mekë.(17)

Murgu Bahira thoshte të vërtetën. Por ishte një gjë që ky s'e dinte: Ai ndodhej nën mbrojtjen e Allahut (xh.xh.) gjer në fund të jetës, gjë që e shpreh

edhe ajeti i mëposhtëm: "Allahu të garanton mbrojtjen prej armiqve". (Kur'ani, Maide: 67). Po, kështu i thoshte atij Zoti i vet dhe do ta mbante premtimin gjer në fund!..

Udhëtimi i dytë për në Damask

Udhëtimin e dytë për në Damask Profeti i Dy Botëve e bëri kur ishte njëzet e pesë vjeç. Këtë radhë ai printe karvanin e Hz. Hatixhesë me të cilën kishte hyrë në ortakëri. Edhe kësaj radhe ai u takua me murgun Bahira. Murgu ishte plakur mjaft. U gëzua shumë kur e pa të Dërguarin e Allahut sepse vazhdimisht e kishte pritur një ditë të tillë. Murgu i tha Muhammedit: "Ti do të bëhesh profet. Ah, sikur t'ia mbërrija ditës kur do të shpallësh profetësinë! T'ia mbërrija dhe të të shërbeja!" Por ai nuk i mbërriti ato ditë, por është e padiskutueshme se ky pohim dhe pranim i ka përfutur atij shumë gjëra në jetën e pasosur.

Çdo njeri atë priste

Numri i atyre që e prisnin dhe që jepnin myzhden për të, nuk ishte i kufizuar vetëm në dy-tre vetë. Ata ishin shumë dhe Zejd b. Amri ishte njëri prej tyre. Zejdi, i ati i Said b. Zejdit, pasuesit të

njohur dhe njërit prej personave të cilësuar "Ashere-i Mybeshere"(i) si dhe ungi i Hz. Omerit, ishte nga Hanifët. Ky person bënte pjesë në grupin e njerëzve që, pak para se të lindte Profeti, qenë distancuar nga idhujt duke deklaruar se ata nuk kishin mundësi për të bërë mirë ose keq. Edhe Zejdi pati bërë parashikime ndër të cilat më të rëndësishmet janë këto fjale: "Unë njoh një fe, ardhja e së cilës është shumë afër, hija e së cilës qëndron mbi kokat tuaja. Por nuk e di nëse do t'ia mbërrij unë asaj dite apo jo!"

Zejdi ishte një njeri i prekur nga një frymëzim, ndërgjegjia e të cilit ishte zgjuar plotësisht kah e Vërteta. Ai i besonte Allahut që ishte një i vetëm dhe Atij dëshironte t'i dorëzohej. Veçse as mundej t'i thoshte "Allahu im!", as dinte se si i duhej bërë adhurim.

Amir b. Rebia, një ndër Sahabe-i Kiram, pasuesit profetikë, na përcjell këto: "Dëgjova nga Zejd b. Amri një ditë të thoshte kështu: "Unë pres një të dërguar që do të vijë nga soji i Hz. Ismailit e i Abdylmuttalibit. Nuk pandeh se do ta arrij atë, por besoj, vërtetoj dhe pranoj se Ai është profet i vërtetë. Nëse ti do të jetosh dhe do t'ia arrish atij, t'i bësh të

fala prej meje! Do të të flas për portretin e tij, por mos u çudit! "Urdhëro e fol, i thashë". Dhe ai vazhdoi: "Eshtë trupmesatar. As shumë i gjatë e as shumë i shkurtër. Flokët i ka as krejt të drejta, as edhe krejt kaçurrela. Emrin e ka Ahmed. Vendlindja e tij është Meka. Po aty do të dërgohet si profet. Mirëpo më pas, fisi i tij, meqë nuk do të jetë i kënaqur me porositë e tij, do ta nxjerrin nga Meka. Ai do të emigrojë në Jethrib (Medinë) dhe feja e sjellë prej tij që atje do të përhapet. Kujdes, të mos të të gjejë të papërgatitur! Unë shëtita vend më vend dhe kërkova fenë e Hz. Ibrahimit. Të gjithë dijetarët çifutë dhe krishterë me të cilët bisedova, më treguan po ato gjëra që të thashë pak më parë dhe e përfunduan fjalën gjithmonë po njëllor: "Ai është peygamberi i fundit, pas të cilit nuk do të vijë më tjetër peygamber."

Amir b. Rebia vazhdon: "Erdhi dita dhe unë u bëra musliman. Ia tregova të Dërguarit të Allahut fjalët e Zejdit një për një. Kur ia dhashë të falat, u përqëndrua dhe iu përgjigj përshëndetjes. Dhe shtoi: "Unë e pashë Zejdin në xhennet tek ecte duke përveshur palët e rrobës së gjatë."(18)

Varaka b. Nevfel ishte një dijetar kristian dhe, gjithashtu, farefis me Hz. Hatixhenë. Kur të Dërguarit të Allahut pati filluar t'i vinte revelacioni i parë, pati shkuar tek ai për të marrë vesh si qëndronte puna dhe pati marrë këtë përgjigje prej tij: "O Hatixhe! Ai është një njeri fjalëdrejtë. Ato ç'ka parë, janë gjithë ç'duhën parë në fillimet e profetësisë. Ai që i ka ardhur, është Virtyti i Madh.(ii) Eshhtë po Ai që u pati ardhur edhe Hz. Musait dhe Hz. Isait. Në një të ardhme të afërt Muhammedi do të bëhet pejgamber. Nëse do t'ia arrij asaj dite, edhe unë do t'i shpreh besimin tim dhe do të bëhem përkrahës i tij."(19)

Kurse Abdullah b. Selam ishte një dijetar çifut. Le ta dëgjojmë personalisht prej tij sesi hyri në Islam. "Kur i Dërguari i Allahut emigroi në Medinë, edhe unë, si gjithë të tjerët, shkova për ta parë. Përreth kishte shumë njerëz. Kur hyra brenda, nga buzët e bekuara po i derdheshin këto fjalë: "Kur t'u vijë kush, përshëndeteni dhe i jepni për të ngrënë!" Kisha mbetur i mahnitur para magjisë së fjalëve dhe thellësisë që shprehte fytyra e tij. Aty për aty dëshmova dhe u bëra musliman, sepse portreti i tij mund të vërehej vetëm te një profet!"(20)

Abdullah b. Selam ishte një personalitet i rëndësishëm. Sipas shënimit të Ibni Haxherit në librin e tij "Isabe", rridhte nga brezi i Hz. Jusufit.(21) Ishte njeri i nderuar. Dëshmia e tij vlerësohej në vetë Kur'anin duke u përmendur në nivelin e argumentit: "Thuaj: Pa mendoni, nëse ju e mohoni këtë (Kur'an) që është prej Allahut e, megjithëse një dëshmitar nga të bijtë e Izraelit e beson si të tillë, ju përsëri tregoni mendjemadhësi, a nuk përbën kjo një padrejtësi? Pa dyshim që Allahu nuk e orienton në udhën e shpëtimit një popull të padrejtë." (Kur'ani, Ahkaf: 10).

Dëshmitari prej të bijve të Izraelit, i përmendur në ajet, është Abdullah b. Selam. Sado që disa komentues të kenë thënë se personi i përmendur duhet të jetë Hz. Musai, duke mbajtur parasysh se kjo sure është mekase, pikëpamja se ky ajet është medinas, është më e fuqishme. Domethënë se sureja "Ahkaf" është mekase, kurse vetëm ajeti në fjalë është medinas dhe bën fjalë për Abdullah b. Selamin.

Pse s'besuan?

Në të vërtetë, të gjithë çifutët dhe krishterët e dinin dhe e njihnin të Dërguarin e Allahut, por zilia dhe urrejtja u bëheshin pengesë për t'i besuar.

Gjithashtu kjo njohje ishte aq e saktë dhe e qartë, saqë mjaftonte ta shihnin vetëm një herë të Dërguarin e Allahut. Sepse ata e njihnin atë në të gjithë portretin e vet. Këtë të vërtetë Kur'ani e shënon në këtë mënyrë: "Ata që u kemi dhënë librin, e njohin Atë siç i njohin fëmijët e tyre të vërtetë. Megjithatë, një grup prej tyre e fshehin të vërtetën megjithëse e dinë atë." (Kur'ani, Bakara: 146). Fakti që në ajet për të Dërguarin e Allahut thuhet "Atë" pa ia përmendur emrin, aludon se të gjithë adhuruesit e librit (çifutët dhe krishterët), kur thoshin "Ai" duke e pasur fjalën për profetin e fundit, kujtonin Personin që përmendej në Testamentin e Vjetër e në Ungjill. Dhe, pa asnjë dyshim, ai ishte Hz. Muhammedi (s.a.v.). Dhe atë e njihnin më mirë se ç'njihnin bijtë e tyre të vërtetë.

Hz. Omeri e pyet Abdullah b. Selamin:
- A e njihje të Dërguarin e Allahut si birin tënd të vërtetë?

Dhe ai i përgjigjet:
- Po, e njihja më mirë se birin tim të vërtetë!

Kur Hz. Omeri e pyet "Si?", ai i jep një përgjigje të tillë: "Mund të dyshoj për tim bir se mos më ka mashtruar gruaja. Por nuk kam dyshim as sa grimca

se i Dërguari i Allahut është profeti i fundit!" Kjo përgjigje e gëzon aq shumë Hz. Omerin, sa ngrihet dhe e puth në ballë Abdullah b. Selamin!(22)

Zili dhe xhelozia

Po, ata e njihnin shumë mirë të Dërguarin e Allahut. Mirëpo njohja është tjetër dhe besimi tjetër gjë. E njihnin, por nuk i shfaqnin besim, sepse u bëheshin pengesë zilia dhe xhelozia: "E kur u erdhi prej Allahut libri (Kur'ani) vërtetues i librit të tyre e të cilin ata e kërkonin më parë si ndihmë kundër mosbesimtarëve, e mohuan atë (Muhammedin) që e njihnin." (Kur'ani, Bakara: 2/89).

Me këtë ajet-argument Zoti tregonte shkaku e vërtetë për të cilin ata nuk e pranonin të Dërguarin e Allahut. E gjithë çështja qëndronte në atë se profeti i fundit nuk ishte hebre. Pa dyshim, po që se profeti i fundit do të kishte dalë mes hebrenjve, qëndrimi i tyre do të ndryshonte.

Me të vërtetë, Abdullah b. Selami shkon te i Dërguari i Allahut dhe i propozon: "Më fshihni mua dhe thirrni të gjithë dijetarët çifutë të Medinës. Pastaj pyetini ata se si më njohin mua dhe tim atë. Sigurisht që përgjigjja e tyre do të jetë pozitive. Pastaj unë do të dal nga vendi i fshehur e do të shpall se jam bërë

musliman!" I Dërguari i Allahut e pranon këtë propozim. Kur dijetarët çifutë hyjnë në dhomë dhe zënë vend, Profeti i pyet: "Si i njihni Abdullah b. Selamin dhe të atin?" Dhe ata i përgjigjen: "Ai dhe i ati janë më të diturit e më të nderuarit mes nesh!" Pastaj Profeti i pyet sërish: "Ç'do të thoshit po qe se ai më vërteton mua?" Dhe ata i thonë: "Eshtë krejt e pamundur, një gjë e tillë nuk mund të ndodhë!" Atë çast del nga vendi i fshehur Abdullah b. Selami dhe, duke shqiptuar Fjalën e Dëshmisë, e vërteton profetësinë e Profetit tonë. Dijetarët çifutë shtangen nga habia dhe, duke i marrë prapë fjalët lavdëruese të shprehura vetëm pak çaste më parë për Abdullah b. Selamin dhe të atin, thonë: "Ky është më ngatërrestari dhe i biri i më ngatërrestarit midis nesh!" Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut i jep fund takimit.(23)

Edhe kjo ndodhi vërteton hapur se çifutët e njihnin dhe e dinin se kush ishte i Dërguari i Allahut, por paragjykimi dhe ideja fikse që ushqenin, u bëhej pengesë në besim.

Edhe Selmani Farisiu është një argument më vete në këtë çështje. Fillimisht ai pati qenë adhurues i zjarrit, megjithatë digjej nga dëshira për të gjetur fenë

e vërtetë. Pastaj u njoh me kristianizmin dhe u mbyll në kishë. Nga murgu pas të cilit ishte lidhur, kërkoi, kur po vdiste, t'i rekomandonte një tjetër murg. Në këtë mënyrë, ai pati qëndruar pranë disa vetëve. Kur i pati shprehur të njëjtën dëshirë një murgu fatlumë që po jetonte minutat e fundit, ai i pati thënë: "Biri im, s'ka mbetur kush që mund të ta rekomandoj. Por është afruar mjaft koha e shfaqjes së profetit të fundit. Ai do të vijë mbi fenë Hanif të Hz. Ibrahimit duke u shfaqur atje ku emigroi Ibrahim, por do të emigrojë dhe do të vendoset diku tjetër. Ekzistojnë argumente të qarta mbi profetësinë e tij. Po munde, atje shko. Ai nuk ha sadaka, pranon dhurata dhe midis dy shpatullave ka një vulë si provë të profetësisë."

Vazhdimin ta dëgjojmë prej gojës së tij.

"Kërkova një karvan për të shkuar atje ku më tha murgu. Më në fund e gjeta dhe u thashë njerëzve të më çonin sipas një shpërblimi të caktuar. Pranuan. Mirëpo kur arritëm në luginën e quajtur Kura, më shitën si skllav të një çifut. Kur pashë kopshtet me hurma, mendova se ndoshta ky ishte vendi për të cilin më kish folur murgu. Pastaj, një ditë, erdhi një çifut i fisit Beni Kurejza, më bleu dhe më çoi në

Medinë. Në Medinë punoja në kopshtet me hurma. Ndërkaq, nuk kisha marrë asnjë lajm për të Dërguarin e Allahut. Një ditë prej ditësh kisha hipur mbi një pemë e po mblidhja hurma, kurse imzot po pushonte poshtë. Një çast se nga doli njëri prej djemve të xhaxhallarëve të tij dhe i foli me zemërim: "Zoti i vraftë! I gjithë mileti po shkon në Kuba. Paska ardhur një burrë nga Meka, paska shpallur se është profet dhe ata i besojnë!" Fillova të dridhesha nga emocioni, aq sa do të bija poshtë mbi kryet e timzoti! Zbrita shpejt dhe i thashë djalit: "Ç'thua more, ç'lajm është ky?" Kur imzot vuri re emocionin tim, më dha një të qëlluar me të pasmen e pëllëmbës duke më thënë: "E ç'të duhet ty? Shih punën!" Kurse unë e mblodha veten: "Hiç...vetëm desha të marr vesh se ç'ka ndodhur..." Dhe hipa përsëri në pemë. Kur u err, mblodha ç'më ndodheshin dhe shkova në Kuba. I Dërguari i Allahut po rrinte së bashku me pasuesit e tij. "Ju jeni të varfër -u thashë- kurse unë kërkoja dikë që të jepja sadaka. Ja, merrini këto e hajini!" I Dërguari i Allahut u tha të pranishmëve të hanin, kurse vetë nuk preku asgjë. Në vetvete thashë: "Ja shenja e parë që tha murgu!" Të nesërmen në mbrëmje shkova prapë dhe u thashë: "Kjo nuk është

sadaka, por dhuratë. Urdhëroni e hani!" I Dërguari i Allahut i ftoi të tjerët të hanin, por mori edhe vetë. "Në rregull -thashë- u vërtetua edhe shenja e dytë siç tha murgu."

Kishte vdekur njëri nga sahabet, pasuesit e Profetit. Në varrezat e Medinës kishte ardhur edhe Ai. Iu afrova pranë dhe i dhashë selam.(iii) Pastaj i kalova pas dhe u përpoqa t'i shihja myhyrin mes dy shpatullave. E kishte kuptuar qëllimin tim... Megjithëse edhe shpatullat të zbuluara i kishte. E pashë myhyrin! Edhe shenja e tretë ishte siç ma kish përshkruar vite më parë murgu im. S'e mbajta dot veten, iu vara në supet e fillova t'i puthja myhyrin. "Dale - më tha i dërguari i Allahut. Prit të marrim vesh..." U hoqa, u ulëm mënjanë dhe ia tregova një për një ç'më kishin rënë në kokë. U gëzua shumë. Kërkoj që rrëfimin tim ta dëgjonin edhe pasuesit."(24)

Po, ata që e kanë vështruar atë duke lënë mënjanë inatin dhe zilinë, e kanë gjetur dhe janë shtënë pas tij. Në këtë fakt nuk ka asnjë thërrime ndryshim në aspektin cilësor midis së djeshmes e së sotmes. Edhe sot, me mijëra dhe qindramijëra vetë, duke parë fisnikërinë e tij, e vërtetojnë Atë dhe i

thërrasin me zë të lartë botës se profeti i fundit është Ai! Megjithatë, është një fakt pa asnjë ndryshim midis së djeshmes e së sotmes, fakti që ata që nuk e lënë mënjaneë inatin dhe këmbënguljen, nuk e pranojnë kumtesën profetike të tij edhe pse e dinë shumë mirë një gjë të tillë!..

Ndjenja e rivalitetit

Mugire b. Shube tregon: "Po rrinim bashkë me Ebu Xhehlin. Erdhi i Dërguari i Allahut dhe nisi të na fliste e të na kumtonte. Atëherë Ebu Xhehli iu drejtua vrazhdësisht: "O Muhammed! Po qe se na i tregon këto gjëra me prapaqëllim për të gjetur dëshmitarë, mos u lodh kot, unë dëshmoj për ty! Dhe tani na lër të qetë!" I Dërguari i Allahut u nda prej nesh. E pyeta Ebu Xhehlin:

- Me të vërtetë, a e beson atë? - Dhe ai m'u përgjigj:

- Ç'është e vërteta, e di që është pejgamber. Mirëpo midis nesh dhe Hashimitëve ekziston një rivalitet i hershëm. Hashimitët krenohen se kanë rezervuar uji, se dinë të bëjnë kompresa... Të ngrihen e të thonë tani se prej tyre ka dalë edhe një pejgamber, këtë s'e duroj dot!(25)

U mblodhën Kurejshët në këshillë dhe vendosën ta çojnë Utbe b. Rebianë te i Dërguari i Allahut. Ky do të shkonte dhe do ta bindte atë të hiqte dorë prej kauzës së vet. Utbe b. Rebiai ishte nga klasa e intelektualëve të kohës dhe kompetent në letërsi. Shkoi te Profeti dhe, duke paramenduar të bëjë lojra logjike me të, e pyeti: "O Muhammed! Kush është më i dobishëm, ti, apo yt atë, Abdullahi?"

Profeti nuk iu përgjigj. Ndoshta pati menduar se përgjigjja më e mirë për njeriun sjelljetrashë ishte heshtja. Utbe vazhdoi:

- Po qe se e pranon që ai ka qenë më i dobishëm se ti, dije se ai pati adhuruar pikërisht këta idhuj që ti sot i poshtëron. Por po qe se e quan veten më të dobishëm, atëherë fol se po të dëgjoj!

I Dërguari i Allahut e pyeti: "A mbarove?"

"Po" - tha Utbe dhe heshti. Atëherë Profeti i Dy Botëve u ul në gjunjë dhe nisi ta këndonte nga kreu kaptinën "Fussilet". Kur Profeti arriti te ajeti-argument i 13-të, "Në qoftë se ata nuk përgjigjen, ti thuaju: "Unë po ju tërheq vëmendjen për një rrufe si rrufeja mbi Adin dhe Themudin!", Utbe nuk mundi të duronte më! Po dridhej si ndër ethe! E vuri dorën në buzët e bekuara të të Dërguarit të Allahut. Nuk i

kishte mbetur pikë fuqie! "Mjaft, o Muhammed! Për emrin e Allahut që beson, mjaft!" - tha dhe u ngrit e iku.

Paria e Mekës prisnin përfundimin. Ebu Xhehli nuk e kishte pëlqyer fare pamjen e Utbes në kthim. U tha atyre që kishte pranë: "Nuk po kthehet siç shkoi!" Ashtu ishte! Utbeja nuk shkoi ku po e prisnin, por drejt e në shtëpinë e vet. Argumentet që kishte dëgjuar, e kishin goditur siç godet rrufeja. Pas pak në derë i kishte shkuar Ebu Xhehli që i jepte mend edhe djallit. Kishte frikë se mos Utbeja kishte besuar dhe mendonte se hekuri duhej rrahur pa u ftohur. I njëjhte mirë dobësitë e Utbes. Do ta godiste në krenarinë e tij! Dhe i tha kështu: "O Utbe! Dëgjova se Muhammedi të kishte bërë komplimente e nderë me të tepërt. Të kishte shtruar të ngrëna e të pira! Dhe ti, duke mos i përballuar nderet, kishe besuar! Njerëzit kështu flasin..." Utbeja u zemërua tepër. I hipi damari: "Ju të gjithë e dini mirë se unë s'jam nevojtar për të ngrënat e tij. Unë jam më i pasuri ndër ju! Ishin të thënat e Muhammedit që më tronditën! Ajo ç'ka këndoi ai, s'ishte poezi. Nuk di ç'të them! Ai është një njeri fjalëdrejtë! Kur po e

dëgjoja tek këndonte, pata frikë se mos na binte mbi kokë ajo që u pat rënë Adit dhe Themudit...(26)

Shkaqe të tjera

Në të vërtetë, këto kundërshtime nuk kufizoheshin vetëm në dy-tre vetë. Në ndërgjegjen e përgjithshme opinioni ishte gjithherë i njëjtë. Mirëpo ndikime të faktorëve negativë të tilla si frika, zemërngushtësia, inati, shpirti i kundërshtimit u bëheshin pengesë në besim dhe nuk arrinin ta deklaronin atë edhe pse e dinin se si qëndronte puna.

Kur'ani, duke treguar për gjendjen e tyre si dhe duke e qetësuar Profetin, urdhëron kështu: "E dimë se ty të brengosin thëniet e tyre, por e vërteta është se ata nuk të quajnë gënjeshtar ty. Të padrejtë e mizorë, ata i mohojnë me ndërgjegje ajetet e Allahut!" (Kur'ani, En'am: 33). Sikur të donte t'i thoshte: "Ata të bëjnë ty akuza të ndryshme që të mërzhisin e të hidhërojnë. Por kujdes! Të mos të hidhërojnë ty thëniet e atyre që ndodhen të shtypur nën dëshirat trupore e të fatkeqëve të dobët që nuk mundën të braktisin veset! Në të vërtetë, ata nuk të mohojnë ty personalisht. Po, asnjëri prej tyre s'ngrihet të të akuzojë ty për gënjeshtër, sepse ata e dinë mirë se ti je i pastër nga gënjeshttrat. Janë

pikërisht ata që të kanë vënë emrin "Emin", "I Besueshmi". Vër re absurditetin e sjelljes së tyre: megjithëse as vetë nuk u besojnë akuzave që të drejtojnë ty, prapëseprapë gjejnë guxim për një gjë të tillë! E në qoftë kështu, përse duhet të mërzhitesh?!"

Po, nëse duhet të jetë dikush që duhet të mërzhitet e të hidhërohet, janë ata që i rrinë kundër Personalitetit që i mban në dorë frenat e kësaj bote e të botës tjetër!

(17) Ibni Hisham, Sire, 1/191 e në vazhd.

(i) Ashere-i Mybeshere: Dhjetë të përgëzuarit; dhjetë persona të shquar midis sahabeve, pasuesve profetikë, të cilëve iu qe dhënë më të gjallë myzhdeja e fitimit të parajsës: Hz. Ebu Bekr, Hz. Omer, Hz. Osman, Hz. Ali, Hz. Abdurrahman b. Avf, Hz. Ubejde bin Xherrah, Hz. Said, Hz. Saad bin Ebi Vakkas, Hz. Talha, Hz. Zubejr bin Avvam.

(18) Ibni Kethir, el-Bidaje, 2/298 e në vazhd.

(ii) Në origjinal: Namus-u Ekber; është atribut i engjëllit të madh Xhebrail (Gabriele).

(19) Buhari, Bediu'l-Vahj, 3.

(20) Mysned, 5/451.

- (21) Ibni Haxher, Isabe, 2/320.
- (22) Muhtasaru Tefsiri Ibni Kethir, 1/140.
- (23) Buhari, Tefsir, 2/6.
- (iii) Përshëndetja në Islam: Esselamu alejkum ve rahmetullah! Paqja dhe Mëshira e Allahut qofshin mbi ty (ju)! Shkurt: Selamu alejkum! Alejkum selam!
- (24) Ibni Hisham, Sire, 1/228-234.
- (25) Alaeddin Ali el-Muttaki, el-Hindi, Kenzu'l-Ummal, 14/39-40; Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/83.
- (26) Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/80-81; Ibni Hisham, sire, 1/313

Profeti i Paralajmeruar dhe i Pritur

Lutja e Ibrahimit (as), sihariqi i Isait (as)

Një ditë, njëri prej pasuesve i thotë Profetit: "O i Dërguari i Allahut, a nuk po na flet pak për veten?" Në një pjesë të përgjigjes së vet, Profeti shprehet kështu: "Unë jam lutja e Ibrahimit dhe sihariqi i Isait!"(27)

Kur'ani e prek këtë specifikë në dy ajete.

1) Hz. Ibrahim është lutur kështu: "Zoti ynë! Dërgoju një përfaqësues nga mesi i tyre që t'u lexojë

ajetet e Tua, t'u mësojë Librin dhe urtësinë e t'i pastrojë (prej idhujtarisë). Ti je i Dituri, Sovrani." (Kur'ani, Bakara: 129)

2) Sihariqi i Hz. Isait: "Kujto se Isai, biri i Merjemes tha: "O të bijtë e Izraelit! Unë jam i dërguari i Allahut tek ju, jam vërtetues i Teuratit(i) të dërguar para meje dhe përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed." Dhe kur ai u paraqiti argumente të qarta, ata thanë: "Kjo është një magji e hapët!" (Kur'ani, Saff: 6)

Po, i Dërguari i Allahut nuk ishte dikush i dalë në shesh si surprizë! Ai është profeti për ardhjen e të cilit ishte lajmëruar shekuj më parë dhe që pritej nga i gjithë njerëzimi.

Argumenti më i madh për profetësinë e tij është Kur'ani, mrekullia e të cilit është e amshuar. Qindra ajete-argumente të Deklaratës Mrekulli - Kur'an(ii) përmendin se Profeti i Dy Botëve është profet i vërtetë. Një person që nuk mundet ta mohojë plotësisht Kur'anin, kurrë nuk mundet ta mohojë kumtesën profetike të Muhammedit (s.a.v.)! Vetëm se ne nuk do t'i futemi tani kësaj specifike që përbën një temë më vete. Fundja, duke iu drejtuar njëri pas

tjetrit ajeteve të ndryshëm, pjesërisht e kemi trajtuar edhe këtë temë.

Paralajmërimet e Testamentit të Vjetër

Në këtë pjesë dëshirojmë të citojmë disa fragmente nga Teurati (Testamenti i Vjetër), Ungjilli dhe Zeburi (Libri i Psalmeve) të cilat, me gjithë korrigjimet që u janë bërë qindra herë, bartin ende analogji dhe myzhde për të Dërguarin e Allahut. Duke ua lënë hollësitë e çështjes veprave të posaçme që merren drejtpërsëdrejti me këtë temë dhe veçanërisht veprës "Risale-i Hamidije" të Hysejin Xhisriut, do të synojmë të përmendim këtu vetëm disa prej atyre që na duken më të rëndësishme.

Malet Faran

Një sentencë e përkthimit arabisht të Testamentit të Vjetër të botuar në Londër më 1944, thotë: "Zoti u drejtua kah njerëzit në Sina, u shfaq në Sair dhe, duke u dukur në malet Faran, doli në shesh me gjithë përsosmërinë e Tij." (kap. 33, sentenca 2).

Kjo do të thotë se mëshira e Allahut, mëshira dhe favori i Tij për njerëzimin kanë marrë trajtë në malin e Sinait në bisedën midis Tij dhe Hz. Musait (a.s.). Konkretizimi i kësaj mëshire është profetësia e dhënë Musait në atë periudhë historike. Sair është

Palestina. Atje, mëshira e Providencës Hyjnore ka rrethuar, me rrugën e revelacionit, Hz. Isanë dhe ata që ndodheshin në mjedisin e tij. Në të njëjtën kohë, Hz. Mesihu është një peygamber i madh, i denjë për shfaqjet e Zotit. Shumica, duke mos i dalluar dot shfaqjen nga dukja, kanë rënë në konfondim në këtë çështje. Ajo që shfaqet tek ai, është fryma hyjnore.(iii) Kurse në malet Faran Providenca Hyjnore është dukur me anë të enigmës së unitetit dhe të nivelit individual unik(iv) që përfshin gjithësinë. Farani është Meka, sepse në një vend tjetër të Testamentit të Vjetër tregohet se Hz. Ibrahim i vendosi në Faran të birin Ismail. Nga kjo kuptohet se në Testamentin e Vjetër, me emërtimin Faran bëhet fjalë për Mekën. Në sentencën në fjalë aludohet radhazi për tre profetë. I pari nga këta është Hz. Musai, i dyti, Hz. Isai (as) dhe, i treti, profeti i fundit, Profeti i Dy Botëve, Hz. Muhammed Mustafai (s.a.v.). Në vazhdimin e sentencës në fjalë të Testamentit të Vjetër janë këto pohime: "Pranë Tij do të jenë mijëra pasues, modele të përsosmërisë, kurse në dorën e Tij do të ndodhet një sëpatë dytehëshe prej zjarri." Nga kjo kuptohet se ai do të ngarkohet me detyrën e xihadit.

Tashmë është i njohur fakti se i Dërguari i Allahut, para se të fillonte revelacioni, tërhiqej në vetmi në një shpellë të malit Hira, ku jepej pas meditimit dhe adhurimit. Edhe revelacioni i parë në këtë mal i pati ardhur.(28) Po qe se Farani nuk është Meka, e cili mund të jetë ai vendi tjetër nga ku të jetë përhapur në lindje e perëndim një fe si Islami? Meqë në botë nuk ekziston ndonjë vend i quajtur kështu, Farani i përmendur në Testamentin e Vjetër shënon Mekën. Veçanërisht, ashtu siç e përmendëm edhe më sipër, pohimi "e vendosi në Faran" që përshkohet në sentencën 21 të librit të parë të Testamentit të Vjetër e që tregon se ku u vendos Hz. Ismaili, është argumenti më i hapur e më i madh në favor të thënies sonë. Dhe askush nuk do të kishte mundësi të pretendonte të kundërtën. Kundërshtimet e bëra rreth kësaj çështjeje janë polemika vetiake larg kompetencës shkencore. Sidomos pjesa e fundit e sentencës ku aludohet për pasuesit dhe xhihadin, tregon në një mënyrë që nuk lë shesh për asnjë ngurrim dhe dyshim se personi në fjalë është Hz. Muhammedi (s.a.v.).

Nga soji i Hz. Ismailit

Në një ajet tjetër të Testamentit të Vjetër, Zoti i thotë kështu drejtpërsëdrejti Hz. Musait: "Për ta (të bijtë e Izraelit) do të nxjerr një profet si ti mes vëllezërve të tyre dhe fjalët e mia do t'i vë në gojë të tij dhe do t'u thotë atyre çdo gjë për të cilat e urdhërova." (kap. 18, sentenca: 18).

Edhe sentenca e 19-të është në cilësinë e plotësimit të kësaj: "Unë vetë do të hakmerrem ndaj atyre që nuk do t'u binden fjalëve të tij të thëna në emrin Tim!"

Në këtë sentencë, me vëllanë e të bijve të Izraelit aludohet për një profet të ardhshëm nga soji i Hz. Ismailit dhe, siç dihet, si i ardhur nga soji i tij njihet vetëm një profet i cili është Hz. Muhammedi (s.a.v.). Veçanërisht theksohet se do të vijë si Musai, me një ligjshmëri të caktuar. Nga ana tjetër, bëhet e ditur se profeti i ardhshëm do të jetë mbarëbotëror. Kurse hakmarrja ndaj të pabindurve duhet të jenë detyrimet dhe ndëshkimet të cilat janë të pranishme vetëm në Islam.

Ky profet që përmendet në Testamentin e Vjetër, kategorikisht nuk mund të jenë Hz. Isai dhe Hz. Jushai, sepse këta janë nga të bijtë e Izraelit. Veçanërisht Hz. Isai nuk ka sjellë ndonjë ligjshmëri

të re për një shumicë çështjesh, vetëm ka qenë vazhdues i Hz. Musait. Kurse është e qartë si drita se Hz. Jushai nuk i përngjet Hz. Musait, sepse edhe ai nuk ka ardhur me një ligj të ri. Ndërkaq, ajeti-argument i Kur'anit "Ne dërguam te ju një të dërguar që të dëshmojë për ju, ashtu siç patëm dërguar edhe te Faraoni" (Kur'ani, Muzemmil:) bën të qartë ngjashmërinë mes Hz. Musait dhe Profetit tonë. Në të vërtetë, nuk ka nevojë më tej për ndonjë argument tjetër.

Veçori të tjera

Një sentencë e tretë nga Testamenti i Vjetër. Abdullah b. Amr b. As, Abdullah b. Selam dhe Kabul Ahbar të cilët kanë qenë shquar në njohjen e librave të vjetër, përcjellin se në tekstin e Testamentit të Vjetër i cili në ditët e tyre nuk pati pësuar dhe aq shumë korrigjime, ekziston një sentencë e tillë: "O i Dërguar! Ne të dërguam ty si dëshmitar, paralajmërues dhe mbështetje për popujt. Ti je rob i dhe dorëzanësi Im. Ty të dhashë titullin "Përfaqësues". Ai nuk është njeri i ashpër e i trashë. Nuk bërtet me zë të lartë nëpër treg. Nuk i përgjigjet të keqes me të keqe, por fal dhe dhuron. Zoti nuk do t'ia marrë shpirtin atij gjersa të mos e drejtojë me anë

të tij një popull që të thotë "Nuk ka zot tjetër veç Allahut!"(29)

Dhe tani le të mendojmë. Këto fjalë të Testamentit të Vjetër kujt i drejtohen? Duke mos ndjerë as nevojën e një analize thelluese, kuptimi aparent i sentencës tregon se fjalët i drejtohen një profeti që do të vijë dhe, midis profetëve, personalisht Muhammedit (s.a.v.). Ai është një profet i dërguar për të gjithë njerëzimin dhe sentenca sikur i thotë kështu atij rreth kësaj teme:

Të dërgova ty për gjithë njerëzimin si një myzhdedhënës i rrugës së drejtë dhe si paralajmërues e frikësues i tyre për fundin e dhimbshëm të rrugës së shtrembër. Ti do t'u vësh gjoksin të këqiave dhe do t'i pengosh njerëzit që të shkojnë e të bien në gropën e xhehennemit. Në të njëjtën kohë, do t'u bëhesh dritë të mbeturve në errësirën e rrugëve të shtrembra e plot lakime e, duke i kapur për dore, do t'i mundësosh t'ia arrijnë xhennetit dhe takimit me Bukurinë Hyjnore.

Të dërgova ty si një strehim, si një vendruajtje për bashkësinë e përgjithshme njerëzore të periudhës së injorancës. Kur t'i hapin sytë tek ti, do t'u jepet dora e do të mbrohen dhe për sa kohë do të

mbështeten tek ti, do të kenë mundësi të vazhdojnë ekzistencën e tyre.

Ti je rob i dërguari Im. Po, edhe ne, në lutjet tona, gjithmonë për pozitën e tij si rob i Zotit dhe për kumtesën profetike të tij bëjmë fjalë. Unë të quajta ty "Përfaqësues". Sikur gjithë njerëzimi të vijë e të ngulet para teje e ti të bëhesh një me ta, përsëri asnjë lëkundje nuk pëson. Çdo profet e ka një masë përfaqësimi, por ti në këtë dimension je krejt tjetër. Prandaj edhe Unë të quajta "Përfaqësuesi Im"!

Pastaj fjala drejtohet në vetë të tretë:

Ai nuk është njeriu i urrejtjes që ua thyen zemrat njerëzve përreth. Në të kundërt, ai është njeriu i edukatës, i masës dhe i seriozitetit. Nuk thërret e bërtet nëpër sokakë. Dëshira dhe përpjekja për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve mbi veten në këtë mënyrë është shenjë dobësie, nga e cila si dhe nga shenja të tjera si kjo ai është i pastër.

Kurrë nuk i përgjigjet të keqes me të keqe. Vjen një beduin, e kap e e shkund për xhybeje duke i thënë "ma jep të drejtën time!" Ndërsa sahabet, pasuesit e tij, tërbohen nga kjo paturpësi dhe brutalitet, Përmendorja e Mëshirës qesh dhe urdhëron: "Jepini këtij njeriu çfarë kërkon!"(30) Po,

ai falte edhe fajet e pafalshme. Mjafton që çështja të mos përbënte një kundërvënie ndaj urdhrave të sheriatit. Pa mendoni një herë! Si u pati thënë mekasve që i patën bërë gjithë ato të këqia atë ditë kur i kishte ardhur rasti t'u bënte ç'të donte? "Shkoni, të gjithë të lirë jeni!"(31) Allahu nuk do ta merrte pranë të dashurin e Tij dhe nuk e mori gjersa njerëzit që jetonin rrugën e shtrembër të periudhës së injorancës të mos e gjenin orientimin e tyre me nurin e sjellë prej tij. Lartësimi(v) i tij te Shoku i Lartë(vi) do të bëhej kur të përplotësohej feja dhe kur të merrte fund detyra e tij. Do të shkonte në audiencën e Mikut të Vërtetë duke u larguar nga mesi i njerëzve kur njerëzit e përgatitur prej tij të kishin arritur nivelin për ta përfaqësuar atë me të drejtë, sepse detyra e tij në këtë botë atë çast do të kishte marrë fund.

Po, kështu e përshkruante atë Testamenti i Vjetër. Edhe ai, kur të vinte koha, do ta përfaqësonte këtë përshkrim në tërë jetën dhe veprimtarinë e tij. Përshkrimet e Testamentit të Vjetër janë vetë mënyra e të jetuarit të të Dërguarit të Allahut. E kush mund të ishte tjetër veç tij me këto cilësi? Historia nuk njeh ndonjë rast tjetër. Sigurisht! Njeriu për të cilin aludon

Testamenti i Vjetër, është vetë Hz. Muhammedi (s.a.v.)!

Lajmet e gëzueshme të Ungjillit

Farakliti

Një sentencë nga Ungjilli i Shën Joanit: "Mesihu tha: Unë po shkoj te Zoti im dhe juaji gjersa të dërgojë tek ju Faraklitin i cili do të sjellë Interpretimin".

Fjala "Faraklit" ka kuptimin "shpirt i së vërtetës", "ndarës i së drejtës nga e shtrembra". Po, i Dërguari i Allahut është shpirti i së vërtetës! Sepse zemrat e vdekura vetëm me të vërtetën e sjellë prej tij kanë marrë jetë. Për t'i orientuar njerëzit e për t'i sjellë ata në rrugën e drejtë, Ai pati zhvilluar një luftë vetmohuese dhe vetëm në sajë të një lufte të tillë që bërë e mundur të ndahej e vërteta nga gënjeshttra, e drejta nga e shtrembra. Ja, pati ardhur një Faraklit për të cilin pati paralajmëruar Hz. Mesihu dhe Ai është përfaqësuesi i fundit i Zotit, Drita e të Dy Botëve, Hz. Muhammedi (s.a.v.)!

Në Ungjillin e Shën Joanit, kreu i 14-të, sentencat dhe 16 thuhet kështu:

"Nëse më doni, i ruani urdhrat e mia! Unë do t'i lutem Zotit dhe Ai do t'ju japë juve një tjetër

ngushëllues, shpirtin e së vërtetës (Faraklitin) që të jetë me ju së bashku gjithmonë."

Dhe tani le t'i shohim me radhë këto sentenca:

"Farakliti është Shpirti i Shenjtë që Zoti do ta dërgojë me emrin tim (domethënë si profet). Ai do t'ua mësojë të gjitha gjërat dhe do t'jua kujtojë përsëri edhe ato që unë ju pata thënë". (Ungjilli i Shën Joanit, 14:26)

"Kur të vijë Farakliti, do të dëshmojë për mua, po ashtu edhe ju do të dëshmoni". (Shën Joani, : 26-27)

"Unë ju them të vërtetën. Është më mirë për ju që unë të shkoj. Sepse po nuk shkova unë, nuk ju vjen Farakliti. Kurse po të shkoj unë, ua dërgoj Atë". (Shën Joani, 16:7)

"Kur të vijë Farakliti, do t'i qortojë të gjithë njerëzit për shkak të gabimeve dhe do t'i edukojë ata". (Shën Joani, 16:8)

Ardhja e parë e ungjillit është bërë në hebraisht dhe pastaj është përkthyer në greqisht. Kurse përkthimi arabisht që kemi ne në dorë, është bërë nga greqishtja. Kështu që nuk mundemi ta dimë se cili është përgjegjësi i emrit "Faraklit" në origjinalin hebraisht. Kjo fjalë është varianti i arabizuar i fjalës

përkatëse në greqisht. Vetëm se ne nuk do të kërkojmë ta ngremë tematikën tonë mbi këtë fjalë duke u përqëndruar vetëm mbi të. Ne do të përipiqemi të shohim në Ungjill vërtetimin, ndoshta, të të gjitha veçorive të profetit të ardhshëm.

Le t'i përdorim si një epilog vargjet e një personi të pasionuar pas profetit, vargjet e poetit të shquar Mevlana - Xhelaledin Rumi:

Cilësitë Mustafai (s.a.v.) në Ungjill i kish të shkruar,

Ai që ish enigma dhe oqeani i kulluar i profetëve;
Morali, sjelljet, e ngrëna, agjërimi, luftërat që kish për të fituar,

Një për një i gjen në Ungjill mes radhëve...

Prijësi i Gjithësisë

Ungjilli i Shën Joanit në kreun e 14-të, sentenca e 30-të thotë:

"Mesihu tha kështu: Unë s'kam për të biseduar edhe shumë me ju, sepse prijësi i kësaj gjithësie po vjen. Tek unë kurrsesi nuk ka gjëra prej tij..."

Te Zeburi, Libri i Psalmeve, në kreun e 72-të, sentenca e 30-të e në vazhdim thuhet kështu:

"Ai do të mbretërojë nga deti në det e nga lumi gjer ku të ketë tokë. Popullsia e shkretëtirës do të

përgjunjet para tij, kurse dushmanët do të lëpijnë dheun. Sundimtarët e Tarshisit dhe të ishujve do të sjellin peshqeshe, Shebaja dhe sundimtarët e saj do të ofrojnë dhurata. Të gjithë sundimtarët do të bien në sexhde para tij dhe të gjitha fiset do ta adhurojnë atë. Sepse ai do të shpëtojë të varfërin dhe të pashpresin dhe të braktisurin që thërresin për ndihmë. Duke treguar mëshirë për të varfërin dhe nevojtarin, do të sjellë shpëtim për jetën e tyre. Duke u shpëtuar jeta prej padrejtësisë dhe brutalitetit, gjaku i tyre do të fitojë vlerë. Dhe do të luten çdo ditë për të e çdo ditë do ta lartësojnë atë. Emri i tij i amshuar do të ekzistojë gjersa të ekzistojë dielli dhe njerëzit do të bëhen të bekuar me të. Të gjithë popujt atij "i bekuar" do t'i thonë!"

Ashtu siç e prekëm edhe më sipër, ne i hymë kësaj teme vetëm pjesërisht dhe me synimin për të dhënë një mendim. Dhe as që do t'u hyjmë hollësisë. Megjithatë, as nuk do të kalojmë pa shtuar edhe këtë: pavarësisht nga përpjekjet për korrigjime të çifutëve dhe krishterëve të djeshëm e të sotëm, të cilëve urrejtja dhe xhelozia u kanë hyrë gjer në palcë, në Testamentin e Vjetër dhe Ungjillin që kemi në dorë, është e mundur të gjenden shumë analogji dhe

paralajmërimë lidhur me profetësinë e të Dërguarit të Allahut. Dashtë Zoti, në të ardhmen, në u gjetshin ekzemplarë me korrigjimet më të pakta të Testamentit të Vjetër, Ungjillit dhe Librit të Psalmeve nëpërmjet zellit të historianëve tanë analistë, pandeh se, pa qenë fare nevoja e interpretimeve dhe komenteve, do të shihet edhe nga njerëzit më të rëndomtë se në to gjenden shenja shumë të qarta mbi të Dërguarin e Allahut. Ndoshta në hadithet që lajmërojnë se kristianizmi do të pastrohet e thjeshtohet, aludohet edhe në këtë kuptim.³²

Nga ana tjetër, fakti që në Testamentin e Vjetër, në Ungjill e në Librin e Psalmeve flitet për të Dërguarin e Allahut personalisht si dhe për sahabet, pasuesit e tij, është i sanksionuar në Kur'an dhe Sunnetin, Traditën Profetike. Për rrjedhojë, përpjekja për mohimin e kësaj është perversitet dhe blasfemi.⁽³³⁾

(27) Kenzu'l-Ummal, 11/384.

(i) Teurati: Testamenti (Dhjata) i Vjetër.

(ii) Në origjinal: Kur'ani Muxhizul Bejan

- (iii) Në origjinal: Nefha-i ilahi.
- (iv) Në origjinal: Sirr-i ehadijet; makam-i ferdijet.
- (28) Buhari, Bedu'l-Vahj, 3.
- (29) Buhari, Byjy, 50; Mysned, 2/174.
- (30) Ebu Davud, Edeb, 1; Nesai, Kasame, 24.
- (31) Ibni Hisham, Sire, 4/55.
- (v) Lartësimi: ndarja nga kjo botë.
- (vi) Në origjinal: Refik-i A'la.
32 Buhari, Enbija, 49; Myslim, Iman, 244, 245, 246, 247.
- (33) "Ata i binden Përfaqësuesit, atij pejgamberi të përgjithshëm për të cilin gjejnë të shkruar në Teurat dhe në Ungjillin që i kanë pranë..." (Kur'ani, A'raf: 7/157; veçanërisht shih Fetih: 29, Saff: 6); Buhari, Byjy, 50; Mysned, 2/174. Për hollësi, shih: Sujuti, el-Hasaisu'l-Kubra, 1/18-31.

Ai Eshte Njeriu i Dimensioneve te Veçanta

Ashtu si njeriu i sotëm i mjerë ka humbur gjithato kritere vlerash, ashtu edhe qëndrimi, vështrimi dhe mendimi i tij për profetët dhe veçanërisht për mbretin e profetëve, Hz.

Muhammedin (s.a.v.) ndodhen sot në një gjendje krejtësisht të përmbysur. Ndërkaq, është kategorikisht e padrejtë ta vlerësojmë atë me kritere njerëzore sikur të ishte një njeri i zakonshëm.

Madje, kjo nuk është as e mundur. Sepse ai është një njeri i dërguar për ta rishikuar konfiguracionin e tokës dhe për t'i hapur njerëzimit horizonte të reja duke u pajisur, për këtë qëllim, me një shpirt të posaçëm dhe me kapacitete të posaçme, kështu që vlerësimi i tij i kapërcen kriteret tona. Duke u nisur nga kjo, kushdo që të përpiqet për të treguar për të, le të tregojë sa të dojë; ashtu siç duhet dhe plotësisht nuk mundet të tregojë! Njëri prej atyre që e kanë kuptuar më mirë atë, është Hasan b. Sabiti që thotë:

Me fjalët e mia Muhammedin nuk e lavdërova;
Fjalëve të mia me të lavdi u përftova...

Sipas kësaj thënieje, ajo çka u përfton bukuri fjalëve, është përmendja e bukur e tij midis atyre fjalëve, sepse shprehjet tona nuk kanë asgjë që mund t'i përftojnë atij! Në mënyrë po kaq lakonike janë shprehur edhe për Kur'anin mendimtarët e mëdhenj të këtij shekulli.[34]

Të gjitha këto, në një masë, janë rezultati i përjetimit të të njëjtave ndjenja e mendime. Kush

është shprehur, frymëzimin nga i njëjti burim e ka marrë dhe të njëjtat gjëra i ka shprehur me të njëjtën formë. Dikush ka zgjeruar dhe qartësuar shprehjen e shkurtër të dikujt, kurse dikush tjetër është shquar për një frymë poetike më të avancuar, megjithatë, të gjithë janë vërtitur rreth po të njëjtit bosht.

Në të njëjtën formë edhe ne jetojmë të veçantën e të qenit ummet, bashkësi e Tij, dhe e deklarojmë me zë të lartë harenë tonë gjë që është, në të gjitha aspektet, "e mira, dhuntia e mundësisë për të falënderuar". Sado që ta falënderojmë dhe lavdërojmë Zotin tonë që na ka bërë kryelartë me të mirën më të madhe dhe na ka bërë ummet të Hz. Muhammedit (s.a.v.), është pak. Ky është një Favor Hyjnor. Favorin Ai ia jep kujt të dojë dhe në masën që të dojë. Vetëm se është i gjerë sa nuk mund të matet me asnjë kriter dhe masë nga tonat. Po, ajo që na është dhuruar neve në krahasim me të tjerët, është një det favorit që s'i gjendet bregu...

Ai është njeriu i dimensioneve krejt të veçanta. Ajo çka na takon neve të bëjmë, është zelli për ta akorduar veten në vijën dhe frekuencën e tij. Kur sigurohet kjo, në mes fillojnë biseda të hapura e të shifruara. Urdhrat i jep vetë i Dërguari i Allahut.

Drejtimin ai e merr në dorë. Kurse cilësia e xhemaatit, bashkësisë, dhe shoqërisë që do të drejtojë, do të administrojë Ai, është e lartë në atë nivel sa t'i bëjë engjëjt të dëshiruar dhe të përjashtuar prej çfarëdo shpjegimi e përshkrimi.

Ndoshta disave këto thëniet tona mund të mos u duken objektive. Punë e madhe! Sidomos pasi që çdo ditë katër - pesë të rinj fytyrëdritë të kenë marrë shpirtërisht nga i Dërguari i Allahut ca përgëzime! Dhe sidomos pasi që disa prej tyre të thonë se kanë hyrë në lidhje me Të fare pa pengesë, drejtpërsëdrejti, madje në botën konkrete!

Ai është vazhdimisht midis nesh me konstitucionin e Tij shpirtëror dhe, sipas disave, me trajtën e Tij materiale të transformuar në dritë. Imam Sujuti thotë se mbi shtatëdhjetë herë është parë me të Dërguarin e Allahut. Po, ai nuk ka vdekur në atë kuptim siç e themi ne, ai vetëm dimension ka ndryshuar. Do të ishte gabim të mendohej vdekja e tij si vdekja e një njeriu të zakonshëm. Sepse Kur'ani thotë se nuk kanë vdekur edhe për dëshmorët, pozita e të cilëve është dy shkallë më e ulët se pozita e profetëve. E nëse është kështu, si është e mundur të themi për të "vdiq" me kuptimin që i japim ne kësaj

fjale? Ne mund të themi vetëm këtë që ai ka kaluar në një dimension tjetër. Është për këtë arsye që e kanë parë atë njerëzit, shikimi i të cilëve zotëron mundësinë për të kapur ato dimensione. Këta njerëz e shohin atë personalisht atje...

Ata që shpëtojnë prej errësirës së trupit dhe të të qenit lëndë e që arrijnë nivelin jetësor të shpirtit, munden ta jetojnë në të njëjtin çast të shkuarën dhe të ardhmen. Ja, pra, njerëzit e këtij dimensionit edhe rrinë, në këtë çast, pranë e pranë me ju, edhe ndodhen gju më gju me të Dërguarin e Allahut katërbëdhjetë shekuj më parë, në Shekullin e Lumtur. Personat prej kastës së njerëzve të Zotit të cilët thirren "ebdall", mund të gjenden në të njëjtin çast në disa vende. E pse të mos ndodhet ai Mbreti i Profetëve edhe në botën e pastajme, edhe në botën tonë, edhe në praninë tonë, edhe në praninë e profetëve? Ndodhet e do të ndodhet!

Kam për qëllim që të gjitha ç'po them, t'i bëj themelin e atyre që do të them këtej e tutje. Kur shohim kah profetët dhe Profeti ynë, merr rëndësi të madhe këndi dhe qëllimi i vështrimit. T'i lëmë mënjatë profetët e mëdhenj; nëse parandjerja dhe njohja e shenjtoreve, e të urtëve dhe e mirëbërësve të

mëdhenj kërkon një puritet shpirtëror të posaçëm dhe kthjelltësi ndjesore, si mund të njihen e të kuptohen profetët në klimën mjegullore të natyrës lëndësore? Atëherë, duke u përpjekur për t'i kuptuar ata, do të duhet të tregohemi tepër të kujdesshëm e të pozicionohemi me të gjithë delikatesën dhe etiketën e mundshme. Ky kujdes duhet të shtohet disa herë sidomos në përpjekjet për të njohur personalitetin e Hz.Muhammedit (s.a.v.). Por ç'e do që prapëseprapë, çdo njeri do të ndjejë e do të kuptojë për aq sa ia lejon fuqia e shikimit të syrit të zemrës së vet dhe, ndërkaq, askush nuk do të mundet ta konceptojë atë tërësisht me plot kuptimin e fjalës.

Po, Busajriu thotë kështu:

Njerëzit e përgjumur që jetojnë në ëndërra e qetësi,

Si munden ta kuptojnë të vërtetën e Tij?..

[34] "Nuk munda ta zbukuroj unë mrekullinë e vërtetë të Kur'anit; ndoshta, të vërtetat e bukura të Kur'anit ma lartësuan shprehjen time!" (Bediuzzaman Said Nursi, Mektubat, f. 370).

Qellimi i Dergimit te Profeteve

Profetët, pavarësisht nga ndryshimi i nivelit mes tyre, janë shpirtë të zgjedhur, të denjë për shfaqjen e personit të Providencës Hyjnore. Allahu (xh.xh.) i ka pranuar ata si të posaçëm vetëm për veten, i ka rritur në mjedise të mbyllura për të tjerët, i ka zhvilluar dhe ka prerë mundësinë që në sytë e tyre të hyjnë, përveç vetes, iluzione të tjera.

Ashtu si te të gjithë profetët, për më tepër te Profeti ynë, syri i tij nuk ka parë gjë tjetër përveç Zotit të vet. Po, tjetërkushi nuk ka mundur ta mjegullojë shikimin e tij, nuk ka mundur t'ia turbullojë mendjen. Kur i hapte sytë, ai Zotin e vet shihte; po ashtu, edhe kur i mbyllte, duke e vështruar përsëri Atë, thoshte: "Allahu im, o miku më i Lartë!" Dhe tani le të dëgjojmë se ç'thotë vetë Hz. Aisheja:

"Kur sëmurej ndonjëherë, i Dërguari i Allahut më vinte pranë dhe më thoshte: "Lutu për mua!" Dhe unë merrja në njëren dorë dorën e tij të bekuar dhe, duke shprehur shpresën për shërimin e tij me begatinë e asaj dore, vija dorën tjetër mbi atë ballë që qëndronte mbi kohën dhe hapësirën dhe lutesha...

Kur në sëmundjen e fundit desha t'ia marr dorën për të njëjtin qëllim, e tërhoqi me forcë dhe u lut: "Allahu im, o miku më i Lartë!"(35)

Ndoshta i Dërguari i Allahut nuk e kishte më mendjen te miqtë e tij tokësorë, por dëshironte Zotin, Mikun e tij të Vërtetë dhe kërkonte të shkonte tek Ai në një dimension tjetër.

Ja, pra, profetët që kanë bërë një jetë të tillë me ardhjen dhe shkuarjen e tyre, veçanërisht Profeti ynë, përse, vallë, kanë ardhur në këtë botë dhe në bazë të ç'qëllimi janë dërguar? Analiza e kësaj teme shumë të rëndësishme paraqet rëndësi edhe më shumë si rrjedhojë e veçanërisht dy parimeve kryesore:

E para: Duke vështruar pozitën e lartë dhe sublime të institucionit të profetësisë, profetët nuk duhen konsideruar si njerëz të zakonshëm.

E dyta: Duhet treguar se ç'rrugë dhe sistem duhet të ndjekin në ditët tona ata që ndodhen nën barrën e përfaqësimit të detyrës profetike.

Nga çfarëdo aspekti që ta trajtojmë çështjen, hapi i rëndësishëm së temës nuk do të ndryshojë. Prandaj edhe ne do të përpiqemi që, pa zgjedhur ndonjë renditje të caktuar, t'i paraqesim mendimet

tona lidhur me temën në fjalë në trajtën e disa nënçështjeve.

1. ADHURIMI

Qëllimi i dërgimit të profetëve bashkohet në të njejtën pikë me qëllimin e krijimit të njeriut. Dhe kjo pikë qëndron në vijën që përcakton pozitën e njeriut si rob i Zotit, për rrjedhojë, adhurimin e Tij nga njeriu.

Allahu urdhëron kështu në Kur'an: "Unë i krijova xhindët dhe njerëzit vetëm për të më adhuruar!" (Kur'ani, Dharijat: 56).

Kjo do të thotë se qëllimi themelor për të cilin jemi krijuar, është ta njohim Zotin dhe ta kryejmë denjësisht detyrën e robit ndaj Tij. Nuk është të hamë e të pimë, të vëmë mall e pasuri e të bëhemi pronarë ndërtesash të dimensioneve të kësaj bote. Ç'është e vërteta, këto janë nevojat tona të krijimit, por jo qëllimi i krijimit tonë. Ja, pra, profetët na kanë ardhur për të na treguar këtë rrugë enigmatike. Në Kur'an bëhet fjalë për këtë specifikë: "Nuk pati të dërguar para teje që të mos i kemi reveluar: "Nuk ka zot tjetër përveç Meje, prandaj më adhuroni!" (Kur'ani, Enbija: 25).

Edhe në ajetin e mëposhtëm preket e njëjta specifikë duke e lidhur qëllimin e dërgimit të profetëve me urtësinë e largimit dhe ruajtjes nga idhujt si dhe kryerjes së rolit të prijësit të njerëzimit në udhën e adhurimit të Zotit: "Ne i dërguam çdo populli nga një të dërguar me porosinë: "Adhuroni vetëm Allahun dhe largohuni prej djajve!" Allahu i orientoi një pjesë të njerëzve në rrugë të drejtë, por pati edhe prej atyre që u gjykuan me humbje. Udhëtoni, pra, nëpër botë dhe shihni sesi qe fundi i përgënjeshtresve të së Vërtetës!" (Kur'ani, Nahl: 36).

E veçanta e Profetit tonë

Kurse gjendja e Profetit tonë është më e veçantë. I dërguar si mëshirë për të gjitha botët, ai është i ngarkuar me detyrën për të futur në rrugën e adhurimit edhe njerëzit, edhe xhindët. Abdullah b. Mesud e përcjell kështu një ngjarje të jetuar nga ai vetë:

"Shkuam bashkë me Profetin diku. Pasi vizatoi një rreth përreth meje, më tha të mos largohesha prej aty, kurse vetë u largua. Më pas fillova të dëgjoja zhurma. Po shqetësohesha seriozisht se mos i kishte ndodhur ndonjë e keqe të Dërguarit të Allahut, por

edhe nuk mund të lëvizja sepse ashtu më kishte porositur. Pas një farë kohe, Profeti u kthye. E pyeta për shkakun e zhurmës: "O i dërguari i Allahut, ç'ishin ato zhurma e ato të goditura?" Dhe ai m'u përgjigj: "Fisi i xhindëve më shprehu besimin dhe më dha fjalën. Pastaj filloi polemika midis tyre. Besimtarët dhe mosbesimtarët u grindën. Ajo ishte zhurma që dëgjove ti. Përveç kësaj, m'u lajmërua edhe vdekja."(36)

Me fjalët e tij të fundit, Profeti donte të thoshte se qëllimi i dërgimit të tij ishte hapja e rrugës së drejtë për xhindët dhe njerëzit. Fakti që atë ditë atij i kishin shprehur besimin dhe bindjen edhe xhindët, do të thoshte se qëndrimi i mëtejshëm i tij në botë s'kishte më kuptim.

Kështu mendonte ai dhe, përmes pohimeve të veta, zbërthente enigmën e synimit e të qëllimit të kumtesës profetike të tij. Në të vërtetë, ai na pati mësuar një lutje neve lidhur me çështjen e zgjedhjes mes kësaj bote dhe jetës së pasosur: "Zoti im, më mbaj gjallë për sa kohë jeta ime të jetë e dobishme për mua. Kur të vijë çasti që vdekja të më jetë më e dobishme, merrma shpirtin duke i dhënë fund jetës sime!"(37)

2. KUMTESA

Një nga qëllimet e tjera të dërgimit të profetëve është edhe kumtesa fetare. Po të mos kishin ardhur profetët, ne nuk do të mund t'i dinim çështjet lidhur me adhurimin, nuk do të mund të merrnim urdhrat dhe ndalimet dhe nuk do të mund të konceptonim përgjegjësinë tonë. Ç'janë namazi, agjërimi, zeqati dhe haxhi? Ç'është statusi i ndalimeve të tilla si pijet alkoolike, kumari, adulteri, faizi, etj? Të gjitha këto dhe shumë çështje të tjera të ngjashme i njohim sot me anë të ndërmjetësisë së profetëve. Kësaj i themi shkurt "detyra e kumtesës" që ka qenë po ajo tek të gjithë profetët, të cilët kanë ardhur me të njëjtat mesazhe dhe kanë thënë të njëjtat gjëra në çështjet kryesore edhe nëse kanë pasur dallime në hollësitat.(38)

Qëllimi dhe detyra e përgjithshme e profetëve shprehet kështu në Kur'an: "Ata që kumtojnë fjalën e Allahut, frikësohen vetëm prej Tij e askujt tjetër. Mjafton Allahu si llogarikërkues!" (Kur'ani, Ahzab: 39).

Po ata kanë ardhur për të realizuar një qëllim të tillë. Pengesa që u ka zënë rrugën, kushdo qoftë dhe çfarëdo qoftë, nuk ndikon tek ata as sa grimca, sepse

ata s'e njohin se ç'është frika. Sepse ata kanë frikë gjithmonë vetëm Allahun! Lidhur me këtë çështje, Profetit tonë i thuhet kështu: "O i Dërguar! Kumtoje atë që t'u revelua prej Zotit tënd! Nëse nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke kryer detyrën. Allahu do të të mbrojë prej njerëzve. Allahu nuk e fut në rrugë të drejtë popullin mohues!" (Kur'ani, Maide: 67).

Këtu kuptohet se plotësimi i detyrës së kumtesës prej profetit nuk ka të bëjë me atë si individ, pra, nuk kufizohet në planin individual, por ka përmasa mbarënjerezore, sepse detyra e tij është të ndriçojë gjithë njerëzimin. Në të vërtetë, Profeti ynë ishte i vetëdijshëm për detyrën e tij.

Fundja, po të mos qe kështu, dërgimi i tij me një detyrë të tillë qysh më parë nuk do të planifikohej e miratohej.

Kumtesa te i Dërguari i Allahut

Pasi mori përsipër këtë detyrë të lartë, e gjithë jeta e Profetit kaloi me kumtesën fetare. Ai shëtiste derë më derë dhe kërkonte fytyra dhe zemra të njohura të cilëve të mund t'u kumtonte mesazhin e tij.

Kundërveprimi i frontit përballë, në fillim, qe në formën e indiferencës e të bojkotit. Pastaj vazhdoi

me përqeshje e tallje dhe, në fund, me të gjitha format e mundimeve e torturave. I vinin gjemba në rrugën nga kalonte, e vinin në lojë kur falej dhe e konsideronin me vend çdo lloj sulmi dhe dhune ndaj tij. Kurse i Dërguari i Allahut nuk u mërzit e nuk u zbraps prej asnjërës prej tyre, sepse ai kishte ardhur në botë për një qëllim të caktuar. I shkoi disa herë me radhë secilit njeri, përfshi edhe armiqtë e tij vrasës dhe ua paraqiti mesazhin hyjnor. Po, s'dihet se sa herë u shkoi edhe armiqve të fesë e të besimit si Ebu Xhehl dhe Ebu Leheb dhe u tregoi se ç'ishte e drejta dhe e vërteta. Shëtiste nëpër panaire, vërtitej nga çadra në çadër për t'u bërë pretekst i orientimit edhe të një njeriu të vetëm. Portat ku trokiste, i mbylleshin para syve, por një radhë tjetër ai prapë trokiste në atë portë dhe përsëriste të njëjtat gjëra... Kur iu prenë shpresat në Mekë, shkoi në Taif. Taifi ishte një vend klimaterik e turistik. Të përkëdhelur prej rehatit dhe mirëqenies, taifasit dolën më brutalë se mekasit. U mblodhën gjithë fundërrinat dhe e përzunë me gurë të Dërguarin e Madh, atë diellin e diejve... Me vete ai kishte marrë birin për shpirt, Zejdin e Harisesë i cili, duke e bërë mburojë trupin e

vet, u përpoq ta mbronte Profetin. Megjithatë, disa gurë që e goditën, ia përgjakën trupin e bekuar.

Duke u shmangur nga ajo atmosferë keqkuptimi, Profeti që tërhequr në rrëzë të një peme kur ia behu Xhebrail Emini që i kërkoi leje t'u përmbyste mbi kokë malin atyre njerëzve azganë. Qoftë edhe në këto çaste kur ndihej i thyer keqas, nuk mendonte ashtu dhe i përgjigjej "jo" Engjëllit. Duke pasur parasysh se dikush nga ata do të mund të hapte sytë te besimi, ai kundërshtonte ndëshkimin...

Pastaj ai hapi duart dhe iu lut Zotit të tij:

"Zoti im! Të ankoem Ty për pafuqinë, dobësinë dhe për faktin që njerëzve u dukem i pavlerë! O Mëshirues e Bamirës! Ti je Zoti i atyre të pashpresëve që duken të dobët e të pavlerë! Ti je Zoti im! Atëherë, në dorë të kujt po më lë? Në dorë të gojëkëqinjve, të fytyrëprishurve apo të armiqve që përzihen në punët e mia? Nëse me këtë nuk kërkon të më ndëshkosh, nuk ua vë veshin fare belarave e mundimeve. Ndërkaq, mirësia Jote, ashtu siç dëshirohet, është shumë më prehëse, shumë më e gjerë. O Zot, për t'u mbrojtur nga përfshirja e ndëshkimit Tënd apo nga meritimi i pakënaqësisë Tënde, në kompetencën Tënde të merituar të punëve

të të dy botëve strehohem, në Fytyrën Tënde-Dritë strehohem! O Zot, e pres faljen Tënde gjersa ta miratosh atë! O Zot, gjithë fuqia dhe transformimi vetëm në dorën Tënde janë!"

Ndërsa ai lutej kështu, dikush afrohet në heshtje dhe i vë përpara të Dërguarit të Allahut një tabaka me vile rrushi dhe thotë: "Urdhëro e ha!" Duke zgjatur dorën për të marrë rrush, Profeti thotë "Bismillah", "Në emër të Allahut!" Për skllavin me emrin "Addas" që solli rrushin, kjo ishte një ngjarje e papritur. Dhe pyet me habi: "Kush je ti?" I Dërguari i Allahut i përgjigjet: "Jam i dërguari i fundit dhe profeti i fundit!" Addasi i hidhet sipër dhe fillon ta puthë... Atë që me vite e kishte kërkuar në qiej, e gjeti tani para vetes, madje krejt pa prituri! Dhe i pohon besimin!(39)

Po të mos kishte ndodhur kjo ngjarja e fundit, Profeti do të kthehej shumë i mërzitur nga Taifi. Mërzitja dhe hidhërimi nuk ishin për shkak të qëndrimit kundër tij, por si rrjedhojë e faktit se ai askujt s'do të kishte mundur t'i kumtonte diçka. Kurse tani fluturonte nga gëzimi, sepse Addasi ishte vënë në rrugë të drejtë me dorën e tij!

Po, nëse është me vend të thuhet, ai ishte pëllumbi i profetëve. Kërkonte pa pushuar e në çdo vend fytyra dhe zemra të pastra e të shtëna pas së vërtetës dhe, kur i gjente, u frynte atyre frymëzimet shpirtërore. E, kështu, rrethi dritësor i mjedisit të tij zgjerohej çdo ditë, gjë që e bënte të tërbohej herezinë.

Ashtu si tërbimi mes përçartjeve i herezisë përballë ekzistencës së Islamit në lindje e perëndim të botës sot, edhe në atë periudhë kështu e tërbonte herezinë zgjerimi i rrethit të mjedisit të Hz. Muhammedit.

Ky tërbim i çoi ata në një marrëzi të tillë, sa që erdhi dita dhe u ngritën ta shuanin krejtësisht këtë pishtar si të deshin të shuanin me të fryrë diellin në qiell! Ç'po them dhe unë! Dielli është për ne vetëm një mjet metafore e paralelizmi figurativ, kurse drita e sjellë prej Profetit, është që t'i japë shkëlqim vetë diellit, sepse ajo është drita, është nuri i Allahut (xh.xh.)! Kur'ani e përshkruan kështu situatën qesharake të heretikëve: "Ata kërkojnë ta shuajnë nurin e Allahut me gojët e tyre. Edhe nëse mosbesimtarëve nuk u pëlqen, Allahu nuk dëshiron

gjë tjetër veçse ta plotësojë dritën e Vet!" (Kur'ani, Tevbe: 32).

Ai ndezi një pishtar edhe në shekullin XX dhe me të pothuaj na futi prush në zemra. Mijëra dhe qindramijëra vetë vunë ballin në rrugën e tij dhe nisën shërbimin për të lartësuar kauzën e tij. Kjo do të thotë se Providenca Hyjnore deshi të sendërtonte përsëpari një situatë Muhammediane, një rreth drite dhe një zinxhir të artë, gjë që s'mundet ta ndalë as zemërimi, tërbimi e dhuna e herezisë, as dhe sulmi i ushtrive të djallit. Sigurisht, këto farëra të hedhura me pastërti, edhe nëse jo sot, nesër me siguri do të marrin zhvillim dhe drita e shpërndarë prej të Dërguarit të Allahut kurrë nuk do të shuhet!

Kur Meka, më në fund, nuk mundi ta pranonte të Dërguarin e Allahut, ai mërgoi në Medinë. Përhapjen e dritës atje do ta vazhdonte. Do të merrej me çifutët dhe hipokritët, do të organizonte ushtri kundër mohuesve e heretikëve e do të ndodhej vetë në krye të atyre ushtrive, do të vërtitej në fushat e luftës me dhëmbë të thyer, me fytyrë të plagosur, i uritur e i etur, por i vendosur të ecë në rrugën e tij. Dhe ashtu pati bërë. Ai nuk e la qoftë edhe për një çast të vetëm detyrën e kumtesës profetike. E

kumtoi, e tregoi, e përshkroi, e sqaroi çdo gjë gjer në çështjen më të vogël të fesë. Edhe në kohët kur ndodhej në Medinë, edhe kur përleshej me shtetet, kurrë nuk e la pas dore orientimin e individit. Nëse një beduin do të vinte e ta pyeste për një çështje që ai e kish rrëfyer qindra herë, ai do t'i përgjigjej me të njëjtën dëshirë dhe pasion pa shfaqur as më të voglën mungesë dëshire!

Kumtesa profetike ka vetëm një kuptim: t'i fusë njerëzit në rrugë të drejtë. Dhe, në esencë, ky është edhe qëllimi i ardhjes së të gjithë profetëve si dhe i Mbretit të Profetëve. Rrugën e drejtë që ne e quajmë "Sirati Mustakim", duhet ta njohë çdo musliman dhe e njeh. Çdo ditë ne, në namazet tona, e lusim Zotin që të na orientojë në "Sirati Mustakim", domethënë në rrugën e profetëve, e besnikëve, e dëshmorëve. Ajo është një rrugë e gjerë dhe çdokush e ka pjesën e vet të paracaktuar në të, sepse, sipas pohimit të ajetit-argument përkatës të Kur'anit, Profeti i Fundit është dërguar si mëshirë për të gjithë botët!

Veçanërisht ai është dëshmues, myzhdedhënës dhe paralajmërues e qortues, gjë që e shpreh ajetit-argument i mëposhtëm: "O ti Nebi, Ne me të vërtetë

të dërguam ty dëshmues, myzhdedhënës e qortues!"
(Kur'ani, Ahzab: 45).

Profeti ynë është një njeri i jashtëzakonshëm i cili pati bartur për njëzet e tre vjet me radhë një barrë shumë të rëndë si profetësia, përgjegjësitë e së cilës i pati çuar në vend në atë mënyrë që në histori nuk e kishte arritur dhe nuk do të mund ta arrinte asnjë burrë që i kishte dalë për zot një kauze. Dhe me këtë shpirt e me këtë vetëdije ai i afrohej çdo ditë e nga pak fundit të tij të bekuar.

Po kryente haxhin e ndarjes...Le që vetëm një herë pati bërë haxh në jetën e tij! Meqë në atë rast bashkoheshin umreja me haxhin, ne i themi edhe "Haxhi Ekber", "Haxhi i Madh". Ja, në këtë haxhin e fundit të tij, i Dërguari i Allahut i hipi edhe një herë tjetër devesë së vet dhe u përpoq të thoshte çdo gjë që duhej thënë e t'i jepte fund. Po, foli për çdo gjë, nga gjakmarrjet te të drejtat e grave, nga faizi te marrëdhëniet midis fiseve. Pastaj, në fund, e pyeti xhemaatin, bashkësinë: "A e kryeva kumtesën?" Dhe, pasi mori përgjigjen "po, e kryeve", e kërkoi Zotin për dëshmitar duke thirrur tri herë: "Ji dëshmitar, o Zot!"(40)

Ai e kishte kryer detyrën drejtësisht. Prandaj edhe ishte me ndërgjegjen të qetë, me zemrën të kënaqur dhe përgatitej hap pas hapi të shkonte te Zoti i tij. Por ai në përgjithësi kishte qenë njeriu i vetëkontrollit dhe më i ndjeshmi ndër të ndjeshmit. Për rrjedhojë, të gjithë jetën në një të tillë përgatitje e kishte kaluar duke pyetur vetveten: A munda ta jetoj, vallë, në përshtatje me qëllimin për të cilin më dërgoi Zoti im?

3. SHEMBULL I BUKUR

Një tjetër specifikë që do ta quanim si qëllim të dërgimit të profetëve, është edhe që ata të bëhen një shembull i bukur për bashkësitë e tyre.

Në Kur'an Allahu thotë: "Ishin ata që Allahu i vuri në rrugë të drejtë, prandaj edhe ti përshtatiu atyre!" (Kur'ani, En'am: 90). Duhet të na vërë në mendime fakti që edhe vetë Profetit tonë, pasi i përmenden profetët e kaluar emër për emër, i thuhet që të ecë në rrugën e tyre! Edhe neve kështu na bën zë Kur'ani: "I Dërguari i Allahut është një shembull i bukur për ata që shpresojnë shpërblimin e Allahut në Ditën e Ringjalljes, për ata që e përmendin shpesh Allahun." (Kur'ani, Ahzab: 21)

Profetët janë për ne prijës dhe imamë. Ashtu siç i shkojmë pas imamet në falje, po ashtu veprojmë në përputhje me shembullin e Profetit edhe në çdo fragment të jetës. Sepse për ne, jetën e vërtetë ai dhe profetët e tjerë e kanë përfaqësuar. Ata që e patën përjetuar periudhën e parë të Islamit, e patën ndjekur Profetin milimetër për milimetër. Prandaj edhe ata si dhe pasardhësit e tyre patën pasur fatin të cilësohen si më poshtë nga Profeti i Dy Botëve. Profeti urdhëron e thotë:

"Do të vijë një kohë që një grup njerëzish do të luftojnë dhe atyre do t'u bëhet kjo pyetje:
- A ka midis jush që ta kenë parë të Dërguarin e Allahut?

- Po, - do të përgjigjen dhe pas kësaj atyre do t'u bjerë në pjesë fitorja. Pastaj një grup tjetër njerëzish do të luftojnë dhe, gjithashtu, atyre do t'u bëhet pyetja:
- A ka midis jush që të ketë parë pasuesit e të Dërguarit të Allahut?

- Po, - do të thonë. Edhe atyre do t'u bjerë në pjesë fitorja.

Pastaj përsëri një pjesë njerëzish do të shkojnë në luftë dhe do të pyeten:

- A ka midis jush që të jetë shok me ata që i kanë parë pasuesit e të Dërguarit të Allahut?
- Po, - do të përgjigjen edhe ata. Pastaj atyre do t'u hapen portat e kalave dhe do t'u bjerë në pjesë fitorja."(41)

Në një hadith, porosi të tijën, Profeti ynë urdhëron: "Më të dobishmit e njerëzve janë ata që kanë jetuar të njëjtën kohë me mua. Pastaj pasardhësit e tyre dhe, më pas, pasardhësit e këtyre të fundit."(42) Me këtë ai kërkon të theksojë vlerën dhe virtytin e periudhave të afërta me periudhën e tij. Sepse njerëzit që patën jetuar në ato periudha, qenë sjellur shumë të ndjeshëm e të kujdesshëm për t'i përngjarë të Dërguarit të Allahut në jetë, në ndjenja e në mendime. Në të vërtetë, dëshira për t'i ngjarë atij njeriu që Allahu kishte zgjedhur si model, si shembull, duhet të përbënte një qëllim dhe ashtu ngjau.

Po, sahabet, pasuesit e Profetit; tabiünët, pasardhësit e pasuesve dhe tebe-i tabiünët, pasardhësit e këtyre të fundit, të gjithë këta, kanë qenë më të ndjeshmit në këtë çështje. Dhe në këtë aspekt, ata janë më të dobishëm se njerëzit që kanë jetuar në shekujt e tjerë. Hz. Mesihu thoshte:

"Flamurët ndodhen në duart e shenjtorëve." Me këtë fjalë ai aludonte për bashkësinë e Profetit tonë. Dhe ky ishte një vlerësim i madh. Në një porosi tjetër, i Dërguari i Allahut thotë: "Dijetarët e ummetit tim janë si profetët e të bijve të Izraelit."(43)

Po, në përngjasimin me Profetin ata i ishin afruar një niveli të tillë, pak pas të cilit fillonin kufijtë e profetësisë.

Ja njëri prej këtyre, Omeri, është shembulli më i goditur! Ai e pati pranuar plotësisht Profetin si një prijës dhe udhëzues për vete dhe gjithë jetën ia pati përngjasuar atij. Ishte njeriu i pashoq, trajta e jetesës së të cilit i përngjante plotësisht asaj të Profetit! Megjithëse i qenë hapur kat më kat dyert e Romës e të Bizantit, megjithëse popuj dhe sundimtarë pranonin t'i bëheshin skllëvër, në jetesën e tij nuk pati ndodhur as ndryshimi më i vogël. Jerusalemi në kohën e tij ishte triumfuar; ai Jerusalem sot i mërzhitur, i brengosur, i robëruar, njollë e zezë në ballin e botës Islame. Megjithëse ishte realizuar praktikisht pushteti ushtarak, priftërinjtë ngulmonin të mos i jepnin çelësat e qytetit duke thënë: "Nuk i japim sepse nuk e shohim midis jush atë fytyrë që duhet t'i marrë çelësat e qytetit..." Kur situata i

njoftohet Kalifit Omer, ai niset për udhë. Meqë nuk kishte deve të vetën, merr hua një deve nga prona e familjes profetike dhe, duke u shkëmbyer rregullisht me shërbëtorin, shkojnë në Jerusalem. Për ironi të fatit, kur do të hynin në qytet, radha për të hipur në deve i takon shërbëtorit. Pavarësisht nga këmbëngulja e shërbëtorit, kalifi zbaton radhën, e hip këtë të fundit në deve, merr kapistrën në dorë dhe ashtu hyjnë në qytet...

Ata që e shohin këtë pamje, shkrijnë në çast si qiriu dhe thonë: "Ja, ky është njeriu që përmendet në librat tanë!" Dhe ia dorëzojnë çelësat e qytetit!

Ai Omeri i madh shtrihej i sëmurë nga plagët e hanxharit të një iranasi adhurues të zjarrit. E nxirrte çdo gjë që hante e pinte, s'bënte zë e rrinte indiferent ndaj zërave. Kur shërbëtori vinte për ta pyetur nëse donte të hante a të pinte gjë, ose nuk i jepte përgjigje, ose i përgjigjej negativisht vetëm me vështrim. Kurse kur e lajmëronte me fjalët "O emiri i muslimanëve, është koha e namazit!", i përgjigjej në çast: "Ja, po ngrihem. Kush e lë namazin, s'ka pjesë nga Islami!" Dhe ashtu, me plagë të përgjakura ngrihej e falej.(44)

Vepronte kështu, sepse kështu kishte parë te i Dërguari i Allahut. Do t'i përshtatej atij, do të

vepronte si ai, do t'i përngjante atij dhe, kështu, do të bëhej shembull për pasardhësit. Po, njëri prej qëllimeve të dërgimit të profetëve ishte që ata t'i bëheshin shembull bashkësisë së tyre...

4. SIGURIMI I DREJTPESHIMIT BOTE - AMSHIM

Profetët kanë ardhur për të realizuar drejtpeshimin botë - amshim.

Me drejtpeshimin e sjellë prej tyre do të shpëtonte njeriu nga qëndrimet ekstremiste të indiferencës dhe teprimit dhe do të gjente kahjen e duhur. Po, as tërheqje nëpër manastire duke braktisur çdo gjë të kësaj bote siç bëjnë priftërinjtë dhe murgjit, as dhe shtënie me gjithçka duke u bërë skllav i saj, por gjetje e udhës së mesme dhe një jetesë e tillë që, në vetvete, është një meritë që mund të shtihet në dorë vetëm nën ndriçimin e revelacionit hyjnor. Sa për mendjen dhe ndërgjegjen, me këto nuk mund të arrihet një drejtpeshim i tillë. Veçanërisht me shkencat abstrakte nuk mund të ngjitet njeriu në një nivel të tillë.

Kur'ani e karakterizon kështu këtë drejtpeshim: "Dhe me ato që të ka dhënë Allahu, kërko të fitosh botën tjetër pa lënë mangut atë që të takon nga kjo

botë. Dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë mirë Allahu ty e mos syno për të këqia, se Allahu nuk i do ata që shkaktojnë të këqia e çrregullime në tokë." (Kur'ani, Kasas: 77)

Në njërën anë të peshores së këtij drejtpeshimi hyjnor ndodhet e vërteta "Me të mirat që të dha Zoti, trego (udhëzo)" (Kur'ani, Duha: 11), kurse në tjetrën anë ndodhet ajeti "...atë ditë do të pyeteni për të gjitha të mirat e kësaj bote" (Kur'ani, Tekathur: 8) me shprehjen e tij paralajmëruese. Ja, brenda këtyre kritereve do të ruhet drejtpeshimi!

Hz. Ebu Bekri e pati shpenzuar tërë pasurinë për Allahun. Sepse besnikëria* këtë e kërkonte. Në kohën e hilafetit të tij, një ditë, i patën dhënë një gotë me ujë të ftohtë, e pati pirë dhe, pastaj, papritmas, pati nisur të qante me ngashërim, aq sa i kishte bërë edhe të tjerët të qanin. Pastaj e patën pyetur për shkakun dhe u qe përgjigjur kështu: "Një ditë kur isha bashkë me të Dërguarin e Allahut, m'u duk sikur shtynte diçka me duar sikur të donte t'i thoshte "Largohu prej meje, qëndro larg meje..." E pyeta: "O i Dërguari i Allahut! Diçka po largon me duar, por unë s'po shoh gjë..." Dhe ai urdhëroi e tha: "Përballë m'u shëmbëllye bota me tërë shkëlqimin e saj duke

më kërkuar që ta pranoja, kurse unë i thashë të qëndronte larg meje. Duke u tërhequr tutje për në një breg, po më thoshte: "Edhe nëse ti shpëton prej meje, të betohem se ata që do të vijnë pas teje, nuk do të munden të shpëtojnë nga dora ime!" Edhe unë qava se m'u duk sikur bota më bëri për vete me këtë gotë uji të ftohtë!"

Po, ai dhe të tjerët si ai, megjithëse i kishin mundësitë të bënin një jetë të qetë e të begatë, patën jetuar vazhdimisht një jetë të matur, sepse ashtu kishte jetuar shembulli i tyre, ai Shembulli i Përgjithshëm, ai Udhëzuesi i Përsosur!(45)

5. MBYLLJA E DERES PRETENDIMEVE

Profetët janë dërguar që Ditën e Gjykimit njerëzit të mos kenë asnjë pretendim ndaj Providencës Hyjnore.

Një ajet-argument i Kur'anit e shpjegon kështu këtë specifikë: "Dërguam pejgamberë myzhdedhënës dhe paralajmërues në mënyrë që pas tyre njerëzit të mos kishin pretendime para Allahut. Allahu është Sovran dhe i Gjithëditur!" (Kur'ani, Nisa: 165).

Përrjashtuar profetët, liderët e tjerë rregullisht nuk kanë mundur t'i bëjnë masat t'u besojnë. Edhe në qoftë se i kanë bërë, meqë mesazhet dhe propozimet

e tyre kanë qenë të mangëta nga mbështetja hyjnore, me asnjë mesazh, me asnjë fjalë dhe me asnjë sjellje nuk kanë mundur ta kapërcejnë njerëzoren dhe mjedisi i tyre me kohë është shpërndarë si gjethet e zverdhura në vjeshtë...

Kurse prijësia e profetëve nuk është e tillë. Ashtu siç thamë edhe më parë, ata janë njerëz të porositur. Ata janë pejgamberë qysh në mitrën amësore. Jetesa e tyre është harmonike si muzikë, po ashtu edhe të folurit e tyre pothuaj si një poezi! Kur flasin ata, qenia e tërë ngreh veshët dhe i dëgjon. Sa e sa ngjarje e dukuri ndërrojnë ecuri me ardhjen e tyre dhe sa e sa ndjesi lidhen pas tyre. Ligjet efektive në gjithësi disa herë për hir të tyre nuk funksionojnë dhe disa herë ndërrojnë funksion me dëshirën e tyre...

Hidhini një shikim Mbretit të Profetëve! Gur, dhe, dru si dhe kafshë të ndryshme secili pothuaj në hesap të vet kanë hyrë në marrëdhënie me të dhe kanë paraqitur një gjendje sikur të vërtetonin profetësinë e Tij. Ashtu siç përmend edhe Busajriu, "Druri vinte me vrap tek ai dhe, me gjuhën e vet të posaçme, i thoshte: "Ti je i Dërguari i Allahut!"(46)

Me ardhjen e tij materia kishte fituar kuptim dhe kishte dalë nga gjendja e të qenit kaos. Me gjuhën e

Kur'anit ai thoshte "...nuk ka asnjë send që të mos e madhërojë Atë, por ju s'e kuptoni (sepse s'është në gjuhën tuaj)..." (Kur'ani, Isra: 44) dhe me këtë sikur i frynte shpirt e jetë çdo qenieje.

Çdo gjë që mësuam, ne prej tij e mësuam dhe materja hipi në fronin e urtësisë.(47) Natyrisht që në këtë mes edhe njeriu arriti të kuptojë se s'ishte diçka e kotë e pa ndonjë qëllim!(48)

Çdo peygamber ka ardhur me një pjesë mrekullish për t'i bërë njerëzit që të besojnë dhe për të mos u dhënë mundësi pretendimeve të atyre që s'besojnë. Kurse më i madhi i peygamberëve i pati sjellë të gjitha mrekullitë e paraardhësve të tij dhe pati treguar se ishte Shembulli i Përgjithshëm. Po, çdo bashkësi i pa vetë ose dëgjoi për mrekullitë e profetit të vet. Edhe ne kemi dëgjuar për mijëra mrekulli të të Dërguarit të Allahut, ndërsa e kemi parasysh gjithmonë një mrekulli të amshuar si Kur'ani. Pas kësaj, askush nuk ka të drejtë për të kundërshtuar apo pretenduar. Allahu (xh.xh.), të vërtetat që ka dashur t'i besojmë, i ka parashtruar para syve të njerëzve me anë të profetëve të vet në një formë mjaft të hapët e të qartë. Sepse kjo ka qenë edhe një nga qëllimet e dërgimit të tyre. Është edhe

një moment veçanërisht i rëndësishëm, thënia e Providencës Hyjnore: "Ne nuk dënuam askënd para se t'i dërgojmë profetin!" (Kur'ani, Isra:). Kjo do të thotë se, meqë u dërguan profetët, do të ngrihet edhe peshorja dhe secili do të merret nën përgjegjësi pa iu marrë parasysh justifikimet.

(35) Buhari, Megazi, 83; Myslim, Selam, 50, 51; Ebu Davud, Tib, 19; Ibni Maxhe, Tib, 38.

(36) Taberi, Xhamiu'l-Bejan, 24/33 e në vazhd.; Mysned, 1/449.

(37) Buhari, Merda, 19; Myslim, Zikr, 10.

(38) Profetët janë të një mendjeje në parimin kryesor të fesë, unitetin e Zotit. Kurse në hollësiirat ndryshojnë se kanë sjellë gjëra të ndryshme. (Buhari, Enbija, 48; Myslim, Fezail, 145).

(39) Ibni Hisham, Sire, 2/60-63; Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/166 e në vazhd.; Buhari, Bedu'l-Halk, 7.

(40) Ibni Maxhe, Menasik, 84; Ebu Davud, Menasik, 56.

(41) Buhari, Fezailu'l-Ahsab, 1; Myslim, Fezailu's-Sahabe, 208-209.

(42) Buhari, Fezailu'l-Ahsab, 1; Myslim, Fezailu's-

Sahabe, 212.

(43) Axhluni, Keshfu'l-Hafa, 2/83.

(44) Ibni Said, Tabakat, 3/350; Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid, 1/295.

* Në origjinal: sidkijet, niveli më i lartë i vërtetësisë, drejtësisë, fjalëmbajtjes, besnikërisë. Ky është edhe parimi themelor i Islamit. Atributi "Sadik", "Besnik" i qe dhënë Hz. Ebu Bekrit, të parit musliman ndër burrat, shokut të pandarë të Profetit (s.a.v.) dhe kalifit të parë në historinë Islame.

(45) Myslim, Eshribe, 140; Ebu Nuajm, Hilje, 1/30.

(46) Shih Myslim, Zyhd, 74; Mysned, 1/223; Ibni Kethir, el-Bidaje, 6/135 e në vazhd.

(47) "...ashtu siç dërguam nga mesi juaj një Përfaqësues t'ju lexojë ajetet tona, t'ju pastrojë e t'ju mësojë librin dhe traditën si dhe atë që nuk e dinit".

(Kur'ani, Bakara: 151. Veçanërisht shih Bakara: 129; Al-i Imran: 164; Xhum'a: 2. Nga veprat e tjera, Mysned, 1/202, biseda mes Hz. Xhaferit dhe Nexhashiut).

(48) Sa bukur e shpjegojnë këtë specifikë këto ajete:

"A mos pandeh njeriu se do të lihet pa përgjegjësi?"

(Kur'ani, Kijame: 36); "A menduat se ju krijuam për

lojë dhe zbavitje dhe se nuk do të ktheheni prapë tek Ne?" (Kur'ani, Mu'minun: 115.)

Veçorite e Profeteve

SHENJTERI

Asnjë profet nuk ka filluar duke u menduar e duke thënë "të zbatoj një sistem të tillë..." dhe as nuk mund të fillojë! Në çështjen e kumtesës profetike, drejtpërsëdrejti Zoti dëshiron të bëjë profet dikë nga njerëzit.

Kur t'i vijë koha, ia komunikon këtij njeriu të zgjedhur, të krijuar krejtësisht për profetësi, detyrën dhe përgjegjësinë profetike dhe pastaj e shpall atë. Çdo profet vjen me revelacionin sipas nivelit të tij, me atë revelacion mbahet gjallë dhe shkon kur ai revelacion t'i ndërpritet. Ç'vlerë të kenë për vazhdimin e jetës sonë elementë themelorë si ajri, uji dhe buka, atë vlerë ka edhe revelacioni për profetin. Ata sikur jetojnë me frymërat hyjnore që vijnë prej Allahut. Nga Burimi i Begatisë së Shenjtë si një erë mëngjesi vazhdimisht fryjnë e vijnë ca gjëra dhe ata

mbeten mes njerëzve për sa kohë të fryjnë këto frymëra. Dhe kur ndërpritet kjo, hapin krahët me dëshirë drejt Zotit dhe presin çastin kur do të fluturojnë përtej...

Ata i janë dorëzuar Zotit të tyre me të gjithë qënien e tyre. Çfarëdo që të duan të thonë, ata e thonë vetëm në masën që do Zoti. Meqë feja që kanë sjellë është e buruar plotësisht dhe vetëm nga Zoti, ata janë shenjtore dhe të ngarkuar me përgjegjësinë e sjelljes në vend të një detyre të tillë të shenjtë.

Pranimi ose kundërshtimi i bashkëbiseduesve të tyre gjatë kryerjes së detyrës nuk ndikon tek ta për t'i shmangur nga detyra, e cila është vetëm kumtesa dhe shpjegimi. As që i marrin parasysh thëniet apo bëmat e kundërshtarëve. Kurse lëshimet në emër të kauzës së tyre kategorikisht nuk mund të mendohen. Qëndrimi i palëkundur i Profetit Muhammed (s.a.v.) nëpërmjet thënies së tij "Edhe sikur të më vënë hënën në një sup e diellin në supin tjetër, nuk heq dorë nga kjo kauzë", është parimi i përgjithshëm i tyre.(49)

2. VULLNETARIZEM

Profetët nuk presin asnjë pagesë shpirtërore e materiale si kundërvlerë të shërbimit të kryer. Kur'ani

bën fjalë për këtë specifike të tyre në raste të ndryshme dhe në ajete të ndryshme. Momenti i përbashkët i thënieve të tyre përqëndrohet te e vërteta "Shpërblimi im i përket vetëm Allahut". Sa për ne, mundet të presim një shpërblim shpirtëror edhe në mos qoftë fjala për shpërblim material. Kurse profetët nuk e presin as këtë dhe të gjitha bëmat i bëjnë duke i vlerësuar nga këndvështrimi se ato janë urdhëri i Zotit. Për supozim, edhe po ta dinin se, në përfundim, do të digjeshin mes flakëve të xhehennemit, prapëseprapë kthjelltësia e mendimeve të tyre nuk do të turbullohej dhe do të vazhdonin të mendonin vetëm për kryerjen e detyrës së tyre...

Profetët janë njerëz që flijojnë ndjenjat e përfitimit materialo-shpirtëror dhe në këtë çështje janë qenie eprore. Nuk janë as sevdaja për xhennetin apo frika për xhehennemimin që i shtynjë për të kryer këtë detyrë të rëndë e të vështirë, por vetëm e vetëm dëshira për të fituar miratimin e Zotit të tyre.

Çdo profet është një vullnetar. Kurse pika më e lartë e vullnetarizmit i përket Mbretit të Profetëve. "Ummeti, njerëzit e mi!" ka thënë kur ka lindur dhe edhe në ditën e ringjalljes ashtu do të thotë.(50)

Shihni se çfarë vullnetarizmi dhe vetmohimi që, ndërsa portat e xhennetit të hapura kat më kat presin të nderohen me ardhjen e tij, ai parapëlqen të përjetojë çastet më të turbullta të ringjalljes pas katastrofës me qëllim që të marrë me vete edhe ummetin, bashkësinë e tij! Jo vetëm farefisën dhe ata që i kanë ndenjur afër, por të gjithë ummetin, përfshi edhe atë më mëkatarin!

Po, udhëkalimet shpirtërore të tyre janë të hapura vetëm për një gjë: për pëlqimin dhe miratimin e Allahut! Për çdo gjë tjetër i kanë vënë derës shulin nga pas.

Veçanërisht në ditët e sotme, ata që i kanë vënë shpatullat detyrës së kumtesës e të orientimit që është një detyrë profetike, duhet të kenë shumë kujdes në këtë pikë dhe duhet të sillen me shumë ndjeshmëri. Sepse forca ndikuese e fjalës është e fshehur jo në kumtesën dhe në ligjërimin e bukur, por në të qenit i sinqertë. E të qenët i sinqertë kërkon vullnetarizëm dhe flijim. Pikërisht për të vënë gishtin në këtë konceptim, në Kur'an thuhet: "Ndiqui njerëzit që nuk kërkojnë ndonjë shpërblim prej jush e që janë në rrugë të drejtë!" (Kur'ani, Jasin: 21) Po, ndërsa ata fluturojnë në qiejt e orientimit,

edhe ju ndiqini ata. Sepse nuk kërkojnë prej jush ndonjë gjë në emër të kësaj bote. I mendoni mirë njerëzit që do t'i ndiqni pas me mendje të fjetur, i matni dhe lidhuni pas atij që jeton natë e ditë i mbushur plot me ashkun e shërbimit. Ai duhet të parapëlqejë përgatitjen e rrugëve nga do të kalojnë karrocet e fitores së brezit të ardhshëm, konceptimin dhe arritjen e ditëve të mrekullueshme e të përshndritshme të asaj kohe. Dhe në botën ndjesore të tij të mbrujtur me vullnetarizëm e sakrificë të mos bjerë qoftë edhe hija e një kërkesë të pafajshme. Ja, të tillë prijës e të parë zgjidhni për vete dhe u shkoni pas!

I Dërguari i Allahut ishte njeriu i vullnetarizmit e i sakrificës. Gjatë gjithë jetës as me bukë thekre nuk e pati mbushur barkun. Ndodhte që kalonin ditë, javë e muaj e në banesën e tij të mbushur plot lumturi të mos ndizej zjarr për të gatuar e të mos ziente një enë me supë.(51) Ebu Hurejre tregon: "Shkova një ditë pranë të Dërguarit të Allahut dhe e gjeta tek po falej ulur. Pasi mbaroi, e pyeta:

- O i Dërguari i Allahut, mos je i sëmurë?
- Jo, o Hurejre, e kam nga të pangrënët.

Fillova të qaja. I dashuri i Allahut, për të cilin ishte krijuar gjithësia, falej ulur nga të pangrënët! Kurse ai më qetësoi kështu kur më pa të përlothesha:

- Mos qaj, o Eba Hurejre! Ai që vuan në këtë botë ankthin e urisë, do të jetë i sigurt nga ana tjetër se do të jetë i mbrojtur nga ndëshkimi i Zotit!(52)

Një grua medinase i kishte sjellë Profetit një si dyshek dhe Hz. Aisheja e kishte shtruar mbi rrogozin mbi të cilin ulej e prehej gjithmonë ai. Kur Profeti kishte ardhur dhe e kishte vënë re ndryshimin, kishte kërkuar shpjegim për këtë. Pas përgjigjes së marrë, kishte thënë:

- O Aishe! Ktheje mbrapsht menjëherë këtë. Betohem në Allahun se, po të desha, Allahu më vinte djathtas e majtas male me ar e argjend, por unë s'dua...(53)

Ashtu është, po të donte, ai mund të kalonte një jetë komode. Një ditë kishte ardhur një engjëll e i kishte sjellë të fala nga Zoti: "A do të bëhesh një pejgamber sundimtar apo një pejgamber rob?"

Engjëlli Xhebrail i vjen në ndihmë: "O i Dërguari i Allahut, tregohu i thjeshtë!" Dhe Profeti e bën zgjedhjen: "Dua të jem një profet që një ditë i

pangrënë lutet e që një ditë tjetër i ngopur falënderon!"(54)

Profeti rrinte bashkë e hante bukë me shërbëtorët e skllëverit. Një grua që një ditë sheh një pamje të tillë, i thotë me përbuzje: "Je ulur e ha bukë si një skllav!" Kurse Zotëria i Gjithësisë i përgjigjet: "A mund të ketë skllav më të lumtur se unë? Unë jam skllav i Zotit!"(55)

E gjithë jeta e të Dërguarit të Allahut është e mbushur me tablo vullnetarizmi e sakrifice. Tani për tani, hollësitë po ua lëmë mijëra librave që kanë për tematikë jetën e tij të lartë. Po, të gjithë profetët me të në krye kanë jetuar si vullnetarë dhe njerëz të sakrificës dhe nuk kanë kërkuar asgjë nga sendet e kësaj bote apo tjetrës si kundërvlerë të shërbimeve që kanë sjellë. Prandaj fjalët e tyre kanë pasur ndikim. Në qoftë kështu, ata që kërkojnë që fjalët e tyre të kenë aftësi ndikimi si të ishin një eliksir, para çdo gjëje tjetër duhet të mësojnë të mos kërkojnë asgjë dhe prej askujt në përgjigje të shërbimit të kryer!

3. PRINCIPIALITET

Principialitet do të thotë që çdo gjë që bën, ta bësh për Allahun dhe, gjithashtu, çdo gjë që nuk bën,

për hir të Allahut të mos e bësh. Profetët janë personalitete të përgatitur pikërisht me një principialitet të tillë që në krye të herës. Ç'është e vërteta, njeriu me përpjekje mund të arrijë në principialitet në një pikë të caktuar, por ç'e do se pika ku mund të arrijnë njerëzit e zakonshëm është vetëm një fillim për profetët. Ata janë bërë pothuajse vetë esenca e principialitetit. Këtë specifikë Kur'ani e shtjellon kështu duke e personifikuar te disa profetë: "Përmendju në libër edhe Musanë! Ai ishte një i dërguar dhe profet i zgjedhur." (Kur'ani, Merjem: 51).

Po ashtu edhe për Hz. Jusufin: "Vërtet ai ishte nga robtë tanë të zgjedhur!" (Kur'ani, Jusuf: 24).

Kurse për personalitetin e të Dërguarit të Allahut i flet kështu ummetit, bashkësisë së tij: "Pa dyshim që Ne ta zbritëm Librin për hir të së vërtetës, prandaj ti adhuroje sinqerisht Allahun!" (Kur'ani, Zumer: 2)

Dhe në një vend tjetër Allahu e porositi kështu të flasë të dashurin e Tij: "Thuaj: Unë e adhuroj Allahun sinqerisht duke ia dedikuar fenë vetëm Atij!" (Kur'ani, Zumer: 14).

Shkaku i adhurimit është urdhri i Allahut dhe rezultati, pëlqimi dhe miratimi i Tij; kurse frytet dhe përfitimi janë ato që do të japë Zoti në jetën tjetër. Adhurimi e përfshin në vetvete tërë një jetë dhe e bën veten të ndihet si një vetëdije e konceptim në të gjitha sjelljet e besimtarit.

Mendimtari i madh i shekullit tonë, duke thënë "Punoni për Allahun, filloni për Allahun, përpiquni për Allahun dhe veproni brenda kuadrit të pëlqimit dhe të miratimit të Tij!", edhe bën përkufizimin e principialitetit, edhe flet për rëndësinë e tij.(56)

Principialiteti është emërtimi i të qenit i drejtë e i orientuar për njeriun. Në jetën e një njeriu të tillë nuk ka zigzage. Diagrama e zhvillimit të tij shpirtëror është gjithmonë në ngjitje. Është për këtë që njerëz të tillë kanë mundur ta ruajnë thjeshtësinë e ditëve të para edhe pasi janë ngjitur në maja. Mirëpo ç'e do që ata janë aq shumë pak!

Në historinë e njerëzimit është vetëm një njeri që ka arritur në këtë majë dhe ai është i Dërguari i Allahut. E si të mos jetë, kur, midis ditës së parë kur nisi ta bëjë të njohur kauzën e tij dhe ditës kur u triumfua Meka, në sjelljet e tij, përse i përket

thjeshtësisë, nuk pati treguar edhe ndryshimin më të vogël?

Meka që marrë me paqe. Nëse pati një dy ngjarje të veçuara, përfshirja e tyre në të përgjithshmen nuk është e drejtë. Duke hyrë në atë vend të bekuar nga ku ishte nxjerrë vite më parë, Profeti i të Dy Botëve nuk hynte me pamjen e një komandanti triumfator. I hipur mbi kalë, e mbante kokën aq ulur, sa ajo kokë e bekuar pothuaj do t'i prekte në jelet e kafshës.(57)

Ai nuk e pati ndryshuar sjelljen dhe qëndrimin as gjatë periudhës kur pati ndenjtur në Medinë. Sahabet, pasuesit e tij, ngriheshin në këmbë kur hynte ai. Dhe ashtu është, duhet të ngriheshin! Madje edhe të vdekurit duhet të ngriheshin nga varret e t'i shprehnin respektin e tyre! Ai e meritonte me të tepërt një respekt të tillë. Kurse ai ndjehej seriozisht i shqetësuar nga ngritja në këmbë e pasuesve dhe çdo herë u thoshte si me qortim: "Mos u ngrini në këmbë si fëmijët ndaj të mëdhenjve!"(58)

Po, ashtu si ta fillonte ai një detyrë të shenjtë, ashtu edhe e mbaronte. Jeta e tij pati kaluar pothuajse si në një harmoni melodike. E mbaronte punën në po atë perde ku e pati filluar dhe kjo do të thoshte një sukses i madh. Madje, në një aspekt, ai e

pati filluar këtë melodi hyjnore në "lento" dhe, në përfundim, pati kaluar në "fortissimo" duke gjëmuar qiej e tokë!

Gjatë gjithë jetës ai adhuroi vetëm Allahun duke ia dedikuar Atij fenë, ndjesitë ia mbushën zemrën e dolën nga shtrati me afërsinë e ndjerë për Të, syri i kërkoi në çdo vend veprën e Tij, gjithë ndjenjat i valuan e u derdhën me kënaqësinë shpirtërore të buruar prej Tij! Ai pati hapur sytë te e vërteta, pati hapur velat drejt së vërtetës dhe qe sjellë kudo duke thënë gjithmonë "Allah!" me një oreks që s'dinte të ngopej. Sepse ai ishte njeri i principialitetit!

Edhe vetëdija e favorit tek ai përbënte një dimension të veçantë. Sepse favori brenda përkufizimit të tij personalisht ishte kryerja e adhurimit sikur ta shihje Allahun.(59) Po qe se çështjen do ta shpjegonim figurativisht, do të thoshim se, ndërsa të tjerët faleshin duke u kthyer nga Qabeja, ai e falte namazin brenda në Qabe!

4. KESHILLE E MIRE

Duke bërë të njohur dhe përhapur kauzën e tyre, profetët kategorikisht nuk hyjnë në dialektikë. Ata u afrohen njerëzve me urtësi dhe këshillë të mirë. Me të vërtetë, Kur'ani i shprehet kështu Profetit: "Ti

thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ta në formën më të pëlqyeshme..." (Kur'ani, Nahl: 125). Me fjalë të tjera, kërkon t'i thotë që urtësinë e fshehur në materie dhe të fshehtën e krijimit ta tregojë në mënyrë të butë dhe me një stil bindës. Të përpiqet për t'ua ngopur mendjet dhe zemrat pa ua prekur ndjenjat.

Profetët nuk i kanë pëlqyer aspak demagogjinë, dialektikën dhe stilin filozofik. Nëse dje apo sot i janë drejtuar demagogjisë disa kokëtrashë, me këtë rrugë askujt nuk ka qenë e mundur t'i tregohet diçka. Edhe Providenca Hyjnore nuk ka dashur t'i preokupojë profetët me të tilla gjëra boshe. Detyra e tyre ka qenë kumtimi dhe përhapja e çështjeve fetare me urtësi dhe këshillë të mirë.

Njeriu nuk është identitet i vetëm një koke dhe mendjeje; ai ka edhe një zemër, një shpirt, ka enigmën e tij dhe të gjitha këto kërkojnë e presin të kënaqen. Ja, pra, profetët, duke i trajtuar njerëzit në të gjitha këto aspekte e duke u kumtuar mesazhet e tyre profetike, i bindin dhe i kënaqin ata në të gjitha aspektet e individualitetit të tyre. Dhe rezultati i një kumtese të realizuar pa lënë mangut asnjë prej specifikave njerëzore, është afrimi i lëkundjeve te

ideja e unitetit e asgjësuar në besimin e bashkëbiseduesit, gjë që është vetë qëllimi i krijimit të njeriut.

Te të përgatiturit në rrethin e mësimi të profetëve del në pah një fakt tjetër. Në praninë e tyre, krahas syve që shohin këtë botë, hapen edhe kapakët e syve të zemrës dhe çështjet e papërceptuara e të panjohura për dikë tjetër, për ta bëhen të qarta më në fund. Sikur e gjithë bota tjetër të fryhet e të derdhet me lëkundje e dyshime, këta njerëz s'bëjnë gjë tjetër veç të kalojnë duke hedhur sytë me një vështrim ironik. Sepse në hojet e intuitës së krijuar në ndërgjegjet e tyre nuk mund të hyjë e të vendoset asnjë mizë dyshimi...

Njëshin që njohin ata, Allahu ua bën një mijë, njohurive u jep bereqet dhe ua mëson ato që s'dinë.(60) Erërat frymëzonjëse që vijnë nga qiejt, i shndërrojnë pothuaj në qiell zemrat e tyre dhe ata, duke i zbatuar shkronjë për shkronjë ato që dinë, gjejnë pegasin që quhet "fjala e bukur" dhe lartësohen lart pa pra.(61)

Madje midis tyre përgatiten të tillë si Hz. Aliu që thotë: "Edhe sikur perdja e së fshehtës të hapet, faktet që shoh nuk do të ndriçohen më shumë!" Me

fjalë të tjera, kërkon të thotë se edhe sikur të hiqet perdja e së padukshmes dhe, si rezultat, të shohë çdo gjë që i duhet të shohë, prapëseprapë nuk mendon se do të arrijë një horizont besimi më të largët se ai i sotmi, sepse ajo çka di ai, është e tillë që e vendos atë pikërisht në fokusin e besimit për të panjohurën.(62) Kjo fjalë në gojën e një njeriu si Hz. Aliu, është një fjalë e thënë në nivelin e "falënderimit për të mirën".(*) I Dërguari i Allahut e ka shpallur atë, me miratimin e Zotit, si atin e prijësve gjer në Kiamet. E pati sjellë atë në qelizën e tij të lumturisë, e pati martuar me Hz. Fatimenë, me atë lulen e bahçes profetike, dhe nga ajo martesë e lumtur patën ardhur në botë dy bukuri, Hz. Hasani dhe Hz. Hyseni. Në mënyrë të veçantë, të gjithë prijësit dhe majat ndërmjet tyre gjithë prej këtij burimi patën shpërthyer...

Po, ashtu siç që Hz. Aliu, edhe pothuaj çdo hallkë e zinxhirit të artë të lidhur pas tij qenë bërë heronj përfaqësues të kësaj vetëdijeje.(63)

Kjo vetëdije zhvillohet tek ata që kanë rrokur enigmën e favorit si rezultat i besimit, të cilët, duke qenë ende në këtë botë, meritojnë komunikimin "...ta hoqëm perden dhe ti tashmë sheh shumë prehtë!"

(Kur'ani, 50/22). Sapo që kjo gjendje e cila në terminologjinë perëndimore quhet "intuitë", fillon të veprojë në ndërgjegjen e njeriut, bota e jashtme hesht dhe vetveten e mbështjellin tingujt zhurmërues të parandjenjave të brendshme duke kaluar, kështu, në një situatë shpirtërore disaplanëshe, (*) sepse Mbreti i ndjenjave intuitive është ulur në fronin e tyre. E, atëherë, pse duhet kërkuar Ai jashtë?

Ja, pra, Profeti që i lartëson nxënësit e vet në një ndjesi dhe mendim të tillë, në metodë ka marrë për parim gjithmonë këshillën e mirë në kuptimin e plotë e të përgjithshëm të saj, po ashtu edhe ndërtesën e orientimit mbi këtë themel e ka ngritur.

Specifikat për të cilat u përpoqëm të flasim në këtë kapitull, ajeti i mëposhtëm i shpreh me stilin më konçiz e më të mrekullueshëm:

"Ju dërguam një Përfaqësues nga mesi juaj që t'ju lexojë ajetet tona, t'ju pastrojë, t'ju sjellë Librin e urtësitë e t'ju mësojë ato që s'i dini." (Kur'ani, Bakara: 1).

Pasi kemi parashtruar dhe ilustruar nisur nga raste të ndryshme ndjeshmërinë dhe metodën e Profetit të të Dy Botëve lidhur me tematikën në fjalë, e shohim të tepërt të shtojmë diçka tjetër.

Megjithatë, po qe se do të bënim një përmbledhje me dy-tri fjali, do të mund të thoshim kështu: Ai gjithmonë i fliste bashkëbiseduesit me një mënyrë dhe metodë brenda kuadrit të urtësisë, të pastër nga mangësitë dhe tepritë, të tillë që do t'ia ngopte mendjen, zemrën dhe ndërgjegjen, në përputhje me gjendjen dhe nivelin e tij. Për rrjedhojë, në përgjithësi, ata që ndaheshin prej tij pasi e kishin dëgjuar, ndaheshin të tillë që kishin fituar besim e siguri. Nëse ka ndodhur që të ketë raste si ai i Velid b. Mugires dhe Utbe b. Rebiait që, megjithëse e kanë pranuar se thëniet e Hz. Muhammedit janë të vërteta, nuk kanë shpëtuar dot nga të qenit robër të krenarisë dhe mendjemadhësisë bashkë me ata që janë bërë kurban i frikës nga e reja dhe, për pasojë, kanë mbetur në herezi, pra, nëse ka pasur raste të tilla, këto janë mangësi që u përkasin plotësisht subjekteve në pozitën e receptorit. Disa herë ka pasur edhe raste si poeti Asha që, megjithëse e kanë pranuar çdo gjë, kanë kërkuar kohë për shkak se nuk kanë mundur t'i braktisin veset e tyre; nëse këta kanë vdekur para se të hynin në rrugë të drejtë, kjo duhet të shpjegohet me faktin që kaderi (paracaktimi hyjnor) dhe kadhaja (aksidenca) përkatëse e tyre ka

hyrë në veprim që më parë. Në asnjërin nga këto raste nuk ekziston ndonjë mangësi dhe e metë që t'i reflektohet të Dërguarit të Allahut dhe nuk mund të ekzistojë, madje!

5. THIRRJE PER UNITET

Në Kur'an, kur tregohet se si u janë drejtuar profetë të ndryshëm fiseve të veta, përdoret kjo shprehje: "O njerëz të mi! Allahun adhurojeni, se nuk keni zot tjetër përveç Tij!" (Kur'ani, Hud: 84).

Kauza e çdo profeti me këtë të vërtetë fillon dhe me të i vihet pika.

Marrëveshja e njëzëshme në këtë pikë e këtyre personaliteteve të shquar, të ardhur në kohë e vende të ndryshme, si dhe fakti që kanë proklamuar gjithmonë të njëjtat të vërteta, nuk lë asnjë lëkundje e dyshim që ata nuk kanë kumtuar idetë dhe mendimet e veta, por mesazhet e marra nga Zoti i tyre. Eshtë e papranueshme mendërisht që të jenë unaninë për të njëjtën çështje njerëz me dhunti dhe aftësi krejt të ndryshme e që kanë jetuar në kohë dhe vende të ndryshme. Ju bëheni dëshmitarë të faktit se midis ndjekësve të një shkolle, madje edhe midis bashkëkohësve, në çështje shumë të vogla e të thjeshta të një pjese rrymash filozofike ka shumë

ndryshime dhe kontradikta. Ja, pra, ky kontradiksion në rrymat me burim mendimin njerëzor dhe polemikën si dhe ky unanimitet në sistemet e ofruara nga individë të zgjedhur me revelacionin hyjnor, tregon se të parat janë me burim subjektiv e iluziv, kurse të dytat janë të orientuara e të qëndrueshme, me një fizionomi përfundimtare. Sigurisht, uniteti i fjalës të profetët dhe fakti që të gjithë ata kanë ardhur me të vërtetën e unitetit hyjnor, është, përsëri, një specifikë e atij institucioni. Është për këtë arsye që i Dërguari i Allahut ka urdhëruar: "Fjala më e lartë dhe e virtytshme e thënë prej meje dhe prej të gjithë profetëve të ardhur para meje, është fjala që përmbledhet në këtë shprehje: "La ilahe illallahu vahdehu la sherike lehu", "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut Një të Vetëm e të Pashoq!"(64)

(49) Shih Ibni Hisham, Sire, 2/285.

(50) Buhari, Tevhid, 36; Myslim, Iman, 326.

(51) Buhari, Rikak, 17; Myslim, Zyhd, 28...

(52) Kenzu'l-Ummal, 7/199.

(53) Ibni Kethir, el-Bidaje, 6/60.

(54) Mysned, 2/231; Kenzu'l-Ummal, 7/191;

- Mexhmau'z-Zevaid, 9/19-20.
- (55) Mexhmau'z-Zevaid, 9/21.54; Mysned, 2/231; Kenzu'l-Ummal, 7/191; Mexhmau'z-Zevaid, 9/19-20.
- (56) Bediuzzaman, Sözlər, 1. Söz; Lem'alar, 21. Lem'a.
- (57) Ibni Hisham, Sire, 4/47-48; Mexhmeu'z-Zevaid, 6/169.
- (58) Ebu Davud, Edeb, 152; Mysned, 5/253.
- (59) Buhari, Iman, 47; Myslim, Iman, 5, 7.
- (60) Një hadith aludon për këtë: "Kush vepron me aq sa di, Allahu ia favorizon njohjen e diturisë së gjërave që nuk di." (Ebu Nuajm, Hilje, 10/15).
- (61) "Vepra e pastër e lartëson njeriun, fjalët e bukura ngjiten tek Ai..." (Kur'ani, Fatir:10).
- (62) Aliju'l-Kaari, el-Esraru'l-Merfua, f. 286.
- (*) Në origjinal: Tahdis-i nimet.
- (63) Myslim, Fezailu's-Sahabe, 61
- (*) Në origjinal: Ruh-efza.
- (64) Muvatta, Hacc, 246; Kenzu'l-Ummâl, 5/73

Besnikeri dhe Drejtësi

Drejtësia është boshti qëndror i profetësisë. Profetësia lëviz në orbitën e drejtësisë. Çdo fjalë e dalë nga goja e profetit ka pamjen e diçkaje të vërtetuar për drejtësinë e saj, sepse profetët nuk bëjnë kurrë ndonjë deklaratë kontradiktore. Kur'ani bën fjalë për këto karakteristika të profetëve duke na folur neve për madhësitinë e tyre.

"Përkujto në libër edhe Ibrahimin. Vërtet ai ishte një pejgamber i drejtë!" (Kur'ani, Merjem: 41).

Me fjalë të tjera, i thuhet Hz. Muhammedit (s.a.v.) të kujtojë në Levhi Mahfudh ose në Kur'an që është e vërteta e palëkundshme ose kopja e tij, Ibrahimin si një profet me fjalë, sjellje e mendime të drejta.

"Përkujtoju në këtë libër edhe Ismailin. Ai ishte njeri që e mbante fjalën, ishte i dërguar dhe profet." (Kur'ani, Merjem: 54).

"Kujto në libër edhe Idrisin. Ai ishte një pejgamber shumë i drejtë. Ne e lartësuam atë në një pozitë të lartë." (Kur'ani, Merjem: 56-57).

Duke përcjellë fjalët e shokut të burgut të Jusufit, Kur'ani bën fjalë përsëri për të njëjtat karakteristika: "O Jusuf, o ti i drejti..." (Kur'ani, Jusuf: 46)

E si të mos jenë të përgatitur me drejtësi ata, kur Allahu edhe njerëzit e zakonshëm i do që të jenë të drejtë dhe në Kur'an i ngre lart të drejtët:

"O ju që besuat! Kinie frikë Allahun dhe bëhuni bashkë me të drejtët!" (Kur'ani, Tevbe: 119).

"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që i besuan Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që nuk dyshuan dhe që luftuan në rrugën e Allahut me pasurinë dhe shpirtrat e tyre. Vetëm ata janë të drejtë!" (Kur'ani, Huxhurat:).

Besnikët janë të denjë për lavdërim

Besnikët që janë burra të fjalës, ngrihen lart në Kur'an: "Mes besimtarëve ka sa e sa burra që e mbajtën fjalën e dhënë, nga të cilët dikush dha jetën duke e çuar premtimin në vend e dikush pret atë ditë. Ata në asnjë rast nuk e ndryshuan qëndrimin." (Kur'ani, Ahzab: 23).

Dua të ndalem pak në këtë ajetin e fundit.

Enes b. Maliku ishte shërbyesi i të Dërguarit të Allahut. Kur Profeti e nderoi Medinën me vajtjen atje, e ëma e pati marrë për dore Enesin dhjetëvjeçar, e pati çuar te Profeti, të cilit i pati thënë: "O i Dërguari i Allahut! Le të të shërbejë im bir sa të jetë gjallë!" (65) Dhe Enes b. Maliku thotë se personat për

të cilët aludohet në këtë ajet, janë i ungi Enes b. Nadr dhe shokët e tij.

Kur Enes b. Nadr e pati parë Profetin në Akabe, qe lidhur pas tij i mrekulluar dhe e pati dashur si i marrë. Mirëpo, megjithatë, nuk pati mundur të ndodhej në luftën e Bedrit. Ndërkaq, Bedri kishte një vend të veçantë në kauzën e Islamit. Për më tepër, ashtu siç konsideroheshin të zgjedhur midis sahabeve, pasuesve profetikë, ata që kishin marrë pjesë në Bedër, ashtu shiheshin si të zgjedhur edhe engjëjt pjesëmarrës të Bedrit. Kjo ishte fjala e engjëllit Xhebrail që kishte komanduar engjëjt në Bedër.(66) Shihni, tani, se Enes b. Nadri që e pati humbur këtë rast, digjej në vetvete e s'i hynte gjumë në sy. E, kështu, pati shkuar te Profeti e ia pati qarë hallin: "O i Dërguari i Allahut! Po qe se edhe një herë do të na mundësohet të përballemi me ta, atëherë do ta shohin qafirët se ç'kanë për të hequr prej meje!" Kjo lutje e brendshme e Enesit qe pranuar dhe ai qe vënë në Uhud ballëpërballë me mohuesit...

Uhud... Kur përmendet kjo fjalë, njeriu rrëqethet. Sepse atje patën rënë dëshmorë shtatëdhjetë sahabe. Ndoshta me mendimin se mos

Uhudi mbetet si një kujtim i keq për shkak të kësaj humbjeje të hidhur, një ditë, duke kaluar andej, Profeti pati thënë: "Uhudi është një mal i tillë që edhe ai na do, dhe ne e duam."(67)

Uhudi është një mal i rrëpirë. Edhe vetë lufta e Uhudit pati pasur një të rrëpirë. Gjithsesi, sahabet nuk e patën ruajtur përkohësisht, ashtu siç u ishte kërkuar, pozicionin, madje e patën braktisur atë duke dalë, kështu, jashtë taktikës së treguar nga Profeti. Në fakt, ajo ishte një kërkim strategjie dhe taktike. Nisur nga kjo, nuk është e drejtë që rasti të quhet disfatë. Në këtë vijë qëndron kuptimi i respektit që kemi ne për sahabet.

Në këtë luftë edhe i Dërguari i Allahut që plagosur, dhëmbi i bekuar i që thyer, trupi i që larë me gjak. Por, pavarësisht nga çdo gjë, ai Profeti i mëshirës dhe faljes pati ngritur duart drejt qiellit e që lutur gjatë e gjatë: "Allahu im! Fali njerëzit e mi, se nuk dinë..!"(68)

Enes b. Nadri vraponte andej-këtej dhe përpiqej të çonte në vend fjalën që i kishte dhënë të Dërguarit të Allahut qysh një vit më parë. Përpiqej, por si shumë të tjerë edhe ai vërtitej drejt një pike fundore. Trupi i ishte bërë copë e çikë dhe po jetonte çastet e

fundit. Me buzëqeshjen e fundit në buzë, po i thoshte kështu Sa'd b. Muazit që i kishte shkuar pranë: "I bëj të fala prej meje të Dërguarit të Allahut! Për Zotin, këtë çast po ndjej pas Uhudit aromën e xhennetit..."

Sa e sa dëshmorë nuk pat qenë e mundur të njiheshin për shkak të plagëve të rënda atë ditë! Nuk qenë njohur Hamzai e Mus'ab b. Umejri. Vetëm kur ishin bashkuar copat e trupit të Abdullah b. Xhahshit, ishte bërë e mundur të thuhej "ai është"! Po në atë gjendje ndodhej edhe Enes b. Nadri. Kishte ardhur e motra, e kishte vërejtur në dorën ku mbante këllëçin -siç duket, i vetmi vend i paplagosur i trupit të tij- dhe me sytë e mbushur plot kishte mundur të thoshte: "Ky është Enes b. Nadri, o i Dërguari i Allahut!"(69)

Ja, pra, ajeti për këtë trim të madh tregonte. Ai e mbajti fjalën e dhënë! "Do të luftoj gjër në vdekje!" - tha dhe vdiq. As vdekja nuk mundi ta luante atë nga fjala e ta nxirrte gënjeshtar!

Ajeti ka për qëllim ta bëjë atë një shembull për besimtarët. Pasi të thuhet "Lailaheillallah", çdo individ duhet t'i mbetet besnik përmbajtjes sublime të kësaj fjale në mënyrë që feja të mos shkatërrohet,

besimi të mos bëhet diçka iluzore dhe traditat e mira të mos merren nëpër këmbë...

Enes b. Nadri dhe Enesët e tjerë i qëndruan fjalës. Ata e vërtetuan se ishin të drejtë dhe burra të fjalës. Sepse mësimet i patën marrë prej Muhammed Eminit, zotërisë së gjithësisë. Ashtu siç ishte ai vetë i drejtë e i besueshëm, ashtu edhe miqtë e tij e patën treguar veten të drejtë e të besueshëm!

Injoranca e pati njohur atë si të besueshëm

Mekasit i drejtoheshin atij jo me ndonjë fjalë abstrakte, por me atributin konkret "Emin", "I besueshëm". Me këtë atribut ishte bërë i njohur ai.

Ishte meremetuar Qabeja dhe vendosja sërish në vend e Gurit të Zi ishte shndërruar në një çështje të madhe. Fiset kishin zhveshur shpatat dhe secili prej tyre kërkonte të kishte nderin për ta vendosur atë në vend. Më në fund vendosën kështu: do të pranonin gjykimin e të parit njeri që do të hynte, pas atij çasti, në Qabe. Çdo njeri priste me kureshtje se kush do të hynte dhe, në këtë mes, i Dërguari i Allahut s'dinte gjë. Me t'u dukur fytyra e tij e ndritshme që rrezatonte besueshmëri si për mikun, ashtu edhe për armikun, njerëzit që pritnin u hodhën përpjetë nga gëzimi duke thirrur: "Emini po vjen!" Dhe i thanë se

do t'i nënshtroheshin pa kushte vendimit të tij...(70)
Ata i besonin atij plotësisht. Atë ditë ai ende nuk ishte ngarkuar me detyrën e profetësisë, por ishte një njeri të cilit i bindej çdokush dhe bartte mbi vete të gjitha atributet përkatëse të një profeti.

Po, virtyt është ai që ta pranojnë dhe vërtetojnë edhe armiqtë! Ja, pra, vërtetimi i drejtësisë së tij nga armiku më i tërbuar i tij i asaj dite!

Ishte koha kur Profeti po u bënte thirrje sunduesve përreth. Një letër i kishte dërguar edhe perandorit të Romës, Heraklitit. Perandori e lexoi letrën gjer në fund. Pastaj thirri Ebu Sufjanin që ndodhej atë radhë në Damask dhe midis tyre u zhvillua kjo bisedë:

- Cilët e respektojnë atë më shumë, të pasurit apo të varfërit?
- Të varfërit.
- A ndodhi që të kthehet pas ndonjëri prej atyre që e kanë besuar?
- Deri tani, jo.
- Ata që e ndjekin, shtohen apo pakësohen?
- Çdo ditë shtohen nga pak.
- A keni dëgjuar ndonjëherë që të ketë gënijer?
- Jo, asnjëri prej nesh s'e kemi dëgjuar ndonjëherë që

të ketë gënjyer! Ja, pra, Herakliti i tronditur nga ndikimi i letrës pas përgjigjeve të marra nga Ebu Sufjani, armiku më i pamëshirshëm i muslimanëve, tha kështu:

- Nuk mund të mendohet që njeriu që nuk ka thënë kurrë gënjeshtër për njerëzit, të gënjejë për Zotin!(71)

Në këtë ndodhi që e prekëm shumë shkurt vetëm për të përcjellur thelbin e saj lidhur me çështjen që po diskutojmë, ka dy argumente mbi drejtësinë e të Dërguarit të Allahut. I pari është fjala e thënë nga perandori romak dhe e dyta, përgjigjja e dhënë nga Ebu Sufjani i pandëruar ende atë ditë me Islamin, me anë të së cilës ai e pranon dhe e vërteton drejtësinë e të Dërguarit të Allahut. Ç'e do që Herakliti nuk pati mundur të kapërcente lidhjet me pozitën, nuk pati përfituar nga një "pasuri" e vërtetë dhe e amshuar që i pati ardhur gjer te këmbët dhe nuk pati mundur të bëhej musliman e të hynte në bashkësinë e fatlumturve. Pavarësisht nga kjo, fakti që e pati pranuar kumtesën e të Dërguarit të Allahut duke u sjellë me respekt, pati qenë një gjest mençurie nga ana e tij, kurse për ne, një pohim i gëzueshëm, pohimi i besnikërisë së të Dërguarit të Allahut!

Në fakt, thëniet e Heraklitit janë shumë të thella. Një njeri i cili gjer në moshën dyzet vjeç nuk ka gënjer edhe para njerëzve më të zakonshëm qoftë edhe për shaka, a mund të mendohet se ka gënjer para Zotit dhe në një periudhë kur qe rrethuar nga vdekja?

Jasiri ende nuk ishte bërë musliman. Një ditë e pyeti të birin, Ammarin se ku po shkonte.

- Te Muhammedi, - iu përgjigj Ammari.

Kjo përgjigje i kishte mjaftuar Jasirit:

- Ai është një njeri i besueshëm. Kështu e njohin mekasit atë. Nëse thotë se është pejgamber, e drejtë, ashtu është. Sepse askush nuk ka dëgjuar që ai të thotë ndonjë gënjeshtër!

Këto fjalë, këto miratime nuk u përkisnin vetëm disa vetëve. Njerëzit që e patën njohur atë para profetësisë si dhe në periudhën e pasme të dritës, të gjithë dhe unanimisht e patën vërtetuar drejtësinë e tij.

Ai pati këshilluar gjithmonë për drejtësi

Ashtu siç pati jetuar gjithmonë me drejtësi, edhe ummetin, bashkësinë e tij, e pati këshilluar gjithmonë për drejtësi. Dëshiroj të përmend këtu disa prej atyre këshillave:

"Më jepni fjalën për këto gjëra dhe unë t'ju jap fjalën për Xhennetin:

- Kur të flisni, flisni drejt!

- Kur të premtoni, çojeni premtimin në vend!

- Tregohuni të besueshëm në ruajtjen e amanetit!

- Ruani nderin!

- Mbyllni sytë para haramit (gjësë së ndaluar e që s'ju përket)!

- Mbani duart larg nga harami!(72) Po, ai gjithmonë drejt pati jetuar, drejtësinë pati këshilluar dhe me drejtësinë që ishte diçka e posaçme për të, pothuajse ishte afruar në një pikë mes mundësisë dhe domosdoshmërisë, në një pikë të tillë, pas së cilës qëndronte vetëm e vetëm besnikëria e Allahut. Me fjalë të tjera, në drejtësi, i Dërguari i Allahut shihte nga horizonti afër sa dy kut. (Kur'ani, Nexhm: 9). Në një aspekt, ai ndodhej në kuadrin e mundësisë, kurse në një aspekt tjetër, e pati kapërcyer botën e mundësisë. Me rastin e Miraxhit, siç ka thënë edhe Kadi Ijazi, ai erdhi në një vend ku nuk po dinte se ku ta vendoste këmbën. Atij iu tha që ta vendoste njërën këmbë mbi tjetrën. Gjithsesi, në çdo specifikë ai ishte një njeri. Mirëpo drejtësia në një nivel të tillë e pati lartësuar atë. Edhe ne një të

tillë drejtësi na këshillon ai: "Jepni fjalën se do të flisni drejt, se nuk do të fusni në jetën tuaj gënjeshtërën që edhe unë t'ju premtoj xhennetin!"

Edhe në një tjetër porosi të tij kështu urdhëron: "Hiqni dorë nga gjërat që përmbajnë dyshime. Drejtësia prodhon në brendësi të njeriut siguri dhe qëndrueshmëri, kurse gënjeshtria është shtrembërim, është turbullirë."(73)

Dhe prapë urdhëron: "Kërkoni vazhdimisht drejtësinë! Edhe nëse në drejtësi shihni shkatërrimin tuaj, pa asnjë diskutim që aty është shpëtimi juaj!"(74)

Edhe në një porosi tjetër po kështu konkludon: "Mos u ndani nga e drejta. E drejta ju çon në mirësi, kurse mirësia në xhennet. Nëse personi tregohet i drejtë dhe e kërkon të drejtën, shkruhet mes besnikëve në lartësinë e Allahut.

Ruhuni nga gënjeshtria. Gënjeshtria e çon njeriun në mëkat, kurse mëkati në xhehennem. Nëse personi vazhdimisht gënjen dhe e kërkon gënjeshtërën, shkruhet si gënjeshtar në lartësinë e Allahut!"(75)

Shpëtimi dhe fundi i mirë janë te drejtësia. Edhe sikur njeriu të vdesë duke thënë të drejtën, një herë vdes, kurse çdo gënjeshtër është një vdekje më vete!

Ka'b b. Malik thotë: "Unë shpëtova në sajë të drejtësisë sime." Po, kur thuhet "drejtësi", është e pamundur të mos e kujtosh atë.

Ka'b b. Malik ishte një njeri me fjalën të mprehtë si shpata dhe me shpatën të mprehtë sa fjala. Ishte poet. Me poezitë e tij mund ta kthente përmbys botën morale të njerëzve...

Pat ardhur në Akabe dhe i pati dhënë besën të Dërguarit të Allahut. Për rrjedhojë, pati qenë ndër parësinë e Medinës. Por nuk pati marrë pjesë në luftën e Tebukut. Tebukun pati qenë një luftë e vështirë. Në atë luftë, një grusht njerëzish do të përleshesh me armatën e Perandorisë Romake. Dhe ku, pikërisht në të nxehtët përvëlues e shfarosës të shkretëtirës! Me atë mendim u bë nisja për atje, u tregua ajo trimëri e jashtëzakonshme për t'u nisur, u fitua ajo mirësi, por ajo luftë e frikshme vetëm në mendime mbeti.

Ndërsa Profeti të gjitha fushatat luftarake i mbante të fshehta, atë radhë që nisur haptas dhe çdo njeri e pati ftuar haptas. Ja, pra, me gjithë këtë ftesë të hapët, Ka'bi atë radhë nuk pati mundur të merrte pjesë.

Dhe tani le ta tregojmë shkurt aventurën e tij nga goja e tij:

"Të gjithë u ftuan për në luftë. Sepse përplasja do të ishte e ashpër. Por Allahu nuk e miratoi dhe lufta mbeti vetëm si një nismë. I ishte bërë apo jo e ditur, i Dërguari i Allahut i jepte një rëndësi të veçantë asaj lufte.

Ashtu si çdokush, edhe unë i përfundova përgatitjet. Madje, si atë radhë s'isha përgatitur për asnjë luftë tjetër gjer atë ditë.

Profeti i të Dy Botëve dha urdhër për nisje dhe ushtria u nis. Unë nuk dola bashkë me të tjerët duke thënë me vete se, sido që të ishte, do t'i arrija ata. Dhe nuk kisha ndonjë punë. Por më pengonte vetësiguria. Hë sot, hë nesër, kur ç'të shohësh, ditët ikën si pa u kuptuar. Tani më ishte e pamundur ta arrija të Dërguarin e Allahut. Kisha mbetur i detyruar të prisja dhe prita. Dhe prita çdo orë në një pritje që zgjati me ditë.

Më në fund filloi të dëgjohej nga të gjitha anët se Profeti po kthehej. Kështu ndodhte çdo radhë. Afër kthimit të tij Medina gjallërohej edhe një herë tjetër. Ja, tani, në sytë e çdokujt kishte një gëzim: po kthehej i Dërguari i Allahut!

Më në fund, erdhi koha e shumëpritur. Ushtria u kthye në Medinë. Edhe Profeti, ashtu siç ishte bërë rregull, fillimisht kishte shkuar në faltore, kishte falur dy reqate namaz dhe kishte nisur takimet me popullin. Njerëzit shkonin në faltore grupe-grupe, e vizitonin, kurse ata që s'kishin marrë pjesë në ushtri, i kërkonin falje. Edhe shumica e atyre që ndodheshin në gjendjen time, kishin paraqitur justifikime që ishin pranuar nga i Dërguari i Allahut. Edhe unë mund të bëja një gjë të tillë. Mes tyre, unë isha një ndër më të aftët për të folur dhe me fuqinë bindëse më të madhe. Mirëpo si mund të ndodhte që, duke mos pasur asnjë justifikim, ta gënjeja të Dërguarin e Allahut? Nuk e bëra një gjë të tillë. Nuk munda ta bëja! Kur u takuam, Profeti më priti me një buzëqeshje të rrudhur që ma shpoi zemrën tej e tej. Dhe më pyeti: "Ku ishe?" Ia tregova situatën ashtu siç ishte, pa lënë gjë mangut. E ktheu kokën anash dhe më tha me majë të gjuhës: "Ngreu, shko!"

Dola jashtë. Më rrethoi fisi im: "Gjej dhe ti një justifikim e shpëto!" Për një moment sikur fjalët e tyre më zunë vend në zemër. Mirëpo erdha menjëherë në vete dhe pyeta: "A ka të tjerë në gjendjen time?" "Ka", më thanë dhe më përmendën

dy emra. Që të dy kishin marrë pjesë në Bedër dhe ishin ndër sahabet, pasuesit profetikë me emër e me zë: Muare b. Rebi dhe Hilal b. Umejje. Edhe ata nuk kishin paraqitur asnjë justifikim dhe kishin rënë në pozitën time. Kishin mbetur në pritje. Për mua ishin njerëz që mund t'u shkoje pas, prandaj vendosa të bëj si ata dhe hoqa dorë nga gjetja e një justifikimi.

U shpall një urdhër për ne të tre. Tanimë asnjë musliman nuk do të takohej e të bisedonte me ne. Dy shokët e mi u mbyllën nëpër shtëpitë dhe qanin natë e ditë. Unë isha i ri e i fuqishëm. Dilja në treg, në sokak dhe mund të hyja edhe në faltore në kohët e namazeve. Vetëm se me mua asnjëri nuk bisedonte. Shumicën e kohës e kaloja në faltore. Ndodhte që të prisja shumë gjatë për të mundur të kapja një buzëqeshje nga i Dërguari i Allahut. Por ç'e do që çdo ditë kthehesha në shtëpi vetëm me vetminë time. Ai, të cilit kurrë nuk i mungonte buzëqeshja në fytyrë, qoftë edhe një herë të vetme nuk m'i kishte hedhur sytë të më buzëqeshte! I jepja selam dhe ia ngulja sytë buzëve të tij se mos dalloja ndonjë lëvizje, por më kot!

Gjatë namazit shumë herë e shihja atë me bisht të syrit. I hidhte sytë nga unë kur filloja të falesha,

por, sapo mbaronte namazi, menjëherë i hiqte sytë. Kështu do të vazhdonte plot dyzet ditë. Njerëzit dhe vendi ku ndodhesha më ishin bërë të huaj në atë mënyrë, sa që fillova të pandehja se ndodhesha në një vend të huaj.

Një ditë u hodha nga muri i avllisë drejt e në bahçen e Ebu Katades, djalit të xhaxhait, të cilin e doja shumë e që edhe ai më donte me shpirt. I dhashë selam, por nuk reagoi fare. E pyeta: "Më thuaj, për Zotin, a e beson që e dua të Dërguarin e Allahut?" Nuk m'u përgjigj fare. Ia përsërita tri herë pyetjen. Pas herës së tretë, më tha: "I Dërguari i Allahut e di!" Vetëm kaq dhe u largua. Më ishte shembur bota mbi krye! Nuk i prisja kurrë këto fjalë prej Ebu Katades! M'u mbushën sytë dhe fillova të qaja me ngashërim.

Një ditë tjetër, duke u vërtitur i vetëm sokakëve të Medinës, dëgjova një njeri të pyeste për mua. Personat që kishte pyetur, i kishin bërë me shenjë nga unë. Njeriu më erdhi pranë dhe në dorë mbante një letër që ishte për mua. Vinte nga sundimtari i Gassanit. Sundimtari më ftonte në vendin e tij. Më shkruante: "Dëgjova se ytzot të ka braktisur të vetëm. Eja tek ne. Njerëzve si ti pranë nesh u rritet

vlera..." "Edhe kjo një provë" - thashë me vete, e grisa letrën dhe e hodha në zjarr.

Ishte dita e dyzetë. I Dërguari i Allahut më kishte dërguar një njeri. Njeriu thoshte se duhet të rrinim larg nga gratë. "Ç'të bëj, a ta ndaj?" - e pyeta. "Vetëm rriji larg" - më tha dhe shkoi. I thashë gruas të shkonte te prindët. Në këtë mes, gruaja e Hilalit kishte shkuar te Profeti e i kishte kërkuar leje t'i rrinte të shoqit pranë për t'i shërbyer, pasi ishte plak dhe nuk i përgjigjej detyrës së tij si burrë. Dhe i Dërguari i Allahut i kishte dhënë leje. Disa më thanë që edhe unë të kërkoja leje. Por unë nuk pranova, pasi nuk e dija se si do ta priste Ai një kërkesë të tillë.

Kaluan ditë dhe u mbushën pesëdhjetë. Kisha arritur në një pikë që më ishte mbaruar durimi. Më ishte nxirë bota dhe më ishte bërë varr. Si çdo ditë, edhe atë mëngjes, pasi kisha falur namazin, po rrija në ballkon. Dëgjova se dikush po përmendte emrin tim me zë të lartë: "Myzhde, o Ka'b!" E kuptova si qëndronte puna. Menjëherë rashë në sexhde. Atë ditë, pas namazit të agimit, i Dërguari i Allahut kishte shpallur faljen tonë. Shkova në faltore. Të gjithë u ngritën në këmbë dhe po më uronin. Talhai m'u hodh në qafë e po më puthte. Sikur po përjetoja

sërisht një Akabe! I shkova pranë Profetit dhe ia kapa dorën. Edhe ai ma kapi. Pandehja se nuk do të ishte gëzuar më shumë edhe sikur ta kishin uruar për xhennetin. I Dërguari i Allahut urdhëroi: "Allahu ju fali!" Dhe këndoi ajetin e zbritur për ne:

"Dhe Allahu pranoi edhe pendimin e atyre të treve. Toka u ishte ngushtuar aq shumë, edhe shpirtrat u ishin ngushtuar aq shumë, sa ishin bindur se nuk ka strehim tjetër veç Allahut. Allahu e pranon pendimin, është mëshirues i madh!" (Kur'ani, Tevbe: 118).

Pas këndimit të ajetit, iu drejtova Profetit: "O i Dërguari i Allahut! Mua e drejta më shpëtoi! Jap fjalën se sa të jem gjallë, do të them vetëm të drejtën e të vërtetën!"(76)

Po, e vërteta profetike që e quajtmë "besnikëri", qëndron mbi fundamentin "vërtetësi dhe drejtësi". Çdo profet flet drejt. Dhe kjo gjë është e detyrueshme. Sepse, po që që në cilindo prej këtyre personave që sjellin nga bota e panjohur urdhra dhe ua kumtojnë njerëzve, do të ndodhte edhe gabimi ose shtrembërimi më i vogël, çdo gjë do të kthehej me kokë poshtë. Të gjitha të vërtetat që na duhet t'i mësojmë në emër të njerëzimit, me anë të profetëve

na përcillen. Dhe kjo është një çështje shumë delikate që s'lejon shtrembërim as sa grimca. Prandaj edhe Providenca Hyjnore urdhëron kështu lidhur me këtë çështje: "Sikur të trillonte ai (Muhammedi) për Ne ndonjë fjalë, do ta mbërthenim me forcë, do t'ia këputnim aortën dhe askush prej jush nuk do të mund t'i dilte në mbrojtje!" (Kur'ani, Hakka: 44-47).

Përballë urdhrave dhe ndalimeve hyjnore Profeti ishte si i vdekuri në duart e larësit të kufomave. Revelacioni e vërtiste atë nga të donte dhe Profeti atë kahje merrte. Nga kjo ndjeshmëri dhe bindje e pakufishme ai s'kishte humbur asgjë edhe kur kishte fituar intimitetin hyjnor dhe kishte arritur në pikën e fundit. Jo që s'kishte humbur, por e kishte thelluar edhe më atë ndjeshmëri duke e kthyer në diçka të patjetërsueshme!

Ai pati qenë burrë i fjalës

Gjer në moshën dyzetvjeçare askush nuk kishte dëgjuar e parë që ai të thoshte ndonjë gjë kontradiktore apo të mos qëndronte në fjalë. Një person që kishte fituar nderin të bëhej pasues i tij më vonë, tregon: "Ishte periudha e injorancës. Ishim marrë vesh me të Dërguarin e Allahut që të takoheshim në një vend. (Siç kam theksuar edhe në

krye, ashtu quhej ajo periudhë, kurse Profeti nuk e pati jetuar atë në veçoritë e saj, por pati ndjekur një vijë tjetër jetese, të posaçme vetëm për profetët). Mirëpo unë e harrova fjalën e dhënë. Kur u kujtova pas tri ditësh, shkova me vrap atje ku e kishim lënë takimin dhe pashë se i Dërguari i Allahut po më priste! As u nxeh e as m'u zemërua. Më tha vetëm kaq: "O djalë i ri! Më mundove! Kam tri ditë që të pres këtu!"(77)

-
- (65) Myslim, Fezailu's-Sahabe, 143.
(66) Buhari, Megazi, 11; Ibni Maxhe, Mukaddime, 11.
(67) Buhari, Zekat, 54.
(68) Myslim, Xhihad, 101, 105; Buhari, Enbija, 54.
(69) Myslim, Imare, 148.
(70) Mysned, 3/425; Ibni Hisham, 1/209.
(71) Buhari, Bedu'l-Vahj, 6.
(72) Mysned, 5/323.
(73) Tirmizi, Kijame, 60; Mysned, 1/200.
(74) Kenzu'l-Ummal, 3/344; Fejzu'l-Kadir, 3/232.
(75) Buhari, Edeb, 69; Myslim, Birr, 105.
(76) Buhari, Megazi, 79; Myslim, Tevbe, 53.

(77) Ebu Davud, Edeb, 82. (Personi i përmendur është Abdullah b. Ebi'l-Hamsa).

Fjalet e Vertetojne Ate

Ai ishte që në lindje Hz. Muhammed Mustafa (s.a.v.)! Prandaj, edhe pasi iu shpall profetësia, çdo njeri e besoi nga zemra për çfarëdo që tha dhe e vërtetoi atë. Po, njerëzimi si një i vetëm vrapoi t'ia vërtetonte fjalët: "Drejt po thua, o i Dërguari i Allahut!" Jo vetëm njerëzit. Çdo formë e ekzistencës, me gjuhën e mrekullive, i dërgoi atij një përfaqësues dhe i dha besën!

Këtu mendoj se do të ishte e dobishme të hapja një parantezë. Deklaratat dhe shprehjet e ndritshme të Kur'anit dhe të Profetit, me cilësinë e tyre të përputhjes ndaj marrëdhënieve midis individualitetit, attributeve dhe emrave të Providencës Hyjnore, zotërojnë një nivel të lartë të tillë të cilit është e pamundur t'i afrohet ndonjë shprehje apo deklaratë e bërë me rrugën logjike të filozofëve apo me dimensionet shpirtërore të të urtëve e të shenjtoreve dhe as që do të jetë e mundur.

Ngjitja lart drejt engjëllizimit e këtyre shpirttrave të evoluar, në përfundim ka treguar e do të tregojë gjithmonë këtë që ata do ta njohin vërtetësinë dhe përsosmërinë e deklaratave të Kur'anit e të të Dërguarit të Allahut, do të ndjejnë kënaqësi në zbulimin dhe vëzhgimin e tyre.

Të gjitha fjalët e thëna prej Tij mbi hyjnitetin, po vërtetohen sot prej kompetentëve të asaj tematike dhe po pranohen si nga një fundament më vete. Madje Ai ka bërë fjalë për çështje të tilla të imta lidhur me hyjnitetin, grumbullimin dhe shpërndarjen e njerëzve ditën e ringjalljes* dhe kaderin, paracaktimin hyjnor - duke ruajtur edhe drejtpeshimin midis tyre - saqë jo vetëm nuk mund t'i rrokë mendja e të parëve dhe e të pasmëve, por, sikur t'i supozonim të paqena deklaratat e ndritshme të Tij, në këto specifika ata s'do të kenë mundësi të thonë qoftë edhe një fjalë të vetme!

Hz. Omeri tregon: "Një ditë, pas namazit të agimit, i Dërguari i Allahut u ngjit në minber dhe foli e foli gjatë. U këndua ezani i mesditës, Profeti drejtoi faljen dhe u ngjit prapë e foli gjersa erdhi koha e pasdites. Pas përfundimit të namazit të pasdites foli prapë gjer në mbrëmje. Për çfarë foli, çfarë tregoi?"

Eshhtë e vështirë të thuhet për gjithçka, por mund të thuhet se preku çdo çështje të padiskutuar gjer atë ditë." Po, kishte filluar nga krijimi i parë, kishte treguar për hedhjen e farës së parë të krijimit në "mitrën" e qenies, kishte folur për trajtësimin e gjithësisë, kishte radhitur një e nga një të gjitha epokat e krijimit gjer te krijimi i njeriut dhe më pas kishte përcjellur te dëgjuesit një e nga një ngjarjet që do t'u bien në kokë njerëzve gjer në kiamet, në ditën e katastrofës së përgjithshme dhe ringjalljes.(78)

Po, ishte zhytur në thellësitë e së shkuarës dhe kishte treguar për të gjithë profetët gjer te Hz. Ademi, madje duke i portretizuar; pastaj, duke e kthyer shikimin në të ardhmen, kishte shpalosur para syve të dëgjuesve çdo gjë gjer te ringjallja, xhenneti dhe xhehennemi.

Mirëpo ai as libër s'kishte lexuar, as dhe në mësimet e dikujt kishte marrë pjesë. Atëherë, si mundej t'i dinte të gjitha këto? Mundej, sepse ishte dikush që ia mësonte dhe se ai ishte, pa asnjë dyshim, Allahu që di çdo gjë!..

Të gjitha çështjet e shpjeguara prej tij, nga qielli te njeriu e gjer te thellësitë e tokës, Oratori i Amshuar ia mësonte atij. Edhe nga njerëzit e sotëm

pranohet se ndryshe s'kishte sesi t'i mësonte, gjë që, njëkohësisht, është argument më vete për drejtësinë dhe besnikërinë e Hz. Muhammedit (s.a.v.).

Ai fliste për profetët, i karakterizonte, i portretizonte dhe adhuruesit e librit (krishterët dhe çifutët) e asaj kohe i pranonin të gjitha këto pa bërë asnjë lloj kundërshtimi e pa shfaqur ndonjë pretendim dhe thoshin: "Po, këto gjëra i gjejmë në librat tanë në atë trajtë që i thatë ju!"(79) A nuk është dëshmitar dhe argument për besnikërinë e të Dërguarit të Allahut dhe drejtësinë e vërtetësinë e kauzës së tij fakti që një njeri i cili s'ka lexuar as Teuratin (Testamentin e Vjetër) e Ungjillin e as ndonjë libër tjetër, të flasë mbi të gjithë profetët paraardhës të përmendur në ato libra me të gjitha cilësitë e tyre, madje me hollësi dhe fakti që për këtë ka marrë miratimin e kompetentëve të fushës përkatëse?

Parashtrimi i këtyre specifikave që u përpoqëm ta bëjmë brenda një paranteze, i kapërcen shumë mundësitë e mia. Në fakt, edhe gjendja e lexuesit me mundësi sa të miat, nuk duhet të jetë e ndryshme nga e imja. Që të mund të kuptohen e të trajtohen çështje si kjo, njeriu duhet të jetë i nivelit që të mund

të bëjë vlerësimin e tyre. Vetëm se ne, duke u mbështetur në fjalët e personave për të cilët besojmë se janë ngjitur në një nivel të tillë, themi se fakti që qindra mijëra të urtë e shenjtorë të ngjitur shkallë-shkallë drejt përsosmërisë shpirtërore si dhe filozofë e shkencëtarë që e kanë ndriçuar mendjen me dituri, kur i shohin deklaratat e Profetit tonë, pranojnë se deklarata e tij qëndron vazhdimisht në kulmin e çështjes përkatëse, përbën një dimension tjetër të drejtësisë, vërtetësisë dhe besnikërisë së Tij. Po, edhe miratimi i këtyre njerëzve të zgjedhur tregon se në asnjë fjalë të tij ai s'ka thënë ndonjë gjë kontradiktore. Në fund të fundit, fjalët e tij s'kanë qenë fjalët e tij...Ai ka folur gjithmonë në bazë të mesazheve hyjnore, ka bërë përkthimin e revelacionit, prandaj edhe është bërë Mbreti i Fjalës për të gjitha vendet dhe kohët.(80)

Specifika mbi të cilën do të përqëndrohemi në këtu, është fakti që disa ngjarje të së ardhmes për të cilat ai pati bërë fjalë katërmbëdhjetë shekuj më parë, u realizuan identikisht kur u erdhi koha, gjë që përbën një tjetër argument për vërtetësinë, drejtësinë dhe besnikërinë e thënieve të tij ndaj së vërtetës. Vetëm mendojmë se, pa hyrë ende në temë, do të

ishite e dobishme të bënim shpjegime mbi një çështje e cila është interpretimi indryshëm i të fshehtës.(*)
Po, edhe kjo është ndër ato çështjet e imta që duhen ndjekur me kujdes.

(78) Myslim, Fiten, 25; Mysned, 5/341.

(79) Myslim, Iman, 271.

(80) "Ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur'ani) s'është gjë tjetër veçse mesazhi hyjnor që i është reveluar."

(Kur'ani, Nexhm: 3-4).

(*) Në origjinal: gajb

Mbi Çështjen e se Fshehtes

Fjala "e fshehta" (gajb) trajtohet në Kur'an në ajete të ndryshme e në forma të ndryshme.

"Çelësat e së fshehtës janë tek Ai. Vetëm Ai e di të fshehtën. Ai e di se ç'ka në tokë e në det, Ai di për çdo gjeth që bie dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë e s'ka të thatë që s'është shënuar në librin e qartë!" (Kur'ani, En'am: 59). Në këtë ajet thuhet se e fshehta ndodhet plotësisht në lartësinë hyjnore të Allahut dhe se askush përveç Tij (përfshi

edhe Hz. Muhammedin) nuk mund ta dijë të fshehtë.

"Thuaj: "Unë nuk ju them se kam në dorë thesaret e Allahut dhe se e njoh të fshehtë. As po ju them se jam engjëll. Unë bëj vetëm ashtu siç më thuhet." Thuaj: "A janë të barabartë i verbëri me atë që sheh?" A nuk po mendoni?" (Kur'ani, En'am: 50).

"Thuaj: "Përveç dëshirës së Allahut, nuk kam në dorë ndonjë forcë për t'i sjellë dobi ose dëm vetes. Po ta dija të fshehtë, do të bëja më tepër dobi për vete dhe s'do të më prekte asnjë e keqe. Unë jam vetëm një paralajmërues dhe myzhdedhënës për njerëzit që besojnë." (Kur'ani, A'raf: 188).

Kurse në kreun "Xhin" thuhet kështu: "Eshtë Ai që e di të gjithë të fshehtë që nuk ia zbulon askujt përveç ndonjë të Dërguari që do. Atëherë Ai vë rojë edhe para, edhe prapa tij që ata ta kuptojnë se i dërguari ka kumtuar fjalët e Zotit të tij dhe se Allahu ka përfshirë dhe shënon çdo gjë që ndodh rreth tij." (Kur'ani, Xhin: 26-28).

Tani, nën dritën e këtyre ajeteve, mund të bëjmë një ndarje të tillë: "I Dërguari i Allahut e njihnte absolutisht të fshehtë." Dhe "I Dërguari i Allahut absolutisht nuk e njihnte të fshehtë." Këto janë dy

vlerësime ose konkluzione ekstreme: i pari, një pohim absolut dhe, i dyti, një mohim absolut. Në të vërtetë, ai vetë nuk e njihte të fshehtën, por, në sajë të njoftimit të Allahut, arrinte ta njihte në atë mënyrë, saqë, sikur të rrinte para një ekrani, u shpaloste njerëzve para syve në vijat kryesore dhe me parimet themelore, të gjitha ngjarjet që do të ndodhnin gjer në Kiamet. Kjo është edhe çështja mbi të cilën ne kërkojmë të qëndrojmë në mënyrë të posaçme. Ai nuk thoshte diçka nga vetja e tij; ato që thoshte, ishin gjithmonë revelacioni dhe njoftimet e Zotit. Pas Zotit si njoftues, jo vetëm profetët dhe Profeti ynë, por edhe një pjesë njerëzish të avancuar mund të bëhen pjesëtarë të së fshehtës si shprehje e lartësimit të tyre shpirtëror. Me të vërtetë, i Dërguari i Allahut pohon: "Mes ummetit tim ka një pjesë njerëzish të frymëzuar",⁽⁸¹⁾ ku nënkuptohen njerëzit e denjë për frymëzimin hyjnor. Lidhur me këtë çështje, le të kujtojmë sesi Hz. Omeri që po mbante hutben (ligjëratën) në minber, sheh, prej aty ku është, sesi ushtria Islame po rrethohet pas malit prej ushtarëve armiq dhe i flet tri herë komandantit Sarije: "O Sarije, nga ana e malit!" Komandanti e dëgjon zërin dhe e çan rrethimin...⁽⁸²⁾ Po ashtu,

persona si Muhedini Arabiu që kanë aluduar për ngjarje që do të ndodhnin identikisht shekuj më vonë, qindra persona si Mevlanai, (*) Imami Rabbaniu, Myshtak Efendiu që kanë paralajmëruar lidhur me të ardhmen. Fakti që të gjithë këta kanë parashikuar të ardhmen, që kanë treguar besnikëri nga zemra për të Dërguarin e Allahut dhe që kanë pohuar se e gjithë pasuria e frymëzimit të tyre për të cilën janë bërë të denjë, rrjedh prej burimit dritësor Muhammedian, tregon se - me lejen e Allahut - sa i hapur ndaj së fshehtës ka qenë Ai! Po, nëse ata që përgatiti Ai, bëhen të denjë për frymëzime të tilla dhe të aftë për të kapur frymërat hyjnore dhe, në këtë dimension, bëhen pjesëtarë të së fshehtës, përse të duket me mundësi të largët pjesëtaria ndaj të fshehtës - si një mrekulli kjo - e Profetit të të Dy Botëve i cili do të peshonte më rëndë nëse ai vihej në një anë të peshores dhe i gjithë ummeti i tij në anën tjetër? (83)

Ekzistojnë afro treqind të tilla mrekulli të Profetit, të përmendura në librat e shquar të hadithit. Këto janë njoftime të së fshehtës, nga të cilat një pjesë e madhe janë realizuar identikisht dhe një pjesë tjetër presin kohën për t'u realizuar e vërtetuar. Ne

këtu nuk do t'i përcjellim të gjitha këto. Mendojmë të mjaftohemi vetëm me disa raste tipike për të dhënë një ide; këto raste mund t'i ndajmë në tre grupe kryesore:

I pari: Njoftimet e së fshehtës përkatëse të periudhës së vet.

I dyti: Thëniet mbi të ardhmen e afërt dhe të largët.

I treti: Deklaratat mrekullishprehëse të pohuara me një stil figurativ, e vërteta e të cilave është kuptuar më vonë me zbulimet shkencore.

-
- (81) Myslim, Fezailu's-Sahabe, 23.
(82) Kenzu'l-Ummal, 12/571.
(* Poeti i shquar Xhelaledin Rumi.
(83) Ebu Davud, Synne, 8; Mysned, 2/76

NJOFTIMET E FSHEHTA

Për kohën e vet

I. Të gjithë librat e hadithit me Buhariun dhe Myslimin në krye, përcjellin unanimitisht këto raste të veçanta:

Një ditë, i Dërguari i Allahut ngjitet në minber, në vendin e predikimit, dhe, me vështrimin në horizontin e botëve të fshehta, mes shfaqjeve sublime të zbuluara vrullshëm, i ofron xhemaatit buqeta të rejash. Një moment u thotë njerëzve: "Sot më pyetni çfarë të doni!" Pas kësaj, të gjithë fillojnë të pyesin dhe ai 'u përgjigjet. Mes të tjerëve, ngrihet në këmbë një djalë i ri dhe e pyet: "Kush është im atë, O i Dërguari i Allahut?" Siç duket, qoftë edhe pak, qarkullonin thashetheme për atësinë e tij, gjë që e shqetësonte djalin. Djali kishte shfrytëzuar rastin dhe e kishte pyetur Profetin, sytë e të cilit, me leje të Allahut, qëndronin hapur ndaj të fshehtës. Profeti i përgjigjet: "Babai yt është Huzafe!" Më në fund, djali është i qetë, sepse përgjigjja e ka kënaqur. Tashmë ai do të quhet pa asnjë kundërshtim Abdullah b. Huzafetu's-Sehmi. Kështu, pra, në çastet kur secili pyeste diçka, është dikush që e kupton shumë mirë situatën shpirtërore të të Dërguarit të Allahut. Është Omeri që ngrihet menjëherë në këmbë dhe thotë:

"Ne jemi të kënaqur me Allahun, Zotin tonë, me Islamin, fenë tonë dhe Hz. Muhamedin, peygamberin tonë!" Ky reagimi i tij i hollë e kuptimplotë i zgjeron rrugëkalimet e frymërave të sigurisë që fryjnë në ndjesitë e të Dërguarit të Allahut dhe, ndërkaq, shfaqjet sublime ia lënë vendin frymërave intime.

Kjo ngjarje pati ndodhur në prani të sahabëve që patën mbushur atë ditë faltoren. Të gjithë sahabet i vërtetonin thëniet e të Dërguarit të Allahut dhe me qetësinë e tyre sikur thoshin: "Sadakte!", "Drejt fole!"³⁴

2. Myslimi na përcjell: Hz. Omeri, rrëfyesi i ngjarjes së mëposhtine, thotë: "Ndodheshim në Bedr. I Dërguari i Allahut e kishte përcaktuar plotësisht strategjinë e luftës dhe po kalonte nëpër vendet ku do të zhvilloheshin ngjarjet. Një moment, kur sytë poi shihnin përtej perdeve të hapura të së fshehtës dhe vështrimin e kishte hedhur në horizontin e së ardhmes, nisi të shënojë me gisht: "Këtu do të vritet Ebu Xhehli, atje do të bjerë Shejbe, kurse atje, Velidi..." Dhe përmendi edhe emra të tjerë." Pas lufte Hz. Omeri betohej: "I

gjetëm njerëzit e përmendur prej të Dërguarit të Allahut të vdekur atje ku pati vënë gishtin ai!"³⁵ Po, këta njerëz që nuk e kishin vërtetuar Hz. Muhamedin me gojë në të gjallë, tani dëshmonin për drejtësinë dhe besnikërinë e tij ndaj së vërtetës me anë të kufomave të tyre të mjera! Nëse ai lajmëronte për diçka, thënie e tij vërtetoheshin pa u shmangur asnjë centimetër! ' I Dërguari i Allahut po rrinte në faltore së bashku me sahabet, pasuesit e tij. Një çast ai tha: "Pas pak nga kjo portë do të hyjë këtu një njeri me pamje e fytyrë të pastër. Ai është nga njerëzit më të bekuar të Jemenit dhe në ballë bart shenjën e përshkimit të dorës së engjëllit." Pas pak, pikërisht siç pati thënë i Dërguari i Allahut, hyri një njeri, u ul në gjunjë para Tij dhe deklaroi se ishte bërë musliman. Ishte Xherir b. Abdillahi el-Bexheli, ky monument kulture dhe edukate!"⁶

4. Në veprën "Delailu'n-Nubuve" të Bejhakiut përcillet kjo ngjarje:

Ebu Sufjani që bërë musliman kur që triumfuar Meka, vetëm se besimi nuk i pati zënë vend plotësisht në zemër. Ndërsa i Dërguari i Allahut po

bënte "tavaf" rreth Qabes, edhe Ebu Sufjani vinte rrotull aty pari.

Një çast dhe Ebu Sufjanit i shkon nëpërmend: "Ç'bëhet, vallë, sikur të mbledh edhe një ushtri e t' i dal para këtij?" Pikërisht atë çast i Dërguari i Allahut i afrohet, i përkulet dhe i thotë në vesh: "Përsëri kemi për të të mundur!" Ebu Sufjani e kishte kuptuar tashmë të vërtetën! Besimi i lëkundur gjer atë çast në zemër, _zë vend dhe Ebu Sufjani hidhet përpjetë duke thënë: "I kërkoj falje Allahut!"³⁷

Kush ia kishte bërë të ditur Profetit ç'kishte menduar atë çast Ebu Sufjani? Me ç' i kishte ndodhur, Ebu Sufjani bëhej dëshmitar se Muhamedi ishte i Dërguari i Allahut që thoshte gjithmonë të drejtën e të vërtetën!

5. Po kështu, në librat e shquar të hadithit përcillet një ngjarje e tillë:

Umejr b. Vehb, i cili mes sahabëve; pasuesve të Profetit, cilësohej si "Ruhbanu'l-Islam", "Shenjtori Islam", në periudhën e injorancës konsiderohej "njeriu-djall" Një ditë ky ulet. bisedon dhe merret vesh me Safvan b. Umejjen që vetë do të shtirej si musliman, do të shkonte në Medinë dhe do ta vriste

të Dërguarin e Allahut. Për këtë, Safvan b. Umejje do t'i jepte si shpërblim një numër të caktuar devesh. Umejri e mprehu këllëcin dhe u vu për udhë. Kur arriti në Medinë, tha se ishte bërë musliman dhe se donte t' i jepte besën të Dërguarit të Allahut. E morën dhe e çuan në faltore. Por sahabet nuk kishin aspak besim te Umejri. Prandaj edhe askush nuk donte ta linte atë vetëm me të Dërguarin e Allahut. Të gjithë ishin vendosur përreth Tij si një kala prej mishi dhe eshtrash. Kur Umejri hyri në faltore, i Dërguari i Allahut e pyeti pse kishte ardhur. Umejri shqiptoi një sërë gënjeshtresh, por me asnjërën prej tyre nuk mundi ta bindte të Dërguarin e Allahut, i cili, më në fund, iu drejtua: "Meqë ti s'po e thua të vërtetën, atëherë po ta them unë: Ti u more vesh në filan vend me Safvanin dhe erdhe për të më vrarë mua. Për këtë nga Safvani do të merrje kaq kokë deve."

Umejri u shtang sikur ta kishin goditur në kokë. U ul në gjunjë para të Dërguarit të Allahut, ia mori duart dhe u bë musliman." Pas kësaj, ashtu e dha veten pas adhurimit, saqë mes sahabëve thirrej "i shenjte"

Nga e pati dëgjuar i Dërguari i Allahut bisedën midis Umejrit dhe Safvanit? Kush ia kishte sjellë atij që larg këtë lajm?¹

Për të ardhmen në një kohë të afërt

!. Buhariu dhe Myslimi përcjellin sipas Hz. Usames si më Poshtë.

Usame ishte i biri i Zejd b. Harisesë. I Dërguari i Allahut e donte

shumë Usamen dhe nuk e ndante prej vetes. Kur i merrte në njërin gju Hz. Hasanin ose Hysenin, në gjurin tjetër pa tjetër do të merrte Usamen."o Një

⁸⁶.Mysned, 41360, 364.

Tavaf: Adhurimi i Qabes duke i ardhur qark.
' Ibnî Krthir el-Bidaie. 41348. Bejhaki,
Delailu'n-Nubuue. 5/102.Halid Muhammed
Halid, ijhalun Havle'r-Rasul, f. 401.

radhë, duke i pasur parasysh të tre këta, ishte lutur: "Allahu im! Trego mëshirë për këta siç tregoj dhembshuri unë!" Profeti jetonte ditët e fundit të jetës kur e pati caktuar Usamen si komandant të ushtrisë muslimane kundër Bizantit dhe po i jepte si amanet detyrën për t'ua treguar vendin dushmanëve të Allahut në . ato toka ku vite më parë kishte rënë dëshmor i ati, Zejd. Por, kur Usame pati parë se gjendja shëndetësore e Profetit ishte rënduar, e pati ndalur ushtrinë dhe nuk pati lëvizur nga vendi gjer në vdekje të Tij ,” Ia, pra, ky Usame thotë kështu: "Një ditë ndodhesha bashkë me të Dërguarin e Allahut. Ai kishte dalë në ballkonin e njëres prej ndërtesave të larta dhe vërente përreth. Në një çast, Ai tha: “Po shoh se mes shtëpive tuaja po derdhen si shi intrigat!”⁹³

Eh, ai tha kështu dhe u nda prej nesh...por, shumë shpejt pas tij, sokakët rënkuan nën vërshimin e intrigave. Hz. Omeri, Hz. Osmani dhe Hz. Aliu ranë dëshmorë gjithë si pasojë e këtyre intrigave... Sikur edhe vetë intrigat me gjuhën e tyre të ngatërresave e fatkeqësive e vërtetonin të Dërguarin e Allahut: “Po, të vërtetën thua!..”

Intrigat

Hz. Omeri gjithmonë pati pasur frikë nga shfaqja e këtyre intrigave. Një herë, në faltore, duke ndenjur bashkë me shumë vetë, pyet: "A ka dikush që ka dëgjuar për intrigat që ka paralajmëruari Dërguari i Allahut dhe di të thotë ndonjë gjë për to?" "Unë jam" thotë Huzejfe. "Ti je një burrë i guximshëm i thotë Hz. Omeri . fol!" Dhe Huzejfe thotë: "Intriga e personit kufizohet te familja e tij, te malli e pasuria, te egoizmi, fëmijët dhe komshinjtë. Dite këtyre u dilet përballë me agjërim, namaz, sadaka, me zbatimin e urdherave e të ndalimeve." "Jo -i përgjigjet Omeri unë nuk po pyes për këto por për intrigat që do të dallgëzohen si dallgët e detit!"

Huzejfe: "O Omer! Ato s'kanë aspak lidhje me ty. Mes tyre dhe teje është një portë e mbyllur." Kurse Omeri: "Ajo portë a do të hapet, apo do të thyhet?" Dhe përgjigja e Huzejfes: "Do të thyhet?" Hz. Omeri u trondit dhe nga buzët e tija të dridhura

u derdhën këto fjalë: “Në ndodhtë ashtu, ajo derë kurrë më nuk do të mbyllet!”

Më vonë, një sahabë pyeti: "A e dinte, vallë, Omeri se porta është vetë ai? Huzejfe iu përgjigj: "Po, e dinte siç di për netët e ' mbrëmshme!" Po, Hz. Omeri e dinte se, pas vdekjes së tij, portat e unitetit të krijuar prej Hz. Muhamedit do të hapeshin. do të merrnin udhë grindjet dhe intrigat, në gjirin e ummetit do të Shtaqeshin botëkuptime të ndryshme, rryma të ndryshme... Omeri i dinte këto, sepse i kishte lajmëruar njeriu i i jalës dhe besniku ndaj së vërtetës, Profeti i të Dy Botëve, Hz. Muhamedi (s.a.s)!

Dhe, kur erdhi dita, thëniet e tij u realizuan identikisht. Omeri u pre me shpatë nga një tradhtar iranas. Edhe uniteti Islam mori një plagë të thellë në gjoks. Bota amiqësore e kishte zgjedhur shumë mirë objektivin dhe gjahtari i paepur e kishte ngulur shigjetën mu në të. Po, me vdekjen e tij intrigat rrodhën si shtrëngatë, dolën nga shtrati dhe e përmbytën tërë botën Islame. Në një aspekt. kjo ishte një copëtim. një ndarje, një ankth, por, në një aspekt betër, ishte edhe një argument dhe provë e së

vërtetës "La ilahe illallah Muhamedu'r-Resulullah',
'Nuk ka zot tjetër përtëç Allahut,

Muhamedi është i Dërguari i Tij , e shkruar me
gërma yjesh në qiell sipas gjuhës së ngjarjeve e
ndodhive...

Epërsi dhe fitore

2. Te Buhariu si dhe te vepra "Synen" e Ebu
Davudit bëhemi dëshmitarë të kësaj ngjarjeje të
treguar nga Habbab b. Eret. Le t'i përmbledhim ato
që kemi dëgjuar prej tij:

"Ishte një kohë plot shqetësime. I Dërguari i
Allahut po rrinte në hije të Qabes. Kushedi ç'sulme
kishte pësuar përsëri! Ishte një periudhë e tillë që të
gjitha zakonet e injorancës përdroreshin si nga një
armë më vete kundër muslimanëve. Atëherë unë
ende s'e kisha fituar lirinë. Mundimet dhe torturat që
imzot dhe paria e Mekës zgjidhnin për mua, kishin
arritur në një shkallë të tillë që ishin bërë, më në
fund, të padurueshme. Kur e pashë ashtu të vetmuar
të Dërguarin e Allahut, iu afrova pranë dhe i thashë:
"O i Dërguarii Allahut! A s'po lutesh dhe kërkon nga
Zoti ndihmë dhe fitore për ne?"

Habbabi mendonte se i Dërguari i Allahut do të ngrinte menjëherë duart e do të lutej; madje priste se ndoshta edhe do t'i mallkonte Kurejshët... Mirëpo i Dërguari i Allahut i tha kështu Habbabit: "Betohem në Allahun se bashkësitë para jush patën vuajtur tortura më të tmerrshme. Ndodhte që të shtriheshin në hendeqe e t'u sharrohej trupi me sharrë hekuri e prapë të mos ktheheshin nga feja. U ndahej mishi prej kockave e prapë nuk jepeshin. Allahu do ta plotësojë këtë fe, vetëm se ju nxitoheni. Do të vijë një ditë e një grua do të udhëtojë e vetme nga Hire në Hadramut dhe nuk do të ketë frikë në rrugë veçse nga kafshët e egra!"

Dhe Habbabi betohet: "Të gjitha thëniet e të Dërguarit të Allahut dolën. Unë i pashë të gjitha me sytë e mi!"

"Ti do të jesh e para që do të takohesh me mua"

3. Në njërën prej ditëve të sëmundjes që do të bëhej shkak për bartjen e Profetit në jetën e pasosur, ky e thërret pranë të bijën, Hz. Fatimenë, që me sjelljet dhe vështrimin e thellë i ngjante gjer në hollësi, dhe i pëshpërit në vesh ca gjëra... Hz. Fatimeja qan e qan sa i këput zemrat... Pastaj Profeti i pëshpërit në vesh ca gjëra të tjera nga të cilat aq

shumë gëzohet, sa kujtonte njeriu se i ishin hapur të gjitha dyert e xhenetit...Në të vërtetë, ashtu ishte, sepse ajo kishte një gëzim të madh.

Kjo ngjarje nuk i kishte shpëtuar vështrimit të Hz. Aishesë. Më vonë ajo e pyet Hz. Fatimenë, por kjo nuk i tregon gjë duke iu përgjigjur shkurt: "Kjo është një e fshehtë që i përket të Dërguarit të Allahut!" Pas vdekjes së Profetit, Hz. Aisheja e pyet përsëri dhe atëherë Hz. Fatimeja i përgjigjet kështu: "Herën e parë më tha se do të vdiste, prandaj qava. Kurse herën e dytë më dha myzhdenë se i pari njeri nga familja që do të bashkohej me të, isha unë, prandaj edhe u gëzoval!"⁹⁵ Po, ashtu pati qarë, sa që vdekja profetike pati derdhur nga buzët e saj vargjet që do të bënin për të qarë njerëzimin të tërë:

E ç'të kërkojë njeriu aromë tjetër

Kur thith aromën e dheut të Muhamedit?

Të tilla hidhërime më ranë përsipër,

Sa, po t'u binin ditëve, do të bëheshin netë... "

Gjashtë muaj pas vdekjes së Profetit do të vërtetohej fjala e dytë: do të vdiste Hz. Fatimeja duke u bërë, kështu, e para nga familja që i bashkohej Atij!⁹⁸ Edhe vdekja e Hz. Fatimesë vërtetonte

drejtësinë e fjalës së të Dërguarit të Allahut dhe sikur i thoshte Atij: ”Drejt fole!..”²

Paqja

4. Në një ngjarje të rrëfyer nga shumica e autorëve të Kutubi Sites,⁹ thuhet se i Dërguari i Allahut kishte paralajmëruar kështu për Hz. Hasanin një ditë në hutbe: ”Ky është biri im, Hasan; ai është i nderuar. Me të Allahu do të sjellë paqen midis dy xhemaatëve (bashkësive) të mëdha!”⁹⁹

Po, ai është fisnik bir fisniku. Eshtë bir i të Dërguarit të Allahut. Eshtë një zotëri. Një ditë, hilafetin dhe mbretërimin e ofruar do ta refuzonte vetëm e vetëm që të mos jepte shkak për intrigën mes ummetit dhe do të tregonte se ishte zotëri e bir

⁹⁵ Buhari. Menakib, 25; Ikrah, 1, Ebu Davud, Xhihad, 97.

⁹⁶ Buhari, Menakib, 25; Myslim, Fezailu's-Sahabe, 98.99

⁹⁷ Buhari, Megazn, 83; Ibni Maxhe, Xhenaiz, 65; Mysned. 3/1975

zotëriu. Nuk do të kalonin më shumë se njëzete pesë-tridhjetë vjet dhe fjalët e Profetit do të vërtetoheshin një e nga një. Pas Hz. Aliut, Emevitë gjetën përballë Hz.Hasanin.Vetëm se ky njeri i paqes e i qetësisë, duke shpallur se hiqte dorë nga të gjitha të drejtat, parandaloi, qoftë edhe përkohësisht, ndeshjen midis dy ushtrive Islame.¹⁰⁰

Kur Profeti paralajmëronte këtë ngjarje, Hz. Hasani ishte ende një fëmijë i vogël. Ndoshta atë ditë as që kishte kuptuar se ç'thoshte për të Profeti, i gjyshi. Domethënë se ai nuk veproi ashtu, se ashtu kishte pasë thënë i Dërguari i Allahut dhjetra vite më parë. Ndoshta i Dërguari i Allahut e kishte pasë ditur që atëherë sesi do të ndodhte, pa kishte thënë ashtu. Edhe Hz. Hasani e vërtetonte gjyshin e tij dhe, vite më vonë vepronte ashtu siç kishte paralajmëruar Ai, duke i thënë me gjestin e vet: "Drejt ke folur!"

"Do të jetojë një shekull"

5. Duke vënë dorën e bekuar mbi kryet e Abdullah b. Busrit, Profeti thotë: "Ky fëmijë do të jetojë plot një shekull!" dhe shton: "Edhe këto puçrra të shëmtuara do t'i fshihen!"

Sahabet thonë se ai njeri jetoi plot njëqind vjet, ndërsa puçrrat i ishin fshirë me kohë...¹⁰¹. Ashtu siç

i Dërguari i Allahut lartësohej çdo ditë drejt një niveli më të përsosur se i një dite më parë sipas të fshehtës "Bota e ardhshme është më e mirë për ty se e para",¹⁰² ashtu siç e gjente të mangët një situatë të mëparshme në krahasim me atë të mëpasme dhe, për pasojë, pendohej njëqind herë në ditë,¹⁰³ ashtu edhe çdo ditë që kalonte, ummeti i tij hidhte edhe një hap tjetër përpara në njohjen dhe kuptimin e tij, i shtohej edhe më besimi nga vërtetimi i paralajmërimeve të tij lidhur me të ardhmen dhe i thoshte atij: "Ti je i Dërguari i Allahut!"³

E ardhmja e afërt

Nga shembujt që dhamë më lart, për nga këndvështrimi i vendosjes në kohë të tyre, janë gjithë ata shembuj më larg periudhës së Profetit e më pranë periudhës sonë, madje të tilla që shohin brenda këtij shekulli e që presin të vërtetohen në shekujt e

¹⁰¹ Metheu'z-Zevaid, 9/404-405; Hakim, Mystedrek, 4/500.

¹⁰² Kur'ani, Duha: 4.

¹⁰³ Shih Myslim, Zikr, 42; Mysned, 4/211.

ardhshëm, mbi të cilat le të ndalemi një copë herë tani.

Njoftimet e dhëna në hendek

Pothuajse të gjitha librat e hadithit dhe ata biografikë përcjellin këtë ngjarje: "Po gërmohej hendeku.' Na doli një shkëmb i madh, i tillë, që, me gjithë përpjekjet e shumta, nuk po mundeshim ta shkulnim nga vendi. Bashkë me ne gërrnonte edhe Profeti i cili, përveç kësaj, për të na e ushqyer forcën shpirtërore, herë pas here lutej: "Allahu im! Nuk ka jetë tjetër veç asaj të përhershmes! Fali, Ti, ensarët dhe muhaxhirët?"

Kurse ne, sahabet, ia kthenim: "Allahu ynë! Po të mos ishte Ti, ne nuk do të mund të viheshim në rrugë të drejtë, nuk do të faleshim dhe nuk do të jepnim zeqat! Zbrit mbi ne qetësinë e sigurinë dhe, kur të përballemi me armikun, na ruaj të mos na rrëshqasin këmbët!"¹⁰⁵

Sahabet i flisnin Profetit edhe për hallin më të vogël të tyre. I thanë edhe për shkëmbin. Me varenë në dorë, shkoi te shkëmbi dhe nisi ta c0pëtonte. Kur e ulte me forcë varenë mbi gur, shpërthenin shkëndija dhe sikur në të njëjtën kohë mbi të Dërguarin e Allahut binin shkëndijat e revelacionit e

të frymëzimit. Në çdo goditje ai thoshte këto fjalë: "Këtë çast m'u sollën në dorë çelësat e Bizantit. Po shoh sesi po shemben muret e kështjellave të Sasanive. Po vë re se më kanë sjellë çelësat e Iranit..."¹⁰⁶

Kalojnë vite dhe Allahu, me anë të shpatave të Sa'd b. Ebi Vakkas dhe Halid b. Velidit, ua mundëson muslimanëve triumfin e atyre Hendeku rreth Medinës për luftën e pritshme që u quajt "Lufta e Hendekut". vendeve dhe çelësat e tyre i dorëzohen personalitetit shpirtëror të të Dërguarit të Allahut. Dhe ky eveniment është një tjetër vërtetim i drejtësisë së Tij. Dhe as që mund të ndodhte ndryshe. Ai për të përfaqësuar të drejtën e të vërtetën kishte ardhur. Le të supozojmë se edhe sikur gjërat për të cilat ai thoshte se "do të bëhet", nuk kishin për t'u bërë, Allahu do t'i realizonte ato për të mos e nxjerrë gënjeshtar të Dërguarin e vet. Si të mos ndodhte kështu, kur madje edhe për sahaben, pasuesin e njohur Bera, ishte thënë: "Për çfarëdo çështje që të betohet ai, Allahu nuk e nxjerr gënjeshtar!¹⁰⁷ Me fjalë të tjera, nëse Hz. Bera do të betohej për një gjë që nuk do të bëhej kurrë, Allahu do ta realizonte betimin e tij. Dhe me të vërtetë, në

çdo luftë sahabet atë e vinin përpara dhe përpiqeshin që me të t'i garantonin fitoret.¹⁰⁸ Atëherë, nëse Allahu i jepte një vend të tillë njërit prej sahabeve, pasuesve profetikë, si mund të mos ia jepte vetë Profetit të Tij? Për më tepër, Profeti i shihte ngjarjet e ardhshme, pa fliste. Allahu ia bënte të ditur, prandaj edhe ai dinte! ⁴

Sihariqi për siguri dhe pasuri

2. Adij b. Hatem (Adij ishte i biri i Hatemi Taiut. Më parë pati qenë kristian. E pati kërkuar dhe e pati gjetur të Dërguarin e Allahut, e pati gjetur dhe pati shpëtuar), ky sahabe i famshëm, tregon kështu: "Një ditë, në prani të të Dërguarit të Allahut, flitej për varfërinë, vjedhjet dhe plaçkitjet e hajdutëve. Dhe

¹⁰⁴.Buhari, Menakibu'l-Ensar, 9; Myslim, Xhihad, 127.

¹⁰⁵ Buhari, Megazi, 29; Myslim, Xhihad, 123, 124, 125.

¹⁰⁶.Ibni Kethir, 4/116; Ibni Hisham, Sire, 3/230; Mysned, 4/303.

Profeti tha: "Do të vijë një ditë që një grua do të udhëtojë e vetme prej Hires në Hadramut dhe nuk do të ketë frikë veçse prej kafshëve të egra!"

Adiji thotë se i dëgjonte ato fjalë krejt i çuditur dhe se thoshte me vete: "Si mund të ndodhë kjo kur janë gjallë hajdutët e fisit Taj?" Profeti vazhdoi: "Do të vijë një ditë që thesaret e Kisras do të ndahen midis jush!" Kurse Adiji e pyet: "O i Dërguari i Allahut, për thesaret e Kisras së Iranit e ke fjalën?" "Po i përgjigjet Profeti për thesaret e Kisras së Iranit!" Adijit i shtohet edhe më çudia. Atë kohë kur u thanë këto fjalë, Irani jetonte ditët e tij më të shkëlqyera. Pastaj Profeti vazhdoi: "Do të vijë një ditë e tillë që njeriu do të silllet vërdallë me zeqatin në dorë dhe s'do të gjejë se kujt t'ia japë!"

"Unë thotë Adiji dy parashikimet e para i jetova e i pashë të vërtetohen me sytë e mi; në paça jetë, do ta shoh edhe të tretin" ""

Por Adiji nuk do të mund ta shihte këtë kohë të tretë. Ajo ditë erdhi dhe u përjetua. Në periudhën e Omer b. Abdulazizit' u jetua identikisht e vërteta e shprehur nga i Dërguari i Allahut. Ai shteti madh sa tridhjetë herë Turqia e sotme kishte an'itur një nivel të tillë shpërndarjeje të të ardhurave, saqë nuk pati

mbetur individ që të mund të quhej i varfër. Pandej se nuk do ta tepronim sikur të thoshim se standarti i jetesës sot në Amerikë dhe në disa vende perëndimore është i ulët aq sa nuk mund të krahasohet me atë periudhë. Gjithashtu, aq e çekuilibruar është ndarja e të ardhurave në shtetet e pasura të sotme, saqë krahas individëve që jetojnë në luks dhe komoditet, ka edhe të tillë që jetojnë në izba. Kurse në atë periudhë një çekuilibër i tillë ishte eleminuar.¹¹⁰

Dëshmia e Ammarit

3. Po ndërtohet Faltorja Profetike!¹ Secili punon me dëshirë. Mes tyre, natyrisht, edhe i Dërguari i Allahut po bart mbi supe plitharë. Një radhë Ammari afrohet te i Dërguari i Allahut dhe i thotë

¹⁰⁹Buhari, Menakib, 25. Omer ibni Abdulaziz (Hixhri 60-101), një nga kalifët Emevi.

¹¹⁰Ibni Kethir, el-Bidaje, 9/225,

me naze: "O i Dërguari i Allahut, mua më ngarkuan dy plitharë!" Profeti qesh dhe, duke i fshirë pluhurin nga fytyra me ato duar të bekuara, e paralajmëron për një ngjarje që do të ndodhte plot tridhjetë vjet më vonë, për faktin se do të vritej nga një grup njerëzish të revoltuar kundër Hz. Aliut. Dhe ashtu ndodhi; në luftën e Siffinit, Ammari, ky sahabe i madh, ra dëshmor duke luftuar në radhët e Hz. Aliut. Përkrahësit e Hz. Aliut, madje, duke e sjellë këtë vrasje si argument të padrejtësisë së kundërshtarëve, i patën akuzuar ata si "sykëqinj". " " Ç'është e vërteta, në Siffin, në njërën anë, vërtet derdhej gjaku i Hz. Ammarit, por në anën tjetër, çdo pikë gjaku e derdhur sikur i thoshte të Dërguarit të Allahut: "Të vërtetën pate thënë!"

Po, lexues i shtrenjtë! Si mund t'i dijë njeriu këto nëse s'ia bën të ditura Zoti? Sot, në disa filma fantastikë, bëhen parashikime të cilat nuk janë dhe aq të vështira për t'u bërë kur ekzistojnë premiset dhe hapat e para të ngjarjeve të ardhshme të parashikuara si dhe me pak aftësi për të lidhur gjërat me njëra-tjetrën. Mirëpo në pikënisjen e asnjërës prej specifikave për të cilat pati lajmëruar Profeti, nuk pati ndonjë premisë apo shenjë fillestare. Duke u

nisur nga kjo, është e pamundur që një njeri i nivelit të gjeniut me aftësi të jashtëzakonshme parashikuese, madje, të shprehë qoftë edhe një të dhjetën e parashikimeve të Tij. Kjo sepse çështje si kjo janë të tilla që i kapërcejnë kufijtë e mendjeve tona. Me fjalë të tjera, nuk ka mundësi të njihen gjëra të tilla nga një njeri për të cilin nuk hapet dritarja e së fshehtës dhe nuk shoqërohet nga revelacioni. Po kështu, edhe i Dërguari i Allahut nuk i thoshte ato nga vetja, por në sajë të njoftimit të Zotit, prandaj edhe të gjitha thëniet gjithmonë i dilnin të vërteta... ⁶

Një fis i pafe në emër të fesë

Në origjinal: Mesxhid-i Nebi, faltarja ose xhamia e Profetit në Medinë.

¹¹¹Kenzu'l-Ummal, 13/539; Ibni Kethir, el-Bidaje, 7/296.

Sykeq: njeri që dëmton me shikim, që merr mësysh dikë tjetër, magjistar. Në origjinal: Bagi.

4. Një ditë, Profeti e pati ndarë plaçkën e luftës dhe po rrinte kur, papritmas, i erdhi pranë një burrë me tipare mongoloide. Ndoshta ishte njeriu që përfaqësonte atë ditë një komb të ardhshëm. Burri i foli pa edukatë Profetit: "Kjo ndarje nuk u bë drejt! Tregohu i drejtë!" Ndoshta ishte një besimtar hipokrit që mundej t' i drejtohej kështu Profetit. Kurse ky urdhëroi e tha: "Kur të mos sillem unë me drejtësi, kush do të sillet? Nëse s'tregohem i drejtë, do të thotë se kam humbur e dështuar 112 Fjalët e tij kishin një kuptim të thellë. Po qe se profeti nuk është njeri i drejtë, nga kush do ta mësojnë njerëzit drejtësinë? Kurse, nga ana tjetër, njerëzit e ndodhur mbi një bazë ku nuk ekziston drejtësia, janë të humbur e të dështuar. Profeti kërkonte të thoshte edhe për vete se, nëse nuk ishte i drejtë, konsiderohej i humbur. Mirëpo Allahu e kishte dërguar si peygamber atë, gjë që do të thoshte se ai nuk ishte i humbur, prandaj edhe ishte i drejtë!

Në atë mes, Hz. Omeri i kërkoi leje për t'ia treguar vendin atij nje-riu të paturpshëm që nuk dinte sesi duhej folur para të Dërguarit të Allahut: "Më lër t'ia fluturoj kryet këtij hipokriti!" Kurse Profeti nuk e lejoi dhe aty për aty nga buzët e tij të

bekuara u derdhën këto fjalë lidhur me të ardhmen e panjohur:

“Në të ardhmen do të dalë një fis. Kur ata njerëz me mollëza të dala, me hundën të shtypur e me sytë të futur thellë në gropëza, do të këndojnë Kur’an, këndimi juaj do t’ju duket i pavlerë. Mirëpo këndimi i tyre do tëjetë në fyt e lart.’ Ata do të dalin nga feja si shigjeta nga harku. Madje, njëri prej tyre do të ketë një qukë fort të madhe në krah.”“

Vitet kalojnë me shpejtësi dhe ditët sikur bëjnë garë për të vërtetuar thëniet e të Dërguarit të Allahut. Në Nehrivan Hz. Aliu i kalon në shpatë të gjithë të ashtuquajturit ”harixhinj”, personat e . tretë dhe kundërshtarë të Aliut që nuk qenë dakord për caktimin e një arbitri që do të sheshonte mosmarrëveshjet midis tij dhe Hz. Muavijes. Ndërkaq sillet një njeri krejt sipas përkrahimit të Profetit dhe Hz. Aliut ijepet një myzhde. Domethënë se ata ishin njerëzit që, të dalë prej feje, do të luftonin kundër saj.“” Sipas një hadithi dobët të vërtetuar, Profeti i ka thënë kështu Hz. Aliut: ”Unë luftova për zbritjen e Kur’anit, kurse ti do të luftosh për interpretimin e drejtë të tij!””5 Me fjalë të tjera, Profeti ka dashur t’i thotë se, ashtu siç kishte

luftuar ai për të mbrojtur Kur'anin përballë kundërshtarëve, edhe Aliu do të luftonte një ditë kundër atyre që do të donin ta komentonin dhe interpretonin gabim atë. Dhe ky parashikim kishte ndodhur kur i kishte ardhur koha. Hz. Aliu kishte luftuar kundër të ashtuquajturve harixhinj që kishin dalë nga feja si shigjeta nga harku. Njeriu që i kish ardhur Hz. Aliut si përfaqësues i tyre, sikur ishte krijuar pikërisht për të vërtetuar fjalët e të Dërguarit të Allahut! Negativiteti i tij përbënte diçka pozitive kur shërbente për të vërtetuar Profetin. Natyrisht, kur djalli i bie në qafë një besimtari, "Në fyt e lart" : jo prej zemre. grindja e tij me djallin i përfton atij një të mirë, ndërkaq që djalli nuk fiton asgjë megjithëse u bë shkak për një të mirë; po ashtu, personi për të cilin po flasim, duke u ekzekutuar, do të bëhet pretekst që të vërtetohen fjalët e të Dërguarit të Allahut, kurse ai vetë nuk do të fitojë asgjë. Po, e vërteta është se ne, duke lexuar në librin e fytyrës së tij të shëmtuar, lexojmë vërtetimin e drejtësisë së Profetit tonë, kurse personi vetë nuk fiton gjë në këtë mes, sepse ai s'është gjë tjetër veçse një vegël e pafat...

Udhëtimi me anije dhe Ummi Haram

5. Sipas një rrëfimi, Ummi Haram binti Milhan, teze qumështi e Profetit, ka qenë si teze e vërtetë për të, kurse, sipas një rrëfimi tjetër, meqë ka qenë një farefis i afërt i s'ëmës. I Dërguari i Allahut hynte e dilte pa drojtje në shtëpinë e saj dhe disa herë edhe pushonte atje. Një herë, përsëri ishte mbështetur për të pushuar dhe, kur i del gjumi, ngrihet i buzëqeshur. Ummi Haram binti Milhan e pyet: "Pse po buzëqesh, o i Dërguari i Allahut?" Dhe ai i përgjigjet. "Pashë se një grup nga urnmeti im dolën të luftojnë si pasanikë hipur mbi gjemi." Gruaja e pyeti: "A nuk po lutesh që edhe unë të jem njëri prej tyre?" Dhe Profeti e dha fermanin: "Edhe ti, njëri prej tyre je!" Pastaj Profeti ra përsëri të flerë dhe, kur u ngrit, u përsërit e njëjta skenë dhe të njëjtat fjalë 116

Vitet kalojnë dhe Ummi Haram, bashkë me të shoqin, Ubade b. Samit, shkon në luftën e Qipros, sëmuret atje dhe vdes.⁷ Nga ajo ditë e sot muslimanët vizitojnë varret e tyre dhe qajnë. Natyrisht, çdo pikë loti bart, në të njëjtën kohë, edhe

kuptimin e vërtetimit të Profetit. Ai kishte thënë një të fshehtë dhe ajo ishte vërtetuar një për një. Qiproja, historia e Qipros dhe varri i saj bashkë me varret e të tjerëve janë dëshmitarë që nuk mund të përgënjeshtrohen!

Po, thëniet e të Dërguarit të Allahut dalin një e nga një me t'u ardhur koha, ne e rinojmë Fjalën tonë të Dëshmisë për të duke i vëzhguar ngjarjet në pasqyrën e historisë dhe për çdo radhë themi: "Drejt ke thënë, o i Dërguari i Allahut!" Ndoshta thëniet tona nuk janë të afta për ta shprehur gjithçka ashtu siç duhet, por zëri që dëgjon çdo musliman në ndërgjegjen e vet, është aq i kthjelltë, saqë të mos e dëgjosh këtë zë, është sikur ta mohosh atë... ⁷

Benu Kantura

6. Gjithashtu, duke folur për një popull që do t' i bjerë në qafë botës Islame, i Dërguari i Allahut ka urdhëruar kështu: "Në kohët e pasme do të dalë fisi

¹¹⁶ .Buhari, Tabir, 12; Xhihad, 3,8; Myslim, Imare, 160, 161.

¹¹⁷ .Ibni Haxher, Isabe, 41441.

Beni Kantura, njerëz me mollëza të dala, me sy të vegjël dhe hundë të shtypur 118 .Librat e historisë thonë se këta janë mongolët. Në përshkrimin e bërë nga i Dërguari i Allahut janë dy faktorë shkatërrues të mëdhenj e të tmerrshëm të botës Islame: Njëri nga këta është Ferdinandi në Andaluzi që, si një barbari e vërtetë perëndimore, pati vrarë, pati shkatërruar biblioteka dhe djegur libra, kurse e dyta, është fatkeqësia mongole. Edhe mongolët patën bërë rrafsh me tokën të gjitha qendrat kulturore të Egjiptit, Sirisë dhe Anadollit, patën kthyer çdo vend në gërmadhë dhe pastaj qenë larguar andej nga patën ardhur.

I Dërguari i Allahut ia tërheq vëmendjen ummetit të tij ngaqë është shumë i lidhur me fatin e tyre dhe me paralajmërimin në ljalë sikur u thotë se, kur bashkësia e Muhamedit ta ketë bërë hak ndëshkimit, Allahu përdor ndaj tyre mizorët si mjete edukimi. Po, mizorët janë këllëçi i Allahut. Me ata vë të drejtën në vend dhe pastaj kthehet e i ndëshkon edhe mizorët. Në fillim Allahu ua lëshon mbi krye muslimanëve mizorët dhe pastaj i kap edhe këta, i shkund mirë e mirë dhe i fundos nën tokë. Ia, për t' u ruajtur nga një fund i tillë keq e paralajmëron

bashkësinë e tij i Dërguari i Allahut, ajo përmendore dhembshurie; lajmëron për ngatërresat dhe të këqijat që do t' u bien mbi kokë, në formën e këshillës për t'u ruajtur nga veprimet që do tërhiqnin ndëshkimin e Zotit, madje duke bërë edhe përshkrimin e ngjarjeve. Dhe fakti që ngjarjet e paralajmëruara realizohen gjashtë-shtatë shekuj pas tij, shpall se Ai është profeti vërtetë!

Triumfi i Stambollit

7. Stambolli do të triumfohet. Kostandinopoli do të bjerë patjetër në duart e muslimanëve! Hakim Ebu Abdullah, duke përcjellë në veprën e vet "Mystedrek" paralajmërimin e të Dërguarit të Allahut, e jep me këto fjalë këtë informacion të karakterit të mrekullisë: "Sigurisht që Konstandin'opoli një ditë do të triumfohet; ç' ushtarë të mirë ushtarët që do ta marrin atë dhe ç'komandant i mirë ai që do ta arrijë atë fitore.¹¹⁸

Pothuajse të gjithë komandantët e mëdhenj të çdo periudhe dhe heronjtë botërorë, duke nisur, madje, qysh nga koha e sahabëve, pasuesve profetikë, patën ardhur disa herë gjer në Stamboll me

qëllim që të bëheshin vërtetuesit e këtij lajmi të lumtur, por qenë kthyer prapë. Ja, edhe Ebu Ejub el-Ensariu, njëri prej atyre të kthyerve, i mbetur në gjoksin e Stambollit, është si një margaritar, vlerë e vërtetë e Stambollit! Unë edhe mërzitern nga përsëritja këtu e gjërave që janë të njohura për të gjithë, edhe e quaj shpenzim kohe. Megjithatë, duke ndjerë e duke ndjerë nevojë, nuk do të mund të kaloj pa parashtruar nja dy veçanti.

Ullubatllë Hasani, i cili në ditën e triumfit të Stambollit qe i pari që hipi në muret e qytetit, nguli flamurin dhe ra dëshmor po aty, nuk ishte një ushtar i zakonshëm. Ai ishte një oficer i përgatitur në Enderun, aty ku përgatitej elita e Pallatit dhe, njëkohësisht, ishte shok shkolle i Fatihut!

Atëherë ata qenë me numrim. Kadiu i parë i Stambollit, Hizir Çelebiu, Ullubatllë Hasani dhe Sulltan Mehmeti II Ngadhnyyesi ishin vetëm tre prej tyre. Të tre bashkë kishin mësuar dhe të tre bashkë ishin përgatitur.

Atë ditë kur u kapërcyen muret e Konstandinopolit, Ullubatllë Hasani kishte hipur mbi bedena me gjithë trupin tërë plagë dhe kishte arritur ta ngulte flamurin. Pas pak, mbi kryet e këtij

heroi qëndronte Ngadhnyjesi. Hasani jetonte çastet e fundit. Dhe buzëqeshja në buzët e tij e kishte mahnitur Ngadhnyjesin. E kishte pyetur: "Pse po qesh?" Dhe ai i ishte përgjigjur: "Pak më parë këtej po inspektonte i Dërguari i Allahut. Pashë trëndafilin e bukurisë së Tij! Prandaj po qesh..."

Profeti e kishte lajmëruar atë ditë nëntë shekuj më parë! Dhe pas nëntë shekujsh ndodhej mes ushtrisë ngadhnyjmtare! Edhe unë, duke i besuar kësaj, kam thënë gjithmonë dhe gjithmonë do të them: "Edhe sikur tre-katër vetë të bëhen e t'i shërbejnë fesë me zemër të sinqertë, pa asnjë diskutim që edhe shpirti profetik do të jetë gati pranë tyre dhe do t'i nderojë ata dhe atë vend me praninë e tij! Ashtu si triumfi i Stambollit është njëri prej argumenteve që tregojnë drejtësinë e vetë personit të të Dërguarit të Allahut dhe të fjalës së tij, ashtu edhe Ebu Ejub el-Ensariu që një dëshmitar më vete i kësaj drejtësie, sepse ai pati qenë edhe njëri prej atyre që patën dëgjuar të parët personalisht se Stambolli do të triumfohej. Prandaj edhe që ngritur e pati ardhur që

nga Medina e largët dhe pati lënë si amanet që t'ia varrosnin kufomën në Stamboll." ⁸

E ardhmja e largët

Gjendja e pashpresë (Dashuria për këtë botë dhe frika nga vdekja)

1. Profeti ynë (s.a.s.) pati paralajmëruar edhe për ngjarje shumë të afërta me ditët e sotme. Ja njëri prej atyre paralajmërimeve: "Ashtu siç e ftojnë në sofër njerëzit njëri-tjetrin, ashtu edhe popujt dhe kombet do ta ftojnë njëri-tjetrin për tek ju dhe do të mblidhen nga të gjitha anët!" Njëri pati pyetur: "Mos vallë për shkak të gjendjes sonë në pakicë?" I Dërguari i Allahut: "Jo, në të kundërt, ju atë ditë do të jeni shumë, vetëm se si plehurat që i rrokullis era... Allahu do ta largojë frikën ndaj jush prej zemrave të dushmanëve tuaj, kurse në zemrat tuaja do të hedhë gjendjen e pashpresë." Prapë njëri pati pyetur: "Ç'është gjendja e pashpresë, o i Dërguari i Allahut?"

¹⁸.Mystedrek, 4/422; Mysnecl, 4/335. sot një lagje e Stambollit mban emrin e tij.

Dhe ai qe përgjigjur: "Eshtë dashuria për këtë botë dhe frika nga 'vdekjal"121

Nga këto pohime, në shikim të parë nxjerrim këto kuptime: Do të vijë një ditë dhe kombet do të na hidhen sipër grumbuj-gmmbuj. Sikur të ndanin gjellën“ në sofër, do ta ndajnë midis tyre pasurinë tonë mbitokësore e nëntokësore. Po, do të vënë dorë mbi të gjitha pasuritë tona sikur të na vidhnin sofrat duke na parë, madje, drejt e në sy! Ne vetë do t'i përgatisim kafshatat e do t'ua vëmë përpara, kurse ata do t' i përllajnë gjërat që ua kemi vënë para me një uri që s'di të ngopur! Pse do të ndodhin të gjitha këto? Sepse atë kohë ne nuk do të jemi më një dru me rrënjë. Akoma më keq, do të jemi si plehrat që i merr me vete era...

Dhe ashtu ndodhi. Ndërsa ne hanim e çfarosnim njëri-tjetrin me karakteret, veset, grupimet dhe ndryshimet botëkuptimore, ata u bashkuan përreth përfitimeve të ulta të kësaj bote, u njësuuan dhe na asimiluan. Në fillim ata na kishin frikë, sepse ne hidheshim drejt vdekjes ashtu siç iknin ata prej saj dhe e përbuznim këtë botë. Kurse sot jemi ne që e duam më shumë dhe që kemi frikë nga vdekja.

Prandaj edhe ata, duke shfrytëzuar këtë dobësinë tonë, na godasin mu në pikën më të dobët.

Ky hadith që në shikim të parë të bën të kujtosh kryqëzatat e para, po të mendohet pak më thellë, do të duket hapur se aludon edhe për ngjarje të ndodhura në një datë akoma më të afërt.

Raif Karadag pati shkruar një libër me titull "Furtuna e naftës" dhe u vra më vonë prej atyre që e patën shkaktuar atë furtunë. Sepse në atë libër shkruhej për fatin e përmbysur, tradhtinë dhe 'britmën e njeriut turk të shek. XIX dhe XX, nga njëra anë, si dhe për shkujdesjen e dhunuesve, nga ana tjetër.

Si qe sulmuar si të ishte një sofër ku mund të merrje ç'të doje, Shteti i Madh, të cilin e quajnë "perandori", gjë që unë s'e quaj të drejtë, sepse ajo s'ishte një perandori, por shteti më i shkëlqyer ndër shtetet që patën ardhur e shkuar pas periudhës së sahabeve e të bashkëkohësve të tyre! I gjithë halli i tyre pati qenë si të fushin në dorë pasuritë mbi e nëntokësore të këtyre dherave të gjera e të virgjëra. Më e rënda e kryqëzatave të hapura të zhvilluara gjatë gjithë historisë, mbetej prapë më e lehtë në krahasim me këtë dhunë asgjësuese të maskuar! Po,

patën thirrur njëri-tjetrin si ta thërrisnin në një sofër dhe patën ndarë midis tyre të gjithë ekzistencën e një kombi e të një vendi!..

Hz. Osmanin dhe Hz. Aliun e pati goditur nga pas një mendësi që vërtiste rrotën e tradhtisë së asaj periudhe dhe e pati ngjyer në gjak Shekullin e Lumtur; edhe familjen Osmane nipërit e tyre e goditën në shpinë dhe e lanë pa kokë botën Islame.

Ata na u hodhën sipër si t' i hidheshin një sofër të përgatitur e të rregulluar dhe, siç thotë Mehmet Akifi, "dikush hindian, dikush kanibal e dikush s'di se ç'dreq", u bënë bashkë dhe e copëtuan e e shkatërruan Shtetin e Madh.

Kryqtarët na patën sulmuar sipas një mendësie të caktuar dhe ai ishte sulmi i europianit naiv e kokëtrashë të asaj dite. Ato masa njerëzish kokëtrashë të mashtruar vinin, sipas mendjes së tyre, për të shpëtuar varrin e Hz. Merjemes (Shën Mërisë). Mirëpo, në opinionin tonë, Hz. Merjeme ishte shumë më e virtytshme se ç'mendonin dhe ç'besonin ata. Po qe se Hz. Merjeme do të ishte gjallë, ne do të ishim apologistët e të vërtetës së saj origjinale

përballë mendimeve të tyre bestypte e arkaike që do ta shqetësonin edhe atë vetë!

Ajo çka desha të them, është kjo: Rezultati i kësaj mendësie arkaike e regresive për të cilën aludohet në hadithet e të Dërguarit të Allahut që i morëm si bazë për tematikën tonë, nuk janë kryqëzatat e përgatitura; është një aleancë perëndimore e frikshme që ndofta e kemi parë në historinë e afërt në tërë tmerrin e saj dhe që jemi duke e parë ende. Islami akoma nuk ka shpëtuar së qeni një sofër për të.

Siç u pa, gjërat e thëna katërmbëdhjetë shekuj më parë po vërtetohen sot fjalë për fjalë, po shihen e po jetojnë.⁹

Intriga e komunizmit

2. Ibni Omeri tregon: "Një ditë, i Dërguari i Allahut u kthye nga lindja e tha: "Kujdes! Intriga do të shfaqet nga kjo anë, nga vendi prej ku do të zërë fill e do të përhapet epoka e djallit"122

¹²⁰.ibni Haxher, Isabe, 1/405.

¹²⁰Ebu Davud, Melahim, 5; Mysned, 5/278.

Ka shumë mundësi që me këtë porosi Profeti ynë të aludonte për intrigën që do të shfaqej në ditët tona në lindje si alternativë e heretikëve dhe mizorëve europianë. "Epoka e djallit" është antagonistja e "Epokës së Lumtur".¹ Eshtë sistemi ateist e tolerues i ndalimeve, i themeluar mbi parimin e mohimit të Zotit, sistemi që bëri realitet menjëherë të gjitha gjërat e këqia që djalli është përpjekur qëkuri e gjithmonë t'ia pëshpërisë njeriut me anë të egoizmit të tij në tërë kompleksitetin e vet. Ky sistem që të shtie drithmat, bir i adoptuar i sojit të kapitalizmit, megjithëse në ditët tona po heq shpirt, vazhdon të jetë kampion që s'pranon rival i armiqësisë ndaj fesë, gjërave të shenjta, historisë, madje edhe i demokracisë dhe vazhdon të jetë një ëndërr e frikshme. Pandeh se edhe i Dërguari i Allahut, "Epoka e djallit" i thotë veçanërisht kohës kur sundon ky sistem dhe e paralajmëron ummetin, bashkësinë e tij, përballë krizave të përbotshme të ardhura bashkë me këtë epokë.¹⁰

¹²².Buhari, Piten, 16; Myslim, Fiten, 45; Mysned, 2/50, 72.

Thesari në Euftrat

3. Përsëri i Dërguari i Allahut urdhëron: "Ka mundësi që uji i Bufi-atit. të tërhiqet dhe të dalë në shesh një mal prej floriri. Kush të ndodhet atje, të mos marrë gjë!"¹²³

Deri më sot Euftratit i ranë mbi krye krime sa bota. Nëse do të nisnim të flisnim nga data të afërta, do të përmendnim humbjet e mëdha njerëzore midis Iranit dhe Irakut. Prapë, më 1958, në një vend afër Euftratit, në formë genocidi, u vranë nipërit e të Dërguarit të Allahut. Ç'është e vërteta, edhe ata e patën goditur pas shpine Shtetin e Madh. Vetëm se nuk më duket e përshtatshme t'i lidh këto dy ngjarje me porosinë e mësipërme. Ndoshta është më e përshtatshme të kërkohet tek ajo aludim për ngjarje që, sipas shumë gjasash, kanë për të ndodhur në të ardhmen. Për shembull, në mënyrë metaforike, me flori mund të aludohet për të ardhurat që do të mund të sjellë në një të ardhme të caktuar uji i Euftratit pas ndërimit të digave mbi të. Por mundet që porosia të njoftojë se, pas tharjes së plotë të Euftratit, në shtratin e tij do të zbulohen rezerva të

mëdha ari dhe naftë. Por është e mundur, gjithashtu, që të zbulohen shtresa mineralesh edhe si rezultat i rrëshqitjeve të tokës. Por për një gjë nuk dyshohet se kërkon të thotë porosia, që një ditë ajo zonë do të bëhet në trupin e botës së Islamit një rrezik potencial si një dinamit. Këto nuk i përkasin të sotmes, por të ardhmes dhe njerëzit e asaj dite kur do të vërtetohet paralajmërimi i kësaj porosie, do t'i thonë edhe një herë me gjithë zemër të Dërguarit të Allahut "Drejt pate folur!" dhe do ta rinojnë besimin e tyre!

Pastrimi i jesuizmit

4. Profeti i Dy Botëve thotë se jesuizmi, pasi të pastrohet, dotë bëhet një me shpirtin Muhamedian¹²⁴ Atë ditë, atëherë kur përfaqësuesit e mohimit e të herezisë do të kenë shtënë në dorë besimtarët, ata që kanë në dorë fuqinë qiellore, me ndihmën e Allahut do ta ndryshojnë edhe një herë historinë e kthyer mbrapsht të muslimanëve dhe ateizmit do t'i thyhen hundët edhe një herë. Në këtë përleshje mbarëbotërore, që të dy anët do të mbushen me kufoma dhe këto kufoma që do të kenë mbuluar sipërfaqen e tokës, do t'i bartin shqiponjat.

Dhe sa kuptimplotë është aluzioni se këto shqiponja do t'i përkasin një institucioni të caktuar!

Përmirësimet në agrokulturë

5. Në fushë të agrokulturës do të bëhen përmirësime. Në sajtë të tyre do të kultivohen shegë që do t'u mjaftonin njëzet vetëve dhe nën lëkurën e të cilave do të mund të rrinte nën hije një njeri. Edhe kokrrat e grurit po aq të mëdha do të bëhen. Por këto janë gjëra që i përkasin të ardhmes. Këto do të realizohen pa asnjë dyshim dhe, duke i thënë Profetit "Ti je i Dërguari i Allahut", lidhja pas tij do të rinohet e do të fuqizohet më tej. Sepse, si gjer më sot, shekujt do të vazhdojnë ta vërtetojnë atë dhe, kur u vjen dita, të gjitha thëniet e tij dalin në shesh një e nga një!¹²⁵

Çekuilibret e ditëve të sotme

6. Le t'u rikthehemi aluzioneve që shohin kah ditët e sotme. I Dërguari i Allahut thotë: "Në kohën afër kiametit do të ketë përsëritje të posaçme

(përshëndetje duke nxjerrë në pah personalitetin). Tregtia do të marrë rëndësi të madhe, aq shumë, saqë gruaja do ta ndihmojë burrin në tregti. Do të ndërpriten lidhjet e gjakut dhe farefisnore. Do të jepet dëshmi për gënjeshtër dhe do të fshihet dëshmia për të vërtetën. Do të nxitet lapsi."126

Ky hadith, kjo porosi na e jep në dorë të sotmen në tërë lakuriqësinë e saj pa pasur nevojë për asnjë interpretim apo koment.

Tregtia do të marrë rëndësi të madhe, të tillë që do të konkretizohet me investime miliardash e trilionash. Vetëm për reklamë do të shpenzohen miliona e miliarda. Dhe në tregti shpesh herë do të përdoret femra për reklamë. Disa herë femra do të hyjë në tregti drejpt'e'rdrejt dhe do të përsillet në tregje e panairë si objekt reklame në vetvete. (Por në asnjë mënyrë s'duhet të pandehet nga këto fjalë se jam kundër tregtisë.

Unë dëshiroj vetëm të tërheq vëmendjen për drejtësinë e njoftimit të dhënë nga i Dërguari i Allahut). Do të këputen lidhjet e gjakut dhe ato farefisnore. Të drejtat e prindërve dhe të të afërmve do të nëpërkëmben. Me t'u plakur prindët në atë gradë sa të mos jenë në gjendje të vlejné për diçka,

domethënë atëherë kur të bëhen plotësisht nevojtarë për interesim dhe dhembshuri, do të dërgohen në azil ku pleqtë e mjerë do të përpiqen të gjejnë prehjen e humbur në shtëpitë e tyre! Megjithëse Zoti u ka dhënë prindërve të drejtën më të madhe pas vetes, m'urdhrit të Tij nuk do t'i vihet vesh dhe ata do të trajtohen në atë mënyrë të ulët e kriminale, saqë barbarët më të egër do të kujtohen me mëshirë! (Nëse ç'po thuhet, u përshtaten apo jo ditëve të sotme, po mjaftohem ta lë në dijen dhe gjykimin tuaj). Kalemi do të nxitet e do të marrë zhvillim të madh, domethënë se shtypshkronjat do të punojnë pa pushim, do të shtypen gazeta, revista dhe libra. Shtëpitë botuese do të përhapin pa pushim libra dhe enciklopedi, raftet e bibliotekave do të fryhen nga botimet. Shkrimi do të kthehet në një profesion që do të marrë një rëndësi dhe zhvillim të madh. ndërsa askush nuk do të priret për të dëshmuar të vërtetën.

Shoqëria do të kthehet pothuajse në gjendjen e një fabrike gënjeshtresh dhe jeta në një dimension të madh do të lëvizë nëpër një orbitë gënjeshtresh, tradhtish dhe mashtrimesh...

Çështja shprehet aq hapur, saqë në mendjet e disave mund të lindë lëkundja se mos këto fjalë nuk i përkasin me të vërtetë Profetit tonë.

Përgjigjja është mjaft e thjeshtë. Këto fjalë ekzistojnë në librat e hadithit, të kompiluara të paktën trembëdhjetë shekuj më parë. Nëse këto fjalë s'i ka thënë i Dërguari i Allahut, kush i ka thënë? Kush mund t'i ketë shprehur sikur t'i kishte parë me sy këto evenimente që do të ndodhnin shekuj më vonë pas tij? Nëse këto fjalë nuk i përkasin Profetit tonë, a nuk duhet të ketë qenë autori i tyre dritëgjatë së paku sa Ai? Dhe a ka në histori një njeri tjetër të nivelit të tij që të mund t'i atribuohen këto fjalë?

jo! Këto pohime mbi të fshehtën i përkasin të Dërguarit të Allahut! Zoti ia ka mësuar atij dhe ai na i ka njoftuar neve. Dhe këto ngjarje që po ndodhin sot, tregojnë hapur se sa të drejtë ka pasuri Dërguari i Allahut!¹¹

¹²⁶Mysned, 1/407, 408; Mystedrek, 4/98, 446.

¹²⁷ .Mjedisin njerëzor do ta përfshijë dëshmia mbi gënjeshtëri,

Përhapja e diturisë

7. Në një hadithi kudsî (porosi hyjnore), Profeti ynë na e përcjell kështu një urdhër të Zotit: "Në kohën e fundit do ta përhap diturinë në atë mënyrë, sa që do të mësojnë edhe mashkulli, edhe femra, edhe iliri, edhe skllavi, edhe i vogli, edhe i madhi!" 128

Shkollat e panumrim të hapura në ditët tona, universitetet e ngritura dhe bashkëpunimi në fushën e arsimit të këtyre me mjetet e komunikimit masiv, tregojnë se në këtë fjalën e tij të përcjellur prej

Zotit, i Dërguari i Tij aludon për epokën e dijes e të informacionit dhe zhvillimet në këtë fushë e vërtetojnë atë sikur çdo institucion shkencor t' i thoshte Profetit me gjuhën e statusit të tij: "Ti flet drejt!" Në fund të fundit, shkencat do ta thonë vetë këtë gjë kur të jenë kthyer kah orientimi i tyre i vërtetë!

¹²⁸.Myslim, Fiteh, 110; Tirmizi, Fiten, 59; Mysned, 4/182.

Ikja nga Kur'ani

8. Dhe prapë, në një porosi që u përshtatet plotësisht ditëve të sotme, i Dërguari i Allahut urdhëron: "Kiameti nuk shpërthen gjersa Kur'ani të mos konsiderohet si shkak për t'u turpëruar me të dhe Islami të mos jetë bërë diçka e çuditshme.¹²⁹

Ndërsa qafiri, heretiku do ta shpallë hapur mohimin dhe herezinë e tij, muslimani do të thotë se është musliman me vështirësi, sikur të kishte gjë për t' u turpëruar në këtë realitet. Ndërsa mohuesit dhe heretikët do t' i reklamojnë mendimet dhe botimet e tyre në autobuze, avionë dhe kudo krejt hapur, muslimanët nuk do të munden ta hapin e ta lexojnë Kur'anin! Dhe nën një presion psikologjik të tillë do të jenë, sa, edhe sikur të mos vendoset ndonjë ndalim formal, do ta fshehin se janë përkrahës të Kur'anit duke ndjerë turp për këtë gjë. A ka mundësi, tani, të mohohet kjo e vërtetë? A nuk është kjo njëra prej dramave që përjeton muslimani i sotëm? A nuk u bë islami me gjithçka një gjë e çuditshme?

Le t'i vë, pa u zgjatur më shumë, pikën përshkrimit të kësaj gjendjeje të dhimbshme. Të gjitha këto i Dërguari i Allahut i paralajmëroi ashtu

siç do të ndodhnin shekuj më parë dhe paralajmëtimi i tij e vërtetoi atë duke u realizuar në kohën e vet gjer në hollësitë më të vogla! Nuk e di, a s'na mjaftojnë të gjitha këto për ta miratuar edhe një herë tjetër atë Individualitet?¹²

Koncepti i kohës

9. Edhe në një porosi tjetër ku trajtohet sjellja e Kur'anit në një çështje që do të shkaktojë ndjenjën e turpit si shenjë kiameti, i Dërguari i Allahut thotë: "Kiameti nuk shpërthen para se të ndodhë afrimi në kohë dhe largësi."¹³⁰

Fjala arabishte "tekarub" (konvergjençë) në origjinalin e porosisë, do të thotë afrim i dy gjërave ose dukurive. Me këtë, i Dërguari i Allahut ka aluduar edhe për relativitetin e kohës, edhe për faktin se gjërat që në kohën e tij kërkonin shumë kohë, në të ardhmen do të realizoheshin në një kohë më të shkurtër. Fakti që tashmë në transformimet industriale e teknologjike si dhe në çdo fushë kemi

¹²⁸ .Darimi, Mukaddime, 27.

hyrë në epokën e shpejtësive të mëdha, është ndër njohuritë që konsiderohen elementare edhe për fëmijët. Krahas kësaj, në porosinë profetike aludohet edhe për mjetet e shpejta të komunikacionit që i kanë shkurtuar mjaft distancat. Këtu vihet gishti veçanërisht mbi një çështje që mund ta kuptojnë ata që merren , me astronomi dhe astrofizikë. Me kalimin e kohës toka po merr trajtë elipsoide. Ky ndryshim do të ndikojë edhe mbi kohën dhe, pa e dalluar ne, mund të bëhet e ndikueshme për ndryshime në orët tona lidhur me ndryshime në gjendjen e tokës. Është edhe diçka tjetër që kuptoj unë në këtë porosi: koha ka një trajtë konvencionale. Por, kudo që të jetë, koha është prapë kohë. Për shembull, shkoni në konstelacionin e Demit. Dhe prej aty shihni dyzet milion vite drite më tej një nebulozë që largohet me shpejtësinjëqind e pesëdhjetë kilometra në sekondë dhe do të bëheni dëshmitarë të kohëve shumë të ndryshme. Dhe në një nebulozë që largohet me shpejtësi sa gjysma e shpejtësisë së dritës, kjo njësi është një dimension kohor. Raportet ruhen edhe në nivelet më të ulta...

Po, nëse një ditë njeriu do të gjejë mundësinë për të dalë jashtë ' sistemit diellor, gjithsesi koncepti i tij i

tashmë mbi kohën atje do të përmbysset krejt. ja, pra, me dy fjalë të fshehta e të magjishme, ”takarebe’z-zaman”, “konvergjenca e kohës”, i Dërguari i Allahut aludon njëherazi për konceptimin tonë mbi kohën në të ardhmen dhe për shumë dimensione kohore të tjera“ përveç tij.

Tani po pyesim: A mund të. jenë, vallë, këto, fjalë të një qenieje njerëzore? Kush mund t’ i dijë tjetër të vërtetat mbi kohën dhe hapësirën përveç Individualitetit që i vërtit ato në dorën e fuqisë së Tij? Ju lutem, a janë këto gjëra që mund t’i dinte një njeri i pamësuar në një kohë të tillë kur s’njiheshin mësimi e arsimimi? Sigurisht që jo! Por për Atë ndryshon puna, sepse është Allahu që ia ka bërë të ditura këto atij. Ai ka paralajmëruar vetëm ato që ia ka bërë të njohura Zotit!

Ditët, muajt, vitet dhe shekujt ikin .e shkojnë. Shkenca dhe teknika bëjnë përpara me hapa vigane dhe në finalen e arritur si rezultat i këtij përparimi, arrihet e vërteta e njohur dhe e paralajmëruar shekuj më parë nga i Dërguari i Allahut lidhur me çështjen përkatëse. Dhe dijetarët e shkencëtarët, duke mos e fshehur

mahnitjen e tyre, e vërtetojnë me plot entuziazëm Atë duke i thënë: ”Ti je vetë e drejta dhe e vërteta, o i Dërguari i Allahut!”¹³

Përhapja e faizit

10. Një ditë sistemi i faizit do të zgjerohet me të gjitha mundësitë e veta dhe fëlliqësia e tij do t'u ngjitet edhe atyre që s'e lunë atë. Ja, pra. sëmundjen më të madhe të ditëve tona dhe këtë grindje që përhapet çdo ditë e më shumë në dimensione të frikshme, i Dërguari i Allahut na e shënon me këtë porosi: "Për njerëzit do të vijë ditë të tilla që s'do të mbetet njeri pa ngrënë faiz. Fëlliqësitë e tij do t'u ngjiten edhe atyre që s'e hanë"¹³¹

Në porosi tërhiqet vëmendja për dy specifika:

E para, e gjithë paraja e shtetit do të ziejë në çanakun e faizit dhe institucionet jobankare do të veprojnë bashkarisht me bankat; njeriu, sado që të

¹³⁰.Metheu'z-Zevaid, 7/324.

sillet me kujdes, patjetër që do ta marrë pjesën e vet nga kjo sëmundje ngjitëse që rrethon gjithë jetën, domethënë se edhe mbi të do të bien spërkalë. Nga kjo gjendje njeriu do të mund të shpëtojë vetëm në saje të njetit, qëllimit të paracaktuar të tij që do të bëhet strehim për të.

E dyta, u fol për fëlliqësitë e faizit që do t'u ngjiten edhe atyre që s'e hanë. Ndërsa kapitalistët do ta shtojnë dhe zhvillojnë pasu rinë e tyre me anë të faizit, proletarët do të varfërohen në të njëjtin nivel dhe lufta e pamëshirshme midis këtyre dy klasave një shfaqje, kjo, edhe e fëlliqësisë së faizit do ta përmbledhë shoqërinë në një grindje të përgjithshme duke u ngjitur një ditë në një nivel të tillë që do ta shqetësojë çdo njeri. Pandeh se të gjitha këto kanë ndodhur te ndodhin vazhdimisht. Njeriu i ditëve tona po i vëren në tërë shëmtinë e tyre këto dukuri specifike të shënuara nga porosia profetike. Dhe në ditët tona duket sikur nuk ka ndonjë ndërmarrje tregtare që të mos jetë ngatërruar drejtpërdrejt apo tërthorazi me faizin. E gjithë tregtia në përmasa botërore është kah vërtitet midis gurëve të mullirit të kësaj mendësie dhe veprimtaria me anë të faizit, si të ishte një shkëmbim malli, është kah pranohet si një

shkëmbim normal paraje. Profeti i Dy Botëve i pati tërhequr vëmendjen ummetit të tij shumë shumë më“ herët se njeriu i ditëve të sotme t’i nënshtrohej krizës së faizit dhe e pati paralajmëruar të sillej me zgjuarsia etë mos binte në batakun e faizit, mirëpo ec e shih sot sesi e gjithë bota Islame rropatet e fundosur gjer në fyt në batakun e faizit dhe duket sikur ende nuk ka ndonjë përpjekje për të dalë nga kjo ndyrësi. Mirëpo Islami është një fe që i ka shpallur luftë faizit!m Sikur muslimanët të mund të kishin kuptuar të paktën një pjesë të shprehjeve kërcënuese të Kur'anit lidhur me këtë çështje, nuk do të ndodheshin sot si viktima të faizit midis kombeve më të hallakatur të botës!.

Koha kur besimtari do të fshihet

ll. Prapë një porosi që bën tablonë e ditëve tona: ”Do të vijë një ditë që besimtari do të fshihet nga njerëzit e tjerë sikurse fshihet sot prej jush hipokriti..133

Si sillej hipokriti në periudhën e Profetit? Ai përpiquej si e si që të mos binte në sy. Po ashtu si ai, edhe muslimani i ditëve tona përpiquej të mos bjerë

në sy, të fshihet, t' i kryejë fshehur adhurimet, të ruajë

vendin ku ndodhet, megjithatë këto nuk do ta shpëtojnë... [(y sherr i poshtër' nuk dëshiron t' i pranojë ata; vendet e punës dhe disa nomenklatura të shtetit mbahen plotësisht të mbyllura për besimtarët të cilët shihen me përbuzje në shoqëri.

Edhe një porosi tjetër e mbështet këtë specifikë: "Do të shkaktohen intriga. Atë ditë personi do të bëhet me turp për shkak të namazit të tij ashtu siç bëhet me turp sot një femër për shkak të adulterit."

Në këtë porosi, në paralelizmin midis situatave përkatëse është marrë për etalon turpi i adulterit sipas mendësisë së asaj kohe, ' ndërsa në ditët tona, në disa drejtime, adulteri konsiderohet si profesion! '

Po, nëse s'menen në konsideratë dukuritë e përkohshme të një periudhe të caktuar, do të vijë një ditë që njerëzit do të përbuzen për shkak të namazit, do të fajësohen sikur të kenë bërë një punë të turpshme. do të rënkojnë nën sundimin e forcave të

errëta dhe besimtari do ta kapërcejë edhe këtë fatkeqësi duke u fshehur.¹⁴

Naftë në Talekan

12. ! Dërguari i Allahut urdhëron: “Myzhde për Talekanin! Atje ndodhen thesare të Allahut por që s'janë ar dhe argjend.¹³⁴ Ndërsa "Talekan" është emri i një zone ku ndodhen shtretër të pasur naftë.

Në të ardhmen atje mund të gjenden edhe minerale të tjera, si uran apo diamant. Dhe përfundimi nuk ndryshon. Profeti bën fjalë për thesare të tjera përveç arit dhe argjendit. Atëherë, edhe nafta e zbuluar në Talekan e vërteton fjalën e të Dërguarit të Allahut dhe e pohon me në të lartë se Ai është i drejtë.

¹³²”O ju që besuat! Kinie frikë Allahun dhe. nëse jeni besimtarë të singertë, hiqni dorë nga pjesa e mbetur e (aizit. Po s'vepruat kështu, dijeni se jeni në konflikt me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Po që se pendoheni, ju takojnë krerët e pasurisë. As nuk dëmtoni kënd, as vetë nuk dëmtoheni!” (Kur'ani, Bekare: 278-279).

¹³³.Kenm'l-Ummi. 11/176.

Diferencim i ulët që i përbuz besimtarët Pas
gjurmëve të adhuruesve të librit

13. Profeti ynë (s.a.s) ka paralajmëruar kohën kur bota Islame do të vihet në gjurmët e çifutëve e krishterëve me këtë shprehje konçize: “Paraardhësit tuaj do t’i ndiqni pas e do t’ i imitoni hap pas hapi e pash më pash. Sikur ata ta fusin kokën në vrimë të hardhucës, edhe ju do të bëni të njëjtën gjë!”¹³⁵

Pyetjes së pasuesve nëse me fjalën "paraardhësit" nënkuptohen çifutët dhe krishterët, Profeti i është përgjigjur: "E kush mund të jetë tjetër?"

Gjendja jonë dhe e të gjithë botës Islame sot është sheshit. Thuajse të gjithë me personalitetin të humbur dhe në depresion rënkojmë... Gjendja jonë, sipas shprehjes së porosisë, nuk është e ndryshme nga ajo e deles së hutuar që shkon e vjen mes dy tufash. Gjërat negative që një kohë patën shembur, konsumuar dhe asgjësuar shtete të tjera, sot na kanë rrethuar ne nga të katër anët si një oktapod. Kurse ne, me hutinë tonë të imitimit, e kujtojmë për stil novatorizmi dhe qytetërimi këtë elegji vdekjeje! Po, në asnjë periudhë historike, asnjë komb nuk e ka shndërruar në pasion imitim në përmasat e imitimit tonë të perëndimit. Çdo novatorizëm që shfaqet sot në botën perëndimore, pranohet identikisht prej nesh "pa pyetur fare për parrullën' dhe në shpejtësinë e pranimi i lëmë pas, madje, edhe shumë vende perëndimore! Mirëpo i Dërguari i Allahut u bënte opozitë atyre edhe në veçantitë më të vogla dhe në çështjet që dukeshin si hollësira!" Por. meqë s'e kemi në rend të ditës, nuk dua ta hap atë portë.

E tani, specifika mbi të cilën deshëm të përqëndrohemi ne, është se për të gjitha këto evenimente i Dërguari i Allahut pati paralajmëruar shekuj më parë. Realizimi i tyre në kohën

vet ashtu siç i pati paralajmëruar Ai, përbën dëshmi për drejtësinë dhe vërtetësinë profetike të Tij!¹⁵

¹³⁴.Kenzu'l-Ummal, 14/591

¹³⁵.Myslim. Ilim. 6: Buhari, Enbija. 50.

¹³⁶. Shih Ebu Davud. Saint. 88; Mysned, 5/264, 265.

LIDHUR ME DEGE TE NDRYSHME TE SHKENCAVE

Në këtë kapitull duam të ndalemi në mënyrë mjaft koncize mbi tjalët e thëna nga i Dërguari i Allahut për çështje lidhur me degë të ndryshme të shkencave.

Ai ka thënë një fjalë katërbëdhjetë pesëmbëdhjetë shekuj më parë; prej asaj dite e gjer më sot, degët e shkencave të cilat merren me atë çështje, kanë përparuar me hapa vigane e kanë kapërcyer etapa marramendëse dhe, si përfundim, deklarata e Lajmëtarit Besnik është vërtetuar, madje me gjuhën e shkencës, nga shkencëtarë gjigantë, secili prej tyre i konsideruar kompetent i fushës së vet. Po, gjer më sot, qoftë edhe një fjali e vetme e thënë nga i Dërguari i Allahut nuk është përgënjeshtuar!

Shkenca, teknika dhe teknologjia që përparonte me hapa vigane, i lënë mënjanë shumë e shumë individe te apasionuar pas shkencës, të cilëve u shkon fjala, dhe përkulen para të Dërguarit të Allahut me respekt dhe edukatë duke i thënë me zë tingëllues: "Të drejtë ke!" Fundja, as që mund të

ndodhë ndryshe, sepse Ai është përfaqësuesi i Allahut!

Lidhur me këtë çështje, le të përpiqemi të prezantojmë disa shembuj që kemi zgjedhur duke ua lënë analizën shkencore librave dhe manualeve përkatëse.

Shërim për çdo sëmundje

1. Në një hadith, porosi, të rrëfyer nga Buhariu, i Dërguari i Allahut urdhëron kështu: ”Allahu nuk ka dërguar ndonjë sëmundje pas të cilës të mos ketë krijuar edhe një shërim për të”¹³⁷ Kjo do të thotë se për të gjitha llojet e sëmundjeve Allahu ka krijuar nga një formë kurimi dhe shpëtimi. Fjala më e plotë dhe përmbledhëse ndër fjalët e thëna gjer më sot në botën e mjekësisë dhe si nxitëse për shkencën, duhet të jetë kjo fjalë e të Dërguarit të Allahut! Kjo ka këtë kuptim: Nëse ekziston ndonjë sëmundje, pa asnjë diskutim që ekziston edhe mjekimi i saj. Kjo do të thotë se një ditë natyrisht që me ndihmën dhe favorin e Allahutpër të gjitha sëmundjet do të gjendet një shërim.

Në rrëfimin e Ebu Davudit thuhet: "Çdo hall e ka një zgjidhjet!"¹³³ Në një tjetër porosi profetike thuhet: "Kujdes! Mos lini mangut mjekimin! Nëse Allahu ka dërguar një sëmundje, patjetër që pas saj ka treguar edhe rrugën e mjekimit të saj. Vetëm një sëmundje nuk ka mjekim. Dhe kjo është pleqëria?"

Edhe sikur të gjejmë mënyrë për zgjatjen e jetës, edhe sikur ta ndalojmë përkohësisht jetën në një moment të caktuar dhe ta vonojmë vdekjen, prapëseprapë nuk do të mundën ta ndalojmë udhëtimin fatalisht të paracaktuar (mukadder) të karvanit njerëzor, atë udhëtim që, i nisur nga bota e shpirttrave, përshkohet nëpër fëmijëri, rini, pleqëri dhe varr; prej aty zgjatet gjer në ditën e rilindjes dhe merr fund në xhenet ose xhehenem... Eshtë e pamundur t' i vihet pritë kësaj rruge: njerëzit do të lindin, do të rriten, do të plaken e do të vdesin. Vetëm se për vuajtjet e kësaj rruge nga lindja gjer në vdekje, ka shërim, mjafton që të kërkohet e të gjendet...¹⁶

¹³⁷ Buhari. Tibb, 1.

¹³⁸ Ebu Davud, Tibb, 10; Myslim, Selam. 69

Me këtë dhe me shprehje të tjera të ngjashme, Profeti i Dy Botëve e nxit të gjithë njerëzimin drejt diturisë dhe shkencës, të gjithë dijetarët drejt frymëzimit dhe të gjithë kërkuesit drejt kërkimit të zgjidhjeve përkatëse.

Hiqni mënjane para nga buxheti, ngrini institute kërkimesh, ecni gjer në pragun e Vdekjes dhe merreni nën kontroll fushën e gjerë që zgjatet gjer në këtë kufi! Kur'ani vazhdimisht e ka këshilluar këtë çështje, i ka nxjerrë në pah mrekullitë e profetëve për inkurajimin e shkencave dhe kërkimet me ato mrekulli i ka idealizuar. Ashtu si profetët i janë bërë udhëzues njerëzimit në jetën shpirtërore, e kanë nxjerrë atë nga rrugët e shtrembra në bregun e shpëtimit e të perspektivës, ashtu edhe shkencat pozitive, domethënë shkencat e mbështetura në dritën e mendjes, kanë marrë

Me këtë dhe me shprehje të tjera të ngjashme, Profeti i Dy Botëve e nxit të gjithë njerëzimin drejt

¹³⁹ Tirmizi. Tibb, 2; Ibni Maxhe, Tibb. 1; Mysned. 4/278.

diturisë dhe shkencës, të gjithë dijetarët drejt frymëzimit dhe të gjithë kërkuesit drejt kërkimit të zgjidhjeve përkatëse.

Hiqni mënjane para nga buxheti, ngrini institute kërkimesh, ecni gjer në pragun e vdekjes dhe merreni nën kontroll fushën e gjerë që zgjatet gjer në këtë kufi! Kur'ani vazhdimisht e ka këshilluar këtë çështje, ika nxjerrë në pah mrekullitë e profetëve për inkurajimin e shkencave dhe kërkimet me ato mrekulli i ka idealizuar. Ashtu si profetët i janë bërë udhëzues njerëzimit në jetën shpirtërore, e kanë nxjerrë atë nga rrugët e shtrembra në bregun e shpëtimit e të perspektivës, ashtu edhe shkencat pozitive, domethënë shkencat e mbështetura në dritën e mendjes, kanë marrë përsipër udhëzimin e jetës materiale të njeriut dhe secila prej tyre si mjeshtër dhe orientues i fushës përkatëse, i kanë dalë para njeriut dhe i kanë treguar udhën. Për rrjedhojë, mund të thuhet se të gjitha çelësat e përparimit materialo-shpirtëror njeriu i ka marrë prej profetëve. Po, tregimi në Kur'an për mrekullitë e profetëve ka për qëllim të inkurajojë njerëzimin në rrugën për t'u afruar gjer në kufirin mundësisht të arritshëm të atyre mrekullive.

Për shembull, Hz. Mesihu, me lejen e Allahut, i ka ngjallur të vdekurit. Këtë e thotë edhe Kur'ani. Vetëm se ky është kufiri i fundit. Përparimi i njeriut merr fund pa arritur aty. Pse? Sepse aty merr fund e zakonshmja dhe fillon mrekullia. Ato gjëra që mund të bëhen me fuqinë e njeriut dhe me vullnetin e njeriut, nuk mund ta kapërcejnë kuadrin e ligjeve të krijimit. Në çfarëdo niveli që mund të arrijnë "mrekullitë" e shkencës dhe të teknologjisë, kurrë nuk do të mundin të kapërcejnë kufirin e mrekullive në kuptimin e vërtetë të tyre. Këto kufij janë zona e Profetëve të Mëdhenj dhe e tillë dotë mbeten gjer në pafundësi. Përparimi i njerëzimit gjer në kufirin ku fillojnë mrekullitë, është gjithmonë i mundur dhe të gjitha nxitjet dhe inkurajimet, në fund të fundit, për këtë bëhen.

Ja, pra, me mrekullinë e Hz.Mesihut Kur'ani inkurajon dhe thotë se rrugët e mjekimit të sëmundjeve janë të hapura gjer në kufirin e vdekjes, pa përjashtuar edhe sëmundje të tilla si kanceri dhe aidsi për të cilat ende nuk është gjetur shërim. Kur'ani kërkon t'u thotë njerëzve se, ashtu siç mjekohen sot fare lehtë sëmundjet që gjer dje

dukeshin pa shpëtim, ashtu edhe për këto njeriu mund të gjejë shërim, mjafton që të kërkojë!

Ose, për shembull, në mrekullinë e paraqitur njerëzve me dorën e Hz. Musait, u jepet mësimi se është e mundur që një pjesë gjërash jo të gjalla të kryejnë funksione dhe detyra të caktuara, portë, kjo, e hapur në ditët tona, vetëm se as sot dhe as nesër njeriu nuk do të mundet ta hedhë shkopin e ai të bëhet një gjarpër i vërtetë, sepse ajo është një dukuri e realizuar në spektrin e mrekullive, kurse gjërat që mund të bëjmë ne, kufizohen brenda kuadrin të së zakonshmes. është një horizont i fundmë dhe arritja e tij është diçka e pamundur. Fjalët dhe shprehjet më letrare dhe poetike njerëzore të transmetuara brez pas brezi, do të afrohen një ditë gjer në portën e Kur'anit, por atje, në horizontin e mahnitjes, do të ndalen. Sepse Kur'ani është një mrekulli në shprehje dhe sado të bukura të jenë fjalët e shprehura nga njeriu, në fund të fundit, janë fjalë të thëna në fushë të së zakonshmes.

Kur flitet për mrekullinë e shprehjes së Kur'anit, kihet parasysh vetëm origjinali i tij në arabisht.

Meqë kjo specifike është një temë më vete dhe krejt e veçantë, nuk do ta prekim qoftë edhe përciptazi për t'ia lënë kapitullit përkatës.

Mrekullitë e profetëve, ashtu siç pohuanm edhe pak më parë, përbëjnë pothuajse një kufi të caktuar dhe pervijojne horizontin e dijes njerëzore; në të njëjtën kohë, me pohimet e Kuranit, zbatohet detyra e nxitjes dhe e inkurajimit të njeriut. Pas këtyre u lihet radha përpjekjeve të njeriut“”

Njeriu duhet të përpiqet, duhet të afrohet gjer në atë pikë dhe të realizojë çdo gjë që ndodhet në kuadrin e të zakonshmes; duhet të afrohet në kufirin e mrekullive dhe, edhe sikur, ta supozojmë, hedh një hap përtej, duhet të përsillet në horizontet ku ndodhen frytet e mrekullive.

Në fushë të mjekësisë njeriu mund të shënojë një përparim që arrin gjer në cakun e vdekjes. Kur puna vjen te vdekja, ajo s'ka shpëtim, sepse vdekja, ashtu si edhe jeta, është një krijim i Allahut, gjë për të cilën flet edhe ajeti-argument i Kur'anit: "Është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën..." (Kur'ani, El Mulk: 2)

Vdekja nuk është një dekompozim, një shuarje, një copëtim dhe një asgjësim. Vdekje do të thotë kthim prapë i atyre që janë dhënë gjer atë ditë me

dëshirë dhe vullnet të Allahut. Ia, pra, edhe inkurajimi i diturisë e i shkencave kaq është. Të gjithë njerëzit e teorisë e të praktikës duhet të përfitojnë nga ky inkurajim, duhet të arrijnë ç'mund të arrijnë, t'i vlerësojnë dhe përpunojnë ato dhe t' i vënë në shërbim dhe përfitim të njeriut.

Ekzistojnë shumë e shumë thënie të Profetit tonë për mjekësinë

“dhe posaçërisht për higjienën të quajtur “mjekësia preventive”. Kjo

“ Për hollësi, shih Bediuzzaman, pika e dytë e Fjalës XX, Parathënie. Lloj mjekësie zë një pjesë të madhe të mjekësisë së përgjithshme dhe kështu duhet të ndodhë. Sepse thelbësore është të ruhet personi që të mos sëmuret, gjë që është mjaft e lehtë në krahasim me mjekimin e sëmundjes që është më e vështirë, preokupante dhe e shtrenjtë. Është për këtë arsye që Profeti ynë në urdhrat e tij i ka dhënë rëndësi kësaj specifike dhe shumicën e këshillave mjekësore i ka përqëndruar në mjekësinë preventive.

Në Shekullin e Lumtur, veçanërisht mjekët e ardhur nga jashtë nuk gjenin punë në Medinë dhe shkaku më i rëndësishëm i kësaj ishte respektimi i parimeve të predikuara në këtë fushë nga Profeti.

Ndërsa në një rën anë i Dërguari i Allahut kryente detyrën e mjekut të zemrave dhe ndjenjave, nga ana tjetër bënte pothuaj detyrën e mjekut të trupave dhe merrte masa për mbrojtjen e njerëzve përreth mjedisit të tij edhe nga sëmundjet trupore, edhe nga ato shpirtërore.

Në kohët kur doli Profeti, murtaja ishte një sëmundje e tmerrshme që s'i pritej dot udha. Ç'të jetë sot aidsi, ashtu ishte murtaja atë kohë. Sahabet, pasuesit profetikë, silleshin shumë të kujdesshëm dhe pedantë ndaj murtajës, rrinin, si të thuash, me gishtin në këmbëz, sepse Profeti i porosiste dhe i paralajmëronte Vazhdimisht. Ajo bashkësi njerëzish të nurshëm jetonte pastër mes Vedit dhe në atdheun e vet, por, kur shkante në vende të tjera me rastin e fushatave ushtarake, edhe ata i nënshtroheshin rrezikut të goditjes së murtajës të shfaqur në botën bizantine të ekspozuar ndaj sëmundjeve ngjitëse e epidemike. Një fatkeqësi e tillë pat qenë vdekja nga murtaja e tridhjetë mijë sahabëve në Amvas.¹⁶

Atë ditë në Amvas mes sahabëve ndodhej edhe i besuari i Ummetit, Ebu Ubejde b. Xherrah për të cilin vite më vonë, i shtrirë në shtratin e vdekjes pas

një atentati, Hz. Omeri do të thoshte: "Po të ishte gjallë Ebu Ubejde, do ta propozoja të më zëvendësonte mua!":

Nexhranasiti patën qenë drejtuar të Dërguarit të Allahut dukei kërkuar t'u dërgonte një njeri të besuar. I Dërguari i Allahut e pati parë në sy dhe i pati thënë: "Shko me këta!"¹⁴³ Po, ai ishte i besuari i ummetit dhe një prej dhjetë vetëve të përgëzuar në të gjallë me fitimin e xhenetit. Ja, pra, atë ditë ky sahabë i famshëm ndodhej mes shokëve të tjerë të tij i dërrmuar nga goditja & murtajës.

Ishin ditët e hilafetit të Hz. Omerit. Kalifi vizitonte vendet e triumfuara dhe ndiqte nga afër ngjarjet. Do të shkonte në Amvas. Por kur dëgjon se atje ka rënë murtaja, vendos të kthehet prapë. Atëherë Ebu Ubejde i zë udhën: "O Omer, nga kaderi i Allahut po ikën?" "Po, i përgjigjet Omeri, po iki nga kaderi i Allahut për te kadeti i Allahut!"^m Kjo tregonte zgjuarsinë e Omerit i cili dallohej për përgjigjet e shpejta e të gjetura.

A kishte vepruar, vallë, drejt? A kishte qenë me vend kthimi pas? Në këto momente lëkundjeje e dyshimi i pati ardhur në ndihmë Abdurrahman b. Avfi duke i përcjellë këtë porosi profetike: "Nëse

dëgjoni se diku ka rënë murtaja, në asnjë mënyrë të mos shkoni atje! Dhe nëse në vendin ku ndodheni, është shfaqur murtaja, mos dilni e mos ikni prej atje?“¹⁴⁵

Dhe tani ju lutem të më thoni: A nuk është kjo porosi identike me parimin e karantinës të mjekësisë së sotme moderne? Këtë e ka thënë i Dërguari i Allahut shekuj më parë, kurse sot mjekësia i thotë atij: "E vërtetë, drejt ke folur!"¹⁷

¹⁴² Ahmed b. Hanbel, Kitabu Fadaili's-Sahabe. 2/742

¹⁴³ Buhari. FezaiIU'l-ashab, 21; Myslim, Fezailu's-Sahabe: 53'54' *

¹⁴⁴ Buhari, 'l'ibb, 30; Myslim, Selam 98.

¹⁴⁵ Buhari, Tibb, 30; Myslim, Selam, 98.

Lepra dhe karantina

2. Në një porosi të përcjellur nga Ahmed b. Hanbeli, Profeti urdhëron kështu: "Ik prej leprozit si prej luanit!"⁴⁴

Paralelizmi figurativ i përdorur në këtë shprehje, s'ka të bëjë fare me ngjasimin e jashtëm të luanit as me mikrobën e leprës, as me leprozin vetë. Pandeh se interpretime të tilla, si në shumë çështje të tjera, janë sajime të personave të tjerë. Nuk duhet nënkuptuar as ikja me vrap, i tmerruar prej kësaj sëmundjeje si prej luanit. Mendoj se i Dërguari i Allahut më tepër ka dashur të na porosisë majtjen prej sëmundjes, marrjen e masave parambrojtëse, luftën kundër saj dhe kërkimin e mjeteve shëruese. Me fjalë të tjera, ajo çka këshillohet, është karantina dhe marrja e masave kundër ngjitjes së sëmundjes. Sa të kujdesshëm që tregohen njerëzit për të mos u përplasur ballëpërballë me luanin e për të mos rënë nën kthetrat e tij, aq të kujdesshëm duhet të tregohen

edhe ndaj leprës. Në thëniet e të Dërguarit të Allahut ka një dimension të veçantë dhe një thellësi të veçantë. Të vërtetat në fjalët e tij mund të rroken vetëm me përpjekje dhe veprime shumë serioze.

Prekja e gojës së qenit

3. Në veprën e tij "Sahih", Myslimi na përcjell: "Kur enën e ushqimit t'ua këtë prekur qeni, pastrimi i saj duhet bërë me shtatë larje duke nisur me pastrimin me dhe!"¹⁴⁷

Atëherë nuk ekzistonin lëndë sterilizimi që përdorim ne sot. Për dezinfektim i Dërguari i Allahut atë ditë këshillonte më shumë dheun. Por më vonë, në përfundim të përpjekjeve shkencore është kuptuar se dheu bën të njëjtin veprim si uji. Përveç kësaj, dheu përmban lëndë si tetraliti dhe tetraciklina që përdoren për mbytjen e mikrobeve. Kjo do të thotë se me pastrimin fillestar të enës me dhe, i Dërguari i Allahut urdhëronte në fillim sterilizimin e enës.

Përveç kësaj, në hadithin, porosinë profetike, tërthorazi tërhiqet vëmendja edhe për këto specifika. Disa sëmundje që mund të ndodhen te qeni, kanë

aftësinë të jetojnë edhe në trupin e njeriut, gjë që përbën një nga subjektet e konsideruara pothuaj të reja sot.

E dyta, gjëra të tilla si jashtëqitjet e qenit mund të jenë krejtësisht të dëmshme për shëndetin e njeriut. E tillë është edhe pështyma e tij. Pasi të kalojë një kohë e caktuar (periudha e inkubacionit) nga prekja e qenit, bëhet pothuaj i pamundur pengimi i ecurisë së sëmundjes ngjitëse. Prandaj edhe sterilizimi është shumë i rëndësishëm.

E. treta, urdhri për pastrimin nismëtar me dhe, që të tërheq vëmendjen, do të thotë se dheu është menduar si mjet sterilizimi, gjë që është diskutuar edhe në disa revista gjermane dhe angleze duke shprehur miratimin për pohimin e drejtë të Profetit tonë.

Profeti ynë është treguar aq i ndjeshëm lidhur me çështjen e qenve, saqë një herë, me vendimin e vet personal pati urdhëruar, madje, vrasjen e tyre.¹⁴⁸ Por më pas e pati ndaluar këtë urdhër duke thënë kështu: "Po qe se qentë s'do të ishin një popullatë më vete, do të urdhëroja asgjësimin e tyre!" " "

Kjo ka këtë kuptim: Po qe se qeni s'do të ishte në vetvete një prej elementeve të ekuilibrit ekologjik

si njerëzit, kafshët, bimët dhe jogjallesat, dhe po qe se, sipas ligjesisë së krijimit, nuk do të ndihej nevojë për të, do të ishte me vend shfarosja e tyre, sepse qeni është një qenie-fole mikrobesh.

Një trajtim i tillë i problemit nga Profeti ynë është një mrekulli më vete, sepse shihet se që në atë kohë ai trajtonte dhe ligjëronte pengimin e vrasjes qoftë edhe të qenve të lirë në kuadrin e konceptimit të ekuilibrit ekologjik, për të cilin ne pothuajse sapo po bëjmë fjalë. Vetëm 1400 vjet pas asaj dite kur fliste për këtë çështje Profeti ynë, ne filluam të shqyrtojmë domosdoshmërinë e ruajtjes nga shfarosja të balenave, elefantëve, rinocerontëve, etj., për të ruajtur ekuilibrin ekologjik në na tyrë. Kurse me thënien "po të mos ishin qentë një popullatë më vete", i Dërguari i Allahut i vinte gishtin, në ato kohë të hershme, një çështjeje me rëndësi jetësore Vendimtare.

Po, Allahu e pati krijuar gjithësinë duke vendosur një ekuilibër të përgjithshëm midis elementëve përbërës të saj: "...Ai vuri një drejtpeshim që ju s'duhet ta prishni!" (Kur'ani, Rahman: 7, 8). Edhe i Dërguari i Allahut ishte njeriu i drejtpeshimit, prandaj edhe do ta luante

drejtpeshimin dhe nuk do të lejonte të asgjësoheshin qentë. Vetëm në një fjali të shkurtër prej disa fjalësh ka disa aspekte të karakterit të mrekullisë që kemi mundur të hetojmë ne dhe kushedi për sa të vërteta të tjera do të bëhet burim frymëzimi kjo fjali në të ardhmen! Duke pasur parasysh datën kur është thënë kjo fjali, po që se një njeri gjatë gjithë jetës së tij nuk do të kishte arritur të bënte gjë tjetër veçse të mendonte e të thoshte kaq fjalë, kjo do të mjaftonte që ta radhisnim atë midis gjenive. Kurse i Dërguari i Allahut ka edhe mijëra pohime të tjera si kjo apo të ngjashme me këtë. Por le ta lëmë gjenium si lypës në portën e Tij dhe t'i vëmë pikën edhe kësaj çështjeje.

Me një gjuhë të prerë dhe pa i lënë shteg asnjë lëkundjeje, themi se ngjarjet dhe dukuritë, me gjuhën e tyre të posaçme, e vërtetojnë gjithmonë të Dërguarin e Allahut duke i thënë: "Ti je i Dërguari i Allahut dhe je ijalëdrejtë!" Nuk kemi dyshim se me përparimin ekstensiv të shkencave, një ditë të gjithë njerëzit do të thonë të njëjtat fjalë. Po, sot, shkencat që kanë hyrë brenda qenies si nga një informator më vete dhe shpirtat e ndjeshëm të cilët janë kah shqyrtojnë të vërtetat e thëna nga Profeti ynë dhe të përmendura nga Kur'ani, për ç'shkak janë zgjuar kah

e vërteta, çdo ditë që kalon, e ndjejnë dhe e kuptojnë edhe më thellë drejtësinë e të Dërguarit të Allahut dhe përpiqen t'ia bëjnë të njohur me zë të lartë botës...¹⁸

Larja e duarve para dhe pas ngrënies

4. Në një porosi të rrëfyer nga Tirmidhiu dhe Ebu Davudi. I Dërguari i Allahut urdhëron kështu: "Bekimi i ushqimit qëndron në larjen e duarve para dhe pas ushqimit."¹⁵⁰

Po qe se kërkon bekim e pastërti në bukë e po qe se dëshironi që ushqimi t'ju bëhet burim begatie, duhet patjetër të lani duart para dhe pas ngrënies sikur të merrnit abdest!

¹⁴⁷Myslim, Tahare 91

¹⁴⁸ Buhari, Bedu'l-Halk, 17; Myslim, Tahare, 93. *

¹⁴⁹Ebu Davud, Edahi, 21, Ibni Maxhe, Sajd, 2; Mysned, 4/85.

Me këtë këshillë, i Dërguari i Allahut predikon në emër të pastërtisë një parim dhe një fundament. Kurse ne nuk mund t'i dinim këto me mendjen tonë. Veçanërisht njeriu i asaj dite as që e kishte idenë se bartte miliona mikrobe vetëm te një thua! Lëreni njeriun e asaj dite, sa njerëz e njohin aspektin shkencor të kësaj çështjeje?

I Dërguari i Allahut që përsëri në emër të pastërtisë thotë se nuk mjafton vetëm t'u hidhet një ujë duarve menjëherë pas zgjimit, por se ato duhen larë mirë e mirë pasi njeriu në gjumë nuk e di se ku mund t' i shkojnë duart,¹⁵¹ jep porosi pas porosish duke vënë në qendër të vëmendjes posaçërisht pastrimin e duarve.

Mjekësia vetëm sot ka mundur ta kuptojë dhe ta shpjegojë plotësisht këtë. Gjatë gjumit njeriu i çon duart gjithandej dhe i mbush me mikrobe. Dhe nëse pastaj, pas zgjimit, i fut në gojë pa i larë, a është nevoja të themi se ç'gëlltit?

Dhe tani, mos vallë atë ditë kishte mikroskop, rreze iks apo laborator që i Dërguari i Allahut të dinte për ekzistencën e mikrobeve që i ngjiten dorës së njeriut e, kështu, të paralajmëronte ummetin e tij? Asnjëra nga këto gjëra s'ekzistonte, por ekzistonte

një e vërtetë përtej tyre. Dhe ajo e vërtetë ishte ekzistenca e dikujt që ia mësonte atij me anë të valëve të revelacionit të gjatësive të ndryshme... Po, gjërat që ai dinte, i dinte se ia bënte të ditura Mësuesi i Madh.’ Pastaj ai ia kumtonte ummetit dhe e mësonte si t’i zbatonte në praktikë. Është për këtë arsye që në thëniet e tij është e pamundur të gjendet edhe më i vogli sajim apo më e vogla kontradiktë.

Pastrimi i gojës e i dhëmbëve

5. Në një porosi të tijën të rrëfyer unanimisht prej Kutubi Sites dhe të nënshkruar nga pas prej afro dyzet pasuesve, për ç’shkak edhe përshtohet gojë më gojë, i Dërguari i Allahut thotë kështu: "Po të mos druhesha se do t’i shkaktoja mundim ummetit tim, do të urdhëroja që para çdo namazi të përdornin misvak!"¹⁵²

Siç shihet, nuk është urdhëruar përdorimi i misvakut për të mos e vënë në pozitë të vështirë ummetin, ndryshe larja e dhëmbëve do të ishte një nga farzet, detyrimet e namazit, gjë që do të binte në kundërshtim me parimin e lehtësisë që përbën

shpirtin e fesë, sepse jo çdokush dhe kurdoherë mund të gjente misvak.

Përdorimi i misvakut, i furçës së dhëmbëve sot, nuk është farz. domethënë detyrim i formës së prerë, por ama është një sunnet, traditë profetike e rëndësishme. Të vjetrit kanë shkruar vëllime të tëra mbi këtë temë. Edhe kërkuesit tanë të rinj e kanë shqyrtuar çështjen e misvakut në dimensione të ndryshme duke e kushtëzuar me analiza shkencore.

Fjala "sivakllama" që rrjedh nga "misvak", do të thotë "pastrim dhëmbësh", gjë që nuk kryhet vetëm me misvak, por edhe me gishta, me kripë, me pastë dhëmbësh, etj. Ai që dëshiron t'i pastrOjë dhëmbët, mund t'i pastrojë me se të dojë dhe në këtë gjë s'mund t'l përzihet askush. Puna është se nuk duhet nënvleftësuar fakti se te misvaku ndodhen disa gjëra të veçanta për të.

Tani mendoni një fe, kumtuesi (jo krijuesi dhe themeluesi, sepse ai është Allahu, ndërsa Profeti ynë është vetëm kumtuesi i saj) i së cilës urdhëron përdorimin e misvakut pesë apo dhjetë herë në ditë, madje e urdhëron si një sunnet, traditë. Duke u nisur nga kjo, mund të themi se kjo te e ka lënë shumë prapa kuptimin e sotëm mbi pastërtinë dhe

higjienën e dhëmbëve. Pa bërë fjalë për masën e popullit, unë nuk pandeh të ketë as stomatologë që t' i pastrojnë dhëmbët kaq herë në ditë. Kurse me Profetin tonë kështu ndodhte. Natën ngrihej disa herë për të falur namaz dhe për çdo herë para namazit përdorte misvak.¹⁵³ Në namazin e agimit, në ato të paradrekës, në namazet e mesditës, pasditës, mbrëmjes dhe të natës, gjatë marrjes së abdestit përdorte misvak. Po ashtu edhe pasi të hante a të pinte diçka. E po t'i numëronim të gjitha këto, do të shihnim se i Dërguari i Allahut e përdorte misvakun edhe më shumë herë se shifrat që dhamë në fillim.¹⁹

¹⁵⁰ Ebu Davud, Et'rme, 11; Tirmizi, Et' ime, 39; Mysned, 5/441.

¹⁵¹.Myslim, Taham, 87; Ebu Davud, Tahare, 49; Tirmidhi. Tahare, 19.

19 Në origjinal Muallim-i Ekber. Mësuesi i Madh, Allahu.

¹⁵² Buhari, Xhum'a, 8; Myslim, Tahare, 42; Ebu Davud, Tahare, 25; Tirmizi, Tahare 18; Nesai, Tahare, 6; ibni Maxhe, Tahare. 7; Mysned, 1/80.

Masë në ngrënie

6. Prapë, në emër të mjekësisë preventive, i Dërguari i Allahut urdhëron kështu: "Kur të hani, një të tretën e stomakut lërjani ushqimit, një të tretën ujit dhe një të tretën ajrit. Ena që dënohet më rëndë nga Allahu, është një stomak i mbushur plot!"

Ka edhe hadithe, porosi të tjera, që e përforcojnë këtë. Në njëren prej tyre i Dërguari i Allahut urdhëron kështu: "Gjërat nga të cilat frikësoheni më shumë për ummetin tim, janë vënia bark, ijetja gjatë, dembelizmi dhe dobësia intelektuale."¹⁵⁵

Specifikat e përshkruara në porosi, në përfundim, mblidhen në të njëjtën pikë. Po, për një njeri që e shtyn jetën pa kontroll, pa llogari dhe në indiferencë, që e kalon pjesën më të madhe të saj në gjumë, dhjamëzimi dhe obeziteti bëhen dukuri të pashmangshme.

Misvak: në atë kohë, furçë e trajtësuar nga rrahja e kërcellit të një druri fijëzor.

Njeriu, sa më shumë që të shëndoshet, aq më shumë do të hajë dhe, duke ngrënë, do ta lëshojë veten. Ose, po të nisim nga shkaku i parë, do të themi kështu: Njeriu që ha shumë, sigurisht që do të flejë shumë dhe, te njeriu që fle shumë, sigurisht që nuk do të zhvillohet intelekti... Ngado që ta kapni çështjen, të gjitha këto janë gjëra që e kanë shtyrë të shqetësohet Profetin për ummetin e tij Dhe përsëri fjalën po u a lë këtu figurave të shquara të botës mjekësore, kurse ju po ju lë kokë më kokë me kërkimet shkencore të tyre. Pasi t'i lexoni dhe vlerësoni ato, do të shihni se fjalët e thëna shekuj më parë nga i Dërguari i Allahut, janë vetë e vërteta dhe do të bëheni dëshmitarë të faktit se është e pamundur që në fjalët e tij të gjendet qoftë edhe pasaktësia apo kontradikta më e vogël.²⁰

¹⁵³ Buhari, Vudu, 73; Myslim. Tahare, 46, 47.

¹⁵⁴ Tartari, Zuhd, 47; Mysned, 4/132.

¹⁵⁵ Kenzu'l-Ummal, 3/460.

Makiazhi'

7. Dhe tani kërkoj të kaloj në një hadith tjetër. I Dërguari i Allahut urdhëron: "Mjekojini sytë me anë të makiazhit, sepse ai ua hap sytë dhe ua ushqen qerpikët."¹⁵⁶

Mjekët tanë me zemrën dhe mendjen të ndriçuar thonë se mëi dobishmi ndër ilaçet e përdorura gjer më sot për ushqimin e syve, është "syrmeja", makiazhi i këshilluar nga i Dërguari i Allahut. Edhe ne mendojmë se vitet që do të vijnë, në fushë të kozmetikës, mund të jenë vitet e syrmesë. Kënaja është një tjetër lëndë në vlerën : syrmesë, e cila është këshilluar nga Profeti për ruajtjen e lëkurës dhe për vetitë antibiotike. ¹⁵⁷

Fakti që fuqia sterilizuese e kënasë është më e madhe se e është fjala për lyerjen e syve me një bojë të zezë, prandaj edhe quhet "syrme", lyerje.

lëndëve të përdorura sot si tenturjodi dhe merofsiloni, është një prej të vërtetave shkencore të sotme.

Xhenxhefil (Nigella Sativa)

8. Te Buhariu është një hadith, porosi, e rrëfyer nga Ebu Hurejre, këshillohet: "Kjo kokrra e dashurisë, Domethënë, xhenxhefili është shpëtim për çdo vuajtje përveç vdekjes."¹⁵⁸

Në porosi tërhiqet vëmendja veçanërisht në dy specifika: E para: aspekti shërues i xhenxhefilit. E dyta: diskutimi i veprimit shërues të tij madje edhe te vdekja.

Duke ua lënë prapë analizën shkencore të çështjes specialistëve të fushës përkatëse, le të përpiqemi të shënojmë vetëm nja dy gjëra që na vijnë ndërmend.

Në sëmundje, veçanërisht në periudhën e konvaleshencës, rëndësi të madhe ka marrja e bollshme e proteinave. Por, krahas kësaj, për tretjen e lehtë është po kaq e rëndësishme edhe marrja e kalorive dhe vitaminave. Mendoj se këto janë edhe gjërat që do të rekomandonin mjekët në periudhën e sëmundjes. Po, gjërat që do të hajë i sëmuri, duhet të përmbajnë boll proteina, boll vitamina dhe të jenë lehtësisht të tretshme në mënyrë që i sëmuri edhe të rifitojë fuqitë e humbura, edhe të mos heqë vështirësi në tretje.

Kërkimet shkencore të sotme kanë vërtetuar se të gjitha këto Veçori ndodhen te xhenxhefili, Në këtë fushë ka aq shembuj konkretë të provuar e me rezultat, saqë nuk mbarohen me të numëruar. Kjo do të thotë se i Dërguari i Allahut në asnjë mënyrë nuk flet në tym.

Ajo çka thotë, realizohet po ashtu dhe rezultatet gjithmonë. Vërtetojnë atë.

Miza

9. Le ta vazhdojmë temën e bisedës sonë përsëri me një hadith të përcjellur nga Buhariu. I Dërguari i Allahut urdhëron: "Kur të bjerë një mizë në enën tuaj (të ujit ose të ushqimit), një herë zhytem plotësisht në të, pastaj nxirreni, sepse në një krah të mizës ka sëmundje e, në krahun tjetër, shërim."¹⁵⁹ Së pari, fakti që miza ban mikrobe, nuk ishte diçka që dihej nga njeriu i asaj dite. Kur miza bie në një lëng, përpiqet që njërin krah ta mbajë sipër në mënyrë që me të të mund të fluturojë e të shpëtojë. Miza do të ikë, por me mikrobet e lëna në ushqimin ose pijen tonë, na ka ngjitur sëmundje.

E dyta, këshilla e dhënë në këtë rast, është kjo: Miza do të zhytet e tëra në përmbajtjen e enës, pastaj do të nxirret e do të hidhet sepse, ndërsa në njërin krah të saj ka mikrobe, në tjetrin ka mjete mbrojtëse që eliminojnë veprimin e tyre.

Shkencëtarët që merren me analizën e kësaj çështjeje, thonë se. kur kanë shtypur shpinën e mizës, kanë vërejtur mikroorganizma që vrapojnë majtas e djathtas. Pastaj, në kërkimet e mëvonshme, kanë kuptuar se këto mikroorganizma kryejnë funksione sterilizuese.²¹

¹⁵⁶ Ebu Davud, Tibb, 14; Tirmizi, Tibb, 9.

Në origjinal: Habbe-i sevda.

¹⁵⁶Buhari Tibb, 7; Myslim, Selam, 88

Hemorragjia e brendshme

10. Hz. Aisheja tregon: "Një ditë erdhi Fatima binti Ebi Hubejsh dhe i tha Profetit: "O i Dërguari i Allahut, nuk po më ndalet e nuk po më ndalet gjaku; a ta lë namazin?" Dhe i Dërguari i Allahut iu përgjigj: "Jo, ai nuk është gjak menstruacionesh, por nga një çarje në damarë."¹⁶⁰

Kalojnë vite dhe ne shohim se gjaku i mpiksur e ka burimin krejtësisht nga një hemorragji e brendshme dhe edhe një herë tjetër mbetemi të mahnitur. Mirë, po si pati mundur ta dijë i Dërguari i Allahut në atë kohë të vërtetën e kësaj dukurie që është saktësuar vetëm në ditët tona në sajë të kërkimeve shkencore? Sigurisht që me anë të njoftimit të Zotit. Dhe vitet që kanë kaluar ndërkaq, i kanë përfutur thellësi të tjera atij Fjalëxhevahirit. Tani shkencëtarët thonë se autori i këtij konstatimi nuk mund të jetë tjetër veçse profet!

Tek pijet alkoolike nuk ka shërim

11. Tarik b. Suvejd tregon: "Kisha një sëmundje. Para se të ndaloheshin pijet, përdorja pije për mjekimin e sëmundjes. Por pas ndalimit, shkova te i

Dërguari i Allahut, ia paraqita situatën dhe e pyeta nëse do të më jepej mua leje për ta përdorur. ”Jo, - më tha,- pija është sëmundje vetë, kurrë s’mund të bëhet shërim!”” Ashtu si në shumë vende të botës, edhe në Turqi u organizuan simpoziume kushtuar dëmeve të alkoolit. Shkencëtarët folën dhe

konkluzionet e tyre u përqëndruan unanimitisht në këtë pikë: Qoftë edhe një pikë nga pijet alkoolike shkakton deformime në ndërtimin fizik dhe shpirtëror të njeriut.

Ja, pra, i Dërguari i Allahut i ka vënë gishtin kësaj çështjeje shekuj më parë dhe ka thënë se pijet alkoolike janë vetë sëmundje.²²

¹⁵. Buhari, *Bed'ul-Halk*, 17, *Tibb*, 58; Ebu Davud, *Et' ime*, 48.

Syneti

12. I Dërguari i Allahut numëron dhjetë gjëra si të natyrshme. Njëra nga këto është syneti.” 162

Po shkencëtarët e ditëve të sotme, ç’thonë? A nuk thonë ata se lëkura që pritet në aktin e synetit është një element i ekspozuar ndaj mbledhjes së papastërtive dhe mikrobeve, ndaj rrezikut të çarjes dhe prekjës nga kanceri dhe se mënyra e vetme e shpëtimit është syneti, operimi i tij?

Eshtë diçka që bie në sy se, lidhur me këtë çështje, perëndimi ecën shumë më përpara se ca sarhoshë të verbër tek ne! Numri i të bërëve synet sot në Amerikë dhe Angli i kalon milionat.

Në këtë pjesë të diskutimit le të më lejohet të citoj këtë përcaktim të një dëshmitari gjenial të këtij shekulli që m’u kujtua në saje të një asociacioni: ”Perëndimi është shtatzënë për të lindur një ditë një bir të Islamit. Po ashtu edhe osmanizmi ka për të lindur një bir të perëndimit!”163

U realizua një pjesë e kësaj fjale të thënë shtatëdhjetë-tetëdhjetë vjet më parë dhe ne tani presim lindjen e dytë me sytë plot shpresë. Të prerat janë rënduar. Dhe klithmat sihariqplote të fëmijës që

do të lindë, dashtë Zoti do të dëgjohej në një të ardhme shumë të afërt!..

Gjer këtu u ndalëm mbi drejtësinë dhe besnikërinë e të Dërguarit të Allahut dhe të profetëve të tjerë. Çdo profet dallohet për drejtësi dhe besnikëri. Në jetën e tyre nuk ka gjetur vend as edhe gënjeshtria më e vogël. Dhe s'ka pasur si të ishte ndryshe, sepse, sado pak shtrembëri të vihej re tek ata, askënd s'do të kishin mundësi ta kthenin në rrugë të drejtë! Kurse ata patën ardhur pikërisht për ta futur njerëzimin në rrugë të drejtë e për ta orientuar kah rruga e gjerë që të çon në xhenet. Po, nëse do të mishërohej e do të trupëzohej koncepti i drejtësisë, prej tij do të dilnin figurat e përndritshme të profetëve...²³

¹⁶⁰ Buhari, Vudu, 63; Myslim, Hajz, 62; Ebu Davud, Tahare, 109.

¹⁶¹ Myslim, Eshribe. 12; Ibni Maxhe, Tibb, 27

¹⁶² Myslim, tahare, 49, 56; Ebu Davud, Tahare, 29.

¹⁶³ Bediuzzaman Said Nursi, Tarihçe-i Bajat, f. 56.

Famë, gjithashtu, në këtë mes, se drejtësia e Profetit tonë mbështetet në mijëra argumente mes dimensioneve të pakufishme të eternitetit. Ne u përpoqëm që drejtësinë e të Dërguarit të Allahut ta përmblihdhnim në tre grupe kryesore. Natyrisht, klasifikimi dhe paraqitja e çështjes në fjalë në këtë mënyrë, është identitet i subjektivizmit tonë. Ndryshe, drejtësia e tij mund të përshkruhej edhe me forma dhe mënyra të tjera.

Në fund të fundit, kush mund ta thotë fjalën e fundit lidhur me këtë çështje? Besimi ynë është se thëniet e tij do të dalin të drejta gjër në kiamet dhe njeriu i çdo epoke do të zbulojë një tjetër dimension të drejtësisë së tij dhe do të takohet me të në një dimension tjetër.

Edhe në gjithësinë e quajtur ”ahiret”, e pastajme, drejtësia e të Dërguarit të Allahut do të shihet nga çdokush në tërë dukjen e vet; thëniet e tij mbi individualitetin, atributet dhe emrat e Zotit pa diskutim që secili do t’i shohë sipas pasqyrës shpirtërore të vet dhe do ta kuptojë drejtësinë

sublime të fjalëve të tij. Po, xheneti, xhehenemi, hyritë, etj. të gjitha do të na dalin përpara ashtu siç na ika përshkruar i Dërguari i Allahut dhe do t' i thonë atij me gjuhën e amshuar: "Drejt ke folur!"

Atributi i dytë i profetëve është besueshmëria. Ata janë njerëz që i qëndrojnë besnik fjalës së dhënë dhe amanetit, janë të besueshëm. Fjalët arabishte "emanet" gjë e lënë në besim, "iman" besim, "mumin" -besimtar, "emin" i besueshëm dhe "emnijet" besueshmëri, siguri, garanci, kanë një rrënjë të përbashkët." Profetët, ashtu siç qëndrojnë në majë si besimtarë, ashtu edhe janë të parët në besueshmëri dhe në kërkesën ndaj të tjerëve për besueshmëri. Kur'ani i shënon në disa ajete-argumente këtotribute të tyre. Le të paraqesim disa prej tyre.

"Edhe populli i Nuhut i akuzoi të dërguarit si gënjeshtarë. Kurse vëllai i tyre, Nuhu, u pati thënë: "A nuk po frikësoheni? Unë jam për ju një pejgamber i besueshëm. Kini frikë Allahun e më dëgjoni mua!" (Kur'ani, Shuara: 105-108)

Me këto fjalë Nuhu kërkon t'u thotë njerëzve të tij që të heqin, më në fund, dorë nga kundëstimi dhe mohimi, sepse ai është një i dërguar që flet për besueshmëri dhe kërkon besueshmëri, që ka për atribut kryesor besueshmërinë dhe që nuk lejon

thyerjen e fjalës dhe tradhtinë. Në këtë ajet, pra, bëhet fjalë për atributin e besueshmërisë tek profetët me gjuhën e një profeti.

Po ashtu: "Edhe populli Ad nuk i besoi të dërguarit kur vëllai i tyre, Hudi, u tha: "A nuk po keni frikë? Unë jam dërguar tek ju si një peygamber besnik!" (Kur'ani, Shuara: 123-125)

Dhe: "Edhe fisi Themud nuk i besoi të dërguarit kur vëllai i tyre, Salihu u tha: "A nuk keni frikë (nga Allahu)? Unë jam dërguar tek ju si i dërguar besnik. Prandaj kinie frikë dënimin e Allahut dhe ma dëgjoni fjalën!" (Kur'ani, Shuara: 141-144)

Po ashtu: "Edhe populli i Lutit i akuzoi të dërguarit si gënjeshtarë kur vëllai i tyre, Luti, u tha: "A' nuk keni frikë? Unë jam i dërguar e jam besnik!" (Kur'ani, Shuara: 160-162) ,

Mund të sjellim edhe shumë ajete të tjera lidhur me këtë tematikë. Por ne po mjaftohemi me kaq, sa për të dhënë një ide.

Adoptimi i shpjegimeve të këtij paragrafi është i përkthyesit.

Fjala "besimtar", ashtu siç është njëri prej emrave të Zotit, ashtu është edhe emri i njerëzve që besojnë. Përse i thuhet Zotit "Besimtar"? sepse Ai

është burimi i besimit. Është Ai që na e ka dhënë dhe na jep besim. Besimi, siguria, garancia, të gjitha këto na Vijnë prej Tij pika-pika ose si ujëvara. Prapë është Ai që i ka bërë profetët të besueshëm dhe me atributin ”i besueshëm” i ka dalluar ata nga të tjerët. E nëse është kështu, do të thotë se ajo çka na lidh ne ndaj profetëve dhe ata vetë në një dimension të rëndësishëm ndaj Zotit, janë çështjet e besimit, amanetit, besueshmërisë, garancisë dhe sigurisë të cilat fokusohen të gjitha tek atributi “besimtar”. Në konkluzion, kjo lidhje na çon ne si një trup i vetëm në marrëdhënien Krijues krijesë. Dhe një aspekt i rëndësishëm i temës që po shqyrtojmë, është të konceptohet kjo lidhje dhe kjo marrëdhënie. Ashtu siç është besueshmëria atributi më i rëndësishëm i profetëve të tjerë si dhe i Profetit tonë, po ashtu është edhe detyra më e rëndësishme e Xhebrail Eminit, Xhebrailit të Besueshëm, të cilin Kur’ani na e prezanton kështu: “... i respektuar midis engjëjve dhe besnik.” (Kur’ani, Tekvir: 21). Po, ai është i bindur ndaj Allahut dhe, duke u nisur nga detyra pranë Tij, është një i dërguar i besueshëm. Ja, pra, edhe Kur’ani nga një burim i tillë besueshmërie na ka ardhur ne! Allahu është ”Mu ’min”, ”Besimtar”.

Shprehja e Tij është e tillë që kumton besim, besueshmëri dhe siguri. Kur'ani na ka ardhur me anë të Xhebrailit të quajtur nga Allahu "Emin", "I besueshëm". Dhe ky Kur'an i është reveluar profetit të quajtur "Emin" (i quajtur madje që para se t' i vijë revelacioni dhe 1 pranuar si i tillë edhe nga armiqtë më të egër të tij!) si dhe ummetit, bashkësisë së njerëzve të bekuar, të denjë për të fituar besimin e Tij e për t'u bërë edhe ata të besueshëm! Pa diskutim që çdo njeri, sipas nivelit të vet, ka përfituar nga Kur'ani. Edhe Xhebraili është midis atyre që kanë përfituar. Një ditë i pat thënë kështu të Dërguarit të Allahut: "Gjersa Allahu përdori në Kur'an për mua fjalën "Emin" ("I besueshëm"), dyshoja vazhdimisht për fundin tim. Pas kësaj, u mbusha me siguri gjer në palcë..."

BESUESHMERIA TE PROFETI YNE

Së pari, Profeti ynë është i besueshëm ndaj mesazheve të marra nga Allahu. As që mund të mendohet tradhtia e tij ndaj amanetit! Pastaj ai është

i besueshëm ndaj të gjitha krijesave. Çdokush i beson atij. Sepse është ai i pari që e ka treguar veten besnik, të sigurt dhe të besueshëm ndaj njerëzve dhe ka predikuar e kërkuar siguri dhe besueshmëri. Më pas na ka treguar ne sesa të domosdoshëm janë siguria dhe besueshmëria dhe na ka bindur e na ka bërë ne që t'i besojmë për këtë. Po deshët, le të qëndrojmë, tani, mbi këto specifika një e nga një.

I besueshëm në detyrën e dërgesës profetike

Allahu (xh.xh.) e ka zgjedhur të Dërguarin e Tij si një njeri që e respekton amanetin dhe i Dërguari i ka përjetuar gjatë gjithë jetes rrahjet e zemrës dhe emocionet e shkaktuara nga kjo konsiderate, ashtu që, kur i vinte revelacioni, i impresionuar se mos i kalonte ndonjë fjalë, ende pa mbaruar Xhebraili, i përsëriste pa pushim thëniet e tij në mënyrë që t'i nguliste në kujtesë. Madje aq i dëshiruar tregohet, sa që një ditë në Kur'an do t' i thuhej kështu: "Ti (Muhamed) mos e shqipto atë (Kur'anin) me gjuhën tënde për ta nxënë shpejt, sepse e kemi Ne për detyrë tubimin e tij (në zemrën tënde) dhe leximin. E, kur ta lexojmë Ne, ndiqe me të dëgjuar leximin.

Pastaj edhe shkoqitja e tij na takon Nevel!" (Kur'ani. Kijame. 16-19). Kur'ani i qe lënë atij si amanet... Kurse ai dridhej nga frika se mos nuk do të ishte i sigurt në besnikërinë ndaj atij amaneti te shenjtë. Prandaj edhe Allahu e qetësonte atë (siç sapo e cituam) dhe e siguronte të Dërguarin e Vet se do ta bënte të sigurt në besnikërinë ndaj amanetit!

I Dërguari i Allahut e pati kaluar jetën gjithë me këto emocione, qe përpjekur më tepër se çdokush tjetër për të qenë i sigurt në amanet dhe e pati ndjerë plotësisht mbi supe peshën dhe shqetësimin e kësaj ngarkese që e pati marrë përsipër. Është për këtë arsye që, në haxhin në të cilin ai i dha lamtumirën umetit të tij, për çka edhe është quajtur "Haxhi i Lamtumirës", ndërsa dielli perëndonte ashtu siç po prirej kah perëndimi jeta e tij, me vetëdijen e këtij perëndimi ai thithte edhe një herë frymën e kësaj përgjegjësie dhe e pyeste me zë të lartë ummetin: "Nesër do t'ju pyesin për mua. Si do t' u përgjigjeni?" Dhe të gjithë të pranishmit i përgjigjeshin me një zë që kumbonte fuqishëm mes qiellit e tokës: "Dëshmojmë dhe vërtetojmë se dërgesën e plotësove, amanetin në vend e çove, na porosite e na këshillove!" Kurse pas kësaj Profeti i

Dy Botëve ngrinte drejt qiellit gishtin e dëshmisë dhe e ulte mbi ummetin duke thirrur: ”Ji dëshmitar, o Zot!”¹⁶⁴

ja, pra, sesi besueshmëria në amanet kishte nisur te Zoti, kishte arritur te Xhebraili dhe kishte qëndruar te i Dërguari i Zotit për të kaluar, pastaj, te ummeti... Në Haxhin e Lamtumirës, me anë të një deklaratë dëshmie, besueshmëria u rikthye te Zoti e u mbështet tek Ai.

Me ç’përcjellin librat më të njohur të hadithit, Hz. Aisheja thotë kështu lidhur me botëkuptimin e Profetit mbi amanetin: “Po të supozonim se i Dërguari i Allahut do të fshihte ndonjërin prej ajeteve të reveluara atij, pa diskutim që këtë ajet do të fshihte:“...e ti e mbajte fshehtë në veten tënde atë që Allahu do ta zbulojë dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t’i frikësohesh Allahut. E pasi që Zejdi e kishte vendosur atë që kishte menduar ndaj saj, Ne ta kurorëzuam ty atë...” (Kur’ani, Ahzab: 37)¹⁶⁵

Ky ajet ishte reveluar me këtë rast: I Dërguari i Allahut e kishte martuar vajzën e hallës, Zejneb binti Xhahsh, me libetin e tij, Zejd b. Harise. Veçse kjo martesë nuk po ecte ashtu siç duhej. Hz. Zejneb e

kishte pranuar këtë martesë vetëm për të çuar në vend fjalën e të Dërguarit të Allahut. Meqë kjo martesë ishte ngritur qysh në krye mbi mungesën e dëshirës, ajo s'mundej të tregonte ndaj të shoqit respektin dhe konsideratën e duhur. Në këtë mes, Providenca Hyjnore me kohë e kishte dëshiruar ndarjen e saj prej Zejdit dhe hyrjen në Bashkëshortësinë e Dëlrë. Mirëpo, sipas zakonit të arabëve gjer atë ditë, fëmija i adoptuar, i thirrur "bir", konsiderohej si bir i vërtetë. Për rrjedhojë, edhe gruaja e tij konsiderohej si nuset e bijve të vërtetë. Zejnebi i pati qenë propozuar qysh më parë të Dërguarit të Allahut për martesë, por ai s'pati pranuar. Tani, me ajetin në fjalë, këtë martesë e urdhëronte Zoti drejtpërdrejt. Martesa me Zejnebin i rëndoi shumë Profetit, por ç'e do se urdhri vinte që nga lart! Eja, për këtë rast bën fjalë Hz. Aisheja, kur thotë se, nëse Profeti kishte për të fshehur gjë, pa dyshim që këtë ajet, këtë urdhër do të fshihte! Kurse ai ishte krejt besnik ndaj revelacionit. Prandaj edhe as që mund të bëhej fjalë që ai të fshihte qoftë edhe çështjen më të vogël.

Ja dhe një tjetër ndodhi lidhur me botëkuptimin e tij mbi amanetin : Në luftën e Bedrit qenë zënë rob

disa mohues. I Dërguari i Allahut u këshillua me Hz. Ebu Bekrin dhe Hz. Omerin. Hz. Ebu Bekri mbrojti pikëpamjen e lirimt të robërve kundrejt një dëmshpërblimi. Kurse Hz. Omeri anonte nga ekzekutimi i të gjithë robërve. I Dërguari i Allahut, duke anuar nga propozimi i Hz. Ebu Bekrit, i liroi robërit kundrejt dëmshpërblimit. Vazhdimin le ta dëgjojmë nga vetë Hz. Omeri:

"Pata shkuar diku dhe u ktheva. Të Dërguarin e Allahut dhe Hz. Ebu Bekrin i gjeta duke qarë. Kishin ulur kokën dhe qanin me ngashërim. I pyeta për shkakun por s'mundën të më përgjigjeshin. Ngula këmbë të më tregonin e të qaja edhe unë me ta. Më në fund, i Dërguari i Allahut më tregoi duke qarë për ajetin e mëposhtëmtë porsazbritur:166 "Për asnjë të dërguar nuk qe e hijshme që të mbante robër gjersa të mos kishte arritur mposhtjen përfundimtare të armikut. Ju kërkoni gjënë e kësaj bote të përkohshme, kurse Allahu dëshiron për ju jetën e pastajme të amshuar. Allahu është i Madh, është Sundues!" (Kur'ani, Enfal: 67)

Po qe se do të bëhej fjalë që Profeti të fshihte ndonjë ajet çfarëdo, ky ajet do të ishte i dyti. Por ai ishte plotësisht besnik ndaj tevelacionit. Ne do t' i

rimarrim në dorë këto dy ajetet e fundit më tej, kur të flasim për pafajësinë e Profetit dhe do të përpiqemi ta parashtrijmë me hollësi aspektin e këtyre lidhur me atë tematikë.

I besueshëm ndaj të gjithë qenies

Ashtu siç ishte besnik ndaj të gjitha mesazheve të dërguara nga Zoti në detyrën e dërgesës profetike, po ashtu, besueshmëria dhe besnikëria kishin iëshuar rrënjë në shpirtin e Profetit në atë mënyrë, saqë ai vazhdimisht rrezatonte besueshmëri e besnikëri ndaj të gjithë qenies!

Një ditë, tek ishte veçuar në adhurim, i shkon për vizitë e shoqja, Safija. Pasi rri një copë herë, ajo kërkon leje për tu ngritur. I Dërguari i Allahut del jashtë bashkë me të për ta përcjellë dhe, kur kishin bërë vetëm disa hapa, vë re dy nga pasuesit të largohen me nxitim. Profeti i ndalon menjëherë ata, ia zbulon fytyrën Hz. Saijes dhe u thotë: “Shihni, kjo është gruaja ime, Safija!” Pasuesit shtangen: ”Qoftë larg, o i Dërguar i Allahut, a mund të dyshohet ndonjë gjë e keqe për ty?” Mirëpo, ashtu si me të gjitha sjelljet e tij, edhe me këtë Profeti kërkonte të

jepte një mësim. Dhe u thotë atyre: "Shejtani përsillet vazhdimisht nëpër damarët e gjakut të njeriut".¹⁶⁷ Meqë shejtani dhe njeriu janë kaq të lidhur e të ndërthurur me njëri-tjetrin, ai mund të hedhë shumë gjëra në kokën e njeriut. Dhe tani, edhe sikur me një për mijë, madje edhe me një për milion mundësi të lindte në mendjen e njeriut dyshimi ose lëkundje në trajtën "Cila do të ketë qenë, vallë, femra në krah të Profetit", larg qoftë, do t'ia shuante dritën e besimit duke ia shkatërruar personit jetën e amshuar. Ja, pra, për t' u ruaj fundit, a nuk pati qenë quajtur ai "Emin", "[besueshëm" edhe para se të bëhej profet?¹⁶⁸²⁴

Dhe më vonë, a nuk e patën njohur gjithmonë si të tillë atë edhe armiqtë e tij më të pamëshirshëm? E tillë pati qenë kjo konsideratë, saqë pandeh se, po të pyetej Ebu Xhehli se kujt do të mund t'ia linte amanet gjërat më të vlefshme përfshi edhe nderin,

¹⁶⁴ Ebu Garuci, Mmasrk, 56; Ibni Maxhe, Mermsik, 84.

¹⁶⁵ Bunari, Tevhid, 22; Myslim, Iman, 288. Në Original: Evzaxh-i Tahirat.

“el-Eminit”, .. do të thoshte! Po, i pari njeri që do t’i kishte rënë në mend,

Muhamed el-Emini do të kishte qenë! I tillë pati qenë ai dhe të gjithë jetën me një frymë të tillë besueshmërie e pat kaluan

Aq besnik pati qenë ai, sa një herë i kishte ndërhyrë në çast një gruaje që e kish dëgjuar ta thërriste fëmijën e vet duke i premtuar se do t’i jepte diçka: “Çfarë do t’i japësh?” Dhe ajo: ”Do t’i jap disa kokrra hurma, o i Dërguari i Allahut!” Kurse ai kishte vazhduar “Në qoftë se s’do t’i jepje asgjë, do të kishe gënjyer!”

I Dërguari i Allahut e quante shenjë hipokrizie gënjeshtren dhe perpiqej me sa të ishte e mundur të qëndronte larg saj. Gënjeshtra ishte njëra nga tri shenjat e hipokrizisë. Kurse dy të tjerat ishin mëkatet dhe perversitetet e mosmbajtjes së fjalës së dhënë e të tradhtisë ndaj amanetit.¹⁶⁹ Aq sa e huaj të qe për Profetin hipokrazia. po aq e huaj mbetej gjithmonë për të tradhtia ndaj amanetit...

Fryma dhe botëkuptimi i besueshmërisë të të Dërguarit të Allahut nuk qenë të tilla vetëm ndaj njerëzve. Në rrethin e besue shmërisë së tij hynte tërë ekzistenca. Sjellja e një pasuesi që po e thërriste

kalin e vet sikur të kishte në dorë diçka për të ngrënë për të, e pati shqetësuar aq shumë, saqë e pati thirrur personin dhe e pati qortuar rëndë. Ai thoshte se nuk duhej hequr dorë nga besnikëria qoftë edhe ndaj kafshëve.¹⁷⁰

Një herë tjetër po ktheheshin nga lufta. Nja dy vetë prej pasuesve shohin një çerdhe zogjsh, marrin në dorë zogjtë dhe fillojnë t'i përkëdhelin. Pikërisht në ato çaste kthehet zogunënë që nis të përpiket kur s'i gjen zogjtë në fole. Sapo njoftohet për këtë I Dërguari i Allahut, urdhëron që zogjtë të lihen në fole e të mos i shkaktohet mundim nënës, sikur të donte të thoshte se ky veprim su kishte hije njerëzve që ishin në pozitën e përfaqësuesit të sigurisë dhe besueshmerisë në tokë.¹⁷¹

Të tillë qenë edhe sahabet, pasuesit e tij të ndriçuar me dritën e rrezatuar prej tij, ata që ishin votë rreze të asaj drite. Ja, pra, njëri prej tyre, i besueshmi i ummetit, Ebu Ubejde b. Xherrahi! Në kohën e kalifatit të Hz. Omerit ndodhej si vali në Damask. Kur një radhë Herakliti kishte shkuar me ushtri dhe ishte përpjekur për ta rimarrë Damaskun, pranë Ebu Ubejdes ndodheshin shumë pak njerëz. Duke u nisur nga kjo, mbrojtja e qytetit paraqitej e

pamundur. Atëherë, Ebu Ubejde e mblodhi menjëherë popullin e Damaskut dheu tha kështu: "Grumbulluam xhizje prej jush dhe, si përgjigje ndaj kësaj, duhej t'ju mbronim. Veçse tani s'e kemi këtë forcë, prandaj edhe s'mund t'ju mbrojmë, kështu që të gjithë sasinë e Xhizjes së mbledhur do t'jua kthejmë prapë. Sepse s'është e lejueshme që ta mbajmë pa të drejtë..."

Pastaj xhizjet e mbledhura u ndahen të zotërve. Murgjët dhe Priftërinjtë, të mahnitur para kësaj pamjeje, mbushin kishat dhe i luten Zotit t' i mbrojnë muslimanët. Duke i përcjellë muslimanët, ata iuten: "Do Zoti e vijjë prapë dhe na shpëtojnë nga shtypja dhe Padrejtësia e Heraklitit!"¹⁷²

Ebu Ubejde ishte një njeri i kushtuar Zotit, i cili kishte predikuar besueshmëri, kishte jetuar me atributin "i besueshëm" dhe i cili kishte ngritur fron edhe në zemrat e kristianëve, madje! Nëse sot perëndimi nuk na dëgjon ne dhe nuk ua vë veshin mesazheve të njerëzve që çojmë në Europë, kjo buron plotësisht prej një mangësie tonën. Dhe nuk ka asnjë dyshim se e meta më e rëndësishme që ekziston tek ne, është çështja mbi të cilën po flasim, siguria dhe besueshmëria. Atë ditë që të kemi arritur

sërishmi të karakterizohemi nga këto cilësi, atë ditë edhe njerëzimi do të ketë gjetur kombin të cilit mund t'i besohet, kurse ne do të konsiderohemi se kemi hedhur hapin më të dukshëm në emër të rifitimit të vendit tonë në ekuilibrin midis shteteve.²⁵

¹⁶⁷ Buhari, l'tikaf, 8; Ibni Maxhe, Sijam, 65.

¹⁶⁸ Ibni Hisham, Sire, 1/209.

¹⁶⁹ Myened, 3/447; Ebu Davud, Edeb, 80.

¹⁷⁰ Buhari, Iman, 24; Myslim, Iman, 107,

¹⁷¹ Ebu Davud , Xhihad, uz, Edeb, 164; Mysned, 1/404.

¹⁷² Ebu Davud, Edeb. 164; Mysned, 11404.

Edhe në periudhën e sundimit botëror osman, është e mundur të vihet re ndikimi i të njëjtës atmosferë sigurie e besueshmëria: ata njerëz fisnikë, përfaqësues të kësaj besueshmërie për të cilën po bëjmë fjalë, që kalonin nën pemë pa këputur qoftë edhe një kokërr ose që paguanin sendet që konsumonin, para se të triumfonin vendet me anë të shpatës, kishin triumfuar zemrat me atë shpirt besnikërie dhe me atë burrëri të pashoqe. Përndryshe, as që do të mund të kishin hyrë në Europën e sunduar nga ajo mendësi ! frikshme kryqtarie dhe as që do të mund ta kishin vazhduar dot praninë e tyre atje. Shembulli i Ebu Ubejdes i përjetuar në Damask që përjetuar për katër shekuj rrjesht në Ballkan e në Europë. Prandaj edhe në atë periudhë pëmgritjeje që arritur hyrja në portat e Vjenës me aq pak humbje dhe për shekuj me radhë në vendet e triumfuara që realizuar përfaqësimi i sigurisë dhe qetësisë... Pandeh se gjaku i derdhur në Turqi pas shpalljes së republikës për të ndërtuar sigurinë, nuk që derdhur gjatë pesë shekujve për të siguruar qetësinë, madje në kushtet e pranisë së kombësive dhe pakicave kombëtare nga më të ndryshmet. Po, kërkimet e bëra dhe statistikat

tregojnë se numri i të vrarëve gjatë përpjekjeve me armë në periudhën 600-vjeçare osmane është më i vogël se numri i të vrarëve nga përpjekjet me armë në gjysmën e dytë të këtij shekulli. Atëherë kategorikisht nuk është e drejtë të pretendohet se pushtimet osmane kanë qenë mbështetur thjesht te forca. Nga ana tjetër, po të kihen parasysh mjetet e komunikacionit të asaj kohez, bëhet krejt evidente se nuk ka qenë e mundur të administrohej

vetem me autoritetin shtetëror dhe me forcat ushtarake një shtet i shtrirë në tre kontinente...

Sigurisht, pati qenë mbështetja e zemrave të triumfuara që pati bërë të mundur administrimin për një kohë të gjatë dhe pa nxjerrë ndonjë problem serioz nën çatinë e të njëjtit shtet të njerëzve të racave dhe kombësive të ndryshme. Gjithsesi, edhe ajo çka u takon të përdorin ata që flijohen në periudhën tonë për miqësinë midis njerëzve, duhet të jetë e njëjta rrugë dhe e njëjta metodë...

Ftesa bashkësisë për besueshmëri

Mbreti i profetëve i ruante në siguri mesazhet e ardhura nga Allahu dhe këtë atmosferë e mbante të

gjerë sa të përfshinte brenda tërë ekzistencën. Edhe ummetin përpiqej ta pajiste me të njëjtin moral dhe i këshillonte ata që të jetonin si të besueshëm midis njerëzve. Pranë tij nuk mund të mendohej as edhe tradhtia më e Vogël ndaj amanetit ose fjalës së dhënë dhe nuk mund të flitej pas shpine qoftë edhe për një besimtar të vetëm! Ai kundërvepronte menjëherë duke e paralajmëruar bashkëbiseduesin dhe nuk lejonte që mbi shpirtin e tij të binte pluhuri i mëkatit të përfoljes. Fjalëve të Hz. Aishesë, "Sa të gjatë e ka qafën filan gruai", Profeti i pati qenë përgjigjur: "E përfolle atë dhe ia ngule dhëmbët në mish!"¹⁷³ Po kështu pati kundërvepruar edhe ndaj një pasuesi që e pati përfolur pas shpine Maizin.¹⁷⁴ Ky qëndrim unik buronte nga besnikëria dhe drejtësia e tij dhe ngaqë e dinte se një atmosferë -aureolë besueshmërie lindte besueshmërinë dhe besnikërinë në Shpërtra.

Ai vetë këndonte vazhdimisht këtë lutje që ia këshillonte ummetit: "Allahu im! Tek ti mbështetem për t'u mbrojtur nga uria; Ç'shok i keq është ajo! Dhe mbështetem tek Ti për t'u mbrojtur nga Shpërdorimi i besimit dhe tradhtia; ç'shokë të këqinj që janë ata në ruajtjen e së fshehtës!"¹⁷⁵

Sa ç'është i rëndësishëm respekti ndaj amanetit, po aq e rëndësishme është edhe ruajtja nga tradhtia e tij; në fund të fundit, marrëdhënia midis këtyre dy virtyteve është kauzale. Edhe shprehja rrënjëdhënëse e mëposhtme e thënë për njerëzit që nuk tregojnë besnikëri ndaj fjalës së dhënë, domethënë që e tradhtojnë atë, përsëri të Dërguarit të Allahut i përket: “Në ditëne Kiametit, kur Allahu t’ i mbledhë tërë njerëzit nga më i hershmi e gjer te më i vonshmi, do të jepet një njoftim për secilin shkelës të ijalës duke thënë: "Ja kjo është pabesia e filanit të birit të filanit!”

I Dërguari i Allahut kishte një shpirt të mbyllur e të vulosur ndaj të gjitha të këqijave. Ia hapte me sa të kishte mundësi zemrën edhe mirësisë më të vogël, edhe asaj që konsiderohej hollësi e parëndësishme dhe ngrihej e ulej gjithë me ndjenjën e mirësisë! Ai e kaloi jetën gjithë në atmosferën e besueshmërisë. Edhe njerëzimi i besoi dhe i dha besën atij! Kurse ata që i kthyen shpinën, u gënjyen dhe mbetën në rrugë. Ai qëndroi gjithmonë si një engjëll mbrojtës mbi ummetin e tij. Kushdo që pati trokitur në derën e tij, pavarësisht nga kushtet, pati dëgjuar prej tij gjithmonë fjalën ”Urdhëro!”

Siç ishte një njeri i besueshëm, po ashtu i besonte ai Allahut dhe i ofronte besën e tij. Besimi te Allahu dhe dhënia e besës Atij, ka kuptimin e reflektimit të lartësuar të atributit të besueshmëris nga profeti te Allahu. Amaneti zbret nga Allahu te profeti ne trajtën bindjes dhe besueshmërisë. Në këtë cirkuit trajtësohet besueshmëria e përgjithshme dhe besa.

Çdo profet është dalluar si i tillë pikërisht ne besën dhënë Allahut. Kjo është një nga veçoritë e pandara dhe nga atributet e larta të tyre. Këtë Kur'ani na e tregon në ajetet e mëposhtme nga më shumë të qartë.

"Lexoju atyre ngjarjen e Nuhut që i pat thënë kështu popullit të vet: "O populli im, edhe nëse ju rëndon qëndrimi im mes jush dhe përsëritja e argumenteve të Allahut, prapë unë Allahut i besoj dhe te Ai mbështetem! Ndërkaq, edhe ju mblidhuni mes jush e vendosni, thirrni në ndihmë edhe zotat tuaj pa mbajtur gjë të fshehtë dhe veproni kundër meje!" (Kur'ani, Junus: 71)

Hz. Nuhu beson te Zoti i tij i jep besë dhe i drejtohet, po ta shprehim më gjerësisht, kështu një

bashkësie heretikësh të cilëve u del ballëpërballë: "Po qe se ju rëndon qëndrimi im mes jush, Sjellja ime, pozita ime dhe kumtesa ime dhe nuk mundeni ta pranoni një gjë të tillë, bëni si të dëshironi... Unë i kam besuar Allahut dhe jam Mbështetur te Ai! Ja ku më kenit! Ju jeni një turmë, kurse unë, një i vetëm! Por dijeni se Allahu nuk do të më nxjerrë të humbur Përballë jush! Dhe ju tani mblidhuni bashkë kokë më kokë, thirrni edhe të gjithë zotat dhe aleatët tuaj, këshillohuni dhe thurni plane të ndryshme kundër meje. Mos lini gjë pa bërë që të pendoheni nesor pse s'e bëtë. Tani unë pres çdo gjë prej jush!" Kështu i ftonte në shesh të burrave Hz. Nuhu njerëzit e tij mes një besimi të jashtëzakonshëm ndaj Allahut dhe të besnikërisë ndaj Tij. Ai e dinte në mënyrë kategorike se Zoti i tij do ta mbronte. Ne nuk e dimë se sa vetë hipën në varkën e tij, por e dimë se, përfshi Hz. Ibrahimin, shumë profetë kanë rrjedhur prej sojit të tij.

Kur'ani e konsideron Hz. Ibrahimin prej sojit të tij dhe thotë kështu: "Pa dyshim që edhe Ibrahim i qe nga populli i tij!" (Kur'ani, Saftat: 83)

"...Unë dëshmoj vetëm për Allahun. Dhe bëhuni dëshmitarë se unë qëndroj larg prej çdo gjëje që

adhuroni ju e që e barazoni me Të. Unë vetëm Atë e adhuroj! Ejani, pra, bëhuni bashkë kundër meje e mos më jepni afat! Unë jam mbështetur te Allahu që është Zoti im si edhe Zoti juaj, sepse s'ka gjallesë që të mos jetë nën sundimin e Tij! Pa dyshim, Zoti im është i drejtë!" (Kur'ani, Hud: 54-56)

Kurse situata, dorëzimi dhe nënshtrimi i Hz. Ibrahimit shprehen në këtë mënyrë:

"Shembulli më i bukur për ju është tek Ibrahimimi dhe tek ata që e patën mbështetur kur i thanë popullit të vet: "Ne jemi larg prej atyre që adhuroni ju përveç Allahut, nuk duam të kemi punë me ju dhe midis nesh do të ndehet armiqësia gjersa të adhuroni vetëm Allahun që është Një!" Kurse Ibrahimimi i tha vetëm kaq të atit: "Unë do të kërkoj falje për ty, por unë s'mund të të them asgjë se ç'mund të të vijë prej Allahut!" Zoti ynë! Vetëm tek Ti jemi mbështetur vetëm kah Ti jemi drejtuar dhe kthimi ynë është vetëm tek Ti!" (Kur'ani, Mumtehine: 4)

Po, Ibrahimimi me ata që rrinin me të, kështu e kundërshtonin mohimin dhe herezinë dhe kështu i kërcënonin mohuesit. U thoshin se s'kishin të bënin fare me sendet, me idhujt që adhuronin ata, se i mohonin idhujt e tyre dhe se, në këto kushte,

armiqësia midis tyre do të vinte duke u thelluar. Vërtet, kjo armiqësi është shtrirë që nga koha e Hz. Ademit e gjer në ditët tona. Që nga dita e parë e njeriut e gjer më sot, besimi, nga njëra anë, dhe mohimi, herezia e blasfemia, nga ana tjetër, kanë qenë armiq të njëri-tjetrit. Është e pamundur që të qëndrojnë bashkë në një vend. Për rrjedhojë, sigurisht që mohimi do të ndjehet vazhdimisht i shqetësuar prej besimit dhe do të dojë t'i vejë stërkëmbën atij. Siç thuhet se "lakuriqit të natës i vriten sytë prej dritës", edhe ata, ashtu si lakuriqët, do të ndjehen të shqetësuar prej dritës së besimit e të profetësisë. Prandaj, për sa kohë që ata nuk do t' i besojnë Allahut ashtu si besimtarët, armiqësia midis tyre do të vazhdojë.

Mbrapshtia dhe ftohtësia janë përbërës cilësorë të mohimit. Mohuesi e sheh të gjithë botën me një sy armiqësor.⁹ Ndërsa në shpirtin e besimtarit ka njerëzi e mirësi. Ai e sheh gjithësinë si djep të vëllazërisë. Kërkon të gjejë me këdo një vijë bashkimi dhe një rrugë dialogu. I tillë është besimtari, kurse mohuesi ndjen kënaqësi të përfytet me këdo. Kur çdo njeri të besojë me gjithë zemër te Allahu, do të krijohet një paqë dhe qetësi e përgjithshme. Por të presësh një

gjë të tillë prej mohimit dhe mohuesve, është krejtësisht një mosnjohje e të vërtetës dhe naivitet, sepse mohimi nuk ka ç't'i japë gjë tjetër njerëzimit përveç nxitjes së përleshjes së popujve e kombeve me njëri-tjetrin.

Duke u nisur nga kjo, midis besimtarit dhe mohuesit nuk mund të vendoset dialog në kuptimin e vërtetë të fjalës. Prandaj edhe Kur'ani i përmend si një përjashtim fjalët e Hz. Ibrahimit drejtuar të atit. Fjalët e tij ishin vetëm një dëshirë që buronte nga mëshira dhe dhembshuria e tij e thellë. Megjithatë, Ibrahim i thekson se nuk ka asgjë në dorë. Dhe, menjëherë pas kësaj, shpreh besimin. dorëzimin dhe nënshtrimin e tij e të besimtarëve të tjerë ndaj Zotit.

Po të analizohet jeta e profetëve, do të vërehet tek të gjithë ata mbizotërimi i palëkundur i besimit, dorëzimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit, të cilat, megjithatë, nuk janë si të njerëzve të zakonshëm; një vend të veçantë zënë, në këtë mes, besimi, dorëzimi dhe nënshtrimi i Mbretit të Profetëve që janë më të thellë e më të gjerë se të gjithë profetët e tjerë.

Allahu një herë e kishte mësuar atë të thoshte "Allahu e di!" Edhe ai të gjithë jetën e kishte kaluar me besim, dorëzim dhe nënshtrim të plotë ndaj

Allahut. Le të na bëjnë të mendohemi fjalët e një guximtari, trimi dhe heroi të tillë si Hz. Aliu, që thoshte: "Kur në fushë të luftës e ndjenim veten ngushtë dhe në shpirt na hynte një frikë, menjëherë fshiheshim pas të Dërguarit të Allahut dhe fitonim besim e siguri!"¹⁷⁷ ²⁶

Besueshmëria e tij në emigracion

Kur Profeti do të emigronte dhe shtëpia i ishte rrethuar nga njerëz që donin me gjithë shpirt ta

¹⁷³ ibni Kethir, Tefsir, 7/359; et-Tergib ve't-Terhib, 4/285.

¹⁷⁴. Myslim, Hudud, 22, 23.

¹⁷⁵ Ebu Davud, Vitr, 32, Nesai, Istiaze, 19, 20, Ibni Maxhe, Et'ime, 53.

¹⁷⁶Myslim, Xhihad, 9.

sqarim -Të kihet parasysh këtu teoria marksiste e armiqësisë klasore dhe e luftës së klasave në planin individual e shoqëror.Në historinë njerëzore marksizmi ka përfaqësuar mohimin më konsekuent

vrinin, pati kënduar ajetin "Ne u kemi vënë perde atyre, para edhe pas..." (Kur'ani, Jasin: 9), pati marrë një grusht dhe e e pati hedhur në drejtim të rrethonjësve dhe pati kaluar e dalë mes tyre pa treguar qoftë edhe shenjë më të vogël të lëkundjes!¹⁷⁸ Po, aq i patrembur e aq i palëkundur ishte ai! Pastaj pati shkuar te shpella e quajtur Sevr që ndodhej në një lartësi ku edhe të rinjtë, madje, e kishin të vështirë për t'u ngjitur. Ia, pra, ai që ngjitur në atë lartësi në moshën pesëdhjetetrevjeçare! Fundja, gjithë jeta e tij me përpjekje e me mundime pati kaluar! Tani i përgjigjej ftesës së shpellës me gjuhën e saj të veçantë, rrinte si mysafir i saj për ca ditë dhe e nderonte atë si vlerë përmbi vlerat...

Politeistët e Mekës prisnin në hyrje të shpellës. Në mes kishte apo s'kishte ndonjë metër distancë dhe Hz. Ebu Bekri ishte i shqetësuar sepse mendonte që i Dërguari i Allahut i ishte lënë si amanet. Fytyra i ishte bërë dyllë e verdhë. Mirëpo në buzëqeshjen e Profetit nuk kishte asnjë ndryshim. Ai njeri i besimit, bindjes dhe sigurisë e qetësonte kështu Hz. Ebu Bekrin: "Mos ki frikë! Allahu është

bashkë me ne!" Dhe vazhdonte: "Ç'mund të dyshosh për dy vetë kur i treti për ta të jetë Allahu!"²⁷

Besueshmëria e tij në fushën e luftës

Në fillim të luftës së Hunejnit shfaqet një shturje në ushtrinë Islame. Të gjithë pasuesit shpërndahen pothuaj majtas e djathtas dhe çdokush është i bindur se fundi i kësaj beteje është humbja.

¹⁷⁷ Mysned 1/86

Pikërisht në këto çaste ndodh një ngjarje e papritur. I Dërguari i Allahut hidhet drejt radhëve të armikut i hipur mbi kalin e tij të bekuar me gjithë përpjekjet e Hz. Abbasit për ta ndaluar. Dhe bërtet me atë zërin e tij impresionues: "Unë jam i dërguari i Allahut, kjo s'është gënjeshtëri! Unë jam i nipi i Abdylmuttalibit dhe kjo s'është gënjeshtëri?"

Ishte ky veprim dhe guxim i tij në sajë të të cilit ushtria Islame arrin të riorganizohet në një kohë shumë të shkurtër dhe humbja kthehet në fitore.

Nënshtrim marramendës

Profeti po pushon nën hijen e një peme. Pikërisht në ato çaste, një mohues, qafir, i quajtur Gavres, duke përfituar nga kjo, rrëmben Shpatën e varur në një degë dhe ia mbështet Profetit në grykë duke i folur me një zë tallës: "Kush do të të shpëtojë tani prej dorës sime?" Me gjithë situatën e vështirë, i Dërguari i Allahut nuk tregon asnjë shenjë paniku, sepse besimi i tij te Allahu është i plotë e i palëkundur dhe prandaj i thërret njeriut me zë të fortë: "Allahu!" Kjo thirrje e fortë dhe e papritur për mohuesin, ia pret krahët atij, shpata i bie prej dore

dhe mbetet i shtangur në vend. I Dërguarii Allahut e rrëmben shpatën dhe i thotë njeriut: "Po ty, kush do të shpëtojë tani?" Njeriu fillon të dridhet sikur ta kishin zënë ethet Ndërkaq afrohen njerëzit që kishin dëgjuar zërin e Profetit dhe mbeten të çuditur para pamjes që u del përpara. Pasi mësojnë se ç'ka ngjarë, u rritet edhe një herë më shumë besimi ndaj Allahut Ky besim që sheh Gavresi, e bën edhe atë të japë fjalën e besës e të largohet që aty me besim.¹⁸¹

Mendimtari i njohur perëndimor, Bernard Shou, thotë: "muhamedi, me aspektet e ndryshme të tij, është një njeri me epërsi marramendëse. Këtë njeri enigmatik është e pamundur te kuptosh Veçanërisht ai ka një aspekt të lartë e të pakuptueshëm që është besimi dhe mbështetja te Zoti!" Bernard Shou fliste drejt...

Ai përjetonte një besim dhe nënshtrim të tillë ndaj Allahut, sa që ne e kemi krejt të pamundur ta masim apo ta vlerësojmë me kriteret tona. Dhe vendi i tij në lartësinë e Allahut, vlera dhe pozicioni i tij, janë brenda kriterëve të besimit dhe mbështetjes ndaj Allahut. Me kërkesën, dëshirën dhe buzëqeshjen e tij netët kthehen aty për aty në ditë, errësirat bëhen dritë, qymyri shndërrohet në diamant dhe lypësit i

falen pasuri mbretërore. Me këtë rast, dëshiroj të përcjell këtu një hadith të mbështetur te Hasan Basriu. Sipas meje, për nga rëndësia e faktit që ka të bëjë me Profetin, kjo ngjarje zë një vend të veçantë. Ngjarja mund të kritikohet për nga kriteret e hadithit, por aq të shumta janë ngjarjet që i shëmbëllojnë kësaj, sa që mund të konsiderohet normale dhe të mos ketë asnjë pengesë në transmetimin e saj.

Ngjarja është kjo: Një djalë i ri nga Basra bashkë me të atin bëjnë nijet të shkojnë në haxh. Gjatë rrugës ati vdes. Vdes, por e keqja është se transformohet dhe merr një pamje të shëmtuar! Kjo gjë e prek shumë djaloshin e gjerë që hutohet dhe s'di se si të veprojë. E kë mund të thërrasë tani, t'ia tregojë kufomën e t'i kërkojë ndihmë? Duke u përpëlitur në këtë hall, papritmas i vjen si gjumë dhe, ndërsa po rrinte ashtu në një gjendje midis gjumit dhe zgjimit, vëren se hapet dera e çadrës dhe hyn brenda një njeri fytyrëdiell. Njeriu pamjeëmbël rri mbi krye të kufomës, ia fërkon me dorë të gjithë trupin dhe, ndërkaq, kufoma e të atit kthehet në gjendje normale, madje duket edhe sikur rrezaton bukuri. Djaloshi, i mahnitur e i shfytyruar. Por pikërisht në çastin kur i ardhuri enigmatik do të dilte

nga çadra, djali e mbledh veten dhe e pyet: "Në daç Zotin, më thuaj, kush je ti?" Dhe njeriu i përgjigjet: "A nuk më njohe? Unë jam muhamedi!" Djali sikur do të fluturojë nga gëzimi: "O i Dërguari i Allahut, ç'janë këto që ndodhën? Pse ndryshoi trajtë im atë?" I Dërguari i Allahut i përgjigjet: "Ai vazhdimisht pinte. Ky është edhe shkaku i ndërrimit të trajtës." Djaloşi e pyet: "Atëherë, cili qe shkaku për të cilin na e bëre këtë nder?" Dhe Profeti i Përgjigjet: "Sa herë që të përmendej emri im, yt atë më Përshtëndeste dhe lutej në emrin tim!"

Ja, pra, edhe kjo lidhje e vogël nuk mbetet pa shpërblim dhe i Dërguari i Allahut e rrethon me dhimbshuri atë burrë në çastin kur ai kishte nevojë më tepër se kurrë. Sapo merr lajm se njeriu ka vdekur fryrna e Tij, me lejen e Allahut, i ndodhet e gatshme pranë.

I Dërguari i Allahut është personi më i besueshëm ndër njerëzit. Edhe ummeti i tij duhet të jetë i denjë për një besueshmëri të tillë. Prandaj edhe në një ajet urdhërohet kështu:

"Allahu ju urdhëron t'u jepni amanetin të zotërve dhe, kur të gjykoni mes njerëzve, të gjykoni

drejt. Ç'këshilla të mira që ju jep Allahu! Pa dyshim që Allahu dëgjon dhe sheh se si veproni!" (Kur'ani, Nisa: 58)

Shkakun e zbritjes të këtij ajeti Hz. Aliu e tregon kështu: "Kur u triumfua Meka, Profeti i mori çelësat e Qabes nga Osman b. Talhai që atë ditë ende s'ishte bërë musliman dhe e hapi vetë Qaben Ndërkaq, erdhi Hz. Abbasi dhe i kërkoi çelësat. Gjithsesi, besimtari i madhi së ardhmes ishte më i denjë. Në të njëjtën kohë, dhënia e çelësave do t' ia gëzonte zemrën atij. Ashtu edhe u bë. Sapo u zbrit ky ajet, çelësat e Qabes iu dhanë përsëri Osman b. Talhait. Dhe pak më pas ky njeri i madh u bë musliman.¹⁸²

Megjithatë, konkluzioni i ajetit ka karakter të përgjithshëm. I Dërguari i Allahut e quan shenjë kiameti eliminimin e amanetit dhe urdhëron kështu: "Kur të humbasë amaneti, pritni kiametin!" Sahabet, pasuesit e tij e kanë pyetur: "O i Dërguari i Allahut, si humbet amaneti?" Dhe ai u është përgjigjur: "Kur puna i jepet atij që s'është kompetent!"¹⁸³

Po, amaneti është shumë i rëndësishëm. Edhe dhënia e një pune atij që është i asaj pune, domethënë që është kompetent, është një amanet i cili, nga ana e tij, është një prej faktorëve më të

rëndësishëm që e mbajnë në këmbë rregullsinë e botës. Eliminimi i amanetit merr të njëjtin kuptim me eliminimin e rregullsisë dhe të ekuilibrit të përgjithshëm, gjë që do të rezultonte një botë të tillë, ekzistenca dhe mosekzistenca e së cilës janë të barasvlershme. Në një porosi tjetër të tij lidhur me këtë specifikë, Profeti urdhëron kështu: “Secili prej jush jeni çobanë dhe mbani përgjegjësi për ata që keni nën administrim dhe kujdes. Udhëheqësi i shtetit është çoban për shtetasit. Çdo kryefamiljar është çoban për individët që ka nën kujdes. Gruaja është çobane e shtëpisë së burrit dhe përgjigjet për gjërat që ka nën kujdes. Shërbëtori është çobani i mallit të të zot dhe përgjigjet për ata që ka nën vete. Secili prej jush jeni çobanë dhe përgjegjës për tufën tuaj.”¹⁸⁴

Ajo ç’ka kërkohet të tregohet këtu me këtë parashtrim të gjerë, është se ne të gjithë jemi amanete të njëri-tjetrit. Gjithësia e tërë është amanet te Allahu. Kur’ani i është dhënë amanet në fillim Xhebrilit, pastaj Hz. Muhamedit (s.a.s.). Të vërtetat Kur’anore dhe kauza profetike e Hz. Muhamedit janë amanet për ummetin. Dhe ummeti, pastaj, është amanet për Allahun!

Të gjithë elementët që sajojnë jetën dhe që i japin jetë jetesës shoqërore, janë si korniza të futura brenda njëra-tjetrës. Edhe defekti më i vogël që do të krijohej në njërin prej tyre, do të shumëfishohej duke u reflektuar edhe në kornizat e tjera. Pandeh se askush nuk ka dyshim për këtë. Po që se ekziston një defekt në planin individual dhe nuk mënjanohet menjëherë, nuk duhet të dyshohet se pas një kohe të shkurtër ai do të kthehet në një gangrenë të pamjekueshme. Nëse është me të vërtetë kështu, çdo kuadër duhet të çojë në vend me të drejtë amanetin e marrë nën ngarkim në mënyrë që t'u pritët udha të gjitha defekteve të mundshme.

Ja, pra, për këtë marrëdhënie të ndërsjelltë dhe për këtë tërësi vihet gishti në porosinë profetike. Nëse të gjithë individët që formojnë kombin, nga portieri e gjer te udhëheqësi i shtetit, do të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre në lidhje me amanetin që i është dhënë secilit, atë çka kërkon njerëzimi te utopitë, do ta gjejë tek shoqëria e përbërë nga këta njerëz "eminë", "të besueshëm".

Është si rrjedhojë e rëndësisë së amanetit që konsiderohet gjithçka, që i Dërguari i Allahut

urdhëron kështu: "Ai që s'ka amanet, s'ka as besim!"¹⁸⁵ Tek njeriu që nuk respekton amanetin që ka në dorë dhe që nuk kujdeset për të drejtën e atij amaneti, edhe besimi i tij nuk është i plotë e i formuar.²⁸

Nga një pikëpamje, besimi me amanetin janë në marrëdhënie si shkak me pasojën. Ashtu si nuk mundet të konsiderohet besimtar i formuar një njeri që nuk respekton amanetin, ashtu edhe është vështirë të gjendet një koncept i shëndoshë amaneti

¹⁷⁹ Buhari, Tefsir (9), 9; Mysned, 1/4.

¹⁸⁰ Buhari, Xhihad, 52; Myslim, Xhihad, 48

¹⁸¹ Buhari, Megazi, 31; Xhihad, 84; Myslim, Fezail, 13; Mysteredrek, 3/29.

¹⁸² Ibn Haxher, Isabe, 2/460; Ibn Hisham, Sire, 4/55

¹⁸⁴ Buhari, Ilim, 2; Mysned, 2/361.

¹⁸⁵ Buhari, Xhum'a, 11; Vesaja, 9; Myslim, [mare, 20; Ebu Davud, Imare,

jashtë besimtarëve të formuar. Po, po qe se një njeri është një besimtari formuar, ai edhe në amanet do të jetë i besueshëm; po qe se nuk mundet të jetë i besueshëm në amanet, do të thotë se edhe besimin s'e ka të formuar.

Në një porosi tjetër, duke bërë përkufizimin e besimtarit, I Dërguari i Allahut urdhëron kështu: "Besimtar i vërtetë është ai që njerëzit besojnë t'i lënë amanet pasurinë dhe jetën e tyre?" Një porosi që e kam cituar duke treguar për besnikërinë e Profetit tonë, dëshiroj ta përsëris si ide meqë e shoh të lidhur me temën tonë.

I Dërguari i Allahut urdhëron: "Më jepni fjalën për këto gjëra dhe unë marr përsipër t'ju siguroj xhenetin:

1. Kur të flisni, flisni drejt! Domethënë që gjestet, fjalët dhe shprehjet duhet të jenë të drejta.

2. Çojeni në vend premtimin! Fundja, e kundërta e kësaj është shenjë e hipokrizisë, për të cilën është folur më sipër në një moment.

3. Bëhuni të sigurt në amanet! Nëse ju është besuar diçka sepse njiheni si besuar në një vend të caktuar, kujdesuni të mos : "gënjeni njeriun që ju

besoi! Madje përpiquni të mos i zhgënjeni pandehmat e njerëzve as në jetën e pastajme!

4. Jini të ndershëm! Ruani nderin tuaj dhe nderin e të tjerëve si të ishte nderi juaj! (Këtë temë do ta trajtojmë me hollësi më tej, duke trajtuar temën e nderit).

5. Mbyllni sytë para gjërave të ndaluara! Mos ua hidhni sytë gjërave që nuk ju përkasin dhe mos ua ngulni sytë gjërave ku nuk jeni të aftë të siguronit përfitime.

Shikimi në haram, në gjërat e ndaluara, e intrigon zemrën. Në një hadithi kudsî, porosi të shenjtë, urdhërohet kështu: “Shikimi në haram është një shigjetë nga shigjetat e helmuara të shejtanit. (Ajo ielnga harku i vullnetit tuaj dhe ju ngulet në zemër. Ose ky hark që i përket shejtanit, është në dorë të vullnetit tuaj). Kush heq dorë nga ai shikim si rrjedhojë e respektit për mua, i hedh në zemër një besim të tillë, kënaqësinë e të cilit ta ndjejë me plot zemrën?”

6. Mbani duart larg nga dëmtimi i të tjerëve! Mos i bëni keq askujt dhe në asnjë trajtë!188

Ja, pra, njeriu që respekton këto pika. që konsiderohen, në një aspekt, kushte për të qenë njeri

i besueshëm, jeton si i besueshëm si dhe siguron, në këtë mënyrë, jetën e pastajme të amshuar. Fundja, në këtë çështje, atij që i jep fjalën të Dërguarit të Allahut, edhe ai ia jep fjalën për xhenetin!

Vazhdimësia e jetës në tokë në siguri dhe besim varet nga të qenit e njerëzve të besuar të zotët e fjalës. Po që se bota Islame si një trup i vetëm do t'i dilte për zot amanetit që i është dorëzuar dhe do të mundej të shndërrohej në përfaqësues të besimit e të sigurisë në të gjithë botën, kjo do të fitonte sërishmi ekuilibrin. Sa për sot, gjendja është për të vajtuar jo vetëm në Turqi, por edhe në të gjithë botën. Këtë tablo e përshkruan kështu në poezinë e tij Mehmet Akif Ersoji:

Cipa u çor e ra...nj'e' pafytyrësi e tillë kudo,

Ç'fytyra të shëmtuara fshihka një perde e hollë si kjo; S'ka besë e fjalë të dhënë; amaneti një fjalë pa kuptim, Gënjeshtër lulezon, tradhtia; e vërteta n'harrim;

Ç'përmbysje e frikshme, o Zot, që qimet përpjetë t'i ngre:

As fe më s'ka, as besim; feja gërmadhë, besimi
baltë e dhë...²⁹

O gonghe të shpresës!

Ju jeni ata që do ta sillni e do ta vendosni sërish mbi tokë të vërtetën e fesë. Ju jeni filizat e rinj të asaj rrënje dhe rrezet e atij burimi, të cilët, në një periudhë të errët të historisë, e mbytën njerëzimin në dritë dhe, si pema hyjnore "Tuba" në parajsë, i shpërndanë degët, gjethet dhe lulet në të katër anët! Dashtë Zotit duke kapërcyer ditët e errta në të cilat ndodhemi -që besoj se do të kalojnë shpejt- do të jeni ju që do t'i ringjallni ato kohëra ndriçimesh! Ata që ndodhen mbi tokë si dhe ata që ndodhen nën tokë, prej jush e presin këtë dhe veçanërisht e pret ai

¹⁸⁵Mysned, 3/135.

¹⁸⁶Tirmidhi, Iman, 12; Ibni Maxhe, Fiten, 2.

¹⁸⁷ Kenzu'l-Ummal, 5/328.

¹⁸⁸ Mysned. 5/323

që me frymën e tij përsillet vazhdimisht mes jush, Hz. Muhamedi Mëshira dhe Paqja e Allahut qofshin mbi të! që edhe nëse shpesh nuk e shihni dhe nuk e ndjeni, ua fërkon kokën dhe ua rreh shpinën, ai që e pret këtë me vështrimin e tij plot shpresë e me buzëqeshjet plot dhembshuri...

Po qe se ju, si njerëz besnikë, nuk do të largoheshit nga ky orientim dhe do të mund t'i ofronit mjedisit tuaj vazhdimisht mesazhe besimi dhe sigurie, kur të arrinit sukses në këtë gjë, atëherë dyert e zemrës së tërë njerëzimit do të hapeshin për ju kat më kat dhe ashtu si të parët, edhe ju do të ngrinit fron në ato zemra. Mos harroni që kushti i arritjes së këtij rezultati ose, më drejt, i kësaj maje, është besueshmëria në amanet.

Po qe se do të donim të bëheshim sërish element ekuilibri në botë dhe një komb te i cili mund të drejtoheshin sytë gjatë marrjes të vendimeve mbi fatin e botës gjë për të cilën jemi të detyruar atëherë duhet të bëhemi përfaqësuesit e së vërtetës, drejtësisë, orientimit dhe sigurisë...

KUMTIMI

Atributi i tretë i profetëve është kumtimi..Po të doni, quajeni këtë ”Tregimi i të vërtetës së Islamit”, po të doni, konsiderojeni ”Urdhërimet dhe ndalimet”, përfundimi nuk ndryshon. Në të dy rastet ju keni bërë fjalë për këtë atribut të lartë profetik.

Kumtimi është qëllimi dhe synimi i qenies së çdo profeti. Pa kumtesën, edhe dërgimi i profetëve do mbetej diçka e pakuptimtë dhe e kotë. Allahu i ka dhënë jetë me anë të profetëve bujarisë dhe favorit të tij për njerëzit dhe me jetët e tyre e ka shfaqur mëshirën dhe bamirësinë e tij. Kurse reflektimi i të

gjithë kësaj te njerëzit bëhet vetëm me anë të kumtimit profetik.

'Ashtu siç na e nxjerr Allahu (xh.xh.) çdo ditë në kupë të qiellit diellin që na buzëqesh, diellin që është sobë për ato gjëra që duhen ngrohur, furrë për ato gjëra që duhen pjekur dhe furça e piktorit mbi fytyrën shumëngjyrëshe të bukurive duke treguar me këtë një variacion të mëshirës së Tij, ashtu edhe profetët elartë tregojnë, tëpkë si dielli, mëshirën dhe bamirësinë e Providencës Hyjnore. Ata dhe veçanërisht Hz. Muhamed Mustafai (s.a.s.) për të cilin është thënë "Të dërguam ty si mëshirë për botët" (Kur'ani, Enbija: 107), janë përfaqësuesit e mëshirës e të bamirësisë së Zotit për njerëzit. Po të mo kishte ardhur ky e po të mos e kishte ripërtëritur kauzën e profetëve të tjerë, kurrë nuk do të bëhej fjalë për merituar ne mëshirën e Zotit ndërsa do të vërtiteshim të çoroditur e të hutuar në shkretëtirat e egra të injorancës, herezisë e perversitetit...Ndërsa njerëzimi përpëlitej në egërsi, në frymëmarrjet e tij ndjeu frymën jetëdhënëse të profetëve të tjerë. Pikërisht pse ndjeu atë frymë, njerëzimi e pa befas veten në një bahçe parajsore ku mijëra pranvera shfaqeshin në pafundësinë e lojrave të tyre. Ndryshe,

do të çmendej prej egërsisë e vetmisë e do të vdiste... Ç'jemi ne? Prej nga vijmë e ku shkojmë? Këto pyetje të tmerrshme do të na e bironin vazhdimisht trurin si një turjelë; do të na e bironin dhe ne nuk do të mund të gjenim një përgjigje duke mbetur, kështu, të detyruar për ta hequr këtë dhimbje sa të ishim gjallë. Sidomos kur të sillnim ndërmend kockat e sedefa në varr; do të rrëqetheshim dhe shpirtin do të na e mbështillnin frikëra sterrë të zeza e, përtej këtyre, asgjëja, mendimi i kthimit në asgjë dhe drithërima e afrimit të asgjësimit pas çdo minute të jetuar do të na e shndërronin në helm jetën tonë. Erdhën profetët e na treguan qëllimin e jetës dhe të vërtetën e Varrit. Në sajë të kësaj e kuptuam se, ashtu siç ardhja jonë në këtë botë është e lidhur me një qëllim të caktuar, edhe largimi ynë prej këtij mbështetet mbi një urtësi të caktuar. Vdekja nuk është asgjësim, por vetëm një ndërrim mjedisi dhe lirim prej detyre, kurse varri është një sallon pritjeje dhe një derë e hapur për tek bota e pasme. Kur i dëgjuam nga profetët këto, egërsia na kaloi, çdo gjë na u bë e afërt e konfidenciale, u fshinë e ikën të gjitha drojet e frikërat që na kishin mbushur mendjen e zemrën e vendin e tyre e Zunë intimiteti e hareja... Ja, pra, të

tilla mesazhe dhe të ngjashme me to na kanë sjellë ne profetët. Dhe kumtimi i tyre për ne është qëllimi i ekzistencës së profetëve. Ndërsa ne e shohim dhe e kryejmë detyrën e kumtimit si një të drejtë dhe domosdoshmëri për ne, profetët e kryejnë atë me vetëdijen e qëllimit të ardhjes së tyre në jetë e të një urtësie. Dhe thonë; "Ardhja jonë në botë nuk është për asnjë qëllim tjetër. Allahu na dërgoi tek këta njerëz që t' u bëjmë dritë ndaj errësirave që i rrethojnë majtas e djathtas, lart e poshtë, para e prapa në mënyrë që të mund të ecin pa u shmangur në një rrugë të tillë të ndriçuar, që djalli askund të mos gjejë shteg për t'iu hyrë në shpirtira, që të mos mbeten diku në mes të rrugës në këtë udhëtim të gjatë..." Po e përsëris: ne e kryejmë kumtimin si një detyrë, kurse profetët si qëllim të krijimit të tyre.

TRE PARIME NE KUMTIM

Mënyra sesi e sjell mesazhin profeti dhe si e çon tek të tjerët, sigurisht që është e ndryshme nga mënyra sesi e bëjnë këtë gjë njerëzit e tjerë. Fundja, as që bëhet fjalë për ndonjë përngjasim midis profetit dhe dikujt tjetër nga mënyra e përcjelljes së

mesazhit. Në kumtim e sipër ata na mësojnë, njëkohësisht, ne se ç'do të thotë të kumtosh e sesi duhet bërë kjo punë Dhe kjo gjë përbën një aspekt të veçantë të kumtesës së tyre Dhe tani, po të doni, le ta parashtrijmë këtë tematikë duke e mbështetur mbi tre parime

1. Universalitet: Duke i prezantuar njerëzimit mesazhet e sjella nga Allahu dhe specifikat përkatëse të përfaqësimit të vet, profeti vepron me metodën dhe rrugën e duhur, si një specialist i kësaj pune. Ai e trajton njeriun si një e tërë në të gjithë kompleksitetin e vet dhe po ashtu edhe mesazhet që do të përcjellë, kështu, në kompleksitet i prezanton. Eshhtë për këtë arsye. që, në detyrën kumtuese të profetit, nuk nënvleftësohen apo braktisen kurrsesi asnjëri prej elementëve si mendja, logjika, ndjesitë dhe shqisat dhe nuk lihen jashtë rrezeve ndriçuese të revelacionit. Para revelacionit, secili profet është si meiti në duart e larësit të kufomave. Revelacioni i vërtit profetët si të dojë dhe u jep drejtimin që të dojë, aq sa edhe në çështjet më të vogla dhe që mund të duken si imtësira, veprojnë ashtu siç do Zoti, në përputhje me dëshirën e Tij. Fundja, kjo është një

detyrim për profetët të cilët, nga ana e tyre, e respektojnë këtë kusht me një ndjeshmëri të jashtëzakonshme.

Nisur nga kjo konsideratë, ata, kumtesa e të cilëve nuk është në përshtatje me kumtesën e profetëve, kurrsesi nuk mund të kenë sukses në veprimtarinë orientuese të tyre. Për shembull, kur nënvleftësohet mendja, kumtesa nuk jep rezultatin e kërkuar; edhe lënia mënjanë e ndjesive dhe e shqisave lind të njëjtin rezultat negativ. Sidomos ata që dalin jashtë kufijve të revelacionit kurrë nuk mund t'ia arrijnë synimit. Ia tek kemi parasysh situatën e sistemeve njerëzore që kanë dashur të zënë një rrugë jashtë revelacionit dhe ja gjer ku kanë arritur. Komunizmi që një herë e një kohë pati tërhequr pas vetes turmat dhe popujt e gënijer, të shtyrë në varfëri dhe mediokritet e që në shumë vende të varfëra që kthyer në një qëllim-fantazmë, me gjithë revizionimet e herëpashërëshrne nuk pati mundur të shpëtonte nga shembja. Në apogjeun e tyre, themeluesit e këtij sistemi e të sistemeve të ngjashëm me këtë, qenë shfaqur secili si nga një profet i rremë më vete, kurse tani, bashkësitë po ashtu të rreme të tyre thonë:

Sa keq, në këtë lojë prapë u dogjëm e u përvëluam,

Gjithçka iku kot më kot, s'e dimë se ç'fituam!"

Në përfundim, po të njëjtat gjëra do të thonë ata që i ngrenë në praktikë dhe i mbajnë në këmbë sistemet njerëzore. I lashtë çdo diskutimi, një ditë të gjithë ata do të mbeten të detyruar të shpallin se janë gënjyer!

Në kumtesën e profetit, mendja, logjika dhe ndjenjat shkojnë sup më, sup dhe të bashkuar pazgjdhshëmrisht me njëra-tjetrën. Profetët, ashtu siç nuk mendojnë t' i derdhin turmat në rrugë duke përfitur nga ndjenjat e tyre, ashtu edhe nuk i shndërrojnë njerëzit në eremitë larg veprimit dhe aksionit duke u kthyer krejtësisht në teoricienë. Dhe prapë profeti, ashtu siç nuk i derdh njerëzit në rrugë duke i shndërruar secilin në një anarkist më vete, po ashtu edhe nuk i lidh vetëm pas ndjenjave duke i lënë shtatanikë e shterpë. Profeti i shpërndan mesazhet hyjnore zemrave njerëzore, zgjon tek njerëzit shpirtin e aksionit dhe i lartëson ata në qiellin e njerëzimit, i vë gju më gju e sy më sy ata me

engjëjt. Duke treguar për këtë specifikë, Kur'ani i bën zë kështu të Dërguarit të Allahut: "Thuaj: "Kjo është rruga ime në të cilën i thë rresim njerëzit te Allahu unë dhe ata që më vijnë pas..." (Kur'ani, Jusuf: 108). Kjo rrugë është rruga e profetësisë. Është rruga ku përfshihen mendja, logjika dhe gjykimi, zemra dhe ndërgjegjja pa u nënvleftësuar asnjëra prej tyre. Ia, në një rrugë të tillë e mbi një principialitet të tillë i ftojnë për tek e vërteta ndjekësit e tyre profeti dhe të lidhurit pas tij.

2. Të mos presësh shpërblim: Profeti nuk pret asgjë si shpërblim të kumtimit. Ai e kryen këtë vetëm e vetëm si një detyrë. Të gjithë profetët. kanë folur për këtë të vërtetë duke u shprehur: "Shpërblimi im i përket vetëm Allahut!"¹⁸⁹

3. Fjalën e fundit t'ia lësh Zotit: Përfundimin e kumtesës dhe miratimin e saj Profeti ia lë Allahut dhe asnjëherë nuk përzihet në të, pasi profeti e di se detyra e tij është vetëm të kumtojë, kurse përfundimi është diçka që i takon vetëm Allahut.

Dhe tani le të përpiqemi të parashtrojmë se ç'atribut profetik është kumtimi dhe se njerëzit që e kryejnë këtë detyrë në çdo periudhë, me ç'mënyra

dhe metoda kumtojnë dhe duhet të kumtojnë. E gjithë dëshira jonë është që ta kryejmë në mënyrë të përshtatshme ndaj pëlqimit të tij detyrën e kumtimit që na ka caktuar Zoti ne. Është vetëm Ai që edhe do të na ndjellë në zemër dëshirën për të kumtuar, edhe do të na japë në fund suksesin. Atij i besojmë dhe tek Ai mbështetemi ne...

189 Shih Kur'ani, Hud: 29; Shuara: 109, 127, 145, 164, 180; Sebe: 34/47.³⁰

METODA NE KUMTIM

Thamë se profeti vetëm detyrën e tij mendon. Po, kanë ardhur e shkuar profetë të tillë që, pavarësisht nga një jetë të tërë kumtimi e përpjekjesh, nuk është gjetur qoftë edhe një njeri që t'u besojë.¹⁹⁰ Megjithatë, ata kanë vepruar me besim dhe bindje të plotë dhe e kanë kryer gjer në fund

¹⁸⁹Shih Kur'ani, Hud: 29; Shuara: 109, 127, 145, 164, 180; Sebe: 34/47.³⁰

detyrën e tyre. Në asnjë çast të jetës së tyre nuk ka pasur "pse" të tilla ku ndihet pendimi, dyshimi a pasiguria: "Pse nuk munda të shërbej?", "Pse nuk ka njerëz që të më besojnë?", "Pse pësoi fiasco kjo punë?", "Pse ndodhën këto gabime njëri pas tjetrit?"...

Çdo profet mendon vetëm se si ka për ta kryer detyrën e tij duke i marrë parasysh të gjitha kushtet. Detyrimi për pranim nuk përfshihet në detyrën e tij. Vendimi në këtë fushë i përket vetëm dëshirës së Zotit. Në një ajet-argument, Allahu i drejtohet kështu të dërguarit të Tij: "Ti nuk mund të kthesh kë të duash në rrugë të drejtë; është vetëm Allahu që e drejton kë të dojë në rrugë të drejtë!" (Kur'ani, Kasas: 56). Nisur nga kjo, mesazhi i profetit është krejt specifik. Edhe sikur askush të mos e pranojë, edhe Sikur askush të mos tregojë respekt dhe interesim për të, prapëseprapë ai vazhdon ta kryejë detyrën e tij pa u mërzhitur, pa u lëkundur e pa rënë në panik, pa nisur të fajësojë e të urrejë të tjerët. Është për këtë arsye që të gjithë profetët, megjithëse u janë nënshtruar përbuzjes dhe poshtërimit, nuk kanë treguar as thërrimen e pasivitetit në detyrën e tyre. Dhe kjo trajtë e kumtimit është një atribut i

posaçëm vetëm për profetët. Është pothuajse e pamundur të vërehet tek të tjerët një nivel cilësor i tillë i kumtimit në tërësinë e vet përveç se te profetët. Tek të tjerët, në situata të tilla vini re shumë herë pakënaqësi dhe Zemërim; pavarësisht nga përvoja dhe niveli i pjekurisë së tyre, nuk mundën të shpëtojnë nga dëshira për të marrë rezultat. Dhe, kur nuk marrin, shfaqin mërzitje dhe zemërim. Vetëm profetët nuk dinë të zemërohen dhe kjo është një cilësi e posaçme e tyre.

Shihni, të Dërguarin e Allahut nuk e patën zemëruar as dhjetra ndodhi të hidhura që i patën rënë mbi kokë në Uhud. I qe thyer dhëmbi, i qenë ngulur në fytyrë copërat e helmetës, madje Ebu Ubejde pati thyer dhëmbët për t'i nxjerrë ato nga fytyra e profetit.¹⁹¹ Pavarësisht nga të gjitha këto, me fytyrën gjithë gjak, Profeti i Dy Botëve pati thënë vetëm kaq: "Allahu im, drejtoje popullin tim, se nuk di!"¹⁹² (Ata nuk dinë; po ta dinin se jam profet, nuk do të bënin kështu!). Me të vërtetë, më pas, kur ta njihnin, edhe ata do t' i vinin jetët e tyre para këmbëve të tij. Domethënë se në atë çast nuk dinin. Ndodhi si kjo e të ngjashme na tregojnë neve sesa e gjerë ishte zemra e të Dërguarit të Allahut. Ai dhe të

tjerët qenë ”të padorë ndaj atij që i godiste dhe të pafjalë e të pandjeshëm ndaj atij që i shante”. Edhe sikur t’u çahet koka, edhe sikur t’u thyheshin dhëmbët, nuk u dilte as edhe një ”of!” ankese prej goje!

Dhe si oxhak të digjem, tjetri s’ma merr vesh fare, O fati mundimplot, mos më digj në zjarrel...

Po, kështu thotë pothuaj çdo profet: ”Nëse s’më djeg në zjarrin e të huajit, mund të më bësh çfarë të duash, nuk ankohe!” Dhe vazhdon në rrugën e vet.

Sipas pohimit të Kur’anit, Hz. Nuhu i drejtohet kështu popullit të vet: ”Tha: ”O populli im, tek unë nuk ka asnjë lloj perversiteti, unë jam i dërguar prej Zotit të botëve!” (Kur’ani, A’raf: 61). Ajo që e detyron Nuhun të shprehet kështu, është, pa dyshim, akuza që i bënte populli i tij për perversitet. Ata silleshin pa respekt ndaj tij dhe i thoshin: ”Ne të shohim në rrugë të shtrembër e të humbur!” (Kur’ani, A’raf: 60). Edhe sot po e njëjta gjë është. Ato çka thuhet, janë të të njëjtit kuptim. Ti je i mbrapshtë, ti je i prapambetur e reaksionar, ti jeton një shekull pas, etj, etj. Në vazhdimin e ajetit, Nuhu i flet kështu popullit të vet: ”Unë ju kumtoj juve ç’më revelohet nga Zoti im dhe ju këshilloj, sepse unë

mësoj nga Zoti im ato që ju s'i dini!" (Kur'ani, A'raf: 62). Me këto fjalë profeti Nuh kërkon t'u thotë njerëzve se, ashtu siç nuk ka tek ai ndonjë gjë të shtrembër a të gabuar, ashtu edhe kërkon t'i shpëtojë ata nga rruga e shtrembër, nga bestytnitë dhe perversitetet, gjë që ai mund ta bëjë, sepse është një përfaqësues i Zotit të botëve i dërguar tek ata, është mëshirë e Zotit për ta. Ai iu jep mesazhe dhe ua ndriçon rrugën, sepse di atë që ata s'e dinë... Shekujt që kalojnë, nuk e ndryshojnë aspak mohuesin, heretikun. Kësaj radhe është Hz. Hudi që i flet popullit të vet të shndërruar në mohues dhe heretik: "O populli im! I patruri nuk jam unë! Unë jam i dërguari prej Zotit të botëve që t'ju kumtoj të vërtetat e dërguara nga Zoti ynë dhe një këshillues besnik për ju!" (Kur'ani, A'raf: 67-68) ' Nuk ka asgjë të re: profetët dhe popujt e tyre... Ato çka kërkojnë t' u ngjisin njerëzit profetëve dhe përgjigjet e profetëve. Edhe pse me ndonjë ndryshim në fjalë, kuptimi po ai! Dhe, po të doni, ta sjellim fjalën tani për Mbretin e të Dërguarve. Allahu'i flet atij drejtpërdrejt kështu: "O ti i mbuluar! Ngrihu dhe paralajmëro! Dhe lartësoje Zotin tënd! (Kur'ani, Mudeththir: 13). Dhe: "O ti i mbuluar! Përdore për

adhurim gjysmën e natës ose më pak ose më shumë dhe këndoje me kujdes Kur'anin fjalë për fjalë!" (Kur'ani, Muzemmil: 1-4). Sikur kërkon t'i thotë kështu me këto fjalë: "Nuk është më koha për t'u mbuluar e për të fjetur; ngrihu e vrapo në ndihmë të atyre që kanë mbetur në errësirë! Paralajmëroji turmat e hutuara e të çoroditura për fundin e' rrugës së shtrembër dhe rezultatet rrëqethëse të perversitetit! Dhe thirr me zë të lartë, me sa fuqi që të kesh, sa të kumbojnë qiej e tokë, për madhësinë e Zotit tënd! Të gjëmojnë qiej e dhe nën thirrjet e tua që të dëgjojnë edhe një herë tjetër njerëzit e xhindët sesa i madh është Zoti yt!

O mik, që mbulohesh e fle! Të pret një barrë e rëndë si profetësia, pra, ngrihu e bëj adhurim, sepse të duhet të marrësh forcë nga Zoti yt! Shumë punë të mëdha të presin. Të duhet që t'ua kumtosh njerëzve ato që do të thuhën. Këtë "zbrazje" nuk mund ta kryesh pa mbështetjen e Zotit tënd. Dhe ajo që do ta siguronte këtë, është madhështimi dhe adhurimi!.." Kështu është! Ashtu si edhe profeti ynë, çdo profet ka shpallur se ka ardhur për t'u kumtuar njerëzve dhe ka vazhduar t'i kumtojë njerëzimit mesazhe pa pritur gjë, pa u pasionuar pas gjërave të tjera, pa i

shfaqur ndjenja tjetërkujt, pa i çuar sytë te gjërat e tjera, pa iu turbulluar kurrë shikimi. Po të mos ishin mesazhet e ndritshme të tyre, tërë njerëzimi do të mbetej në errësirë dhe nuk do të dallohej nga kafshët! Fati i njeriut është i ndërthurur në atë mënyrë me detyrën e profetëve, saqë, nëse në një vend nuk është dërguar profet, njerëzit e atyre anëve mund të mos merren nën përgjegjësi për disa veprime të tyre. Por po të jetë dërguar profet dhe nuk dëgjojnë, nuk ka dyshim se do t'u kërkohet llogari. Dhe ja një ferman hyjnor. Ne nuk dënuam askënd para se t'i çonim një të dërguar." (Kur'ani, Isra: 15).

Dhe një tjetër deklaratë: "Zoti yt nuk është i tillë që të shkatërrojë vendbanimet para se të dërgojë një peygamber në qendrën e tyre dhe ne kemi shkatërruar vetëm vendet, banorët e të cilëve ishin dhunues e mizorë." (Kur'ani, Kasas: 59).

Kjo do të thotë se Allahu dërgon së pari profetë. Pastaj, nëse njerëzit vazhdojnë të mohojnë edhe pasi profetët e kanë kryer detyrën e tyre dhe i kanë paralajmëruar, Allahu ndëshkon. Kështu ka ndodhur në çdo periudhë. Nëse sot Zoti do të duhet të ndëshkojë një pjesë njerëzish, kjo varet nëse

besimtarët do ta kryejnë apo jo plotësisht detyrën që u bie për të komunikuar të vërtetën hyjnore, Ata që vazhdojnë të këmbëngulin në kundërshtimin e tyre edhe pasi u është komunikuar gjithçka, janë ata që e kanë merituar ndëshkimin. Është si rrjedhojë e kësaj që çdo profet ka udhëzuar pa u mërzhitur, pa u prapësuar dhe duke përdorur të gjitha metodat e kumtimit. Me gjuhën e Kur'anit, Hz.' Nuhu thotë kështu: "Zoti im! Unë i fola popullin tim natën e ditën, por fjalët e mia vetëm sa ua shtuan ikjen. Sa herë që t' i kem ftuar për t'ua falur Ti mëkatet, i kanë zënë veshët me gishtat, e kanë mbuluar kokën me rrobat dhe kanë vazhduar me mendjemadhësi në të tyren. Pastaj i lajmërova dhe i thirra haptas, haptas e fshehtas dhe u thashë: "Kërkoni falje prej Zotit tuaj se Ai fal shumë..." (Kur'ani, Nuh: 5-10.Hz. Nuhu kërkon të thotë kështu: "Imzot. i bëra thirrje natë e ditë pa pushim bashkësisë sime. U trokita vazhdimisht nëpër dyer. Por ftesa ime vetëm sa ua shtoi largimin dhe ikjen pa kthim. Këmbëngulën dhe nuk më dëgjuan. Sajuan vazhdimisht mënyra të reja për të mos më dëgjuar. Disa herë zunë veshët dhe bënë sikur s'kanë

dëgjuar gjë dhe disa herë mbuluan sytë dhe bënë sikur s'kanë parë gjë...”

Kumtimi tek ai, një veçori e lindur

Ndërkaq, kumtimi te Profeti i Dy Botëve ishte një natyrë, një shprehi e lindur. Kur nuk mundej të gjente një zemër të pastër e t'i kumtonte gjë, ndjente një shqetësim të tillë si në ato çaste kur ne nuk gjejmë gjë për të ngrënë a për të pirë, madje edhe kur s'marrim dot frymë; ai pothuajse ishte krejt i paimterësuar për të ngrënë e për të pirë. Disa herë agjëronte për ditë të tëra me radhë.¹⁹³ Dhe disa herë hante sa për të mbajtur frymën gjallë. “Sikur dhimbja e kumtimit nuk kishte lënë oreks tek ai! Ashtu siç jetonin me tesbih' engjëjt, ashtu edhe Hz. Muhamedi (s.a.s.) mbahej gjallë me kumtesën. Ndihej i gjallë atë ditë që kishte mundur të gjente një zemër të pastër për mesazhet e tij.

Duke folur për këtë gjendje të tij, Kur'ani i thotë kështu: ”A mos do të mbytesh veten pse ata nuk bëhen besimtarë?” (Kur'ani, Shuara: 3). Dhe në një vend tjetër i jep këtë ferman: ”Do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi duke vrapuar pas tyre pse nuk i besojnë kësaj ligjërate (Kur'anit)!” (Kur'ani, Kehf: 6).

Ashtu ishte. Me të parë diku një ballë pa sexhde, sterrë të zi, kërrusej nga dhimbja dhe çdo njeri pa besim që shihte, pothuajse i shkaktonte në shpirt furtunë zyrtësie. Fundja, kjo pati ekzistuar në shpirtin e tij, kurse me profetësinë u thellua akoma më shumë, u dimensionua.

I përkushtuar ndaj urdhrave të fesë gjer në imtësi... Ja, pra, për ju, njëri prej nxënësve të Tij dhe i vuajturi i shekullit! Kur më kanë pyetur se pse s'jam martuar, I jam përgjigjur: “Nuk më ka mbetur kohë dhe s'kam patur fare rast të mendoj për martesën ngaqë kam menduar vazhdimisht për vuajtjet dhe ankthet e bashkësisë së Muhamedit!” Ja, pra, halli i profetit dhe i trashëgimtarëve të profetëve! Pandeh se edhe bota sot të tillë të vuajtur pret! Meqë erdhi fjala këtu, dua të përsëris një shembull që e kam dhënë në shumë vende, sepse ky shembull do t'i përftojë, njëkohësisht, një dimension të ri temës sonë. Një shoku ynë ballëlarë që pati qëndruar ca kohë pensionet në një shtëpi, kishte ushtruar ndikim të madh mbi njerëzit e shtëpisë në sajë të shpirtit muhamedian që bartte, kurse Providenca Hyjnore e

kishte caktuar atë si pretekst për futjen e tyre në rrugë të drejtë. Kur në fillim burri, pastaj gruaja e, më pas, fëmijët kishin nisur të thithnin të njëjtën frymë, shtëpia ishte shndërruar në një qoshe parajse... Një ditë, shoku ynë dhe i zoti i shtëpisë ishin ulur e po bisedonim. Në një çast, ky njeri, në shpirtin e të cilit rruga e drejtë kishte bërë që të lindnin ndjenja të reja, i thotë kështu shokut tonë: "O mik, të dua " shumë, sa që më vjen të hap zemrën e të të fus aty, sepse ti u bërë shkaktar që unë të hyja në rrugën e drejtë, mua dhe familjes sime na përfytore një jetë të amshuar. Por, në të njëjtën kohë, ndjehem shumë i zemëruar me ty, aq sa më vjen të të kap për jake e të të heq ca shpulla. Do të më pyesësh, tani, "pse" e "përse". Po ta tregoj: Pak pa ardhur ti, më vdiq im atë, që e meritonte më shumë se ne të bëhej musliman. Kishte një zemër të bardhë borë e bënte një jetë të dëlirë. Po të kishe ardhur pa vdekur, do të bëheshe shkas që edhe ai të bëhej musliman. ja, për këtë vonesën tënde më Vjen inat ..

Ky qortim më duket si rënkimi i gjithë Europës, madje, i gjithë botës! Unë për vete kam shumë frikë se do të më zënë për jake e do të më kërkojnë hesap!

Sepse nuk kam mundur të çoj andej mesazhin e Islamit e ta kumtoj ashtu sa ç'duhet...

31

Pasioni ne Kumtim

I Dërguari i Allahut ishte shumë i apasionuar në kumtim. Nuk donte të mbetej njeri të cilit të mos i ishin treguar e drejta dhe dhe vërteta. Prandaj edhe

¹⁹³.Buhari, Savm, 20; Myslim, Sijam, 56.

194.Shih Myslim, Zekat, 126.

Tesbih: Përsëritje e esklamacionit "Subhanallah!" që do të thotë "I Madhëruar qoftë!", me anë të të cilit besimtari pohon konsideratën dhe bindjen e tij se Allahu, Zoti i gjithësisë, është qenia sublime që s'ka të bëjë me attribute relative dhe cilësi në kundërshtim me hyjnitetin e Tij.

përpiqej pa pushim me një dëshirë të nxehtë dhe çdo njeriu që i dilte përpara, i kumtonte në përshtatje me individualitetin e tij. Ja, pra halli i tij në kokë të të ungjit që po jetonte minutat e fundit të jetës.

Ftesa Ebu Talibit

Ebu Talibi ishte një njeri që e kishte mbrojtur të Dërguarin e Allahut për më se dyzet vjet me radhë. Kur Profeti pati shpallur profetësinë e tij, të gjithë politeistët dhe idhujtarët e Mekës kishin gjetur, para vetes, për të parën herë, një mur kalaje të pakapërcyeshëm si Ebu Talibi. Ishte e pamundur të arrinin te i Dërguari i Allahut pa kaluar mbi trupin e tij! Ebu Talibi që u kishte vënë gjoksin të gjitha shqetësimeve për hatër të Profetit, që, krahas shqetësimeve të tilla si pleqëria dhe varfëria, i ishte dashur të luftonte edhe kundër embargos trevjeçare të idhujtarëve, tani shtrihet në shtratin e vdekjes dhe po përjeton frymëmarrjet e fundit. Profeti shfrytëzon çdo rast për t'i shkuar pranë dhe i kërkon me këmbëngulje të thotë "La ilahe illallah" dhe vazhdon: "Thuaj, që të ndërhyj për faljen tënde në jetën tjetër!" Mirëpo njerëzit shpirtzinj që e rrethojnë Ebu

Talibin, i bëhen pengesë për të gjetur rrugën e drejtë. Prandaj edhe ai, duke dhënë frymën e fundit, thotë: "Me fenë e Abdylmuttalibit!" dhe Zoti e di e humb anijen. Profeti nuk i mban dot lotët e hidhërimit, qan me ngashërim dhe thotë: "Gjersa të më lejohet, do të kërkoj falje për ty!"¹⁹⁵ Vetëm se një ajetargument i ardhur më pas, e ndalon atë të vuajë këtë ankth që i pikonte gjak në zemër. Ai nuk do të mundet më të kërkojë falje as për Ebu Talibin, sepse ajeti thoshte kështu: "Nuk u ka hije as Profetit e as besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët edhe nëse janë të afërmit e tyre, pasi ta kenë të qartë se kanë vdekur idhujtarë dhe se janë banorë të Xhehenemit!" (Kur'ani, Tevbe: 113).

Ebu Bekri është njeriu që di më mirë se çdokush tjetër sesa i dëshiruar ishte Profeti për orientimin e Ebu Talibit. Kur u triumfua Meka, Ebu Bekri e çon pranë Profetit të Dy Botëve të atin plak, Ebu Kuhafe, me mendimin që t'ia pohojë mu aty besimin dhe të tokë dorën me dorën e bekuar të Profetit. Ndërsa ai plak i verbër pohon se ka besuar, Ebu Bekri hiqet mënjane dhe qan me ngashërim. Dhe, kur e pyet Profeti pse po qan, shoku i shpellës i përgjigjet: "O i Dërguari i Allahut, e dëshiroja shumë

kthimin e tim eti në rrugë të drejtë dhe ja, Allahu ia mundësoi një gjë të tillë. Vetëm se këtë gjë e desha më shumë për Ebu Talibin, sepse edhe ti deshe shumë që ai të kthehej kah e vërteta. Por nuk u bë e mundur për atë. Ia, këtë kujtova dhe qava...”¹⁹⁶³²

Profeti, ashtu siç dëshironte orientimin e të ungjit Ebu Talib dhe tregohej këmbëngulës për këtë, po ashtu dëshironte edhe orientimin e Vahshiut, vrasësit të të ungjit tjetër, Hamzait, Luanit të Allahut, duke treguar të njëjtën këmbëngulje. Ia fytyra e vërtetë e ngjarjes së regjistruar nga historia lidhur me çështjen në fjalë:

Ftesa Vahshiut

I Dërguari i Allahut e fton për në rrugën e drejtë Vahshiun, katilin e të ungjit, i çon letër me dikë dhe e thërret pranë që të hyjë në Islam, në fenë e së Vërtetës. Mirëpo Vahshiu shkruan një letër dhe ia jep lajmëtarit. Në letër shkruhej ajeti i mëposhtëm i

¹⁹⁵.Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/153.

¹⁹⁶.Ibni Hisham, Sire, 4/48; Mysned, 3/160;
Ibni Haxher, Isabe, 4/116.

Kur'anit: "...Edhe ata që nuk lusin ndonjë zot tjetër veç Allahut, që nuk vrasin pa të drejtë, gjë që e ka ndaluar Allahu dhe që nuk bëjnë kurvëri. Ndërsa ai që i kryen këto veprime, merr ndëshkimin e mëkatit të tij, i dyfishohet dënimi ditën e kiametit dhe mbetet aty përgjithmonë i përbuzur!" (Kur'ani, Furkan: 68).

Vahshiu kishte shtuar këto rrjeshta poshtë këtij ajeti: "Ti më fton të bëhem musliman, mirëpo unë i kam bërë të gjitha këto gjynahe që përmenden në këtë ajet. Jetova si femohues, kurvërova dhe vrava ungjin tënd që e shihje si dritën e syve. A mund të falet një njeri i tillë si unë që edhe unë të mund të bëhem musliman?"

I Dërguari i Allahut i çon edhe një letër tjetër, ku shkruan këtë ajet: "Allahu kurrë nuk fal që t'i përshkruhet shok. Me përjashtim të kësaj, fal atë që do. Kush i përshkruan Allahut shok, ka kryer një mëkat të madh duke shpifur për Të!" (Kur'ani, Nisa: 48).

Këtë radhë Vahshiu i transmeton të Dërguarit të Allahut se në këtë ajet falja nuk është e prerë, se i është lënë dëshirës Hyjnore.

Por Profeti i Dhimbshurisë i dërgon edhe një letër të tretë, ku i shkruan këtë ajet: "Thuaj: "O robtë

e Mi që e keni ngarkuar veten me të tepërt, mos e humbni shpresën te mëshira e Allahut, sepse Allahu i fal të gjitha mëkatet. Pa dyshim që Ai është mëshirues e fal shumë!” (Kur’ani, Zumer: 53).

Vahshiu vjen vetëm pas letrës së tretë dhe i jep fjalën të Dërguarit të Allahut. Pas kësaj, edhe ai do të konsiderohet njëri prej pasuesve dhe nuk do t’i përmendet emri pa i shtuar ”ra” pas. Megjithatë, ai mbetet vrasësi i Hamzait. Ishte e pamundur që këtë ta harronte qoftë ai, qoftë edhe dikush tjetër. Ndoshta Vahshiu nuk do të jepte llogari në jetën tjetër për këtë mëkat, sepse ai nuk pati qenë musliman ditën e kimit, ndërsa i ishin falur të gjitha gjynahet e kaluara tani që ishte bërë musliman.¹⁹⁷ Në këtë aspekt ishte me fat, vetëm se njeriu që kishte vrarë, ishte Hz. Hamzai!..

Hamzai, i cili ishte një njeri legjendar që trembte edhe luanët në pyll, ishte përgjnjur para të Dërguarit të Madh dhe ishte bërë musliman! Veçanërisht, meqë kishte thithur të njëjtën sisë që kishte thithur edhe ai, qëndronte lart si vëlla qumështi i Profetit.¹⁹⁸ Gjersa hyri Hz. Hamzai në Islam, muslimanët rrinin tërë frikë. Me t’u bërë musliman ai, bulërimat e muslimanëve kishin tronditur tërë Gadishullin

Arabik. Ja, pra, Vahshiu kishte hyrë në gjakun e Hamzait kur përjetonte një kohë egërsie." .Në luftën e Uhudit, heshtën e pafat që mbante në dorë, e kishte ngulur në gjoksin-e Hamzait. Hamzai i cili gjatë gjithë jetës i kishte thënë "La Jo" çdo gjëje përveç Zotit, lëshonte prapë një "La!" të dhimbshme tek binte mbi heshtën që i ishte ngulur në gjoks dhe rrëzohej përdhe si një "La!" Pak më pas i Dërguari i Allahut do t' i shohë gjymtyrët e tij të bëra copë-copë, do t'i ulet te koka dhe do të qajë si fëmijë. Dëshmorët nuk laheshin, por ai e lau Hamzain dhe në vend të ujit pothuajse përdori lotët e tij që ishin më të shtrenjtë se edhe burimet e parajsës. Po, kështu pati derdhur lot i Dërguari i Allahut mbi të! Dhe tani, katili, autori i këtij krimi, i kishte zgjatur atë dorën e përgjakur për t'i dhënë besën! Shihni, pra, se ç'kuptim të lartë kishte kumtesa për të Dërguarin e Allahut që e kapte atë dorë dhe uronte hyrjen e Vahshiut në Islam! Fundja, ishte ai vetë që e kishte ftuar me këmbëngulje Vahshiun për në Islam!¹⁹⁹

Pasi Vahshiu shprehu besimin e tij, i Dërguari i Allahut iu përkul te veshi dhe i mërmëriti këto fjalë: "Mundësisht përpiqu që të mos më dalësh shumë para sysh, sepse, sa herë që të shoh ty, kujtoj

Hamzain dhe mund të mos tregoj për ty dhembshurinë e domosdoshme. Në këtë rast, edhe ti rëndohesh, edhe unë nuk e kryej plotësisht detyrën që më takon! ” Vahshiu, me vetëdijen e një sahabeje, pasuesi profetik, kurrë nuk iu kundërvu kësaj lutjeje të Profetit. Gjithmonë ndejti larg tij dhe u përpoq që të mos i binte në sy. Njëkohësisht, e kaloi çdo sekondë e çdo minutë me pritjen e një ftese tjetër nga Profeti. Na duket sikur Vahshiu rri pas një shtylle, përpiqet të kapë vështrimin e Profetit dhe thotë me vete: ”A do të vijë, vallë, ajo ditë kur të më thotë "Më në fund, mund të shihesh"? Jo vetëm atë ditë që s'e mbërriti, por erdhi një ditë tjetër që Vahshiu të merrte lajmin e hidhur të perëndimit të Profetit e të largimit prej nesh. Vahshiun . sikur e kishin goditur në kokë! Tani i ishte shuar çdo shpresë!

Ditët e Vahshiut pas kësaj ishin vetëm kërkim për të shpague atë mëkatin e tij. Më në fund, shpërtheu lufta e Iemames. Hyri menjëherë në ushtrinë e Halidit dhe u dërgua në Jemame. Ky ishte për të një rast që s'duhej lënë t'i ikte prej dore. Kishte vrarë njërin prej trimave më të mëdhenj të Islamit dhe kishte hyrë në mëkat. Sado që të falej ai

mëkat, nëse falej, ndërgjegjja e tij digjej si ferr nën peshën e tij. Rasti do të thoshte eliminimi i Mysejlemes, armikut më të madh të Islamit. Vahshiu mori me vete heshtën e ndryshkur që s'e kish përdorur më qëkurse e pati nxjerrë nga gjoksi i Hamzait dhe u fut në luftën e Iemames. Lufta vazhdoi për ditë të tëra. Mysejleme dhe ushtria e tij luftonin për jetë a vdekje. Një çast, Mysejleme që doli nga muret e kalasë jashtë për të ikur, u pa prej një pasuesi që bënte rojë. Pasuesi i bëri zë Vahshiut: "Ja ku po ikën dushmani i

Allahut!" Vahshiu rrëmbeu menjëherë heshtën e ndryshkur dhe, ashtu siç e pati ngulur vite më parë në gjoksin e Hamzait, e nguli tani në gjoksin e Mysejlemes. Sa e pa që Mysejleme u shemb përtokë, edhe vetë u ul e ra në sexhde.200 Me ballin

mbështetur në tokë, me sytë plot lot, sikur i thoshte shpirtit të të Dërguarit të Allahut: "A mund të vij tani, o i Dërguari i Allahut?" Ne nuk e dimë se ç' përgjigje i ka dhënë i Dërguari i Allahut, por ka mundësi që edhe shpirti i tij të jetë ndodhur gati në Jemame dhe ky vaj zemërthyer i Vahshiut ta ketë zbutur, ta ketë marrë në gjoks Vahshiun si falënderim për heroizmin e treguar dhe t' i ketë

thënë: "Po, tani mund të më dalësh parasysh!" Nuk mund ta dimë. Kjo është një çështje dimensionesh. Kurse ne e përcollëm këtë ndodhi për të mundur të japim një ide mbi faktin se ç'përbënte kumtimi për Profetin...

Po, po e shohim se i Dërguari i Allahut kthehej në mëshirë edhe për një njeri të tillë si Vahshiu, katili i një shpirti të madh si Hz. Hamzai, të cilin e pati dashur më e pakta sa i ati dhe qe dridhur pas tij më e pakta sa pas të vëllait. Provonte, ndoshta, pesëdhjetë rrugë për ta futur në Islam Vahshiu dhe nxirrte një pasues edhe nga një njeri i tillë si ai! A do të ishte, vallë, e mundur të ftonte me këmbëngulje për në Islam një njeri si Vahshiu nëse te i Dërguari i Allahut koncepti i kumtimit nuk do të ishte njësuar me natyrën e tij, nuk do të ishte gjenetizuar në krijimin e tij dhe nuk do të ishte shndërruar në një copë të shpirtit të tij? Jo, në këtë zellin pasionant të tij qëndronte e fshehur e vërteta se kumtimi ishte një atribut i posaçëm vetëm për profetin. Prandaj edhe ai nuk mund të sillej ndryshe!

Ftesa Ikrimes

Armiqësia e Ikrimes e kapërcente edhe atë të Vahshiut. Ai ishte personifikimi i armiqësisë ndaj

Islamit. Me fjalë të tjera, ai e zhvillonte armiqësinë e tij në mënyrë të vetëdijshme. Pothuaj tek të gjithë pjesëtarët e shtëpisë ku kishte dalë Ikrimeja, kishte një armiqësi të bashkëlindur ndaj Islamit. I zoti i shtëpisë ishte Ebu Xhehli.’ Injoranca e tij u ishte ngjitur gjithë njerëzve të shtëpisë, e cila, me atë errësirën sterrë të zezë të mohimit dhe blasfemisë, ishte kthyer pothuaj në një humnerë që s’i gjindej fundi. Në atë shtëpi, çdokushqë kishte hyrë në Islam u nënshtrohej mundimeve më të rënda dhe kurrë nuk lihej i qetë.

Dukej sikur Ikrime, në armiqësinë ndaj Islamit, bënte garë me të atin. Merrte pjesë, pothuaj, në të gjitha veprimet tradhtare ku merrte pjesë edhe i ati. Mohimi ia kishte qorruar sytë. Edhe pse Meka ishte triumfuar, ai ende kundërshtonte. Sa e sa vetë ishin bërë muslimanë bashkë me triumfin e Mekës dhe kishin hyrë në aureolën e dritës, kurse armiqësia e Ikrimes vazhdonte. Ai kishte ngritur shpatën kundër muslimanëve gjatë triumfit të Mekës dhe, pastaj, kishte ikur në Jemen.

Ummi Hakem ishte gruaja e Ikrimes dhe kushërira e tij, vajza e të ungjit. Kjo grua heroinë

shkoi gjer në Jemen vetëm për të paguar një borxh besnikërie, por arriti ta bindë të shoqin e ta sjellë në Mekë. Vetëm se [krime nuk kishte fytyrë për të dalë para të Dërguarit të Allahut, sepse nuk kishte lënë armiqësi pa bërë kundër Tij. Nëse ishte dashur të shtrohej me gjemba udha nga do të kalonte ai, i pari Ikrime kishte vrapuar, nëse ishte menduar t'i hidhej dhe kokës, i pari Ikrime e kishte marrë përsi-për atë punë. Mirëpo I Dërguari i Allahut kërkonte me ngulm që edhe Ikrime të vihej në udhë të drejtë dhe tregonte ndaj tij po atë ndjeshmëri që kishte treguar për Vahshiun. Kur Ikrime hyri në audiencë te Profeti, i Dërguari i Allahut e priti në një mënyrë dinjitoze që i kishte hije personalitetit të tij, duke iu drejtuar kështu Ikrimes: ”Merhaba, o udhëtar i hixhretit!” Hixhreti, emigracioni i muslimanëve, kishte marrë fund. Por i Dërguari i Allahut iu drejtua kështu duke nënkuptuar se Ikrime vinte nga një udhë e largët. Kjo thënie mjaftoi për të tretur të gjithë akujt në zemrën e tij. Duke rrokur duart e të Dërguarit të Allahut, i kërkoi që të lutej për të: “Lutu për mua, o i Dërguari i Allahut dhe pendohu në emrin tim për të gjitha armiqësitë e mia!” Dhe i Dërguari i Allahut ngriti duart e u lut. Ikrime u

entuziazmaa, Ikrime kapërceu vetveten! Kurrë nuk kishte pritur një trajtim të tillë! Nuk kishte pritur, sepse gjer në atë çast e kishte konsideruar të Dërguarin e Allahut si një njeri të zakonshëm dhe kishte pritur prej tij atë trajtim që do të bënte në këtë rast çdo njeri i zakonshëm. Kurse nga konsiderata, afërsia dhe respekti i të Dërguarit të Allahut e kuptoi se kishte gabuar në pandehmën e vet. Dhe i tha: ”O i Dërguari i Allahut! Pas kësaj, do të jap për Islamit dyfishin e pasurisë që kam dhënë deri tani kundër teje dhe Islamit!” Dhe në Iermuk e mbajti fjalën. Veçse atje, përveç të tjerave dha edhe shpirtin... Ikrime mori pjesë në luftën e Jermukut së bashku me gru an dhe fëmijën. U plagos dhe e sollën në çadër. Gruas që po i qante mbi krye, i tha: ”Mos qaj! Nuk do të Vdes pa parë fitoren tonë!” Dhe ky pohim ishte njëra prej dukurive të jashtëzakonshme që kishin lidhje me të. Pak më vonë hyn në çadër i ungji, Hisham, dhe i thotë: ”Sihariq! Allahu na dha fitoren!” Atëherë Ikrime thotë: ”Më ngrini në këmbë se po hyn i Dërguari i Allahut!” Dhe i drejtohet shpirtit të Tij sikur ta kishte përpara atë vetë: ”O i Dërguari i Allahut! A e mbajta fjalën që të dhashë? A e çova në vend betimin tim?” Dhe, në frymën e

fundit, këndon ajetin-argument të Kur'anit, "Imzot, më bëj të vdes musliman dhe më bashko me të mirët!" (Kur'ani, Jusuf: 101) dhe ia dorëzon shpirtin Allahut!²⁰¹

Te i Dërguari i Allahut kishte një këmbëngulje të veçantë për t' i sjellë njerëzit në rrugë të drejtë. Ai përfaqësonte të paaritshmen në kumtim. Ua zgjaste dorën mijërave e qindramijërave dhe i tërhiqte në klimën e dritës. Tërhiqte mijëra e qindramijëra dhe prapë s'dinte të ngopur, sepse donte që të gjithë të përfitonin nga mëshira e tij e gjerë. Po, ai ua zgjaste dorën e dhembshurisë madje edhe atyre që

ishin treguar armiq të tij për vdekje dhe tregonte, kështu, se atributi i kumtimit të profetët ishte një horizont i paaritshëm.

Dhimbjet e kumtimit e linin pa gjumë

Në sytë e të Dërguarit të Allahut, gjatë gjithë jetës, nuk hyri një herë një gjumë i qetë e i plotë. Sepse ai vuante vuajtjet e të gjithë njerëzimit. Nëse shprehja "gjatë jetës së tij nuk i mbylli një herë sytë etë flinte i qetë" thuhet vetëm për Profetin e të Dy

Botëve, mund të jetë e drejtë! Jeta e tij pati kaluar vazhdimisht me kumtim.

Në vitet e para të periudhës së Mekës, i Dërguari i Allahut shëtiste panair më panair e sokak më sokak dhe, kudo që të organizohej një pazar, shkonte atje dhe i ftonte të pranishmit në fenë e së Vërtetës. Duke i shërbyer këtij qëllimi, u nënshtrohej goditjeve të panumërta, shahej, gjuhej me dhe e gurë, por, megjithatë, ecte drejt synimit të tij pa ua varur trajtimeve të tilla. Ndërsa engjëjt vetë druheshin ta shihnin në sy, ec e shih idhujtarët e Mekës që pështynin në atë fytyrë! Ndërsa herë-herë një re i bënte hije si perçe që të mos e digjte dielli, sjelljet më të trasha binin mbi atë fytyrë të ndritshme për respekt të së cilës jemi krijuar ne.

Me t'u reveluar ajeti-argument "Dhe tërhiqua vëmendjen farefisit tënd më të afërt!" (Kur'ani, Shuara: 214), ai mblodhi përfaqësuesit e të gjitha fiseve dhe tribuve që i kishte më të afërt dhe u tha: "Allahu më urdhëroi t'ju tërheq vërejtjen juve, farefisit tim më të afërt. Juve jeni njerëzit e mi më të afërt, por, nëse s'thoni La ilahe illallah, është e

pamundur të bëj diçka pranë Zotit për ju. Por po ta thoni këtë, mund të dëshmoj për ju në jetën tjetër!”

Ai ashtu u pati thënë, por, të pranishmit, sikur të ishin një mur që qëndronte para tij, nuk patën nxjerrë as edhe një fjalë prej goje. Pati folur vetëm i ungji, Ebu Lehebi -që më mirë t’i ishte tharë gjuha: ”Turp të kesh, a vetëm për këtë na paske thirrur?” Pas këtyre fjalëve të gjithë ishin shpërndarë.²⁰²

E gjithë pasuria e Hz. Hatixhesë që tretur e shkuar në gostitë e dhëna për të mëdhenjtë e Mekës. I Dërguari i Allahut i ftonte ata, u jepte të hanin e të pinin dhe, në këtë mes, ndërhynte pa pushim duke kërkuar ta merrte fjalën: ”A mund të them, vallë, disa fjalë?..” Mirëpo, gjithsesi s’arrihej gjë! Njërin nga këta kuvende Hz. Aliu (r.a.) na e përshkruan kështu: ”I Dërguari i Allahut i kishte ftuar përsëri në shtëpi të mëdhenjtë e Mekës. Mbaroi ngrënia dhe i Dërguari i Allahut gjeti rastin e filloi të fliste. Tha se ishte profet i vërtetë dhe se ata duhej ta ndihmonin si njerëzit e tij më të afërt që ishin. Dhe në fund i pyeti: “A nuk ka midis jush ndonjë që do të më ndihmojë në këtë çështje?” Atë ditë unë isha një çunak shtatëvjeçar fytyrëzbehtë e truphollë. Me shtambën në dorë, shpërndaja ujë.

Kur asnjëri nuk iu përgjigj fjalëve të të Dërguarit të Allahut, nuk durova dot, e lashë shtambën dhe i thashë: "Jam unë, o i Dërguari i Allahut!" Tri herë e përsëriti pyetjen e tij i Dërguari i Allahut dhe të tri herët askush nuk iu përgjigj përveç meje."203

Kështu, pra, me vite e vazhdoi i Dërguari i Allahut detyrën e kumtimit pa u mërzhitur e pa u tërhequr. Kurse të afërmit nuk ia vunë veshin hiç. Prandaj edhe ai u vu të gjente larg njerëz që do ta dëgjonin. Por edhe larg, të gjeje njerëz që të kishin zemër, nuk ishte aq e lehtë sa ç'mund të pandehet. Në Taif e gjuajtën me gurë dhe e tallën.204. Në panairë u përzu nga shumica e çadrave ku hyri.205 Mirëpo kjo kërkesë serioze e tij dukej sikur e tërhiqte atë drejt një bote surprizash dhe ashtu ndodhi në të vërtetë. Fati e shtyu atë drejt Akabes ku e takoi me ca njerëz me zemër të pastër. Në takimin e parë të Akabes u njoh me gjashtë njerëz. Një vit më pas këta erdhën në Akabe të bërë shtatëdhjetë. I Dërguari i Allahut u kumtoi atyre disa specifika. Po që se do t' i besonin, duhej t' i besonin brenda atyre kushteve. Dhe ata i pranuan pa lëkundje të gjitha propozimet e të Dërguarit të Allahut. Në këtë mes, Hz. Abbasi i këshilloi ata të vendosnin pasi të mendoheshin dhe u

tregoi me hollësi se pranimi i një propozimi të tillë do të thoshte të merrnin mbi vete zemërimin e të gjithë njerëzve. Por nuk pati midis tyre ndonjë që të tërhiqej. Pranuan duke dhënë fjalën se do të jenë në anë të të Dërguarit të Allahut edhe në kushtet më të rënda. Në kthim për në vendin e tyre, Profeti u dha me vete Mus'ab b. Umejrin që do t'u mësonte fenë.²⁰⁶

Ashku i kumtimit te sahabet

Mus'abi ishte djali i vetëm i familjes më të pasur të Mekës. Ishte shtatëmbëdhjetë vjeç kur hyri në Islam. Kur kalonte nëpër sokakë, vajzat zgjateshin në penxhere e i tundnin shaminë. Ishte një njeri që u jepte përparësi hajes e veshjes.²⁰⁷ Vetëm se, pasi hyri në Islam, nuk mundi të gjejë mbështetje te familja. Kur u nis për në Medinë, nuk i ndodhej asgjë me vete veç rrobës mbi trup. Kështu vazhdoi të jetonte edhe më pas. Kur ra dëshmor në luftën e Uhudit, të gjitha gjymtyrët i kishte dhënë për Allahun: sikur i ishte bluar trupi! Dhe pastaj nuk

ishte gjetur dot asnjë copë beze si qefin për t'ia hedhur 208 Siper.

Ja, pra, nxënësi i të Dërguarit të Allahut, ky sahabe i famshëm, sapo arriti në Medinë, menjëherë nisi nga detyra e kumtesës profetike dhe e orientimit të njerëzve. Duket se s'la derë pa trokitur në Medinë. Kishte një shpirt aq të sinqertë, të afrueshëm e të pastër, saqë kush e dëgjonte bisedën e tij, largohej nga herezia në kohën më të shkurtër dhe futej në rrethin e Islamit. Ardhja e tij në Medinë shkaktoi një tronditje në ecurinë e zakonshme të gjërave. Ai ishte si një burim drite që ndriçonte edhe zemrat sterrë të zeza. Es'ad b. Zurare bënte detyrën e të zotit të shtëpisë për të. Megjithëse namazi i së premtes ende nuk ishte bërë farz, detyrim, dhe Profeti ende nuk e kishte nderuar Medinën me ardhjen e vet, ky njeri kishte mbledhur njerëzit dhe kishte drejtuar për ta faljen e namazit të së premtes, xhumasë.²⁰⁹

Cilido njeri me reputacion në qytet vinte në shtëpinë e Es'ad b. Zurares dhe dëgjonte Mus'abin. Të ardhurit vinin me maraz, por kthimi i tyre nuk para ishte si ardhja. Njëri nga këta ishte edhe Sa'd b. Muadhi. Një ditë kishte ardhur i zemëruar duke thënë se nuk do të lejonte asnjëri që të fuste intriga,

se i kishin thënë që ardhja e Mus'abit në qytetin e tyre kishte për qëllim të intrigonte. Dhe Sa'di e kishte quajtur detyrë të tijën ta eliminonte këtë intrigë. Hyri në shtëpi. Mus'abi, me atë zërin e tij të butë si kadife, po u tregonte ca gjëra të pranishmëve. Në fillim Sa'di u suall shumë ashpër. Veçse Mus'abi e siguroi në këtë mënyrë: "Në fillim eja, ulu dhe dëgjo. Po të mos të pëlqejnë ato që do të them, mos u lëkund aspak, por lëshoje shpatën mbi zverkun tim. Beto hem se as që kam ndërmend që të të kundërvihem!" Këto fjalë mjaftuan për ta çarmatosur Sa'd b. Muadhin. Pak më pas hyri brenda nga pragu i derës që do ta lartësonte në pozita ku do ta përcillnin engjëjt dhe e thirri Fjalën e Dëshmisë me një zë që i buronte nga thellësitë e zemrës. Sa'd b. Muadhi ishte përgjunjur para Mus'ab b. Umejrit dhe ishte bërë musliman.²¹⁰ Në Medinën e asaj dite, ky eveniment kishte shkaktuar një entuziazëm të ngjashëm me atë të shkaktuar në Mekë me pranimin e Islamit nga Omeri. Kjo u bë një ngjarje e madhe e cila në kohën më të shkurtër gjeti jehonë edhe në fiset dhe tributë e periferisë. Siç shihet, ashtu siç e përhapte i Dërguari i Allahut të drejtën dhe të vërtetën pa u ndalur e pa pushuar, ashtu edhe nxënësit dhe

ndihmësit e tij ishin përhapur në të katër anët dhe përpiqeshin ta kryenin këtë detyrë në nivelin më të lartë! Njerëzimi do të ndriçohej me këta pishtarë të ndezur nga zemrat e përshndritshme! Fundja, a nuk ishte e njëjta ndjenjë që i kishte hedhur Mus'abin në Medinë, Talhain në Dumetu'l-Xhendel e, në vitet e mëvonshme, Berain dhe Halidin në Jemen? ³³

Nëse ndonjëherë, një pasues nuk pati patur sukses atje ku pati qenë dërguar, i Dërguari i Allahut e pati ndërruar dhe ky ndërrim e pati treguar ndikimin e vet në mënyrë absolute dhe në kuptim pozitiv. Për shembull, Halid b. Velidi nuk pati mundur të bëhej edhe aq i suksesshëm në Jemen, ku pati qenë dërguar me mision orientues. I Dërguari i Allahut pati dërguar pas tij Hz. Aliun, kurse Halidin e pati caktuar në Nexhran, në zonën ku ndodheshin të krishterë.

Bera b. Azizi e përcjell kështu këtë ngjarje:

²⁰⁹.Ibni Hisham. Sire. 2/77.

”Me ditë të tëra qëndruam në Jemen së bashku me Halidin. Gjersa erdhi Aliu, askush s’na besoi e s’u bashkua me ne. Por një të ardhur ai, menjëherë çdo gjë ndryshoi. Njerëzit nisën të hyjnë në Islam në grupe.”²¹¹ Po, Hz. Aliu kishte pasur shumë sukses në Jemen. Sepse ai kishte një të kaluar të gjatë me të Dërguarin e

Allahut. Veçanërisht ai ishte ati i Hz. Hasanit e Hysenit, prej të cilëve niste dhe vazhdonte hallka e artë e të gjithë njerëzve të shquar, të shenjtë e të urtë që do të vazhdonte gjer në Kiamet. Edhe sot, e drejta dhe e Vërteta përfaqësohet nën krahët mbrojtëse të tyre. E ja, ky Hz. Aliu triumfoi të gjithë Jemenin me fjalë që zbusnin zemrat, si pasojë e të Cilit triumf, kur të vinte dita e të triumfohej Meka, ata njerëz do të vinin të gjithë e do të bashkoheshin me Islamin!²¹²³⁴

²¹¹.Ibni Kethir,el-Bidaje,5/120-121

²¹².Ibi Kethir,el-Bidaje,5/120 e ne vazhd.

THIRRJE UDHEHEQESVE TE SHTETEVE

Ndërkohë që Profeti dërgonte, nga njëra anë, përreth talente të tillë të ndryshëm duke siguruar vazhdimësinë e detyrës së orientimit, nga ana tjetër, në thirrjet që u dërgonte sundimtarëve dhe

kryetarëve të shteteve, i ftonte ata në fenë e së Vërtetës. Dhe ky ishte një dimension i veçantë i kumtesës.

Nexhashiu

Nexhashiu ishte sundimtari i Etiopisë. Nuk ishte sahabi sepse nuk e kishte parë Profetin, por ishte një njeri shumë i madh. Profeti i pati çuar atij Amr b. Umejjen. Në letrën dërguar Nexhashiut, Profeti i të Dy Botëve i thoshte kështu:

"Nga i Dërguari i Allahut, Muhamedi, sundimtarit të Etiopisë, Nexhashi.

Përshendetje! Me këtë rast falënderoj Allahun që është Sundimtar, Hyjnor, Garantues dhe Mbrojtës! Dhe dëshmoj se Isai është shpirti i Zotit dhe fjala që Allahu ia la Virgjëreshës, të ndershmes e të .pastrës Merjeme...Të ftoj ty tek Allahu që është i vetmi Zot pa shok e pa të ngjarë!"²¹³

Duke e përsëndetur, qysh në fillim, drejtpërdrejt Nexhashiun, Profeti i të Dy Botëve nënkuptonte se tek ai diçka kishte parë. Sikur i Dërguari i Allahut e kishte parë me sytë që shihnin te e fshehta se Nexhashiu do të bëhej musliman që i

drejtohej në këtë mënyrë. E dyta, shprehja dhe stili i përdorur janë një mrekulli, sepse, duke iu afruar çështjes, i Dërguari i Allahut është afruar me Merjemen, e cila, në sytë e Nexhashiut, ishte një person shumë i madh dhe i respektuar. Edhe për ne ajo është po aq e madhe, sepse është gruaja që ka sjellë në botë një profet të madh dhe e merituar për frymëzim. Një specifikë që duhet të na tërheqë vëmendjen, është fakti që Nexhashiu është kristian, kurse Profeti, në letrën dërguar atij, ka përdorur si material ajetet e Kur'anit lidhur me tematikën në fjalë. Kjo ka qenë rruga më efektive dhe më e drejtë për të hyrë në shpirtin e Nexhashiut. Dhe me të vërtetë, ashtu ka ndodhur.³⁵

Nexhashiu ka zbritur nga froni për të marrë letrën, e ka puthur dhe e ka vënë në ballë. Sapo ka mbaruar këndimi i letrës, i është përgjigjur duke shpallur se është bërë musliman dhe, pa humbur kohë fare, u ka diktuar qatipëve të vet këtë letër:

²¹³.Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/104.

”Muhamedit, të Dërguarit të Allahut nga Nexhashiu, sundimtari i Etiopisë.

Dëshmoj se ti je i Dërguari i Allahut...Po qe se më urdhëron, jam gati të Vij menjëherë atje...vetëm se unë urdhëroj vetëm veten time. Në këtë çast nuk i kam nën urdhër nënshtetasit e mi. Dëshmoj prapë se të gjitha thëniet e tua janë të drejta.²¹⁴

Nexhashiu është një njeri me vetëdijen e besimit. Një ditë u kishte thënë kështu të afërmve të tij: "Sikur në shkëmbim të kësaj mbretërie të bëhesha shërbëtori i Hz. Muhamedit!"

Kalon kohë dhe një ditë i Dërguari i Allahut vjen në faltore e u thotë të pranishmëve: "Ngrehuni! Do të falim namazin e të vdekurit të vëllait tonë Nexhashi!"²¹⁵

Mes juristëve, çështja e namazit të kufomës ose të të vdekurit, është një çështje kontradiktore. Ndërsa imamët e tjerë përveç shkollës juridike Hanefite e quajnë të lejueshëm një namaz të tillë,

imamët Hanefitë thonë të kundërtën, sepse, sipas tyre, tabuti i Nexhashiut është ndodhur gati para të Dërguarit të Allahut, si një vepër mrekullie, kjo, dhe namazi i falur, është falur, kështu formalisht. Kjo

është një çështje juridike, trajtimi i hollësishëm i së
cilës nuk e ka vendin këtu...216 ³⁶

²¹⁴ .Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/105.

²¹⁴.Buhari, Xhenaiz, 4, 65; Myslim, Xhenaiz,
62-67.

Herakliti

Letrën e dytë, i Dërguari i Allahut ia dërgoi Heraklitit me anë të Dihjetu'l-Kelbit. Herakliti ishte perandor i Romës. Në atë letër përmbaheshin këto:

“Në emër të Allahut Mëshirues e Bamirës!

Nga Muhamedi, i Dërguari i Allahut, Heraklitit, sundimtarit të Romës. Paqja e Allahut qoftë mbi ata që shkojnë me të drejtën! Të ftoj ty në Islam. Bëhu musliman dhe shpëto! E kështu, Allahu të jep ty dyfish shpërblim. Po qe se kundërshton, të ngarkohet ty edhe e keqja e të gjithë kundërshtuesve!

O adhurues të librit! Ejani e të bashkohemi te një fjalë e përbashkët: të mos adhurojmë tjetër përveç Allahut, të mos ibëjmë shok asgjë Atij dhe të mos e lëmë Allahun e të hyjnizojmë njëri tjetrin! Nëse ata

përsëri kundërshtojnë, atëherë u thoni: "Dëshmoni se ne jemi muslimanë!"²¹⁷

Këto fjalë e kishin prekur Heraklitin. Atë ditë atje ndodhej edhe Ebu Sufjani dhe midis tyre u zhvillua kjo bisedë:

Herakliti: Ç'prejardhje ka ky njeri?

Ebu Sufjani: Ka një prejardhje të pastër e fisnike.

-A ka ndodhur më parë që njëri nga etërit e tij të ketë pretenduar për një gjë të tillë?

-Jo.

-A ka pasur sundimtarë mes etërve të tij? -Jo.

-Ata që i shkojnë pas, a janë të shtresave të ulta, apo të larta?

-Përgjithësisht janë nga shtresat e ulta, Njerëzit e tij Vijnë duke u shtuar, apo duke u pakësuar?

-Vijnë duke u shtuar.

-A ka gënjyer ndonjëherë? '

-Nuk e kemi dëgjuar ndonjëherë që tëketë gënjyer. A ka ndodhur ndonjëherë që të mos e ketë mbajtur fjalën?

-Gjer më sot s'ka ndodhur, por më vonë, s'e di. '.

37

²¹⁶ .Xheziri, Mezahib, 1/522-523.

Ja, pra, Ebu Sufjani, megjithëse ende nuk ishte bërë musliman dhe megjithëse ishte një armik i pamëshirshëm i Profetit, vetëm në fund të asaj bisede kishte mundur të fuste një dyshim.

Herakliti i përsërit përgjigjet e Ebu Sufjanit dhe thotë se të gjitha ato janë argument i profetësisë së Muhamedit (s.a.s.) dhe thërret peshkopin i cili, gjithashtu, shfaq të njëjtin opinion. Sipas një rrëfimi, Herakliti pohon besimin e tij duke thënë: "Pas një kohe shumë të shkurtër, këto vende që shkel këmba ime, të gjitha do të bëhen të tija!"²¹⁸

Veçse Herakliti, për shkak të pellitjeve priftërore si të gomerëve të egër, e ndërron rrjedhën e fjalëve të veta dhe thotë: "Unë ju provova që të shoh se gjer në ç'pikë jeni të lidhur pas fesë suaj." Kurse peshkopi besoi dhe në mënyrë të fshehtë e miratoi Profetin..²¹⁹ ³⁸

²¹⁶.Buhari. Bedu'l-Vahj, 6.

²¹⁸.Buhari, Bed'u'l-Vahj, 6.

Dhe të tjerët

Profeti u pati dërguar letra edhe disa personave të tjerë. Disa prej tyre i qenë përgjigjur letrës dhe qenë bërë muslimanë, kurse disa të tjerë, megjithëse s'ishin bërë muslimanë, ishin sjellë me respekt ndaj të Dërguarit të Allahut. Muvakisi, për shembull, një kipti, banor autokton i Egjiptit dhe sundimtar i tyre. Profeti i pati dërguar atij Hatib b. Ebi Belteanë. Muvakisi nuk u bë musliman, por, sa kohë që Hatib b. Ebi Beltea qëndroi pranë tij, e gostiti dhe, kur u kthye, i dha dhurata për të Dërguarin e Allahut. Një prej tyre ishte edhe nëna jonë, Marije. Profeti pati bashkëjetuar me të dhe nga ajo bashkëjetesë pati lindur një djalë që iu vu emri Ibrahim. Mes atyre dhuratave pati qenë edhe një mushkë e bardhë e quajtur "Dyldy", e para mushkë që shihte atë ditë arabi.²²⁰

Kurse Kisra e pati copëtuar letrën e ardhur nga Profeti dhe e pati hedhur përtokë, veprim i cili ishte rishembëlluar në trajtën e copëtimit të pasurisë së tij; pak kohë pas letrës, Irani ishte bërë copë-copë.²²¹

I Dërguari i Allahut u kumtonte sundimtarëve, kryetarëve të shteteve dhe prijësve të fiseve të

ndryshme në një mënyrë që do të thoshte të luaje me të gjithë botën dhe çdo ditë e më tepër hynte ndër zemra dhe ngrinte fron në to. Dukej sikur ai kishte një tërheqje të shenjtë dhe sikur i tërhiqte njerëzit me ca fije enigmatike. Çdo individ dhe shoqëri, të kapur nga tërheqja e tij, njëkohësisht

bashkoheshin e bëheshin një e tërë me botën e dritës. Pasi ai ngrinte fron në zemra në këtë trajtë, të luftoje kundër tij, ishte e njëjtë sikur të doje t'i hidhje diellit baltë. Ajo do të ishte një përpjekje e kotë!

Dhe ashtu ndodhi pak më vonë. Pothuajse të gjithë ata që patën rezistuar dhe kundërshtuar gjer më atë ditë, e kuptuan se kishin qenë përpjekur më kot dhe, kështu, u bashkuan me Të...³⁹

²¹⁹.Po aty.

²²⁰.Ibni Kethir, el-Bidaje, 5/324.

²²¹.Buharl, Ilim, 7; Mysned, 1/243.

HUDEJBIJE NGA KENDVESHTRIMI I KUMTIMIT

Në kumtim, Hudejbije është një dimension i veçantë. Pranimi nga ana e të Dërguarit të Allahut i një marrëveshjeje të tillë me kushte të rënda që pritur me një reagim që mund të kuptohej si kundërshtim, edhe nga personalitete të tillë si Hz. Omeri në krye, të palëkundur në besnikërinë e tyre ndaj Tij dhe, në këtë rast, qenë përjetuar minuta të avullta deziluzioni; qenë përjetuar, por një vit më vonë muslimanët patën hyrë në Mekë me entuziazëm. Ndërkaq, marrëveshja që bërë në Mekë temë diskutimi gjatë gjithë një viti, gjë që pati bërë të mundur përgatitjen e ngadaltë të zemrave për të pranuar Islamin dhe, gjatë kësaj kohe, patën hyrë në Islam me vullnetin e tyre të lirë personalitete të mëdhenj nga paria e Mekës si Halid b. Velidi, Amr b. Asi e të tjerë si ta.²²² Hyrja e tyre në Islam pa iu cënuar nderi dhe sedra, kishte rëndësi shumë të madhe në lidhje me shërbimet që do të kryenin ata në të ardhmen dhe ashtu ndodhi...

Veçanërisht shembulli i besnikërisë ndaj Profetit që patën treguar sahabet, pasuesit, gjatë marrëveshjes, nuk i pati shpëtuar syrit të delegatëve mekas, gjë që pati shpejtuar zbutjen e qëndrimit të mekasve ndaj Islamit. ⁴⁰

KUMTIMI NE PLANIN INDIVIDUAL

I Dërguari i Allahut u jepte rëndësinë më të madhe marrëdhënieve individuale edhe kur ishte në kulmin e triumfit. Ai e dinte se brenda nja dy vjetësh i gjithë populli i Mekës do të bashkohej me të, por, megjithëkëtë, e priste me një konsideratë të veçantë ardhjen e Halid b. Velidit me Amr b. Asin duke derdhur mbi ta buzëqeshje. E kishte çuar sahaben që kishte pranë për ta pritur Halidin dhe, kur ky e kishte zgjatur dorën në shenjë dorëzimi, i kishte bërë një kompliment të tillë: "Edhe unë çuditesha sesi mund të mbetej në mohim një njeri i mençur si Halidi...

²²² Ibni Kethir, el-Bidaje, 4/272.

Unë e besoja me siguri se do të Vije pa tjetër një ditë e do të bëheshe musliman!”²²³ Për njeriun që ndodhej në atë gjendje, këto fjalë të thëna nga i Dërguari i Allahut ishin komplimenti më i madh. Dhe me këto komplimente kushedi ç’tension metafizik kishte përjetuar Halidi për të ardhmen e tij! Në këtë mes edhe Amr b. Asi e kishte kapur për dore të Dërguarin e Allahut dhe s’e lëshonte! N gulte këmbë pa pushuar e thoshte: ”O i Dërguar i Allahut, kërko falje për gjynahet e mia dhe lutju Zotit, lutju që të më falë mual!” Profeti i të Dy Botëve i bënte komplimenta edhe atij dhe i thoshte kështu: "A edi, Islami i fshin të gjitha gjynahet e kaluara. Kur njeriu hyn në Islam, bëhet i pafajshëm si atë ditë kur e ka lindur nëna!”²²⁴

Po, më në fund, i Dërguari i Allahut kishte ngritur fron në zemrat dhe afërsinë ndaj personalitetit të tij të lartë e vlerësonte në emër të kumtimit. Njerëzit vraponin tek ai tufa-tufa dhe futeshin në fenë e tij. Madje dallgëzimi i asaj dite ka arritur gjer në ditët e sotme. Pandehim dhe besojmë se mesazhi i bekuar i Profetit do të vazhdojë me të gjithë shkëlqimin e vet të veçantë edhe paskëtaj gjer në Kiamet!

Kur e shohim këtë çështje qoftë edhe aq sa ç'reflektohet në shtyp, sot në Europë miliona njerëz po bëhen muslimanë dhe bota po rrëshqet drejt Islamit. Po, Europa është shtatzënë në Islamin dhe do ta tregojë këtë gjë së shpejti. Kurse lindja në botën Islame është duke u plotësuar. Shihni, tani, edhe këtë nga lindja e botës, domethënë nga vendet ku sundon mendimi dyfytyrësh! Megjithëse ka kaluar një kohë më tepër se një gjysmë shekulli dhe megjithëse njeriu i këtyre anëve u është nënshtruar asimilimeve të frikshme, muslimanët që jetojnë këtu, në Turkistan, Uzbekistan, Dagestan, Kirgizistan, etj., vrapojnë drejt botës së tyre mendore e shpirtërore sikur të mos kishin humbur asgjë prej saj. Në një të ardhme të afërt, Ezani Muhamedian do të dëgjohet edhe në zemër të Moskës dhe edhe atje do të ketë njerëz që do të hyjnë në Islam tufa-tufa. Ata që e përfaqësojnë detyrën kumtuese të të Dërguarit të Allahut, nuk do të lënë asnjë vend të botës pa e çuar këtë detyrë dhe, duke i bërë të gjitha këto, do të sillen, njëkohësisht, si therorë të dashurisë dhe dhembshurisë!⁴¹

²²³.Ibni Kethir, el-Bidaje, 4/273; Kenzu'l-

MERITIMI I KONSIDERATES HYJNORE

Në një ajet-argument, Allahu (xh.xh.) i drejtohet kështu të dërguarit të Tij: "O ti i dërguar! Kumtoje atë që t'u zbrit prej Zotit tënd e, nëse nuk e bën këtë gjë, atëherë nuk e ke kryer detyrën. Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon." (Kur'ani, Maide: 67)

Allahu (xh.xh.) nuk i është drejtuar kështu asnjë profeti. Të tjerëve u flitet thjesht në emër; është vetëm Hz. Muhamedi (s.a.s.) ai për të cilin është përdorur një apelacion i tillë lartësues.

Me apelativin "O i'dërguar" bëhet fjalë për njeriun që sjell mesazh nga Zoti, që sjell lajme, që është i informuar për botën përtej. Duke i atribuar atij një nder të veçantë me këtë trajtë apelimi, Allahu edhe neve na kujton Vlerën dhe nderimin që gëzon ai profet. Kjo mund të quhet edhe shpallje e pozitës

Ummal, 13/374.

²²⁴.Ibni Kethir, el-Bidaje, 4/271.

së nderuar të tij. Dhe Profeti na prezanton neve mesazhin e duhur nën hijen e kësaj pozite të nderuar.

Allahu e ka nxjerrë atë në majën e një spiraleje prej drite, me profetësinë. e ka bërë atë të papërsëritshëm dhe e ka shndërruar në një bashkëbisedues me të cilin mund të bisedohet sy 'më sy. Po, ashtu siç kuptohet edhe nga pohime të tilla, Allahu e ka marrë atë para dhe ka biseduar me të drejtpërsëdrejti. Me të vërtetë, disa kërkues të së vërtetës thonë se Profeti ynë në miraxh në këtë mënyrë ka biseduar me Providencën Hyjnore. Ashtu siç ka ndodhur që revelacione të tjera i janë komunikuar si pas perdes, por, megjithatë, personalisht nga Ai, ashtu edhe bisedimi në

Miraxh është bërë drejtpërsëdrejti, duke u takuar personalisht.²²⁵ Ja, ky është Muhamed Mustafai! Allahu e pati nxjerrë Profetin në lartësinë e lartësive dhe i pati thënë: "Mesazhet që të kam lënë si amanet, duhet t'ia bësh të njohura njerëzimit pa u ndalur dhe asgjë s'duhet të të bëhet pengesë në këtë punë, s'duhet të kapesh për asgjëje e të pengohesh! Asgjë s'duhet të të shmangë ty prej detyrës së kumtimit, as frika e as droja, as etja e as uria dhe as ndonjë lloj pozite që i përket kësaj bote!

Dhe, me të Vërtetë, ashtu pati ndodhur! I Dërguari i Madh Paqja e Zotit qoftë mbi të nuk qe kapur pas asnjë pengese dhe e pati çuar në vend detyrën që i ishte lënë amanet, pa u ndalur qoftë edhe një çast të vetëm! Atij i qe hapur porta e detyrës profetike dhe ai qe ngjitur nga këto porta në një lartësi të tillë, pas caktimit të së cilës Hz. Xhebraili i pat thënë kështu: Ec o muhamed! Pas kësaj, pushka është e jotja dhe topi është yti; unë s'mund të bëj edhe një çap më tej, përndryshe .nuri i madhështisë së Tim Zoti do të më digjte e përvëlonte!”

Kjo do të thotë të bësh presion mbi kuadrin e mundësisë, madje ta tejkalosh atë. Kjo çështje më kujton gjithmonë August Kontin. Filozofi francez August Konti (1798-1857) është ndër themeluesit e pozitivizmit. Jeta i pat kaluar vazhdimisht me armiqësinë ndaj fesë, sepse, sipas tij, çdo gjë që nuk hynte në fushën e eksperiencës shkencore, ishte një sofizëm i kotë. Por historia na përcjell një ndodhi të tillë në lidhje me të: Një radhë, August Konti ka shkuar në Andaluzi, ka parë me mahnitje atje veprat artistike islame dhe për të marrë të dhëna rreth Islamit, u ka drejtuar pyetje disa vetëve. Ndër

përgjigjet, ajo që thoshte se Profeti ynë ka qenë i pashkollë, e ka lënë pa mend. Nuk ka besuar, ka shkuar në Romë dhe e ka pyetur papën për këtë gjë. Pasi edhe papa ka vërtetuar ato thënie, filozofi ynë s'ka bërë dot pa thënë: “Muhamedi nuk është zot, por nuk është as dhe njeri!...”

A nuk thotë kështu edhe Busejriu ynë? ”Kjo është pika e fundit ku ka arritur dituria: Ai njeri është, vetëm se është më i dobishmi ndër krijesat që ka krijuar Zoti!”

Me fjalë të tjera, edhe ai është i lindur prej një nëne e një babe, është biri i Amines dhe Abdullait dhe nipi i Abdylmutalibit, që janë aspekti material i tij, megjithatë, është e pamundur që ta shpjegosh dhe ta prezantosh në mënyrë materiale atë! Ai është një pallua që fluturon mbi qiellin e profetësisë. Mirëpo fjalët tona s'bëjnë gjë tjetër veçse vërtiten vazhdimisht përreth vezës së dalë prej tij. Në miraxh ai pat hedhur hapin në një pikë të tillë, saqë ne e kemi të pamundur ta kuptojmë se ku e pati vënë këmbën, madje. Sepse kjo nuk është një specifikë që mund të konceptohet me anë të vetëdijes dhe me anë të njohjes njerëzore.

Kumtimi është i domosdoshëm në nivel të tillë, saqë Zoti ka ngarkuar me këtë detyrë robin më të dashur të Tij që e ka kaq të afërt, të cilin e paralajmëron personalisht se, po të mos e çojë në vend detyrën e kumtimit, do të thotë se nuk e ka kryer në tërësi detyrën profetikel!

Nëse çështja qëndron kështu, do të thotë se edhe detyra më e domosdoshme që na bie ne, bashkësisë së Profetit, është po ajo: detyra e kumtimit. Të mos harrojmë se ringjallja e tërë njerëzimit pothuaj në të gjitha fushat e jetës do të bëhet e mundur vetëm duke u mbështetur në frymëmarrjet ringjallëse të Hz. muhamedit e të atyre që jetojnë po me ato frymëmarrje!⁴²

DISA SPECIFIKA TE RENDËSISHME NE KUMTIM

Në kumtim ka disa specifika të rëndësishme. Sipër patëm prezantuar një pjesë prej tyre. Duke dhënë një përmbledhje të shkurtër të tyre, le ta

²²⁵ .Ibni Kethir, Tefsir, 7/424.

përfundojmë temën e kumtimit me vazhdimin e pjesës së mbetur.

E para, kumtimi ka aspektin e zgjuarsisë, së cilës mund t' i themi edhe logjikë profetike.

E dyta, prijësi që kryen kumtimin, duhet, ta përfaqësojë shumë mirë çështjen që kumton. Gjërat që do të tregojë ai, duhet të jenë gjithmonë gjëra të jetuara. 'Po, ai duhet të tregojë jo gjërat e rëndësishme të jetesës së dikujt tjetër, por jetën e vet të jetuar si dhe njerëzit që do t'i ftojë, për një jetë të tillë duhet t'i ftojë.

E treta, ajo që pritet në fund të kumtimit, vetëm pëlqimi i Zotit duhet të jetë As xheneti, madje, s' duhet të vihet si qëllim në kumtim. Dhe kjo do të thotë të sakrifkosh në ndjenjat e përfitimeve materialo-shpirtërore.

E para është Zgjuarsia e brendshme. Kumtesa e të Dërguarit të Allahut ka edhe një aspekt tjetër që është zgjuarsia, veçse kjo zgjuarsi nuk është një logjikë e thatë. Kjo është një logjikë që përshkohet nga aparenca në thelbin e gjërave e të dukurive, nga bota materiale në atë shpirtërore. Njeriu, ashtu siç ka

aspektin e tij logjik ka edhe aspektin ndjesor. Ata që i flasin vetëm logjikës së njeriut, falimentojnë para ndonjë të çare apo porte që mund të hapet tek ai nga ana e ndjenjave të tij. Kurse ata që kërkojnë të vënë në punë vetëm aspektin ndjesor të njeriut, dalin të mundur përballë logjikës së tij. Ndërsa Hz. Muhamedi (s.a.s.) u flet njëherazi edhe vëzhgimit të njeriut, edhe gjykimit, edhe parandjenjave të brendshme. Njeriun e trajton me gjërat që i sheh syri, e bën shembull dhe me këtë rrugë i zë vend në shpirt. E përdor dhe nxit tek tjetri përdorimin e mendjes e të inteligjencës. I jep rëndësi gjykimit dhe u bën zë ndërgjegjeve në mënyrë të tillë, që çdokush që dëgjon zërin e tij, me një lëvizje u del para atyre që kërkojnë të arrijnë te e vërteta vetëm me rrugën e ndërgjegjes dhe arrin te e Vërteta...Persona të tillë si Paskali dhe Bergsoni që përpiqen ta gjejnë Zotin me anë të rrugës së intuitës, mbeten në këtë fushë që konsiderohet si e tyrja, shumë e shumë larg madje edhe nga besimtarët e përgatitur nga Hz. Muhamedi (s.a.s.) duke u fryrë jetë atyre. Fundja, në virtytshmërinë e përgjithshme, është e pamundur të bësh një analogji midis tyre dhe besimtarit më të vogël!

Njohja e mirë e individëve

Ashtu siç ka qënë i pamundur afrimi ndaj Hz. Muhamedit në asnjë fushë, ashtu nuk është e mundur as në lidhje me këtë zgjuarsi. Po, ai i ka përgjunjur kundërshtarët së pari me anë të vëzhgimit. Ka ngritur gishtin, ka treguar idhujt dhe u ka thënë: “Ç’shpresoni nga ky gur, nga ky dru e nga kjo baltë?” Dhe pastaj, në mënyrë mrekullore ose me anë të një mrekullie që do ta këtë vënë në shesh, e ka kapur për dore bashkëbiseduesin, mendjes së të cilit i është ' drejtuar së pari dhe e ka tërhequr pranë zemrës së vet. Dhe më pas, me anë të ngjyrimit të bashkëbiseduesit me praninë e vet. i ka përfutuar atij një lartësim të ri dhe pothuajse e ka idealizuar.

Le të marrim si shembull ecurinë e zhvillimit shpirtëror të Hz. Omerit. Profeti i qe drejtuar atij me këto fjalë: ”Si ndodh që një njeri i mençur si ti të ketë punë me njerëz të prapambetur? Ç’është e drejta, assesi s'ma pranon mendja që një njeri si ti të

shpresojë diçka prej gurit, dheut apo drurit-!" Pikësëpari, në këto fjalë përcillet vlerësimi i lartë për Omerin, ka një sjellje që bart respekt për logjikën. Në këtë mënyrë, Profeti e ka marrë në dorë Hz. Omerin në emër të logjikës dhe, më pas, me atë qëndrim të shkëlqyer që reflektonte ndaj bashkëbiseduesit besim dhe siguri të kahershme, ka zotëruar zemrën e tij. Kurse në etapën e tretë, me anë të thellësisë së konfidencës së shprehur, e ka sjellë atë në një gjendje të tillë, sa që ai Omeri që mund të kapte për brirësh e të shembte përtokë një deve, të bjerë në gjunjë para të Dërguarit të Allahut si një fëmijë plot edukatë e të paloset më dysh.

Dhe tani, pasi të jap një shembull konkret rreth kësaj çështjeje, dua të kaloj në çështje të tjera.

Në audiencën e të Dërguarit të Allahut vjen një djalë i ri. Sahabet, pasuesit e Profetit, nuk e thonë hapur emrin e tij, por, nësei bëjmë bashkë disa rrëfime, kuptohet se emri i këtij të riu është thlejbib. I riu vjen dhe i thotë kështu Profetit: "O i Dërguari i Allahut, më jep leje të kurvëroj, pasi e kam të pamundur të duroj!" Reaksioni i të pranishmëve është i ndryshëm. Dikush e qorton duke i thënë "Mos fol kështu pa edukatë para të Dërguarit të

Allahut!. Dikush tjetër e tërheq për rrobe. Një tjetër ka ndërmend t'i kërcasë një shpullë. Ndërkaq, vetëm njëri është që hesht para sjelljes së keqe të djalit dhe kundërveprimeve jo konstruktive të të pranishmëve: është profeti i lartë, profeti i dhembshurisë dhe monumenti i mëshirës! E dëgjon djaloshin, pastaj e thërret pranë vetes, e merr dhe e ul pranë gjunjëve të veta. E ka magjepsur me qëndrimin e vet të deritanishëm dhe me këtë gjestin e fundit... Dhe i flet këtij të riu të magjepsur:

A do të doje që një gjë e tillë të ndodhte me nënën tënde?

T'u bëfshin kurban nënë e babë, o i Dërguari Allahut, s'do të doja! Dhe askush s'do të donte që të ndodhte një gjë e tillë me nënën e vet!

Mirëpo, po të kishe pasur një vajzë, a do të doje që të ndodhte një gjë e tillë me të?

T'u bëfsha kurban, o i Dërguari i Allahut, s'do të doja! Dhe askush s'do të donte një gjë të tillë për vajzën e vet!

Mirëpo, a do të doje që të ndodhte një gjë e tillë me hallën apo me tezen tënde?

jo, o i Dërguari i Allahut, s'do të doja

Po me motrën tënde, a do të doje që dikush të përdhunonte motrën tënde?

Jo, nuk do të doja dhe askush nuk do ta donte një gjë të tillë për tezen, hallën apo motrën e vet, o i Dërguari i Allahut!

Në këtë bashkëbisedim, në planin mendor-logjik, i Dërguari i Allahut e ka marrë në pëllëmbë të dorës këtë të ri dhe sikur e ka shtrirë si një kufomë në dërrasën e larjes së kufomave. Ka mbetur pa u bërë vetëm larja. Atëherë Profeti e vendos dorën në gjoksin e këtij të riu dhe lutet kështu: "Allahu im, falja mëkatit, pastroja zemrën dhe ia mbro nderin!"²²⁶

Pas kësaj lutjeje, thlejbib që shndërruar në një monument virtyti. Që shndërruar, mirëpo askush nuk po i jepte vajzë për shkak të së kaluarës së tij. Atëherë pati hyrë në mes i Dërguari i Allahut dhe thlejbib që martuar.²²⁷ Pas martesës, në luftën më të parë, pati rënë dëshmor. Në përfundim të luftës, Profeti i pati pyetur luftëtarët e pranishëm: "A ju mungon kush?" Ata i qenë përgjigjur: "Jo, o i Dërguar i Allahut, të gjithë jemi." Kurse Profeti u pati thënë: "Më mungon mua dikush!" Dhe pati shkuar te koka e thlejbibit. Ky kishte vrarë shtatë

vetë dhe atë çast shtrihej i plagosur për vdekje. Profeti e pati ngritur kokën e thlejbibit, e pati mbështetur mbi gjurin e vet dhe pati thënë kështu: “Ky thlejbibi është imi, po edhe unë i këtij thlejbibit jam!” Dhe thlejbibi që kishte arritur një lartësim të tillë, pati fluturuar përtej...²²⁸

ja, pra, zgjuarsia madhore e të Dërguarit të Allahut, një të ri të dhënë pas marrëdhënieve të paligjshme, brenda një kohe të shkurtër e pati ngjitur në një lartësi të tillë, saqë mendja është e paaftë për ta kuptuar!

E tani, sikur të mblidheshin të gjithë pedagogët dhe edukatorët e ditëve të sotme e të shkonin në Gadishullin Arabik, a do të mund të realizonin jo më atë edukim e atë mrekulli morale të realizuar nga i Dërguari i Allahut brenda një kohe shumë të shkurtër, por qoftë edhe vetëm nja dy parime morale?⁴³

²²⁶.Mysned, 5/ 256-257.

²²⁷.Mysned. 4/422.

²²⁸.Myslim, Fezailu's-Sahabe, 131.

Realiteti është kah na e tregon në tërë lakuriqësinë e vet se përgjigjja e kësaj pyetjeje nuk do të jetë pozitive.

Ai pati jetuar në një periudhë të tillë, kur të gjitha llojet e amoralitetit qenë bërë një natyrë e dytë e njeriut të asaj dite. Por i Dërguari i Allahut nuk pati mbetur vetëm me heqjen dhe hedhjen tej të atij morali të keq nga karakteri i njerëzve. Në të njëjtën kohë, ai i pati pajisur ata me më të bukurin e moralit, ashtu që njerëzimi nuk pati parë e nuk do të shihte as më pas një moral të tillë dhe njerëz të tillë të moralshëm. Ashtu siç është historia islame me anë të mijëra shembujve dëshmitari më besnik i kësaj, ashtu edhe fakti që përpjekjet e ditëve tona për të larguar njerëzit nga disa vese të këqia mbeten pa rezultat, e tregon këtë fare hapur. Ia një shembull: Një shtet kaq i madh i hap luftë cigares, qeveria i del për zot kësaj çështjeje, qindra njerëz të shkencës, me pretekste të ndryshme, mbajnë konferenca me këtë temë, shkruajnë libra dhe përpjekja për t'i bërë njerëzit që ta lënë duhanin kthehet në një bashkëpunim të organizuar, mirëpo rezultati përsëri zero, përsëri zero!

Dhe tani hidhini një sy bashkësisë së njerëzve që edukoi i Dërguari i Allahut, sesi gjejnë zbatim menjëherë tek ta fjalët e thëna prej tij. Ja një shembull. Hz. Enesi tregon: “Në shtëpinë e Ebu Talhait unë po bëja detyrën e sakiut, po u mbushja gotat atyre që pinin. Një çast, nga jashtë u dëgjua një zë. Zëri thoshte: ”Kujdes! Pija u ndalua! ” Atëherë, ai që e kishte gotën plot, e derdhi, ai që e kishte pijen në gojë, e pështyu dhe secili e derdhi në rrugë pijen që kishte me vete nëpër poçe aq sa me ditë të tëra rodhi pija nëpër sokakët e Medinës...” .229

Po, ai i pati bërë të gjitha këto! Atyre që s’duan ta shohin këtë fakt, u tregojmë Gadishullin Arabik dhe u themi: ”Eja, bëni edhe ju një të miliontën e asaj që pati bërë Ai! Eh, kurrë nuk do të mund ta bëjnë!..

Përjetimi paraprak i specifikave që do të kumtohen

E dyta, njëra prej dinamikave të përdorura nga Hz. muhamedi (s.a.s.) në kumtim, që përputhja e plotë e mënyrës së tij të jetuarit me postin që përfaqësonte. Ai i përfaqësonte në një nivel të tillë thëniet e veta, saqë njeriu që e shihte atë, arrinte në

konkluzionin e ekzistencës së Zotit pa pasur nevojë për asnjë argument. Shpesh herë, vetëm prezantimi me të mjaftonte për pranimin e profetësisë së tij.

Sa bukur shprehet Abdullah b. Revaha: '

E sikur me mrekulli të qarta të mos ish i shoqëruar; Mjafton ta shihje Atë e kishe për t'i besuar...230

Ata që e patën pranuar Atë, ata që patën qenë pasionuar pas Tij dhe ata që e patën thirrur Atë "o i Dërguari i Allahut", qenë njerëzit që e patën qeverisur botën pas Tij! Me fjalë të tjera, ai nuk pat qenë dikushi që pat bërë për vete vetëm katër-pesë radhë njerëz. Midis atyre që pati përgatitur ai, është një Ebu Bekr, një Omer, një Osman dhe një Ali (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!), secili prej tyre i dimensioneve botërore dhe secili prej tyre i tillë që _nuk do të binte në gjunjë para të parit njeri që do t'i dilte përpara! Po qe se Hz. Muhamedi nuk do të kishte qenë i Dërguari i Allahut, asnjëri prej tyre nuk do t'i ishte bindur e nënshtruar. Gjithashtu, nëse do ta pranonte atë për profet të vërtetë një njeri i tillë si Hz. Aliu që e thoshte hapur atë që shihte e mendonte, që thoshte "edhe sikur të hapej perdja, nuk do shtohet asgjë në atë që shoh"231 dhe që

ndodhej në nivelin besirnor të posedimit të faktit të së Vërtetës, ky është një eveniment i një dimensionit të tillë 'që do të përbënte një argument në vetvete për besimin e Zotit e të dërgesës profetike të Hz. Muhamedit (s.a.s.)!

Çdo element i pamjes së jashtme e i sjelljes së tij ishte aq magjepsës përsa i përket sublimes që shprehte, saqë edhe një dijetari tillë çifut si Abdullah b. Selami pati deklaruar besimin e tij vetëm me herën e parë që qe prezantuar me Profetin: "Nuk ka gënjeshtër në këtë fytyrë; i zoti i këtij portreti vetëm i dërguar i Zotit mund të jetë!"²³²

Kjo do të thotë se të shihje atë, ishte e mjaftueshme për ta pranuar. Ata që ia kanë kushtuar jetën qëllimit për t'u treguar diçka të tjerëve, e kuptojnë dhe e dinë më mirë se kushdo tjetër sesa i vështirë është ky lloj pranimi. Kështu ndodh që shumica e tyre rropatet një jetë të tërë e nuk arrin t' u tregojë diçka as dhjetë njerëzve, aq njerëzve sa gishtat e të dy duarve të veta, aq më pak t' ua imponojë veten e të hyjë në botën e tyre shpirtërore. Mirëpo pa hidhini një sy të Dërguarit të Allahut! A mund të tregoni një njeri të dytë si ai që sot ka ngritur fronin në ndjesitë e afro një miliardi njerëz?

A ka ndonjë tjetër që t'i thërritet emri nga minaretë pesë herë në ditë me një tingull dhe emocion që të gjëmojë tërë globin? Njerëzimi e do atë dhe e shpall disa herë në ditë besnikërinë ndaj tij, madje përkundër kaq shumë njerëzve e sistemeve që punojnë kundër tij! Po, pavarësisht nga çdo gjë, Hz. Muhamedi (s.a.s.) vazhdon të ngrejë fron në zemrat e njerëzve, sepse ato çka u thotë të tjerëve, ai i ka përjetuar së pari në vetvete, në subjektivitetin e tij dhe gjithmonë është bërë një shembull i gjallë i thënieve të tij! Prandaj edhe çdo fjalë e tij ka ushtruar ndikim mbi masat, thëniet e tij kanë gjetur gjithmonë zbatim dhe janë ruajtur nga njerëzit si shpirti i tyre!

Gjithashtu, edhe kur i pati ftuar njerëzit për ta adhuruar Allahun duke u bërë robër vetëm të Tij, përsëri vetë pati përfaqësuar shembullin e robit më të mirë në pikën finale të horizontit! ⁴⁴

²³⁰.Said Hawa, er-Rasul, 1/19; Për një rrëfim të ndryshëm, shihni Ibni Haxher, Isabe, 2/307.

²³¹.Aliju'l-Kaari, el-Esram'l-Merfua, f. 286.

²³².Ibni Hisham, Sire, 2/163-164.

Nëna jonë, Hz. Aishe, tregon: "Një ditë erdhi e më tha: "O Aishe, a po më jep leje, se sonte dua të mbetem vetëm për vetëm me Zotin tim?" Dhe, pas këtyre fjalëve, qëndroi në namaz."

Dhe atë natë fali namaz gjer në mëngjes duke kënduar ajetin: "Në krijimin e qiejve e të tokës; në ndryshimin e natës e të ditës ka argumente të qarta për ata që kanë intelekt!" (Kur'ani, Al'i Imran: 190). U fal dhe derdhi lot, derdhi lot aq shumë, saqë, po t'ia shtrydhje sexhaden, do t' i pikonte lotët pikë-pikë...233

Ai falte namaz gjersa t'i enjteshin këmbët. Një ditë, duke ia kujtuar se i ishin falur të gjitha gjynahet e shkuara e të ardhme, i ishte thënë: "Pse e fut kaq shumë veten në mundim?" Dhe ai ishte përgjigjur: "A nuk duhet të jem një rob që e falënderon Zotin e tij?"²³⁴. Atij i ishte hapur porta e falënderimit dhe këmbëngulja e tij nga kjo buronte.

Përsëri nëna Aishe tregon: "Ishte mesi i natës kur u ngrita dhe ndjeva zili kur s'e ndjeva pranë të Dërguarin e Allahut: "Mos vallë ka shkuar te ndonjë nga gratë e tjera"? mendova. Sapo do të ngrihesha nga shtrati, më zu dora në këmbën e tij. U përqëndrova, e pashë se kishte rënë në sexhde dhe

po lutej kështu: "Allahu im, nga ndëshkimi Yt, te Pëlqimi yt strehohem!..."²³⁵ ⁴⁵

Po të donte, ai mund të hante, të pinte e të jetonte si mbretërit. Dhe një jetë e tillë i ishte propozuar me kusht që të hiqte dorë nga kauza e tij qysh kur ndodhej në Mekë. Por, në shërbim të kauzës, ai kishte parapëlqyer jetën e mundimshme ndaj jetës së qetë.²³⁶ Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe, sepse ai ishte besniku i portës së të Vërtetës që një ditë i urët i lutej Zotit e një ditë i ngopur e falënderonte Atë si dhe që kishte parapëlqyer profetësinë prej robi ndaj profetësisë prej sundimtari.²³⁷ Ishte pikërisht kjo jetesë e thjeshtë që i robëronte zemrat e njerëzve ndaj tij!

²³³ .Ibni Kethir, Tefsir, 2/164.

²³⁴ .Buhari, Tehexhud, 6; Myslim, Munafikin, 81

²³⁵ .Myslim, Salat, 223; Ebu Davud, Salat, 148, Vitr, 5.

²³⁶ .Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/80.

²³⁷ .Mysned. 2/231; Kenzu'1-Umma1, 7/191; Metheu'z-zevaid' 9/19'20'

Në fakt, edhe Hz. Omeri jetonte një jetë shumë të thjeshtë, por jetesa e të Dërguarit të Allahut edhe sytë e tij i përllote. Një ditë Profeti e pati pyetur Omerin: "Pse qan, Omer?" Dhe ai i qe përgjigjur: "O i Dërguari i Allahut, ndërsa mbretërit flenë këtë çast në dyshekë me pupla, ti fle mbi rrogos që të lë gjurmë mbi trup. Mirëpo ti je i Dërguari i Allahut dhe e meriton më shumë se çdokush tjetër një jetë të qetë!" Dhe Profeti i pati thënë: "A nuk të pëlqen, Omer, që kjo botë të jetë e tyrja, kurse bota e përjetshme, e jona?"²³⁸

Drejtimi i botës duhet të ishte në dorë të muslimanëve dhe këtë, i Dërguari i Allahut e donte më shumë se çdokush tjetër. Ndërkaq, në jetën e tij personale ai jetonte një jetë nga më të thjeshtat, më drejt, ai nuk jetonte, por jepte jetë. Fundja, edhe enigma e hyrjes së tij në ' shpirtira dhe e ngritjes fron atje, a nuk përbënte, në këtë formë, një nivel të caktuar cilësor të përfaqësimit?

Në këtë qëndrim dhe sjellje të të Dërguarit të Allahut ka shumë mësim për ata që e bëjnë punë a profesion detyrën e kumtimit. Po, kushti 1 vetëm për të hyrë në zemra, për të ndikuar tek të tjerët dhe për të ngritur fron në ndjesitë e tyre, është, ashtu siç ka

vepruar i Dërguari i Allahut, që çdo gjë e thënë të jetë më parë e jetuar nga vetë ai që e thotë.

Nëse dikujt kërkoni t'i shpjegoni domosdoshmërinë e të derdhurit lot nga frika e Allahut, më parë duhet të ngriheni natën e të qani gjersa t' ju njomet sexhadeja juaj. Pikërisht atëherë, fjalët që do të thoni të nesërmen, do të kenë aq shumë ndikim, saqë edhe juve do t'ju lënë të mahnitur. Ndryshe, do të hani një shpullë nga ajeti që thotë "Pse thoni gjëra që s'keni për t'i bërë vetë?" (Kur'ani, Saff: 2) dhe kurrë nuk do të mund të bëheni të ndikueshëm!... ⁴⁶

Veprimi pa pritur shpërblim

E treta, i Dërguari i Allahut nuk pati bërë ndonjë kërkesë të llojit material apo shpirtëror, pra, për ndonjë përfitim në këtë botë apo në tjetrën si kundërvlerë të kryerjes së detyrës së kumtimit dhe kjo është një argument më vete mbi profetësinë e tij, sepse një qëndrim i tillë është tipar karakteristik i

²³⁸. "Buhari, Tefsir (66), 2; Myslim, Talak, 31.

moralit profetik. Sa për ata që kanë vepruar pas tij në bazë të këtij morali, janë pikërisht ata kumtuesit e vërtetë dhe burrat e kauzës. Kur'ani urdhëron për t' u lidhur pas këtyre njerëzve që nuk presin shpërblim prej askujt dhe thotë: "Shkoni pas tyre..."²³⁹

Pasuria e Hz. Hatixhesë ishte shkrirë e sosur për të përhapur të vërtetën dhe, pavarësisht nga rrethanat, ai kurrë s'pati kërkuar gjë në emër të vet prej ndokujt. ..

Hz. Ebu Bekri ishte shoku i tij më i afërt dhe ai që do ta shoqëronte edhe në emigrim. Hz. Ebu Bekri i pati përgatitur Profetit kafshën me të cilën do të udhëtonte. Ç'do të bënim ne në një rast të tillë? Veçanërisht në ato kushte të rënda, nuk do të mendonim gjë tjetër veçse për të ikur nga armiku që po na ndiqte. Ndërsa i Dërguari i Allahut i pati thënë se do ta pranonte kafshën vetëm nëse e paguante!²⁴⁰ Ja, pra, a nuk provon kjo sesa i ndershëm sillej ai në çdo punë që kryente? Njeriu që e mendon një pikë të tillë delikate në një çast të tillë të vështirë, a nuk e

mendon edhe në kohë më të qeta? Pandeh se njeriut të kumtimit i mjafton kjo ngjarje si mësim.⁴⁷

Ebu Hurejre tregon: "Një ditë e pashë të Dërguarin e Allahut në mesxhid; po e falte namazin ulur. E pyeta: "O i Dërguari i Allahut mos je i sëmurë?" "Jo, o Eba Hurejra, m'u përgjegj, jam i uritur. Nga uria nuk më ka mbetur fuqi të ngrihem në këmbë." Unë nisa të qaj. I Dërguari i Allahut më qetësoi: "Mos qaj, vështirësia e llogaridhënies nuk do t' i prekë të uriturit!"¹⁴¹

Uria pati qenë vuajtja e tij që s'ndërron...

Një herë tjetër, qenë takuar në një skaj të Medinës në mesnatë¹⁴² të tre pa ditur gjë që më parë për njëri-tjetrin: ai, Ebu Bekri dhe Omeri, prandaj edhe i kishin drejtuar menjëherë njëri-tjetrit të

²³⁹"Ndiqni ata që s'kërkojnë asnjë shpërblim prej jush, ata janë në rrugë të drejtë!"
Kur'ani, jasin: 21.

²⁴⁰.Ibni Kethir', el-Bidaje, 3/213.

njëjtën pyetje: ”Ç’të ka nxjerrë jashtë në këtë orë të natës?” Edhe përgjigjja kishte qenë e njëjtë: ”Uria...” Po, të tre kishin dhënë për Allahun çdo gjë që kishin, kështu që s’kishin gjetur një kafshatë bukë për të ngrënë, s’i kishte zënë gjumi dot dhe kishin dalë jashtë...²⁴²

Ja, pra, këto duar të fuqishme e kishin ngritur ngarkesën e rëndë që duhej ngritur atë ditë në emër të kumtimit, Edhe sot, ata të cilëve u takon të ngrejne të njëjtën ngarkesë, gjithsesi të tillë forcë duhet të zotërojnë!

Fatimen, vajzën e Profetit për të cilën ai thoshte ”ç’gjë &: gëzon atë, më gëzon edhe mua dhe ç’gjë e mërzit atë, më mërzit edhe mua”²⁴³ nuk kishte kush ta ndihmonte në punët e shtëpisë. Duart i mbante të lidhura e supet i kishte tërë plagë nga bartja e ujit dhe vërtitja e gurit të mullirit të dorës. Hz. Aliun e brengoste shumë kjo gjendje, por s’kishte gjë në dorë dhe kështu u jetua ajo kohë e gjatë vuajtjeje. ⁴⁸

²⁴¹.Ebu Nuajm, Hilje, 7/109; Kenzu'l-Ummal, 7/199.

²⁴²..Myslim, Eshribe, 140; Kenau'l-Ummal, 7/196 e në vazhd.

Ajo bartte moralin e të atit. Ajo e kishte kaluar të atin nëshprehinë e trashëguar prej tij për të bërë vetë punët e veta. Ajo i përngjiste të atit edhe sesi ulej, edhe sesi ngrihej.²⁴⁴

Një herë, pasi ishin sjellë në Medinë preja e një luftime, skllevër dhe plaçkë, çdo njeri shkante te Profeti, ia paraqiste nevojat dhe merrte ca gjëra sipas nevojës. Shkoi edhe Hz. Fatimeja me nxitjen e Hz. Aliut, por s'e gjeti në shtëpi të atin, prandaj i tregoi një rës prej grave pse kishte shkuardhe u kthye në shtëpinë e vet.

Sapo e mori vesh, Profeti shkoi menjëherë në shtëpinë e së bijës. Hz. Fatimeja që ndodhej e shtrirë në shtrat, deshi menjëherë të ngrihej. Por ky njeri i natyrshëm u ul në cep të shtratit pa i dhënë mundësi asaj të ngrihej. Hz. Fatimeja po e ndjente në shpirt ftohtësinë e gjunjëve të tij, Ai i tha: "Bija ime, s'mund të të jap asgjë ty pa plotësuar më parë nevojat e Suffes. Por unë po të mësoj ty diçka shumë më të dobishme e të bekuar se kjo. Kur të vish për të rënë në shtrat, thuaj 33 herë Subhanallah, 33 herë

²⁴³..Buhari, Fezailu'l-Ashab, 12, '16; Myslim, Fezailu's-Sahabe, 93:94.

Ëlhamdulillah! dhe 33 herë (sipas një rrëfimi, 34 herë) Allahuekber! Ndër kërkesat e tua, kjo është më e mira për llogarinë tënde të ringjalljes!”²⁴⁵

Prapë një ditë, Profeti i pa një bylyzyk në dorë Hz. Fatimesë. Dhe i tha: ”Moj bijë, mos dëshiron që njerëzit të thonë se vajza e të Dërguarit të Allahut bart në dorë një hallkë xhehenemi?” Dhe iku. Kurse Hz. Fatimeja, pastaj, bleu me atë bylyzyk një skllav të cilit i dha lirinë për hir të Allahut! Sikur ta dinit sesa kishte mbetur i kënaqur Profeti kur e kishte marrë vesh se si kishte ndodhur!”²⁴⁶ ⁴⁹

Një tjetër aspekt i kësaj pike është edhe ky. Profeti, jo vetëm që nuk kërkonte gjë prej njerëzve, por shpesh detyrohej t'u nënshtrohej vuajtjeve e mundimeve që i shkaktinin ata. Sa e sa herë që bërë pluhur fund e krye dhe s'pati ndodhur që t' i vinte kush në ndihmë përveç së bijës Fatime. Dhe sa e sa

²⁴⁴ .Buhari, Menakib, 25; Myslim, Fezailu's-Sahabe, 98-99.

²⁴⁵.Buhari, Fezailu'l-Ahsab, 9; Myslim, Zikr, 80-81; Ebu Davud, Edeb, 100.

²⁴⁶.Nesai, Zine, 39.

herë i patën vënë ferra në rrugën nga do kalonte dhe i qenë larë këmbët me gjak. Një radhë, Profeti po falte namaz në Qabe. Idhujtar'e't iu hodhën sipër e po e qëllonin. Atë çast kaloi andej Hz. Ebu Bekri dhe i shkoi në ndihmë: "Mos do ta vrisni tjetrin pse i tha "Allah" Zotit të vet?".²⁴⁷ Gjëra të tilla ndodhnin pa pushim. Mirëpo këto ndodhi kurrë nuk e patën shmangur atë nga udha e vet. Ai i pati thënë kështu vajzës së vet: "Mos qaj, bijë, Allahu nuk do ta humbë tët atë!"²⁴⁸ Dhe me të vërtetë, Allahu nuk e pati humbur kurrë atë; Allahu i pat bërë zemrat e milionave pasqyra të përyetshme për të! ..

Le t'i hedhim, tani, një sy të fundit diskutimit mbi kumtimin dhe të kalojmë në një diskutim tjetër.

Ashtu siç u përpoqëm ta shpjegojmë gjer këtu, kumtimi është qëilimi i qenies, i ekzistencës së profetëve. Për të kumtuar janë krijuar ata. Kur ne merremi me këtë punë, s'bëjmë gjë tjetër veçse çojmë në vend një përgjegjësi tonën, kurse profetët e kryejnë atë si qëllim të krijimit e të jetës së tyre.

Veçanërisht, duke e analizuar këtë temë, u përpoqëm të tregojmë sesi në fytyrën e dëlirë të mesazhit të sjellë nga i Dërguari i Allahut, shkruhej "Muhameden Resulullah", Muhamedi është i

Dërguari i Allahut”. Në të njëjtën kohë, me mënyrat dhe metodat e

përdorura nga ai në kumtimin e mesazhit të sjellë, u përpoqëm të tregojmë se ato përbëjnë një argument të rëndësishëm që vërteton qenien e tij si i dërguar i Allahut, se, për ata që do të donin të vazhdonin pas tij detyrën e kumtimit, ato janë një rrugë që nuk të

gënjen e të çorienton. Ne besojmë kategorikisht se është e pamundur të bëhet fjalë për sukses të vazhdueshëm e të pandërprerë pa përdorur metodën e kumtimit të të Dërguarit të Allahut. Ka mijëra ngjarje që e vërtetojnë në praktikë këtë pamundësi. Prandaj edhe kujtojmë dhe një herë me një opinion kategorik e me një besim faktikisht të sigurt se ata që dëshirojnë të bëhen udhëzues dhe imamë ose ata që ndodhen në këtë rol, duhet të jenë në harmoni të plotë me Hz. muhamed Mustafanë (s.a.s.), imamin e amshuar të këtij orientimi. Prijësi dhe udhëzuesi i vërtetë

Ai është dhe rruga e hapur prej Tij është rruga e drejtë e vërtetë, sepse Ai nuk flet nga vetja e si t’ i

pëlqejë; ç'të ketë thënë Ai, është revelacion jashtë çdo diskutimi!..⁵⁰

ZGIUARSIA PROFETIKE

Zgjuarsi' do të thotë kapërcim i nivelit të aftësisë së zakonshme' për të menduar. Pata prezantuar se kësaj mund t'i themi edhe logjikë profetike. Ky është emërtimi i dukurisë që sendërtohet duke u bashkuar më një shpirti, ndjesitë dhe delikatesa.

Zgjuarsia profetike kurrë nuk mund të jetë një mendim dhe logjikë e thatë. Është pikërisht për këtë që shprehje të tilla si "Islami është fe e mendjes", "Islami është fe e logjikës" me të cilat Islami kufizohet tek mendja dhe logjika, duke shkuar përtej

²⁴⁷.Buhari, Fezailu'l-ashab, 5; Mysned, 2/204.

²⁴⁸.Metheu'z-Zevaid, 6/21.

mosnjohjes së tij, konsiderohen edhe hapi i parë i një korigjimi të madh. Jo, Islami s'është as fe e mendjes, as fe e logjikës, ai është drejtpërsëdrejti një fe e revelacionit.

Fakti që çështjet islame nuk bien në kontradiktë me mendjen dhe logjikën, rrjedh, nga njëra anë, nga fakti se "ato çështje, duke ardhur nga një mjedis dituror, vërtetohen, njëkohësisht, edhe nga mendja; nga ana tjetër, rrjedh nga fakti se logjika profetike që i komenton ato në përputhje me tërësinë e kontekstit hyjnor, është e gjerë dhe universale, e thënë ndryshe, është frymëzim profetik. Kjo logjikë profetike është krijuar në një dimension që të mundë ta kuptojë e trajtojë revelacionin. Kjo logjikë, gjithashtu, është e hapur Në origjinal: Fetanet. Shpjegimi i mësipërm është i autorit. Në F. Gj. S. Sh., si sinonime të kësaj fjale jepen "mençuri" dhe "mendjemprehtësi". Edhe një ndër fjalorët shpjegues shkencorë më të mëdhenj të turqishtes së sotme, "M.E.B. Omekleriyle TURKÇE SOZLUK, 1995", jep shpjegime të afërta me ato të fjalorit të shqipes. Mirëpo, siç duket më lart, autori mendon se ky nocion është i posaçëm vetëm për profetët. Në fakt, kjo fjalë nuk përdoret në raste të përgjithshme si dhe aspak në turqishten e

sotme. ndaj ndjenjës, logjikës, zemrës, ndaj të gjitha delikatesave njerëzore si dhe ndaj filozofisë që nënkupton urtësinë. Kjo është logjikë mbi logjikat ose, e thënë ndryshe, "Zgjuarsi e Lartë".

Reflektirni pikësëpari tek kjo logjikë i çdo revelacioni që vjen prej Zotit, është domosdoshmëri dhe nevojë. Dhe kjo nevojë ka të bëjë me njerëzit, sepse, nëse revelacioni do të arrinte te njerëzit pa arritur më parë te një logjikë e tillë për t'u rregulluar apo moduluar atje, për t'u transformuar ashtu siç transformohet rryma alternative në rrymë të vazhduar, njerëzimi, përballë revelacionit dhe frymëzimeve të ardhura nga ajo begati e shenjtë me anë të Vullnetit të Përgjithshëm, do të digjej flakë-flakë. Ashtu siç do të digjej e do të bëhej hi tërë ekzistenca nëse Zoti do të hiqte perdet nga Fytyra e Tij Hyjnore, ashtu do të ndodhte edhe gjatë revelacionit.¹⁴⁹Po, është zgjuarsia profetike ajo që bën punën e atmosferës ndaj shkëndijave përvëluese të revelacionit. Kjo është edhe ajo që i themi fe. Revelacioni hyjnor është zbritur në nivelin e njohjes njerëzore. Dhe këtë e ka bërë logjika profetike, domethënë zgjuarsia profetike. Prandaj edhe kjo zgjuarsi është një atribut që duhet të gjendet te çdo

profet. Dhe është kjo një logikë që gjendet vetëm tek profetët, kështu që është gabim të shprehet me fjalën "gjenialitet" . Logjika profetike qëndron mbi të gjitha logjikat, prandaj edhe cilësohet si "zgjuarsia profetike".

E si do të ishte e mundur që profetët, këta njerëz të vënë përballë kundërshtimeve të armiqve dhe pyetjeve të miqve, të shpjegojnë dhe komentojnë gjithë ato çështje nëse nuk do të ishin të pajisur me këtë zgjuarsia? Pa asnjë dyshim, një pamundësi e tillë do të sillte si rezultat që feja të mos kuptohej. E në këto kushte, propozimet fetare do të mbeteshin pa kuptim, gjë që do ta bënte të pakuptimtë edhe krijimin e njeriut. Nëse nuk ka ngjarë kështu, kjo i dedikohet pajisjes së Profetëve me një logikë të mrekullueshme. Po, profetët janë diferencuar nga të tjerët me një zgjuarsia që i zgjidh me mjaft lehtësitë gjitha pengesat e Vështirësitë.⁵¹

²⁴⁹.Myslim, Iman, 293; Mysned, 4/401.

ZGJUARSIA E PROFETIT TONE

Periudhën kur jetoi Profeti, le ta mendojmë kështu: nga njëra anë, sahabet, pasuesit profetikë që paraqesin për zgjidhje te i Dërguari i Allahut çështjet juridike që s'kanë mundur t'i zgjidhin vetë e, nga ana tjetër, disa njerëz që kërkojnë të hyjnë në Islam, të cilët presin përgjigje për lëkundjet dhe dyshimet në kokat e tyre. Po t' u shtojmë këtyre edhe lëkundjet dhe dyshimet e prodhuara e të hedhura në treg nga adhuruesit e librave të shenjtë krishterët dhe çifutët që nuk mund ta pranojnë e që e kanë zili të Dërguarin e Allahut, del se përballimi i të gjitha këtyre si dhe dhënia e përgjigjeve të drejta e të qëlluara pyetjeve të bëra, mund të arrihen vetëm e vetëm me logjikën profetike, domethënë me zgjuarsinë profetike.

Veçanërisht, edhe njerëzit të cilëve u drejtohen urdhrat dhe porositë e Profetit, janë të niveleve të ndryshme. Një pjesë e tyre janë shërbyesit dhe funksionarët e fesë. Këta njerëz të zhytur në thellësitë e shpirtit, janë aftësuar nëpër kisha dhe manastire, të paktën, me sa kanë pasur mundësi, në fusha të caktuara. Një pjesë tjetër, të zhytur

plotësisht në çështjet filozofike, janë pothuajse tërësisht njerëz të logjikës dhe gjykimit. Po kështu, mes tyre, edhe kompetentët në fushë të ekonomisë e të tregtisë, komandantët e çmuar të përgatitur në fushën e luftës, gjenitë e mëdhenj politikë. Së fundi, beduinët, niveli kulturor i të cilëve sheh kah zeroja. Të gjithë këta kanë pyetje që presin përgjigje sipas interesave apo nivelit të vet. Në këto kushte, i Dërguari i Allahut duhet të thotë fjalë të tilla dhe duhet të bëjë shpjegime të tilla që çdo njeri, nga beduini e gjer te ai i nivth më të lartë, të mund të marrë prej tyre pjesën që i përket dhe kjo punë, si specifika e një feje universale, të vazhdojë po kështu gjer në kiamet...

Njeriu është një qenie që flet dhe mendon. Me këtë aspekt ai është kah përfaqëson një atribut të Zotit. Nëse mendimet u kalohen bisedave dhe bisedat shkrimit, atëherë përftohet vazhdimësia e tyre. Mendimet që nuk bisedohen e që nuk shkruhen, groposen bashkë me të zotin dhe marrin fund. Ashtu siç mundësia për të menduar është një favor i madh i Zotit për njerëzit, edhe të folurit dhe të shprehurit e mendimit është po ashtu një favor i madh për ta. Është për këtë arsye që Kur'ani, kur

merr të tregojë se ç'është mëshira e Zotit, menjëherë pas pohimit mbi krijimin e njeriut, përmend se njeriu u aftësua "të shprehet" dhe thotë: "Allahu e mësoi njeriun të shprehet." (Kur'ani, Rahman: 4). sth prej Hz. Ademit, njerëzit mendojnë, flasin dhe, po kështu, do të mendojnë e do të flasin gjer në kiamet dhe nuk do të konsumohen as të menduarit, as të folurit e të shprehurit. Edhe kjo është një nga veprat e mëshirës së pafundme të Zotit. Ja, pra, profetët janë të merituarit e kësaj mëshire në kuptimin më të plotë e të përgjithshëm të fjalës si dhe Hz. Muhamedi (s.a.s.), i merituari në nivelin më të lartë midis tyre. Kjo meritë e profetëve dhe Profetit tonë mund të shpjegohet vetëm me zgjuarsinë profetike tek ta. Pa zgjuarsinë profetike është e pamundur të arrihet kjo. Atëherë themi se zgjuarsia profetike është një veçori shumë e rëndësishme e profetëve.

Çdo profet zotëron një fuqi të lartë njohjeje dhe mundësi shprehjeje. Edhe çështjet më komplekse e të ngatërruara, madje, i zgjidh me lehtësinë e ngrënies së mëngjesit. E njëjta lehtësi vihet re edhe kur tregon apo përshkruan. Njerëzit që dëgjojnë fjalën e tij, pandehin se edhe vetë do të mund të

shprehnin një gjë të tillë, mirëpo sapo që t'ia nisin, e shohin se është krejt e pamundur të

flasin si profeti ose të shprehen si ai. Sepse është Allahu që ua ka lehtësuar trajtimin e atyre çështjeve në të vërtetë aq të vështira. Po, njomështia dhe bukuria e lules së ligjërimit e hapur te profetët, kurrë nuk mund të gjendet tek të tjerët!.. Një problem i vënë para profetit, pa diskutim që gjen zgjidhje. Sado e virgjër dhe në çfarëdo niveli të jetë e vështirë ajo çështje, profeti flet rreth saj sikur të kishte një përvojë dyzetvjeçare në atë fushë. Prandaj edhe Bernard Shou ka qenë i detyruar të thotë kështu për të Dërguarin e Allahut: "Në këtë kohë kur problemet e grumbulluara njëra përmbi tjetrën presin zgjidhje, kemi nevojë më tepër se kurrë për Muhamedin që i zgjidhte problemet me lehtësinë e pirjes së një filxhani kafeje..." Ashtu është! Në shekullin tonë ekzistojnë sa e sa probleme ekonomike, shoqërore e politike që presin zgjidhje. Dhe në ditët tona, të gjithë njerëzit, me miq e armiq, ' e kanë kuptuar se, pa iu drejtuar burimit të kulluar të shprehjes së të Dërguarit të Allahut, kurrë nuk do të jetë e mundur zgjidhja e këtyre problemeve.

Janë shumë fjalë të thëna për zgjuarsinë e tij profetike. Sikur të mblidhen bashkë ato, bëhet një libër i vëllimshëm. Duke përcjellë nja dy prej tyre, le të përqipemi t'i vëmë pikën edhe kësaj teme të gjerë. Shkëlqesia e tij Abdullah b. Abbas që ka merituar titujt e juristit e të dijetarit më të madh të bashkësisë islame, thotë: "Më i virtytshmi i njerëzve dhe, gjithashtu, më i mençuri i njerëzve është profeti juaj, Hz. Muhamedi Paqja qoftë mbi Të Edhe Vehb b. Mynebbih, ndër dijetarët e tabiinëve, bashkëkohësve të sahabëve, pasuesve të Profetit, i cili i ka hulumtuar me imtësi Testamentin e Vjetër dhe Ungjillin, e përshkruan me këto fjalë zgjuarsinë profetike të të Dërguarit të Allahut: "Aftësia njohëse e të gjithë njerëzve në raport me aftësinë njohëse dhe zgjuarsinë e të Dërguarit të Allahut është sa një kokërr rërë në shkretëtirë ndaj shkretëtirës..."²⁵⁰ ⁵²

²⁵⁰.Kadi Ijaz,shifra 1/67

Meremetimi i Qabes

1. Njeriu i periudhës së injorancës ishte i biri i intrigës, sikur e vetmja detyrë dhe qëllimi i krijimit të atyre njerëzve të ishte shkaktimi i intrigave! Sapo të bëheshin tre vetë bashkë, pa asnjë diskutim që do të ndiznin ndonjë intrigë. Ja, pra, bashkimi i këtyre lloj njerëzve dhe përgatitja prej tyre e individëve të dimensioneve të mësuesve të të gjitha qytetërimeve, ishte një mrekulli e posaçme e të Dërguarit të Allahut dhe të gjitha këto ai i pati realizuar me anë të zgjuarsisë së tij të dimensioneve qiellore.

Meremetimi i Qabes rastis në një prej viteve që i paraprijnë profetësisë së Profetit tonë. Qabeja që meremetuar dhe vendosja e Haxherul Esvedit, Gurit të Zi, që bërë shkak për përçarje dhe ndarje mes fiseve. Çdokush dëshironte që atij t'i takonte ky nder. Atë radhë Hz. Muhamedi ende nuk ishte zgjedhur

për detyrën e profetësisë. Megjithatë, edhe pse kjo detyrë ende nuk ishte pjalmuar për të dhënë fryte, ekzistonte si një farë në shpirtin e tij. Vetëm një pranverë priste kjo farë që të nxirrte filiza. E, pra, pikërisht këtë radhë, shpatat ishin nxjerrë nga mili, shigjetat ishin tendosur në harqe, një vigjilje zënke përjetohej. Gjendja ishte acaruar aq shumë, sa ishte në prag të një lufte civile e cila, po të mos gjendej një zgjidhje, kushedi sa vite do të zgjaste, humbjen e kushedi sa jetëve e pasurive do të shkaktonte. Njëri mes njerëzve në konflikt bëri, sidoqoftë, një propozim: "Njeriun e parë që do të hyjë nga kjo derë e Qabes, ta caktojmë gqutar dhe të pranojmëç'të thotë ai." Propozimi u pranua. Të gjithë prisnin me kureshtje se kush do të qe njeriu i parë që do të hynte, kur në derë u duk Hz. Muhamedi! "El-Emini po vjen!" thirrën njerëzit dhe ia parashtruan çështjen. I Dërguari i Allahut as nuk u ndal të mendohej, madje. Kërkoi një copë beze të madhe. Ia prunë. E vuri Gurin e Zi në mes të bezes dhe u tha të parëve të fiseve që ta kapnin bezen secili në një cep e ta çonin në vend. Ashtu edhe u veprua. Aty, pastaj, i Dërguari i Allahut e ngriti gurin dhe e vuri në vendin e vet në mur.²⁵¹ Kështu u parandalua një luftë e

madhe. Zgjidhja e një çështjeje të tillë të stërmadhuar e të ngatërruar artificialisht, pa u menduar fare, sapo propozohet, kryerja e një akti pa u menduar dhe me një ndërhyrje të shpejtë, me çfarë mund të shpjegohen veçse me logjikën profetike? Ai nuk ishte ende profet që veprimi i tij të shpjegohet me revelacionin. Megjithatë, këtu kemi të bëjmë, pa diskutim, me një logjikë të porositur dhe me një zgjuarsiri të posaçme për profetët të domosdoshme, këto, për të mbajtur një ngarkesë të tillë si profetësia që ai pati mundur t'i dalë për zot asaj çështjeje. Po, tek ai kishte një logjikë mbi logjikat, një gjykim mbi gjykimet, një aftësi njohëse mbi të tjerat, gjë që, në të vërtetë, ishte kusht për një njeri të cilit do t' i ngarkohej Kur'ani...

Njohja e mirë e bashkëbiseduesit

2. Husajni vjen te i Dërguari i Allahut. Qëllimi, t'i jepte mend këtij. Do ta bindte të Dërguarin e Allahut dhe do të bënte që të hiqte dorë nga kauza e vet. Profeti i të Dy Botëve zotëronte një konstrukt të mrekullueshëm në njohjen e bashkëbiseduesit dhe në përcaktimin e nivelit të tij. Edhe pse nuk mendohej

fare, i drejtohej me të tilla fjalë bashkëbiseduesit, që nëse ju do të ndërronit vendin e disa prej tyre ose do t'i drejtoheshit me po ato shprehje një njeriu

të një karakteri tjetër, do ta ngatërronit çdo gjë e kurrë s'do t'ia arrinit dot synimit. I Dërguari i Allahut ka qenë dhe mbetet pashoq e i pakrahasueshëm edhe në zgjedhjen e fjalëve, edhe në përcaktimin e nivelit dhe gjendjes së bashkëbiseduesit. Është e pamundur të gjendet një individ i dytë që t' i përngjajë atij. Me të tillë shpejtësi e përcaktonte se me kë, në ç'vend dhe në ç'mënyrë do të bisedonte, saqë nuk mendohej qoftë edhe për një çast dhe, çfarëdo që të bisedonte, në përfundim, kuptohej se tërë biseda ishte përbërë nga fjalë që duheshin thënë detyrimisht. Ashtu si në bisedën e tij nuk vihej re ndonjë gjë e pasaktë ose e paqëlluar, po ashtu nuk vihej re edhe ndonjë gjë jo e domosdoshme. Analizoni fjalë për fjalë çdo thënie të tij dhe nuk do të gjeni as edhe një fjalë të tepërt në to. E, në qoftë se kjo nuk është zgjuarsia profetike, ç'mund të jetë tjetër? Shihni, pra, sesi e pati shkrirë Husajnin kjo zgjuarsia. Kur Husajni i pati mbaruar ato që kishte pasur ndërmend të thoshte, i Dërguari i Allahut, pa pakë-suar asgjë prej edukatës dhe pastërtisë morale

të vet, e pati pyetur atë me një shprehje plot edukatë dhe çiltërsi:

-O Husajn, sa zota adhuron ti?

-Adhuroj gjithsej tetë zota: shtatë në tokë e një në qiell.

Zoti i qiellit ishte Allahu, Zoti që ata nuk kishin mundur kurrsesi ta fshinin nga zemrat. Mendimi mbi Allahun ishte një mendim dhe besim aq i rrënjosur nëpër ndërgjegjet, saqë edhe periudha tepër e gjatë e injorancës nuk kishte mundur ta fshinte. Ndërgjegjja nuk gënjen. Mjafton që gjuha të mund ta interpretojë plotësisht e drejt zërin e asaj ndërgjegjeje. Pyetjet e të Dërguarit të Allahut qenë ndjekur nga përgjigjet e Husajnit në këtë mënyrë:

Kur të godet ndonjë e keqe, kujt i lutesh, kujt i përgjëroheSh?

Atij që është në qiell. Kur të shkatërrohet malli e pasuria, kujt i drejtohesh me lutje? Atij që është në qiell.

I Dërguari i Allahut i pati radhitur kështu pyetjet, pas të cilave pati marrë të njëjtën përgjigje. Për çdo gjë Husajni pati thënë se i drejtohej Zotit që ishte në qiell pa ditur se ç'pyetje do të pasonte. Më në fund, i Dërguari i Allahut i pati thënë kështu:

Ai u përgjigjet vetë pyetjeve të tua, kurse ti, pa qenë nevoja, i bën shok Atij! Po çfarë po them unë? Bëhu musliman e shpëto!²⁵²

Në fakt, në këtë bisedë, të gjitha fjalitë janë fare të thjeshta. Vetëm se gjendja dhe niveli i bashkëbiseduesit janë njohur dhe përcaktuar në atë mënyrë, që Husajnit nuk i ka mbetur gjë për të thënë përveç një pohimi të njëjtë. Edhe pas fjalës së fundit të të Dërguarit, të Allahut, bashkëbiseduesit i pati mbetur të thoshte vetëm kaq: "La ilahe illallah, Muhamedu'r-Resulullah", "Nuk ka zot tjetër veç Allahut, Muhamedi është i dërguari i tij!" Me fjalë të tjera, bashkëbiseduesi, ose do të pohonte sa më sipër e do të shpëtonte, ose, i vendosur në kundërshtimin e tij, do të ngrihej e ikte pa thënë qoftë edhe një fjalë! Zgjidhje tjetër s'kishte!⁵³

Biseda sipas bashkëbiseduesit

3. Beduini është një njeri që jeton në shkretëtirë. Shpesh herë i ngordh deveja, i humb gjërat diku ose

²⁵¹.Mysned, 3/425; Ibni Hisham, Sire, 1/209.

e-zë furtuna e rërës e, pastaj, fillon të klithë e të thërrasë. Mendoni, tani, gjendjen shpirtërore të një njeriu të tillë. Ç'do të thoshte ky njeri kur të mbetej ngushtë? Gjithsesi, jo gjë tjetër veç fjalëve që i pati thënë një ditë, kur do të vihej në udhë të drejtë, Hz. Hamzai të Dërguarit të Allahut: "O Muhamed! Kur pata përjetuar errësirën e thellë të natës së shkretëtirës, e pata kuptuar se Allahu është aq i madh, sa të mos mund të shtrëngohet brenda katër mureve!" Po, të njëjtën gjë thoshte çdo njeri që shihte se idhujt që i skalitnin vetë ata me duart e tyre e që i quanin Lat, Uzza, Hubel, etj. nuk vlenin për asgjë, sepse ishte ndërgjegjja ajo që ua thoshte përbrenda me zë të lartë këtë të vërtetë. Dhe ndërgjegjja thoshte të vërtetën. Ja, pra, sa e sa vetë patën shkuar para të Dërguarit të Allahut, në atë qendër të mekanizmave shpirtërore, për pyetjet e tyre prej beduinësh patën gjetur përgjigjet më të bukura e më të përshtatshme ndaj botës së tyre shpirtërore, qenë orientuar kah udha e drejtë dhe qenë bërë secili njëri prej yjeve në qiell.²⁵³

Ahmed b. Hanbel rrëfen duke përcjellë prej Ebu Temimes: "Po rrinim një ditë pranë Profetit. Aty erdhi një beduin dhe e pyeti të Dërguarin e Allahut

drejtpërsëdrejti: "A ti je muhamedi?" Dhe i Dërguari i Allahut iu përgjigj me mjaft butësi: "Po, muhamedi jam!"

-Për çfarë i fton njerëzit? Vazhdoi ta pyesë beduini.

-I ftoj për tek Allahu i lartë e i shenjtë! Vetëm për tek Ai! Për tek Allahu një dhe i vetëm, pa i shoqëruar gjëra të tjera si të barabartë me Të! Allahu është Ai të Cilit ti i lutesh kur të bie në kokë ndonjë e keqe dhe Ai ta largon atë. Vetëm Atij i lutesh ti në kohë zie dhe fatkeqësie. Ai e dërgon shiun dhe e rrit barin. Kur ti humb diçka në mes të shkretëtirës pa anë e pa fund, i hap duart drejt Tij, lutesh e përgjërohesh dhe Ai bën që ta gjesh atë që pate humbur!"

Ç'mrekullll janë këto fjalë të thëna beduinit! Shihni sesi lidhen të gjitha fjalitë me ato gjëra specifike që janë si aorta për njeriun përballë! Ç'do të thotë zi buke ngatërresë, fatkeqësi dhe mjerim në mes të shkretëtirës? Në këto fjali flitet për këto gjëra që beduini njih fort mirë, për Fuqinë e Amshuar që është e vetmja mbështetje në të gjitha këto situata. Në fakt, këto janë edhe kuptimet që lartësohen nga ndërgjegjia e tij, por beduini nuk e ka rrokur ende

kuptimin e atij zëri. E, pra, duket sikur i Dërguari i Allahut, me këto shprehje, s'bënte tjetër veçse i shpjegonte dhe ia mësonte atij kuptimin e atij zëri që i lartësohej përbrenda. Fjalët e thëna patën ndikuar në atë mënyrë mbi beduinin dhe e patën pushtuar, saqë s' i pati mbetur ç 'të thoshte më, veçse këto fjalë.

O i Dërguari i Allahut! Ma jep dorën të të jap besën!²⁵⁴

Pas kësaj, beduini fiton nderin të jetë një ndër sahabet, pasuesit e Profetit.⁵⁴ Gjërat e biseduara janë tepër të thjeshta. Nuk janë bërë lojëra intriguese oratorie me stilin e të shprehurit. Por ka këtu një të vërtetë që është vepruar plotësisht në përshtatje me situatën, si rrjedhojë, edhe beduini është përgjunjur...

Fundja, kujt i është mundësuar në botë përveç Hz. muhamedit (s.a.s.) që të krijojë nga njerëz zemërgurë një popull si engjell? Aq me vend dhe në mënyrë mjeshtërore i pat përdorur ai dinamikat që i pat dhuruar Providenca Hyjnore, saqë transformimi i realizuar prej tij, është një enigmë ende e

²⁵³ .Axhluni, Keshtu'l-Hafa, 1/147.

pakuptueshme për historianët dhe sociologët. Dallgët e krijuara nga margaritarët e hedhur nga i Dërguari i Allahut në detin e jetës shoqërore kanë arritur gjer në brigjet e shekullit të njëzetë duke futur nën ndikimin e tyre edhe këto brigje dhe s'ka dyshim se kjo punë kështu do të vazhdojë gjer në katastrofë...Sot, në të katër anët e botës, vihet re një rrjedhë e pandërprerë drejt Islamit, gjë që s'është tjetër veçse përplasja në brigjet e këtij shekulli i atij dallgëzimi të madh të krijuar nga margaritarët e hedhur nga i Dërguari i Allahut në detin e jetës shoqërore. Fundja, e kujt tjetër mund të jetë kjo tërheqje e shenjtë, forca ndikuese e të cilës ka vazhduar me shekuj? Mos ekziston ndonjë individ tjetër përveç Hz. Muhamedit me të tillë tërheqje, që të jetë e tij? Kurrë, kategorikisht! Ai që është vetë ekzistenca dhe koha, që çdo gjëështë për respekt të syve të tij!..²⁵⁵

²⁵⁴.Mysned, 4/65; 5/64.

Ligjërata para emigrantëve dhe medinasve në Hunejn

4. Mbreti i profetëve, ashtu siç i zgjidhte me mjaft lehtësi problemet më të vështira dhe u jepte rrugë me qetësi dhe mrekullisht shpejt atyre që dukeshin si pa rrugëdalje, ashtu edhe para shumë e shumë ndodhive të papritura e të çastit që do t'i lëkundnin edhe njerëzit më me përvojë, madje do t'i futnin në panik, fillonte të vepronte me shpejtësi pa humbur asgjë nga karakteristika e tij e _ çdokohshme e nga gjakftohtësia, e zgjidhte me të parën atë problem ose grindje dhe e zotëronte gjendjen. Kur të analizohet çdo veprim i tij, çdo hap i hedhur, çdo fjalë e thënë, do të duket se çdo veprim i tij, çdo hap dhe çdo fjalë janë planifikuar me një peshore farmacie e brenda kritereve të rrepta si dhe racionimi kohor i tyre është bërë me një mjeshtëri mjaft të hollë gjer në minuta dhe sekonda. Po qe se do të bëhej fjalë për ndonjë vonesë sekonde ose do të nënvleftësohej qoftë edhe një fjalë e vetme, nuk do të mund të realizohej një sukses i një niveli të tillë. Mirëpo i Dërguari i Allahut nuk e pati matur dhe peshuar këtë veprim të tij dhe as që kishte mundur të

gjente rast të mendohej gjerë e gjatë. Atëherë, me se tjetër do t'i shpjegonit ju ngjarje të tilla veç paisjes së tij me zgjuarsinë e lartë profetike? Po, ai ishte një profet dhe zgjuarsia e tij zgjuarsi profeti ishte. Mendonte si një profet dhe vepronte si një profet, prandaj edhe në asnjë iniciativë të tij nuk vihej re stonaturë. S'bëhet fjalë për stonaturë; sukseset e tij ishin gjithmonë të nivelit më të lartë! E thënë ndryshe, atje ku arrinte ai, ishte e pamundur të arrinte dikush tjetër! Janë qindra ndodhi dhe evenimente që kanë lidhje me këtë specifike, por , ne do të përcjellim këtu atë që na duket më e rëndësishme.

Ndodhia ka marrë udhë pas luftës së Hunejnit. E përcjell Ibni Is'haku. Të njëjtin rrëfim e shohim edhe te Buhariu.

Lufta e Hunejnit pati ndodhur pas triumfit të Mekës. Prenë e shtënë në dorë aty, i Dërguari i Allahut ua pati dhënë njerëzve, zemrat e të cilëve deshte t'i ngrohte ndaj Islamit. Shumica e tyre ishin njerëz të gojës e që u dëgjohej fjala në fise e mes fisesh. Pas triumfit të Mekës ndihej domosdoshmëria e shtrimit të plotë të zemrave të njerëzve të tillë për të siguruar vazhdimësinë e triumfit, ' sepse shumica e

tyre ishin bërë muslimanë pa vullnet. Po qe se akujt e botës së tyre të brendshme nuk do të shkriheshin, me kohë këta mund të bëheshin më të rrezikshëm sesa ç'kishin qenë më parë kur ndodheshin në frontin e mohuesve e të heretikëve. Ia, pra, zgjuarsia e veçantë e Profetit duket qartë edhe në këtë aspekt të çështjes. Atë ditë ndodheshin 6000 robër që duhet të ndaheshin. Numri i deveve ishte 24000, i dhenve e dhive 40000. Ndodheshin edhe 4000 okë ar dhe argjend. Duke i shpërndarë këto, i Dërguari i Allahut qe sjellë sikur kujdesej më shumë për mekasit, shumicën e presë e pati ndarë midis tyre, disa personave u pati dhënë pjesë sikur t'i dallonte ata midis të tjerëve. Këta, siç thamë edhe më sipër, ishin njerëzit, në ngrohjen e zemrave të të cilëve ndaj Islamit ndihej domosdoshmëri dhe dobi e madhe. Për shembull, Ebu Sufjanit dhe familjes së tij i qenë dhënë 300 deve dhe 120 okë argjend; Hakim b. Hizamit, 200 deve; Nusajr b. el-Harisit, 100 deve; Kajs b. Adijit, 100 deve; Safvan b. Umejjes, 100 deve; Huvajtib b. Abdiluzzasë, 100 deve; Akra b. Habisit, 100 deve; Ujejne b. Hisnit, 100 deve dhe Malik b. Avfit, 100 deve. Përveç këtyre, edhe disave

nga paria, sipas gjendjes, u ishin ndarë nga pesëdhjetë ose dyzet deve.²⁵⁵

Ç'qe dhënë, ishte deve, ar, argjend, por ç'kërkohej të ruhej, ishte feja dhe, ç'kërkohej të arrihej me to, ishte ngrohja e zemrave të individëve ndaj Islamit. Triumfi i Mekës ishte realizuar fare pak kohë më parë dhe te disa prej mekasve kishte ndodhur një ndrydhje. Më e pakta, çdo njeriu i ishte thyer nderi, krenaria, sado e vogël. Ndërsa krenaria ishte çdo gjë për mekasin. Ky rast i dhënë nga Providenca Hyjnore, ishte vlerësuar në formën më të mirë nga i Dërguari i Allahut dhe në këtë mënyrë ishin mbështjellë plagët e mundshme. Vetëm se ky lloj përpjestimi kishte shqetësuar pak të rinjtë e ensarëve, siç quheshin medinasit vendas. Madje disa prej tyre patën thënë: "Gjaku i tyre ende pikon nga shpatat tona, prapëseprapë, pjesën më të madhe ata po e marrin!" Dhe kjo ishte fillimi i një intrige. Nuk kishte rëndësi se ishin të pakët ata që flisnin. Po qe se nuk do të ndalej, ajo mund të shndërrohej në një zjarr të papërballeshëm. Io vetëm kaq. Përgjithësisht, kundërshtimi më i vogël ndaj Profetit e nxirrte njeriun nga besimi dhe feja dhe e çonte në

humbjen e përjetshme. Dhe kjo ishte një fatkeqësi më e madhe se ajo tjetra.

Sa'd b. Ubade ia bëri të njohur menjëherë gjendjen Profetit. E vërteta ishte se vetëm të rinjtë flisnin, asnjërit prej të moshuarve nuk i kishte shkuar ndërmend një gjë e tillë. Megjithatë, po të mos parandalohesh, kjo intrigë mund të zmadhohej.

I Dërguari i Allahut urdhëroi që ensarët të mblidheshin menjëherë diku dhe që aty të mos merrte pjesë askush përveç tyre. Ensarët u mblodhën dhe i Dërguari i Allahut u foli kështu:

“O ensarë! Dëgjova se në zemrat tuaja ka lindur një zemërim ndaj meje...”

Një fillim i tillë, nga këndvështrimi i psikologjisë së masës, ishte një hyrje e shkëlqyer. Sepse nisja me një fjalë krejt të papritur për një bashkësi njerëzish, shumica e të cilëve as nuk e dinin shkakun për të cilin ishin mbledhur, ishte si një shpullë e papritur dhe bartte cilësinë për t'i sjellë njerëzit në vete siç edhe i pati sjellë.

Sahabët, vetë, as që mund ta kundërshtonin të Dërguarin e Allahut. Më e shumta, mund t'ju ndrydhej zemra, gjë e cila mund të kapërcehej çdo kohë me një masë profetike dhe kapërcimi i së cilës

kësaj radhe pati nisur, madje, qysh me rrezën e fjalës së parë. Po, kjo fjalë e parë e të Dërguarit të Allahut kishte shkaktuar një veprim të jashtëzakonshëm tek ata me zemër të ndrydhur. Secili prej të pranishmëve e mblodhi veten menjëherë dhe sytë u drejtuan nga Profeti. Fjalët që do të thuheshin pas kësaj, ishin absolutisht shumë të rëndësishme. Çdokush kishte mprehur vëmendjen dhe priste me kureshtje ato që do të thuheshin. Ky sulm i parë i të Dërguarit të Allahut e kishte siguruar dobinë e kërkuar, por duheshin bërë edhe disa lëvizje të tjera një pas një. Por po që se lëvizjet e tjera s'do të ishin të qëlluara, ato mund të sillnin më tepër dëm sesa dobi dhe mund të krijohej një situatë e kundërt me atë që synohej. Nisur nga kjo, kriteri dhe masa që do të përdreshin këtu, ishin shumë të rëndësishëm. Ja dhe lëvizjet e bëra më tej në fjalët e Profetit:

“A nuk ishit në rrugë të shtrembër ju kur erdha unë dhe a nuk ju vuri në rrugë të drejtë Allahu nëpërmjet. meje?”

"A nuk përpëliteshit në skamje e nevojë ju kur erdha unë dhe a nuk ju pasuroi Allahu nëpërmjet meje?"

”A nuk ishit armiq të njëri-tjetrit ju kur erdha unë dhe a nuk jua bashkoi zemrat Allahu nëpërmjet meje?”

Sapo e mbaronte një fjali i Dërguari i Allahut, nga ensarët ngrihej lart një përgjigje e vetme: ”Po, mirënjohja i drejtohet vetëm Allahut dhe të Dërguarit të Tij!”

Profeti ynë e ndërroi ecurinë e fjalës së tij në vendin dhe kohën e duhur. Në këtë etapë, kur ndjenjat morën vlim, ai filloi menjëherë të thotë të tjera gjëra, por këtë radhë në emër të ensarëve. Ai po thoshte tani fjalët që do të mund të thoshin ensarët në rastin më të keq! Nëse një musliman do të fliste kështu para profetit të tij, puna e tij do të kishte marrë fund. Profeti i të Dy Botëve vazhdoi:

”O ensarë! Po të deshit, mund të më jepnit edhe një përgjigje tjetër. Për shembull, mund të më thonit kështu: "Erdhe nga Meka i përgënjeshtuar dhe ne të besuam; erdhe i braktisur dhe ne të dolëm zot; erdhe i përzënë nga vatani yt dhe ne t'i hapëm vatrën tona; erdhe si nevojtar dhe ne t'i plotësuam të gjitha nevojat!" Po qe se do të më përgjigjesht në këtë mënyrë, do të thoshit të drejtën dhe s'do të kishte kush t'ju përgënjeshtronte!

O ensarë! Nëse jeni prekur në zemër pse u dhashë gjëra të kësaj bote ca njerëzve për të cilët desha që të bëheshin muslimanë, a nuk dëshironi ju që të ktheheni në shtëpitë tuaja me të Dërguarin e Allahut ndërsa të tjerët kthehen me dele e me deve? Betohem në Allahun që ka në dorë frymën time, se, sikur të gjithë njerëzit të shkojnë në një drejtim e ensarët në një drejtim tjetër, unë do të shkoja pa u lëkundur fare kah ensarët. Po të mos ndodhte çështja e hixhretit (emigracionit), sa do të desha të isha njëri prej ensarëve! Allahu im! Mbroji ensarët, fëmijët dhe nipërit e tyre!”²⁵⁶

Nuk pati mbetur njeri pa qarë nga këto fjalë! Secili qante dhe mërmëriste me sa mundej: “Ne na mjafton i Dërguari i Allahut. Tjetër gjë nuk duam

Kjo bisedë e shkurtër dhe esenciale e të Dërguarit të Allahut, heshtja në çast e një intrigë të mundshme dhe fitimi edhe një herë më shumë i zemrës së dëgjuesve është një ndodhi e tillë e jashtëzakonshme, shpjegimi i së cilës pandeh se s’mund të gjejë zgjidhje pa iu drejtuar fjalës ”zgjuarsi profetike”...

Analizoni fjalitë një e nga një...Shtoni koherencën e punës... Matni distancën e kapërcyer

në shpirtin e sahabëve midis fjalisë së parë dhe fjalisë së fundit pas pesë a dhjetë rrjeshtash... Shtojuni këtyre veçorive edhe të folurit e improvizuar e të çastit pa i menduar fare sa më sipër dhe pyesni ndërgjegjen tuaj se kush do të jetë një mbret i tillë i fjalës. Themse, gjithsesi, përgjigja që do të merrni, është Muhamedu'r-Resulullah, Muhamedi i Dërguari i Allahut. Në fakt, çdo njeri që nuk e ka dekompozuar ndërgjegjen e vet, mund të dëgjojë në të të njëjtën përgjigje. Mjafton që, duke braktisur kundërshtimin inatçor dhe paramendimin, të mund t'i analizojë ndodhitë më objektivisht.

Tani ne, duke bërë analizën e kësaj bisede të shkurtër, hollësitë e çështjes t'ua lëmë psikologëve dhe sociologëve analistë të ardhshëm. T'ua lëmë ndodhinë ta shpjegojnë dhe analizojnë nga këndvështrimi i vet dhe, në kuptimin e zgjuarsisë profetike të Profetit tonë, t' u përftojnë njerëzve tanë edhe një tjetër dimension njohjeje.

E para, kjo bisedë është bërë vetëm për ensarët, sepse mekasit dhe emigrantët nuk kishin shprehur mendime ose nuk kishin bërë veprime që do të bëheshin shkak për zhvillimin e një bisede të tillë. Për rrjedhojë, një bisedë si kjo nuk ishte e tillë që do

të tërhiqte vëmendjen e tyre në çastin e parë. Nisur nga kjo, prania e tyre mes dëgjuesve do të ndikonte negativisht në përqëndrimin e nevojshëm të ensarëve. Dhe kjo, nga këndvështrimi oratorik, ishte një specifikë shumë e rëndësishme e atij çasti. '

E dyta, mbledhja vetëm e ensarëve i kishte përkëdhelur në sedër ata; të qenët bashkë me të Dërguarin e Allahut pa i marrë edhe të tjerët në këtë mbledhje, kishte shkaktuar tek ata një ndikim pozitiv serioz në aspektin psikologjik.

E treta, midis gjërave që do të bisedoheshin, mund të kishte shprehje që do t' i preknin mekasit dhe emigrantët, si p.s ., ”...ndërsa të tjerët kthehen me dele e deve...”

E katërta, në fund të fjalës ensarët lavdërohen dhe për ta bëhet një lutje. Kjo mund t' i vinte rëndë emigrantit që kishte lënë vendin dhe vatrën e vet e kishte emigruar.

E pesta, origjinali arabisht i kësaj bisede është një model përsosmërie nga oratoria dhe qartësia e shprehjes.

E gjashta, tronditja e dëgjuesve qysh në fjalët e para e zbutja e tyre më pas, diskutimi në emër të tyre

duke i lënë vetëm në rolin e dëgjuesit është një gjetje mahnitëse.

E shtata, të shprehurit me sinqeritetin dhe principialitetin më të lartë larg rregullimit artificial të fjalëve e fjalive, nuk u pati lënë mundësi dëgjuesve për të thënë diçka tjetër, gjë që ishte shumë e rëndësishme për arritjen e rezultatit të dëshiruar.

E teta, edhe shprehja e fjalëve në mënyrë të improvizuar, pa u menduar fare, i përftonte një dimension krejt të veçantë ndikimit të fjalës.

Këto dhe shumë veçanti të tjera që mund të na shkojnë në mendje, tregojnë se si Dërguari i Allahut nuk fliste nga e vetja; në të kundërt, fliste me konceptet e ngarkuara plot revelacion dhe frymëzim të zgjuarsisë së dhuruar atij dhe ashtu i zgjidhte problemet.⁵⁶

PROFETI YNE DHE FJALA

²⁵⁴ Shih Ibni Hisham, Sire, 4/135, 136.

²⁵⁶ Buhari, Menakibu'l-Ensar, 1, 2; Myslim, Zekat, 132-141.

Një dimension i veçantë, gjithashtu, i zgjuarsisë profetike të të Dërguarit të Allahut zbulohet te lakonizmi dhe shumëkuptimshmëria e fjalëve dhe shprehjeve të tij.

Po, ai ishte një mbret i fjalës. E si të mos ishte kur Zoti e kishte dërguar atë si interpret të fjalës së Vet?

Gjer më sot ka ndodhur që të thuhet shumë e shumë fjalë të bukura nga njerëz të ndryshëm sipas nivelit të tyre dhe aftësisë për t'u shprehur në një masë të caktuar, kurse në fjalët e të Bukurit të të Bukurve ka një thellësi tjetër, një shije tjetër, një ëmbëlsi tjetër.

Shprehja e tij ishte aq e ëmbël, pohimet e tij ishin aq magjepsëse, saqë, kur ai fliste, vështrimet tjetërsoheshin, zemrat dukej sikur do të ndalonin, mendja dhe gjykimi dorëzonin armët, ndjesitë njerëzore ringjallehin dhe shpirtrat merrnin krahë. Allahu i kishte dhuruar një forcë të tillë gjuhës së tij, që ata që ia arrinin fatmirësisë për ta dëgjuar, nga impresionimi i ndodhjes në prani të Mbretit të Fjalës me pohimet më rrënjësore e me shprehjet më të goditura, sikur u merrej gjuha dhe magjepseshin; kurdo që të fillonin të derdheshin nga buzët e tij

margaritarët e urtësive, fjala e kompetentëve të mendjes dhe gjykimit paralizojë; kurdo që të vihej ai për të treguar se ç'është e mira, e bukura dhe e drejta, shpirtrat e dëgjuesve i mbështillte sherbeti i gojës së tij; kurdo që të godiste të këqiat me zjarrin e fjalëve të tij, herezia dhe ndalimet mbyteshin në shëmtitë e veta; sidomos kur parashtronte me forcë para auditorit dokumente, prova dhe argumente në emër të kauzës së tij, u vinte zinxhirët gjuhëve të të gjitha shpirtrave të errësirës dhe i shpartallonte errësirat.

Ai ishte i vetëdijshëm për të gjitha meritat që i ishin falur dhe e shihte të domosdoshme e me vend t'i bënte të ditura ato duke e konsideruar këtë si shpallje e të mirave, bekimeve e favoreve hyjnore me synimin për të shprehur falënderimin për to. Ai thoshte: "Unë jam Muhamedi, profeti i përgjithshëm. Pas meje s'do të ketë profet tjetër! Unë jam dalluar nga të tjerët dhe privilegjuar me fjalën e parë, të fundit dhe me fjalën e pakët e me kuptim të gjerë".²⁵⁷ Kurse me deklaratat dritë-rrezatuese, si "Unë jam nderuar me të drejtën për të thënë fjalën e fundit si fjalën më kuptimplote e që do t'u japë shpjegim e zgjidhje të gjitha çështjeve",²⁵⁸ shpallte

se ishte Ligjëruesi i Famshëm i së shkuarës dhe i së ardhmes.

Me të Vërtetë, ai Zotëria i Zotërinjve, me frymëmarrjet ringjallëse të tij ishte një bilbil që u kompozonte ilahi' trëndafilave të lulishtes së Zotit, i tillë, që, kurdo që të këndonte, për ndjenjat këndonte dhe thurte meloditë më magjepsëse të gjuhës së ndjenjave. Ato fjalë të njoma ndër më të njomat, të filizuara në fidanet e njoma të kopshtit të tij, nuk u përngjanin sytheve të hapura në pranverën e tjetërkujt, luleve të zgjuara ndaj diellit të mëngjesit të tjetërkujt. Në sofrën e fjalëve të tij, çdo gjë ishte krejt e re dhe e porsakrijuar, ishte një rikrijim pranveror, si një gonxhe e porsambuluar nga vesa. Dhe në këtë rikrijim pranveror, njohja dhe shijimi i të gjitha begative në tërë thellësinë e tyre, po ashtu edhe përjetimi i kënaqësisë më të madhe prej asaj njohjeje dhe shijimi, u patën rënë në pjesë vetëm fatlumëve të asaj sofre gostie e muhabeti.⁵⁷

²⁵⁷.Kenzu'l-Ummal, 11/412.

²⁵⁸ Kenzu'l-Ummal, 11/425.

Ai Mbreti i Shprehjes, prej diamantit të fjalëve bëri një të tillë këllëç, që, me një ta rrotulluar mbi kokat, të gjitha deklaratat e gënjeshtërtë e plehërishte ikën, u strehuan e u fshehën në furriqet e lakuriqëve të natës dhe të gjitha përrallat u mblodhën diku te Mali i Përrallave.“

Ai bëri që prej fjalëve të rridhnin çezme të tilla që të katër anët e shkretëtirës së injorancës u kthyen menjëherë në bahçe xheneti. Ai krijoi prej fjalëve ujëvara të tilla që të gjitha zemrat e hapura ndaj besimit e gjetën papritmas veten brenda atyre ujëvarave që rridhnin në oqeanin e amshimit.

Fjalët e tij ishin prej burimeve të universeve të përtejme... Po të mos qenë fjalët e tij që ndriçonin me anë të fitilit të revelacionit, njerëzimi do të mbetej e do të merrte fund në kaos. Ai e bëri copëcopë me këllëçin e fjalëve perden që kish mbuluar fytyrën e natyrës dhe prapë, librin e sheriatit me qëndismat e fjalëve e zbukuroi. Fjala, një velenxë e çmueshme e hedhur mbi vithet e atit të tij, një shigjetë me bisht fijesh të arta në shigjetoren e tij. Kudo që shkoi, ai mbushi plot xhevahirë prehrin e atyre që kuptonin ç’është fjala dhe, me shigjetën të tendosur e kalëroi atin nëpër errësira. Kur Allahu

dëshiroi të ngrinte për të fundit herë një shtet botëror të fjalës, në krye të shtetit atë Mbretin e fjalës e sollti dhe në dorën e tij e la fjalën dhe vulën e Tij.

Të gjithë burrat e fjalës të së shkuarës e të së ardhmes, të hapur ndaj universeve të përtejme, ishin individë të korit që himnizonte Fronin e Shfaqjes Hyjnore. Ai u bë dirigjenti i atij kori. Profetët dhe të urtët venin e vinin duke formuar një rreth zikri,' kurse ai erdhi

Kemi përdorur këtu fjalën e origjinalit muhabet, që do të thotë jo vetëm bisedë, si në shqip, por, më shumë, afërsi, konfidencë, intimitet, dashuri. me detyrën e zërit të parë" të atij rrethi njerëzish të shenjtë e të bekuar. Ai erdhi dhe gjëmoi qiell e dhe me atë zë tingëllues! Çdo ushqim i sofrës qiellore i dhënë njerëzimit pajisur dhe zbukuruar me fjalët e tij, ishin fruta origjinale nga retorika e hollë e mrekullueshme, të marra nga pikat më intime të kopshtit të miqësisë hyjnore e të ofruara atij të mbuluara, pa iu hapur askujt. Para tij as i kishte parë kush ato fruta, as dhe me dorë i kishte prekur...

Sidomos kur hapte krahët pëllumbi i frymëzimit i këtij Bilbili të Famshëm që u këndonte me meloditë

më të ëmbla trëndafilave më të zgjedhur të lulishteve më intime, të gjitha gjuhët pushonin, ndjenjat mbanin vesh dhe shpirtrat ngazëlloheshin e dilnin nga vetvetja përballë burimit zemzem të fjalëve të tij.

Po, në çdo dallgëzim, fjalët e tij ishin si dete me brigjet të zbukuruara me margaritarë, si ujëvara që derdhen nga lartësitë duke u shtënë drithërimën shpirtrave dhe si shatërvan që shpërthen nga thellësitë...

Gjer më tani qindra letrarë dhe analistë u vërtitën rreth minierës së fjalëve të tij, mijëra e mijëra mendimtarë iu drejtuan atij burimit jetësor të tij dhe gjithë ata gjigantë të mendimit konsumuan jetën e tyre për të rrokur e konceptuar thellësitë e tij, por ai gjithmonë përtej pikave të arritura mbeti. Pandeh se do të ishte me vend që, duke u bërë një rregullim të vogël fjalëve të thëna mbi Kur'anin nga një poeti ynë në poezinë e tij, të thoshim kështu:

Copë e çikë u bënë mendimet, idetë e gjithësisë, Porjj'ala profetike tingëllon ende n'akordin e delirësisë...

Ashtu siç pika nuk mund ta shprehë detin të tërë, ashtu siç molekula nuk mund t'i tregojë të gjitha

veçoritë e diellit, edhe dijetarët, të urtët e shenjtorët që konsiderohen nga një copë e së vërtetës, edhe

nëse do të ishin të përsosur në raport me dikë tjetër, nuk mundën ta përfaqësojnë atë plotësisht dhe nuk mund ta reflektojnë atë identikisht.

I Dërguari i Allahut që një prijës i përsosur që s'kishte parë shkollë e mësim. Me konstruktin e shëndoshë morale-material, me kthjelltësinë e ndjenjave, me qëndrueshmërinë e mendimeve dhe me gjerësinë e ndërgjegjes të hapur ndaj tërësisë së kuptimeve, që krijuar me një natyrë kapacitive e të aftë për t'i marrë siç qenë mesazhet e Zotit e për t'ua transmetuar njerëzve në origjinalitetin e tyre, i qenë ruajtur identiteti dhe dëlirësia shpirtërore, pat mbetur . mbyllur ndaj ndikimit të mësimit dhe edukimit njerëzor, ndaj ndikimit të sistemeve njerëzore të mësimit dhe edukimit dhe pastaj, i pajisur me revelacion, i që dërguar njerëzimit. Prandaj edhe themi se ai që një prijës e mësues mrekullisht i përsosur që " s'kishte parë shkollë e mësim.

Natyra dhe karakteri i tij, ndjenjat e jashtme e të brendshme, mendja dhe gjykimi ishin të lidhura reciprokisht me detyrën e tij profetike gjer në atë

shkallë, saqë çdo mesazh i ardhur nga e Vërteta, çdo frymëzim kristalizohej nëpër cilësinë dritëdhënëse të atij prizmit prej drite dhe, pastaj, duke u përforcuar gjer në lartësinë e valës së revelacionit, ia arrinte synimit të tij.

Ky mesazh hyjnor i të gjitha formave që, duke shpërthyer e rrjedhur nga burimi më i pastër, zbrazej në zemrën më të pastër ndër të pastrat dhe, pastaj, trajtësohej në tingull të përshtatshëm për përceptimin njerëzor me anë të një gjuhës më delikate, më të pastër e më të komunikueshme, ashtu siç ishte shenjë e profetësisë së tij dhe argument i misionit të tij profetik, ishte edhe ushqimi, feneri dhe ati i tij në ato rrugë të vështira e të ngatërruara, dokumenti dhe prova para armiqve. Duke u parashtruar bashkëbiseduesve mesazhet e Zotit, njëkohësisht ai demonstronte profetësinë dhe shpallte përfaqësimin e tij. Po ashtu, siç përdorte thesaret prej margaritarësh enigmatikë e të magjishëm të revelacionit për të ndihmuar bashkëbiseduesit në kapërcimin e pengesave e vështirësive e për të plotësuar nevojat e tyre, edhe në mposhtjen dhe heshtjen e armiqve të njëjtën shpatë prej diamanti përdorte. '

Kur'ani për të ishte gjithçka: ishte ajër, ujë, armë, mburojë, kala, bedena dhe flamur që valëvitej mbi bedena. Me Kur'anin merrte frymë ai, me të ngjitej si retë në qiej, me të u shkonte në ndihmë qenieve në tokë në trajtën e shiut të mëshirës, me të luftonte kundër dhunës e padrejtësisë, me të mbrohej prej ngatërresave e ngatërrestarëve, me të bubullonte e me të bëhej dritë e reshonte në të gjitha anët. '

Vetëm se pranë atij Mbretit të Fjalës, gjuhës së shtruar të urtësisë, pranë atij thesarit të diturisë hyjnore që kurrë s'di të konsumohet e të mbarojë, kishte shumë pyetje që i drejtoheshin, shumë pengesa e vështirësi që duheshin kapërcyer e zgjidhur, shumë çështje fetare, shoqërore, politike të lidhura me ummetin, bashkësinë që, duke iu dhënë përgjigje me anë të gjuhës së pastër dhe zemrës së bardhë Muhamediane të konsideruara si pasqyra vezulluese e diturisë së amshuar dhe vendzbritja, stacioni, qendra, korija e të ardhurave të larta e sublime, i zgjidhte vështirësitë, i sqaronte gjërat e pakuptueshme dhe, duke i regjistruar shumë e shumë urdhra absolute të ardhura me Kur'anin, duke i emërtuar ato, duke e përgjithësuar të veçantën si dhe duke e detajuar të përgjithshmen, krahas mesazhit të

Kur'anit, tërhiqte vëmendjen mbi elementët themelorë të pohimeve e shprehjeve të veta. Fundja as që mund të mendohet të jetë ndryshe një kumtues, një prijës, një reformues e një novator që, me profetësinë e tij universale ka për bashkëbisedues gjithë njerëzimin dhe bashkëbisedon me të gjithë “njerëzit.

Në periudhën kur Profeti ynë (s.a.s.) u zgjodh për detyrën e profetësisë, ”malli më i vlefshëm në tregtinë shëtitëse” për bashkëbiseduesit e parë të tij ishin ligjërimi i qartë dhe oratoria. Në periudhat e mëvonshme, kur ai komb i zgjuar poetësh e letrarësh pati dominuar botën me epërsitë e veta të zgjuarsisë, fjalës e shprehjes dhe e pati futur njerëzimin nën sundimin e vet, ai përfaqësuesi i ndritshëm e i bekuar i mesazhit hyjnor vazhdimisht qe kujtuar me mahnitje e qe vlerësuar qoftë për revelacionin kuranor, qoftë për elementët jashtë tij si mesazhin, orientimin, ligjërimin, oratorinë, porosinë, etj. Edhe ai pati bërë që ta dëgjojnë, ta pranojnë dhe kurrë s’që kritikuar prej tyre. Po qe se do të ish bërë edhe kritika më e vogël ose kundërshtimi më i parëndësishëm ndaj fjalës, shprehjes dhe mendimeve

të tij, armiqtë e tij të të gjitha kohërave gjer tek këta të sotmit do ta vlerësonin një gjë të tillë, do ta zbukuronin e do ta bënë tërheqëse, do ta hiperbolizonin dhe do të dëshironin të shkaktonin zhurmë e rrëmujë duke e përhapur atë në të katër anët e botës. Do të dëshironin, sepse një situatë dhe një rast i tillë do të ishte diçka që do ta kërkonin dhe nuk do ta gjenin dot ata që, për ta tronditur atë, për ta shembur, për ta rrëzuar nga epiqendra e vështimit e për ta shkatërruar, e qanin legal e të justifikueshëm çdo lloj preteksti gjer te shpifjet më të turpshme. Kurse për forcën e fjalës dhe shprehjes së tij nuk ishte thënë as edhe aq sa ç'kishte thënë Faraoni për Hz. Musain dhe as që mund të thuhej...

Ai kishte një frymëmarrje e një zë të tillë kumbues që edhe miku, edhe armiku ndjenin mahnitje dhe para asaj shprehjeje mbinjerëzore përkuleshin më dysh.

Qindra mjeshtër të fjalës midis sahabëve, pasuesve profetikë, si Hz. Lebid, Hansa, Ka'b, Hasan dhe Ibni Revaha, qindra hatibë, juristë dhe burra të urtësisë si Hz. Ebu Bekr, Omer, Ali, Muavije, Amr b. As dhe Ibni Abbas e patën pranuar si mjeshtër, prijës e udhëzues pothuajse në çdo çështje. Po ashtu, në

shekujt e mëvonshëm, hafizët dhe komentuesit gjigantë të hadithit, imamët gjenialë analistë të tefsirit, juristët e pashembullt të krijimit të legjislacionit Islam, novatorët e pashoq që kapërcejnë epokat e fesë, mijëra shenjtorë, të urtë, individë të përsosur të klimës moraloshpirtërore, dijetarët e mëdhenj të logjikës dhe gjykimit në teologji dhe të shkencave pozitive i patën njohur margaritarët e shprehjes si deti të tij gjithmonë si burimin më të begatë, më të kthjelltë e që s'të gënjen kurrë, i janë drejtuar atij, janë mbështetur tek ai dhe, duke plotësuar urinë dhe etjen në atë sofër qiellore, kanë arritur ngopjen e kënaqësinë.

Po, sunneti, tradita e tij, dje e sot qe bërë e vazhdon të jetë burimi më i pagabueshëm i juristëve krijues, krahu më i fuqishëm i atyre që fluturojnë në qiellin e marifetit, intuitës, me anë të së cilës e ndjen Zotin, burimi më i kthjellët i shkencëtarëve si dhe burimi dritësor i ushqimit të të urtëve e shenjtorëve. Dituritë e ndryshme të sheriatit rrugët e shumëllojshme të misticizmit, esenca dhe tërësia e shkencave subjektive e objektive gjithë prej margaritarit të fjalëve dritëdhënëse të tij kanë shpërthyer e dalë.

Shumë çështje, nga fillimi e gjer në mbarimin e qenies, nga krijimi i njeriut e gjer në përfundimin e tij në xhenet apo xhehenem, nga zgjimi i ndërgjegjeve ndaj intuitës hyjnore e gjer te vëzhgimi prej tyre në botën tjetër i Bukurisë Hyjnore, nga besimi dhe bindja gjer te hollësitë e adhurimit, çdo tematikë dhe çdo çështje i ka trajtuar aq përsosmërisht dhe me gjuhën dhe trajtën specifike për secilën tematikë dhe çështje, saqë, po të përjashtonim Kur'anin, do të ishte e pamundur të thonim se gjendet ndonjë tjetër shprehje që të jetë ekuivalente me shprehjen e tij.

Ai i përshkruan Allahun me individualitetin, atributet dhe emrat e Tij brenda një drejtpeshimi të përsosur, madje edhe me kujdesin dhe delikatesën që kërkon subjekti; i përshkruan kiametin, ringjalljen, grumbullimin e shpërndarjen e njerëzimit, llogaridhënien, xhenetin dhe Xhehenemin brenda një drithërime që bërtet me shpresë dhe një tmerri që transformohet në kënaqësi; i përshkruan engjëjt, shpirtin, xhindët dhe shejtanin pas fshehtësisë së të panjohurës dhe pas një kristali të avullt; i përshkruan besimin, veprimin dhe principialitetin në veprime në trajtën e dhuntive të farës, e fuqisë mbirëse të tokës, e cilësisë jetëdhënëse të shiut dhe e frymëmarrjes

mes ngjyrash të pranverës, të gjitha këto përshekime i bën në atë mënyrë, saqë njeriu, duke soditur ato tablo të mrekullueshme të vizatuara prej tij, i duket sikur po sheh sesi u përgatitën natyrat e pastra për t'u rritur e zhvilluar me besimin, si hodhën shtat e u përhapën me Islamin, si u shndërruan me anë të sinqeritetit dhe principialitetit në një pemë xheneti.

Namazi në shprehjet dhe pohimet e tij; abdesti me të cilin ulet e ngrihet, shok për njeriun të cilit ia eleminon vetminë dhe ia ndriçon rrugën me dritat e veta; ezani që qarkullon nëpër damarët e njeriut si gjaku dhe jeta, që rrjedh si lumë para derës së shtëpisë së tij, që rrjedh dhe mbledh përpara çdo lloj ndryshku e papastërtie; zeqati dhe sadakaja që hedhin shtat si selvitë e lëkundën e, duke uturitur, i trembin shejtanët, që, si begati e rehati, ua mbështjellin shpirtat e atyre që shkojnë në namaz; agjërimi që, krejt si një urë, i bashkon masat njerëzore të shkëputura njëra prej tjetrës, që i ngjit copat Si një saldaturë e shëndoshë; haxhi që mbron si mburoja të zotin, që, për ta ndihmuar atë të hyjë në xhenet, shndërrohet në një portë të fshehtë në muret e tij dhe, si një saki me poçen e verës në dorë, i ofron atij të mirat e xhenetit; xhihadi që i arnon të

grisurat si një rrobaqepës, që i pastron njollat si një larës kufomash, që i bën bashkë të gjithë besimtarët si një kuvend konsultimi; zikri dhe lutja që mbyllin rrugët që shpien për në xhehenem duke u vënë gjoksin si një theror, që si nëpunës pritjeje, hapin rrugët e xhenetit dhe u thonë njerëzve ”mirë se erdhët!” dhe që, si një baba i dhembshur, kundërshtuesit dhe inatçinjtë i lidhin me zinxhirë e i zvarrisin drejt parajsave; zbatimi i urdhrave dhe respektimi i ndalimeve që, si një mjet ndërlidhjeje, i lidhin e i takojnë e i vënë të bisedojnë me njëritjetrin Krijuesin me krijesën; marrëdhënia dhe mirëkuptimi farefisnor që, si një polic trafiku, si një rojë dere, zë kryet e udhës e vendin para portës e rregullon vajtje-ardhjet dhe hyrje-daljet; të gjitha këto, pra, në shprehjet dhe pohimet e tij, shndërrohen, secila më vete, në një motiv të gjallë që, si një nënë, hapin prehrin e presin, që bëjnë gqu me njerëzit dhe ftojnë për gjykim, që bisedojnë me ta e premtojnë, që i kërcënojnë ata nga frika se mos rrëshqasin nga udha, që i kapin për jake e i shkundin mirë e mirë; shndërrohen kështu dhe pothuajse i magjepsin dëgjuesit.

Po, përshkrimi i të gjitha këtyre specifikave prej tij sikur të qëndiste një copë, veçoritë e mjeteve të përdorura në përshkrim, forca e lëvizjes, shenjimit, vizatimit dhe melodisë në shprehjen e tij, përdorimi me vend dhe pa u sforcuar i të gjithë elementëve të artit letrar, të gjitha këto veç e veç janë. tema që do të deshin nga një vëllim më vete. Nisur nga kjo konsideratë, lidhur me tema të ndryshme, duke ua lënë hulumtuesve shkencorë të së ardhmes fjalët dhe shprehjet e ndryshme të tij që kërkojnë analiza të ndryshme, dotë merremi këtu e poshtë vetëm me shënimin e disa thënieve të bekuara të tij që i di gjithkush, e thellësisë kuptimore të tyre, forcës dhe soliditetit i të shprehjes.

ANALIZA E NJË TUFË HADËTHESH

Veçoria më e shquar e të gjitha thënieve të Profetit tonë është se ai është shprehur në mënyrën

më përgjithësuese lidhur me çështjen apo temën në diskutim. Në këtë kuptim, ekzistojnë mijëra shembuj që do të ilustronin dhe konkretizonin thënien tonë. Por ne do të përcjellim nga këto vetëm disa, ato që çdokush, në çdo periudhë i ka quajtur “Xhevamiul kelim”, ”Fjalët lakonike”. Megjithatë, përsëri më duhet të them me këmbëngulje se jo vetëm këto, por të gjitha fjalët e Profetit tonë të tilla janë. Ia disa prej tyre.

1. Disa fjalë që përbëjnë kulm në tevhid (unitet) ,

Tirmidhiu rrëfen prej Ibni Abbasit: “O djalosh! Dua të të mësoj disa fjalë: Mbroji të drejtat e Allahut që edhe Ai të të mbrojë ty! Shih nga Allahu që ta gjesh para vetes! Kur të kërkosh, kërko nga Allahu! Po qe se do të të duhet të kërkosh ndihmë, prapë nga Allahu kërko dhe dije se edhe sikur të gjithë njerëzit të mblidhen e të përpiqen që të përfitosh diçka, nuk mund të arrijnë gjë tjetër veçse atë që ka shkruar Allahu për ty! Po edhe sikur të gjithë njerëzit të mblidhen e të përpiqen për të të shkaktuar ndonjë dëm, nuk mund të të shkaktojnë dëm as sa grimca

me përjashtim të asaj që ka shkruar Allahu për ty! Më në fund, kalemët u hoqën dhe shkrimet u thanë!
”259

Ja, pra, në këto pak rrjeshta janë futur çështjet më të komplikuarat e më të vështira mbi kaderin, paracaktimin hyjnor dhe bindjen e nënshtimit dhe kjo temë e thellë është sqaruar plotësisht me stilin më të thjeshtë. Në të njëjtën kohë, në këto pak fjali janë përmbledhur shumë gjëra që do të mund të thuheshin në emër të aksionit dhe veprimit duke përfshirë edhe kuptimin e adhurimit.⁵⁸

²⁵⁹ .Tirmidhi, Kijame, 59.

2. Njeriu eshte një udhetar

Prapë Tirmidhiu rrëfen, por prej Ibni Omerit: "Jeto si i vetëm në botë. Ose hiqe veten si një udhëtar. Quaje se je ndër të varrosurit ende pa vdekur!.269

Ja një thënie prej tri fjalish. Më koncizja e më kuptimplotja prej fjalëve që mund të thuhet mbi adhurimin dhe pastërtinë moraloshpirtërore lidhur me sigurimin dhe mbrojtjen e drejtpeshimit midis kësaj bote dhe botës së pasme. Po të ketë ndonjë shprehje më koncize se kjo, pa asnjë dyshim se edhe ajo Atij i përket. Për këtë askush të mos ketë dyshim!

Fundja, njeriu i vetëm është në këtë botë! Sipas shprehjes së Mevlanait,' njeriu është një fyell i prerë nga kallamishtja. Prandaj edhe rënkon paprerë, sepse është ndarë dhe larguar nga i zotii vërtetë i tij. Rënkimi i njeriut vazhdon gjatë gjithë jetës.

Njeriu është një udhëtar. Udhëtimi i tij fillon nga bota e shpirtave, kalon nga barku i nënës në këtë botë, në periudhën e fëminisë, të rinisë, të pleqërisë, në varr dhe, së fundi, mbaron në xhenet ose xhehenem. Mirëpo, sa është, vallë, i ndërgjegjshëm njeriu për një realitet të tillë? Po që se do ta shihte vazhdimisht veten si një udhëtar, do ta vazhdonte

udhëtimin pa e sforcuar ecjen e do të ecte para pa u shmangur nëse nuk do të kapej pas bukurive të ndryshme të kësaj bote që nuk do t'i vlenin për gjë tjetër veçse për ta lëkundur dhe shmangur.

Pasi që njeriu të mos e konsiderojë veten ndër të vdekurit, domethënë pa ia atribuar atë specifike që të vjetrit tanë përpiqeshin ta shpjegonin me devizën "Vdisni pa vdekur ende",²⁶¹ veprimit dhe jetesës, mbrojtja e plotë dhe shpëtimi nga intrigat e djallit janë të pamundura. Ashtu është! Njeriu duhet të vdesë në egon dhe aspektin material të tij në mënyrë që të jetë i gjallë në aspektin shpirtëror dhe ndërgjegjësor. ''

Fundja, ata që e lidhin çdo gjë me trupin-kufomë, a nuk janë ata të mjerët që mbeten dhe shtypen nën peshën e kufomave të veta?⁵⁹

²⁶⁰.Tirmidhi, Zuhd, 25.

*Mevlana, atributi i poetit të shquar persian xhelaledin Rumi (1207-1273).

3. Përfundimet e fjalës së drejtë e të fjalës së gënjeshtërt

Buhariu, Myslimi dhe Ebu Davudi përcjellin nga Abdullah b. Mesudi: "Juve ju ka hije fjala e drejtë. E drejta e tërheq njeriun kah e mira, kurse e mira e tërheq kah xheneti dhe atje e çon. Nëse njeriu drejtohet një herë kah e drejta dhe vihet në atë rrugë, gjithmonë të drejtën thotë, atë e kërkon. E kështu, njeriu, në lartësinë e Allahut shkruhet si "I Drejtë".

Ruhuni nga gënjeshtria. Gënjeshtria e çon njeriun në imoralitet, në llum dhe ato në xhehenem. Sapo që njeriu ta lëshojë veten një herë në gënjeshtërt, gjithmonë do të gënjejë pastaj dhe, si përfundim, te Allahu do të shkruhet si "Gënjeshtar".²⁶²

Drejtësia është shenjë e profetëve, kurse gënjeshtria, atribut i heretikëve dhe hipokritëve. Drejtësia, një parim i rëndësishëm që rrok të sotmen e të nesërmen; gënjeshtria, një njollë e zezë mbi fytyrën e kohës. Nuk mund të tregohet qoftë edhe një individ i vetëm që të ketë jetuar i lumtur në klimën e gënjeshtres, kurse në rrugën e ndritshme të së drejtës që zgjatet e shkon në drejtim të lumturisë së amshuar, nuk takohet qoftë edhe një individ i

vetëm që të ketë pësuar humbjen e kësaj bote e të amshimit.

Gënjeshtria është parimi më i rëndësishëm i mohimit dhe herezisë, treguesi më i shquar i hipokrizisë, emërtimi i pretendimit të kundërt për njohjen e Zotit. Veçanërisht në ditët tona, gënjeshtria është një sëmundje shoqërore që e ka rrënuar moralin tërësisht, që e ka shndërruar botën në një gur mulliri të gënjeshtarëve, pra, aq e frikshme, sa që asnjë komb që i ka hapur asaj portat e jetës duke i njohur të drejtën e qarkullimit të lirë nëpër atdheun e vet, shtëpitë e veta, në treg, në parlament e në ushtri, në të gjithë jetën e vendit, nuk ka pasur fund të mirë dhe nuk mund të ketë. Në mënyrë diametralisht të kundërt me këtë, e drejta është parimi më i rëndësishëm i Islamit, specifika më e shquar e besimit, guri themeltar i moralit Muhamedian, karakteristika më dalluese e të urtëve e shenjtoreve, boshti i vetëm i përparimit materialoshpirtëror.

Njëra është atributi i engjëjve, tjetra është atributi i djajve; njëra, e robërve të përsosur të Zotit, tjetra, e shpirtave të ulët; njëra, e Krenarisë së Njerëzimit Paqja e Zotit qoftë mbi Të tjetra, e falsifikatorëve.’

Edhe stacionet e fundit të këtyre dy rrugëve, relativisht të gjata a të shkurtëra, të ndritshme a të mjegullta, të sigurta a të rrezikshme janë veç e veç, xheneti dhe xhehenemi. Në një rrugë, në çdo etapë, një përparim, një shpërblim i veçantë; më në fund ajo finalizohet me xhenetin ku arrin udhëtari. Kurse në rrugën tjetër, pas dezavantazheve dhe cungimeve gjatë gjithë gjatësisë së saj, finalja është disfata dhe humbja e amshuar.⁶⁰

Këtë hadith e patëm përmendur kur folëm për drejtësinë e Hz. Muhamedit (s.a.s.). Vetëm se specifika mbi të cilën deshëm të përqëndrohemi këtu, janë përfundimet e fjalës së drejtë në këtë dhe në tjetrën botë. Pohimi i të këqiave që i sjell gënjeshtër jetës personale e shoqërore me fjali kaq të shkurtra dhe esenciale, është një arritje që i përket Profetit tonë. Njeriu që do ta analizonte vetëm këtë hadith, do ta kuptonte përfundimisht se parashtrimi i çështjeve të tilla kaq të gjata e kaq të ngarkuara në

²⁶¹ .Shih Axhluni, Keshfu'l-Hafa, 2/291.

²⁶² .Buhari, Edeb, 69; Myslim, Birr, 105; Ebu Davud, Edeb, 80.

mënyrë kaq të shkurtër dhe tërheqëse, është një cilësi dhe meritë vetëm e të Dërguarit të Allahut. Është e pamundur që dikush tjetër t'i shprehë këto çështje në këtë mënyrë!

4. Njeriu rri me atë që do

Buhariu dhe Myslimi përcjellin këtë hadith, porosi profetike, përsëri sipas rrëfimit të Abdullah b. Mes'udit: "Njeriu rri me atë që do!"²⁶³

Po qe se do të merrej ky hadith, të shpjegohej e interpretohej, do të bëhej, të paktën, një libër. Ky hadith që i ofron një gotë ujë parajse, madje vetë jetën të mbeturit në rrugë, atij që s'ka mundur ta ndjekë udhërrëfyesin e vet, sa e sa zemërthyerve që 's'kanë mundur t'i bëjnë denjësisht ato që kanë dashur të bëjnë, vë gishtin në faktin se njeriu për herë do të jetë bashkë me njerëzit që do, në cilindo skaj qoftë, pozitiv apo negativ. Edhe këtu, edhe atje, njeriu është vazhdimisht me ata që do. Atëherë, ai që kërkon të jetë bashkë me profetët, njerëzit besnikë e të drejtë dhe dëshmorët, më parë duhet t' i dojë ata që pastaj të mund të bëhet bashkë me ta. Ose, e thënë ndryshe, njerëzit që në jetën e pasme do të jenë bashkë me profetët, dëshmorët, të drejtët e

besnikët, janë njerëzit që, qysh në këtë jetë, i duan ata dhe bartin karakteristikat dhe atributet e tyre. Kuptimi dhe konkluzioni i hadithit vlejnë edhe për njerëzit që përfaqësojnë të keqen. Ja, pra, hadithi prej një fjalie të vetme shpreh mijëra kuptime e pohime, madje në një mënyrë kaq lakonike, gjë që mund të jetë vetëm rezultat i një zgjuarsie profetike të hapur ndaj frymëzimit hyjnor dhe revelacionit.

Nuajmani pinte ndonjëherë dhe i Dërguari i Allahut zbatonte atë kohë ndaj tij distancimin. Veprimi i personit ishte një mëkat. Por, kur sahabet, pasuesit e Profetit i drejtuan atij fjalë të rënda për shkak të këtij veprimi, Profeti vrenjti vetullat dhe urdhëroi: "Mos e ndihmoni shejtanin kundër vëllait tuaj! Betohem në Allahun se ai do Allahun dhe të Dërguarin e Tij.²⁶⁴ Sado mëkate të bëjë njeriu te i cili dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij jep si rezultat bashkimin e tij me ta, nuk e meriton fjalën e keqe, sepse ai i do Allahun dhe të Dërguarin e Tij...Dhe kjo dashuri është e mjaftueshme për të qenë bashkë me të Dërguarin e Allahut për një njeri i

cili i kryen farzet, detyrimet fetare, dhe ruhet nga mëkatet e mëdha, sepse njeriu rri me atë që do...⁶¹

5. Takva ose morali i bukur'

Ahmed b. Hanbeli përcjell prej Muaz b. Xhebelit: "Ki frikë nga Allahu kudo që të jesh! Bëj një të mirë menjëherë pas mëkatit që të ta fshijë. Mos hiq dorë nga morali i bukur në marrëdhëniet me njerëzit!"²⁶⁵

. *Kuptimi leksikor i fjalës takva: (Vjen prej fjalës vikaje: 1. shmangie, mbrojtje. 2. mjekësi: masë profilaktike). Ruajtja nga aktet e ndaluara fetarisht; frikësimi nga Allahu dhe ruajtja nga aktet e ndaluara dhe mëkatet nga frika prej Allahut. Ehli takva quhen njerëzit që u rrinë besnikë në mënyrë konsekuente urdhrave e ndalimeve fetare në bazë të të cilave

²⁶³.Buhari, Edeb, 96; Myslim, Birr, 165.

(Kujtoni fjalën e urtë popullore shqiptare: "Më thuaj se me kë rri, të të them se cili je!" përkth.).

*Në origjinal: ab-i hayat.

²⁶⁴.Buhari, Hudud, 4, 5

përvijohet morali Islam, morali i bukur për të cilin bëhet fjalë më sipër. (përkth.)

Nuk ka një element të dytë që ta lartësojë njeriun sa morali i bukur. Morali i bukur është morali i Allahut dhe pajisja e njeriut me moralin e bukur do të thotë pajisja e tij me moralin e Allahut!

Gjendemi ballëpërballë një hadithi që mund të shtjellohet vetëm me vëllime, një hadithi që parashton dhe shpjegon takvanë, ruajtjen e takvasë dhe rrugët e të jetuarit brenda kësaj mendësie. Por nuk do të hyjmë këtu në shtjellimin e këtyre të vërtetave të larta që i përmendëm vetëm për të dhënë shembull.⁶²

²⁶⁵ Tirmidhi, Birr, 55; Mysned, 5/153.

6. Si të jeni, ashtu qeveriseni

Në një tjetër hadith, l'profeti ynë (s.a.s.) urdhëron e thotë: "Si të jeni, ashtu qeveriseni"¹266

Ç'të jetë cilësia juaj, do të jetë edhe e atyre që keni në krye. Ç'lloj burimi të jeni ju, edhe ata që keni në krye do të jenë prodhim i atij burimi. Kjo fjalë është një fjalë e tillë që, lidhur me çështjen e administrimit e të qeverisjes, sendërton fjalorë të tërë. Po deshët, le të qëndrojmë vetëm mbi këtë hadithin tjetër. Sipas fetvasë, konkluzionit "Të gjithë çobanë jeni dhe të gjithë përgjegjjeni për tufën tuaj"²⁶⁷, secili, nga shtetasi i zakonshëm e gjer te kryetari i shtetit, ndodhet brenda një kuadri të caktuar përgjegjësie. Vetëm se shprehja "ç'të jeni ju, të tillë do të jenë edhe administratorët (qeveritarët) që keni në krye" që e thamë më sipër në një trajtë të përafërt, nga këndvështrimi i drejtësisë juridike shoqërore i përftojnë një dimension krejt të veçantë kësaj specifike.

Së pari, ky hadith u thotë masës që ndodhet nën administrim ose qeverisje, se ata janë shumë të

rëndësishëm. Sepse njerëzit që do të vijnë në krye të tyre, janë të detyruar të trokasin në portën e tyre pavarësisht nga ç'rrugë do të nisen. Me fjalë të tjera, masa është ajo që do t'u japë trajtë administratorëve. Edhe shoqëria ka parimet e veta të pandryshueshme. Ashtu siç kanë parime të pandryshueshme, të quajtura ndryshe "ligjshmëria e natyrës", fizika, kimia, astronomia, ashtu edhe shoqëria ka, specifike për të, parime që do të mbeten të pandryshuara gjer në kiamet. Prandaj, nëse njerëzit u hapin udhë ngatërresave dhe ngatërrestarëve dhe nëse jetojnë me prehrin hapur për të këqinj të, pikërisht këta tipa të këqinj e ngatërrestarë do t' i administrojnë dhe qeverisin ata. Ky është kanuni i pandryshueshëm i Zotit.

Po, kur e keqja merr zhvillim në trupin e njerëzve, kur në konstruktin e njerëzve blerojnë të këqijat, atëherë Zoti sjell në krye të tyre që t' i drejtojnë njerëz nga i njëjti brumë e nga e njëjta baltë.

E dyta, prapë ky hadith pohon se ligjet dhe rregullat vëna prej njerëzve janë gjëra në letër dhe s'kanë ndonjë ndikim të madh Edhe sikur njerëzit të bëhen kokë më kokë e të hartojnë ligjet më të

shëndosha, rëndësi ka sesa respektohen spëcifikat që përmbahen në ato ligje. Për rrjedhojë, esenciale është konstruktiv moral i njerëzve që administrohen. Nëse ata janë të moralshëm, nëse janë njerëz që i zgjidhin problemet dhe çështjet që u bien në pjesë, edhe personat që do të vijnë në krye, kurrë s'do të jenë njerëz problematikë.

Le të përcjellim, këtu, meqë i ka ardhur vendi, një ngjarje të jetuar. Është një person me emrin Tahir Efendi ndër deputetët e parë. Ky ishte nga dijetarët, nga njerëzit e virtytshëm. Ndërsa deputetët e tjerë thurnin oratorira nëpër sheshe, Tahir Efendiu, në një qoshe, po heshtjen pëlqente. Mirëpo përkrahësit ngulin këmbë, e nxjerrin hoxhën në një shesh mitingu dhe e bindin që të flasë. Por ç'e do që Tahir Efendiu ishte një njeri fjalë pak. Dhe u thotë të pranishmëve pak a shumë këto gjëra:

O njerëz! Dijeni se ju jeni "muntehibë", zgjedhës", kurse unë jam "muntehab", "i zgjedhur". Vendi ku do të shkoj unë, quhet "muntehabun ilejh", "vendi i të zgjedhurve", domethënë ai qëne e quajmë "kuvend". Puna që bëni ju, është "intihab", "zgjedhje". Kjo fjalë vjen nga rrënja "nuhbe" që do të thotë "kajmak". Mos harroni se ç'të jetë masa që

ndodhet në një enë, edhe cipa e sipërme e saj do të jetë nga e njëjta lëndë. Mbi kos ka kajmak kosi, mbi qumësht, kajmak qumështi, po ashtu, edhe mbi shap, kajmak shapi ka...”

Ja dhe një variant tjetër i kësaj.

Përgjigjja që Haxhaxhi i jep personit që i flet për drejtësinë proverbiale të Hz. Omerit, ka shumë rëndësi sepse i përfton qartësi çështjes në fjalë. Përgjigjja e Haxhaxhit është kjoi "Po të ishit ju po ata njerëz të kohës së Omerit, pa asnjë dyshim që edhe unë Omer do të bëhesha!..”

E treta, çdo njeri, fajin te vetja duhet ta kërkojë. Për sa kohë që njeriu do të jetë avokati i vetes dhe fajin do ta kërkojë jashtë vetes, është e pamundur të hedhë ndonjë hap përpara. Për sa kohë që njerëzit nuk do të bëjnë ndryshime në botën e tyre të brendshme, Zoti nuk do t'i ndryshojë ata.²⁶³ Kur prishet diçka brenda, prishja pa tjetër që do të përhapet në të gjitha anët, gjer lart. Mund të thuhet të njëjtat gjëra edhe për orientimin e brendshëm të njerëzve. Duam të themi se gjendja e të administruarve ndikon mbi gjendjen e administruesve brenda marrëdhënieve shkak-pasojë. Dhe kushedi ç' gjëra të tjera fshihen në shpirtin e

këtij margaritari fjalësh! Dhe kushedi ç' gjëra të tjera parandjen autori i tyre. Eshtë e pamundur të gjesh një tjetër fjalë njerëzore që të shprehë dhe të shpjegojë në mënyrë kaq lakonike konstruktim dhe konstruktivizmin në planin shoqëror dhe, në të njëjtën kohë, të tregojë rrugën e bukur për konstruktivizimin shoqëror. Hz. Muhamedi (s.a.s.) është zotëruesi i zgjuarsisë së lartë që edhe çdo fjalë e tij është një pëllumb i një qielli të tillë të shprehjes...

63

Po, në lidhje me mënyrën e të shprehurit, ai zë vendin më të lartë e më të zgjedhur midis të gjithë njerëzve. Asnjë letrar nuk mund t'i afrohet atij. Fjalët e tij nuk janë Kur'an, por janë të ngarkuara krejt me frymëzim. Prandaj, ashtu siç e prekëm edhe në krye të diskutimit, të gjithë letrarët dhe ata që kuptojnë

²⁶⁶.Kenzu'l-Ummal, 6/89.

²⁶⁷.Buhari, Xhum'a, II; Myslim, Imare, 20.

²⁶⁸.Allahu nuk e prish gjendjen e një populli gjersa ata nuk e ndryshojnë veten e tyre

*Shap: Kripë minerale, sulfati i dyfishtë i aluminit e i kaliumit.

nga letërsia, në mjeshtërinë e ljalës mund të jenë vetëm nxënës të tij!

Hasan b. Sabit është një poet i madh. Është i merituari i lutjeve të bëra për të dhe i mburrjeve të të Dërguarit të Allahut dhe poeti i mbështetur prej Xhebrailit. Përkundër kësaj, Hansa pati gjetur plot tetë gabime në një poezinë e tij katërrrokëshe. Ia, kjo grua e specializuar kështu në poezi, pasi pati dëgjuar të Dërguarin e Allahut, pati hyrë në Islam dhe gjithë puna e saj që bërë të dëgjonte Mbretin e Fjalës. Ashtu ishte magjepsur dhe ashtu kishte kapërcyer _ vetveten duke dëgjuar Atë, sa që kjo grua, e cila me elegjitë që pati shkruar në kohën e injorancës për vdekjen e të vëllait, pati mbytur botën në lot, jo vetëm s'pati shqiptuar edhe një fjalë të vetme . ankuese ndërsa i binin dëshmorë të katër djemtë në Kadisije, por pati thënë kështu: “Ç'lumturi për mua që u bëra nëna e katër dëshmorëve! Lavdi ty, Allahu im!²⁶⁹

Hansa është një grua e merituar për frymëzimin hyjnor. Në rënien e secilit prej të bijve që përpjekur sikur t'i ishte ngulur asaj në gjoks shigjeta. Por aq fuqimisht pat qenë lidhur ndaj të Dërguarit të Allahut, sa asnjë fjalë e vetme ankese nuk pati

vizituar ato buzë të hapura e të mbyllura me atë frymëzim!⁶⁴

7. Aktet janë sipas nijetit (qëllimit)

Buhariu, Myslimi dhe Ebu Davudi përcjellin prej Hz. Omerit: “Aktet janë vetëm sipas nijetit. Çdo njeri do të marrë sipas nijetit të vet. Hixhreti, emigrimi i atij që e ka bërë për pëlqim të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të quhet i prirur kah Allahu dhe i Dërguari i Tij. Dhe kush të ketë emigruar meqë emigrimi do t’i siguronte të mira materiale ose lidhjen e niqahut me një grua, edhe emigrimi i tij do të vlerësohet sipas gjësë së synuar.”²⁷⁰

Meqë për thënien e këtyre fjalëve nga i Dërguari i Allahut u bë shkak hixhreti, emigracioni i tij bashkë me muslimanë të tjerë nga Meka në Medinë, tema

²⁶⁹.Ibni Haxher, el-Hisabe, 4/288.

kryesore në këtë fjalë është hixhreti. Sipas rrëfimit, Profeti e ka shprehur këtë fjalë duke u mbështetur në ndodhinë e mëposhtme:

Të gjithë ata që emigronin nga Meka për në Medinë, emigronin për hir të Allahut. Vetëm një pasues që nuk ia dimë emrin, kishte emigruar për hir të një gruaje të quajtur Ummi Kajs që e dashuronte.”²⁷¹ Pa dyshim që ky person ishte një besimtar, por sjelljet e tij nuk priheshin nga nijeti dhe mendimet e tij prej besimtari...

Edhe ai ishte një emigrant, por emigrant i Ummi Kajsit. Ai ishte pajtuar me shumë e shumë Vështirësi për një grua, ndërkohë që duhet t'i bënte gjithë ato sakrificavetëm për Allahun. Kjo ndodhi ' ishte bërë temë e fjalës së bekuar të të Dërguarit të Allahut ku nuk përmenden emra. Specifika e shkakut nuk i bëhet pengesë karakterit përgjithësues të konkluzionit të hadithit. Prandaj edhe konkluzioni i këtij hadithi është i përgjithshëm dhe përfshin gjithkënd. ⁶⁵

²⁷⁹.Buhari: BediU'l-Vahj, 1,Myslim, Imare, 155,Ebu Davud, Talak, 11. 271” Kastalani, Irshadu's-Sari, 1/55.

Nijeti ose qëllimi i paracaktuar

Jo vetëm hixhreti, por të gjitha aktet dhe trajtimet e tyre janë sipas nijetit. Kur njeriu kërkon të bëjë hixhret, të emigrojë, duke pasur në nijetin e tij vetëm Allahun dhe të Dërguarin e Tij, si përgjigje ndaj këtij nijeti, do të gjejë vazhdimisht para vetes Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kjo është e tillë edhe në namaz, edhe në agjërim, edhe në zeqat. Ashtu siç u pohua edhe në një hadith të përmendur më lart, njeriu që mban parasysh të drejtën e Zotit, vazhdimisht e gjen Atë para vetes. Në ç'trajtë? Në trajtën e mëshirës, bujarisë dhe favorit të Tij. Kur njeriu i gjen këto, entuziazmohet, kapërcen vetveten dhe, duke rënë në sexhde, përpiket ta shtojë afërsinë me Zotin e tij. Pastaj, duke iu afruar Zotit, kjo ndjenjë, ky mendim zotërojnë në të gjitha aktet dhe veprimet e tij. Dhe, kur, nën hijen e këtij zotërimi, të kalojë në botën ku çdo gjë ndryshohet e tjetërsohet, domethënë në varr, në ringjallje, në sirat, gjithmonë Zotin para vetes do ta gjejë. Po qe se aktet e tij do të mund ta çojnë te Flamuri i Profetit,' do të takohet

edhe atje me Profetin dhe do të arrijë të lartësohet cilësisht përtej përfytyrimit.

Por nëse një njeri emigron për një grua, do të thotë se ka pranuar t' u futet vështirësive e privacioneve për kënaqësi trupore, kështu që, pavarësisht nga përpjekjet dhe zelli, çdo gjë që ka bërë konsiderohet se ka shkuar dëm dhe është bërë pluhur e hi...

Një njeri që vazhdimisht përjeton aspektin material të ekzistencës së tij, që vazhdimisht ngrihet e ulet duke u marrë me jetën e tij trupore pa ia vënë veshin asnjëherë zërit të shpirtit dhe ndërgjegjes së vet. do të ulet e ngrihet kot më kot, do ta konsumojë jetën e vet andej-këtej pa dobi, por kurrsesi nuk do të mund të sigurojë rezultatin e siguruar prej njerëzve që e kanë rregulluar jetën e tyre sipas pëlqimit të Zotit! Për këtë edhe ka pohuar Profeti në një hadith tjetër: "Nijeti i besimtarit është më i dobishëm se vepra e tij"²⁷². Sepse sado që të përpiqet, njeriu nuk mundet ta arrijë veprën e menduar në nijetin e tij. Është mëshira e gjerë e Zotit që më shumë se për veprën e kryer, njeriu trajtohet për nijetin në brendësi të tij. Për rrjedhojë, sigurisht që ato që i ka përfutur nijeti njeriut, janë shumë më tepër se ato që

i ka përftuar akti, vepra e tij. Ia, me këtë aspekt nijeti i besimtarit është më i dobishëm se vepra e tij.

Do t' ju lutesha të kishit vëmendjen te hadithi i mëposhtëm meqë ka lidhje me çështjen në fjalë. Profeti ynë thotë: "Kujdes! Në trupin e njeriut është një copë mishi. Po të jetë mirë ajo, gjithë trupi është mirë; po të prishet ajo, gjithë trupi prishet. Kujdes, ajo është zemra!"²⁷³. Po të jeni të sinqertë e me qëllim të pastër, të gjitha farërat që do të hidhni pasi t' u keni gjetur vendin, do të marrin jetë. Në fillim janë të dobëta e të brishta si embrionet, por, me kohë, marrin shtat si selvitë. Ndërkaq, ju jetoni përtej nën hijen e tyre. Po, ato rriten, zgjaten e zhvillohen në raport të drejtë me sa të jenë të shëndosha nijetet tuaja dhe, në trajtën e frutave parajsore, tregojnë shtatin e vet përballë jush. Shprehitë dhe zakonet e njeriut marrin vlerën e adhurimeve sipas nijetit. Për një njeri që bie të flejë me nijetin e adhurimit, edhe frymëmarrjet në gjumë, madje, marrin vlerën e zikn't. Fundja, po të mos ishte kështu, si mund të fitohej xheneti në një kohë kaq të shkurtër, me kaq pak vepra? Po, nëse besimtarit do t'i jepet një jetë e amshuar, kjo do të jetë një favor për nijetin e tij për

adhurim të amshuar, gjë që, për rrjedhojë, do t'i sjellë atij xhenetin e amshuar.⁶⁶

Edhe situata e mohuesit në polin tjetër është e njëjtë. Domethënë se edhe ai e ka bërë hak Xhehenemin e amshuar.

Po, ne, me mendimin e adhurimit të amshuar në nijetin tonë, fitojmë të drejtë për xhenet. Edhe mohuesi me vendosmërinë në nijetin e tij për të qenë mosmirënjohës. Po, është vetëm e vetëm nijeti ai që u përfton vlerë akteve nga më i vogli e gjer te më i madhi, pa përjashtim, dhe që u jep jetë atyre.

Madje, te aktet, veprat e mira, shumë gjëra përfitohen vetëm nga nijeti. Për shembull, nëse një njeri bën nijet për një vepër bamirësie, posaçërisht të përshtatshme ndaj pëlqimit të Zotit, por, për shkaqe të ndryshme, nuk arrin ta realizojë, prapë e merr një sevap, një të mirë. Por po ta realizojë, sipas situatës, fiton herë njëqind e herë më shumë sevape, të mira. Kurse aktet e këqia nuk konsiderohen mëkat nëse

²⁷⁴ .Shih Buhari, Rikak, 31; Myslim, Iman, 206-207.

²⁷⁵ Buhari, Xhihad, 1; Myslim, Imare, 85.

mbesin vetëm në nijet, pa u realizuar. Nëse realizohen, konsiderohen një mëkat.²⁷⁴ Sigurisht që çdo vepër e keqe kërkon edhe një ndëshkim nga të llojit të vet.

Hixhreti

Në këtë mes nuk duhet harruar edhe se hixhretit i jepet një rëndësi e veçantë. Ç'është e vërteta, në kuptimin e vet specifik, hixhreti ka marrë fund, sepse i Dërguari i Allahut urdhëron: "Pas triumfit të Mekës nuk ka më hixhret!"²⁷⁵ Por në kuptim të përgjithshëm, hixhreti vazhdon dhe do të vazhdojë gjer në kiamet. Sepse hixhreti me xhihadin janë binjakë, bashkë kanë lindur dhe bashkë kanë për të jetuar. Prapë është Profeti ynë që na bën të ditur se xhihadi do të vazhdojë gjer në kiamet. Për këtë, ai urdhëron:

"Xhihadi do të vazhdojë gjer në ditën e kiametit!"²⁷⁶

Po, çdo burrë i kauzës, çdo njeri që ka besuar, i cili lë vendin e vet, nënën, babanë, të dashurit e miqtë dhe shkon vend më vend me synimin për t' u treguar të drejtën dhe të vërtetën zemrave nevojtare,

ndodhet në kuadrin e dobishëm të një hixhreti, emigracioni të pambarim dhe pa asnjë diskutim që do ta marrë sevapin, të mirën e kësaj pune.

Nga ana tjetër, nuk bëhet fjalë kund për një të mirë konkrete e të caktuar për hixhretin në rrugën e Allahut e të të Dërguarit të Tij. Ka mundësi që kjo të jetë shenjë se e mira e këtyre lloj akteve do të jepet përtej si një surprizë. Engjëjt e shënojnë aktin identikisht, kurse shpërblimin e cakton vetë Zoti.

Fjala "inne-ma" (vetëm e vetëm) në krye të hadithit, duke bërë një përjashtim absolut të të gjitha mundësive të tjera, përforcon mendimin në vazhdim se trajtimi i veprave dhe i personit bëhet sipas nijetit. Dhe kjo do të thotë, gjithashtu, se edhe asnjë adhurim nuk pranohet pa nijet. Me të Vërtetë, edhe sikur një mijë reqate namaz të falë njeriu, por pa nijet, edhe sikur të mbetet i urët me Vite të tëra e të shpenzojë në rrugën e fesë tërë pasurinë e vet, por pa nijet, edhe sikur të niset për në haxh e t'i kryejë në rregull të gjitha elementët e tij por pa bërë nijet as në nisje e as, gjatë adhurimeve, ky njeri do të jetë sikur as ka falur namaz, as ka agjëruar, as ka dhënë

zeqat dhe as ka shkuar në haxh. Domethënë se është nijeti i njeriut ai që i shndërron në adhurim të gjitha këto akte dhe veprime.

Hixhreti ose largimi nga mëkatet

Po qe se i hedhim edhe një herë sy çështjes, do të shohim sei Dërguari i Allahut, fillimisht, një temë të gjerë si nijeti e ka parashtruar me tri ljalë dhe, pastaj, ka folur me dy-tn' ijali për një specifikë shumelementëshe si hixhreti. Të trajtosh, duke nisur me hixhretin që ka kuptimin e largimit prej të gjitha mëkateve, të gjitha hixhretet në rrugën e së vërtetës, të cilat do të vazhdojnë gjer në kiamet, me një shprehje të tillë si "sehl-i mumteni", "edhe e vështirë, edhe e lehtë", madje duke e shtrënguar brenda dy-tri fjalive, mund të jetë vetëm punë e atij Individualiteti me fjalën prej rubini. Do të ishte e dobishme që ta hapnim edhe këtë specifikë, që emigranti më i madh është ai që largohet prej mëkate-ve dhe që i fshin prej zemre të gjitha dashuritë përveç dashurisë për Allahun.²⁷⁷Një ditë, Ibrahim b. Et'hem, i lutet kështu Zotit: "O Zot, u vrava pas ashkut tënd! E braktisa çdo gjë veç Teje e të erdha pranë. Pasi të pashë Ty, sytë nuk më shohin tjetërkënd! "

Një radhë, kur ai s'bënte tjetër veçse lutej dhe kur jetonte në atmosferën morale-shpirtërore të lutjeve, sheh të birin në një qoshe të Qabes. Edhe i biri e kishte parë. Malli i viteve i nxit të dy që t'i hidhen në krahë njëri-tjetrit duke klithur. Pikërisht në çastin e përqaimit më të nxehtë, një zë i fshehtë i thotë: "Ibrahim, nuk mund të bëhen dy dashuri në një zemër!"

E ja, atëherë, Ibrahim i thërret për të dytën herë: "Merre, O Zot, atë që i bëhet pengesë dashurisë Tëndel!" Dhe i biri i shembet mu ndër këmbël.. 278⁶⁷

Hixhreti ose strehimi te Mëshira Hyjnore

²⁷⁴.Shih Buhari, Rikak, 31; Myslim, Iman, 206-207.

²⁷⁵Buhari, Xhihad, 1; Myslim, Imare, 85.

²⁷⁶" Metheu'z-Zevaid, 1/106.

²⁷⁷ 277.Shih.Buhari, iman,4;Ibni Maxhe,Fiten,2.

²⁷⁸.Feriduddim Attar.Tezkiretu'l-Evlija,pjesa mbi jetën e 1,Et'hemit.

*Adoptimi i shpjegimit, i përkthyesit.

Të ikësh nga mëkatet e të trokasësh në portën e Zotit e të mos largohesh nga ajo portë gjersa të vijë prej Tij fermani i faljes, të mos largohesh kurrë nga ajo portë, është, gjithashtu, hixhret, emigrim. Sa bukur e shpreh këtë kjo lirikë përgjërimi:

Robi yt mëkatar po të vjen, o Zot:

Po të lutet tek mëkatet i pohon;

Po më fale, më fal se je i Lartë!

Po më përzure, veç Teje kush më mëshiron?

Një njeri i cili, pasi të ketë braktisur mëkatet e kryera më parë, rikthimin te të njëjtat mëkate e quan më të dhimbshëm se hyrjen në terr, është vazhdimisht në rrugën e hixhretit, emigracionit, në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Njeriu që i sheh si një arë e minuar gurët e kufirit të gjërave të lejuara e të bekuara që u themi "hallall" dhe që nuk afrohet gjër atje, që u kushton kujdes dorës, këmbës, syrit, veshit, gojës dhe buzëve të veta, do të thotë se bën hixhret gjatë gjithë jetës. Edhe sikur të rrijë mes njerëzve, edhe sikur të tërhiqet në vetmi, emigrimi i shenjtë do t' i jetë bashkudhëtar besnik në thellësitë e botës së tij ndjesore. Vetëm se në tërheqjen në vetmi, emigracioni ka një dimension

të veçantë. Atje njeriu ia arrin shoqërimin hyjnor dhe privilegjohet me frymën hyjnore.

Po qe se do të bënim një përmbledhje të çështjes, do të thoshim ' se hadithi argumenton specifikat e mëposhtme, në mos, të paktën aludon për to:

a. Nijeti është shpirti i veprës; veprat pa nijet quhen të vdekura.

b. Nijeti është një eliksir i bukur e enigmatik që i shndërron të mirën në të keqe dhe të keqen në të mirë.

c. Që vepra të ketë vlerë, varet nga nijeti. Hixhreti pa nijet është një shëtitje turistike, xihadi është dhunë e padrejtësi, haxhi është një udhëtim mashtrues, namazi është kulturë fizike dhe agjërimi, dietë ose pehriz. Shndërrimi i këtyre adhurimeve për njeriun në flatra që do ta çonin fluturim për në xhenet, mund të bëhet vetëm nëse ato prihen nga nijeti' dhe bëhen në bazë të nijetit për adhurim.

d. Xheneti i amshuar është rezultati i nijetit për adhurim të amshuar, kurse xhehenemi i amshuar është rezultati i qëllimit për mohim të amshuar dhe blasfemi të amshuar.

e. Në sajë të nijetit, njeriu mund të shtjerë në dorë gjëra shumë të mëdha e shumë të vlefshme me një përpjekje të vogël dhe me shpenzime shumë të pakta. '

f. Ata që munden ta përdorin mirë kredinë e nijetit, mund të kërkojnë, me të, botët.

g. Ndërsa të mirat materiale të kësaj bote dhe femra janë krijuar të përshtatshme për të qenë nimet, begati, nëse ato shpërdorohen ose nuk trajtohen në bazë të kriterëve juridike, në përfundim mund të bëhen alternativë ndaj miratimit të Allahut dhe të dërguarit të Tij. Për rrjedhojë, duke e futur njeriun në rrethimin e përfitimeve, mund të bëjnë që ai të humbasë çdo gjë...

Ja, pra, janë edhe sa e sa çështje si këto që, ndërsa janë secila më vete tema për një libër, në shprehjen e Mbretit të Fjalës, i aftë për të treguar diellin te molekula dhe për ta dendësuar detin te pika, kanë mjaftuar vetëm katër-pesë fjalë për ta parashtruar tërë këtë përmbajtje të gjerë.

8. Belaja e dorës dhe e gjuhës

Përsëri nga fjalët lakonike, në një hadith të përcjellur nga Buhariu, Profeti ynë urdhëron kështu:

“Muslimani i vërtetë është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit muslimanëve nuk u vjen e keqe. Edhe emigranti i vërtetë është ai që largohet nga gjërat e ndaluara prej Zotit.²⁷⁹

Besimtari ideal

Le ta analizojmë tani shkurtimisht këtë hadith. Besimtari ideal është besimtari, i cili, duke hyrë me të vërtetë në atmosferën e paqes, sigurisë dhe mirësisë, ka mundur ta shkrijë veten në atë atmosferë, i cili nuk u bën keq me dorë a me gjuhë besimtarëve të vërtetë si vetja. Bëhet fjalë, pra, jo për persona që duken a tregohen besimtarë, që pretendojnë se janë besimtarë ose që e kanë të shkruar në pasaportë se janë muslimanë, por për besimtarë muslimanë idealë të vërtetë, të reflektuar si të tillë në mendësinë e të gjithë opinionit.

I tillë është besimtari që shënon hadithi, porosia profetike, si dhe personi që të vjen ndërmend i karakterizuar në mënyrë të përsosur.

Gramatikisht, kjo fjalë në origjinal është shprehur me trajtën e shquar që quhet ”Lam-i tarif”, domethënë duke marrë në krye elit dhe lam,

përkatësisht "el-muslim" dhe "el-muslimun". Kjo trajtë e Veçon emrin e përgjithshëm nga emrat e tjerë të së njëjtës farë, duke e caktuar dhe saktësuar atë krejt si një emër të përveçëm i cili është i njohur për të gjithë folësit në trajtat e tij karakteristike përfundimtare. Një dukuri e tillë në shqip është e posaçme vetëm Për emrat e përveçëm të cilët, si të shquar, si të pashquar, janë Në origjinal: muhaxhir, mekasit besimtarë që emigruan bashkë me Profetin për në Medinë. njëlloj të dallueshëm, ndërkaq që emrat e përgjithshëm si të shquar, si të pashquar, mbeten të padallueshëm. Pra, në arabisht, trajta e shquar i jep emrit të përgjithshëm vlerën e emrit të përveçëm. Duke i ndenjtur besnik origjinalit arabisht, edhe ne përdorëm trajtën e shquar "besimtari", pa arritur, megjithatë, ta përcjellim origjinalin ashtu siç duhet, gjë që ndodh aq më tepër në turqisht ku s'ka shquarësi gramatikore të emrave.

Kjo njohuri dhe kulturë gjuhësore, në atë kohë, ishte e posaçme vetëm për njerëz të arsimuar, gjë që s'mund të thuhet për Profetin, prandaj edhe themi se ai nuk fliste nga vetja. Ç'fliste ai, ipërkisnin Mësuesit të Madh. Prandaj edhe themi se, jo vetëm që e folura e të Dërguarit të Allahut ishte e pasur me të gjitha

mjetet gramatikore dhe letrare, por në të folurën e tij nuk vihej re as edhe një mangësi e vetme. Por le të kthehemi tek hadithi në fjalë. Muslimani i vërtetë është njeriu i besimit dhe sigurisë, i tillë që të gjithë muslimanët e tjerë mund t' i kthejnë shpinën pa ndërjerë asnjë lloj dyshimi apo frike, sepse ata e dinë që prej tij nuk i vjen e keqe askujt. Po qe se u-duhet t' ia lënë familjen amanet dikujt, mund t' ia lënë atij pa u mbetur sytë pas, sepse askujt nuk i vjen e keqe prej dorës dhe gjuhës së tij. Nëse ' dikush është ndodhur në një kuvend ose bisedë bashkë me të, largohet i sigurt prej andej, me mendimin se ai nuk do ta përfolë pas shpine as atë vetë, as edhe të tjerët dhe as do të pranojë të dëgjojë përfolje për tjetërkënd. Sa i dhënë të jetë ai ndaj nderit dhe dinjitetit të vet, aq i dhënë është edhe ndaj nderit dhe dinjitetit të të tjerëve. Ai nuk ha, por u jep të tjerëve për të ngrënë, nuk jeton, por u jep jetë të tjerëve. Për të tjerët ai sakrifikon edhe nga ndjenjat personale të lumturisë. Të gjitha këto kuptime leksikore dalin ⁶⁸

²⁷⁹.Buhari, Iman, 4.

*Adoptimi i shpjegimeve të këtij paragrafi është i përkthyesit.

Privimi nga shikimi hyjnor

Tabloja e dytë është: ”Allahu nuk i sheh ata...” Atë ditë kur ata do të jenë më nevojtarë se kurrë për shikimin mëshirëplotë të Zotit, Ai në asnjë mënyrë nuk do t’ua hedhë atyre shikimin e Vet të mëshirshëm. Ndërsa disa fytyra do të përshndrisin mes buzëqeshjesh, disa fytyra të tjera do të rrinë të varura e të murrëme atë ditë. Pa asnjë dyshim që ky grupi i dyte janë ata që Zoti nuk do t’ua hedhë shikimin e mëshirës.

Ndërsa çdokush thirret me emrin e vet, çdokush ia arrin shpëtimin me një pretekst të caktuar, sa e rëndë, sa rrëqethëse gjendja e këtyre njerëzve të braktisur!

Fakti tashmë i njohur për lexuesit në faqet e kaluam të këtij libri i dënimet për një kohë të shkurtër me një bojkotim të tillë i Ka’b b. Malikut nga ana e të Dërguarit të Allahut, sa rëndë i vjen edhe personit vetë, edhe dëgjuesve të asaj ndodhie!²⁹⁵ Mirëpo njerëzit për të cilët po bëjmë fjalë, do të mbeten përjetësisht të merituar për një dënim të tillë. Aman,

*Në origjinal: Fyjuzat-i hiss.

o Zoti im! Edhe xhehenemi nuk mund të jetë kaq i frikshëm! Të mos ia hedhë vështrimin njeriut qoftë edhe për një çast të vetëm Zoti, mëshira e të cilit është e pafundme, ç'ndëshkim i rëndë që është, ç'përfundim i frikshëm!

Siç mund të themi ne! Njerëzit do të marrin përgjegjësen e gabimeve të tyre. Ata që kanë bërë të mira, do të përballen me të mira, kurse ata që kanë bërë të këqia, do të përballen me të këqia!

Privimi nga përfundimi i mirë

Situata e tretë është: “Allahu ata nuk i nxjerr të pastër...”

Njerëzit duhet të pastrohen këtu e të shkojnë atje krejt të pastër. Pastrimi bëhet në këtë botë. Kurse në botën e përtejme njeriun vetëm xhehenemi mund ta pastrojë. Prandaj edhe Zoti nuk do t'i quajë të pastër ata.

Njerëzit vetëm një herë hyjnë në turin e provimit dhe vetëm një herë në dymbëdhjetë iu bie në dorë mundësia për të qëlluar. Kush e vlerëson siç duhet këtë mundësi, fiton, kush e nënvleftëson, humbet. Alternativë tjetër s'ka.

Le të marrim si shembull Hz. Ejubin me sëmundjet "materiale", nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, një njeri që, në vend të atyre sëmundjeve, e ka të sëmurë të gjithë botën shpirtërore e ndjesore; atë ditë, ky njeri i mjerë do të hedhë sytë nga gjendja e vet e shkatërruar dhe do të shpresojë se mos pastrohet. Por ç'e do që atje Zoti nuk do t' i pastrojë njerëzit e atyre tre kategorive.

Fundi: Dënim i dhimbshëm

Dhe rezultati: "Për ata ka një dënim të dhimbshëm!" Pasi të hedhin edhe një hap më shumë, e vetmja gjë që do t' u dalë përpara, është ai dënimi i frikshëm. Një dënim i tillë që të merr shpirtin, që e ndjen gjer në palcë. Ja, pra, në një të tillë vorbull e në një të tillë humnerë do ta shohin ata veten.

Po kush janë ata tre grupe njerëzish të kapur nga ky lloj ndëshkimi? Kush janë ata me të cilët Zoti nuk do të bisedojë, që nuk do t' i shohë në sy e që në asnjë mënyrë nuk do t' i pastrojë? Dhe kush janë ata

për të cilët është përgatitur ai ndëshkimi zemërpërvëlues?

Te njeriu që e ka lexuar hadithin gjer këtu, është zgjuar një kureshtje tepër e madhe dhe tani ai ka mprehur vëmendjen dhe e ka vënë në veprim tërë aftësinë e vet analizuese për të mësuat identitetin e atyre tre grupeve të panjohura.

I Dërguari i Allahut vazhdon: "...ata që ecin duke e hequr rrobën zvarrë..." Në këto fjalë alegorike shënohen mendjemadhësia dhe krenaria.

Në librat e historisë së Greqisë e të Romës së Vjetër shihni figurat e njerëzve që ecin duke hequr zvarrë tuniket. Kjo duket më qartë në filmat me tematikë nga ajo kohë. Vetëm se themelore këtu nuk është heqja zvarrë e veshjes, cilado qoftë ajo, por e gjestit që shpreh dhe e idesë që përmban veprimi në fjalë që është sjellë si simbol i mendjemadhësisë dhe krenarisë. Dhe pikërisht këtë kërkon të thotë hadithi.

Mendjemadhësia dhe krenaria

Në shumë ajete dhe hadithe, mendjemadhësia dhe krenaria janë marrë e janë trajtuar veç e veç duke treguar se ç'sëmundje e keqe janë dhe ç'përfundime

të këqia sjellin. Për shembull, në një hadith, Profeti ka thënë: "Njeriu që ka në zemër edhe një thërrime mendjemadhësi, nuk mund të hyjë në xhenet!"²⁹⁶

Allahu i ka zënë rrugët e orientimit për atë njeri, në zemrën e të cilit gjendet mendjemadhësi dhe krenari qoftë edhe sa një thërrime. Zoti urdhëron kështu në Kur'an: "Unë do t'i privoj nga argumentet e mia ata që tregojnë pa të drejtë kryelartësi mbi tokë, që edhe po t'i shohin të gjitha mrekullitë, nuk do të besojnë, që edhe nëse e shohin rrugën e shpëtimit, nuk e marrin atë rrugë, ndërsa marrin rrugën e kundërshtimit sapo t'u dalë përpara. Dhe kjo sepse ata i quajtën te

rreme faktet tona dhe i lanë mënjanë." (Kur'ani, A'raf: 146).

Mendjemadhësia është një perde që e verbon kuptimin, aftësinë për të kuptuar. Një ndërgjegje e fryrë me mendjemadhësi, nuk mund t'i shohë mrekullitë e shkruara fletë-fletë në gjithësi, nuk mund t'i përceptojë e t' i njohë ato, sepse, kur kuptimi të jetë verbuar, i zë vendin njohjes dhe flet në emër të tij, prandaj edhe s'vlen më për asgjë!

Madhështia i përket vetëm e vetëm Zotit!* E si mund të duket i përshtatshëm atribuimi një tjetri i

madhështisë së posaçme të Zotit që shpallet pesë herë në ditë nga minaretë?

Në një hadith të shenjtë,** Zoti urdhëron: "Epërsia dhe madhështia janë veshja ime. Kush ngrihet e kërkon të matet këtu me mua, e hedh në xhehenem!"²⁹⁷

Madhështia është një ndër atributet e Zotit. Ç'të shprehë veshja për ne, atë shpreh ky atribut për Zotin, cilësia e të Cilit është e panjohur për ne. Atë që kërkon ta ndajë me Zotin këtë atribut, Ai e përbuz me të drejtë dhe e hedh në xhehenem.

Besimi nuk mund të ngrejë fron në zemrën e mendjemadhit. E thënë ndryshe, besimi nuk vjen e ulet në një zemër ku ka ngritur fron dikush tjetër veç Allahut. Kjo është gjendja e njeriut që me veprimet dhe sjelljet e tij përfaqëson mendjemadhësinë dhe krenarinë. Në hadith një njeri i tillë tipizohet si dikush që "ecën duke e hequr rrobën zvarrë".⁶⁹

²⁹⁶ Ebu Davud, Libas, 26; Ibni Maxhe, Zuhd, 16.

* Allahu Ekber: Allahu është më i madhi!

Kopracia dhe mburrja në të dhënë

Grupi i dytë përbëhet prej njerëzish të favorizuar me mall e pasuri nga Zoti, të cilët e vlerësojnë shtrembër këtë favor. Zoti i ka dhënë mall e pasuri dikujt që edhe vetë të përfitojë, edhe të tjerëve t'u japë pjesë e t'u sigurojë të ardhura e, si shpërblim për këtë, Zoti ti japë atij një mijë për një. Mirëpo ky njeri as që e ka vënë ujët në zjarr për këtë gjë! jo vetëm që s'u siguron pjesë të tjerëve, por edhe kur jep, e zhvleftëson të dhënë me mburrje dhe duke i lënë të tjerët të detyruar për ta falënderuar ndërsa si pasuria, si ai vetë janë pasuria dhe prona e Zotit! Ndërsa e gjithë detyra e tij është shpërndarja e mallit dhe e pasurisë së Zotit, ai është rrëmbyer nga sevdaja për t'i bërë njerëzit që ta falënderojnë e të ndihen të detyruar ndaj tij sikur ai të ishte vetë pronari i mallit

** Në origjinal: Hadithi kudsi, hadith i shenjtë, por OSi hyjnore e frymëzuar Profetit.

²⁹⁷ Ebu Davud, Libas, 26; Ibni Maxhe, Zuhd, 16.

dhe i pasurisë! Ç' pakujdesi e madhe kjo, ç' rënie e frikshme!

Allahu (xh.xh.) i ka dhënë pasuri atij. Vetëm se në këtë pasuri kanë të drejtë edhe të tjerë veç tij. Mirëpo ky njeri bën kopraci dhe, edhe kur jep, mburret për këtë. Përcjellja me fjalë të mira është më e mirë se sadakaja (lëmosha) e ndjekur nga poshtërimi : "Një fjalë e mirë është më e dobishme se lëmosha e përcjellur me të keqe..." (Kur'ani, Bakara: 263).

Ky njeri, pra, është edhe koprac. Mirëpo kopracia e largon njeriun nga Zoti, xheneti dhe njerëzit e tjerë. E largon prej tyre dhe e afron te xhehenemi. Për kopracinë, Profeti është shprehur kështu në një hadith: "Kopraci është larg Allahut, është larg xhenetit, është arg njerëzve. Ai është afër Xhehenemit."298

Ndëshkimi i llojit të aktit

Për sa u përket rregullave stilistike, në këtë hadith është përdorur formimi i foljeve me të njëjtën rrënjë me emrat përkatës* gjë që bëhet për të krijuar lidhjen kauzale midis parashtrimit (introduksionit)

dhe përfundimit (zgjidhjes). Kjo trajtohet edhe në logjikë si dukuria e pasqyrimit. Ajo çka nënkuptohet në hadith me këtë, është se personi në shqyrtim, i cili nuk i pati parë të tjerët me mëshirë në këtë botë, nuk pati qenë interesuar për ta, e pati zhvlerësuar gjënë e dhënë me mburrje, në jetën tjetër do të përballet me një ndëshkim të të njëjtit lloj dhe Zoti do ta trajtojë atë ashtu siç i pati trajtuar edhe ai të tjerët.

Njerëzit që ecin me mendjemadhësi e krenari, që e heqin rrobën zvarrë, që e quajnë ulje të bisedojnë me të tjerët, duhet ta dinë mirë se edhe Allahu nuk do të bisedojë me ta në ditën e ringjalljes. Duhet ta dinë mirë dhe të mos ecin në ato rrugë që çojnë te ai ndëshkim.

Ndërsa s'është me vend betimi zakonisht, betimi në gënjeshtër dhe thjesht për të siguruar përfitime materiale duke u sunduar nga ndjenja e kopracisë dhe pangopshmërisë si dhe përpjekja për ta shitur mallin duke ia rritur vlerën me gënjeshtër, është tabloja e tretë e përfundimit të njerëzve të tillë në një fund të errët.

Grupi i tretë, pra, përbëhet prej atyre që duke e përdorur gënjeshtërën në tregti, synojnë fitime të

padrejta, që besojnë se do ta bindin popullin me betime të gënjeshtërta.

Shihni këtë fjalë lakonike të të Dërguarit të Allahut dhe thoni: "Muhamedu'r-Resulullah!" Çdo shprehje e tij na nxit ne të pohojmë pa pushim se Ai është i dërguari i Allahut!

13. Belaja e gjuhës dhe nderi

Në një hadith tjetër të rrëfyer nga Buhariu, i Dërguari i Allahut urdhëron e thotë kështu' "Kush më jep tjalën dhe bëhet dorëzanës*

dh gjuhën dhe nderin e vet, edhe unë i bëhem dorëzanës për xhenetin!"²⁹⁹

Ai që e thotë këtë, është i dërguari i Allahut. Ai e di më mirë se çdokush se për çfarë duhet e për çfarë s'duhet t' i dalë dorëzanës një njeriu. Po qe se thotë se do t' i dalë dorëzanës për xhenetin, pa asnjë diskutim se ashtu do të bëhet. Osman b. Maz'uni qe një sahabi, pasues i Profetit, të cilin ky e pati bërë si vëlla. Kur vdiq, njëra nga gratë e Osman b. Maz' unit qe shprehur kështu për të shoqin: "U bërë zog parajse e shkove!" Profeti e pati kundërshtuar në çast gruan duke i thënë: "Kur nuk e di unë që jam i

dërguar i Allahut, ku e dite ti se ai shkoi në xhenet?"300

Kjo do të thotë se, duke i dhënë fjalën për xhenetin një njeriu që ika premtuar se do t' i dalë për zot gjuhës dhe nderit të vet, i Dërguari i Allahut nuk fliste sipas hamendjes dhe dëshirës së vet. Ai premtonte duke u mbështetur mbi diçka të njoftuar nga Zoti lidhur me këtë çështje.

Ai kurrë nuk pati folur në emër të Zotit sipas hamendjes dhe dëshirave të veta. Nga një drojë e tillë ai pati dalë gjithmonë i pastër e i lartë. Prandaj edhe thëniet e tij patën qenë vetë e drejta dhe e Vlvërteta dhe ç' pati premtuar, qe realizuar pa asnjë diskutim në ditën e Caktuar!

Po qe se ti mundesh ta ruash gjuhën që ke midis dy nofullash

dhe vendin e nderit, po të them pa u lëkundur aspak se, nëse pas ringjalljes, engjëjt e xhehenemit* të rrokin e nisen të të hedhin atje, mund të bërtasësh me sa zë që të kesh se i Dërguari i Allahut është dorëzanësi yt thirrjes tënde do t'i vijë në ndihmë

dorëzanësia dhe ndërmjetësim** i Hz. Muhamed Mustafajt (s.a.s)! ⁷⁰

Të folurit është një dhuratë e bekuar

Goja e njeriut, e merituar për dhuratën e bekuar të të folurit, është një organ me rëndësi dhe vlerë të pallogaritshme. Por, nëse një organi tillë i bekuar përdoret për të keq, shndërrohet në mjetin më të dëmshëm që e çon njeriun në fatkeqësi e shkatërrim.

Është goja, me të cilën njeriu e përmend dhe e lartëson Zotin. Me gjuhë miratohen urdhërimet dhe pohohen ndalimet. Me gojë e këndon njeriu Kur'anin, librin e gjithësisë dhe interpretuesin e

* Qefil: dorëzanës.

²⁹⁹ Buhari, Rikak. 23.

Buhari, xhenaiz, 3; Ibni Maxhe.
Xhenaiz, 7; Mysned, 2/335.

përjetshëm të tij, me gojë i këndon ajetet-argumente dhe shpjegimet mbi to dhe na përcjell edhe të tjerëve. Disa herë, gjuha, me anë të shprehjeve dhe shpjegimeve të saj, e kthen në besim një njeri mosbesimtar, duke bërë, kështu, gjënë më të mirë midis gjërave mbi të cilat lind dhe perëndon dielli. Me anë të gjuhës njeriu ngjitet në pikën më të lartë të xhenetit** dhe ngre fron në majën e besueshmërisë e besnikërisë.****

Por po ajo gojë mund të përgatisë edhe fatkeqësinë e njeriut. Goja shërben si mjet edhe për të gjitha llojet e mohimit, herezisë e blasfemisë. Ata që u hedhin fjalë sharësë Allahut dhe të Dërguarit të Tij famëmadh, me gojë e kryejnë këtë mëkat të shëmtuar. Me gojë bëhen gënjeshtër, përfolja, shpifja dhe për shkak të gojës së vet rrëshqet njeriu në gropën e gënjeshtërave të Mysejlemes.

Ja, pra, vetëm një fjalë thotë i Dërguari i Allahut e tërheq vëmendjen mbi një organ... Në këtë fjalë të vetme ndodhen të ngjeshura të gjitha të vërtetat prej të cilave ende me qindra s'janë thënë si dhe specifikat për të cilat bëjnë shenjë në një copë herë të shkurtër. Profeti na thotë që ta përdorim gjuhën brenda një kuadri të rregullt e të lejueshëm që edhe

ai të na e japë fjalën për xhenetin. Ai nuk kërkon të na thotë që ta mbyllim gojën e të strukemi në një qoshe...⁷¹

Edukata në të folur

Duke folur për nderin, i Dërguari i Allahut e ka fjalën për atë aspekt të nderit që ka të bëjë me seksin. Në këtë rast ai nuk përmend emrat e organeve përkatëse, por thotë në mënyrë metaforike: ruani vendin midis shalëve.* Gjithmonë, edhe kur bën fjalë për gjëra mjaft të natyrshme për ne e që janë

* Në origjinal: Zebani

** Në origjinal: dorëzanësia:
kefalet; ndërmjetësimi: shefaat.

*** Në origjinal: A'laj-i Il'lijin,
niveli më i lartë i xhennetit, niveli i
njerëzve më të mirë e më të
përsosur pranë Zotit.

**** Në origjinal: Sidkijjet.

elemente të krijimit tonë, Ai qëndron brenda edukatës, ashtu që edhe gjërat e dukura të pakëndshme prej disave, kthehen menjëherë në tablo të pëlqyeshme para syve të njeriut. Me moralin, etikën karakterin dhe natyrën e tij, Ai qe një njeri i programuar për gjëra të bukura.

Vendi midis shalëve

Ka një rëndësi shumë të madhe. Fruti i ndaluar pretekst për nxjerrjen e Hz. Ademit nga xheneti - në këtë dimension i pati dalë atij përpara. Meqë analiza e hollësishme e rrjetit përkatës është jashtë temës sonë, nuk do ta prek, por vetëm do të ndalem pak për të tërhequr vëmendjen mbi të.

Siç sigurohet vazhdimi i brezit me këtë rrugë, edhe shkatërrimi i brezit me anë të adulterit dhe prostitucionit përmes kësaj rruge rezulton, sepse nga shpërdorimi i saj ngatërrohen gjinitë njerëzore me njëra-tjetrën dhe, për këtë shkak, në të gjitha sistemet juridike shemben specifikat më të rëndësishme që duhen mbrojtur. Kush është i ati i dikujt? Kush dhe kujt do t'i lërë trashëgimi, kush dhe nga kush do të kërkojë një të drejtë të caktuar? Si do të ruhet familja

dhe si do të qëndrojë kombi në këmbë? Të gjitha këto pyetje dhe të tjera të ngjashme me këto janë të kushtëzuara vetëm prej nderit seksual. Ndërsa njerëzit e ndershëm dhe bashkësitë e krijuara prej tyre janë të aftë për të siguruar vazhdimësinë e konstitucionit të brendshëm të tyre gjer në kiamet, individët dhe kombet e zhytur në batakun e adulterit dhe prostitucionit, nuk mund ta çojnë as edhe një brez më tej ekzistencën e tyre.

Në esencë, ashtu si në çdo subjekt, edhe në subjektin që po flasim, kuadri i së lejueshmes është i gjerë dhe i mjaftueshëm për të realizuar kënaqësinë e kërkuar. Nuk është aspak e nevojshme të hyhet në haram, në veprime të ndaluara. Dëshira e njeriut mund të kënaqet në formën më të mirë brenda kuadrit të së lejueshmes. Prandaj edhe i Dërguari i Allahut urdhëron: "Martohuni dhe shtohuni! Unë krenohem para popujve të tjerë me shtimin tuaj!³⁰¹ Siç shihet, i Dërguari i Allahut do të krenohet me shumimin e ummetit, bashkësisë së tij. Aq shumë do të shtohet ummeti i tij, saqë ummetet e tjerë, në raport me të, do të mbeten në hije. Dhe kjo ka lidhje prapë me seksin. Me këtë rrugë arrihet në atë rezultat. Edhe të pafismët, edhe zotëruesit e

fisnikërisë së lartë gjithë me atë rrugë dalin në dritë të diellit. Kështu, seksi është një arë pjellore e përshtatshme për të dy elementët antagonistë.

Kërkimi i rrugës së miratuar e të bekuar nga njeriu në këtë subjekt, i përfton atij një sevap, një të mirë të domosdoshme.* Kur mbreti u ka bërë këtë pohim pasuesve, ata e kanë pyetur me habi sesi mund të shpjegohet një gjë e tillë. Dhe Ai, duke buzëqeshur, u ka dhënë një përgjigje të tillë: "Po qe se nuk do të kërkonin rrugën e bekuar (hallall), a nuk do të drejtoheshin kah rruga e ndaluar (haram)?"³⁰² Kurse ikja nga harami është vaxhip, domosdoshmëri. Pra, iniciativa për në rrugën e drejtë i përfton njeriut një të mirë të domosdoshme.

Duhet të na shkojë mendja se ky subjekt që i bën njerëzit të turpërohen kur diskutohet për anën e jashtme të gjërave, është një rrugë ku kanë kaluar edhe të gjithë profetët. Si do të krijohej Hz. Muhamedi (as), krenaria e gjithësisë, po qe se Hz. Ademiti nuk do t'i jepej një ndjenjë e tillë? Kjo do të thotë se qëllimi esencial dhe pasoja e vërtetë e atij frutit të ndaluar ishte krijimi i Profetit tonë...

"Po qe se Hz. Ademi do të njihte lidhjen midis zgjatjes së dorës drejt atij fruti të ndaluar dhe ardhjes

në botë të Hz. muhamedit (as), jo do të zgjaste dorën, por do ta hante atë pemë me rrënjë...” Këto fjalë i kam dëgjuar nga një predikim entuziast.⁷²

Lartësim vertikal

Këtu do t'ju lutesha veçanërisht të kini vëmëndjen mbi një specifike shumë të rëndësishme: i Dërguari i Allahut i premtton Xhenetin atij që i jep fjalën se do ta zotërojë gjuhën dhe seksin e vet. I lanë të njohura figurat e zgjedhura të përgëzuara me xhenetin. Domethënë se edhe disa vetë të tjerë veç tyre, të cilët, me postin eshtënë në dorë dhe me nderin e konfidencës së fituar, bëhen të denjë për një meritë të tillë. Merita në fjalë rrjedh nga vështirësia e ruajtjes së gjuhës e të seksit dhe ashtu është, sepse, në qastin kur epshi e mbështjell gjithë trupin, e pushton qenien dhe e trtmldt shpirtin, në kohën kur vullneti lëshohet dhe i ekspozohet së keqës në të gjitha variantet e saj, frenimi i vetvetes nga njeriu për

³⁰¹ Mynavi, Fejzu'l-Kadir, 3/269;
Kenzu'l-Ummal, 16/276.

hir të Zotit është aq i rëndësishëm, saqë mund të bëhet pretekst për një lartësim vertikal të njeriut cili, pasi që ka arritur një sukses të tillë, sigurisht që mundet të hyjë nën garancinë e të Dërguarit të Allahut dhe të fluturojë në xhenet.

Po, po them me këmbëngulje: njeriu që mundet t'u vërë kufizim shpërthimeve të nefsit, egos së vet, që mundet ta zotërojë atë në çastet kur është e ekspozuar ndaj të gjitha llojeve të të keqes dhe e pengon të bjerë në mëkate e që u bën ballë atyre vazhdimisht me durim, madje që bën përgatitje të vazhdueshme kundër këtyre dobësive, pra, një njeri i tillë mund të fitojë në një çast produktin që dikujt tjetër që rri në posti, do t' i duheshin vite për ta fituar. Gjithashtu, këto përpjekje mund t' i përftonin njeriut shumë më tepër se ç' mund t' i përftonin dikujt tjetër një mijë reqate namaz në natë, madje edhe në një çast të vetëm. Ia përftojnë dhe e ngjisin njeriun vertikalisht drejt pikës së përsosjes shpirtërore e të shenjtërisë? Me këto që po them, të mos pandehet se nënvleftësohen namazi dhe agjërimi nafie, suplementar. Ato janë pretekste për të fituar afërsinë hyjnore dhe ashtu do të mbeten gjithmonë. Ne

vetëm deshëm të kujtojmë një pretekst tjetër që e nxjerr njeriun në lartësinë : përsosmërisë njerëzore.

Le t'i lutemi Providencës Hyjnore që të na pajisë me fuqi njerëzore sa për pesë a dhjetë vetë dhe ta pajisë njeriun me bazat e lartësimit drejt “kulmit të përsosmërisë njerëzore”,* megjithatë, edhe ta mbrojë prej çfarëdo lloj shpërdorimesh! Ruajtja e linjës është shumë e rëndësishme për njeriun që ka një natyrë të ekspozuar ndaj “rreziqeve e në një bazament të ekspozuar ndaj rreziqeve. Ndërkaq, shpërblimi është po aq sa shqetësimi i hequr dhe lartësimi, po aq sa rreziku. Sa punë të mira që të bëni mbi një bazament të rrezikshëm dhesa përgjegjësi që të merrni në buzë të greminës, aq shpërblim ju jepet për suksesin e arritur.

Le të zgjerohemi edhe ca.

Për shembull, Allahu ju ka pajisur, përveç të tjerash, edhe me disa elementë të dëmshëm, si zemërimi, tërbimi, përbuzja, urrejtja dhe epshi. Mirëpo asnjëri prej këtyre elementëve dhe në asnjë kohë s’ju ka sunduar. Përkundrazi, ju, me atë vullnetin tuaj të hekurt, i keni mbajtur ata vazhdimisht nën zotërim dhe keni jetuar si njeri me

shpirt dhe vullnet të vërtetë. Farzet dhe sunnetet** i keni çuar në vend, keni ndjekur nivelin jetësor të zemrës dhe shpirtit, nuk jeni kapur pas bukurive tërheqëse të rrugës së Xhehenemit ndërsa jeni përpjekur të ruani shenjtërinë tuaj duke i pranuar vështirësitë e rrugës së xhenetit si dhe keni parë se po ndani të njëjtën klimë bashkë me profetët, besnikët, dëshmorët.

Pandeh se pas etikës së hollë të vështrimit të Hz. Muhamed Mustafait (s.a.s.) drejt kësaj bashkësie të rilindjes së dytë që përpiqet t'i dalë për zot fesë që e ndan të mirën nga e keqja, mes një mijë e një intrigave të kohës së pasme,* është edhe kjo e fshehtë. Këta njerëz të

cilët, përkundër tërheqjes asimiluese si një vorbull të tregut, ruajnë ekzistencën, rezistojnë, shtrëngojnë dhëmbët e qëndrojnë, me të vërtetë mund të konsiderohen menjëherë në cilësinë e sahabeve, pasuesve të Profetit. Sahabët ishin shokët e Profetit, kurse këta janë vëllezërit e Tij. Sepse Ai pati shfaqur dëshirë në kohën e vet për këta njerëz që do të vinin shekuj më vonë dhe pati thënë: "Përshëndetje vëllezërve të mi!"³⁰³

Po, i Dërguari i Allahut, krahas njerëzve të të gjithë shekujve, sikur u thotë posaçërisht njerëzve të këtij shekulli se atij që do të japë fjalën se do të ruajë gjuhën dhe nderin, do t'i bëhet dorëzanës për xhenetin. Kjo fjalë u thuhet njerëzve jashtëzakonisht të apasionuar pas xhenetit dhe të dashuruar me tërë ndjesitë e tyre për t'u bashkuar me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Dhe ata, duke vepruar si të merituar të kësaj shprehjeje plot sihariq të të Dërguarit të Allahut, dashtë Zoti të jenë plot vendosmëri për t'i vënë gjoksin perit të cakut final!

Ja, pra, i Dërguari i Allahut kështu, me shprehjen më koncize, i parashtron rrugët që çojnë në xhenet dhe vizaton, me këtë shprehje fare të shkurtër, tablonë e individit dhe shoqërisë më ideale. Me ç'mund të shpjegohet mundësia për të rrokur një të vërtetë kaq të gjatë në një shprehje kaq lakonike, veçse me zotërimin e Zgjuarsisë Profetike? Po, Mbreti i Fjalës vetëm Ai është dhe "fjalë lakonike" vetëm fjalëve të tij u thonë!

14. Aktet që fshijnë gabimet dhe lartësojnë nivelin

Në një hadith tjetër të përcjellë nga Myslimi, i Dërguari i Allahut u drejtohet kështu pasuesve: "Shihni, a t'ju shpjegoj sesi jua fshin

Allahu gabimet e ju pastron dhe sesi ju lartëson ju shkallë-shkallë?" Pasuesit i përgjigjen: "Po, o i Dërguari i Allahut!" Dhe i Dërguari i Allahut vazhdon: "Të marrësh abdest të plotë kur kushtet për marrjen e abdestit janë vështirësuar në maksimum, të bësh rrugë të gjatë për të ardhur e shkuar nga shtëpia në faltore dhe të presësh njërin namaz pas tjetrit si të bëje rojë në kufi, ja kjo është ta vësh veten në marrëdhënie me Zotin."³⁰⁴ ⁷³

* Në Origjinal: Vaxhib, domosdoshmëri; një nga shkallëzimet e vlerës juridike të urdhrave e ndalimeve fetare.

³⁰²Myslim, Zekat, 53; Mysned, 5/167, 168.

* Në origjinal: Velilik

* Në origjinal: "Evxh-i kemalat-i insanije".

**Farz; detyrim; sunnet: e lirë (traditë Profetike). Shih shpjegimin mbi vaxhibin në shën. nr.

Dhe tani, me aq sa të kemi fuqi, le të qëndrojmë mbi këtë gjerdan fjalësh prej smeraldi.

Së pari, i Dërguari i Allahut ua tërheq vëmendjen bashkëbiseduesve, sepse çështjet që do të trajtohen në vazhdim, janë çështje që kërkojnë vëmendje. Ato mund të kryhen vetëm me vëmendje, kujdes si dhe duke qenë zgjuar. Disa herë njeriu mund të bëjë mirë edhe duke fjetur. Për shembull, nëse e zë gjumi dhe nuk hyn në marrëdhënie seksuale të jashtëligjshme

* Në original: Ahirzaman, koha ose periudha e pasme e njerëzimit, pas së cilës do të vijë kiameti, katastrofa e botës dhe ringjallja. Autori flet për ditët e sotme, duke i konsideruar këto si pjesë e kohës së pasme.

³⁰³ Kenzu'l-Ummal, 12/183 e në vazhd

ose e zë gjumi dhe nuk merr pjesë në përfoljen e dikujt, e pakta ka shpëtuar prej këtyre mëkateve. Ndërsa sjelljet dhe veprimet mbi të cilat na duhet të qëndrojmë ne, kërkojnë të jesh zgjuar, kërkojnë vëmendje e kujdes.

Edhe fjala "gabimet" është një fjalë që të tërheq vëmendjen në hadith. Çdo njeri bën gabime. Madje, njeriu që thotë se s'bën gabime, ka bërë gabimin më të madh. Mosbërja e gabimeve është e posaçme vetëm për profetët. Çdokush bën gabim, por më i dobishmi i atyre që gabojnë, është ai që pendohet.³⁰⁵

Ia, pra, këtu, i Dërguari i Allahut kërkon t'u tregojë njerëzve mundësinë e shpëtimit prej gabimeve që e zvarrisin njeriun drejt . humnerës skëterrore.

Nuk është e mjaftueshme vetëm të shpëtosh nga gabimet. Është shumë i rëndësishëm edhe përparimi i njeriut hap pas hapi dhe lartësimi i tij shkallë-shkallë. Në të vërtetë, edhe fshirja e gabimit, lartësimi i tij një shkallë më lart do të thotë. Por përparimi dhe lartësimi i njeriut bëhet edhe me aktet dhe veprimet që kryen ai. E kështu, njeriu, në sajë të këtyre akteve negative pozitive, do të hyjë brenda një spiraleje prej

drite dhe do të ngjitet pa pushim drejt pafundësisë. Pandeh se kjo duhet të jetë ajo që i themi hapja e velave në detin e intimitetit hyjnor.’

I pari prej këtyre akteve, është manja e abdestit në kushtet më të rënda. Vetëm se ky abdest duhet të jetë pa të meta. Në dimër, në dëborë, në të ftohtë, në çaste si ato kur uji është i tillë që s’merr dot abdest...

74

I dyti, ta harxhosh jetën në rrugën e faltores. Një jetë e tillë, si një farë nga ku del embrioni, do të shndërrohet në jetën tjetër në një pemë që jep fruta xheneti. Të shkosh në faltore shumë të largëta dhe të mos të ndahet këmba kurrë prej faltores, është, gjithashtu, akt i llojit të dytë.

³⁰⁴.Myslim, Tahare, 41; Tirmidhi, Tahare, 39.

³⁰⁴ Tirmidhi, Kijame, 49; Ibni Maxhe, Zuhd, 30.

Synimi: Namaz

Kurse i treti është të presësh me dëshirë, pas njërit namaz, namazin tjetër. Dhe kjo, ashtu siç është pohuar edhe në një hadith tjetër, do të thotë ta kesh zemrën të lidhur pas faltores.³⁰⁶

Namazi është prehja e shpirtit, shëtitja e ndërgjegjes. Çdokush ka dobësi dhe pasion për diçka. Kurse dëshira pasionante e të Dërguarit të Allahut i kushtohet namazit.³⁰⁷ Prandaj edhe çdo radhë i thoshte Bilalit: "A s'na freskon pak, o Bilal!"³⁰⁸ Dhe thoshte:

"Namazi është bërë drita e syve të mi"³⁰⁹ Pandeh se dëshirën dhe pasionin që do të ndjejmë ne duke hyrë në xhenet, i Dërguari i Allahut e ndjente çdo radhë kur drejtohej në namaz, prandaj edhe e priste me dëshirë të zjarrtë namazin tjetër.

Në hadith parashtrohen tri gjëra të ndryshme. Por, po të bëhet kujdes, do të shihet menjëherë se të tri gjërat përsillen rreth namazit.

Në jetën e njeriut, namazi është një faktor i rëndësishëm, skaji i të cilit mbështetet në miraxh, i cili ia tërheq Vëmendjen dhe e nxit në mënyrën më

të bukur njeriun ndaj të vërtetave njerëzore, prandaj edhe është konsideruar miraxhi i besimtarit.⁷⁵

Namazi është shtylla e besimit;310 namazi e vë në lëvizje anijen e fesë. Pa të, është e pamundur që feja të qëndrojë në këmbë për një kohë të gjatë. Siç është namazi në vetvete një akt ngacmues, paralajmërues, nxitës për ta mbajtur të gjallë besimin e për ta ruajtur njeriun nga plogështia mendore e shpirtërore, ashtu edhe kryerja e tij këtë karakter duhet të ketë. Njeriu duhet ta kryejë namazin i lirë prej të gjitha preokupacioneve përveç ndjesive shpirtërore. Prandaj edhe nuk është konsideruar i pranueshëm namazi kur njeriun e shtrëngon jashtëqitja.³¹¹ Ashtu është. Njeriu nuk duhet të qëndrojë në namaz kur koka e tij është e zënë me gjëra të tilla. Sepse në atë çast koka e njeriut është e zënë me dy gjëra dhe, në situata të tilla, përgjithësisht

* Në origjinal: Marifet-i ilahi.

³⁰⁶ Tirmidhi, Zuhd, 35.

³⁰⁷ Mexhmeu'z-Zevaid, 2/271.

³⁰⁸ Mysned, 5/364, 371.

njeriu kapërcen shumë gjëra të rëndësishme. Veçanërisht, ndejtja në namaz në situata të tilla do të thotë ofendim i namazit, sepse ai nuk është një akt aq i parëndësishëm sa të kalohet ashtu shpejt e shpejt. Namazi është jo një intermexo midis dy situatash që mund e duhet të kalohet lehtë e lehtë, por ndriçim ritmik i jetës shpirtërore të njeriut.⁷⁶

Përgatitjet për namaz

Nga ana tjetër, edhe të gjitha përgatitjet paraprake që bëhen për të falur namaz me zemër të kënaqur, i përftojnë njeriut të mira po ashtu si edhe vetë namazi. Prandaj, së pari, do t' i hedhë gjërat që duhen hedhur, do të hyjë në qerthullin e adhurimeve vetëm me ndjenjën e adhurimit dhe, duke shpëtuar nga të gjitha ndikimet që e pengojnë gjatë namazit,

³⁰⁹ Mysned, 3/128.

*Zezaku Bilal është personi që ka kënduar ezanin e parë në historinë e Islamit.

³¹⁰ Kenzu'l-Ummal, 7/284.

³¹¹ Ibni Maxhe, Tahare, 114; Mysned, 5/250

ashtu do të drejtohet në namaz. Në këtë mënyrë, edhe çdo etapë e kaluar gjer në çastin e qëndrimit në namaz, do t' i përftojë atij të mira. Sepse mjeti i tij është që të talet në qetësi e kënaqësi dhe nijeti i besimtarit është më i dobishëm se akti i tij.³¹² Mendoni se dikush tjetër e bën të njëjtin pastrim thjesht për pastrim, kurse besimtari fiton të mira edhe gjatë çfarëdolloj pastrimi që bën si përgatitje për namaz.

Në të vërtetë, kryerja e nevojave dhe marrja e abdestit kanë mjaft rëndësi për ta përgatitur njeriun shpirtërisht për në namaz. Edhe sikur të bëhet fjalë për realizimin e ndryshimit të kahut të elektrizimit të trupit gjatë larjes së organeve të abdestit, edhe sikur të bëhen shpjegime të tjera, përfundimi nuk ndryshon. Në të vërtetë, kur besimtari merr abdest, nuk i çon aspak ndërmend urtësi si këto. Ai mendon vetëm ato gjëra për të cilat merr abdest. Dhe, në radhë të parë, mendon për namazin.

Përgatitja e bërë për namaz, është nxitja dhe zgjimi i parë, kurse zgjimi i dytë është namazi. Pastaj këndohet ezani, që e nxit, e paralajmëron dhe e përgatit për të tretën herë besimtarin për namaz. Në të vërtetë, edhe duke marrë abdest, edhe duke sjellë

në vend sunnete si pirja e ujit të mbetur dhe këndimi i lutjeve, përfshihet nga një tensionim metafizik. Këtë e pason, pastaj, falja e sunnetit e, kështu, njeriu përgatitet plotësisht për faljen e namazit farz.

Çdo detaj, çdo eveniment që përfshihet në qerthullin e përgatitjeve për namaz, na bëjnë që vetëm aty ta kemi mendjen, vetëm për atë të mendojmë. Thirrja hyjnore që lartësohet nga minaretë, na e rrit tensionimin dhe ne fillojnë të ndjejme madhështinë e Allahut në ndërgjegjet tona. I shpejtojmë hapat për të shkuar në faltore e, kështu, e rrisim ritmikën e reagimit tonë sikur t'i përgjigjeshim një thirrjeje të ardhur prej përtej me ezanin. Kur zëri i ezanit fillon të zbresë drejt finalizimit, edhe ne sikur shkrihemi e bëhemi një me ndërgjegjen dhe shpirtin tonë. Pastaj hyjmë në faltore dhe drejtohem në namazin nafile.* Në një vështrim, kjo për ne do të thotë të nisim të shtyjme portat e farzit. Sikur duam t'i themi kështu Zotit tonë që iu drejtuam me namazin nafile: Zoti im, vetëm kah Ti dua të drejtohem, tek Ti ta gjej atë që kërkoj, të Të shoh e të Të dëgjoj dhe vetëm Ty të të ndjej në frymëmarrjen time... Sepse, përveç Teje, është e kotë dhe e padrejtë të shohësh tjetërkund, të shohësh

tjetërkënd, të merresh me të tjera gjëra. Unë iki nga gjërat e kota dhe vetëm një gjëje shumë të rëndësishme i drejtohem.

Shtyrja e derës së farzit në nafile, trokitja në të, është një pretekst i rëndësishëm për të arritur kushtet për të hyrë në mënyrë të vetëdijshme në farz e për t'u përqëndruar në të.

Abdesti e pati bërë punën e vet. Edhe ezani e bëri. Me namazin nafile hodhëm edhe hapin e tretë. Dhe pikërisht në këtë kohë ngrihet një muezin me zërin prekës, drejtohet me sinqeritetin më të thellë kah Allahu dhe kryen ikametin.** Zëri prekës e zemërdrithërues i tij për ne bëhet, përse i përket emocioneve, pika e fundit që derdh gotën...

Nëse në këtë pikë ndëgjegjja nuk emocionohet, nuk mundet të kthehet kah Allahu plotësisht e nuk e kërkon duke rënkuar atë drejtim, do të thotë se aty mungon diçka.

Me këndimin e kametit, muezini i jep goditjen e fundit çdo gjëje . tjetër që do ta preokuponte njeriun përveç Zotit; edhe robi futet në namaz me thënien "Allahu Ekber" (Allahu është më i Madhi), të cilën e përsërit në të gjitha fragmentet e tij: në ruku, në sexhde. Kështu, në çdo seancë të namazit njeriu

shpall pa pushim madhështinë e Zotit duke e bërë këtë me ndërgjegjen e përlësisë prej robi me të cilën shpall, në të njëjtën kohë, vogëlsinë e vet. ju mund ta quani këtë ecurinë e përgjithshme të përqëndrimit në namaz.

Në namaz njeriu i afrohet Zotit, i afrohet në atë mënyrë, saqë, ashtu si Hz. Muhamed Mustafai (s.a.s.) i dha selam drejtpërdrejt Zotit në miraxh, edhe ai i drejtohet Zotit drejtpërdrejt në fund të namazit dhe e përsërit atë selam.⁷⁷

Pastrimi i gabimeve

Në hadith thuhet "...ua pastron gabimet..." Në origjinal është fjala "mahv" që do të thotë pastrim i diçkaje të shkruar. Domethënë se gabimi ekziston në

³¹² Mexhmeu'z-Zevaid, 1/61, 109

*Nafile: suplementare, jashtë farzeve, detyrimeve.

** Kamet: ezani që këndohet brenda në xhami fill para faljes.

natyrën njerëzore në trajtën e një fare. Njeriu ose e ujit këtë farë, ose e pengon për t'u zhvilluar. Me kryerjen e porosive të Profetit, Zoti i pastron gabimet në tjalë dhe aftësinë e njeriut për të bërë keq e shndërron në aftësi për të bërë mirë. ,

Në Kur'an thuhet: "Allahu shlyen çka të dojë dhe fikson çka të dojë. Tek Ai janë bazat e të gjitha librave." (Kur'ani, Ra'd: 39)

Kjo do të thotë se gabimi si dhunti është një simptomë e pandarë nga natyra njerëzore dhe një veçanti shumë e rëndësishme për çdo

njeri. Prandaj edhe pastrimi dhe fshirja e tij pa tjetër që do t'i interesojë çdokujt.

Çdo njeri mund të bëjë gabime, madje mund ta çojë jetën mes prapësisht e gabimesh. Vetëm se për çdo njeri dhe në çdo kohë ekziston mundësia që, duke i fshirë gabimet, të shënojë nivele të larta në vend të tyre. Ja, pra, njëra prej rrugëve për të arritur një famirësi të tillë, është të marrësh abdest pavarësisht nga pengesat dhe duke i marrë parasysh të gjitha vështirësitë. E dyta, të vraposh për në faltore me një dëshirë serioze, të të mbetet zemra e lidhur pas faltores dhe të largohesh prej saj me njetin për t'u kthyer përsëri me qëllim që t'u bësh

dritë edhe fragmenteve të tjera të jetës tënde. Dhe e treta, pas një namazi, të përgjosh namazin tjetër. Këto edhe gabimet i fshijnë e i mënjanojnë, edhe e ngjisin nivel pas niveli njeriun drejt kulmit të përsosmërisë.

Përgatitja dhe kujdes

Kështu i ka vlerësuar i Dërguari i Allahut veprimet e mëposhtme dhe këtë e ka përsëritur tri herë.

Fjala "ribat" e origjinalit, përveç të tjerash, do të thotë të jesh i zgjuar dhe i kujdesshëm ndaj pikave nga ku mund të të vijnë të gjitha llojet e ngatërresave dhe fatkeqësive si dhe t'ia kushtesh veten një pune ose diçkaje tjetër.

Në Kur'an urdhërohet: "O ju që keni besuar! Bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm dhe rrini të gatshëm e syhapur ndaj armikut! Kini frikë Allahun që të keni sukses! " (Kur'ani, Al-i Imran: 200)

Edhe në një ajet tjetër tërhiqet vëmendja për përgatitje e kujdes parë nga një kënd tjetër: "...përgatitni, sa të keni mundësi, kuaj të ushqyer për të luftuar kundër armikut..." (Kur'ani, Enfal: 60)

Duke u nisur nga kuptimi i kushtirnit ndaj një qëllimi të caktuar të fjalës "ribat", nëse njeriu merr abdest siç duhet, nëse e bën rregullisht rrugën shtëpi faltore dhe nëse kthehet në shtëpi apo në punë me zemrën dhe mendjen përherë te faltorja, kjo do të thotë se ai njeri ia ka kushtuar veten Zotit.

Duke përdorur fjalën "ribat", Profeti ka parasysh edhe një kuptim tjetër të saj dhe thotë se kuptimi i parë i kësaj fjale është përkushtimi i plotë i ushtarëve në kufi për të mbrojtur atdheun nga armiqtë. "Ribat" do të thotë të jesh i përgatitur ndaj armiqve dhe, për këtë qëllim, të organizosh pika përqëndrimi ushtarak në pararojë; po ashtu, do të thotë të luftosh kundër armiqve të quajtur "shejtan" dhe "egoizëm", luftë, "e cila është, në një kuptim, më e madhe se e para. Dhe njeriu është i ngarkuar me përgjegjësinë për t'i çuar në vend që të dyja këto luftëra. Njëra nga këto quhet "xhihad-i asgar", "lufta e vogël", kurse tjetra, "xhihad-i ekber", "lufta e madhe". Ndërsa përfytet me dushmanin, në të shumtën e herës njeriu nuk

mund të gjejë rastin për të menduar gjërat mashtruese që kanë lidhje me egon e tij. Atëherë ka më pak mundësi që ky njeri të bjerë nën pushtetin e trupit, e kufomës së vet, sepse veten ia ka pushtuar mendimi i luftës duke e preokupuar tërësisht. Por sapo që të tërhiqet në qetësi, bëhet e madhe mundësia që botën shpirtërore t'ia mbështjellin gjërat e këqia. Atëherë bëhet i detyruar që ta rrethojë e ta ruajë botën shpirtërore kundër tyre. Edhe kjo është një luftë dhe arma më e rëndësishme që duhet të përdoret në të, është namazi. Fetafisht, lufta është, sipas vendit, "farz-i ajn", detyrim i përgjithshëm ose "farz-i kifaje", detyrim i pjesshëm. Mes luftës materiale dhe luftës në veten e njeriut ka ngjashmëri edhe në detyrim. Prandaj

edhe i Dërguari i Allahut, duke u kthyer nga një luftë, pati thënë: "Po kthehemi nga xhihadi i vogël për në xhihadin e madh!"³¹³

Lidhja e zemrës së njeriut pas xhamisë, domethënë pas namazit, ndjekja e namazit me pasion, sipas mendësisë profetike, dhe shndërrimi i namazit për atë person në dritë të syve, është quajtur

e barasvlershme me veprën e njeriut që bën rojë në front.

Po qe se do të bënim një përmbledhje të shkurtër të diskutimeve tona mbi hadithin në fjalë, do të thoshim se janë tri gjëra, dy prej tyre të lidhura më shumë me sjelljet e veprimet, tjetra me njetin, të cilat, për sa u përket ndjenjave e mendimeve, e marrin njeriun brenda një rrethimi, të cilat e pastrojnë njeriun nga mëkatet e së kaluarës në bazë të fermanit bujar e qetësues "Pa dyshim që të mirat i fshijnë të këqiat" dhe pasioni i adhurimit përballë gabimeve të mundshme të së ardhmes, i cili e Vë njeriun në lidhje me Zotin, e pajis me forcën e njetit dhe e vë të luftojë.

E para, abdesti me plot dëshirë kur uji dhe atmosfera nuk janë të përshtatshme për të marrë abdest qetësisht, kur uji dhe ajri janë ftohur ose uji, për shkak të gjendjes me pakicë, është aq i vyer sa të mos mund të shpenzohet për abdest përjashtuar situatat jetësore dhe detyruese të natyrshme kërkon një sinqeritet shumë të thellë, një dëshirë serioze për të bërë sevap, të mirë, dhe një dëshirë maksimale adhurimi që të mund të kryhet. Po qe se një njeri mundet të marrë abdest nën kushtet më të rënda si

tregues, kjo, e gjithë këtij predispozicioni të thellë, do të thotë se ndjesitë e tij janë të lidhura me Të dhe të dehura pas Tij. Më në fund (këtu përbën lidhje edhe aspekti i bashkësisë), në një botë të tillë të ndritshme, edhe sikur njollat të bien fletë-fletë mbi shpirt a të hyjnë në thellësi të tij, absolutisht nuk mbeten të qëndrueshme. Ekuilibrimi elektrik i trupit prej abdestit, eliminimi në një masë të madhe i streseve nga njeriu me anë të abdestit dhe rinimi i shpirtit me anë të forcës, metafizike pesë herë në ditë janë për ne çështje të mbrojtura e të pakontestueshme; megjithatë, po kalojmë meqë e kapërcejnë kuadrin e subjektit që po diskutojmë...⁷⁸

* Në origjinal: Nefs, egoja njerëzore, tërësia e proceseve dhe e tipareve fiziologjike të njeriut që përbëjnë aspektin e tij material.

** Në origjinal: Xhihad; ne po përdorim fjalën "luftë" sepse një emërtim cept i tillë është i pranuar edhe nga shkencat përkatëse jofetare.

³¹³ Axhluni, Keshfu'l-Hafa, 1/511, 512.

E dyta, në një kuptim, miraxhi, shkelja e pareshtur e rrugëve të faltores për t'u afruar te Zoti, ruajtja e gjallërisë së trupit dhe e forcës fizike, vrullëzimi i shpirtit me gëzime që e kapërcejnë njohjen, zhytja e zemrës në fjalët e namazit pa hyrë ende në namaz, sigurimi i përqëndrimit të duhur për një adhurim cilësor të konsideruar si audiencë hyjnore e plotë, zhytja në thënie të ndryshme në dimensione veç e veç të këtij rrugëtimi të shpeshtë, zhytja në to dhe tjetërsimi, fshirja, brenda këtij tjetërsimi, shoqëruar me pendesë e së kaluarës së zezë, zbardhja dhe ngjyrosja në të bardhë e asaj së kaluarë përmes rënkirnesh, të gjitha këto përbëjnë një kuadër të pastër, të kthjelltë e me perspektivë në kuptim të shërbimit të së dobishmes e të bekuarës si pretekste për dobi e bekime të tjera (në antagonizëm me një kuadër vicioz e pa perspektivë), ku e kaluara e dikujt që është i vendosur për të udhëtuar në një kuadër të tillë, është amanet që i bëhet besnikërisë së tij përmes deklaratës "Si përfundim, Zoti ka për të t' i falur mëkatet e kaluara", që i bëhet gjithashtu,

kalasë së tij të shëndoshë me deklaratën "...edhe mëkatet e së ardhmes..."

E treta, pritja e kohëve të namazit siç pret dashnori takimin dhe rregullimi i jetës dhe veprimtarisë duke i përdorur ato kohë të bekuara si kalendar është një mendësi kohe që e kapërcen përfytyrimin, e tillë që në sajë të saj, njeriu, vetëm me një dimension të tillë nijeti mund t'i mbushë boshllëqet e krijuara nga shpërndarja e veprimeve në pjesë të caktuara kohe, mund t' i bartë edhe jashtë namazit kënaqësinë e këtij të fundit dhe afërsinë ndaj Zotit dhe, duke i lidhur me Zotin të gjitha preokupacionet e kësaj bote, mund t'i shndërrojë ato në adhurim. Në bazë të këtyre konsideratave, ashtu si shumë adhurime që janë bërë të pakufizuara në sajë të nijth brenda kufijve të caktuar, edhe namazi i falur me shpirtin e pritjes, krejt si lufta (xhihad) materialo-shpirtërore, me fjalën "rabit" është bërë titulli i marrëdhënieve me Zotin.

Dhe hadithi në fjalë, është, përsëri prej Profetit, një shembull shprehjeje të shkurtër aq sa s'ka ku të shkojë më, por të thellë, me mjaft pak fjalë, por gjithëpërfshirëse në emër të prezantimit të një fragmenti të vogël nga bota e ndritshme e besimtarit

e ravijëzuar me abdestin dhe e bërë qiellore me namazin. Pa e zgjatur më fjalën, dëshiroj të kaloj në një deklaratë tjetër të ndritshme të tij që, kësaj radhe, është një hadithi kudsî.

15. Surpriza për robtë e mirë

Në këtë hadith të rrëfyer nga Buhariu, Zoti urdhëron kështu: "Për robërit e mi të mirë Unë kam përgatitur përtej gjëra të tilla që as syri s'i ka shikuar, as veshi s'i ka dëgjuar dhe që s'kanë hyrë në përfytyrimin e askujt.³¹⁴

Në hadith flitet për një surprizë. Atje njeriu do të përballet me gjëra të papritura dhe në një çast të papritur. Në të vërtetë, në Kur'an flitet për disa nimete, të mira e begati. Por ajo është vetëm një emërtim i tyre, një shembëllim dhe një tequrë ideore. Koncepti i të Vërtetës së tyre duke qenë në këtë botë është i pamundur.

Në komentin e ajetit "Atyre iu dhanë gjëra të ngjashme..." (Kur'ani, Bakara: 25), Ibni Abbasi thotë se në xhenet ka gjëra të cilave ne ua dimë vetëm emrat.³¹⁵ Por, kur t' i shijojmë, mund të themi, sipas shijes, "kjo i përngjet kësaj", por në asnjë mënyrë

s'është ajo vetë. Begatitë e xhenetit, ashtu si edhe vetë xheneti, janë krijuar në përshtatje me përjetësinë e tij. Do të ishte naivitet të kërkoje atje shalqinin, pjeprin, mollën, dardhën e kësaj bote.

Xheneti është vendi i surprizave. Xheneti është një panair i ngritur në amshim, ku janë radhitur të gjitha të mirat e begatitë që do t'jua çonin mendjen vërdallë, që do t'jua turbullonin shikimin, që do t'ju dehnin sa të mos mund të kuptonit se ç'po bëni. Veçanërisht, një nga surprizat e xhenetit është edhe mundësia për ta parë Zotin, një çasti soditjes së bukurisë së të Cilit nuk ndërrohet me mijëra vite jetë xheneti. Besimtarët, pra, kur të hyjnë në xhenet, do ta sodisin Zotin. Në fakt, Zoti është i pavarur nga koha dhe hapësira, qofshin këto edhe koha dhe hapësira e xhenetit. Soditja e Zotit është përgatitur si një surprizë për robtë e mirë të Tij.

Në origjinal, për robtë e mirë është përdorur fjala "salih". "Salih" quhet njeriu që bën një punë pa gabime e pa të meta. Kurse "salihat" quhen punët e kryera pa të meta e pa gabime. Nëse një punë e caktuar futet ndër punët e tilla të mira, kuptohet vetëm duke iu drejtuar kriterëve hyjnore. E thënë ndryshe, duke parë në kriteret e Allahut, si falet

namazi, si mbahet agjërimi, si jepet zeqati, si bëhet xhihadi, si mbahet nën kontroll bota e brendshme, si kujdeset për ndërgjegjen, si vrullëzohet shpirti, si fuqizohet vullneti, si zhvillohen ndjenjat? Të gjitha këto "si?" vlerësohen ashtu si të jenë kriteret hyjnore dhe ashtu realizohen. Nisur nga kjo, vetërregullimi e akordimi i njeriut sipas fjalëve të Zotit dhe përpjekja për të nxjerrë tinguj në atë trajtë që do t'i pëlqenin Zotit, konsiderohen si hapi i parë në emër të mirësisë.

Po, ashtu siç i akordojmë veglat muzikore para se të fillojmë t'u biem, edhe ju, nëse do të donit të nxirrnit një zë që do t'i pëlqente lartësisë hyjnore, që të futej në kor, pa tjetër që duhet ta rregulloni dhe akordoni veten sipas Kur'anit gjersa zëri juaj të pranohet si i pëlqyeshëm përtej. Ndryshe, nuk jua hedh vështrimin e nuk ju dëgjon kush! Zoti është Semi (dëgjues) dhe Basir (shikues). Ai sheh çdo gjë dhe dëgjon çdo zë, vetëm se nuk dëshiron t'ju dëgjojë nëse zëri juaj nuk është i përshtatshëm për atë pozitë. Për rrjedhojë, edhe ju s'arrini dot t'ju dëgjojnë.

Në një kuptim tjetër, "salihat" do të thotë se punët që do të kryhen, duhet të kryhen me kujdes

dhe korrektesë duke pasur parasysh se vrojtohen dhe do të vrojtohen nga ana e Zotit. Prandaj njeriu duhet t'i kryejë me korrektesë të gjitha të mirat që do t' i dalin përpara, sepse nuk dihet se cila prej atyre akteve do t' i bëhet pretekst për shpëtim. Prandaj edhe i Dërguari i Allahut urdhëron:

”Ki frikë nga Zoti dhe mos nënvleftëso asnjërën prej atyre që dihen!”316

Në hadithin në fjalë thuhet veçanërisht ”robve të mi të mirë”. Kjo do të thotë se mirësia i ka afruar ata tek Zoti dhe i ka bërë të dashur të Tij. Kurse në një tjetër hadithi kudsî, gjendja e atyre që duhen prej Zotit përshkruhet kështu: ”Pasi ta dua dikë, bëhem veshi i tij që dëgjon, syri i tij që shikon, dora e tij që prek, këmba e tij që ecën!”317

Me mirësinë e tij robi fiton një afërsi të tillë ndaj Zotit, saqë ngjyroset plotësisht me bojën e Tij dhe vjen e bëhet si ajo kufoma në duart e larësit të kufomave: është gjithmonë Zoti që e vërtit atë djathtas-majtas. Ç’dhunë e ëmbël, kjo, me të cilën Zoti e bart atë në drejtim të drejtësisë. Veçanërisht nuk bëhet fjalë që një njeri i tillë, vepër e një favoriti hyjnor, të heqë sytë nga Zoti, sepse ai ka kapur pikën e quajtur "robtë e mi" dhe është futur ndër të afërmit

e Zotit. Prandaj edhe një njeri i tillë rënkon e thotë:
"Mbamë, o Zot! Mbamë, se pa Ty s'bëj dot!"

Ai bën pothuaj çdo gjë që është e mirë dhe e bukur dhe kërkon pretekst për shpëtim në çdo gjë që bën. Meqë s'e di se cila e mirë do ta shpëtojë, nuk e lë t' i ikë nga dora asnjë e mirë që i del përpara Të gjitha bëmat e tij shkojnë në jetën tjetër në formën e paketave me surpriza dhe atë ditë që të hyjë në xhenet, këto paketa do t' i hapen një nga një përpara e do t'i jepet mundësia që të përjetojë surpriza që s'ia ka parë syri e që s'ia ka dëgjuar veshi.

Duke marrë parasysh të vërtetën se disa herë njeriu shkon dhe do të shkojë në xhenet edhe duke i dhënë ujë një qeni,³¹⁸ se shkon dhe do të shkojë në xhennem edhe duke e lënë pa një një mace,³¹⁹ themi se edhe gjërat që do të jepen në xhenet, do të jenë surpriza.

Njeriu mund të dijë për gjëra që ia sheh syri, që ia dëgjon veshi e që mund t' i sajojë me përfytyrim. Mirëpo, siç është njeriu i kufizuar, edhe këto reflekse i ka të kufizuara. Për rrjedhojë, me këto reflekse të kufizuara mund të njihen vetëm sende të

kufizuara; me këto është e pamundur të maten të mirat e botës së pakufizuar:

Gjërat e larta s'janë për këtë mendje të vogël;

Ngarkesë të tillë kjo peshore s'mund të përballojë...

Z.P.

Një interpretim tjetër mund të jetë edhe ky: Mirësive të bëra, Zoti u jep herë 10 shpërblime, herë njëqind, herë shtatëqind, herë njëqind mijë, herë një milion e herë një numër që vetëm Ai mund ta dijë. Asnjë rob nuk mund ta dijë sesa shpërblim i është dhënë. Kurse në jetën tjetër, kur përgjegjëset e veprave të tij t'i dalin para në trajtën e surprizave të papërfytyrueshme, do të shtanget nga mahnitja që sheh të sendërtuara si të vërtetat vetë gjëra që as i ka shkuar nëpër mend!

Ja, i Dërguari i Allahut që ka parashtruar me disa fjalë një të vërtetë kaq të thellë, i ka thënë këto fjalë që e kapërcejnë cakun e aftësisë sonë konceptuese, pa u menduar fare, në çast dhe në mënyrë të improvizuar. Qoftë edhe vetëm këto fjalë mjaftojnë për të provuar se ç'zgjuarsi të jashtëzakonshme zotëronte Ai. Megjithatë, ne, meqë e kemi të

pamundur të heqim dorë nga kënaqësia sublimë që na jep diskutimi mbi Të, mendojmë që, të paktën, të flasim edhe për disa fjalë të tjera të Tij.

16. Xheneti është rrethuar me shëmti, kurse xhehenemi, me epshe

Në një tjetër hadith të tij të rrëfyer nga Buhariu dhe Myslimi, Profeti ynë thotë: ”Xheneti është rrethuar nga të gjitha anët me gjëra që nuk i pëlqejnë nefsit, egos, kurse xhehenemi me epshe qëi fryjnë uritë dhe dëshirat trupore...”³²⁰

Xhehenemi është i mbuluar me epshe, është i mpleksur me epshe në bohçën e epsheve dhe i hapur për atmosferën e epsheve. Kurse xheneti, sipas vështrimit aparent të mendjes, është i ndarë me perde prej gjërash të papëlqyeshme e të shëmtuara. Për sytë e atyre që e kërkojnë çdo gjë te materia, ato që ndodhen në rrugët që të çojnë për në xhenet, nuk janë aspak gjëra të llojit që duken të bukura.

Në fakt, edhe xheneti, edhe xhehenemi janë mirësi për ne, sepse, në gjetjen e orientimit, njëri ka rol nxitës, kurse tjetri, rrëqethës. Kur njeriu sheh

pamjen tërheqëse të xhenetit, përpiqet vazhdimisht për të hyrë atje. Edhe kur sheh çehren prej humnere të xhehenemit, vrapon drejt xhenetit me zellin për të mos rënë atje. Kështu, që të dy bëhen mirësi e mëshirë për ne.⁷⁹

Zoti i ka mbështjellë xhenetin dhe Xhehenemin në bohça të veçanta dhe i ka nxjerrë në tregun e veprave të njeriut. Me vullnetin që i është dhënë, njeriu është në pozicionin e parapëlqyesit të njërit prej këtyre. Kush do, tregohet i lartë dhe kërkon xhenetin, kush do, tregohet i ulët e hyn në rrugën e Xhehenemit. Po, përreth Xhehenemit ka një atmosferë dëshirash dhe epshesh dhe me një atmosferë të tillë është i mbuluar ai. Kjo atmosferë

³¹⁴.Buhari, Tevhid, 35.

³¹⁵.Ibni Kethir, Tefsir, 1/91

³¹⁶ Mynavi, Fejzu'l-Kadir, 1/121,
Kenzu'l-Ummal, 6/576.

³¹⁷ Buhari, Rikak, 38

³¹⁸ Buhari, Enbija, 54; Myslim,
Selam, 153. ³¹⁹ Buhari, Mysakat,
9; Mysned. 2/507

³²⁰ Buhari, Rikak, 28; Myslim, Xhennet, 1.

duket shumë tërheqëse nga jashtë: ngrënie, pirje, fjetje, sigurimii çdo gjëje tërheqëse për nefsin, egon e njeriut. Ç’pastë që mund t’u bëjë zë dëshirave të njeriut si kënaqje të aspektit të tij trupormaterial, të gjitha janë si një qëndismë që e ka mbështjellë Xhehenemin. Përfundimi, rruga e Xhehenemit është një mozaik dëshirash e epslesh që gudulis aspektin material të njeriut. .

Xheneti është një sedef i rrethuar me vështirësira, me halle, me gjëra të shëmtuara: të marrësh abdest, të falësh namaz, të shkosh në haxh, të japësh zeqat, të luftosh, t’ u futesh vështirësive në rrugën e Zotit, vende-vende të trajtohesh në shoqëri si njeri i sërës së ulët, të liresh i privuar nga të gjitha llojet e të drejtave njerëzore, të shëtisësh nga burgu në burg, të hash dru vetëm se ka thënë “Allahu është Zoti im”, të internohesh dhe një sërë gjërash të dukura të shëmtuara sipas aparencës mendore gjer te dënimi me asgjësim. Po, këto e kanë rrethuar xhenetin, me një atmosferë të tillë është mbuluar ai. Ata që shohin nga jashtë, gjithmonë tek këto perde ngecin. Nisur nga perdet, xhehenemi është ngacmues, gudulisës e përkëdhelës, kurse xheneti, që të shtie drithmat. Prandaj edhe shumica e njerëzve

kanë parë anën e jashtme të punëve dhe janë gënjyer. Për rrjedhojë, kërkesat për xhehenem janë të shumta, kurse për xhenetin, mjaft të pakta.

Shumica e njerëzve vrapojnë pas hesapeve të vogla. Një njeri që thotë “namazi është i mirë, por unë e kam të vështirë për t’u falur pesë herë në ditë”, është penguar në vështirësinë shumë të vogël të namazit. Vështirësia e abdestit në dimër i ka lënë në rrugë disa. Mirëpo në hadithin e mësipërm pamë se i njëjti abdest është kah e afron hap pas hapi në xhenet një tjetër që e ka pranuar këtë shqetësim të vogël të abdestit. Të njëjtat gjëra është e mundur t’i mendojmë edhe në agjërim, në zeqat, në haxh, në xhihad. Sa e sa vetë, mendja e të cilëve u bëhet pengesë për të vepruar me mençuri, përballë këtyre pengesave dhe të përpjetave e tatëpjetave nuk po munden të bëjnë shpërthimin e duhur dhe gjërat e pakëndshme që vërejnë rreth xhenetit, po u bëhen pengesë për të hyrë atje.

Kurse xhehenemi është si një shtrigë që dëshirat e ulta i ka bërë kurth për njeriun. Shumë vetë që s’dinë gjë se pak më pas veprimi i tyre do t’u kushtojë jetën, vrapojnë pas këtij kurthi-helm ashtu si dhe mizat që vrapojnë pas mjaltit. Këta njerëz

mund t'ua përngjasojmë edhe fluturave që vërtiten rreth zjarrit ku do të digjen e shkumbohen; ata ecin pa mend drejt dëshirave e epsheve që rrethojnë Xhehenemin dhe veç kur e gjejnë veten atje. Meqë nuk e dallojnë qartë se ç'ka në të Vërtetë pas perdes, gjërat që shërbejnë si perde për Xhehenemin, ua kamxhikojnë dëshirat dhe epshet trupore dhe i tërheqin kah vetja.³²¹ Kurse njerëzit që, në rrugën e jetës, janë njohur me Personin që Ndodhet atje ku ndahen rrugët, që ndjekin rrugën dhe drejtimin Sipas mesazhit të marrë prej Tij, që e kanë njohur të vërtetën e Zemrës, e kuptojnë fytyrën e brendshme të gjërave të pa-pëlqyeshme që kanë zënë të dy anët e rrugëve të xhenetit dhe në asnjë mënyrë nuk gënjehen nga pamja e jashtme e tyre, se xheneti që ndodhet si një embrion në ndërgjegjet e tyre, është në zhvillim të vazhdueshëm tek ua mbështjell botën e tyre shpirtërore. Ndërsa të tjerët e kërkojnë xhenetin jashtë, këta edhe në këtë botë kalojnë një jetë të rehatshme me xhenetin që gjejnë në vetvete. Por njerëzit që jetojnë në xhenetin material të kësaj bote, nuk mund të kapin as minutën e xhenetit që jetojnë këta në ndërgjegjet e tyre, madje as gjatë gjithë jetës. Besimi është një embrion që bart brenda

xhenetin, kurse mohimi është një farë që bart brenda Xhehenemin. Përtej këto do të zhvillohen e do të hapin degë dhe do të transformohen në xhenet dhe xhehenem në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kjo do të thotë se besimtari bën jetën e xhenetit edhe në këtë botë, por gjërat që jeton, duken nga jashtë të papëlqyeshme.

Shpirtrat që përpëliten me afsh për t'iu afruar xhenetit në këtë rrugë ku çdo etapë është një lumturi më vete, shqetësimet e sjella nga adhurimet trupore si abdesti, namazi e agjërimi që, në kundërshtim me shpirtin, nefsi, egoja nuk i pret me kënaqësi, detyrimet mjaft të rënda si zeqati, sadakaia dhe llojet e tjera të tatimeve, përgjegjësitë trupore e pasurore si haxhi dhe lufta e bëjnë për disa këtë rrugë që nuk mund të vazhdohet më. Në këtë rrugë ngecin menjëherë e mbeten disa në abdest, disa në namaz, disa në uri dhe etje, disa në dashurinë për jetën dhe mallin e disa në shumë prej këtyre gjërave e nuk mundin të arrijnë në xhenetin që i pref katër hapa më tutje në tërë madhësinë dhe shkëlqimin e vet!

Po, nëse xheneti është një vend me qindra përgjegjësi dhe detyrime disa prej të cilave i

përmendëm më sipër e, në anën tjetër, irrethuar me pengesa, të përpjeta e tatëpjeta sa bota, megjithatë një botë e lartë dhe vendi i ëndrrave shumëngjyrëshe që i kapërcejnë përfytyrimet për çfarëdolloj lumturie, që kështu është, edhe xhehenemi, në antipod me të, është një gropë plot me dëshira, uri dhe epshe që entuziazmojnë neftin, egon, dhe vrullëzojnë dëshirat trupore e që ua ka zënë rrugën udhëtarëve të amshimit, është gropa e trëndafilave të egër, që i fryn dhe shkumëzon të gjitha llojet e dëshirave, urive e epsheve trupore, që çdo kohë mundet të mbledhë mbi vete vëmendjen e shpirtrave të dobët e që, me atë forcën e tmerrshme thithëse si të vrimave të zeza, i tërheq brenda kalimtarët dhe i shkrin.

Sa e sa njerëz ka që magjepsen nga pamja e stolisur e Xhehenemit e që e hedhin veten në atë gropë, ndërsa sa e sa të tjerë ka që vetëm pse shohin pamjen e jashtme të perdes që mbulon xhenetin, rrëqethen e, kështu, rrinë larg nga ai vendi i lumturisë e nga ajo botë surprizash!

Po, nëse do të shihnim si qëndron, në të vërtetë, puna, do të thoshim se nuk mund të mendohet që të mos kenë dëshirë për të hyrë në xhenet ata që e njohin dhe për t'iu afruar Xhehenemit ata që,

gjithashtu, e njohin. Ç'e do se, për shkak të së fshehtës së propozimit, të besimit në të fshehtën dhe së vërtetës së provës, xheneti u ka dalë njerëzve përpara mbuluar me një perçe prej gjërash të papëlqyeshme, kurse xhehenemi, i veshur me një fustan epsheh e dëshirash.

Ecni e shihni, tani, te përmbajtja, fuqia dhe magjia e fjalës së Profetit, që dy rrugë shumë të gjata e të vështira bashkë me të gjitha frikërat, rreziqet dhe kënaqësitë e tyre i kushtëzon me dy Përfundime të padiskutueshme që të drithërojnë ose të kënaqin.⁸⁰

Gjithashtu. ai në çdo punë tjetër të tij, duke iu përshtatur parimit të tij të "kursimit maksimal",

³²¹ Këtë Profeti e tregon me një analogji: "Shembulli im me ummetin tim është si shembulli i njeriut që ndez një zjarr ku fillojnë të bien flutura dhe kafshë të tjera, Unë ju tërheq për kindesh. kurse ju hidheni në të!" (Buhari, Rikak, 25; Myslim, Fezail, 17, 18; Mysned, 1/39).

përdor vetëm katër-pesë fjalë për të parashtruar çështje gjigante si kjo.

Këtu, meqë i erdhi radha, le të pohoj menjëherë këtë që ne dëshirojmë të mjaftohemi vetëm me shënimin se këto fjalë të bekuara të Profetit tonë janë vetëm perla fjalësh, sepse në këto hadithe e në të tjera të ngjashme, për nga aspekti i gjuhës e i shprehjes ka sa e sa subjekte të tjera që na përcjell neve. Sikur edhe të mund të analizoheshin në këtë aspekt fjalët e bekuara të të Dërguarit të Allahut, kushedi edhe për ç'gjerdanë kuptimesh do të bëheshim dëshmitarë! Por, meqë kjo specifike është një temë krejt më vete, nuk do ta hapim tani atë portë. '

17. Tri të drejta: e drejta e Zotit, e shtetit dhe e fesë

Një hadith tjetër Imam Tirmidhiu e përcjell: "Ju këshilloj të keni frikë Allahun si dhe ta dëgjoni e t'i bindeni atij që keni mbi krye, edhe sikur të jetë një

skllav zezak! Ietëgjatët mes jush do të bëhen dëshmitarë të shumë kontradiktave në të ardhmen. Ju mbani për rrugë rrugën time e të kalifëve rashidinë e shtrëngojeni fort atë siç shtrëngoni gjuhën mes dhëmbëve. Dhe ruhuni nga bidatet (sajimet). Pa asnjë diskutim që çdo sajim është një devijim."322

Këtu i Dërguari i Allahut flet për tri të drejta: e para, takvaja, e drejta e Zotit. E dyta, dëgjimi dhe bindja që është e drejta e atyre që drejtojnë shtetin. E treta, lidhja fort pas sunnetit, traditës profetike, që është e drejta e fesë.

Fjala "takva" vjen nga rrënja "vikaje" që do të thotë "mbrojtje, parandalim, profilaksi". Në një aspekt, "takva" do të thotë që, duke respektuar parimet e ligjshmërisë së krijimit, të hysh nën mbrojtjen e Allahut dhe, kështu, të jesh i mbrojtur edhe nga ligjet e krijimit. Edhe sikur njeriu që është zgjedhur e vënë në krye të shtetit, të jetë një skllav zezak kaçurrel, bindja ndaj tij është kusht. Kjo është një demokraci mbi çdo demokraci. Është një demokraci që njerëzit assesi s'kanë mundur ta arrijnë e që s'do ta arrijnë edhe për shumë kohë nëse punët do të vazhdojnë po kështu, një demokraci që është

realizuar plot katërmbëdhjetë shekuj më parë. Vetëm se nuk është e drejtë t' i thuhet demokraci këtij sistemi të ardhur me dorën e një profeti, sepse asnjë botëkuptim demokracie në botë nuk ka mundur të arrijë në këtë horizont. As në vendet më moderne dhe të qytetëruara në dukje, madje, nuk ka zënë vend një mendim dhe botëkuptim i tillë. Sot në Amerikë zezakët vazhdojnë të jenë në gjendjen e qytetarit të dorës së dytë

Ka vende që ende s'i pranojnë zezakët si njerëz. Kurse Islami qysh shekuj më parë ka shpallur se, nëse njerëzit sjellin në krye të shtetit një zezak, duhet edhe t'i binden. Veçanërisht në këtë hadith tërhiqet vëmendja se rruga për në postin e kalifit është e hapur për këdo. Po deshi populli, mund të sjellë në krye të shtetit edhe një zezak. Dhe, pasi të bëhet kjo, çdo njeri është i detyruar t' i bindet atij. Nuk është e rëndësishme se kush zgjidhet, por se kë zgjedh populli.

Me ajetin-argument të Kur'anit, "Sot e plotësova fenë tuaj..." (Kur'ani, Maide: 3), plotësimi i fesë ka marrë fund. Nuk ka mbetur asnjë fjalë pa thënë. Asgjë e re nuk mund të futet më në te, sepse çdo sajim i ri që do të futej, do të ishte vrasja e një

sunneti, e një tradite profetike. Prandaj është e domosdoshme lidhja fort pas sunnetit të të Dërguarit të Allahut dhe kalifëve (zëvendësve) të tij Rashidinë.* Kjo lidhje s'është me duar, por me dhëmbë. Sunneti i Profetit është një zog fati. Nëse duhet gjuajtur, ai duhet gjuajtur dhe duhet mbajtur fort në duar. Kurse sunneti i tij do t'u tregohet të tjerëve me gojë si dhe do t'u tregohen dhëmbët atyre që e zgjasin gjuhën kundër sunnetit. Atyre nuk do t'u lihet hapësirë që të flasin si t' u vijë për mbarë mbi sunnetin.

Po të kishim patur mundësinë t'i dëgjonim drejtpërdrejt prej tij këto gjëra që u përpoqëm t'i parashtrojmë pak a shumë këtu, kushedi se ç'pasuri do të pikonin në botën tonë të përfytyrimit! Çdo gjethe e çelur në fjalët e tij do të na pëshpëriste neve kuptime të tjera. Pas fjalës së tij, edhe ne do ta miratonim atë duke thënë "Drejt foli i Dërguari i Allahut!". Dhe kështu themi...

E si të mos themi, kur fjalët e tij, sikur edhe një hap të hidhnin, do të ngjiteshin në qiellin e mrekullisë së Kur'anit!⁸¹

³²² Tirmidhi, Ilim, 16; Për variante të tjera rrëfimesh shih Ibni Maxhe,

18. Të gënjejesh një herë apo dy herë

Në një hadith të përcjellur bashkërisht prej Buhariut dhe Myslimit, Profeti thotë: "Besimtari nuk mund të goditet dy herë në të njëjtën vrimë."³²³

Nuk do të themi ndonjë gjë të madhe mbi këtë hadith që u intereson shumë nga afër politikanëve të së ardhmes, por do të mjaftohemi vetëm me shënimin e disa gjërave.

Shpirtrat e ndriçuar, armata e dritës që u janë hapur sytë për të kuptuar e njohur kulturën e vet, që e kërkojnë botën e tyre po në botën e tyre, duhet vazhdimisht të rikthehen për t'u menduar mbi këtë hadith dhe të gjitha politikat e jashtme e të brendshme duhet t'i ngrenë mbi bazën e mësimëve të nxjerra prej tij. Atëherë quhet 5e kanë gjetur një rrugë të rëndësishme që të çon drejt suksesit. Ndryshe, mashtrimet e vetëmashtrimet në platformën politike kurrë s'do të mbeten mangut dhe

Mukaddime/ 6, Mysned, 4/126,
127.

njerëzit tanë gjithmonë e vazhdimisht do të jenë të mashtruar e të vetëmashtruar!⁸²

19. Njerëzit janë si mineralet

Edhe edukatorët e së ardhmes duhet të bëjnë studime mbi këtë hadith të rrëfyer nga Buhariu dhe Myslimi. I Dërguari i Allahut urdhëron: "Njerëzit u ngjajnë krejt mineraleve të arit e të argjendit. Të dobishmit në kohën e injorancës, pasi të hyjnë në Islam e ta përvetësojnë atë, mbeten prapë më të dobishmit!"³²⁴

Me këtë thënie, Profeti sikur i ka mbledhur të gjithë psikologët dhe pedagogët dhe po u jep këtë mësim:

* Rashid: njeri i rrugës së drejtë.
Kalifët Rashidinë, katër kalifët e ardhur në pushtet pas Profetit: Ebu Bekr, Omer, Osman, Ali.

Në edukimin e njerëzve ka shumë rëndësi përcaktimi i karakterit të tyre. Fizionomia nxjerr në shesh botën shpirtërore të njeriut. Prandaj në fillim duhet të kuptohet bota shpirtërore e njeriut e pastaj të futet në poçen e duhur e të tretet. Edukim do të thotë t' i japësh formë njeriut. Dhe dhënia e formës mund të bëhet nëse tretet si duhet e pastaj futet në kallëpin përkatës.

Edukimi spontan jo vetëm që nuk ka dobi, por mund edhe t'u hapë rrugë dëmeve serioze. Prandaj Allahu (xh.xh.) e urdhëron kështu Personin që i ka rënë përsipër kjo detyrë: “Thuaj: “Kjo është rruga ime. Unë dhe ata që më vijnë pas, i ftojmë njerëzit te Allahu në bazë të fakteve të qarta!” (Kur’ani, Jusuf: 108)

Sigurisht, ftesa për tek një ide apo kauzë duhet bërë në bazë të të dhënave të sakta e të qarta: kush do të ftohet, për çfarë, në ç’masë. Ftesa duhet bërë me vetëdije të plotë.

Kjo do të thotë se i Dërguari i Allahut ka zgjedhur në ftesë rrugën e vetëdijshme për vete e për ummetin, bashkësinë e vet Fundja, këtë rrugë e urdhëron drejtpërdrejt vetë Zoti!

Në sa gradë shkrihet dikushi për të dhënë metalin e pastër? Në ç'poçe shkrihet dikushi? Në ç'distilues futet një tjetër? Këto e të tjera pyetje mund të marrin përgjigje vetëm me dije.

Në periudhën e injorancës, midis njerëzve të asaj dite, ata që ishin të vetëdijshëm, të aftë për të menduar, që e donin të vërtetën, që ishin të matur, edhe pasi iu hapën sytë kah e vërteta dhe e kuptuan Islamin, prapë mbetën më të dobishmit. Sepse edhe pasi të shkrihet, ari mbetet ar dhe, po ashtu, argjendi dhe bakri mbeten argjend e bakër. Ata kurrë nuk kthehen në ndonjë metal tjetër. Ata, minerali i të cilëve në periudhën e injorancës qe ar, do të bëheshin ar edhe pasi të kalonin në Islam, por

vetëm me një kusht, që të dendësoheshin duke u pastruar prej të gjitha skorjeve...

Që të kryhej ky proces, sigurisht që ndihej nevoja e një mësuesi, e një udhëzuesi dhe, në një kuptim, e një kimisti. Po, vetëm ashtu mund t'u fryhej Islami atyre nëpër ndërgegjet!⁸³

³²⁴ Buhari, Menakib, 1; Myslim, Birr, 160; Mysned, 2/539.

20. Padrejtësia nuk mbetet pa u ndëshkuar

Një hadith tjetër që nuk do të kalojmë pa e prekur, është edhe kjo thënie e Profetit: "Allahu i jep kohë mizorit. Por kur e kap, për atë s'ka më shpëtim!" Pastaj Profeti vazhdon me këto fjalë të Kur'anit: "Ja, kështu është ndëshkimi i Zotit tënd. Kështu i kap e i ndëshkon Ai popujt mizorë. Ndëshkimi i Tij është shumë i rëndë e idhimbshëm!" (Kur'ani, Hud: 102)³²⁵

Allahu i jep shumë kohë mizorit. Atë që ushtron dhunë e padrejtësi, atë që revoltohet e ngre krye kundër Tij, Zoti e pret me durim, duke i dhënë kohë. Veçse kur e kap për ta ndëshkuar, s'ka gjë që ta shpëtojë! Kjo do të thotë se padrejtësitë dhe mizoritë e kryera e kanë kapërcyer durimin dhe, si pika e fundit, e kanë derdhur gotën. Janë disa ligje të Zotit që veprojnë në gjithësi e që kurrë nuk ndërrojnë. Këtë na e tregon ajeti-argument "Nuk ka ndërrim në atë që ka krijuar Allahu" (Kur'ani, Rum: 30). Një nga këto ligje është edhe ky: Mizori është shpata e Allahut. Duke na e sqaruar këtë gjë, i Dërguari i Allahut thotë: "Mizori është drejtësia e Allahut. Me

të Ai merr hak, pastaj ngrihet dhe merr hak edhe mbi të!"³²⁶

Mizori është shpata e Allahut. Ata që e tejkalojnë të drejtën e vet dhe e kapërcejnë masën, Allahu i rregullon me anë të mizorit. Pastaj ngrihet dhe hakmerret ndaj mizorit në mënyrë të tillë, që edhe ju mbeteni me gojë hapur. Me gjendjen e tyre të sotme, mizorët vrapojnë si kuajt që kanë këputur frerin. Por ju në asnjë mënyrë nuk duhet të ndikoheni nga kjo e të bini në dëshpërim! Sa e sa "katundeve" u ka dhënë, po kështu, kohë Allahu sikur t'u thoshte: "hani, pini, bëni qejf"! Mirëpo e keni parë se pastaj i ka përmbysur e i ka dhënë fund punës së tyre!³²⁷

Po qe se i hidhni sytë një herë përreth, edhe ju do të shihni krejt hapur peizazhe konkrete të këtyre që po themi. Sodom, Gomore e

Pompei janë vetëm tre shembuj të kësaj. Kushedi se edhe sa e sa shembuj ka që nuk i dimë, ose i kemi harruar se s'janë të këtij niveli, të cilët, të gjithë së bashku, me gjuhën e gjendjes së tyre bëhen dëshmitarë të këtij ligji hyjnor.⁸⁴

³²⁵ Buhari, Tefsir, (11) 5; Myslim, Birr, 61.

Ç'është nevoja për të shkuar larg? Dikur, mbi këto dhera që jetojmë, ishte një shtet i madh. Shembja e tij ishte një gjë që s'mund të mendohej as në ëndërra. Kjo shembje që s'i shkonte kujt nëpër mend, nuk ka shpëtuar pa u shënuar në kujtesën e historisë si një ndodhi e hidhur...

...dhe kanuni që s'ndërron: "Ja, kështu të shkatërron Allahu!" Historianët dhe sociologët e vërtetë do të përfitojnë shumë nga ky ligj i pandryshueshëm i Allahut dhe nga shembujt në varrezën e Tij të historisë. Ndoshta ky përfitim do të sigurojë që ata të mbeten gjallë për shumë shekuj. Kurse ne le të kalojmë në një hadith tjetër. I Dërguari i Allahut urdhëron:

21. Shtatë grupe njerëzish nën hijen e Zotit

³²⁶ Axhluni, Keshtu'l-Haia, 2/49.

"Allahu shtatë njerëz do të marrë nën hijen e vet ditën e kiametit, kur nuk do të ketë hije tjetër: të parin, imamin e drejtë; të dytën, të riun që e kalon jetën nën gëzimin e adhurimit; të tretin, njeriun e dhënë pas faltoreve; të katërtin, secilin prej dy njerëzve që duhen dhe bashkohen për hir të Allahut dhe që ndahen prapë për hir të Allahut; të pestin, burrin i cili, në çastin kur po bie në rrjetën e femrës me post dhe bukuri, del kundër egos së vet duke thënë: "Unë kam frikë nga Allahu"; të gjashtin, njeriun që, nga gjëja që dhuroi në të majtë, të japë në të djathtë pa u kuptuar; të shtatin, njeriun që, kur të jetë vetëm fare, të kujtojë Zotin dhe t' i mbushen sytë me lot." 328

Ja, pra, specifikat e sipërme, të cilat nga këndvështrimi i vullnetit njerëzor, paraqesin veç e veç rëndësi të veçantë, janë, disa, punë shumë të vështira për t'u kryer dhe, disa, rrjeta që konsiderohen pengesa serioze për shpirtin. Sikur edhe të shpëtojë nga disa prej këtyre rrjetave, njeriu prapëseprapë ndodhet ballëpërballë me mundësinë për t'u kapur prej të tjerave. Mundësia për t'u shmangur prej këtyre kurtheve vrasëse që kapërcehen vetëm me mbrojtjen dhe favorin e

Allahut dhe çarja në vend me sukses e këtyre përgjegjësive të vështira që herë e vënë në diskutim fuqinë e njeriut e herë e kalojnë atë, mendoj se duhet të gjenden te dhënia e hakut vullnetit që konsiderohet preteksti më i fuqishëm e më i përshtatshëm i tërheqjes të po asaj mbrojtjeje dhe favori, te forcat për t'u gjendur në lidhje të ngushta me Allahun...

Ja, pra, kjo fjalë e Profetit, me një fragment të tillë nga xhemaati, bashkësia e njerëzve të bekuar që ka mundur të ekzistojë në çdo kohë me anë të vullnetit të vet dhe ka vënë në shesh forcën e lidhjeve me Allahun, është kah na paraqet neve shoqërinë ku sundon ndërgjegjja, e kërkuar, kjo, qysh herët nëpër utopitë, por përfundimisht e pagjetur, është kah na i entuziazmon ndjesitë e na i mbush shpirtrat me dëshirë për t'i arritur ata...

Po, atë ditë kur dielli do të përcëllojë çdo anë, kur trutë do të ziejnë dhe djersët do të vijnë gjer në fyt, kur të gjitha justifikimet do të falimentojnë dhe çdo gjë do të kthehet kundër njeriut, nuk do të ketë hije tjetër veç mbrojtjes dhe favorit të Zotit dhe s'mund të ketë. Nuk ka rëndësi se si do të jetë kjo

hije; e rëndësishme është të dimë se atë ditë rregulli i gjërave ka ndryshuar, kriteret dhe etalonet janë përmbysur, qielli dhe toka janë tjetërsuar.

Në këtë ditë të tmerrshme është jashtë çdo diskutimi se askush nuk do të ndihmojë tjetrin dhe se mbrojtjet e mbështetjet nuk do të vlejné për asgjë. E kush mund të të mbrojë atë ditë kur zërat do të ndërpriten, kur shpirtrat do të vijnë në të dalë, kur njerëzve do t'u merren mendtë dhe do t'u turbullohet shikimi? ⁸⁵

Ja, pra, në një ditë të tillë ekziston vetëm një strehim: hija e mbrojtjes së Allahut! Ata që do të përfitojné nga ajo hije, janë:

a- Lideri dhe udhëheqësi i shtetit, i vetëdijshëm për përgjegjësinë e vet dhe që, me respektimin e amaneteve të marra përsipër, përfaqëson të vërtetën, drejtësinë dhe orientimin.

³²⁷ Kësaj i bën shenjë kapitulli Haxh i Kur'anit, ajeti 48.

³²⁸ Buhari, Ezan, 36; Myslim, Zekat, 91; Tirmidhi, Zuhd, 53.

b- I riu që, në periudhat kur egoizmi dhe epshet kanë sunduar me tërbimin e tyre më të madh, ia ka kushtuar veten adhurimit të Zotit pavarësisht nga dëshirat trupore e materiale.

c- Heroi i adhurimit që i ka vënë dëshirën dhe harenë e adhurimit para dëshirave materiale, zemra e të cilit rreh vazhdimisht në faltoret.

d- Vetmohuesit e dashurisë që janë dashuruar me njëri-tjetrin për hir të Allahut, që janë bashkuar për hir të Allahut e që janë ndarë për hir të Allahut, që i kanë bërë pikë orientimi e shprese pëlqimin dhe dashurinë e Allahut.

e- Trimi që mundet ta çojë jetën gjithë në rrethin e frikës dhe respektit ndaj Allahut, jashtëzakonisht i ndjeshëm në mbrojtjen e nderit dhe pafajësisë së vet, i vendosur gjer në fund kundër dëshirave epshore, që mundet t'i shtypë propozimet e këqia të nefsit, egos së vet, me mendimin dhe duke thirrur "Unë kam frikë nga Zoti!"

f- Heroi i singëritetit dhe bujarisë i cili, si simbol të besnikërisë ndaj Allahut, mallin e mbledhur me thonj e me dhëmbë e jep për të ushqyer nevojtarët duke dashur që të mos ia dijë tjetërkush veç Allahut, madje me një dëshirë që shkon gjer në xhelozin, ashtu

që kur jep në të majtë, përpiqet që të mos e shohë tjetri në të djathtë.

g- Heroi i ndjesive që i dimensionon çastet e vetmisë me meditim dhe përkushtim, që u jep melodi përmes lotëve ndjenjave të poetizuara aty-këtu në ndjesitë e tij, që e merr gjithmonë prej Allahut forcën e vullnetit, me të cilën, në cilësinë e një dallgëthyesi, thyen e shpartallon dëshirat e mbrapshta.

Po, ashtu siç është pohuar edhe në hadithet e tjera, vendosja mbi podiume prej drite atje përtej të gjykatësit që gjykon me drejtësi dhe pirja fyt pas fyti e komplimenteve të Zotit të ardhur njëri pas tjetrit; shpërblimi me kënaqësinë e Zotit i të riut që në rini e ka kapërcyer rininë e vet; marrja nën mbrojtjen hyjnore të heroit të adhurimit që ka arritur suksesin të qëndisë si një dantellë jetën e tij në dimensionin faltore-shtëpi-vendpune; shpërblimi me dashurinë hyjnore i atyre që, duke e parë gjithësinë si "djepin e vëllazërisë", e kalojnë jetën duke dashur e duke u dashur për hir të Allahut; siguria se ka frikë prej përtej e njeriut të ndjenjave që e thur jetën mbi frikën dhe respektin; meritimi i trajtimit të paimagjineshëm nga Ai më besniku i heroit të

besnikërisë që e jep sadakanë si shenjë besnikërie; më në fund, meritimi i fitimit të gjërave të shpresuara pas kapërcimit të të gjitha rreziqeve nga njeriu i zemrës dhe i ndjenjave që mundet t'ia zbrazë zemrën. Atij përmes lotëve në çastet e intimitetit të fshehtë me atë Mik, nga njeriu-shembull më i përsosur në aspektet me të cilat e njohin atë njerëzit, me paraqitjen e jashtme plot kuptim dhe botën e brendshme të thellë; me të gjitha këto, në të njëjtën kohë, me një tablo të tillë të konsideruar si pamje të një shoqërie ideale, jepen, krahas pohimit të dhënies së çmimeve sublime, kuadri i të qenit komb i përsosur dhe tregohen parimet që do t'i bartnin njerëzit për atje. Nuk e di, a duhet të përsërisim se shtrëngimi në disa rrjeshtat një përmbajtjeje të tillë të thellë që mund të parashtrohet me vëllime, është si të pohojë detin me pika?..

22. Bota është një "hije për të kaluar vapën"

Një hadith tjetër thotë: "Ç'lidhje kam unë me botën? Në botë unë jam si një udhëtar që, pasi është ndalur nën hijen e një peme për të kaluar vapën, e lë atë dhe ikën në rrugën e vet..."³²⁹

Ç'është bota? Si duhet ta trajtojë njeriu situatën përballë gjërave të vdekshme e të përkohshme? Gjithashtu, përse ka ardhur njeriu në këtë botë dhe ku po shkon? Ja temat më të para të filozofisë dhe për të cilat është diskutuar për shekuj të tërë. Siç shihet, këtyre pyetjeve, i Dërguari i Allahut u jep sqarim me një shprehje shumë lakonike. Si marrin trajtën e tyre më të qartë brenda shprehjeve të Profetit çështje si kjo e të ngjashme që të tjerët nuk kanë mundur t' i parashtrojnë në mënyrë kategorike e të qartë në vepra seriale! Po, i gjithë njerëzimi mahnitet për lakonizmin e shprehjeve të Tij...

23. Pesë gjëra që s'u janë dhënë të parëve

”Mua më janë dhënë pesë gjëra që s'u janë dhënë paraardhësve tanë: Ndihma hyjnore për t' i shtënë frikën armikut në zemër qysh një muaj më parë. Toka m'u bë namazgjah* dhe mjet pastrimi. Nisur nga kjo, çdokush që dallon kohën e faljes, le të falet atje ku ndodhet. Ndërsa preja** që nuk i qe quajtur e lejueshme dhe e bekuar askujt para meje, mua m'u lejua. Mua m'u dha edhe e drejta e ndërmjetësimit për falje.*** Secili peygamber para meje qe dërguar

vetëm për popullin e vet, kurse unë u dërgova si përfaqësues për të gjithë njerëzimin."330

Allahu u ka dhënë, përgjithësisht, ndihmë dhe favor të gjithë njerëzve si dhe çdo popull e çdo profeti veç e veç: Hz. Ademit dhe fëmijëve të tij, pastërti shpirtërore dhe emër; Hz. Nuhut, vendosmëri të lartë dhe aftësi për të luftuar dhe përballuar vështirësi; Hz. Ibrahimit, meritën për të qenë ati i shumë profetëve, dashuri për Zotin një e të vetëm, sinqeritet; Hz. Musait, aftësi mësimi e edukimi, dituri shoqërore dhe talent në dituritë shoqërore; Hz. Isait, butësi në marrëdhëniet ndërnjerëzore, durim dhe transigjencë, dashuri dhe dhimbshuri; kurse Hz. muhamedit (s.a.s.), zotërisë së vendit e të kohës dhe ummetit, bashkësisë së tij, u ka dhuruar, përveç gjërave të dhuruara profetëve të tjerë, edhe vullnet, urtësi, drejtpeshim, aftësi për marrëveshje, pajtim e paqë, cilësinë për të qenë universalë. Nisur nga këto, mund të thuhet se feja Islame, në raport me fetë e tjera, është më serioze, zyrtare dhe e përgjegjshme, por edhe më e butë e delikate, më e lartë, më e mbarë dhe e begatshme dhe më njerëzore. Kjo konsiderohet edhe si një nga veçantitë e universalitetit të saj. Kurse hadithi

profetik për të cilin po flasim, na i servir para syve Profetin Islam dhe mesazhin e tij universal duke i trajtuar me një stil më të qëlluar e më me kolorit.

Duke transmetuar në të katër anët e botës këtë sistem universal, përfaqësuesit e parë dhe kumtuesit e nderuar të kësaj feje dhe kauze universale ishin të vetëdijshëm për detyrën dhe e kuptonin përgjegjësinë e tyre; vraponin front më front për t'i dhënë nder botës, luftonin, vrisnin e vriteshin në rrugën e Allahut, tregonin sheshit se ishin të denjë për të hyrë në xhenet e për të parë Bukurinë e Allahut, e përbuznin jetën për hir të kauzës së cilës i kishin kushtuar zemrën; ata digjeshin nga dëshira për të biseduar me Zotin të paktën aq sa të tjerët dëshironin jetën dhe përpiqeshin të realizonin hilafetin mbarëbotëror, kështu që askujt nuk i mjaftonte fuqia për t'u ndeshur me njerëz të tillë që e çonin jetën në një orbitë të tillë marrëdhëniesh me botët e përtejme. Edhe ata që, pa ditur gjë e duke u gënjyer, kishin fatkeqësinë ta hidhnin veten në një rrugë të tillë të rrezikshme, dridheshin nga një frikë që i kapërcente caqet, paralizoheshin që në fillim të rrugës e hiqeshin mënjanë.

Shndërrimi i tokës, i globit tokësor në një faltore për anëtarët e kësaj feje, mundësia që çdo musliman të kryejë adhurimin e namazit, faljes, kudo që të dëshirojë pa ndjerë nevojën e faltores apo të namazgjahut, është një dimension i universalitetit të fesë Islame; po ashtu, lejimi i presë së luftës me qëllim që të mund të sigurohej pa hasur asnjë pengesë zhvillimi i detyrës së xhihadit, luftës e cila do të vazhdonte gjer në kiamet, e drejta e _Pozitës Muhamediane për të ndërmjetësuar për falje për secilin njeri dhe dërgimi i Profetit për të gjithë njerëzimin ndryshe nga profetët e tjerë të dërguar vetëm për popujt e tyre, janë dimensione të tjera të saj.⁸⁶

* Namazgjah: Vendfaljeje.

³²⁹ Tirmidhi, Zuhd, 44; Ibni Maxhe, Zuhd, 3.

** Në origjinal: Ganimet, plaçka e zënë në luftë, plaçkë lufte.

*** Në origjinal: Shefaat.

³²⁰Buhari, Tejemmum, 1; Salat, 56.

Veçanërisht, nga hadithi mundet të nxjerrim, pa hyrë në vështirësi e mundim, këto specifika:

a- Profetësia dhe mesazhi i ardhur me të janë një dhunti hyjnore e tillë që kurrsesi nuk mund të sigurohen me luftë dhe përpjekje.

b- Këto pesë specifika, si merita krejtësisht Muhamediane, nuk i janë dhënë asnjë prijësi apo profeti.

c- Sugjestionimi i frikës në zemrën e armikut nga një largësi e caktuar është shenjë profetësie dhe një dhuratë hyjnore vetëm për ata që kanë jetuar në atë brez.

d- Fakti që adhurimi në fenë Islame nuk është i varur dhe i kushtëzuar nga faktorë të tillë si faltorja dhe shërbyesit e fesë,331 ashtu siç përbën një dimension universal të kësaj feje, ashtu edhe pohon, me anë të lidhjeve Krijues krijesë, lehtësinë për të hyrë në marrëdhënie me Zotin.

Një tjetër specifike e ardhur me mesazhin profetik e që është e dobishme të shënohet këtu, është edhe cilësia pastruese që ka toka, ashtu si edhe uji. Veçanërisht, nuk e di a është nevoja të qëndrojmë mbi rëndësinë e larjes në Islam, mbi

cilësitë pastruese e jetësore të ujit dhe aftësinë tjetërsuese të tokës? e- Meqenëse preja e luftës (ganimeti) në vetvete nuk është e ndaluar (haram), se ligji mbi ndalimin e saj është një provë e lidhur me kohën, pra, e përkohshme, ndërkaq që në kohën e Profetit tonë ishin kapërcyer ose eliminuar specifikat që do të përbënin bazë për ligjin e ndalimit të saj, se, në mënyrë të posaçme, preja është burimi më i rëndësishëm dhe i vetëm i xhihadit, veprimtarisë që do të vazhdojë gjer në kiamet,³³² preja ka një rëndësi të jashtëzakonshme edhe si mjet jetese për ata që ia kanë kushtuar veten luftës, edhe si një shpërblim nxitës, edhe për ta dobësuar materialisht dhe ekonomikisht frontin e armikut e për të mos i dhënë atij mundësi që ta mbledhë veten. Dhe pse është e rëndësishme, është konsideruar normale (mubah) pa u bërë e detyruar (vaxhib); ndërkaq, nuk është as pengesë për principialitetin, një fundament i rëndësishëm ky, në lartësimin dhe përhapjen e besimit monoteist Islam në një mënyrë të denjë për të.

f- Përfitimi nga ndërmjetësimi për falje, një e drejtë... Në dashtë Zoti, për secilin do të ndërhyhet për falje. Por fakti që ndërhyrja për faljen e madhe

në ringjallje, e cila, me universalitetin, karakterin përfshirës dhe cilësinë e saj, ka të bëjë në një masë të caktuar me çdo njeri, i është dhuruar vetëm Atij, është, gjithashtu, një nga specifikat Muhamedianedhe, natyrisht, për ne, pretekst krenarie dhe gëzimi...

g- Dërgimi i profetëve të tjerë si përfaqësues në një kuadër të ngushtë,

fiseve dhe popujve të vet, kurse i Mbretit të Profetëve për të gjithë njerëzimin, madje për të gjithë ekzistencën, tregon se, për rrjedhojë, ndërsa detyra e përfaqësimit e profetëve të tjerë ka qenë e kufizuar në kohë me ekzistencën e fiseve, bashkësive apo popujve përkatës, ky mision i madh që ka lidhje me të gjithë ekzistencën, do të vazhdojë gjersa të ekzistojë bota!⁸⁷

³³¹ Në këtë hadith nënkuptohet se adhurimi nuk është i lidhur me faltoret. për rrjedhojë, me shërbyesit e fesë ose, siç thuhet përgjithësisht, me klerikët.

24. Besimtari është njeriu i përgjegjesisë

"Secili prej jush jeni çobanë dhe mbani përgjegjësi për ata që keni nën administrim dhe kujdes. Udhëheqësi i shtetit është çoban për shtetasit. Çdo kryefamiljar është çoban për individët që ka nën kujdes. Gruaja është çobane e shtëpisë së burrit dhe përgjigjet për gjërat që ka nën kujdes. Shërbëtori është çobani i mallit të të zot dhe përgjigjet për ata që ka nën vete. Secili prej jush jeni çobanë dhe përgjegjës për tufën tuaj."333

Përdorimi këtu i simbolit ”çoban” nisat nga roli dhe figura morale e përgjithshme e tij. Çobani i kullot kafshët që ia kanë lënë amanet, në vendet më të mira dhe më të sigurta, kujdeset thellësisht nga zemra që të mos i hanë egërsirat dhe që të mosi nënshtrohen çfarëdolloj vështirësie, goditjeje apo të keqeje, ka aftësinë që, duke e kryer këtë detyrë, në sajë të natyrës së tij të thjeshtë, të pastër e të papërlyer, të qëndrojë larg dëshirave të këqia dhe, me ndjenjat e dhembshurisë së thellë ndaj tufës, me mëshirën e gjerë që ushqen për të, të vuajë bashkë me të e të kënaqet bashkë me të.

Për të njëjtat marrëdhënie bëhet fjalë edhe midis kryetarit të familjes dhe anëtarëve të saj. Kryefamiljari, siç ka përgjegjësi të parë sigurimin e ushqimit, veshmbathjes dhe një vendbanimi të përshtatshëm për pjesëtarët e familjes së tij, është përgjegjës, gjithashtu, edhe për mësimin dhe edukimin, për bashkëjetesën e pëlqyeshme, për sigurimin e lumturisë materiale e shpirtërore për ta. Kjo është e vlefshme edhe për gruan në raportet e saj me të shoqin. Ashtu si çobani për tufën, edhe gruaja është përgjegjëse për qeverisjen e punëve të

shtëpisë, për mbrojtjen e mallit, pasurisë, nderit dhe dinjitetit të burrit.

Në interesimin dhe mbrojtjen e mallit e të pasurisë të pronarit nga shërbëtori, të pasurisë, nderit dhe dinjitetit të babait nga ibiri, ka, po kështu, ngjashmëri me rolin e çobanit. Mund të thuhet se sipas pikëpamjes fetare nuk ka asnjë përgjegjësi që të mos jetë e tipit të çobanit. Për çdo njeri janë të vlefshme raportet çoban tufë. Edhe nëse një njeri nuk ka një "tufë" për të cilën duhet të kujdeset, ai është përsëri përgjegjës si për një amanet, këtë radhë për egon, mendjen, ndjenjat si dhe për të gjitha organet e trupit, përgjegjësi, kjo, jashtë së cilës, në fakt, nuk ndodhet askush. Mes të gjitha sistemeve shoqërore dhe feve që njohim, Islami është i vetmi rregullim jetësor i cili ka bërë të qartë dhe ka shpallur gjer në imtësi përgjegjësitë e çdo njeriu duke nisur nga udhëheqësi i shtetit e gjer te shërbëtorët që punojnë nëpër shtëpitë tona, për më tepër në një periudhë kur demokracia nuk ishte parë as në ëndrra dhe në këtë fushë është e pamundur të tregohet ndonjë sistem tjetër që të konkurrojë me të.

Profeti Islam thotë "udhëheqësi i shtetit është përgjegjës" dhe radhit një e nga një përgjegjësitë e tij,

kufijtë e tyre, detyrat; u kujton përgjegjësitë burrit dhe gruas dhe u ngarkon secilit përgjegjësi të veçanta në fusha të veçanta; flet për përgjegjësinë e babait ndaj bin't dhe birit ndaj babait dhe tërheq vëmendjen për të drejtat dhe përgjegjësitë e të dy anëve; veçanërisht, po qe se do të kishim parasysh zhvillimet në botë në këtë fushë, duke hapur, në një periudhë shumë të hershme, diskutime mbi përgjegjësitë e punëtorëve, ai propozon zgjidhje për një problem social shumë para tronditjeve shoqërore në historinë njerëzore.

Ja, pra, për ju një tjetër shprehje profetike me pak fjalë mbi dhjetra çështje, qysh nga të drejtat reciproke udhëheqës shteti nënshtetas e gjer te marrëdhëniet punëtor punëdhënës, të cilat zenë vend me vëllime në librat e drejtësisë!⁸⁸

³³² Mexhmeu'z-Zevaid, 1/106.

³³³ Buhari, Xhuma, 11.

25. Disa ndalime* dhe veprime të papëlqyeshme**

”Allahu ua ka quajtur haram kundërshtimin ndaj nënës groposjen e vajzave për së gjalli, moszbatimin e detyrimeve ligjore dhe mospagimin e borxheve, përvetësimin e padrejtë të gjërave. Ai i ka quajtur të shëmtuara thashethemet, pyetjet e shumta andej-këndeje, shpenzimin e pavend dhe shpërdorimin e pasurisë?”³³⁴

Kundërshtimi i nënës

inati kundër nënës dhe kundërshtimi i saj karakterizohet si "rebelim ndaj nënave"*** që nënkupton se i biri që është rebeluar kundër nënës, e

ka braktisur në vetmi duke i prerë të gjitha marrëdhëniet me të. Megjithëse edhe rebelimi kundër babait është i ndaluar në të njëjtën masë, përmendja vetëm e nënës bëhet sepse gratë janë më nevojtare për mbrojtje, janë të dobëta, janë para burrave në dhembshuri dhe, për shkak të delikatesës e të dobësisë natyrore të tyre në qëndresë, janë më shpejt të prekshme ndaj kundërshtimit dhe keqtrajtimit. Në të njëjtën kohë, edhe kundërshtimi ndaj babait që ka të njëjtat të drejta si edhe nëna, quhet rebelim, megjithatë u kujtohet njerëzve se bëmat ndaj nënës kategorikisht nuk do të quhen të barasvlershme me bëmat kundër babait.

Groposja e vajzave për së gjalli

Në periudhën e injorancës, në vende të caktuara dhe në shtresa të caktuara të popullsisë, përgjithësisht, vajzat groposeshin për së gjalli. Ky zakon i egër zbatohet nga dikush nisur nga një zell i çuditshëm injorance, nga dikush për shkak të frikës nga vështirësitë e jetesës, nga dikush për të mos kaluar malli, pasuria dhe mirëqenia e vet te dikush tjetër me anë të vajzës dhe nga dikush tjetër me nxitjen e fisit. Çfarëdo shkaku që t'i lihej kjo, me

çfarëdo nxitjeje që të bëhej, kjo egërsi pa tjetër që duhej ndaluar, u ndalua dhe në themelin e ndalimit të tij janë shumë e shumë urdhra të Kur'anit e të Traditës Profetike.⁸⁹

Tradhtia ndaj amanetit

Në hadith vihen në një plan si refuzimi i të drejtave juridike ikujt, mosshlyerja e borxheve dhe detyrimeve, ashtu edhe marrja dhe përvetësimi i gjërave që nuk duhen marrë: që të dyja janë laram. Dhe harami është tradhti ndaj amanetit dhe së drejtës. Në këtë vijë mund të shpjegohen të gjitha aspektet e këtij konceptimi: moskryerja e detyrimeve si zeqat dhe sadaka, moszbatimi i të drejtave që u

* Ne origjinal: Haram.

** Në origjinal: Mekruh.

334.Buhari, Istikraz, 19; Edeb, 6.

*** Në origjinal: "Ukuk-u ummehat".

përkasin të varfërve dhe, nga ana tjetër, lypja; mohimi i të drejtave që i kalojnë drejtpërdrejt dikujt, mospagesa e çeqeve dhe seneteve, fitimet e siguruara me rrugë ilegale nga falimentimet hileqare gjër të gjitha llojet e spekulacioneve, mosriktimi i të drejtave të të tjerëve, madje këmbëngulja për të vazhduar në këto rrugë të padrejta; shfrytëzimi dhe keqpërdorimi i ndjenjave patriotike e fetare të popullit, kërkesat legale e jolegale, të hapura a të fshehta drejtuar popullit për të grumbulluar ndihma nga një sërë rrugaçësh, grabitja dhe zhveshja me një mijë e një rrugë e popullit nga organizmat mafioze të mëdha a të vogla, etj. Në hadith, njëkohësisht, nënkuptohen edhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve, sjellja ndaj tyre me mëshirë dhe dhembshuri e jo në mënyrë çnjerëzore. Po ashtu, në shoqëri, e cila është një familje e madhe, dënohen vënia mbi gjithçka e interesave dhe shpërblimit të një pjese njerëzish egoistë, tronditja e mendimit mbi ekzistencën e së drejtës, besimit e sigurisë, për rrjedhojë, e rregullsisë dhe ekuilibrit shoqëror.

Thashethemet

Thashetheme u thonë bisedave të kota, të panevojshme e pa asnjë dobi materiale e shpirtërore për njeriun. Thashethemja, qoftë kjo bisedë mbi gjëra që s'na hyjnë në punë, qoftë shprehje që vërtiten rreth gjërave të ndaluara, është një sëmundje shoqërore e shoqërive me individë të përgjumur, me turma të pandërgjegjshme e pa perspektivë, në vartësi, kjo, të nivelit të thashemexhinjve dhe të gjerësisë së fushës ku është shpërndarë thashethemja, si p.sh., në gazeta, revista, radio dhe televizion. Të gjitha pislleqet vrasëse që mund të ekzistojnë ndër ato gjëra që Islami i konsideron gjynahe, mëkate të prodhuara mes dy buzësh, në këtë korijen e thashethemeve blerojnë e zhvillohen. Prandaj edhe i Dërguari i Allahut, duke bashkërenduar edhe të folurit me heshtjen midis disa gjërave të tjera, thotë: "Kush u beson Allahut dhe ditës së ringjalljes, të mos e mendojë komshiun e tij! Kush u beson Allahut dhe ditës së ringjalljes, ta gostisë mikun e vizitorin! Kush u beson Allahut dhe ditës së ringjalljes, ose të thotë fjalë të mira e të dobishme, ose të heshtë!"

Të pyeturit shumë

Pyetjet vend e pa vend ose lypja pa pasur nevojë, që të dyja janë turp, janë të dëmshme. Në Kur'an dhe në Traditën Profetike, ashtu Siç është dënuar lypja pa nevojë, ashtu edhe është quajtur turp pyetja e vazhdueshme dhe kot më kot, ndërkaq, ndjenjat dhe mendimet e njerëzve janë orientuar për të mësuar, në çdo rast të mundshëm, gjërat e dobishme. Krahas kësaj, në Kur'an shohim se pyetjet janë klasifikuar në dy lloje: të pranueshme e të papranueshme.

Të pyesësh apo të mos pyesësh, të lypësh apo të mos lypësh (të kërkosësh apo të mos kërkosësh), janë veprime që do të konsideroheshin të domosdoshme (vaxhib), të palejueshme (haram) ose normale (mubah) nëse bazoheshin apo jo mbi një detyrim apo kërkesë dhe nëse buronin apo jo nga një nevojë. Unë mendoj se trajtimi i përbashkët dhe interpretimi i përbashkët sipas një “kriteri unik”, për të cilin u aludua gjër tani, i këtyre dy çështjeve që duken si të veçanta, do të ishte më i goditur.*

Duke pasur një ngjashmëri me të folurit shumë e pa vend, domethënë me shpenzimin e kotë të fjalëve,

edhe shpenzimi i pasurisë andej-këtej pa pasur parasysh ndonjë dobi materiale.. shpirtërore është një sëmundje individuale dhe shoqërore. Po, shpenzimi pa vend nga dikush i mallit dhe pasurisë së vet, edhe nëse mund të duket në pamje të parë si një dëm individual, nga pikëpamja se në dëmtimin e pasurisë së individit është edhe dëmtimi i pasurisë kombëtare, është një ngjarje që e intereson tërë një komb dhe ku bëhet fjalë për dëmin e një kombi të tërë.

26. Dhurimi**

”Dhurim është ta adhurosh Allahun sikur po të sheh; Ai të sheh edhe pse ti nuk e sheh...”³³⁵

Njësimi i besimit me Islamin, përjetimi i Islamit në kulmin e dhurimit janë tregues të besimtarëve të përsosur. Arritja e besimtarit, brenda besimit dhe Islamit, në një dimension mbibesimor dhe mbiislam dhe çuarja në vend e së drejtës së kësaj pike fundore të arritur janë një dhurim, kurse përgjigjja e Zotit në një mënyrë të përshtatshme me madhështinë e Tij ndaj këtij orientimi, sipas parimit se e mira lind të mirën, është një dhuratë e veçantë e llojit të

surprizave ”që syri s'i ka parë, veshi s'i ka dëgjuar, zemra e njeriut s'i ka ndjerë"...336 Fundja, "përgjegjësja e dhuratës nuk mund të jetë veçse dhuratë!" Ndërsa dhurimi i robit, brenda masës së thellësisë së tij, është sinqeritet, edukatë, respekt dhe frikë, dhurimi i Zotit, sipas madhësisë dhe pasurisë së Tij dhe me një mijë e një përfitime, është pajisja dhe zbukurimi i zemrës së robit me besim dhe ngazëllimi i saj me frymëzim, heqja e perdes nga sytë e robit dhe njohja e tij me të vërtetën e materies, mbrojtja e gjuhës së robit nga kotësitë dhe aftësimi i saj për të folur me plot urtësi, zgjimi i ndjenjave të robit dhe shëtitja e tyre në agimet e kënaqësisë... Besimtari që ka arritur në këtë pikë ku shihet paskuinta e qenies, bëhet sikur e sheh Atë krejt hapur. Por, meqë e zotëron të vërtetën sipas së cilës "T ë parët dhe shikimet (e njerëzve) nuk mund ta përfshijnë Atë" (Kur'ani, En'am: 103), dehet me faktin që Ai e sheh dhe e di, dehet nga kënaqësia për ta parë Atë, nga impresionimi se po shihet prej Tij. Me anë të adhurimit, sinqeritetit dhe përlësisë, ndjen kënaqësinë e bashkimit me mikun ashtu siç ndodh me atë që agjëron, i cili, në çastet kur është i

agjëruar, ndjen në shpirt, bashkë me kënaqësinë e agjërimin, edhe kënaqësinë e çasteve të iftarit...

Po, robi ndjen një kënaqësi të thellë për ta parë atë Sundimtarin Eternal, por edhe për t'u parë dhe vëzhguar prej Tij gjatë shërbimeve të veta dhe qoftë edhe shërbimin më të vogël të bërë për këtë qëllim, e bën mes haresë së një adhurimi të gjerë...⁹⁰

Ja një dritarez në fjalët e Profetit, e hapur lehtë! Ja katër-pesë fjalëza të bekuara si perla nga Mbreti i Fjalës dhe ja një përmbajtje e gjerë që thotë se s'e nxënë vëllimet!..

Ja një pikë nga deti, një molekulë nga dielli dhe disa drita nga botët ku shëtisin yjet!.. Të qëndrosh mbi ato fjalët e përndritshme pasqyrë e shkëlqyeshme e Të Vërtetës muhamediane e të bëhesh interpret i vlerave të tyre, gjithsesi nuk duhet të jetë punë për injorantët që s'dinë se ç' është fjala. Ç'është e vërteta, edhe ne, në këtë çast, një mungesë respekti të tillë jemi duke shfaqur. Në krye e në fund

* Autori e trajton këtu çështjen nga pikëpamja e së drejtës Islame.

** Në origjinal: Ihsan

Zotit i përgjërohem dhe i lutem Atij që të na falë për guxmun.sì në krye patëm parashtruar se trajtimi gjithëdimensional i fjalëve të ndritshme të tij i kapërcente mundesitë tona dhe patëm bërë të qartë se prisnim të dilte i zoti i kësaj pune. Nese pavarësisht nga të gjitha këto, guxuaam dhe provuam te analizojme disa aspekte të disa haditheve, çka guxuaam të analizojmë, qene vetëm disa fjalë të ndritshme nga ajo botë e gjerë e hadithit, edhe për to, ka qenë vetëm për thellësinë e përmbajtjes, strukturën e shëndoshë të shprehjes dhe fuqinë e saj. Dhe me një gjuhë të thjeshtë...

Lus Zotin të na falë dhe kompetentët ta shohin punën tonë me dashamirësi, pa i vënë re të metat! ⁹¹

SPEKTRI I LUTIEVE TE TIJ

Në këtë mes, kërkoj të tërheq vëmendjen tuaj edhe për nja dy lutje të Profetit tonë. Fjalët e përdorura në lutjet e tij dhe thellësia e lutjeve

³³⁶ Buhari, Tevhid, 35.

paraqesin një pasuri krejt të veçantë dhe një pasuri sublime të pamundur për t'u arritur nga të tjerët. Le të themi pa u lëkundur fare se çdo lutje e të Dërguarit të Allahut, përsa i përket gjerësisë së kuptimit që përmban, është e vëllimshme sa një libër. Ashtu siç qëndrojnë fjalët e tij mbi çdo fjalë njerëzore, ashtu edhe lutjet e tij janë shumë më të thella se lutjet që bëjnë e do të bëjnë njerëzit e tjerë. Kjo sepse është i Dërguari i Allahut ai që e njeh Zotin më mirë, që ka frikë më shumë prej Tij. Edhe lutja e tij është një trajtë përfundimtare. Profeti na mëson një lutje të tillë: "Para se të bini në shtrat, merrni abdest si për namaz dhe pastaj lutuni kështu: "Zoti im! T'u dorëzova me frikë (nga ndëshkimi yt) dhe shpresë (prej mëshirës tënde), fytyrën nga Ti e ktheva, për punët Ty të porosita, shpinën tek Ti e mbështeta. Nuk ka mbështetje, nuk ka strehë tjetër veç Teje. U besova Librit që na zbritte, Profetit që na dërgove!"³³⁷

Fjalët e përdorura në këtë lutje janë aq tronditëse, aq turbulluese, saqë është e pamundur të thuhet një fjalë më e lartë se kjo.

Meqë më tej do të bëhet fjalë për lutjet e të Dërguarit të Allahut në një kapitull të veçantë, këtu

do të kursehem në hollësitat duke tërhequr vëmendjen vetëm në lakonizmin e shprehjes.

Një lutje tjetër është kështu: "Zoti im! Më veço mua prej mëkateve

teve të mia siç e ke veçuar lindjen prej perëndimit! Zoti im! Më pastro prej gabimeve siç pastrohet këmisha e bardhë prej papastërtisë!"³³⁸

Shprehjet në këtë lutje mund të shpjegohen vetëm me libra. Dhe nuk po gjej dot fjalë tjetër për të thënë. Po, ai është edhe mbreti i lutjes!

Ja një lutje tjetër e tij: "Zoti im! Kërkoj prej Teje të gjitha gjërat e dobishme që i njoh e s'i njoh, që janë dhuruar e do të dhurohen në të ardhmen! Zoti im! Tek Ti mbështetem prej të gjitha sherreve që njoh e që s'njoh, që u kanë rënë njerëzve mbi kokë e që do t'u bien në të ardhmen?"³³⁹

Ja edhe disa perla të tjera nga lutjet e Profetit (s.a.s.) lidhur me këtë subjekt: "Zoti im! Nuk ka gjë që ta pengojë favorin Tënd! Nuk ka edhe favor kur atë e pengon Ti! Asnjë pasanik nuk mund të bëjë dobi, sepse të gjitha pasuritë janë tek Ti!"

"Zoti im! Nuk kam thënë një fjalë, nuk kam bërë një betim, nuk kam dedikuar një gjë që të mos jetë

dëshiruar më parë prej Teje! Ç'ke dëshiruar Ti, ajo është bërë dhe ç' nuk ke dëshiruar Ti, nuk është bërë! Fuqia është vetëm tek Ti dhe pa dyshim që Ty të mjafton fuqia për çdo gjë! Zoti im! Çdo lutje që kam bërë, le të jetë për atë që e ke mëshiruar Ti dhe çdo mallkim që kam bërë, le të bjerë mbi atë që ke mallkuar Ti! Ti je miku dhe kujdestari im në këtë botë e në botën tjetër; më bëj të vdes si musliman dhe më fut mes robve të Tu të mirë!"³⁴¹

"Zoti im! Duke pranuar të papriturat, por pa pësuar ndonjë dëm prej Teje dhe pa rënë nën goditjen e ndonjë intrigë që do të më kthente nga rruga, kërkoj pas vdekjes të shijoj kënaqësinë e shikimit të bukurisë së një jete të qetë dhe kënaqësinë e bashkimit me Ty! Mbështetem tek Ti për të mos bërë padrejtësi dhe për të mos u goditur nga padrejtësia, për të mos bërë armiqësi e për të mos rënë nën armiqësi, për të mos bërë gabime dhe për të mos rënë në një mëkat të pafalshëm prej Teje!³⁴²

"Zoti im! Po më lë vetëm për vetëm me veten time, më ke shtyrë në dobësi, në nevojtarë, në gabime e në mëkat. Unë i besoj vetëm mëshirës Tënde; m'i

fal të gjitha mëkatet, sepse mëkatet vetëm Ti i fal! Ma prano pendesën, sepse Ti je që i pranon pendesat dhe shumë mëshirues!”³⁴³

“Zoti im! Ti je më i merituari për të t’u kujtuar emri, vetëm Ti e meriton të adhurohesh! Ti je ai që i ndihmon më shumë ata që kërkojnë ndihmë, më i dhimbshuri i atyre që zotërojnë fuqi dhe pasuri! Ti je më bujari për ata që trokasin në portë për të kërkuar diçka dhe më dorëhapuri i dhënësve, i zoti dhe gjykatësi i çdo gjëje! Ti nuk ke ortak! Ti je Qenia e vetme që nuk ka të barabartë e të ngjarë! Çdo gjë përveç Teje është e dënuar të shkatërrohet! Ty të tregohet bindje vetëm me lejen Tënde dhe të kundërshtohet vetëm me dijeninë Tëndel! Bindjen e shpërblen, kundërshtimin e fal! Ti je dëshmitari më i afërt për çdo gjë dhe mbrojtësi i çdo gjëje! Ti i pengon dëshirat e egos dhe i rrok për zverku! I shkrove bëmat e njerëzve dhe ua caktove jetëgjatësinë. Zemrat rrjedhin drejt Teje. Pranë Teje të fshehtat bëhen të dukshme. Hallall, është ajo që Ti e ke bërë hallall; haram është ajo që Ti e ke bërë haram. Fe është ajo që ligjërove Ti; urdhër, ai që urdhërove Ti; krijesë është krijesa jote dhe rob është mbi Yt. Ti je Zoti Mëshirues e Bamirës! Për hir të

bukurisë së fytyrës me të cilën janë ndriçuar qiej e dhe, për hirtë të gjitha të drejtave që janë të drejtat e Tua dhe për hir të robve që kërkojnë prej Teje, të kërkoj falje këtë mëngjes e këtë mbrëmje e të lutem të më mbrosh nga zjarri me fuqinë Tënde!"³³⁴

"Zoti im! Kërkojmë prej Teje çdo gjë të dobishme që ka kërkuari dërguari Yt, Hz. Muhamedi prej Teje; mbështetemi tek Ti për çdo gjë për të cilën Hz. Muhamedi është mbështetur tek Ti!"³⁴⁵

"Zoti im! Mbrohem tek Ti nga dituria që s'jep dobi, nga zemra që s'dridhet, nga egoja që nuk ngopet, nga lutja që s'merr përgjigje!"³⁴⁶

"Zoti im! Kërkoj prej Teje vendosmëri në punën time, qëndrueshmëri në rrugën e drejtë! Kërkoj të Të falenderoj për të mirat e Tua dhe të Të adhuroj mirë e bukur! Dhe dua një gjuhë besnike dhe një zemër të pastër! Mbështetem tek Ti nga shërrit e gjërave që di Ti! Prej Teje e kërkoj dobinë e gjërave që di Ti dhe Ty të shfaq pendim për gjërat që di Ti! Pa dyshim, Ti je Njohësi i të Fshehtave!"³⁴⁷⁹²

³³⁹ Mysned, 6/147.

”Zoti im! Të lutem të më ndihmosh që të bëj punë të mira, që t’i braktis të këqijat dhe t’i dua të varfërit; të lutem të më falësh, të më mëshirosh dhe, kur të dëshirosh për intrigën e njerëzve, të bësh të vdes pa u përfshirë nga intriga! Lus prej Teje dashurinë Tënde. dashurinë e të dashurve të Tu dhe dashurinë e veprimeve që do t’e më afronin te dashuria Jote!”³⁴⁸

”Zoti im! Kërkoj prej Teje fillimin dhe fundin e dobive, ato më të gjerat, të parat dhe të fundit, të dallueshmet e të fshehtat si dhe gradën më të lartë të xhenetit!”³⁴⁹

”Zoti im! Na ndihmo të Të përmendim, të Të falënderojmë dhe të Të adhurojmë bukur e mirë!”³⁵⁰

³⁴⁰ Buhari, Ezan, 155; Myslim, Salat, 205; Ebu Davud, Sadat, 139.

³⁴¹ Mysned, 5/191.

³⁴² Nesai, Sehv, 62; Mysned, 5/191.

³⁴³ Mysned, 5/191.

Zoti im! Lus prei Teje rrugën e drejtë, majtjen nga mëkatet, nder dhe pasuri ndjesore!"³⁵¹

"Zoti im! Na e bëj fundin të mirë në të gjitha punët tona, na mbro nga turpërimi në këtë botë dhe nga ndëshkimi Yt në botën tjetër!"³⁵² ⁹³

Mes këtyre shprehjeve është e pamundur të heqësh qoftë edhe një fjalë të vetmel' Rregullsia në ecurinë e fjalës është një mrekulli, kurse rrokja e dimensionit të lutjes është e pamundur. Po, i Dërguari i Allahut edhe në lutje nuk ka shok!

Të gjithë njerëzit e mëdhenj, në lutjet dhe përgjërimet e veta janë përpjekur të shtojnë ngjyrimet

³⁴⁴ Metheu'z-Zevaid, 10/117.

³⁴⁵ Tirmidhi, Daavat, 89.

³⁴⁶ Myslim, Zikr, 73; Ebu Davud, Vitr, 32.

³⁴⁷ Tirmidhi, Daavat, 23; Nesei, Sehv, 61.

³⁴⁸ Tirmidhi, Tefsim'l-Kur'an, 39; Muvatta, Kur'an, 40; Mysned, 4/243

dhe shpirt me anë të huazimeve prej lutjeve të të Dërguarit të Allahut dhe në portën e Zotit me dorën e lutjeve të tij janë përpjekur të trokasin. Në lutjet e Profetit tonë ka një shprehje, një stil dhe një bukuri të tillë që dallohet menjëherë mes shprehjeve të të tjerëve dhe thuhet: "Kjo fjalë është e Hz. Muhamed Mustafait..."

* Të kihet parasysh se në të gjitha vlerësimet e këtij lloji, autori ka parasysh tekstet origjinale dhe jo këto tekste që po i ofrohen lexuesit qoftë në turqisht, qoftë në shqip të cilat, sado të përkthyer me kujdes, janë mjaft larg tingëllimit në origjin.

Personalisht, duke kënduar lutjet dhe përgjërimet e individualiteteve të tillë si Hasan Shazeliu, Ahmed Bedeviu, Ahmed Rufaiu dhe Shah Gejlaniu, kapërcej vetveten; madje, kur këndoj disa fragmente, edhe nuk përmbahem dot. Edhe lutjet e tyre janë të mrekullueshme, por të gjithë kanë huazuar nga disa lutje të Profetit dhe, duke shtuar lutjet e tij midis lutjeve të veta, kanë arrisur një nivel të lartë pasurie shprehëse. Po ashtu, edhe ne, lutjet e këtyre njerëzve të mëdhenj i sjellim në ndihmë të lutjeve tona dhe trokasim në portën e Mëshirës me shpresën e pranimit të atyre lutjeve.

Si përfundim, themi se tërësia e shprehjeve të Profetit përbën një argument të zgjuarsisë profetike të tij. Kurse disa shprehje, meqë përbëjnë fjalë lakonike, bartin një rëndësi tjetër. Këtu futen edhe trajta e shprehjes dhe stili në lutjet e tij. Atëherë, edhe shprehjet, edhe lutjet janë tregues të logjikës profetike të tij, domethënë të dimensionimit tejtokësor të mendjes së tij dhe burimin prej frymëzimi të tyre. Për rrjedhojë, themi se ai është Profet dhe Mbret i profetëve...⁹⁴

PROFETI I MESHIRE

Edhe mëshira dhe dhembshuria e të Dërguarit të Allahut përbëjnë një dimension të zgjuarsisë profetike të tij. Në mëshirën dhe dhembshurinë e tij, në të njëjtën kohë rri e fshehur një thellësi e veçantë

³⁴⁹ Mystedrek, 1/520.

³⁵⁰ Mystedrek, 1/499.

³⁵¹ Ibni Maxhe, Dua, 2; Myslim, Zikr, 72, Tirmidhi, Daavat, 73, Mysned, 1/416-434-467

³⁵² Mysned, 4/181; Mystedrek, 3/591.

e një konceptimi të mrekullueshëm. Po, Profeti ynë, si përfaqësuesi i vetëm i mëshirës dhe i bamirësisë së Providencës Hyjnore, e pati përdorur si një eliksir ndikimin e këtyre dy attributeve të bekuara dhe pati ngritur fron në të gjitha zemrat. Fundja, nuk ka një pretekst të dytë që ta bëjë të pranueshëm njeriun tek shtresat shoqërore aq sa ç'e bëjnë dhembshuria, bujaria, butësia, sinqeriteti. Ia, pra, i Dërguari i Allahu, me delikatesën e brendshme, aftësinë e mrekullueshme dhe zgjuarsinë e tij profetike ipati vlerësuar shumë mirë mëshirën dhe dhembshurinë si një dimension të veçantë të zgjuarsisë profetike, gjë e cila konsiderohet si një argument më vete i profetësisë së tij.

Allahu (xh.xh.) e pati dërguar atë si mëshirë për të gjitha botët. Dhe ai vazhdon ta reflektojë krejt të shkëlqyeshme mëshirën e Zotit. Sikur ai është një burim uji në mes të shkretëtirës, një hauz begatish dhe çdo njeri vjen me enë në dorë në buzë të atij hauzi, edhe enën e mbush, edhe pi vetë sa të ngopet. Kështu, me atë dimension mëshire, ai është një burim begatish i hapur për çdo njeri. Çdo njeri që do, mund të përfitojë prej tij.

Me zgjuarsinë e tij profetike, mëshirën si pjesë përbërëse të cilësisë së kësaj zgjuarsie ai e ka bërë për shpirtrat nevojtarë të asaj mëshire pothuaj një kurth të ndritshëm që i çon ata në xhenet. Kush hyn në atmosferën magjepsëse të këtij kurthi, e gjen veten në maja.

Ja, pra, mëshira në dorë të të Dërguarit të Allahut një çelës i tillë i magjishëm është. Me këtë çelës pati hapur ai të gjithë drynat e ndryshkur, të mykur e të pandehur si të pahapshëm dhe pati nderur nga një pishtar besimi në çdo gjoks. Po, mes të gjithë njerëzve të botës, ky çelës i artë i është dorëzuar Hz. Muhamed Mustafait (s.a.s.) shpirtartë! Sepse mes njerëzve ai është më i denjë për ta marrë atë çelës! Ashtu është! Gjithmonë Zoti ia dorëzon amanetin atij që është i aftë për ta ruajtur atë. Edhe çelësin e zemrës të cilën ua ka dhënë si amanet njerëzve, ia ka dorëzuar Profetit të të Dy Botëve që është më i afti për atë punë.

Po, Allahu e ka dërguar atë si mëshirë për botët dhe ai e ka vlerësuar këtë amanet në formën më të mirë brenda një drejtpeshimi të mrekullueshëm. Dhe drejtpeshimi në mëshirë është shumë i rëndësishëm.

Ekstremizmi në mëshirë

Ashtu siç ka çdo çështje trajtimin e saj ekstremist, ashtu edhe mëshira ka dy skajet e saj të zbatimit: nënvleftësimin dhe teprimin. Shembullin më tipik të shpërdorimit të mëshirës mund ta shohim në mendimet dhe sjelljet e grupeve masonike. Me diskutimin mbi një dashuri dhe humanizëm të çekuilibruar, në njëerën anë, dhe me mosinteresimin e sinqertë të askujt prej tyre për një besimtar ose fetar, nga ana tjetër, ata përbëjnë shembullin më të gjallë në këtë subjekt. Po, po ta kishin në dorë, ata do të donin t'i mbysnin në një lugë ujë të gjithë muslimanët dhe fetarët. Të dashurit e tyre janë vetëm ata që u besojnë atyre dhe si ata. Edhe kjo dashuri, në të vërtetë, nuk është e pastër në atë kuptim siç e mendojmë ne, ajo është ngritur mbi bazë përfitimi. Mirëpo mëshira e Profetit të të Dy Botëve që zhvilluar tërësisht e orientuar dhe nuk e pati përfshirë vetëm njerëzimin, por të gjithë qenien. Dhe vazhdon ta përfshijë...

Nga mëshira e përfaqësuar nga i Dërguari i Allahut përfitojnë besimtarët. Sepse ndaj besimtarëve ai është "Mirëbërës" dhe "Mëshirues" (Kur'ani, Tevbe: 128).¹ Është i sinqertë, i butë, me zemër dhe shumë i mëshirshëm. Krahas muslimanëve, nga mëshira që përfaqëson ai, përfitojnë edhe hipokritët dhe mohuesit. Madje nga kjo mëshirë edhe Xhebraili ka një përfitim të posaçëm për të.³⁵³ Gjerësinë e kësaj mëshire mateni me këtë që ka ndodhur që edhe shejtani të shohë nga kjo mëshirë e të shpresojë!³⁵⁴

Mëshira e përfaqësuar prej tij nuk u përket njerëzve dhe grupeve të caktuara. Gjithashtu Profeti nuk e përdor mëshirën si pretekst përfitimi, siç kanë bërë të tjerët.

Gënjeshtra e humanizmit

Është një e vërtetë se në ditët tona, një pjesë rrymash, për ta gënjyer njeriun, e përdorin atë si paravan. Ju lutem, ç' ndryshim ka kjo nga afërsia e gjarprit në gjë? Dashuria e përfaqësuar nga i Dërguari i Allahut kategorikisht nuk duhet ngatërruar me të tilla kuptime për dashurinë. Edhe dashuria e Islamit, ashtu siç ndodh në të gjitha çështjet, është e

posaçme, me dimensione tokësore e jotokësore dhe e ekuilibruar.

Hz. Muhamedi (s.a.s.) i ka rrethuar të gjithë njerëzimin dhe të gjithë qenien me një dashuri si një mesazh për ta. Vetëm se, ashtu siç e bëmë të qartë edhe më sipër, dhembshuria e gjerë dhe mëshira e thellë e tij nuk kanë mbetur vetëm si një mendim apo ide në faqet e librave siç ka ndodhur me botëkuptimet mbi mëshirën dhe dhembshurinë e atyre që i shfrytëzojnë dhe i shpërdorojnë këto çështje. Përkundrazi, janë kthyer në praktikë në kohën më të shkurtër dhe janë përfaqësuar me të gjithë thellësinë e tyre. Në fakt, nuk ka asnjë ide të Profetit tonë që të mos ketë gjetur zbatim praktik. Ai është në tërë kompleksitetin e vet njeriu i aksionit dhe veprimit.

Thënie se i Dërguari i Allahut, mendësinë e asaj mëshirës së gjerë që përfshin të gjithë qenien, e ka vënë në shesh në formën më të sinqertë dhe si një kuptim të lartësuar nga gjoksi i qenies, kanë gjetur vazhdimisht zbatim praktik. Për shembull, sjelljen me dhembshuri ndaj kafshëve ai na e tregon me të tillë shembuj konkretë dhe mësimdhënës. Këta dy

shembuj të treguar nga i Dërguari i Allahut duket se s'kanë për t'u harruar:

”Allahu, për shkak të një qeni, e fali një grua të pamoralshme dhe e mori në xhenet. Qeni po kuiste në anë të një pusi me gjuhën të varur nga etja e madhe. Gruaja në fjalë, që mu në ato çaste po kalonte aty pari, e pa gjendjen e qenit dhe nuk mundi të durojë. U afrua menjëherë, hoqi qemerin nga beli, e lidhi me të këpucën, nxori me të një nga pusi dhe i dha qenit për të pirë. Dhe qeni shpëtoi. Ja, pra, kjo sjellje ndaj një qeni u bë pretekst për faljen e gruas të cilën Allahu e çoi në xhenet.”³⁵⁵⁹⁵

Shembullin e dytë por në skajin tjetër, i Dërguari i Allahut na e tregon kështu:

“Një grua hyri në xhehenem për shkak të një maceje. As i jepte për të ngrënë gruaja maces, as për të pirë dhe as e lëshonte të lirë.

* Në origjinal: Rauf, Rahim.

³⁵³Kadi Ijaz, esh-Shifa, 1/17.

³⁵⁴Semerkandi, Tenbihu'l-Gafilin (përkthim), 1/94.

³⁵⁵Buhari, Enbija, 54; Myslim, Selam,

Dhe, kështu, macja ngordhi. Edhe gruaja për këtë shkak hyri në xhehenem.” 356

I Dërguari i Allahut ka ardhur me detyrën e kumtimit të këtij mesazhi të mëshirës së gjerë. Ai është një "Burim uji të ëmbël".* Kush të hedhë në të kovën e kuptimit, gjen mëshirë. Kurse kush pi ujin e jetës prej dorës së tij, ia arrin kuptimisht pavdekësisë.

Eh, sikur t'ia dinin vlerën ata që ndodhen me hir a me pahir në buzë të këtij hauzi begatish! Për të mos i lënë të zhveshura fjalët që thamë, dëshiroj të ofroj disa shembuj konkretë. Vetëm se para kësaj nuk do të rri pa jua tërhequr vëmendjen për specifikën e mëposhtme.

Në çdo gjë ai është në majë

Mes njerëzve, ata që shkojnë shumë përpara në disa profesione, në antagonizëm me këtë, në fusha të tjera janë po në atë raport të prapambetur, aq sa kjo të bjerë në sy.

Për shembull, një oficer apo një ushtar me përvojë të gjatë luftarake, sado të aftë e të suksesshëm të jenë në profesionin ushtarak, disa herë, në disa fusha të tjera mund të mos jenë të kuptueshëm, të ndjeshëm e të dhembshëm as sa një çoban. Për më tepër, disa herë, ngaqë vrasja është bërë natyrë e dytë e një njeriu të tillë, ai mund të mos jetë aspak i dhembshur. Vrit e vrit, ndjenjat i janë verbuar në një masë të caktuar dhe ai mund të mos jetë më në gjendje të ndjejë atë çka ndjen njeriu i zakonshëm nga vrasja e një njeriu.⁹⁶

Një politikan është shumë i suksesshëm në politikë. Vetëm se mund të shmanget nga drejtësia po në atë raport dhe të mos tregojë respektin e duhur për të drejtën e njerëzve. Me fjalë të tjera, mund të bëhet fjalë gjithmonë për një prapambetje në drejtësi e në njerëzi në përpjestim të zhdrejtë me suksesin në fushë të politikës. Kjo ka këtë kuptim:

³⁵⁶ Buhari, Musakat, 9; Mysned, 2/507.

* Në origjinal "Menhelu'l-azbi'l-mevrud".

ndërsa në një vend bën përpjetë në trajtë spiraleje, në një vend tjetër zbret vazhdimisht drejt fundit.

Po ashtu, një njeri që ia ka kushtuar veten rrymës së pozitivizmit dhe që kërkon pa pushim ta mbështesë çdo gjë në eksperimentin dhe përvojën, shihni se në jetën shpirtërore e ndjesore nuk ka mundur ta kalojë zeron. Disa herë, hasen edhe të tillë që, ndërsa në planin mendor lartësohen si maja e Everestit, në jetën ndjesore janë të groposur në një gropë të tillë si Liqeni i Lutit.*

Sa e sa njerëz ka me mendjen të zbritur te sytë, të cilët përpiqen që çdo gjë t'ia kushtojnë materies dhe të cilët, përballë logjikës së revelacionit, janë abdallë e shkuar abdallëve dhe të verbër para kuptimit.

Siç kuptohet edhe nga ky parashtrim, disa njerëz, në kundërshtim me sukseset e arritura në fusha të caktuara, nuk janë treguar aspak të suksesshëm në fusha të tjera shumë më jetësore e të rëndësishme. Me fjalë të tjera, karakteristikat antagoniste të pranishme tek njerëzit sikur veprojnë njëra kundër tjetrës. Ndërsa njëra karakteristikë merr zhvillim, tjetra shkon drejt atrofizimit dhe mbetet e cinguar.

Por nuk ndodh aspak kështu me të Dërguarin e Allahut. Krahas të qenit një luftëtar, ai është njeriu i

dhembshurisë së gjerë, politikan dhe po aq njerëzor dhe i ngrohtë. Ndërsa u jep rëndësi

* Profeti Lut u qe dërguar fiseve të Sodomit dhe Gomorras. Zoti i ndëshkoi ata me një kataklizmë duke e fundosur vendbanimin e tyre, ku pastaj doli një dhe u formua një liqen. vëzhgimit dhe përvojës, qëndron në majë edhe në jetën ndjesore e shpirtërore.

Shembujt më të goditur të kësaj mund t'i gjejmë në luftën e Uhudit. Mendoni se atje ka rënë dëshmor Hz. Hamzai, ungji dhe vëllai i qumështit i të Dërguarit të Allahut të cilin ai e donte si shpirtin. Përtej të rënit dëshmor, trupin ia kanë prerë e bërë copëcopë.³⁵⁷ Po aty, edhe i biri i hallës, Abdullah b. Xhahsh, është grirë si mishi në tavolinën e kasapit.³⁵⁸ Në këtë mes edhe ai vetë është plagosur në kokën e bekuar, i janë thyer dhëmbët, trupi i është bërë tërë gjak.³⁵⁹ Edhe në këtë situatë, kur armiqtë i janë hedhur sipër me zemërim e maraz dhe po bëjnë të gjitha përpjekjet për ta vrarë, ai i lartii të lartëve dridhet nga frika se mos po t' i pikojë gjaku në tokë, Allahu mund ta shkatërrojë krejt fisin e tij, dhe thotë: “Fale, o Zot, fisin tim se nuk më dinë?”³⁶⁰ Ç'kuptim

i jashtëzakonshëm dhembshurie është ky që ai lutet për ata që duan ta vrasin duke mbetur i mbyllur ndaj mallkimit!

Dukej se gjer në triumfin e Mekës nuk pati mbetur ndonjë e keqe që armiqtë të mos kishin punuar kundër tij. Mendoni një herë: do të vendosin bojkot kundër jush, do t'ju përzënë nga vatrat e nga shtëpitë e do t'ju lënë në mes të shkretëtirës, pastaj do të varin një vendim vrasës në murin e Qabes, ku do të jetë shkruar se është e ndaluar marrëdhënia me ju, njerëzit e përzënë, marrja dhe dhënia e vajzave...etj. dhe do t'ju mbajnë tre vjet nën këto kushte mu në mes të shkretëtirës, ku s'do të mundin t'ju ndihmojnë as edhe të afërmit tuaj, kurse ju do të përpiqeni ta shtyni jetën atje duke ngrënë bar; fëmijët e pleqtë do t'ju vdesin nga uria dhe s'do të ndjeni asnjë fije mëshire dhe njerëzillëku; sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, do të nxirreni më pas nga vatani juaj e do të zvarriteni në vende të tjera, ku prapë edhe atje s'do të liheni të qetë dhe çdo ditë do të ndodheni nën një kërcënim të ri; pastaj, në Bedir, në Uhud, në Hendek me dhjetra herë do të përlesheni me ta e do t'ju hiqen edhe të drejta krejt të natyrshme si vizita në Qabe e do të ktheheni pas

duke pranuar kushtet më të rënda. Pastaj, nëse pas kësaj Zoti do t'ju favorizonte e, në krye të një ushtrie të madhe do të pushtonit Mekën e do të vendosnit pushtetin tuaj mbi të, si do të vepronit kundër atyre që ju patën shkaktuar gjithato mundime? A do të mund t' u thoshit "Shkoni, të gjithë të lirë jeni, sot për ju nuk ka qortim!" ? Unë, për hesapin tim, po të mos kisha marrë këtë mësim prej tij, në asnjë mënyrë nuk do të sillesha kështu ndaj tyre. Pandeh se edhe ju të gjithë keni po të njëjtin mendim me mua. Por ai, tek hynte në Qabe i veshur me përkrenare, me shpatën në dorë, me shigjetat në shigjetore duke ngarë kalin me mamuze, ishte, në të njëjtën kohë, një hero dhembshurie. Dhe i pati pyetur mekasit: "Ç'prisni prej meje?" Dhe të gjithë i qenë përgjigjur: "Ti je biri i dhembshur i një babai të dhembshur! Prej teje vetëm bujari pritet!"

Edhe ai pati thënë po ato tjalë që u pati thënë Hz. Jusufi vëllezërve të vet: "Sot nuk ka qortim për ju. Zoti ju faltë! Ai është Mëshirues e Bamirës!361

Gjatë jetës së tij ai kurrë nuk e pati lënë mangut kujdesin. Nuk ka njeri të dytë që t' i ketë trajtuar

ngushtësisht dhe pranë e pranë si ai dorëzimin te vendimi i Zotit' dhe kujdesin.⁹⁷

Duke dalë për betejën e Bedrit, i pati vënë në provë sahabet, pasuesit e tij. Secili prej tyre ishte si një bombë atomike dhe bartnin një tension që do t'u mjaftonte për të përballur një ushtri vetëm për vetëm. Sa'd b. Muadhi i pati thënë: "Ti ngaje kalin po deshe gjer në Berk Gimad, o i Dërguari i Allahut, se qoftë edhe një i vetëm prej nesh nuk do të mbetet pas!"³⁶² Dhe sa kuptimplote që është përsëritja e vazhdueshme e fjalëve të mëposhtme po nga ky njeri: "Ja, ku i ke jetët tona, oi Dërguari i Allahut, merr kë të duash! Ja, ku e ke pasurinë tonë, o i Dërguari i Allahut, merr sa të duash e çoje ku të duash!"³⁶³ Ushtria ishte gati. Secili ishte një Sa'd b.

³⁵⁷ Buhari, Magazi. 23.

³⁵⁸ Ibni Hisham, Sire, 3/103.

³⁵⁹ Buhari, Magazi, 24; Myslim, Xhihad, 100 Ibni Hisham, Sire, 3/84.

³⁶⁰ Buhari, Enbija, 54; Myslim, Xhihad, 104, 105; Mysned, 1/380

Muaz. Megjithatë, i Dërguari i Allahut nuk i linte mangut kujdesin, i kryente një e nga një, pa asnjë mungesë, të gjitha parapërgatitjet që duheshin për një luftë. Pastaj, pas kësaj "lutjeje" praktike, hapte duart dhe me një përgjërime që i ngrihej lart që nga thellësitë e zemrës, fillonte t' i lutej Zotit. Dhe lutej me një vetëharrim të tillë, sa që i binte pelerina, kurse ai s'e ndjente. Hz. Ebu Bekri që e vinte re këtë pamje, i shkante pranë, ia ngrinte pelerinën dhe i thoshte: "Mjaft, o i Dërguari i Allahut! Allahu kurrë s'ka për të të hidhëruar ty, kaq lutje mjaftojnë!"³⁶⁴

Po, kaq masa parapërgatitore, në njërën anë, dhe një dorëzim i tillë tek Zoti, në anën tjetër, është një veçori tjetër karakteristike e tij që i ka rënë në pjesë vetëm këtij njeriu të kulmeve...⁹⁸

Mëshirë universale

³⁶¹ Ibni Hisham, Sire, 4/55; Ibni Kethir, el-Bidaje, 4/344.

* Në origjinal: Tevekkyl.

Ashtu siç pohova edhe në krye të kësaj fjale, Profeti ishte një njeri simbol mëshire nga i cili patën përfituar të gjithë: besimtari, mohuesi dhe hipokriti. Besimtari përfitonte, sepse ai urdhëron: “Unë jam për besimtarët më i afërt se vetja e tyre!” Ç’është e vërteta, komentuesit shprehen kështu: ”I Dërguari i Allahut është për besimtarët më i vyer se jeta e tyre.” Megjithatë, të dyja kuptimet janë të afërta. Ne e duam atë më shumë se jeta jonë. Edhe ai i do në të njëjtën masë ata që ushqejnë një dashuri të tillë për të, sepse ai është njeriu i bujarisë më të madhe!

Kjo është një dashuri gjykimi dhe logjike. Edhe nëse kjo dashuri do të kishte aspekt ndjesor, është më tepër intuitive si dimension dhe logjike si thellësi. Nëse ngacmohet dhe trajtohet, hedh rrënjë të tilla tek njeriu, saqë njeriu fillon ta kërkojë atë vazhdimisht e në çdo vend, ashtu siç kërkonte Mexhnuni Lejlanë. E kërkon dhe, sa herë që t’ia kujtojë emrin, ngashërehet, jetën e kaluar pa të e quan ndarje e vetmi dhe rënkon për të si fyell...

Po, i Dërguari i Allahut është për ne më i afërt se nefs, egoja jonë. E si të mos jetë, kur prej nefsit shohim shpesh të këqia, kurse prej tij pamë gjithmonë bujari, mirësi, mëshirë, dhembshuri. Ai

është përfaqësuesi i mëshirës së Zotit, kështu që është më pranë nesh se vetja jonë.

I Dërguari i Allahut thotë: "Unë për besimtarët jam më pranë se vetja e tyre." (Po deshët, kujtoni këtë ajet të Kur'anit: "Pejgamberi është më i ndjeshëm ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetes së tyre..." Kur'ani, Ahzab: 6). Dhe vazhdon: "Kush lë pasuri, ajo u përket të afërmeve të tij. Por kush lë një borxh e ikën, ai më mbetet mua."³⁶⁵

Pas këtij hadithi fshihet kjo ngjarje:

⁹⁹ 362 Myslim, Xhihad, 83; Ibni Hisham, Sire, 2/266; Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/322.

363 Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/32z

364 Myslim, Xhihad, 58; Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/332; Mysned. 1/32; Ibni Hisham, Site, 2/279.

Një ditë sollën një të vdekur. Do të falej namazi i tij. I Dërguari i Allahut pyeti: "A ka lënë ndonjë borxh?" "Po, O i Dërguari i Allahut" -iu përgjigjën të pranishmit. Atëherë i Dërguari i Allahut tha: "Ju faleni namazin e shokut tuaj, unë nuk mund të fal namazin e borxhliut!" Megjithatë, kjo i kishte rënduar shumë atij. Atëherë u revelua ajeti i mësipërm. Më vonë, kur Profeti iu krijuan disa mundësi, tha: "Unë i dal për zot atij. Kush të ketë për të marrë, le të vijë tek unë!"³⁶⁶

Me cilësinë e tij për të qenë për besimtarët më afër se vetja e tyre, Profeti është mëshirë për ta në këtë botë e në përjetësi. Aspekti i tij si mëshirë do të vazhdojë gjer në pafundësi.

Ai është mëshirë edhe për të pasinqertët ose hipokritët. Në sajë të kësaj mëshire nuk u ndëshkuan ata në këtë botë. Erdhën në xhami, u përsollën mes muslimanëve dhe përfituan nga të gjitha ato të drejta si edhe muslimanët. Profeti nuk e grisi perden në adresë të tyre. Ai e njihte fytyrën e vërtetë të shumicës prej tyre. Madje këto ia pati thënë edhe Huzejfes.³⁶⁷ Siç rrëfëhet, prandaj Hz. Omeri e

ndiqte Huzejfen dhe nuk e falte namazin që nuk e falte Huzejfe.^{368 100}

Megjithatë, Islami nuk i demaskoi ata. Qëndruan vazhdimisht mes muslimanëve kështu që herezia e tyre absolute u kthye, të paktën, në lëkundje e dyshim. Edhe kënaqësitë e kësaj bote nuk iu helmuan krejtësisht. Është e pamundur të ndjejë kënaqësi nga kjo botë një njeri që beson se do të asgjësohet. Por, kur arrihet të mendohet se "ndoshta ka ringjallje" dhe herezia vishet me dyshim, ka mundësi që jeta të mos bëhet krejt e hidhur. E, ja, në këtë aspekt iDërguari i Allahut është bërë, në një farë mase, mëshirë edhe për hipokritët.

Edhe mohuesit kanë përfituar nga mëshira e të Dërguarit të Allahut. Më parë se të dërgohej Profeti Muhamed, Zoti i ndëshkonte me asgjësim të tërësishëm fiset dhe popujt për shkak të mohimit dhe kundërshtimit të tyre, kurse pastaj, këtë lloj ndëshkimi e pati hequr, për rrjedhojë, njerëzit shpëtuan nga shkatërrimi total. Dhe kjo është në këtë botë një mëshirë e madhe për mohuesit.

³⁶⁵ Myslim, Feraiz, 14.

Në lidhje me këtë subjekt, Zoti i drejtohet kështu të dërguarit të Tij: "Allahu nuk do t'i dënojë ata për sa kohë ti do të jesh mes tyre dhe nuk do t'i dënojë ata për sa kohë kërkojnë mëshirë!" (Kur'ani, Enfal: 33)

Po, Zoti, për hir të Profetit, e ka hequr dënimin kolektiv. Ndërsa Hz. Mesihu thoshte "Po qe se i ndëshkon, ata janë robtë e tu" (Kur'ani, Maide: 118), vini re vlerën dhe pozitën e veçantë të Profetit tonë pranë Allahut kur atij i thuhet: "Allahu nuk do t'i dënojë ata për sa kohë ti do të jesh mes tyre..."

Një aspekt tjetër i përfitimit të mohuesve nga mëshira e të Dërguarit të Allahut, është edhe deklarata e tij: "Unë u dërgova si mëshirë, jo si mallkim!"³⁶⁹ (Unë erdha si mëshirë për të gjithë njerëzit, nuk u dërgova si një njeri që do të mallkonte për t'u rënë njerëzve fatkeqësi mbi krye.) Prandaj ka ndodhur që i Dërguarii Allahut ka kërkuar vazhdimisht orientimin në rrugë të drejtë edhe për armiq të më të mëdhenj të Islamit duke u përpjekur pa u ndalur për këtë gjë.

Nga nuri i sjellë prej të Dërguarit të Allahut ka përfituar edhe Xhebraili. Një ditë, Profeti e pyet Xhebrailin: "A është Kur'ani një mëshirë edhe për

ty?” Dhe Xhebraili i përgjigjet: “Po, o i Dërguari i Allahut! Sepse edhe unë nuk kam qenë më parë i sigurt për fundin tim..”³⁷⁰

Në një hadith të tij, i Dërguari i Allahut porositi kështu: “Unë jam Muhamed, unë jam Ahmed, unë jam Mukaffi, unë jam Hashir. Unë jam profeti i pendesës e i mëshirës!”^{371*}

Porta e pendesës është e hapur gjer në kiamet. Sepse i Dërguari i Allahut është pejgamber pendese dhe fjala e tij do të vendosë gjer në kiamet.

Nëse do të shihte ndonjë fëmijë duke qarë, do t'i shkonte pranë e do të qante bashkë me të. Ai e ndjente në ndërgjegje ankthin dhe vuajtjen e një nëne që rënkon. Ja edhe një hadith tjetër i rrëfyer nga Ebu Hurejre dhe dhembshuria e tij legjendare: ”Unë drejtohem në namaz dhe dua të falem gjatë. Pastaj dëgjoj një të qarë fëmije. Meqë e di se ç’emocione do të përjetojë e ëma, e fal namazin shpejt e shpejt dhe ngrihem.”^{372¹⁰¹}

³⁶⁶ Myslîm, Feraiz, 14, Buhari, Istikraz, u; Mysned, 3/311.

³⁶⁷ Buhari, Fezailu’l-Ashab, 20; Ibni Esir, Usdu’l-Gabe, 1/468.

I Dërguari i Allahut e falte namazin mjaft gjatë. Veçanërisht namazet nafile (suplementare) të tij ishin të tilla që e tejkalonin mundësinë e sahabeve, pasuesve të tij. Ia, pra, ai drejtohej për të falur një namaz me qëllim të tillë dhe, nëse gjatë namazit dëgjonte të qarët e ndonjë fëmije, menjëherë e shpejtonte faljen. Atëherë edhe gratë merrnin pjesë në xhemaat për ta falur namazin pas Profetit. Duke menduar se nëna e fëmijës mund të ishte duke u falur, ai e shpejtonte faljen dhe e qetësonte nënën. Ja, kështu e tregonte veten ai, një monument

³⁶⁸ Ibni Esir, usdu'l-Cabe, 1/468.

³⁶⁹ Myslim, Birr, 87.

³⁷⁰ Kadi Ijaz. esh-Shifa, 1/17.

³⁷¹ Mysned, 4/395; Myslim, Fezail, 126.

³⁷² Buhari, Ezan, 65; Myslim, Salat, 192.

dhembshurie në çdo çështje. Megjithatë, ai ishte i ekuilibruar. Për shembull, kjo dhembshuri marramendëse e tij

* Emrat Muhammed, Ahmed (si dhe Mahmud) që vijnë nga një rrënjë e përbashkët, do të thonë "i përlavdëruar, i përzgjedhur". Mukaffi, këtu do të thotë "profeti i fundit". Hashir, do të thotë "mbledhësi, grumbulluesi"; në ditën e ringjalljes njerëzimi do të grumbullohet duke ardhur pas gjurmëve të bekuara të Profetit. asnjëherë nuk i qe bërë pengesë për zbatimin e kufizimeve fetare dhe e pati zbatuar dënimin çfarëdo që të ishte trajta e tij...

Maizi, nga sahabet, pasuesit e tij, i pati shkuar e i pati thënë: "O i Dërguari i Allahut, më pastro! " Profeti i pati kthyer shpinën duke e urdhëruar: "Shko pendohu!" Mirëpo Maizi ngulte këmbë në të tijën. Kërkonte me çdo kusht të pastrohej. Kur e pati përsëritur kërkesën për të katërtën herë, i Dërguari i Allahut e pati pyetur. "Nga ç'gjynah të të pastroj?" Dhe Maizi i qe përgjigjur: "Nga faji i zinasë, o i Dërguari i Allahut!"

Maizi ishte i martuar. Nisur nga kjo, dënimi i tij ishte me vdekje. Profeti i Dy Botëve, sikur të deshte që të nguliste në kujtesa këtë pamje që do të bëhej

një tablo mësimdhënëse për të gjitha kohërat gjer në kiamet, i pati pyetur të pranishmit: "Mos është i çmendur ky?" "Jo", thanë ata. "Maizi është një njeri i mençur!" Profeti pati pyetur përsëri: "Mos vallë është i dehur?" "o", thanë përsëri ata. "Nuk është i dehur!"

Pas kësaj, Profeti i urdhëroi të pranishmit: "Shkoni e ia tregoni vendin..."

Maizi u çua në një shesh ku do të vritej duke u gjuajtur me gurë. Një çast iu dhimb jeta dhe deshi të ikte. Por njëri e arriti, e qëlloi në kokë me copën e eshtrës që mbante në dorë dhe Maizi u shtri përtokë i pajetë. Kur ia treguan të Dërguarit të Allahut sesi kishte ndodhur, filloi të qante dhe tha: "Eh, sikur ta kishit lënë, ndoshta i merrte prapë fjalët..." Atë çast, një nga sahabet, duke e pasur fjalën për Maizin, tha: "E nxori në shesh mëkatin e fshehtë dhe vdiq si

qen!" [Dërguari i Allahut i vrenjti vetullat: "E përgojove shokun! Betohem në Allahun se Maizi bëri një pendesë të tillë që, po t'u shpërndahej të gjithë mëkatarëve në faqe të tokës, do t'u mjaftonte!"³⁷³ Me gjithë këto, ai ishte njeriu i ekuilibrit. Po supozojmë se, po të ringjallej Maizi e të paraqitej tek

ai me të njëjtin jaj, Profeti do ta zbatonte pa u lëkundur fare urdhrin e Allahut!

Njëri prej fisit Beni Mukarrid kishte rrahur shërbëtoren që shkon duke qarë te Profeti. Ai e thirri të zotin e shërbëtores dhe i tha: "E ke rrahur me të padrejtë. Ose jepi lirinë, ose lëre të shkojë!"³⁷⁴ Po, po qe se përgjigjja e kësaj shpulle të padrejtë do të mbetej për në jetën tjetër, shpullat e atjeshme janë më të rënda. Për rrjedhojë, përgjegjësja e shpullës duhet të jetë liri në mënyrë që të vlejë si pagesë për të shpëtuar nga ndëshkimi i xhehenemit.³⁷⁵¹⁰²

Fëmijët

Sidomos dhembshuria e tij për fëmijët qe krejt e veçantë. Shkonte shpesh pranë familjes ku pinte gji djali i tij, Ibrahim, e merrte në prehër dhe e përkëdhelte për një kohë të gjatë.³⁷⁶

Një herë, kur Akra b. Habis pa të Dërguarin e Allahut të marrë në prehër Hasanin dhe Hysenin e t'

¹⁰² * Zina: adulter, marrëdhënie seksuale e jashtëligjshme, shkelje e besnikërisë bashkëshortore.

i përkëdhelë, i tha: "Unë kam dhjetë fëmijë dhe akoma s'kam puthur asnjërin prej tyre!" Kurse i Dërguari i Allahut i dha njëpërgjigje të tillë: "Nuk mund të ketë mëshirë për atë që s'ka mëshirë!"³⁷⁷

Një tjetër hadith është kështu: "Kini mëshirë ju për ata që janë në tokë që të kenë mëshirë për ju ata që janë në qiell!"³⁷⁸

Kurse sipas një rrëfimi tjetër, është kështu: "Po qe se Allahu ta ka marrë nga zemra ndjenjën e mëshirës, ç'mund të të bëj unë?"³⁷⁹

I Dërguari i Allahut ishte plot dashuri dhe mëshirë si ndaj të afërmve, ashtu edhe ndaj miqve të afërt apo të largët.¹⁰³

³⁷³ Myslim, Hudud, 17, 18, 19, 20, 22, 23; Buhari, Hudud, 28; Mysned. 1/238. 2/450, Ibni Maxhe, Hudud, 9.

³⁷⁴ Myslim, Ejman, 31, 33; Mysned, 3/447.

³⁷⁵ Myslim, Ejman, 30.

³⁷⁶ Buhari, Fezailu'l-Ahsab, 63.

³⁷⁷ Buhari, Edeb, 18.

Hz. Aishe tregon:

Sa'd b. Ubade ishte sëmurur. Profeti i shkoi për vizitë këtij miku të besës duke marrë me vete edhe disa nga sahabet, pasuesit e tij Gjendja e rënduar e Sa'd b. Ubades e preku aq shumë, saqë filloi të qante duke i bërë edhe të tjerët të qanin. Por që kjo gjë të mos interpretohej ndryshe, tha: "Allahu kurrë nuk ndëshkon për lotët e syve dhe hidhërimin e zemrës. Por për këtë (dhe tregoi gjuhën) ndëshkon!"³⁸⁰

Po, Allahu nuk ndëshkon për lotët e syve, përkundrazi, edhe e heq ndëshkimin. Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut porositi kështu: "Janë dy sy që nuk i prek zjarri i Xhehenemit, syri i njeriut që qan nga frika e Allahut dhe syri i njeriut që e kalon natën zgjuar në rrugën e Allahut!"³⁸¹

Njëri prej këtyre syve është i "murgut" e tjetri, i "kalorësit"? Janë sytë e atij që, si një murg, e kalon gjithë natën me adhurim e duke derdhur lot, kurse ditën duke u përleshur si luan me mohimin dhe herezinë, domethënë sytë e muslimanit të vërtetë...

Edhe sahabet, pasuesit e Profetit kështu na i përshkruajnë ata: netëve janë të zënë me adhurim si murgjit, kurse gjatë ditës, duke luftuar si luanë, bëjnë që të gjëmojnë të katër anët.¹⁰⁴

Kur vdiq Osman b. Mazi, i Dërguari i Allahut shkoi me vrap. Ai ishte një pasues i famshëm që i Dërguari i Allahut e pati bënë për vëlla. Aq shumë qau. aq shumë lot derdhi mbi kufomën e tij. sa që u bë sikur të ishte larë me lotët e tij. Pikërisht në ato momente, njëra prej grave të të ndjerit, duke e patur fjalën për të, tha: "U bë zog e fluturoi në xhenet!" I Dërguari i Allahut i vrenjti vetullat dhe iu drejtua gruas. "Kur nuk e di unë që jam i Dërguari i Allahut, ku e di ti se fluturoi në xhenet?"³⁸² Po, ai

³⁷⁸ Tirmidhi, Birr, 16.

³⁷⁹ Buhari, Edeb, 18; Myslim, Fezail, 64; Ibni Maxhe, Edeb, 3; Mysned. 6/56.

³⁸⁰ Buhari, Xhemaiz, 45; Myslim, Xhenaiz, 12.

³⁸¹ Tirmidhi, Fezailu'l-Xhihad, 12.

* Në origjinal: Ruhban.

ishite njeriu i ekuilibrit. Dhembshuria dhe e qara kurrë nuk i bëheshin pengesë për të rregulluar ndonjë gabim. Fakti që i hidhej sipër duke qarë njeriut që e kishte bërë vëlla, që e lante me lotët e syve, nuk i bëhej pengesë për t' 1 tërhequr vërejtjen dikujt që kishte thënë një fjalë poetike për atë të vdekur aq të dashur, por që e gjente të pavend. Besnikëria ishte tjetër dhe e drejta, tjetër! Dëshmorët e Uhudit 1 vizitonte çdo javë, por nuk u thoshte "fluturuat e shkuaat në xhenet..."³⁸³

Edhe sikur të themi "po nuk shkuan edhe ata në xhenet, ..." një gjë e tillë... A nuk mjafton vlera që u ka dhënë Profeti atyre që mbrojnë jetimët për të provuar se ç'monument dhembshurie është ai? Shihni se ç' urdhëron Profeti: "Unë dhe ai që kujdeset për jetimin, në xhenet jemi ja, kështu..." dhe i bën gishtat bashkë për të treguar sesa afër është ai me ata që i mbrojnë dhe kujdesen për jetimët.³⁸⁴

Sikur thoshte se në xhenet askush nuk mund t' u futej në mes Profetit dhe njerëzve të tillë.¹⁰⁵

³⁸² Buhari, Xhenaiz, 3; Ibni Maxhe, Xhenaiz, 7; Mysned, 2/355.

Dhembshuri edhe për kafshët

Dhembshuria e tij përfshinte edhe kafshët. Më sipër tregova sesi një grua hyri në xhehenem për shkak të një maceje dhe sesi një grua e përdalë u ftua në xhenet pse i dha ujë një qeni. Le t' i vë pikën edhe kësaj specifike duke sjellë një hadith tjetër.

Muslimanët po ktheheshin nga një luftë. Në kohën e pushimit, disa nga pasuesit shohin një fole zogu, i marrin të vegjëlit në duar e i përkëdhelin. Pikërisht atë kohë vjen zogu nënë, i sheh zogjtë në duart e njerëzve dhe fillon të përpiqet e të vijë rrotull tyre. Kur merr njoftim Profeti, zemërohet shumë dhe urdhëron që të vegjëlit të lireshin menjëherë në fole.³⁸⁵ Po, dhembshuria e tij përfshinte edhe kafshët. Pse, a nuk pati qortuar Zoti njërin prej profetëve për shkak të një foleje milingonash?

³⁸². Buhari, Megazi, 27; Myslim, Fezaii, 30; Nesai, Xhenaiz, 103; Ibni Sa'd. Tabakat, 2/205; Ibni Hisham, Sire, 4/300.

Profeti në fjalë, me të ditur a me të paditur, i kishte djegur milingonat dhe pas kësaj kishte dëgjuar qortimin e Zotit.³⁸⁶ Dhe tani, a është e mundur të sillet ndryshe i Dërguari i Allahut që nai përcjell në këtë ngjarje e të tjera si kjo? Pastaj, nga ummeti, bashkësia e tij, do të përgatiten njerëz të tillë që do të quhen "zotërinjtë që nuk shkelin milingonat". Ata do të vendosnin zile në këmbë që të trembeshin insektet e të iknin... Aman, o Zot!

Ç'shembull dhembshurie dhe mëshire të thellë e të gjithanshme! Po, nga kuadri i mëshirës së tij as milingonat nuk janë përjashtuar. Këta njerëz që nuk shkelnin as milingonat, a mund t'i bënin keq kujt? Jo, ishte e pamundur që t' i bënin keq kujt me dashje a me të ditur!..¹⁰⁶

³⁸⁴ Buhari, Talak, 25; Edeb, 24; Myslim, Zuhd, 42.

³⁸⁵ Ebu Davud, Edeb, 164, Xhihad, 112; Mysned, 1/404.

³⁸⁶ Buhari, Xhihad, 153; Myslim, Selam, 147.

Një radhë kur ndodheshin në Mina, mes gurëve u del një gjarpër. Pasuesit e sulmojnë menjëherë gjarprin që, megjithatë, arrin të largohet. I Dërguari i Allahut që po e vëzhgonte këtë pamje nga larg, tha: "Ai shpëtoi nga sherri juaj, edhe ju shpëtuat nga sherri i tij!"³⁸⁷ I Dërguari i Allahut e quante "sherr", domethënë "të keqe" atë që pasuesit donin t' i bënin gjarprit. Sepse edhe gjarpri kishte një vend në ekuilibrin e botës. Çdo vdekje e çekuilibruar si kjo do ta prishte ekuilibrin ekologjik dhe do të nxirrte në shesh një defekt të vështirë për ta përshkruar. Në fakt, goditja ndaj insekteve në emër të zhvillimit të bujqësisë dhe shkatërrimi i tyre është një krim ekologjik. Aspekti më i çuditshëm i kësaj dukurie në ditët tona është se ky krim bëhet në emër të shkencës!

Ibni Abbasi tregon: "Po shkonim diku bashkë me të Dërguarin e Allahut. Pamë se dikush kishte lidhur një dele për ta therur dhe po e mprehte thikën mu para syve të saj. I Dërguari i Allahut iu drejtua njeriut: "A po kërkon që ta vrasësh disa herë me radhë"?"³⁸⁸

Abdullah b. Xhaferi tregon: "I Dërguari i Allahut hyri në një bahçe duke patur pranë edhe disa nga

sahabet, pasuesit e tij. Në qoshe të bahçes ishte një deve shumë shumë e dobët. Me ta parë të Dërguarin e Allahut, devesë filluan t'i rridhnin lotët çurg. I Dërguari i Allahut i shkoi menjëherë pranë. Ndenji një copë herë pranë saj, pastaj, si e thirri të zotin, e paralajmëroi atë mjaft ashpër që të kujdesej mirë për devenë.³⁸⁹

I Dërguari i Allahut, i mbushur plot e përplot me mëshirë shumë më përtej dashurisë dhe dhembshurisë të pretenduar prej humanistëve në ditët tona, ka ditur ta ruajë këtë mëshirën e tij universale nga çdo lloj ekstremizmi dhe, në sajë të zgjuarsisë së tij profetike të mjaftueshme për çdo gjë, nuk ka rënë kurrë në qëndrime të skajshme!¹⁰⁷

Po, ai kurrë nuk i ka vështruar butë të këqiat në emër të mirëkuptimit, nuk ka ngritur sera mëkatesh e të këqijash. Ai e dinte shumë mirë se mirëkuptimi i treguar në emër të dhembshurisë ndaj një shpirtkeqi e ndaj një kriminel, është dhunim i të drejtës së

³⁸⁷ Nesai, Haxh, 114; Mysned, 1/385.

³⁸⁸ Mystedrek. 4/231, 233.

mijëra njerëzve të pafajshëm. Më duhet ta pohoj me keqardhje se këto lloje padrejtësish po kryhen sot më tepër se në çdo periudhë tjetër. Se në ç'gjendje e pruri atdheun mirëkuptimi i treguar ndaj anarkistëve dhe armiqve të së kaluarës e të të parëve tanë, e pamë mjaft hidhur në historinë tonë të afërt dhe jemi ende duke e parë pjesërisht. Nëse dashuria e dhembshuria nuk përdoren me ekuilibër, mund të lindin për individin dhe shoqërinë përfundime të paparashikueshme e të papërbalueshme. Kurse tek i Dërguari i Allahut është e pamundur të tregosh qoftë edhe një rast të vetëm negativ në këtë drejtim.

Po, ai i donte njerëzit gjer në vetmohim. Fakti që Kur'ani vende vende e korrigjon atë, është një argument i kësaj. Kur'ani i thoshte: "A thua do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pse ata nuk i besojnë këtij Kur'ani?" (Kur'ani, Kehf: 6) A s'e pati burgosur veten ai në një shpellë kur atmosfera e profetësisë pati nisur t'ia trondiste qenien? Edhe revelacioni aty i pati ardhur për herë të parë.

Në fakt, edhe botëkuptimi i Profetit mbi xhihadin buronte nga aspekti i tij si njeri i mëshirës. Sigurisht, njerëzit mund të pësonin humbje vlerash të kësaj bote për shkak të xhihadit, por do të fitonin

aq shumë gjëra në emër të jetës shpirtërore të amshuar, saqë do t' i zbrisnin në zero dëmet materiale. I Dërguari i Allahut i hapte rrugët për në xhenet me majën e shpatës që mbante me vete. Edhe lq'o është një dimension tjetër i dërgesës së tij si mëshirë për botët...¹⁰⁸

Durimi i tij

Edhe durimin ai e përdorte bashkë me zgjuarsinë duke i kombinuar ato dhe në vendin e duhur. Sa e sa maja mbetën në fund të këmbëve, sa e sa zemra të ngurta si ajzbergë, sa e sa shpirta të akullt u shkrinë para atij dielli të durimit dhe u vunë në udhë të drejtë në sajë të këtij faktori! Ebu Sufjani, Ikrime e plot të tjerë... Pse, a do të kishin hyrë ata në Islam po të mos kishte patur tek ai kaq transigjencë e durim?

Po, ai është mëshira e botëve. Kurse ekuilibri i mëshirës tek ai është një tjetër argument i zgjuarsisë së tij profetike.

³⁸⁹ Sujuti, el-Hasaisu'l-Kubra, 2/95;
Hejsemi, Metheu'z-Zevaid, 9/9.

BUTESIA E PROFETIT TONË

(Butësia e shprehive dhe e sjelljeve)

Në pjesën e mëparshme u përpoqëm të tregojmë se Profeti ynë është pasqyra më e përsosur dhe më e shkëlqyer e mëshirës dhe bamirësisë së Zotit. U përpoqëm, gjithashtu, të tregojmë, në mos sipas vendit dhe vlerës së tij, në një hap të vogël dhe cilësisht mjaftueshëm sa për të dhënë një ide se çfarë ekuilibri ruajti ai në mëshirë dhe bamirësi dhe sesi e realizoi këtë ai me anë të zgjuarsisë së tij profetike. Edhe në këtë pjesë do të përpiqemi të paraqesim butësinë e shprehive dhe sjelljeve të shpirtit të zotërisë së qenies lidhur prapë me mëshirën dhe

bamirësinë e tij dhe që konsiderohet, në një aspekt, një dimension i veçantë i tyre.

Butësia është një çelës i artë i veçantë i dhënë të Dërguarit të Allahut. Shumë zemra pati hapur ai me këtë çelës dhe pati ngritur {ron në to. Po të mos ishte kjo butësi e tij, shumë zemra të paafrueshme e të pashkueshme do të përballëshin me një sërë sjelljesh të ashpra dhe, ndryshe me ç'ndodhi në realitet e ç'ndodh, dikush do t' i kundërvihej Islamit e dikush tjetër do të largohej prej tij me ndonjë ndjenjë të pakëndshme. Por këto u parandaluan në sajë të butësisë së të Dërguarit të Allahut dhe të gjithë erdhën duke vrapuar e hynë në Islam...

Po, butësia ishte një ndër atributet më të zgjedhur që i pati dhënë Zoti të dashurit të Tij e që e reflektonte mëshirën ashtu siç ishte. Zoti që e trajton këtë specifikë në një ajet-argument, thotë kështu: "Atëherë, në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butë me ta. Po që se do të ishe treguar zemërashpër e i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje e do të shpërndaheshin, prandaj fali e kërko ndjesë për ta dhe në punët e përditshme këshillohu me ta, por, kur të vendosësh, atëherë mbështetu te Allahu, se Allahu

i do ata që mbështeten tek Ai!" (Kur'ani, Al-i Imran: 159)

Siç kuptohet edhe nga ajeti, butësia vjen nga mëshira. Po që sei Dërguari i Allahut do të ishte i trashë dhe i ashpër në sjellje, të gjithë ata që kishte përreth, do të shpërndareshin dhe iknin. Eshtë mëshira e gjerë e Providencës Hyjnore që e pati bërë atë të butë në sjellje e shprehi. Me fjalë të tjera, aq të përsosur e pati bërë Zoti tharmin e tij dhe aq të butë cilësinë e tij, sa që duart që e prekën atë, kurrë nuk u gërvishtën dhe, atëherë kur pritën të hasin në gjemba, gjetën trëndafila. E kur pati ndodhur që të jenë ngacmuar prej tij zemrat ku pati hyrë dhe gjokset ku ai pati ngritur fron?

Ajeti i mësipërm pati zbritur me rastin e luftës së Uhudit. Megjithëse i Dërguari i Allahut u pati shpjeguar pasuesve gjithë taktikën e luftës së pritshme, madje me të tëra hollësitë, fakti që disa prej pasuesve ende nuk e kishin përvetësuar delikatesën e dëgjimit dhe zbatimit të urdhrit dhe e patën braktisur pozicionin pa urdhër, pati pasuar humbjen e përkohshme të muslimanëve. Ndoshta, duke u nisur nga rezultati përfundimtar, mund të mos i thuhej humbje, por edhe fitore s'ishte.

Lajmi se i Dërguari i Allahut qe vrarë, i pati futur në panik shumicën e muslimanëve. Në këtë mes, atë ditë atje kishte edhe njerëz që mendonin si Enes b. Nadri. Ai u qe hakërryer muslimanëve: ”Po ju, pse po rrini atje ku është vrarë i Dërguari i Allahut?³⁹⁰ Dhe ata ishin hedhur në luftë dhe kishin dhënë jetën për Allahun.. Fundja, ajo ishte rruga: të vraponin në rrugën ku kishte vdekur i Dërguari i Allahut dhe aty të bënin fli jetët!¹⁰⁹

Po qe se do të veprohej sipas urdhrit të Profetit, sipas të gjitha gjasave do të shkohej drejt suksesit dhe do të sigurohej fitorja. Mirëpo një kundërshtim i vogël i treguar, ç’situatë të rrezikshme kishte krijuar dhe sa shumë që e pati ndryshuar përfundimin! Dhe tani le të qëndrojmë një çast mbi këtë pikë e le të mendojmë: po qe se lideri në krye të kësaj bashkësie nuk do të ishte i Dërguari i Allahut por ndonjë tjetër, ç’qëndrim do të mbante ndaj atyre njerëzve që nuk e kishin zbatuar urdhrin ose që i kishin dalë urdhrin kundër? A do të mund të sillej ndaj tyre si të mos

³⁹⁰ Ibni Hisham. Sire, 3/88.

kishte ndodhur gjë? Dhe sidomos po të ishte lideri material dhe shpirtëror i tyre!

Pasuesit, të gjitha gjërat e drejta prej tij i kishin mësuar. Në jetën e tyre, me qindra herë ishin bërë dëshmitarë sesi ai ia qëllonte çdo çështjeje. Ja, pra, ky njeri, qysh në fillim i pati paralajmëruar ata me këmbëngulje që të mos e linin pozicionin. Kurse tani po e vuanin mjaft hidhur ndëshkimin që s'ia kishin dëgjuar fjalën. Përveç dhjetërave të rënë dëshmorë, dukej sikur s'kishte mbetur njeri pa u plagosur. Vetë Profeti ishte plagosur në kokë, i ishte thyer një dhëmb dhe trupi i ishte lyer me gjak. Po, nëse në vend të të Dërguarit të Allahut do të kishte qenë një lider tjetër, a nuk do t'i vërehej, më e pakta, një nervozizëm në fytyrë ose a nuk do të thoshte diçka të tillë, si: "A nuk ju pata thënë që të vepronit kështu e kështu?.." duke ua kujtuar atë që kishte ndodhur? Në këtë momentin më të vështirë, Kur'ani u bëhej pritë mendimeve që gjithsesi mund të kalonin nëpër mendjen e tij dhe i fliste atij me anë të ajetit që përcollëm më sipër.

Ky ishte një moment dhe një situatë delikate që edhe gjesti,

mimika apo veprimi më i vogël që mund të shfaqte lideri, në këtë atmosferë psikologjike mund të shkaktonte ndikime shumë më të ndryshme nga ç'mund të shkaktonte në një situatë normale. Në një moment të tillë kur i duhej shmangur edhe veprimet më të vogël që do t' i prekte dhe thyente ata, Kur'ani i thoshte Profetit: "Po qe se do të ishe treguar zemërashpër e i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje e do të shpërndareshin..." (Kur'ani, Al-i Imran: 159) Kurse sahabet, pasuesit, jo se s'e kishin ndryshuar fare qëndrimin e mëparshëm: tani vërtiteshin përreth të Dërguarit të Allahut si fluturat rreth dritës...

Morali dhe etika e tij Kur'ani ishte.³⁹¹ Edhe ato çka na tregonte Kur'ani ne, ky moral hyjnor ishte. Pse, a nuk bie në sy që, megjithëse njerëzit ngrejne krye dhe e kundërshtojnë vazhdimisht Zotin, Ai vazhdon t' i furnizojë plot me të mira? Ndërsa njerëzit i ngarkojnë Zotit grua dhe fëmijë e kushedi sa shpifje të tjera, Allahu, me mëshirën e Tij, u bën favorizime të shumëllojshme. Çdo ditë, dielli me rrezet e tij dhe retë me lotët e syve që u thonë shi, vrapojnë në ndihmë të njeriut, kurse toka i hap prehrin me lloje-lloje pemësh e frutash, kurse njeriu

iu përgjigjet të gjitha këtyre të mirave me të këqia që s'të shkojnë nëpër mend!

Po, njerëzit nuk i përgjigjen me falënderime dhe mirënjohje as edhe një të milionave të të mirave që u jepen. Ç'e do që Allahu që është i butë, nuk i ndëshkon menjëherë ata, nuk e ndërron zakonet hyjnor për shkak të gabimeve të bëra dhe vazhdimisht jep e jep...

Edhe Hz. Muhamedi (s.a.s.), meqë është emërtuar me këtë emër* dhe është pajisur me këtë etikë e moral, shërben, në këtë subjekt, si

Por jo vetëm ai. Edhe gjyshi i tij, Hz. Ibrahim, kur përshkruhet, me cilësinë e butësisë karakterizohet dhe Kur'ani thotë kështu për të: "Vërtetë, Ibrahim ishte shprehëbutë, i sinqertë e që ia kish kushtuar veten Allahut." (Kur'ani, Hud: 75)

Ibrahim ishte një njeri me shprehë të buta në një nivel mbi të gjitha nivelet. Dridhej edhe për njerëzit që e hidhnin veten në zjarr se mos u vinte ndonjë e keqe. Ai ishte një njeri që mjerohej e rënkonte gjer në mëngjes si dhe që pendohej vazhdimisht. Çdo çast, me një rilindje dhe një krijim përsëpari, u drejtohej shtigjeve të rikthimit te Allahu; pa u ndalur, me zemrën krejt të re dhe të mbushur plot

emocione, i kërrusur më dysh rënkonte në portën e të Zot.¹¹⁰

I Dërguari i Allahut gjithmonë ia përngjasonte veten Hz. Ibrahimit.³⁹² Ashtu është. Në butësi ai i ngjante të gjyshit, Hz. Ibrahimit.

Butësia është një parim shumë i rëndësishëm edhe për të gjithë miqtë e të Vërtetit. Njeriu duhet të silllet me butësi edhe ndaj njerëzve që e presin me egërsi dhe urrejtje në çdo qoshe. Hallaxhi* i falte ata që po ia prisnin duart; jo vetëm që s'i mallkonte ata që e syrgjynosnin egërsisht andej-këndej dhe e sorrollasin burg më burg, por lutej që t'u shpëtohej besimi; lutej dhe tregonte me këtë se ç'favor i nivelit të lartë ishte butësia. Eh, sikur edhe pasardhësit të

³⁹¹ 391 Myslim, Mysafinm, 139; Ibni Maxhe, Ahkam, 14; Mysned, 6/91.

* Me emrin "Halim", sjelljebutë.

pasqyrë e plotë e emrave dhe atributeve të Zotit. A s'i thotë Kur'ani atij: "...shumë i dhembshur e i mëshirshëm ndaj besimtarëve..."? (Kur'ani, Tevbe: 127)

kishin mundur ta kuptonin këtë magji që fshihej te butësia në sjellje!

Po kthehemi sërish te Hz. Ibrahimimi. Armiqtë e hedhin në zjarr, kurse Zoti e urdhëron zjarrin: "O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!" (Kur'ani, Enbija: 69) Pra, as akull, as dhe prush, por, midis tyre, i pranueshëm dhe shpëtim. Edhe Ibrahimimi, ashtu e kishte treguar veten ndaj njerëzve. As zemërohej e tërbohej, as edhe sillej ftohtë ndaj tyre. Ai ishte njeriu i paqes e i shpëtimit. Edhe nga Zoti të njëjtin trajtim pati. E si do të mund të ndodhte ndryshe kur ai ishte i pajisur me moralin dhe etikën e Zotit? Kurrë! "Selam", që do të thotë "paqë, shpëtim", ishte emri i vetë Zotit! Prandaj edhe zjarri u bë i pranueshëm për Ibrahimin, u bë paqë dhe shpëtim!

I Dërguari i Allahut e ngjiti në majë këtë moral dhe etikë butësie të nisur nga Hz. Ibrahimimi. Edhe në kohën kur i pati shtrirë armiqtë përtokë dhe i pati shtënë në dorë të gjitha mjetet e mundësitë, madje, i Dërguari i Allahut nuk u nda edhe një qime prej bujarisë dhe zemërgjerësisë së vet. A do të kishte kush t'i kundërshtonte nëse do t'i ndëshkonte fajtorët? Jo. Ndoshta ishin qindra vetë si Hz. Omeri

që e përgjonin në dritë të syve dhe, para një ndodhie që mund ta hidhëronte atë, duke bulëruar si luanë, kërkonin leje për të prerë koka. Mirëpo në çdo rast ai i qetësonte pasuesit dhe i këshillonte për butësi e paqe.¹¹¹

Një ditë i qe hedhur baltë gruas së bekuar, nderit të së cilës i besonte në mënyrë absolute. Cilitdo muslimani që t'ia bënte shenjë me vetull, mund t'u ikte koka shumë hipokritëve dhe çdo njeri do ta bënte me mjaft dëshirë këtë gjë. Kurse i Dërguari i Allahut me ditë të tëra i gëlltiste fjalët e pëshpëritura si të gëlltiste gjemba, mblidhej e tkurrej, përjetonte

³⁹².Buhari, Enbija, 24, 48; Myslim, Iman, 272.

* Hallaxh-i Mansur: Sofist i famshëm, emri i të cilit haset shpesh në letërsinë e Divanit. Eshtë ekzekutuar me varje më 922. Emrin e vërtetë e ka Hysejin

në ndërgjegje ankthin më të papërballueshëm dhe nuk nxirrte zë në asnjë mënyrë. Kjo gjendje pati vazhduar gjersa pafajësia e të nderuarës Aisheja Besnike qe dokumentuar me Kur'anin.

Të gjithë sahabet, pasuesit, i kishin sytë midis dy buzëve të tij“ dhe prisnin ç’fjalë do të dilnin prej andej. Disa herë ndodhte që para tij të dilnin njerëz të trashë në sjellje ose që silleshin trashë. Sikur ai ta ulte dhe ngrinte lehtë gishtin, njëqind shpata menjëherë ia fluturonin kokën atij njeriu. Kurse ai tregohej i vendosur që t’u përgjigjej gjithmonë me butësi atyre sjelljeve të trasha. Aq i kujdesshëm tregohej ai për të mos trembur kërkënd, saqë kur i jepte dikujt shpatën ose thikën, ia jepte nga doreza.

E si mund të ndodhte që një njeri i tillë, pastaj, t’i merrte jetën pa të drejtë dikujt?

Ai ishte një njeri tepër delikat. Ai shqetësohej jashtëzakonisht nga sjelljet e trasha të njerëzve që i dilnin përballë. Megjithatë, këto lloje sjelljesh ai i hidhte në detin e butësisë së vet, i treste atje dhe, pavarësisht nga çdo gjë, sillej butë. Kaq e gjerë ishte bota e tij ndjesore! Edhe sëmundjet dhe shqetësimet e tjera i përjetonte disa herë më rëndë se ne. Një ditë, kur ishte i sëmurë, Abdullah b. Mes’udi e pati parë

dhe i pati thënë i çuditur: "O i Dërguari i Allahut, ti digjesh si furrë!"³⁹³ Po, aq shumë i ndjeshëm qe bërë i Dërguari i Allahut! Kishte shumë mundësi që një gjilpërë e ngulur në gishtin e tij të ishte shumë herë më e dhimbshme se shigjeta e ngulur në trupin e një tjetri. Kjo ndjeshmëri ka mundësi t'i jetë dhënë atij si domosdoshmëri e detyrës së tij. Sido që të jetë, edhe shqetësimi i një njeriu kaq të ndjeshëm për shkak të sjelljeve të trasha të njerëzve në mjedisin e tij pandeh se do të ishte në raport të drejtë me ndjeshmërinë e tij. Po të ishte ndonjë tjetër kaq i ndjeshëm, disa herë në ditë do ta kthente përmbys mjedisin, kurse i Dërguari i Allahut kurrë nuk pati vepruar kështu dhe nuk vepronte, sepse ai ishte njeri i sjelljes së butë. Megjithatë, duhet

theksuar se butësia e tij ishte e ekuilibruar. Blasfemia e një mohuesi e kërruste nga vuajtja dhe e bënte të qante. Ai bënte ç't' i vinte për dore për ta sjellë dikë në rrugë të drejtë. Por atje ku bëhej fjalë për një dënim ose për t'i treguar vendin dikujt, kurrsesi nuk lëshonte pe, kushdo që të ishte personi, do ta zbatonte pa një pa dy dënimin. Veçse duhet theksuar këtu se asnjëri prej fajeve të dënuara prej tij nuk kanë qenë faje të kryera kundër personit të tij.

Përkundrazi, kurrë nuk ka ndodhur që të mos jenë falur fajet e kryera kundër tij!

Në të njëjtën formë sillej ai edhe në të jetuarit e fesë: për vete zgjidhte gjithmonë më të rëndën, kurse të tjerëve gjithmonë më të lehtë u ngarkonte. Madje namazet sunnet i falte gjithmonë në shtëpi dhe vetëm në mënyrë që ummeti, bashkësia të mos rëndohej dhe të mos i linte shteg kuptimit të tyre si farze, detyrime. Veçanërisht, nuk kishte një njeri të dytë që mund të përballonte gjatësinë e namazeve nafile, suplementare që falte ai. Disa herë agjëronte dy ditë me radhë njëra pas tjetrës, gjë që quhet savm-i visal.* Ai ecte i vetmuar në këtë dhe punë të tjera shumë të rënda që mund t'i përballonte vetëm vetë. Në të vërtetë, Zoti ia pati falur të gjitha mëkatet e kaluara e të ardhshme. Kuptimi i kësaj nuk është formal. Kuptimi i kësaj duhet të jetë ky: Zoti e kishte eliminuar tek ai qysh në krye mundësinë për të rënë në mëkat, gjë për të cilën edhe vetë aludon kur thotë në një hadith lidhur me miraxhin se kishte kaluar një operacion jolëndor.³⁹⁴ Me rastin e miraxhit, engjëjt i kishin hequr një copë nga gjoksi; sigurisht këtu bëhet fjalë për diçka lidhur me nefsën, egon njerëzore. Nga i Dërguari i Allahut kategorikisht nuk qe parë edhe

shfaqja e vetme e ndonjë veprimi Ose akti që mund të konsiderohet gjynah, mëkat. Përkundër kësaj,¹¹²

çdo ditë bënte mbi shtatëdhjetë herë pendim. Më së pari, ai ishte njeriu i thjeshtësisë, vetëkontrollit dhe vetëllogarisë. Meqë në çdo hap të ri i afrohej edhe pak më shumë Zotit në raport me një hap më parë, shihte nga maja e arritur gjendjen e mëparshme dhe pendohej. Me fjalë të tjera, në çdo ditë të re e kujtonte me pendesë ditën e mëparshme. Pandeh se vetëm durimi për t'u ndodhur mes njerëzish i këtij njeriu kaq të pamëkat, është i mjaftueshëm për të treguar gjërësinë e butësisë së tij. Kurse, ndërkaq, ai

³⁹³ Buhari, Marcia, 3, 13; Myslim, Birr, 45; Mysned, 1/381.

* Savm-i visal: agjërime dy ditë me radhë pa ngrënë iftar, gjë që, sipas juridiksionit përkatës, kur kryhet pa pasur ndonjë detyrim, konsiderohet "mekruh", e papëlqyeshme.

³⁹⁴ Myslim, iman, 261; Nesai, Salat, 2; Buhari, Tevhid, 37.

ti qe nënshtruar sa e sa veprimeve të paturpshme, të cilave, gjithashtu, u qe përgjigjur me butësi.

Buhariu dhe Myslimi rrëfejnë prej Ebu Said el-Hudriut: Dikushi i quajtur Zul Huvejsira vjen tek i Dërguari i Madh (s.a.s.). (Siç duket ky person ishte mongol sepse librat biografikë na e portretizojnë me mollëza paksa të dala, me fytyrën të rrumbullakët e pamjetrashë e që të jepte përshtypjen e një mburoje të kalitur). Atë rast Profeti ndodhej në ndarjen e një malli. Personi i qe drejtuar Profetit në mënyrë të paturpshme: "O Muhamed, tregohu i drejtë!" (Po qe se kjo fjalë do t'i thuhej njërit prej nesh, pandeh se do të tronditej seriozisht, ndërsa ne me të vërtetë mund të bëjmë padrejtësi. Kurse personi të cilit i ishin drejtuar këto fjalë, ishte profeti që ishte ngarkuar për të vendosur drejtësinë mbi tokë!).

Hz. Omeri që ndodhet aty, zemërohet shumë nga kjo sjellje e paedukatë dhe i thotë Profetit: "Lërmë, o i Dërguari i Allahut t'ia heq kryet këtij hipokriti!"

Pasi i qetëson Hz. Omerin dhe të pranishmit e tjerë, Profeti i drejtohet personit: "Turp të kesh! Po s'qeshë unë i drejtë, kush mund të jetë tjetër?"³⁹⁵¹¹³

Një rrëfim tjetër është kështu: "po qe se 5' a m i drejtë, do të thotë se jam djegur, jam shkatërruar!"³⁹⁶

Në një rrëfim tjetër këto fjalë janë për personin e jo për veten: "Po s'qeshë unë i drejtë, do të thotë se ti ike, u dogje?"³⁹⁷ Me fjalë të tjera, kërkon t'i thotë se personi duhet t' i shkojë pas profetit në gjithçka e, nëse profeti nuk është në udhë të drejtë, do të thotë se edhe ai që i beson e i shkon pas atij, është në rrugë të shtrembër, pra, i paracaktuar të humbasë!

I Dërguari i Allahut nuk u pati dhënë mundësi atyre që patën dashur ta vrisnin, sepse ai ishte njeriu i sjelljeve të buta. Megjithatë nuk pati munguar të portretizonte në figurën e Zyl Huvejsirasë tipin e një të huaji që në të ardhmen do të përzihej në një intrigë. Po, në bazë të njofimit të Allahut, ai e dinte se kjo racë do t'i sillte shqetësime e ngatërresa në kokë ummetit të tij. Me të vërtetë, paralajmërimet e

³⁹⁵ Myslim, Zekat, 142; Buhari, Edep, 95; Burra-ri, Menakib, 25; Mysned, 3/56

Profetit u vërtetuan qysh në kohën e Hz. Aliut. Pjesa më e madhe e njerëzve që i dolën kundër Hz. Aliut në Nehrivan, qenë njerëz të këtij tipi...

Po, Profeti i Dy Botëve nuk i pati thënë gjë as edhe këtij njeriu. Po qe se do ta luante kokën, ose do t'i përgjigjej qoftë edhe një çast me heshtje kërkesës së Hz. Omerit, vrasja e atij njeriu do të ishte e pashmangshme. Mirëpo Profeti vepronte ashtu siç e mësonte Zoti, prandaj edhe nuk merrej me tipa të tillë injorantësh. Kur'ani i thoshte: "Ti largohu prej injorantëve..." (Kur'ani, A'raf: 199). Me këto fjalë Kur'ani e këshillonte që të mos shqetësohej nga sjelljet e njerëzve të tillë.

Injoranti sillet me injorancë. Kurse Profeti s'ka të bëjë me ta. Prandaj edhe nuk mundet të sillet e të veprojë si ata. Ai është ibutë

në sjellje. Me këtë butësi ai është i predispozuar të ngrejë fron në zemra. Dhe me të Vërtetë, ashtu pati ngjarë. I Dërguari i Allahut, në sajë të butësisë së tij, pati ngritur fron në zemrat e njerëzve për të cilët as që shpresojë. ¹¹⁴

³⁹⁶ Myslîm, Zekat, 148.

Enes b. Maliku tregon: pas luftës së Hajberit, një grua kishte pjekur një qengj, i kishte hedhur helm dhe e kishte ftuar në haje të Dërguarin e Allahut. Pasuesi me emrin Bishr që ndodhej në sofër, kishte vdekur në vend, sapo kishte futur një kafshatë në gojë. Domethënë se kjo grua kishte dashur ta vriste të Dërguarin e Allahut me një helm shumë të fortë.

Aspekti mrekullor i kësaj ndodhie nuk është subjekti ynë tani. Por do të themi se; pasi u ngritën të gjithë nga sofra, gruaja u suall para Profetit dhe pohoi se kishte dashur ta vriste atë duke përdorur këtë mjet.

Në disa rrëfime gruas i atribuohen edhe fjalë të tjera. Pyetjes se pse e kishte bërë këtë, gruaja i është përgjigjur: ”Po qe se ti do të ishe me të vërtetë i dërguar i Allahut, helmi nuk do të vepronte mbi ty.

³⁹⁷ Buhari. Edeb, 95, Menakib, 25;
Myslim, Zekat, 142.

Në të kundërt, do të desha ta shpëtoja njerëzimin nga sherri yt!”

Pasuesit kërkuan që gruaja të ekzekutohej menjëherë. Por Profeti e fali gruan në emër të vet. Kurse për Bishrin nuk tha asgjë.

Ka dy rrëfime mbi fundin e gruas. I pari thotë se trashëgimtarët e Bishrit e vranë gruan sipas shpagimit kokë më kokë. I dyti, edhe ata e falën meqë gruaja u kthye e u bë muslimane. Kështu, hyrja e gruas në Islam qe bërë shkak për shpëtimin e saj.³⁹⁸

E veçanta mbi të cilën deshëm të qëndrojmë këtu, ka lidhje me butësinë e të Dërguarit të Allahut, në sajë të së cilës ai ka falur edhe një grua çifute që ka dashur ta vrasë. Ç’shembull i madh në emër të arritjes së majës në sjelljebulësi. Në kuptim të fundit, periudha e butësisë e nisur me Hz. Ibrahimin, ka arritur kulmin me Mbretin e Profetëve.

Ebu Davud dhe Nesaiu rrëfejnë prej Ebu Hurejres: I Dërguari i Allahut ka biseduar në faltore me pasuesit dhe pikërisht kur po bëhej gati të tërhiqej në dhomën e tij, dëgjohen fjalët e një beduini që ia thoshte duke e tërhequr nga pas për xhybeje: ”O muhamed! Më jep hakun që më takon.

M'i ngarko edhe dy deve, se nuk po jep as nga malli yt e as nga i tyt eti!"³⁹⁸

Ç'poshtërsi, ç'paturpësi që ishte kjo! Duke filluar me thirrjen thjesht në emër e duke vazhduar më tej! Përsëri zemërimi i madhi pasuesve dhe, natyrisht, edhe i Hz. Omerit: "Lërmë t'ia këpus kokën, o i Dërguari i Allahut!" Por i Dërguari i Allahut i urdhëroi përsëri pasuesit: "Jepini ç'do këtij njeriu!"³⁹⁹ Dhe e heshti edhe Hz. Omerin.

Sikur të mendoni vetëm kaq që sjellja e ulët e atij njeriu pati ndodhur pas një bisede të Profetit, është e mjaftueshme për të kuptuar se ç'karakter të ashpër kishte ai njeri. '

Bisedat e të Dërguarit të Allahut nuk i përngjasin kurrë bisedave qoftë edhe të ndonjë prijësi apo udhëheqësi. Akoma më pak mund të jepet ideja për to me këto fjalë të papërpunuara dhe me këto

³⁹⁸ Buhari, hibe, 28; Ebu Davud, Dijet, 6.

shprehje gjysmake si tonat. Por ekziston një e vërtetë që mund ta dijë çdokush: Në bisedat e veta, Profeti, duke hapur një shteg mbi atmosferën e qenies së vet, me zemrën dhe ndërgjegjen të kthyer në pasqyrë të shfaqjeve të reflektuara nga e Vërteta, me një kërcim i nxirrte të pranishmit në maja. Po, edhe pse për një kohë të shkurtër, ata që mund të ndodheshin në prani të tij, kanë pasur mundësi të ngjiten në vendet më të zgjedhura ku mund të arrijë njeriu.

Në praninë e tij ndodhte një purifikim përtej përfytyrimeve dhe kush hynte aty një herë, pothuajse bëhej engjëll dhe ashtu dilte. Dhe në zemër s'i mbetej më asnjë e keqe... ¹¹⁶

Një shembull purifikimi dhe përsosjeje

Më e rëndësishmja prej të fshehtave të faktit se asnjë prej njerëzve të mëdhenjë nuk ka mundur t'i arrijë sahabet, pasuesit e Profetit, është edhe e vërteta e purifikimit dhe e përsosjes. Një personalitet

³⁹⁹Ebu Davud. Edeb. 1; Nesai, Kasame, 24.

i ditëve të sotme, lidhur me këtë të vërtetë, thotë: ”Mendoja vetmevete se pse individualitete të mëdhenj si Muhedhini Arabiu nuk mundën të ngjiten në nivelin e sahabeve. Një ditë, duke falur namaz, Zoti më dha mundësi të kryej një sexhde si të sahabeve. Dhe atëherë e kuptova se ngjitja në nivelin e sahabeve është e pamundur! ”

Ka mundësi që u hap një dritare për këtë personalitet të madh dhe iu bë e ditur se sexhdeja që kishte kryer, kishte qenë një sexhde sahabesh. Këtu është i rëndësishëm thelbi i çështjes. Ky personalitet thotë se do të jepte të gjitha adhurimet e veta vetëm për një rekat namazi të tillë. Mirëpo, kur unë pata parë namazin e një nxënësi nga ata që kishte përgatitur ai, namazin që nxënësi e falte duke e imituar mësuesin e tij, më pati ardhur turp nga namazet e mia! Ia, pra, emri ”sahabe” është emri i një maje të tillë të bisedës profetike.

Namazin, një rekat të të cilit ne nuk arritëm ta falim, ata e falnin vazhdimisht me atë thellësi!

Sepse ata i merrnin mësimet nga vetë i Dërguari i Allahut. Gjithashtu, në atë periudhë, të gjitha çështjet e fesë ishin origjinale e të freskëta. Një ditë dëgjonin ezanin tingëllues dhe kjo mjaftonte për emocionet

dhe entuziazmin e tyre për një kohë të caktuar. Një ditë tjetër, me një tjetër sofër hyjnore u vihej para një urdhër tjetër i fesë pothuajse si një grumbull frutash të freskëta pranverore; edhe këtë radhë, kjo sofër qiellore krijonte tek ta një tensionim të ri...

Megjithatë, pavarësisht nga të gjitha këto ç'u thanë, kishte zemra të ngrira që as në këto kushte e në këtë atmosferë nuk shkrinin dhe këto mundet të silleshin trashë dhe pa respekt ndaj të Dërguarit të Allahut. Kurse ai personalitet i delikatesës dhe butësisë i shihte me transigjencë këto lloj sjelljesh dhe atëherë s'mbetej ashpërsi pa u tretur në oqeanin e sjelljebutësisë së tij.

Po, ai sillej duke llogaritur të sotmen, të nesërmen, të nesërmet... Po që se do të tregohej i ashpër e ndëshkues, të gjithë ç'kishte përreth do të shpërndaheshin e do të iknin prej tij, ashtu siç thotë edhe Kur'ani. Kjo do të thotë se, nëse ata nuk iknin, kjo ndodhte, në një aspekt, si rrjedhojë e butësisë së tij. Ai kishte ardhur jo për t'i thyer njerëzit e për ta shpërndarë shoqërinë, por për t'i çuar të gjithë njerëzit drejt lumturisë së kësaj bote e të jetës së amshuar. Këtë jetë njerëzimi do ta siguronte në rrugën e treguar prej tij. Kjo do të thotë se në

perspektivën e tij ishte amshimi, përjetësia. Edhe ai, sjelljet dhe veprimet e veta sipas një botëkuptimi të tillë mbikohor i planifikonte.

Hz. Halidi ishte një njeri që u pati bërë shumë dëme muslimanëve në Uhud. Mirëpo, kur pati ardhur para Profetit e qe dorëzuar, qe ndeshur me një trajtim të tillë, saqë të nesërmen e pranonte veten pothuajse si një pjesë e të Dërguarit të Allahut. Prandaj edhe fakti që, në këtë mes, nuk qe dërguar në luftën më të parë pas dorëzimit, i pati rënduar shumë dhe pati qarë gjer në mëngjes. Dhe kjo është shumë kuptimplote për të treguar se në ç'nivel ishte lidhur dhe njësuar ai me Profetin vetëm me takimin e parë!

Edhe Amr b. As dhe Ikrime, që të dy, i patën bërë shumë të këqia Profetit më parë. Por butësia e të Dërguarit të Allahut i treti në atë mënyrë, saqë më pas që të dy u bënë si shpata Islame të nderura mbi kokën e mohimit e të herezisë. Po qe se nuk do të ishte marrë parasysh ky nivel që do të fitonin ata në të ardhmen, do të mbetej diçka krejt e pamundur t'i shihje këta njerëz mes sahabëve, pasuesve të Profetit.

Dhe Ibni Hishami që e njeh çdo njeri. Ky pasues që ishte vëllai i Ebu Xhehlit dhe vjehrri i Ikrimes, qe

bërë musliman pak para vdekjes së Profetit. Ibni Hishami që, gjer kur u bë musliman, pati punuar për frontin e mohuesve, madje në radhët e para të tyre, edhe pas hyrjes në Islam, që ndodhur prapë në radhët e para e në pararojë. Si përfundim, në Jermuk trupit i që copëtuar, pati rënë dëshmor e pati vrapuar drejt Zotit të vet. Në çastet e fundit, kur Huzejfetul Adeviu i pati afruar tek buzët paguren për t' i dhënë ujë, që dëgjuar ca më tutje një zë i mekur që kërkonte ujë. Ibni Hishami e pati shtyrë paguren duke bërë me shenjë që t'i çohet atij. Hollësitë e mëtejshme janë të njohura për të gjithë ne... Edhe kur ky personi i dytë po çonte paguren te buzët, që dëgjuar një zë tjetër që kërkonte ujë, kështu që edhe ky, pa pirë, e kishte shtyrë paguren për tek i treti me të cilin pati ndodhur prapë e njëjta gjë. Përfundimisht, që të tre këta patën mbyllur sytë pa pirë as edhe një pikë ujë!⁴⁰⁰

Të interesohesh për tjetrin, të vuash për tjetrin... Karakteristika e shquar, e vyer e të Dërguarit të Allahut. Edhe sahabet, pasuesit e Profetit, më të shquarit në purifikimin dhe përsosmërinë shpirtërore, për të cilën po flasim, në interesimin dhe vuajtjen për tjetrin. Po, Profeti jetonte për t'u dhënë

jetë të tjerëve dhe bënte sakrifica të tilla që të linin pa mend. Pse ishte ai i tillë, pa ishin edhe pasuesit e tij. Kurse shembulli që sapo dhamë, s'është veçse njëri prej mijërave... Zejd b. San'an tregon:

"I Dërguari i Allahut pati marrë borxh prej meje. Atëherë unë ende s'isha bërë musliman. Shkova tek ai para ditës së caktuar dhe kërkova borxhin. Për më tepër, Profetit i thashë: "Ju të bijtë e Abdylmuttalibit jeni shumë përtacë në dhënien e borxhit!" Omeri iu përgjigj ashpër këtyre fjalëve të mia: "O dushman i Allahut! Po qe se s'do të kishim marrëveshje me çifutët do të ta kisha fluturuar kokën! Fol me edukatë me të Dërguarin e Allahut!" I Dërguari i Allahut pa nga unë e buzëqeshi. Dhe iu kthye Omerit: "O Omer, jepja hakun këtij njeriu. Dhe shto edhe njëzet sa'* pse e trembe!"

Vazhdimin e ngjarjes e tregon Hz. Omeri: "Pas urdhrin të të Dërguarit të Allahut, u ngrita dhe u vura për udhë për t'i dhënë Zejd b. San'anit ato ç'i duheshin dhënë. Dhe gjatë rrugës ai më tha gjëra të cilat as që i prisja:

"O Omer! E di, m'u zemërove shumë për fjalët që thashë. Por po të them tani se tek ai pashë gjithçka thuhet për profetin e fundit në Testamentin

e Vjetër. Atje është një shprehje e tillë: "Durimi i tij e ka kaluar paditurinë e tij. Ashpërsia dhe dhuna e injorantëve vetëm se e shton butësinë e tij." Dhe unë prandaj i thashë ato fjalë, për të marrë vesh nëse butësia e tij është si në Testamentin e Vjetër, apo jo. Tani e besoj se ai është vetë profeti që pati paralajmëruar Testamenti i Vjetër! Që prej këtij çasti edhe unë e besoj se ai është profet dhe dëshmoj për këtë!⁴⁰¹¹¹⁷

I Dërguari i Allahut përsëri me butësinë e tij e pati zbutur zemrën e dijetarit çifut Zejd b. San'an duke u bërë shkak që edhe ai të hynte në fenë e së vërtetës, Islam.

Po, i Dërguari i Allahut ishte shprehi e sjelljebutë në përmasa të pamundura për t'u përballuar nga të

⁴⁰⁰.Mystedrek, 3/242.

* Sa': Njësi mase drithi prej një mijë derhemësh.

⁴⁰⁰. Sujuti, el-Hasaisu'l-Kubra, 1/26; Ibni Haxher, el-Hisabe, 1/566; Ibni Kajjim elXhevziye, Za du'l-Mead, 1/59; Mystedrek, 3/604.

tjerët. Vetëm se kjo gjë ishte e ekuilibruar dhe e orientuar tek ai. Ndërsa sillej gjithmonë me butësi ndaj çdo sulmi dhe reagimi të keq ndaj tij, i Dërguari i Allahut ashpërsohej si një luan përballë padrejtësisë së kryer ndaj një tjetri dhe s'i binte kurrsesi zemërimi gjersa e drejta të shkonte në vend. Kushdo që të bënte një padrejtësi dhe ndaj kujt do që të bëhej ajo, qëndrimi i tij ishte gjithmonë po njëlloj. Sidomos nënvleftësimi i urdhrave fetare e revoltonte aq shumë, sa që nuk dinte të qetësohej. Dhe kjo është pohimi i hapur i faktit se ç'njeri i ekuilibrit ka qenë ai! Këto dy mënyra reagimi e sjelljeje që duken si kontradiktore, ishin aspekte qiellore të personalitetit të shquar të Profetit tonë. Dhe tani, le të përpiqemi të parashtrojmë nja dy shembuj konkretë për specifikat që bëjnë fjalë, sa për të dhënë një mendim.

Buhariu dhe Myslimi përcjellin prej Ebu Mes'ud el-Bedriut:

”Një ditë, një pasues u paraqit te Profeti. Ky pasues ankohej për personin që Profeti e kishte dërguar dhe urdhëruar t’u printe në namaz atyre që mbeteshin pa ardhur në faltore se personi në fjalë që ishte, pra, imam, i zgjaste shumë namazet e agimit.

Pasuesi i tha kështu Profetit: "O i Dërguari i Allahut! Për shkak të tij më në fund nuk do të mund të shkoj në xhemaat. Sepse i zgjat shumë namazet!"

Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut vrenjti vetullat, u ashpërsua, hyri në faltore, hipi në minber, në vendin e predikimit, dhe u tha të pranishmëve: "O njerëz! Po i detyroni njerëzit t'ju urrejnë! Kush prej jush do të drejtojë faljen, ta bëjë të lehtë atë, sepse mes jush ndodhen edhe të moshuar, të sëmurë dhe nevojtarë..."⁴⁰²

Edhe vetë Profeti e respektonte një gjë të tillë. Disa herë namazin e falte gjatë, kurse disa herë, në përputhje me gjendjen e xhemaatit, e falte shumë shkurt.

I Dërguari i Allahut e donte shumë Muaz b. Xhebelin. Vetëm se, kur një herë i qenë ankuar për të se i falte namazet shumë gjatë, i pati folur ashpër këtij pasuesi që e donte aq shumë: "A mos je ngatërrestar ti? A mos je ngatërrestar ti? A mos je ngatërrestar ti?"⁴⁰³

Usame b. Zejd, i cili gjatë një lufte komandonte një repart kalorësie, e pati vrrarë një njeri pse e kishte

dëgjuar të thoshte "sebe'tu"* me qëllim për të treguar se ishte bërë musliman, duke konkluduar se njeriu ishte shprehur ashtu nga frika. Sipas një rrëfimi tjetër, ky njeri, madje, kishte shqiptuar Fjalën e Dëshmisë! Vetëm se, në e pati thënë fjalën e parë, do të thotë se nuk ishte bërë musliman. Ose, në pati dëshmuar, këtë e pati bërë prej frike. Kështu mendonte Usame, por, kur në kthim, çështja i ishte bërë e njohur të Dërguarit të Allahut, ky e pati thirrur menjëherë pranë dhe e pati marrë në pyetje. Dhe Usame ia pati treguar ngjarjen pa ndryshuar asgjë. Atëherë i Dërguari i Allahut që zemëruar aq shumë, sa pati filluar ta qortonte atë duke i përsëritur të njëjtën pyetje me çka tregonte sesa shumë ishte mërzitur prej ndodhisë: "A mos ia hape zemrën e ia pe?" Aq shumë ia kishte përsëritur këtë pyetje, sa që Usame që turbulluar gjer aty sa pati thënë: "Eh, sikur të mos isha bërë musliman gjer më sot e të mos i kisha dëgjuar këto fjalë?"⁴⁰⁴ e ky Usame ishte rritur në prehër të Profetit i cili e donte po aq sa edhe Hz. Hasanin dhe Hysenin.

Një ditë, Ebu Dheri i drejtohet Bilalit me këto fjalë: "O i biri i zezakes!" Pasi Bilali' shkoi te Profeti duke qarë e i ankohet, ky e thërret Ebu Dherin dhe e

qorton rëndë duke i thënë: ”Tek ti ka akoma shenja injorance!”⁴⁰⁵

Pas një polemike midis Hz. Ebu Bekrit dhe Hz. Omerit, ky i fundit që e ka prekur Hz. Ebu Bekrin, është thirrur nga Profeti për të dhënë shpjegime, pas të cilave e drejta i është dhënë Hz. Ebu Bekrit, megjithëse Profeti e donte shumë Omerin.

Nga këto dhe nga qindra shembuj të tjerë të ngjashëm me këto, kuptojmë se edhe atributi i butësisë tek Profeti ishte në dimensione të ekuilibruara si edhe atributet e tjera. Si edhe në çështje të tjera, këtu ai përfaqësonte përsëri plotësisht Rrugën e Drejtë.” Profeti i Dy Botëve që ishte njeriu i butësisë dhe transigjencës së gjerë ndaj edhe reagimeve më të parregullta të bëra ndaj personit të tij, kurrë nuk pajtohej edhe me padrejtësinë më të vogël të bërë ndaj një tjetri dhe kushdo që të ishte personi fajtor, pa diskutim që do ta thërriste dhe do ta çonte të drejtën në vend!¹¹⁸

⁴⁰⁴ Myslim, Iman, 158; Ibni Maxhe, Fiten, 1.

* Bilali: I quajturi Bilali Etiopias, zezaku i parë musliman dhe ai që

MIRESIA, BUJARIA DHE THJESHTESIA E TIJ

Para se të hyjmë në temë, dëshiroj të bëj një kujtesë të vogël. Në një kapitull të veçantë bëmë fjalë për atë që quhej fetanet, zgjuarsia profetike me të cilën nënkuptojmë logjikën profetike para së cilës mendja ngec dhe falimenton.

Të gjitha logjikat mund të ngecin në një vend, dituritë dhe shkencat mund të mos e kalojnë një pikë të caktuar, por është vetëm zgjuarsia profetike që përkufizuar më sipër, e cila shpalos krahët si një pëllumb dhe kapërcen maja që duken si të pakapërcyeshme. Dhe kjo është një argument më vete i profetësisë së Tij.

ka kënduar ezanin e parë në historinë e Islamit.

⁴⁰⁵ Buhari, Iman, 22.

* Në origjinal: Sirati Mustakim. Është një përcaktim i Kur'anit në kapitullin e parë, "Fatih".

Fundja, këtë jemi duke bërë; me të gjitha specifikat që po trajtojmë, po përpiqemi të rrokim profetësinë e Tij.

Të shohësh durimin te Profeti, është e pamundur të mos pranosh se ai është i dërguari i Allahut. Në fytyrën e durimit të tij është shkruar e vërteta "Muhamedi është i dërguari i Allahut" dhe këtë të vërtetë e lexon e gjithë bota serioze dhe e matur. Vetëm i dërguari i Allahut mund të jetë ai që u vë gjoksin rreziqeve kështu, që nxjerr gjoksin para ngatërresave me këtë botëkuptim.

Kur e ndjekim atë në mëshirën e tij, përsëri na del përpara si diell fytyra dritëplote e po kësaj të vërtete. Sepse i Dërguari i Allahut është i hapur ndaj një dhembshurie që mund të quhet e pasosur dhe është i më i ngarkuar me mëshirë e dhembshuri se retë me shi, më produktiv. E thënë shkurt, ai s'është tjetër veçse mëshira e gjithësisë.

Mëshira e tij nuk ka mbetur e kufizuar vetëm për njerëzimin. Ndoshta i gjithë universi ka përfituar nga kjo mëshirë dhe po përfiton. Dhe do të përfitojë gjer në kiamet. Edhe ne u kthjem e u kthjem për ta vështruar të zotin e kësaj mëshire të gjerë duke përjetuar në ndërgjegjet tona emocionet e pëllumbit

që ka humbur të vegjëlit e kthehet vazhdimisht te foleja dhe në fytyrën e tij u përpoqëm të shohim e të tregojmë misionin e tij profetik!¹¹⁹

Si të fundit, u përpoqëm të prezantojmë butësinë e tij duke vënë në dukje se ajo është një dimension i mëshirës së tij. Të gjitha këto, dimensione më vete të zgjuarsisë së tij profetike janë. Kjo zgjuarsi kuptohet përfundimisht vetëm kur të trajtohet me këto dimensione veç e veç.

Një fragment nga mirësia dhe bujaria e tij

Një dimension i veçantë i mëshirës, për rrjedhojë, i zgjuarsisë profetike, është edhe mirësia dhe bujaria e të Dërguarit të Allahut. Dhe tani le ta shtjellojmë pak këtë specifikë.

Me fjalën kerem në arabisht emërtohen së bashku cilësitë e mirësisë dhe të bujarisë tek karakteri

* Në original: Kerem ve Tevazuu;
Kerem: mirësi, bujari; Tevazu:
thjeshtësi, modesti

i njeriut, domethënë prirja dhe dëshira për të bërë mirë e për të dhuruar.

Ndër arabët, kerem është një cilësi shumë e pëlqyeshme dhe e kërkuar nga të gjithë. Sidomos kur të trazoni poezinë e periudhës së injorancës, do të shihni se arabi i atyre kohëve krenohej me këtë: "... dhe therëm për mysafirin. kaq e aq dele, kaq e aq qe, kaq e aq deve..." Gostia e shtruar miqve, në përgjithësi, gostitja e miqve ishte për ta pretekst krenarie dhe në këtë fushë të zakoneve e traditave të tyre fiset bënin garë me njëri-tjetrin. Natyrisht që bujarinë, garën në bujari dhe çdo gjë që bënin, në këtë kuadër, ata e bënin për llogari të egoizmit. Ja, pra, në një kohë kur mirësia dhe bujaria kishin marrë zhvillim të madh dhe sundonin në rend të ditës, mes tyre doli një Person bujar mbi çdo bujar. Kur njerëzit panë se ç'ishte bujaria e tij, iu zu gjuha e iu ngeci fjala në gojë. Ky Person mirëdashës e bujar e bënte çdo gjë për hir të Zotit; edhe sikur botën t'i falte ndokujt, nuk thoshte qoftë edhe një fjalë për këtë! Për më tepër, nuk i pranonte aspak lavdërimet e poetëve që u jepnin vend në poezitë e tyre vargjeve ku përshkruhej bujaria e tij dhe ato lavdërime ia

dedikonte Allahut që ishte "Ekremul Ekremin", "Më Bujari i bujarëve"!

Ai ishte një pasqyrë e shkëlqyer që emri "Kerim", "Bujar" i Zotit e tregonte veten duke u shfaqur tek ai. Si në çdo subjekt tjetër, edhe këtu ai paraqitej si kalifi, përfaqësuesi i Zotit në nivelin më të lartë dhe nuk mund të tregohet një njeri i dytë në faqe të tokës që të ishte më bujar se ai.

Hz. Muhamedi (a.s.) është rruga e bujarisë, kurse bujaria është rruga e xhenetit. Kurse kopracia është një rrugë që e çon njeriun në xhehenem. Edhe ata që e shihnin nga larg Profetin e Dy Botëve, e njihnin menjëherë prej karakteristikave që kishte dhe thoshin ky është Ai... Mendimtari i madh i këtij shekulli* e quan atë "Ndihmësi i Madh".** Ai është udhëzuesi i vetëm i rrugës së xhenetit. Pa e pyetur atë, nuk mund të shkohet në xhenet. Po s'u fut në llogari ai, të gjitha llogaritë kthehen përmbys. Hz. Muhamedi (a.s.) është një kurth llogarie që i ngatërron të gjitha llogaritë njerëzore dhe një çelës llogarie që i zgjidh të gjitha llogaritë e ngatërruara. Ne huazojmë për të një prej titujve të Krijuesit dhe e quajmë Bujari i Bujarëve, sepse ai është një njeri që me bujarinë e tij

e ka kapërcyer normalen njerëzore dhe në bujari është çiraku i vetëm i Zotit.

Me bujarinë e tij ai pati hyrë në zemrat në të cilat s'pati mundur të hynte me karakteristikat që u përmendën më parë. Mëshira e tij që kthyer në avull krejt si një re, që lartësuar gjer në pikën e dëndësimit dhe, pastaj, në trajtën e bujarisë, pati reshuar në gjë të gjithësisë. Pati reshuar dhe e pati zbutur çdo gjë që që lagur prej saj duke përgatitur kushte për mbirjen dhe rritjen kudo të embrioneve e të filizave. Me fjalë të tjera, shpirtrat me butësinë i pati fituar, kurse me bujarinë pati ardhur e pati ngritur fron në to. Po s'i trajtuat këto të dyja bashkë, nuk mundeni ta kuptoni një aspekt të rëndësishëm të tij.

Po të kishte dashur, ai mund të bëhej njeriu më i pasur i botës. A nuk ia patën propozuar këtë Kurejshët qysh në ditët e para të shpalljes së profetësisë së tij me kusht që të hiqte dorë prej kauzës së vet? Edhe më pas, gjërat që jepnin muslimanët në rrugën e Allahut, gjithë nëpër duart e tij kalonin. Dhuratat e ardhura prej sundimtarëve nuk kishin të llogaritur. Mirëpo ai kurrë nuk pati menduar të merrte prej tyre ndonjë gjë për vete, madje as nuk e pati shkuar nëpërmend një gjë të tillë!

Ai e konsideronte veten vazhdimisht si një udhëtar dhe jetonte me mendimin se në një të ardhme të afërt do të emigronte nga kjo botë. Sipas tij, bota ishte një pemë nën hijen e së cilës bëhej një pushim gjatë një udhëtimit të gjatë...¹²⁰

Në qe kështu, atëherë duhej ta preokuponte zemrën me gjërat specifike të cilave me të vërtetë u duhej dhënë rëndësi. Gjithashtu duhej t' u mësonte njerëzve rrugët që çonin te të qenit njeri. Do të rrinte sa të rrinte nën hijen e kësaj peme dhe pastaj do të vazhdonte në rrugën e vet.⁴⁰⁷ Qëllimi dhe objektivi ishin të lartë. Afrimi tek Zoti ishte qëllimi i tij më i parë dhe detyra për t'i çuar njerëzit te i njëjti objektivi, detyra më e parë e tij. Ja, për këtë vuante e digjej ai! E ç'rëndësi mund të kishte pasuria e kësaj bote për një njeri në një pozicion të tillë? Sigurisht që asnjë rëndësi. Atëherë, s'e vllente të interesoheshe për të...

* Bediuzzarnan Said Nursi (1873-1960)

** Në origjinal: Javer-i Ekrem.

Për jetën vetiake ai pati zgjedhur varfërinë. Kjo nuk donte të thoshte se donte që edhe çdo njeri tjetër të ishte i varfër. Por ai nuk e shihte të pëlqyeshme edhe atë që njerëzit të sundoheshin e të nëpërkëmbeshin prej stomakut. Fundja, në sajë të atij njeriu të madh qenë bërë muslimanët brenda një kohe shumë të shkurtër populli më i pasur i botës. Mes tyre nuk gjenin njeri për t'i dhënë sadaka dhe zeqat. Aq e lartë ishte mesatarja e të ardhurave për person. Megjithatë, mes tyre kishte asketë të tillë të dhënë pas adhurimit që, nëse në shtëpi u ndodhej haje për një ditë, nuk e pranonin gjënë e dhuruar sado tërheqëse që të ishte. Kjo është një çështje vetëmohimi, një çështje shpirtlartësie. Është ashku për t'u dhënë jetë të tjerëve. Është ideali për të mohuar kënaqësitë e jetës. Gjithashtu është e pamundur që ta kuptojnë këtë njerëzit që nuk njohin këto ndjenja, që nuk i përjetojnë në tërë intensitetin e vet ato.

Në një sofër iftari, Hz. Ebu Bekrit i jepet një gotë ujë të ftohtë. Kur e çon gotën te buzët, ngashërimi ia zë grykën. Të pranishmit e pyesin se ç' i ndodhi. Dhe ai u përgjigjet.

Një ditë, edhe të Dërguarit të Allahut i ishte dhënë një gotë ujë të ftohtë dhe ai ishte ngashëryer pasi e kishte pirë, kishte kënduar ajetin kuranor "Atë ditë do të merreni në llogari për të mirat që u janë dhënë" dhe kishte thënë se do t'u kërkohej llogari edhe për atë gotë ujë. Edhe Hz. Ebu Bekri këtë kishte kujtuar dhe ishte ngashëryer.⁴⁰⁸¹²¹

Ndërkaq, Hz. Ebu Bekri çonte një jetë mjaft të thjeshtë e të varfër.

Llogaria që do të jepte, ishte mjaft e lehtë. Edhe pse ishte e lehtë, për shumë kohë ai u përpoq të siguronte jetesën e familjes së vet duke u marrë me mjeljen e bagëtive të të tjerëve. S'dihet pse më pas iu lidh një rrogë, por edhe atë e quajti shumë. Ai pati caktuar si masë për vete jetesën e njeriut më të varfër të Medinës. Nisur nga kjo, paratë që tepronin, i fuste në një shtambë dhe atje i mblidhte. Kështu i pati mbledhur të gjitha ç'pati marrë gjatë kalifatit të tij prej dy vjet e gjysmë. Kur do të vdiste, pati lënë si porosi që ajo shtambë t'i dorëzohej kalifit që do të

⁴⁰⁶ Ibni Hisham, Sire, 1/285.

⁴⁰⁷. Buhari, Rikak, 3.

vinte pas. Kur u bë kalif Hz. Omeri dhe urdhëroi të thyhej shtamba, gjeti aty monedha të vogla dhe një letër për kalifin pasardhës, ku thuhej: "Këto para janë teprica prej rrogës që më qe dhënë si kalif. Unë pata marrë për kriter jetesën e njeriut më të varfër të Medinës dhe paratë e tepruara i kam mbledhur në këtë shtambë. Për rrjedhojë, këto para i përkasin thesarit të shtetit dhe atje duhet të vendosen!"

Kur e këndoi letrën, Hz. Omeri qau dhe tha: "Barrë shumë të rëndë u le pasardhësve, o Ebu Bekr!"⁴⁰⁹

Një jetesë të tillë kaq të përkorët Hz. Ebu Bekri e pati mësuar prej Hz. Muhamedit (a.s.) i cili u pati treguar në praktikë, me anë të jetesës së vet, atij dhe pasuesve të tjerë se një jetë e tillë ishte e mundur.

Mendoni se Profeti kishte të drejtë, madje edhe me fermanin e Zotit, që të merrte një të pestën e presë së luftës. E thënë ndryshe, preja ndodhej nën administrimin e tij. Kompetenca për ta përdorur atë si ta shihte vetë me vend, i ishte dhënë atij nga ana e Zotit.¹²²

⁴⁰⁸ Myslim, Eshribe, 140; Ebu Nuajm, Hilje, 1/30.

Kurse Hz. Omeri do të hynte një ditë në shtëpinë e tij dhe nga keqardhja do të qante. Dhe, kur Profeti do ta pyeste se pse qante, do t'i përgjigjej:

”O i Dërguari i Allahut, ndërsa Kisra, mbreti i botës, noton në pasuri, ti nuk ke as edhe ç'të shtrosh nën vete përveç një rrogozi dhe të duken në trup gjurmët e vendit ku ke rënë... Kurse gjithësia është krijuar për ty...”

Atëherë i Dërguari i Allahut do t'i jepte këtë përgjigje:

”A nuk do të deshe, o Omer, që bota t'u mbetej atyre dhe përjetësia neve?”⁴¹⁰

Por duke i thënë këto fjalë, Profeti nuk i thoshte si fjalë të një varfanjaku i cili nuk ka mundësi të jetojë ndryshe, si fjalë dëshpërimi të thëna në pesimizëm nga dikushi i dhënë pas jetesës së mirë. Ashtu siç e thamë edhe më lart, po të kishte dashur, ai mund të ishte bërë njeriu më i pasur i botës. Shihni, po jua prezantoj sa për shembull se vetëm një e pesta që i takonte atij nga preja e Hunejnit,

⁴⁰⁹ Taberi, Tarihu'l-Umem ve'l-Mylyk, 4/252.

përbëhej si më poshtë: 40.000 dele, 24.000 deve, 6.000 robër, 4.000 okë argjend.⁴¹¹

Po qe se do të kiheshin parasysh edhe pasuritë e zëna gjatë luftërave të tjera si dhe dhuratat e mbretërve, do të shihej se atë s'e pengonte asgjë për të jetuar në mirëqenie të plotë. Kurse ai bënte jetën e njeriut më të varfër. Ato që i binin në dorë, ia shpërndante që të gjitha popullit, sepse ai ishte mishërim i mirësisë e i bujarisë

dhe një njeri kaq mirëbërës e bujar s'mund të ishte tjetërkush veçse i dërguar i Zotit! ¹²³

I Dërguari i Allahut përfaqësonte tipin e njeriut më të ekuilibruar përsa u përket raporteve midis pamjes së jashtme dhe asaj të brendshme. Ashtu siç të impresiononte pamja e tij e jashtme dhe siç të magjepshte, pothuaj, bukuria e tij, po në atë masë i

⁴¹⁰ Buhari. Tefsir, (66), 2; Myslim, Talak, 31.

⁴¹¹. Ibni Sa'd Tabakat 2/152.

tërhiqte njerëzit ai edhe me pamjen e tij të brendshme.

Hz. Enesi thotë: "I Dërguari i Allahut ishte më i bukuri i njerëzve!"⁴¹² Ashtu është, ai ishte më i bukuri i njerëzve edhe në pamje, edhe në botën e tij të brendshme!

Hz. Xhabir b. Themure tregon kështu për mbresat e veta: "Një natë po rrinim në faltore. Ishte pikërisht nata e katërmëdhjetë e hënës.* Ajo ndriçonte me tërë shkëlqimin e vet mbi kryet tona. Atë mes në faltore u fut i Dërguari i Allahut. Unë po shihja herë hënën, herë fytyrën e tij. Betohem se fytyra e të Dërguarit të Allahut ishte më e shkëlqyer!"⁴¹³

Edhe Hz. Aisheja e shpreh kështu ndjenjën e saj në lidhje me të: "Kur gratë e Egjith panë Jusufin, prenë duart. Po të kishin parë zotërinë tim, do t' i kishin ngulur në gjoks thikat që mbanin në duar!"

Nedimi thotë: "Një guri të Stambollit, gjithë pasuria e të huajve i bëhet kurban!" Po që se do ta njihje të Dërguarin e Allahut, do të thoshte: Edhe një fijeje të vetme floku të të Dërguarit të Allahut, gjithë njerëzimi i bëhet kurban...

Ai ishte më i bukuri injerëzve. Dhe Enesi vazhdon: "Ai ishte më bujari i njerëzve!" I Dërguari i Allahut që ishte në pamje "Ahsenu'n-nas" (më i bukuri i njerëzve), me zemrën dhe vullnetin ishte "Exhvedu'n-nas" (më bujari i njerëzve)!⁴¹⁴

Sipas pohimit të Ibni Abbasit, veçanërisht në muajin e Ramazanit ai bëhej bujar si të ishte një erë që mbledh e merr me vete çdo gjë që gjen përpara.⁴¹⁵ E thënë ndryshe, i shpërndante edhe gjërat e fundit që mund t'i kishin mbetur në dorë. Kjo ishte një çështje shpirti dhe vullneti. Ai nuk jetonte për vete, ai jetonte vetëm për të tjerët! Duke menduar gjatë gjithë jetës vetëm për të tjerët, nuk i kishte mbetur rast të mendonte për vete. Fundja, për

⁴¹² Myslim, Eezail, 48 (Nga Enesi); Buhari, Menakib, 23 (Nga Berai).

* Hënës së plotë ne i themi "Hëna më pesëmbëdhjetë".

⁴¹³ Sujuti, el-Hasaisu'l-Kubra, 1/123; Kenzu'l-Ummal, 7/168.

⁴¹⁴. Myslim, Fezail, 48.

të nuk ekzistonte kënaqësi që do ta bënte të lumtur sa t'i shihte të tjerët të lumtur. Në vetmohimin e tij, prapë radhën e fundit shtëpia e vet, të afërmit e vet e përbënin. Interesimin e fillonte, së pari, nga më të largët dhe e përfundonte tek të afërmit. Nëse do të ndahej preja e luftës, përparësia u përkiste familjeve të dëshmorëve të Bedrit dhe Uhudit. Dhe u thoshte vazhdimisht njerëzve të shtëpisë së vet: "Pa 11 dhënë atyre, juve s'mund t'ju jap asgjë!"⁴¹⁶

Ai ishte, gjithashtu, më trimi i njerëzve, ishte njeriu që s'e njihte frikën. Në jetën e tij s'ishte parë që të kishte frikë a të druhej prej diçkaje apo prej dikujt përveç Allahut. Përkundrazi, atëherë kur njerëzit frikësoheshin e strukeshin, ai bulëronte si luan dhe sulmonte i vetëm edhe mbi armiqtë më azganë,⁴¹⁷ gjë të cilës do t'i rikthehemi më tej.

Le të kthehemi prapë te butësia e tij. Po, sa e sa zemra të drynosura, të pamundura për t'u hapur me çelësat e sjelljebutësisë e të ndjenjave të tjera të larta, i qenë hapur aty për aty Profetit me anë të çelësit të bujarisë. Njëra prej këtyre zemrave, Safvan b. Umejje.

Hz. Enesi tregon: "I Dërguari i Allahut, para se të nisej për në Hunejn, pati huajtur armë prej këtij

personi. Pastaj, pas mbarimit të luftës, Safvani po rrinte e po shihte i mahnitur e i rrëmbyer kah preja e asaj lufte. Qëndrimi i tij pati tërhequr vëmendjen e të Dërguarit të Allahut. Dhe i pati thënë njeriut: "Le të jenë të tuat ato deve që po të pëlqejnë!" Pas kësaj i pati dhënë edhe gjëra të tjera. Safvani që shtangur para një bujarie të tillë. Ky njeri me zemrën plot antipati dhe urrejtje ndaj Profetit, pati ndërruar aty për aty. Bujaria e tij e pati distancuar prej antipatisë dhe urrejtjes dhe Profeti i Dy Botëve që bërë në çast njeriu më i dashur mes njerëzve për të. Sigurisht, të fitoje Safvanin, ishte shumë më e rëndësishme se mijëra deve e që. Edhe i Dërguari i Allahut kishte bërë atë që ishte më e rëndësishme, më me vlerë. Me të vërtetë, kjo bujari e treguar ndaj Safvanit nuk pati mbetur pa rezultat. Ai pati shkuar menjëherë te fisi i vet e u pati thënë: "O njerëz të mi! Vraponi e hyni në Islam! Hz. Muhamedi jep në mënyrë të tillë, që mund të japë vetëm një njeri që s'frikësohet nga varfëria e që e beson plotësisht Allahun!"⁴¹⁸

Po t' i kërkohej ndonjë gjë, e jepte, po të mos i ndodhej, e premtonte. Disa herë pati qëlluar, madje, që dikush t'i kërkonte edhe këmishën e vetme që

kishte veshur dhe ai ia pati dhënë pa u lëkundur aspak. '

Një herë, një beduin i pati kërkuar diçka dhe i Dërguari i Allahut ia pati dhënë. Personi i pati shkuar dhe i pati kërkuar përsëri dhe i Dërguari i Allahut përsëri i pati dhënë. Radhën e tretë, me që s'pati patur ç't' i jepte, i pati premtuar se në rastin më të parë që t' i binte në dorë diçka, do t' i jepte. Kjo situatë e krijuar e pati mërzhitur jashtëzakonisht Hz. Omerin, e pati shqetësuar shumë për shkak të shqetësimit të krijuar për të Dërguarin e Allahut. Qe ulur në gjunjë para tij e i pati thënë: "Të kërkoj dhe i dhe. Të kërkoj prapë dhe prapë i dhe. Të kërkoj edhe një herë tjetër dhe i premtove. Mos e fut kaq në mundim veten, o i Dërguari i Allahut!"

Vetëm se këto fjalë nuk i patën pëlqyer aspak Profetit. Abdullah b. Huzafetu Sehmi që pati parë t'i vrenjten lehtë vetullat, qe ngritur në këmbë dhe e pati qetësuar me këto fjalë: "Jep, o i Dërguari i Allahut dhe kurrsesi mos kujto se Zoti do të të lërë të varfër dhe do të t'i presë të mirat!" I Dërguari i Allahut pati ndenjur një copë herë iheshtur dhe pastaj i pati thënë: "Ja, pra, për këtë jam urdhëruar unë!"⁴¹⁹

Sa bukur që shprehet Ferazdak: jashtë faljes ai kurrë nuk tha ”jo! ” Të mos ishte kjo, buzët e tij do të thoshin vetëm ”po!” *

Po, kaq i shkrirë, kaq i njësuar ndodhej ai me ”po”-të! Ai i përgjigjej në çast çdo kërkese të bërë në kuadrin e gjërave të lejueshme** dhe i jepte personit atë që ikërkonte.¹²⁵

Po, Mbreti i Profetëve edhe në bujari ishte i pangjashëm, ishte i vetëm dhe bujaria e tij e këtyre përmasave vetëm me profetësinë e tij mund të shpjegohej!

⁴¹⁵ Buhari, Savm, 7.

⁴¹⁶ Buhari, Deavat, 11; Ebu Davud, Edeb, 100; Mysned, 1/136.

⁴¹⁷ Myslim, Xhihad, 78.

⁴¹⁸ Ibni Hisham, Sire, 4/135; Ibni Haxher, el-Isabe, 2/187; Mysned, 6/465; Kenzu'l Ummal, 10/505; Myslim, Fezail, 57.

E si të mos ishte Profeti bujar kur bujaria është një shprehje që të afron tek Zoti? Kurse në afërsinë ndaj Zotit ai kishte lënë pas edhe vetë Xhebrailin!¹²⁶

⁴¹⁹ Ibni Kethir, el-Bidaje, 6/63.

* Në namaz, në ndejtjet ulur këndohet një lutje ku përfshihet edhe Fjala e Dëshmisë, La ilahe illallah, Muhammedu'r-Resulullah, Nuk ka zot tjetër veç Allahut, Muhammedi është i dërguari i Tij! Siç shihet, pohimi i qenies së Allahut fillohet duke mohuar (me fjalën la, nuk, jo), më parë, ekzistencën e çdo lloj hyjnie tjetër, e çdo lloj politeizmi. Ky është parimi i pohimit duke përjashtuar dhe mohuar më parë, është parimi i kalimit nga mohimi në pohim, i pranuar edhe nga të gjitha filozofitë. Duke kaluar te çështja që kemi në shqyrtim, themi se edhe "jo"-ja e vetme që përdorte në atë moment të faljes Profeti, ishte preludi i një pohimi, madje, esencial!

** Në origjinal: Sher'i daire, Kuadri i Sheriatit.

Profeti porosiste: "Bujari është afër Allahut, xhenetit dhe njerëzve, kurse kopraci ndodhet larg Allahut, xhenetit dhe njerëzve dhe afër Xhehenemit."420

Librat e përshkruajnë pemën e Tubas* me rrënjët lart dhe degët të lëshuara poshtë. Unë nuk mund ta di nëse ashtu është vërtetë, por nuk kam aspak dyshim se i Dërguari i Allahut është për ne një pemë e tillë bujarie xheneti që varet mbi ne duke na rrethuar me bujarinë e tij! Ai që strehohet nën degët e tij, ai që kapet pas degëve të tij, bëhet pëllumb e fluturon për në xhenet!

Në këtë subjekt, Profeti urdhëron kështu: "O njerëz! Allahu zgjodhi Islamin si te për ju. Atëherë edhe ju, shoqërinë që keni me Islamin, forcojeni me bujari dhe moral të bukur!"

Islami rrotullohet nëpër orbitën e bujarisë dhe moralit të bukur. Edhe sikur të mos keni asnjë aspekt përsosmërie, përsëri mund t'i kapni lartësitë shpirtërore me anë të moralit të bukur.

Dhe bujaria është një prej disiplinave të moralit të bukur. “Kushtojuni Islamit me bujari dhe moral të bukur! Bujaria është si një pemë. Me rrënjët në xhenet dhe degët të varura mbi tokën tonë. Kushdo që jeton nën atë pemë dhe sillet me bujari, shpejt a vonë kapet pas njëres prej degëve të saj dhe ngjitet për në xhenet, atje ku ndodhen rrënjët e saj!”⁴²¹

Nëse kopracia është një mungesë ekuilibri, një qëndrim ekstrem, edhe shpenzimi i kotë e i tepërt është një qëndrim ekstrem në kahje të kundërt. Që të dyja janë mungesë ekuilibri. Zgjuarsia profetike e përdor bujarinë për lartësimin e Islamit. Ashtu siç pati hyrë Profeti ndër zemra me anë të mëshirës dhe sjelljes së butë, ashtu pati hyrë edhe duke përdorur gjërat që ia pati dhuruar dhe favorizuar Allahu dhe pati hapur edhe zemrat që mendoheshin si të pamundura për t’u hapur.¹²⁷

⁴²⁰ Tirmidhi, Birr, 40.

* Tuba: një pemë hyjnore me rrënjët përpjetë dhe degët poshtë që i bën hije gjithë xhematit.

⁴²¹ Kenzu’l-Ummal, 6/571.

Hz. Hatixheja, nëna jonë, është gruaja e parë e zgjuar në Islam. Dhe vetë fjala "hatixhe" do të thotë "e lindur herët". Ajo pati lindur pesëmbëdhjetë vjet para Profetit dhe, po ashtu, në Islam më herët se çdo njeri tjetër.* Shihni përputhjen midis kuptimit të emrit dhe personalitetit të saj! Kjo grua që pati qenë ndër njerëzit më të pasur të Mekës, e pati shpenzuar të gjithë pasurinë e vet për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, aq sa, kur pati vdekur, nuk i pati mbetur gjë as për t'i blerë edhe një copë qefin! Gjithsesi, Profeti do t'i ketë blerë qefin me para të marra borxh, gjë që, sipas meje, edhe paravdekja, edhe pasvdekja e asaj gruaje të madhe ashtu duhet të ishin. Para se të hynte në Islam, ajo kishte qenë legjendare për pasurinë e saj dhe gjithë ajo pasuri ishte shpenzuar gjer në qindarkën e fundit në shërbim të lartësimit të Islamit.⁴²² Dhe kjo ishte një shembull më vete i "Rrugës së Drejtë".** I Dërguari i Allahut e pati përdorur bujarinë me një zgjuarsis të tillë, sa që edhe

një thërrime e saj nuk pati shkuar kot, por qe kthyer pas në trajtën e forcës së Islamit...¹²⁸

Dhe thjeshtësia e Tij

Edhe përulësia dhe thjeshtësia e tij, si dimension më vete i zgjuarsisë së tij, shkëlqejnë si yll. Sa më shumë t'i shtohet popullariteti e të pranohej nga të tjerët, aq më shumë thellohej thjeshtësia e tij. Dukej sikur përulësia dhe thjeshtësia kishin lindur bashkë me të. Po ashtu, ato e shoqëruan gjer në vdekje duke u zhvilluar gjithmonë e më shumë. Eshtë Hz. Muhamedi (a.s.) ai që ka thënë se "Allahu e lartëson atë që tregohet i thjeshtë"⁴²³ dhe që e ka zbatuar dhe përfaqësuar thjeshtësinë në trajtën më të mirë.

* Hz. Hatixheja është muslimani i parë në historinë e Islamit, i pari njeri që i pati besuar Profetit dhe i pati dhënë besën atij.

422.Ibni Kethir, el-Bidaje, 3/158, 159.

** Në origjinal: Sirati Mustakim.

Ai gjithmonë e pati parë veten një njeri si të gjithë njerëzit dhe asnjëherë nuk e pati diferencuar veten prej të tjerëve.

Sigurisht, pozitat dhe funksionet nuk duhet ta ngashnjëjnë njeriun dhe nuk duhet ta bëjnë që të humbasë mendjen pas tyre. Njeriu mund të bëhet edhe mbret, edhe rojtar fushe. Por edhe mbreti, edhe rojtari i fushës vazhdojnë të kenë një pikë të përbashkët, të jenë njerëz. E nëse është kështu, do të thotë se cilësia e përgjegjësisë që merr përsipër një njeri, nuk mund ta shndërrojë atë në një qenie tjetër. Për rrjedhojë, njeriu, kudo dhe kurdo duhet ta pranojë veten si njëri prej njerëzve të tjerë.

Po qe se sistemi i quajtur "demokraci" është, ashtu siç e pranojnë disa, sistemi më i lartë në botë, Islami e pati arritur këtë lartësi shekuj më parë. Megjithatë, ne jemi kundër mendimit se Islami është një sistem demokratik.

Ja disa aspekte sociale që tregojnë për përsosmërinë e sistemit Islam.

Kur Hz. Aliu paraqitet në gjyq për të marrë pjesë në procesin me një nënshtetas jomusliman, Kadiu Shurejh i tregon vendin për t'u ulur. Hz. Aliu e refuzon duke vrenjtur vetullat. Sepse s'mund të ulet

ndërsa hasmi i tij ndodhet në këmbë! Dhe mendoni se atë ditë Hz. Aliu ishte kalifi i një shteti të madh, domethënë ishte kryetari i atij shteti!⁴²⁴¹²⁹

I Dërguari i Allahut që shkrirë me jetën, që bërë njeri i natyrshëm. Shpesh herë, ata që vinin për herë të parë në faltore, nuk e gjenin dot se kush ishte Profeti. Ata mundeshin ta dallonin vetëm sipas sjelljeve të sahabeve, pasuesve të tij ose kur ai fillonte e fliste. Gjatë emigrimit, shumica e medinasve që s'e kishin parë Profetin gjer atëherë, atë ditë kishin vrapuar t'i puthnin dorën Ebu Bekrit, se e kishin kujtuar atë për të Dërguarin e Allahut. Kur Ebu Bekri, pastaj, kishte marrë një elpaze e kishte filluar t'i bënte fresk Profetit, të gjithë e kishin kuptuar si qëndronte e vërteta. Ja, kështu kishte ndodhur, sepse i Dërguari i Allahut nuk mbante ndonjë qëndrim që ta dallonte prej Ebu Bekrit. 425

Eshtë bërë legjendare hyrja thellësisht e përrulur e Profetit në Mekë pas triumfit të saj. I hipur mbi devenë e tij, i përthyer më dysh sa koka do t'i prekte

⁴²³ Kenzu'l-Ummal, 3/113;
Metheu'z-Zevaid, 10/325.

në jelet e kafshës. Ashtu pati hyrë ai Profet 1 famshëm në atë qytet të famshëm!⁴²⁶

Një hadith i rrëfyer nga Hz. Aisheja, na tregon këto: "Në shtëpi, i Dërguari i Allahut sillej si një pjesëtar i zakonshëm i familjes. I amonte vetë rrobat e veta, riparonte këpucët dhe i ndihmonte gratë në punët e shtëpisë."⁴²⁷ Kur ai i bënte këto, emri i tij kujtohej në të katër anët e njerëzimit, njerëzit flisnin për të dhe për fenë e sjellë prej tij. Ai e rregullonte kohën në atë mënyrë që, mes aq përgjegjësish të rëndësishme, të gjente kohë edhe për punë të tilla.

Ai ishte i denjë për të qëndruar në majë të çdo tipari të bukur dhe ashtu pati ndodhur...¹³⁰

Ishte mes njerëzish

⁴²⁴ Ibni Kethir, el-Bidaje, 8/5.

⁴²⁵ Ibni Hisham, Sire, 2/137.

⁴²⁶ Metheu'z-Zevaid, 6/169; Ibni Hisham, Sire, 4/47, 48.

⁴²⁷ Tirmidhi, Shemail, 78; Mysned, 6/256.

Te njerëzit e mëdhenj, thjeshtësia dhe përulësia janë treguesit e faktit që ata janë të mëdhenj. Kurse treguesi i njerëzve të vegjël është mendjemadhësia. I Dërguari i Allahut është njeriu më i madh ndër njerëzit. Atëherë, edhe thjeshtësia e tij e tillë duhet të jetë.

Profeti, i cili në ndërtimin e faltores profetike bartte dy qerpiçë ndërsa të tjerët bartnin nga një, 428 i cili në gjurmimin e hendekut bartte dy gurë ndërsa të tjerët bartnin nga një, 419 i cili i thoshte njeriut që i rrinte përpara duke u dridhur nga impresionimi, "Mos ki frikë, o vëlla, se edhe unë, ashtu si ti, jam një njeri, nëna e të cilit ka ngrënë bukë të thatë", 430 pa asnjë dyshim, ka qenë më i thjeshti ndër njerëzit! "

Nuk e di se ç'sëmundje psikiatrike përbën të ndenjurit këmbë përmbi këmbë, por nuk kam asnjë dyshim se te njerëz të tillë ka defekte shpirtërore serioze. I Dërguari i Allahut rrinte si çdo njeri dhe sillej si çdo njeri. Çdo sjellje e tij merrte trajtë brenda një kuadri të caktuar edukate. Ai e tregonte se ishte njeri i madh duke e mbajtur gjithmonë kokën ulur dhe duke e vënë ballin në sexhde.

”Allahu e lartëson atë që tregohet i thjeshtë. Allahu ia zvarrit përtokë hundën atij që tregon mendjemadhësi!“⁴³¹

Thjeshtësia dhe përrulësia janë si dy flatra për njeriun, ato e lartësojnë atë drejt një bote të lartë mbi të lartat. Në sajë të thjeshtësisë Profeti ka kapërcyer gjërat e pakapërcyeshme dhe është bërë lideri i njerëzimit gjer në përjetësi. Njerëzit dilnin shumë të qetë para këtij lideri të zgjedhur e të shquar që kishte kapërcyer dimensionet e ngushta të vendit e të kohës dhe, po ashtu, i thoshin me qetësi ato që kishin për të thënë. Sepse edhe ai vetë ishte një njeri shumë i qetë.¹³¹

⁴²⁸.Mysned. 2/381; Ibni Hisham, Site, 2/141.

⁴²⁹. Buhari, Rikak, 17.

⁴³⁰.Mexhmeu'z-Zevaid, 9/20; Ibni Maxhe, Et' ime, 30.

Kadi Ijazi na përcjell: "Një ditë, erdhi një grua e metë, e kapi për dore të Dërguarin e Allahut dhe filloi ta tërhiqte duke i thënë t'i kryente diçka në shtëpinë e saj. Gruaja duke e tërhequr për krahu të Dërguarin e Allahut dhe sahabet duke u shkuar pas, a nisën drejt shtëpisë së saj. Pasi i dha me qetësi ndihmën që i kishte kërkuar, i Dërguari i Allahut u kthye pas."⁴³² Pavarësisht se ç'i kishte kërkuar gruaja, t'i fshinte shtëpinë apo t'i shtrydhte rrobat e lara, Profeti i ishte përgjigjur, sepse ai ishte njeri i natyrshëm dhe puna që kishte bërë, kurrsesi nuk ishte ulje e poshtërim. Një gjë e tillë s'i kishte shkuar as nëpërmend. Si mund t' i shkonte, kur ai bëhej tepër i vështirë para mohimit dhe kundërshtimit? Dhe siç thamë edhe më lart, ai ishte më i guximshmi i njerëzve. Hz. Aliu thotë: "Kur në fushën e luftës na kapte frika, fshiheshim pas shpinës së të Dërguarit të Allahut dhe ashtu mbroheshim!"⁴³³ Edhe atmosfera përreth tij u jepte besim e siguri njerëzve. Dhe përrulësia e tij vetëm prej thjeshtësisë së tij buronte.

132

⁴³¹ Kenzu'l-Ummal, 3/113;
Mexhmeu'z-Zevaid, 10/325.

Natyrshmëria

Ashtu si thjeshtësia që s'është ulje, ashtu edhe mendjemadhësia nuk është shenjë rëndësie e vlere. Ndërkaq, Profeti edhe në thjeshtësi ishte i ekuilibruar dhe qëndronte brenda kritereve të caktuara. Edhe kjo cilësi e tij na bën të themi se ai është i dërguari i Allahut!

Një gjykatës, në gjykatë duhet të jetë serioz. Kurse po ky qëndrim në shtëpi, para fëmijëve të vet, do të ishte mendjemadhësi. Në shtëpinë e vet njeriu duhet të sillet si një pjesëtar i zakonshëm i saj. Këto janë parime kuranore dhe praktikuesi më i mirë i tyre është i Dërguari i Allahut. Kurse të tjerët pas tij janë shembëllyes dhe imitues të tij.

Çdokush mund ta konsiderojë atë si më të madh ndër më të mëdhenjtë, mirëpo ai thotë kështu: “Askush nuk mund të hyjë në xhenet me punën e vet!” Atyre që e kanë pyetur, “mos vallë, edhe ti?”, u

⁴³² Kadi Ijaz, *esh-Shifa*, 1/131, 135.

⁴³³ Mysned, 1/86.

është përgjigjur: "Po edhe unë. Po qe se Allahu s'të rrethon me mëshirën e Tij!"⁴³⁴

Po, ai ishte një njeri aq i natyrshëm sa të thoshte një gjë të tillë. Ai e shihte veten si një individ mes të tjerëve, si një copë e tyre dhe, pas kësaj, sjelljet dhe qëndrimet e veta sipas kësaj mendësie i përcaktonte.

Një ditë, Hz. Omeri pati shkuar te i Dërguari i Allahut dhe i pati kërkuar leje për të bërë Umre, një vizitë në Qabe, kjo, jashtë kohës së caktuar të haxhit. Edhe për umre merrej leje prej tij. Sepse ata ishin njerëz të disiplinës. Për çdo punë e çdo preokupacion vraponin te Profeti dhe ia paraqisnin atij çështjet e tyre. Nëse në një shtëpi kishin vajzë për të martuar, prindi vinte te Profeti dhe i thoshte: "O i Dërguari i Allahut! Kam një vajzë për të martuar. Po qe se ke ndonjërin, urdhëro!.." Nëse dikush donte ta bënte bahçen e vet vakëf, fillimisht vinte te i Dërguari i Allahut dhe ia paraqiste çështjen atij. Nëse dikush donte të mbyllej në adhurim, vinte e merrte leje prej të Dërguarit të Allahut. Dhe ja, tani kishte ardhur Hz. Omeri dhe i kërkonte leje për në umre. Jo vetëm që Profeti s'do ta kthente mbrapsht, por do t'i paraqiste edhe një kërkesë, emocionet e së cilës do ta shoqëronin gjer në fund të jetës Hz.

Omerin: "O vëlla, na bëj pjesëtar edhe ne në lutjet e tua!" Lidhur me këtë, Hz. Omeri do të thoshte kështu: "Atë ditë, edhe sikur bota të ishte bërë e imja, s'do të isha gëzuar më shumë!"⁴³⁵ ¹³³

Thjeshtësia dhe dimensionimi i tij prej robi

Kjo thjeshtësi dhe përlësi tek ai i triumfante rishmë zemrat e triumfuara një herë. Me këto triumfe ai e kapte për dore ummetin e tij dhe, përmes spiraleve prej drite, e ngjiste atë në majat e kuptimit. Omeri e pati kapur qysh me lëvizjen e parë distancën që duhej të kapte. Vetëm se i Dërguari i Allahut donte t'i ngjiste ata lart e më lart. Dhe ia arriti. Prej një popullate beduinësh nxori në shesh një shoqëri prej mësuesish e prijësish. Ndërsa i lartësonte të tjerët drejt majave, edhe vetë lartësohej vertikalisht. Megjithatë, me distancat e kapërcyera, atij i shtoheshin në raport të drejtë me to vetëm thjeshtësia dhe përlësia. Sa për aspektet e egos, ai mbushej e derdhej nga ndjenjat me të cilat e shihte

⁴³⁴ Buhari, Rikak, 18.

veten si njëri prej robve të Zotit. Ahmed b. Hanbeli na rrëfen prej Ebu Hurejres:

“I Dërguari i Allahut ishte ulur e po bisedonte me Xhebrailin. Dhe s’di prej sa ditësh nuk kishte shtënë asgjë në gojë. Xhebrail ishte miku më i ngushtë i tij. Sipas një rrëfimi të dobët, i kishte pasë thënë kështu të Dërguarit të Allahut: ”Pas teje, do të zbres në tokë vetëm disa herë!” Sepse një botë pa Hz. Muhamedin (a.s.) ishte e Vetmuar edhe për Xhebrailin. (Me të vërtetë, u bënë vite që bota është bërë e vetmuar edhe për ne). Profeti i tha kështu Xhebrailit; "U bënë shumë ditë që s’kam shtënë gjë në gojë!" Në çast u dëgjua një zë si gjëmim qiellor. Një engjëll po zbriste poshtë. (Taberani thotë Se ai ishte engjëlli i madh, Israfili, a.s.). Xhebraili e njofton Profetin se është hera e parë që ky engjëll zbret në botë. Engjëlli kishte sjeHë të fala prej Zotit dhe e pyeste Profetin: “A dëshiron të bëhesh një pejgamber mbret, apo një pejgamber rob?” Përballë këtij propozimi të Zotit, Profeti rri e vështron me habi Xhebrailin. (Ai merrte nga Xhebraili, gjer në një pikë të caktuar, mësimet të afrimit shpirtëror. Madje, gjatë miraxhit, Profeti pati mbetur i mahnitur nga afërsia e Xhebrailit ndaj Zotit, gjë që e përmend në

një rast. Po, është e pamundur të njihet Zoti në atë masë që mund ta njohë një engjëll si Xhebraili). Xhebraili i bën shenjë Profetit dhe i thotë: ”Tregohu i thjeshtë para Zotit, o i Dërguari i Tij!”⁴³⁶

Fundja, a nuk e urdhëron edhe vetë Zoti Profetin me gjuhën e Kur’anit që të tregohet i thjeshtë? Sa e sa ajete të tilla si ky më poshtë ka në Kur’an: ”Dhe tregohu i thjeshtë ndaj besimtarëve që të pranuan ty!” (Kur’ani, Shuara: 215) Dhe Profeti të njëjtën gjë parapëlqeu: ”Dëshiroj të jem një peygamber rob!”⁴³⁵

Pas zgjedhjes së pozitës së robit të Zotit, Ai e bëri këtë pozitë si përkrenare për të. Në shumë vende, Kur’ani me këtë pozitë e përmend Profetin. Edhe muslimanët, kur dëshmojnë, thonë se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Allahut! Ashtu është! Ai është më parë robi, pastaj i dërguari i Allahut. Pozita e robit vjen para detyrës profetike.

⁴³⁵ Ibni Maxhe, Menasik, 5; Tirmidhi, Daavat, 109; Ebu Davud, Vitr, 23.

⁴³⁶ Mysned, 2/231, Mexhmeu’z-Zevaid, 9/18.

Çdokush mund të jetë rob i dikujt dhe mund të bartë një kular në zverk për llogari të tij. Kurse Hz. Muhamedi (s.a.s.), fillim e fund, gjithnjë robi i Allahut ka qenë! Në asnjë periudhë, në asnjë faqe të jetës së tij, s'ka ndodhur që ai t'i përulej kujt, të thyente belin para dikujt! Pozita prej robi të Zotit është ndër karakteristikat esenciale të tij. Si një shenjë e kësaj merite dhe privilegji, pozita e tij e robit të Zotit i shpallet njerëzimit pesë herë në ditë nga minaretë duke u përmendur, pranë saj, edhe detyra profetike, sepse, ashtu siç thamë edhe më lart, pozita e robit, tek ai, vjen para pozitës profetike.

Ai është robi i Zotit. Duke theksuar pozitën e tij prej robi, Zoti thotë kështu në Kur'an: "Dhe kur u ngrit robi i Allahut për ta adhuruar Atë, ata (xhindët dhe idhujtarët) u sulën kush e kush për ta parë më mirë!" (Kur'ani, Xhin: 19)

Edhe sikur këtu të bëhet fjalë për xhindët, edhe sikur të bëhet fjalë për idhujtarët e Mekës, e rëndësishme për ne është se ai është përmendur me atributin e lartë "Abdullah", "Rob i Allahut"!

Edhe në këtë ajet që tregon se Kur'ani është tjala e Allahut dhe që, në lidhje më këtë, i fton në debat ata që dyshojnë, atij i thuhet "rob": "E në qoftë se

dyshoni për Kur'anin që ia zbritëm robit tonë, atëherë sajoni një kaptinë të ngjashme dhe thirrni në ndihmë ata që u besoni, nëse jeni të sinqertë. E në s'e bëfshi dot, gjë që s'keni për ta bërë dot kurrë, ruhuni nga zjarri, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët dhe që është përgatitur për mosbesimtarët!" (Kur'ani, Bakara: 23-24)

Përsëri, duke folur për të nisur nga pika e lartë ku qe ngritur, Kur'ani flet duke theksuar pozicionin e tij si rob i Zotit: "E lartë është fama e Atij që robin e Vet e kaloi një natë nga Mesxhidi Harami* në Mesxhidi Aksa** për t'ia treguar atij një pjesë të argumenteve. Vërtetë, Ai dëgjon dhe sheh!" (Kur'ani, Isra: 1)

Bojkoti dhe, më pas, vdekjet e Hz. Hatixhesë e të Ebu Talibit pothuajse e patën lënë mes njerëzve krejt të pambrojtur të Dërguarin e Allahut. Kur qenë thyer të gjitha pajandrat tek të cilat mbështetej ai dhe nuk pati mbetur degë për t'u kapur, ishte Allahu ai që e pati ngushëlluar, Allahu që zotëron të gjitha shkaqet. E pati ngushëlluar në konstelacionin e Unitetit të Tij*** me mëshirën e Tij të përsosur. Sipas shprehjes së mendimtarit të madh të kohës, Said Nursi, Drita e

Unitetit në atë konstelacion që dukur dhe Profeti që ftuar përtej qiejve për ta parë Zotin e tij, Sundimtarin e tij dhe Zotërinë e tij dhe që pritur atje si mik i nderuar...

Qëllimi ynë kryesor këtu nuk është të tregojmë për miraxhin Por qemë tëdetyruar tëbënim këtëhyrje meqëllim që t'ju tërheqim vëmendjen për një specifikë të tillë. Duke treguar për një mrekulli të tillë si miraxhi, Allahu nuk e përmend Profetin me asnjërin prej emrave me të cilët përmendet ai në Kur'an, Ungjill dhe Teurat, domethënë me emrat Muhamed, Ahmed dhe Ahjed, por me atributin "Rob" dhe, siç cituam më sipër, thuhet "...robin e Vet..." Dhe me këtë sikur kërkon t' i thotë se, meqë Profeti zgjodhi të ishte rob, edhe Zoti e shndërroi këtë pozitë në një vlerë të lartë duke e pranuar si vlerën më të madhe në mbarë botën. Prandaj, edhe kurdo që të bëjë fjalë për vlerën e Profetit, Zoti do ta përfaqësojë atë me pozitën e robit, ashtu që kur muslimanët të dëshmojnë, të përmendin më parë pikërisht këtë pozitë për të, pastaj detyrën profetike

duke e shpallur me zë të lartë këtë në të katër anët e botës...¹³⁵

Dhe një pëmbledhje...

Në librat e moralit dhe etikës , i Dërguari i Allahut përshkruhet në të gjitha aspektet e natyrës e të karakterit të tij. Siç ishte i përsosur në aspektin fizik, ai ishte i përsosur edhe në aspektin shpirtëror e të karakterit. Në një përshkrim të mbështetur në fjalët e Hz. Aliut, i Dërguari i Allahut na tregohet kështu: "Në bujari, i Dërguari i Allahut është më bujari dhe dorëploti i njerëzve. Për nga butësia dhe

* Mesxhid-i Haram: Faltorja e Qabes në Mekë.

**Mesxhid-i Aksa: Faltorja në Jerusalem.

*Në origjinal: Ehadijet.

gjerësia, zemra e tij është më e buta dhe më e gjëra zemër e njerëzve. Atij i qenë ngarkuar ngarkesa të rënda që i pati ngritur pa bërë "of!", u pati vënë gjoksin punëve të papërballueshme e që s't'i rrok mendja dhe pati vepruar gjithmonë njerëzisht ndaj çdo lloj mundimi, torture dhe mungese njerëzie. Ai përfaqëson ndër njerëz mënyrën më të qëlluar të të shprehurit." Ai është njeriu më i drejtë në fjalë. Edhe duke bërë shaka, nuk ka ndodhur që të shfaqet edhe kontradikta më e vogël në fjalët e tij. Nga goja e tij nuk ka dalë gënjeshtër as edhe në ëndërr. Është ulur drejt, është ngritur drejt, ka menduar drejt, ka folur drejt dhe i ka ftuar të tjerët të drejta. Ai ishte jashtëzakonisht i natyrshëm. Po t'i rrinin pranë, kurrsesi s'do të ndjeheshit i shqetësuar. Iu qetësonte sikur të ishit duke ndenjur me një shokun tuaj. Kishte një natyrë dhe një shpirt të lartë që asnjë njeri nuk mund të ngjitej në nivelin e tij, nuk mund të rrinte si ai, nuk mund të mendonte si ai dhe nuk mund të bëhej si ai. Ai zbriste me thjeshtësi në nivelin e bashkëbiseduesve ose të kuvendit dhe ata që kishte pranë kurrë nuk i shtypte me ndryshimin që kishte me ta dhe nuk u shkaktonte shqetësim.⁴³⁷ Nëse dikë do të shihte se një njeri nuk mund të ecte

si ai vetë, do të fillonte të ecte me hapin e më të dobët. Fundja, ishte ai vetë që e këshillonte një gjë të tillë. Ky parim i përgjithshëm që përfshin të gjitha unitetet e jetës gjente zbatim dhe mbështetje gjithmonë tek ai.

Ai ishte më fisniku i njerëzve për nga prejardhja. Kushdo që do ta shihte, do ta donte atë. Sidomos ata që i ndodheshin pranë, e donin më shumë se kushdo tjetër. Hz. Ebu Bekr ishte njeriu që i rrinte më pranë e që e donte më tepër.¹³⁶

Eshtë e pamundur të tregohet një njeri i dytë që të jetë dashur si ai, as para tij, as më pas. Kush me fjalë e kush me qëndrim, por të gjithë njerëzit, me tërë sinqeritetin dhe dëshirën e brendshme të tyre kanë thënë pa pushim e do të thonë:

Përse zemra është e shtënë kaq shumë pas teje,

Përse bukuria jote ndrit si dita, e përse?

⁴³⁷ Ibni Kethir, Shemail, 44;
Tirmidhi, Menakib, 8.

*Po, ashtu është. Sepse ai është i dashuri i
Zotit të Botëve...*